

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

GJENOCIDI DHE MASAKRAT E SERBISË NË KOSOVË (1998-1999)

Konferencë shkencore

(28 prill 2023)



KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

GENOCIDE AND MASSACRES OF SERBIA IN KOSOVA (1998-1999)

Scientific Conference

(28 April 2023)

Prepared for publication by: Correspondent Member Frashër Demaj

Organizing Committee:

Isa Mustafa, Jusuf Bajraktari, Arsim Bajrami, Ramë Manaj, Frashër Demaj.

Editor: Correspondent Member Gjyljeta Mushkolaj, Secretary of the Section of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

GJENOCIDI DHE MASAKRAT E SERBISË NË KOSOVË (1998-1999)

Konferencë shkencore

(28 prill 2023)

Përgatiti për botim: Anëtar korrespondent Frashër Demaj

Këshilli organizues:

Isa Mustafa, Jusuf Bajraktari, Arsim Bajrami, Ramë Manaj, Frashër Demaj.

Redaktor: Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.



Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
Isa Mustafa DHUNA SI MJET PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE POLITIKE.....	9
Josef Martinsen GJENOCIDI NË KOSOVË BAZUAR NË DOKUMENTACIONIN TIM.....	29
Rudina Jasini PJESËMARRJA E VIKTIMAVE SI PALË CIVILE NË PROCESET PENALE NDËRKOMBËTARE	41
Hivzi Islami TENDENCAT SERBE PËR SHKATËRRIMIN E THEMELEVE TË JETËS SË SHQIPTARËVE.....	67
Ksenofon Krisafi TRAJTIMI I MASAKRAVE SERBE NË KOSOVË SIPAS TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE.....	95
Arsim Bajrami GJENOCIDI I SERBISË NË KOSOVË: NDËRMARRJE E PËRBASHKËT SHTETËRORE KRIMINALE	139
Frashër Demaj MASAKRA E REÇAKUT, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT.....	171
Salih Krasniqi KRIMET SERBE NDAJ PACIENTËVE DHE PERSONELIT SHËNDËTËSOR SHQIPTAR.....	191
Mimoza Shahini TRAJTIMET E SPECIALIZUARA TË TË MBIJETUARVE TË MASAKRAVE DHE GJENOCIDIT NË KOSOVË.....	217

Muhamedin Kullashi	
NDRIÇIMI DHE MOHIMI I KRIMEVE NË KOSOVË NGA DISA RRYMA POLITIKE E INTELEKTUALE FRANCEZE NË VITET 1998-99	233
Teqi Kurti	
MASAKRAT SERBE NË KOSOVË SIPAS MEDIEVE NDËRKOMBËTARE (1998-1999)	257
Ismet Salihu	
MASAKRAT E FORCAVE SERBE NË KOSOVË DHE PERSONAT E ZHDUKUR 1998-1999	265
Eglantina Kraja Bardhi	
DHUNA DHE PËRDHUNIMET NGA FORCAT SERBE GJATË LUFTËS NË KOSOVË 1998-1999	273
Ramë Manaj	
TIPOLOGJIA E MASAKRAVE TË LUFTËS 1998-1999 NË KOSOVË.....	283
Jusuf Osmani	
MASAKRAT NDAJ GRAVE, PLEQVE, FËMIJËVE DHE TË BURGOSURVE NË KOSOVË MË 1998-1999	293
Arbër Hadri	
RELACIONE TË DEPARTAMENTIT TË SHTETIT TË SHBA- SË, LIDHUR ME SPASTRIMIN ETNIK TË POPULLIT SHQIPTAR DHE KRIMET SERBE KUNDËR NJERËZIMIT NË KOSOVË (1999)	313
Sadik Krasniqi, Besnik Rraci	
MASAKRAT SERBE NË KOSOVË 1998-1999 - SIPAS DËSHMIVE MATERIALE MUZEORE	331
SHTOJCË.....	349
DËSHMI TË TË MBIJETUARVE NGA MASAKRAT E POLICISË, USHTRISË DHE NJËSIVE PARAMILITARE SERBE GJATË LUFTËS NË KOSOVË.....	349

PARATHËNIE

Lufta e viteve 1998-1999 në Kosovë pati pasoja të rënda të cilat rezultuan me humbje jetë njerëzish, vrasje, masakra, përdhunime, plaçkitje, djegie të shtëpive, kidnapime njerëzish dhe rreth 1600 të pagjetur për fatin e të cilëve nuk dihet as sot. Veprimet e forcave serbe (policisë, ushtrisë dhe formacioneve paramilitare) të komanduara nga hierarkia ushtarake serbe e cila ishte nën urdhrat direkte të politikës zyrtare të udhëhequr nga presidenti serb Milosheviç, ushtruan dhunë e terror ndaj popullsisë civile shqiptare pa kursyer fëmijë, gra e pleq dhe pa respektuar në asnjë moment konventat ndërkombëtare të luftës.

Tendenca e Serbisë për gjenocid ndaj shqiptarëve zunë fill që nga gjysma e parë e shekullit XIX me “Naçertania”-n kur Serbia filloi me projekte të organizuara shtetërore antishqiptare më qëllim vrasjen, dëbimin dhe asimilimin e shqiptarëve dhe pushtimin e tokave të tyre. Vazhdimin e politikës shfarosëse ndaj shqiptarëve, Serbia e shfaqti edhe në kohën e luftërave ballkanike dhe Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913) kur përveç Kosovës kërkonte të pushtonte edhe vise të tjera shqiptare në veri dhe verilindje të territoreve shqiptare me synim pushtimin dhe daljen e përhershme në detin Adriatik. Të gjitha këto synime i mbështeti me veprime politike dhe ushtarake duke vrarë e masakruar popullsi të pambrojtur dhe të paarmatosur shqiptare. Tendencat me premisa gjenocidale shteti serb i rishfaqti edhe në kohën e Luftës së Parë Botërore (1914-1918) duke vrarë e terrorizuar shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera të mbetura jashtë Shqipërisë së vitit 1912-1913. Periudha në mes dy luftërave botërore u karakterizua me shpronësim, reformën agrare dhe kolonizimin e Kosovës me kolonë serbë e malazezë me qëllim të shpopullimit dhe ndryshimin e balancës demografike të Kosovës.

Në kohën e Luftës së Dytë Botërore 1939-1944, vazhdojnë tendencat antishqiptare pavarësisht se këta të fundit ishin pjesë e koalicionit antifashist dhe synimet e tyre ishin të mbështetura në Kartën e Atlantikut, UNÇJ-, UNÇSH dhe aleatët e mëdhenj të luftës antifashiste që pas përfundimit të luftës dhe fitores kundër fashizmit secili popull do të përcaktohej për të ardhmen e vet politike. Mirëpo, mospërfshirja e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në vendimet e Mbledhjes II të KAÇKJ –së, që ishte mbajtur në Jajce, më 29-30 nëntor 1943, ishte një paralajmërim për injorimin e interesave të Kosovës dhe shqiptarëve pas përfundimit të luftës.

Dhuna dhe terrori serb ndaj shqiptarëve vazhdoi me masakrën e Tivarit, vendosjen e administrimit ushtarak 1945, aksionin e mbledhjes së armëve 1956, shuarjen e dhunshme të demonstratave të vitit 1968, demonstratave të vitit 1981, suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitin 1989, burgosjen e udhëheqësve shqiptarë të Kosovës, vrasjen dhe burgosjen e protestuesve shqiptarë 1989-1992, dëbimin masiv të shqiptarëve nga puna, dëbimin e nxënësve, studentëve dhe personelit të mësimdhënësve nga objektet shkollore dhe universitare dhe luftën e vitit 1998-1999.

Shumë shqiptarë u detyruan të shpërngulen në Turqi (si rezultat i konventave jugosllavo-turke), në Shqipëri e më vonë edhe drejt vendeve perëndimore për të shmangur represionin dhe për të mos u gjuhëzuar para dhunës shtetërore serbe.

Serbia duke përdorur forcat policore, ushtarake, njësitë paramilitare të mobilizuara me serbë lokalë, të tjerë të ardhur nga Serbia dhe mercenarë kryesisht rusë, nga viti 1997 intensifikoi dhunën dhe terrorin ndaj shqiptarëve në çdo cep të Kosovës. Ofensivat e forcave serbe lanë shumë të vrarë e të plagosur gra, pleq e fëmijë të moshave të ndryshme. Masakra e Reçakut, Qirezit, Likoshanit, Abrisë, Izbicës, Mejës, Korenicës, Dobroshit, Guskës, Krushës së Vogël, Krushës së Madhe, Pastaselit, Lubeniqit, Qyshkut, Rogovës, Celinës, Belegut, Kralanit, Slllovisë, Ribarit të Vogël, Grashticës, Studimes etj. nxorën në sipërfaqe tendencën serbe për gjenocid ndaj shqiptarëve.

Pra, shqiptarët e Kosovës janë përballur historikisht me dhunë e represion me qëllim të mohimit të drejtave të tyre, historike, politike, ekonomike-pronësore, qytetare e kombëtare. Vitet 1998-99 të karakterizuara me vrasje, ekzekutime masive, masakra të përcjella me shpërfytyrim të viktimave, rrahje dhe tortura të të zënëve robër dhe të burgosurve, përdhunimet, dëbimet me forcë, shkatërrimi i kartave të identitetit, plaçkitja, shkatërrimi dhe djegia e pronave të shqiptarëve në fshatra e qytete e deri te deportimi masiv i shqiptarëve, përbën një përpjekje të organizuar shtetërore serbe për shkatërrimin total të Kosovës dhe shqiptarëve.

Prandaj për të nxjerrë në sipërfaqe të vërtetën historike dhe për të trajtuar çështje të rëndësishme nga periudha e viteve 1998-1999, e sidomos për të sjellë argumente shkencore për gjenocidin dhe masakrat e Serbisë në Kosovë, Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK-ut, organizoi Konferencë shkencore multidisiplinare për të trajtuar aspekte historike, politike, diplomatike, ekonomike, demografike, juridike, mjekësore, psikologjike dhe muzeore për të vërtetën historike të kësaj periudhe, të cilat botohen në këtë vëllim të veçantë.

Frashër Demaj

Isa Mustafa

DHUNA SI MJET PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE POLITIKE

Abstrakt

Etapa të ndryshme të historisë përshkruajnë vuajtje dhe tragjedi që kanë përjetuar popujt për shkaqe politike, ekonomike, kombëtare, kulturore e fetare. Kësisoj, shqiptarët e Kosovës janë ballafaquar pareshtur me forma të ndryshme të dhunës dhe presioneve me qëllim të dëbimit të tyre dhe spastrimit etnik. Dhuna shtetërore, politike, ushtarake dhe policore ndaj shqiptarëve mori hov dhe përmasa të gjera në fundshekullin që e lamë pas. Ishte rast i veçantë pas Luftës së Dytë Botërore, që një shtet, si Serbia, me manipulimet për qëllime politike me etninë, kulturën dhe faktorët historikë organizoi dhe ekzekutoi shpopullimin, dëbimin dhe shpërnguljen e më shumë se gjysmës së popullsisë shqiptare nga Kosova dhe mbi një të katërtën e zhvendosi jashtë shtëpive të tyre, duke e bërë gjithë këtë nën maskën e çështjeve të brendshme.

Dëbimet me forcë, vrasjet, ekzekutimet masive, masakrat të përcjella me çhumanizim të viktimave, rrahjet, torturat, dhunimet seksuale, ndarjet nga familja dhe zhdukjet, mburojat njerëzore, pastrimi i identitetit, shkelja e neutralitetit mjekësor ishin vetëm disa nga veprimet serbe që lanë pas vetes shumë viktima njerëzore, shtëpi, fshatra e qytete të shkatërruara. Format e tilla të dhunës u përdorën si instrumente për të terrorizuar popullsinë civile, për të grabitur pronat e tyre, për të zhvatur para nga qytetarët-ngjashëm me kohën e holokaustit, dhe që t'i shtyjnë të largohen nga shtëpitë e tyre dhe nga Kosova. Politika e dhunës dhe luftës e cila eskaloi në masakra u përcoll me propagandë të orkestruar me qëllim të përgatitjes dhe bindjes së opinionit për të drejtat e agresorit. Ishte një luftë e pabarabartë e zhvilluar nga Armata jugosllave, Forca policore serbe dhe njësitë paramilitare përkrahur nga Kisha ortodokse serbe kundër popullsisë së paarmatosur dhe njësive vullnetare të UÇK-së, të armatosura keq, që vepronin në zona të ndryshme për të mbrojtur shtëpitë dhe vendin e tyre.

Rasti i Kosovës tregoi rëndësinë e ndërhyrjes ndërkombëtare për të shmangur katastrofën e madhe njerëzore dhe shënoi një kthesë në fillimin e rendit të ri botëror, në të cilin vlerat humanitare do të kenë përparësi ndaj sovranitetit shtetëror.

Fjalët çelës: dhuna, politike, forcat policore, Kosova, UÇK, lufta.

Hyrje

Në vitin 1989 Serbia suspendoi me dhunë autonominë e Kosovës, instaloi aparteidën në ekonomi, arsim, shëndetësi e kulturë dhe vazhdoi me dhunë shtetërore, e cila si pasojë pati mijëra të vdekur, shkatërrimet e shtëpive, ekonomisë dhe infrastrukturës. Ligjet diskriminuese serbe quan në vrasjet masive dhe individuale të shqiptarëve dhe konfiskimin e pronave dhe pasurisë së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. Ushtria jugosllave e dirigjuar nga Serbia, si dhe policia serbe kanë kryer shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut, veprime që janë vlerësuar si krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Hetimi i këtyre krimeve është penguar nga autoritetet jugosllave dhe serbe, por janë një sërë organizatash të pavarura të të drejtave të njeriut, organizata kosovare për të drejtat e njeriut, organizata serbe për të drejta të njeriut, studiues të Kombeve të Bashkuara dhe të qeverive nga vende demokratike, që kanë hetuar dhe raportuar për to si dhe disa rezoluta të Kombeve të Bashkuara të cilat kanë kërkuar t'i jepet fund dhunës (Iacopino, 1999). Nga organizatat ndërkombëtare veçohen Human Rights Watch, Amnesty International, Mjekët për të Drejtat e Njeriut (PHR), Shoqëria për Popujt e Kërcënuar, Federata Ndërkombëtare e Lidhjeve për të Drejtave të Njeriut, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Komiteti i Juristëve të Minesotës për të Drejtat e Njeriut. Shoqata Amerikane e Avokatëve, Iniciativa për Ligjin e Evropës Qendrore dhe Lindore (ABA/CEELI), Shoqata Amerikane për Avancimin e Shkencës (AAAS), Qendra për Paqe Përmes Drejtësisë. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, në sesionin e 55-të të Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë, më 7 prill 1999 kishte deklaruar se në historinë e njerëzimit, “midis gjithë dhunimeve flagrante, gjenocidi nuk barazohet me asnjë...shenja të të cilit duken se janë duke u vërejtur edhe në Kosovë”. Kombet e Bashkuara duhet të zhvillojnë një mënyrë për të ndëshkuar vendet dhunuese që pretendojnë se problemet e tyre etnike janë një çështje e brendshme në të cilën bota nuk ka të drejtë të ndërhyjë, thoshte Anan.

Dhuna politike në Kosovë eskaloj veçmas pas nënshkrimit të Marrëveshjes së paqes të Dejtonit në fund të vitit 1995, e cila anashkaloi Kosovën. Serbia intensifikoi sulmet e policisë kundër shqiptarëve, kundër UÇK-së, familjeve të njohura dhe intelektualëve shqiptarë. Ndërkaq, shpërthimi i luftës së armatosur mori hov në vitin 1998 dhe intensitet të veçantë gjatë kohës së operacioneve të NATO-s kundër çaqeve ushtarake serbe në vitin 1999. Ofensiva e qeverive serbe e jugosllave

në Kosovë që filloi më 20 mars 1999, vetëm katër ditë para se të fillonte bombardimi i NATO-s, (Abrahams, 2001) përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës më 11 qershor 1999.

Dhuna politike

Në rastin e dhunës politike mund të flitet për determinizëm shumëkauzal, sepse ajo nxitet nga ndërthurja e shumë faktorëve. Mider, D. (2014) thekson se “mund të dallohen tre grupe të përcaktuesve të dhunës politike. Grupin e parë, ai e referon si *përcaktues strukturorë* brenda strukturës shoqërore. Modelet dhe normat kulturore që veprojnë brenda kulturës ose nënkulturës dominuese, formojnë grupin e dytë të burimeve të dhunës, të referuara si *përcaktues kulturorë të dhunës*. Grupi i tretë – *përcaktuesit individualë* ose socio-psikologjikë të dhunës në politikë – cilësohen si faktorë individualë, zakonisht subjektivë, të lidhur me emocionet”.

Studiuesit që kërkojnë burime të dhunës politike brenda strukturave të pushtetit kanë treguar fillimisht se nevoja politike është përcaktuesi kryesor, ndërkaq interesi ekonomik vihet në dukje si një përcaktues tjetër shumë i rëndësishëm i dhunës politike. Vrasjet zakonisht janë të nxitura nga politika zyrtare e shtetit dhe kryhen pavarësisht nga mosha apo gjinia, raca feja apo gjuha, për motive të qarta politike dhe ekonomike.

Duke trajtuar identitetin etnik dhe konfliktet, Negash, M. H. (2013) konstaton se tensioni etnik nuk është kërkesa e njerëzve për të siguruar ndonjë përfitim; përkundrazi përdoret nga elitat politike si instrument për të çuar përpara interesin e tyre nëpërmjet mobilizimit të popullit. Etnia, kultura dhe faktorët historikë manipulohen kryesisht për qëllime politike që në rastin e Serbisë rezultuan me veprime të dhunshme represive dhe shfarosëse kundër shqiptarëve në Kosovë. Sipas tij, edhe pse shkak kryesor i dhunës është politik, përvojat kanë treguar se sapo të ndodhë konflikti, identiteti etnik, kultura dhe historia luajnë një rol kryesor për të manipuluar dhe nxitur mbështetjen për kauzën shtetërore.

Winston Churchill në fjalimin e tij në gusht të vitit 1941 thoshte: ”Jemi në prani të një krimi pa emër (Lemkin, 1946). Në fakt, nuk shkoj gjatë dhe dhuna politike mori emër dhe sinonime, si masakra. Shkatërrime, spastrime etnike, gjenocid, holokaust. Emëruesi i përbashkët i tyre është shkatërrimi biologjik dhe kulturor i një populli. Sipas Gallant-

it (2001), masakra është një koncept elastik me gamë të gjerë të ngjarjeve. Atë e përshkruajnë etapa të ndryshme të historisë, vuajtje dhe tragjedi që kanë përjetuar popujt për shkaqet politike, ekonomike, fetare, kombëtare e kulturore. Si të tilla, masakrat përshkruhen si *politicide*, të projektuara që përmes pastrimit politik të popullsisë të ruhet ekuilibri i pushtetit, dhe si *gjenocidale*, me qëllim të ngjalljes së frikës ose zhdukjes së një grupi të caktuar etnik (Uekert, 1995). Në të vërtetë, masakra konsiderohet si *strategji e shkatërrimit*, prej të cilave, njëra nga strategjitë synon *nënshtrimin e një populli*, kurse tjetra *çrrënjosjen e tij*. Kjo vërtetohet qartë në Kosovë. Serbia synoi nënshtrimin e shqiptarëve, por kur nuk ia arriti, provoi çrrënjosjen e tyre.

Në trajtimin e shkaqeve të masakrave Dutton, D. G. (2007) kërkon përgjigje në pyetjet: “Si mund të transformohen njerëzit që duken normalë deri në atë pikë sa të vrasin, torturojnë dhe shijojnë dhimbjen e njerëzve të tjerë? A është ky një potencial në të gjithë ne, një burim i trashëguar dhune? Nëse po, cilët janë mekanizmat e tij? Si ndodh që njerëzit që ne i shohim si patologjikë.... – përdhunuesit, vrasësit serialë, sadistë – pasqyrohen kaq shpesh gjatë luftërave”? Lidhur me këtë mbizotërojnë pikëpamjet se barbaria nuk është një predispozitë biologjike, por se ajo mësohet, kultivohet dhe përsoset në ndërveprim me të tjerët. Aktet e masakrave, siç janë argumentuar nga Semelin, “nuk janë një shprehje e pushtetit nga një regjim i fortë, por një shenjë e dobësisë së tij”. Në luftën e fundit, në Kosovë, por edhe në Bosnjë e Hercegovinë masakrat u përcollën me çhumanizim të viktimave, veprim ky si metaforë e bishave, ujqërve, egërsirave. Gjymtimi i trupit dhe gjymtyrëve si dimension simbolik, sipas Dwyer dhe Ryan (2012), kryhet për të mbjellë frikë te të tjerët, si mision themelor i dhunës politike.

Në *Psikologjinë e turmave* Gustave Le Bon (1895), (Psychologie des Foules), e përshkroi sjelljen e turmave revolucionare në revolucionin francez si tregues të asaj që ai e quajti "mendje grupore", turma apo "grupe psikologjike". Në këtë formë, thoshte ai, sugjestibiliteti i individit kontrollohet nga mendja e grupit-turmës. Për Freud. S.(1955), turma prodhoi liderë fanatikë e të rrezikshëm, të lidhur me këdo përveç vetes dhe ndjekës që ishin të lidhur me këta liderë, sepse përfaqësonin një formë të vetvetes ideale. Frojdi i shikonte ndjekësit si skllavërues ndaj lideri, që vinin me një etje për bindje, gjë që e bëri kombinimin lider-pasues një sinergji të natyrshme dhe të dyanshme.

Në veprën e tij me një titull shumë simbolik “Mos lini asnjë të tregojë historinë” që i kushtohet gjenocidit në Ruanda, Forges, A. D.

(1999) thotë se “ky gjenocid erdhi nga zgjedhja e qëllimshme e një elite për të nxitur urrejtje dhe frikë për të mbajtur veten në pushtet. Organizatorët edhe vrasësit që ekzekutuan gjenocidin nuk ishin demonë dhe as automatikë që u përgjigjeshin forcave të pashmangshme; ata ishin njerëz që zgjodhën të bënin keq”.¹ Hardin (1995) me të drejtë vërejtë se në Jugosllavinë e shpërbërë postkomuniste nuk ishte e kaluara ajo që diktonte të tashmen, por e tashmja që manipuloi të kaluarën. Duke marrë shembuj nga Bosnja e Hercegovina dhe nga Ruanda, Hardin shpjegon pse vetëm urrejtja nuk i fillon domosdoshmërisht luftërat, por se si udhëheqësit e kultivojnë urrejtjen për të mobilizuar njerëzit e tyre për konflikte dhe luftë.

Qëllimet dhe logjika e masakrave të pushtetit serb ilustrohen qartë në dëshminë e profesor Paul Williams (2019) para Komisionit për Punët të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, 30 prill 2019, i cili shprehet “gjatë luftërave jugosllave, forcat e armatosura iu bashkuan regjimin serb për të kryer gjenocid, vrasje masive, tortura, përdhunim masiv, dëbim masiv, si mjet për të arritur Serbia objektivat ushtarake dhe politike; kjo fushatë terrori dhe shkatërrimi është projektuar dhe zbatuar në nivelet më të larta të regjimit serb, e cila kërkonte dhjetëra mijëra individë të gatshëm për të kryer krime të tilla, dhe la qindra mijëra viktima në vazhden e saj”.

Komuniteti ndërkombëtar evropian dhe botëror është treguar i ngadalte; i ngathët në vendimmarrje dhe i luhatshëm në ndërhyrje për të ndaluar dhunën, masakrat dhe gjenocidin. Kësisoj, Mider, D. (2014) konstaton se ekziston një dualizëm i rrezikshëm në kulturën perëndimore që i referohet perceptimit të dhunës politike. Nga njëra anë, dënohet qartë dhe pa kushte çdo manifestim i dhunës e nga ana tjetër kemi të bëjmë me fenomenin e abuzimit dhe standardizimit të dhunës në praktikën politike. Sipas tij, kjo është pasojë e kulturës evropiane, e cila në të kaluarën u zhvillua përmes dhunës së jashtme në formën e pushtimit, luftërave, kolonializmit e shfrytëzimit dhe dhunës së brendshme – mbi bazën e revolucioneve politike dhe sociale, grushteve dhe konflikteve etnike.

Politikat e dhunës dhe luftës, që përfundojnë me masakra zakonisht përcillen me propagandë të orkestruar brenda dhe jashtë me qëllim të përgatitjes dhe bindjes së opinionit për të drejtat e agresorit. Duke

¹ Në vitin 1994, të paktën gjysmë milioni njerëz vdiqën në gjenocidin në Ruandë, rreth tre të katërtat e popullsisë Tutsi dhe mijëra Hutu, të cilët kundërshtuan fushatën e vrasjes dhe forcat që e drejtonin atë.

kërkuar përgjigje në pyetjen se a është mjet apo qëllim propaganda e luftës, në veprën *Mein Kampf* (Lufta ime) të (Adolf H, 1940, fq.156) thuhej se propaganda është mjet dhe se ajo duhet gjykuar nga pikëpamja e qëllimit, prandaj forma e propagandës duhet t'i përshtatet qëllimit të cilit i shërben. Përdorimi i propagandës për të theksuar pabarazinë midis asaj që kundërshtari thotë dhe bën është treguar si strategji e fuqishme në çdo fushatë në një luftë asimetrike. Propaganda është përdorur në mënyrë strategjike për efektet e synuara të veprimeve vetjake (Ingram dhe Reed, 2016).

Propaganda serbe ishte e madhe, ajo ishte e mbushur me shembuj se si mashtrimi ose gënjeshtria e hapur në mesazhe mund të kenë efekte mbi besueshmërinë e cila vazhdonte akoma nga disa qarqe ndaj Serbisë. Se gënjeshttrat janë në qenien e shtetit serb vërtetohet më së miri thënia e Çosiq.D. (Deobe, 1961), “Gënjeshttra është interes shtetëror serb”.

Lufta dhe spastrimet etnike nga diktatorët janë promovuar si një mjet për zhdukjen e popujve të tjerë dhe pastrimin e hapësirës për shëndetin e specieve, forcës dhe zhvillimit të kombit të tyre. Logjika naziste e autoritetit shtetëror funksiononte e bazuar në popullizëm, në pushtet si forcë dhe në traditë. Nga kjo logjikë nuk dallonin veprimet serbe kundër shqiptarëve, boshnjakëve e kroatëve. Pikëpamjet naziste mbi racën ariane, si dhe për kultivimin e saj; mbi rrezikun e kryqëzimeve midis dy qenieve me standarde jo të njëjta, mbi peshimin e elementeve inferiore mbi ato superiore, nëse nuk kryhet korrigjimi i kësaj gjendjeje (Adolf, H. 1940, fq.390-411) quan në zhdukjen e miliona hebrenjve dhe popujve të tjerë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por te gjermanët pas luftës ndodhi procesi i pranimit të fajit të tyre për pasojat e tmerrshme të luftës. Shteti serb dhe serbët edhe sot e kësaj dite nuk kanë treguar ndjenja të pranimit të fajit as të pranimit të krimeve mizore që ata i kryen në Kosovë.

Shtrimi i rrugës për diskriminim dhe zhbërjen e shqiptarëve të Kosovës

Etnonacionalizmi serb lëshoi rrënjë të thella qysh nga mesjeta, duke u thirrur në mitologji e duke portretizuar serbët në vazhdimësi si viktima të historisë. Vitet e mesme të shekullit të 19-të shënuan mbledhjen dhe transkriptimin e poezisë epike fshatare sidomos për Betejën e Kosovës. Ishin këto përpjekje që humbjet e tyre t'i mbulojnë me stereotipa etnike dhe kombëtare, me rrëfime ciklike për lirinë, tradhtinë,

skllavërinë, mërgimin, robërinë dhe nevojën e luftës. Spastrimi etnik është një pasardhës i drejtpërdrejtë i kësaj qasjeje të nxitur nga shtrembërimet e së kaluarës; janë këto mizoritë që shënuan masakrat dhe debimet e shqiptarëve nga trojet e tyre. Në këtë formë, politika dhe intelektualët serbë, duke i shërbyer pushtetit, punuan që të manipulojnë të kaluarën për qëllime të kohës aktuale. Reforma agrare ndërmjet dy luftërave botërore, Elaborati i Çubrilloviqit i vitit 1937 dhe 1944 për dëbimin e shqiptarëve, ai i Ivo Andriqit (nobelist serb) i vitit 1939, aksioni i grumbullimit të armëve i Rankoviçit i vitit 1955 dhe 1956, Libri i Kaltër i Komitetit të Serbisë i vitit 1977, Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë i vitit 1987. Në këtë formë fryma nga “Naçertanije” e Garashaninit, e vitit 1844 u vazhdua me idetë për Serbi të Madhe etnikisht homogjene, për shpërnguljen e shqiptarëve me presion shtetëror, me marrjen e të drejtave dhe tokës dhe duke shkatërruar kulturën e tyre.

Pas Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974, kur ndodhi edhe reforma kushtetuese në nivel të ish-Jugosllavisë, Serbia përmbloodhi pakënaqësitë e saj në një dokument të kohës, i quajtur “Republika Socialiste e Serbisë dhe Krahinat Autonome në përbërjen e saj – pozita kushtetuese dhe praktika“. Dokument që u njoh si Libri i Kaltër, doli në dritë më 11 mars 1977, atakonte pozitën duale të krahinave, si element i barabartë në Federatë, pavarësia e krahinave në fushën e mbrojtjes dhe lidhjen e tyre me Federatën, pavarësia e politikave ekonomike dhe e rregullimit ligjor. Për rreth dy vite, Libri ishte një iniciativë e brendshme e një grupi politikanësh dhe intelektualësh serbë që përfaqësonin lëvizjen për unitarizëm. Idetë e Librit të Kaltër u rikthyen në vitet tetëdhjetë me Memorandumin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (SANU) që u shfaq në publik në vitin 1986 si një "dokument i papërfunduar" nga një grup akademikësh dhe intelektualësh, 206 shkrimtarë, ekonomistë, historianë, filozofë dhe gjuhëtarë dhe u bë agjendë politike e Serbisë.

Memorandumi ishte kritikë e hapur ndaj zhvillimeve në ekonomi, pohonte se populli serb ishte shfrytëzuar dhe zhveshur politikisht në ish-Jugosllavi, duke përfunduar se viktimitë e të gjitha padrejtësive që u institucionalizua me Kushtetutën e vitit 1974 ishin serbët. Memorandumi akuzonte se “dëbimi i popullit serb nga Kosova është një dëshmi spektakolare e disfatës historike dhe se kjo luftë sipas tyre e veçantë dhe e hapur iu shpall popullit serb në pranverën e vitit 1981”. Të drejtat e shqiptarëve, cilësoheshin si shqiptarizim i Kosovës, duke aluduar se shqiptarizimi i Kosovës u përgatit në mënyrën më legale me njësimin e

gjuhës letrare, emrit kombëtar, flamurit, teksteve shkollore - sipas udhëzimeve nga Tirana. Në këtë formë, pohohej se komplotet, të cilat zakonisht kurdisen fshehurazi, në Kosovë u krijuan jo vetëm haptas, por edhe demonstrativisht. SANU theksonte...se fati i Kosovës mbetet një çështje jetike për mbarë popullin serb. Nëse nuk zgjidhet me një rezultat të vërtetë të luftës së imponuar, nëse nuk vendoset siguria e vërtetë dhe barazia e qartë, nëse nuk krijohen kushte objektive dhe të përhershme për kthimin e të shpërngulurve – Kosova do të bëhet edhe çështje evropiane, me pasojat më të vështira, të paparashikueshme. Në vitet tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë u orkestrua një fushatë e planifikuar paraprakisht që përfshinte policinë, ushtrinë, paramilitarët, si dhe civilët e armatosur. Kjo qasje u kontribuoi luftërave të viteve '90, në të cilat u tentua të realizohet ideja e Serbisë së Madhe. Në 1987, sapo Slllobodan Milosheviçi mori pushtetin, ai u kërcënua hapur se zgjidhja e këtyre çështjeve do bëhet me Kushtetutë e pa Kushtetutë. Këto kërcënime filluan të zbatohen në vitin 1989 me ndryshime të dhunshme kushtetuese, me suspendimin autonomisë dhe me masat e projektuara shtetërore për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe serbizimin e saj. Në këtë formë, me Kosovën përfundoi lufta e përgjakshme e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Heqja e autonomisë u përcoll me privimin ekonomik perkatësisht me aparteidin në fushat themelore të jetës së shqiptarëve në Kosovë.

Presidenti Ibrahim Rugova, themelues i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në vitin 1989 iu kundërvu, me rezistencën jo të dhunshme, politikës së represionit dhe padrejtësive, duke krijuar qeverinë, e cila veprroi në ekzil dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Krahas kësaj, që nga viti 1991-1992 filloi organizimi për mbrojtje me themelimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Punëve të Brendshme që fshehurazi përgatiteshin në Kosovë. Në vitin 1993 pushteti serb burgosi përgjegjësit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Punëve të Brendshme, ministri në të cilën nuk kishin pranuar të punojnë për Serbinë rreth 3.500 policë, dhe nga e cila u dënuan 149 vetë me 614.5 vjet burg. Përmes shmangies së dhunës, Rugova kishte për synim evitimin e qëllimit të pushtetit serb për të filluar luftën me përmasa tragjike në Kosovë duke besuar se gradualisht do të fitonte mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare për pavarësinë e Kosovës. Është një kontribut i jashtëzakonshëm i Rugovës që me pjekuri të lartë evitoi ndezjen e luftës në fillim të viteve nëntëdhjetë, atëherë kur ajo sapo kishte filluar në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, kurse në Sllloveni për shkak të rrethanave të tjera zgjati vetëm disa ditë. Vlerësimet e profesionistëve që në vitet

nëntëdhjetë punonin në fushën e mbrojtjes për Qeverinë në ekzil ishin se, nëse atëherë do të shpërthente lufta, çmimin më të madh do ta paguante Kosova. Llogaritej se në periudhën e muajve të parë të luftës Kosova mund të kishte rreth 300 mijë viktima në njerëz. Rugova nuk pajtohej që Kosova të involvohej në luftë në kohën kur ishte krejtësisht e papërgatitur dhe pa përkrahje ndërkombëtare.

Goditja e madhe rezistencës paqësore i erdhi pas Marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995, e cila nuk u mor me gjendjen në Kosovë dhe as që e theksoi atë. Dështimi i bashkësisë ndërkombëtare në Dejton për t'u dhënë mbështetje efektive shqiptarëve të Kosovës u shfrytëzua nga Serbia që të radikalizojë edhe më shumë veprimet ndaj tyre. Pushteti ishte asimetrik, ku Armata jugosllave, policia serbe, grupet paramilitare, kleri i kishës ortodokse serbe së bashku me ekonominë ishin forcë e madhe ndaj një popullate të paarmatosur.

Fazat dhe format e dhunës politike në Kosovë

Politikat dhe planet kriminale serbe ishin hartuar me saktësi dhe në asnjë rast nuk mund të flitet për veprime spontane apo për aksione individuale. Politikat gjenocidale (Lemkin 1945) që praktikoi shteti serb ndaj shqiptarëve ishin ndërtuar mbi përvoja të sprovuara nga e kaluara. Atakohej kohezioni politik i shqiptarëve, në mënyrë që ata të dorëzoheshin dhe të frikësoheshin, zhvillohej serbizimi i Kosovës përmes instalimit si bartëse të pushtetit të pakicën serbe në Kosovë e cila nuk përbënte as 10 për qind të popullsisë. Shkatërrohej struktura shoqërore përmes mbylljes së shkollave shqipe dhe sulmeve ndaj inteligjencës shqiptare. U bënë përpjekje të fshihen të arriturat kulturore duke ndërruar emra të rrugëve, shkollave, shesheve e mbishkrimeve. U atakua fuqia shpirtërore e klerit mysliman dhe katolik, i cili ishte vënë në mbrojtje të të drejtave kombëtare dhe njerëzore; u aplikuan metodat më të ulëta të poshtërimit moral sidomos ndaj grave shqiptare; u shkatërruan dhe u degraduan themelet ekonomike dhe kushtet e jetesës së shqiptarëve për të shuar mundësitë për jetë kulturore dhe kombëtare. Një numër i madh i shqiptarëve, sidomos i të rinjve dhe të rejave u detyruan të emigrojnë jashtë, me ç' rast u ndërpre në trendet e zhvillimit biologjik; u kryen vrasje të drejtpërdrejta dhe masakra masive.

Largimi i shqiptarëve nga institucionet e Kosovës, ato shtetërore, arsimore, kulturore e shkencore, diskriminimi i nxënësve dhe mësuesve shqiptarë dhe mbyllja e shkollave dhe fakulteteve në gjuhën shqipe

ishte masë që pasoi menjëherë pas rrënimit me forcë të autonomisë. Dëshmitë e dhunës politike në Kosovë flasin për brutalitetin e policisë ndaj shqiptarëve, vrasjet, sekuestrimet dhe arrestimet, torturat, keqtrajtimet dhe diskriminimet në administrimin e drejtësisë; pengimin e partive politike dhe shoqatave të shqiptarëve dhe aktiviteteve të tyre, keqtrajtimet dhe burgosjet e liderëve të tyre, mbylljen e medimeve në gjuhën shqipe dhe burgosjet e gazetarëve shqiptarë; eliminimin në praktikë të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, veçanërisht në administratën dhe shërbimet publike. Gjatë gjithë periudhës së okupimit serb, buxheti i Kosovës, i cili mblidhej në masë dërmuese nga shqiptarët, u përdor kundër popullatës shqiptare dhe të komuniteteve të tjera që nuk bashkëpunuan me okupatorin, sikurse edhe për qëllime të luftës dhe të gjenocidit.

Ndër hapat e parë të Serbisë ishte vendosja e masave të dhunshme administrative në ndërmarrjet shoqërore, shtëpitë informative, në institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore dhe ndërrimi i strukturave udhëheqëse, duke zëvendësuar drejtorët shqiptarë me ata serbë. Ishte kjo parapërgatitje për dëbimin e rreth 146 mijë punëtorëve shqiptarë nga puna, përfshirë institucionet shtetërore, ndërmarrjet ekonomike, shkollat dhe fakultetet. Serbia në vitin 1992 transformoi Kombinatin “Trepça” në shoqëri aksionare, duke ia dhuruar pronën e këtij sistemi ekonomik Fondit për Zhvillim të Serbisë, Jugobankës, Progresit të Beogradit, kurse vetëm një çerek të pronës ia la Trepçës si kapital shoqëror. Ky veprim u përcoll me largimin e rreth 12 mijë punëtorëve shqiptarë nga ky kombinat.

Në vitin shkollor 1989/90, në arsimin fillor vijonin mësimet 305.562 nxënës në gjuhën shqipe me të cilët punonin 12.697 mësimdhënës, 67.772 nxënës dhe 3.402 mësimdhënës në shkollat e mesme, 18.918 studentë dhe 800 mësimdhënës në arsimin e lartë (Shatri, B. (2010). Për të mos humbur mësimin, ai filloi të organizohet në shtëpi-shkolla private në vitin shkollor 1991/1992 dhe vazhdoi deri në vitin 1999 me angazhim të LDK-së, Partisë Fshatare, Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë Naim Frashëri (LASH), Entit Pedagogjik të Kosovës dhe Sindikatave të Arsimit të Kosovës.

Si pasojë e politikave serbe, zhvillimi i Kosovës (1990-1999) shprehur në bruto produktin e brendshëm për kokë banori shënoi rënie për 65 për qind (FMN, 2002), humbën tregjet e jashtme dhe eksporti ra për rreth 82 për qind si pasojë e dezinvestimit, institucionet shtetërore serbe, si Fondi për Zhvillimin e Serbisë, Agjencia për Vlerësimin e Kapitalit, ministrinë dhe Oda Ekonomike, përmes transaksioneve fiktive

e bënin Serbinë pronare të pjesës më të madhe të kapitalit të Kosovës². Në vitin 1997 Serbia miratoi Ligjin për Transformimin e Pronës, për të vazhduar plaçkitjen e plotë të pronave dhe pasurive të patundshme në Kosovë.

Serbia mbylli një nga një dhe shkatërroi dhe institucionet financiare të Kosovës. Së bashku me këto veprime, kursimet e qytetarëve u tërhoqën për në Serbi jo vetëm nga bankat e Kosovës, por edhe nga bankat e tjera që operonin në Kosovë, siç ishte Banka e Lubjanës, Jugobanka dhe Banka Investive e Beogradit. U grabit sistemi pensional i Kosovës duke ia bashkëngjitur atij serb me të gjitha fondet pensionale e invalidore, të cilat u takonin punëtorëve të pensionuar dhe invalidëve në Kosovë.

Departamenti i Shtetit, në dokumentin “Fshirja e historisë, spastrimi etnik në Kosovë” (1999) thekson se vdekja përfaqëson vetëm një aspekt të veprimeve serbe në Kosovë. Në këtë dokument thuhet se më 10 qershor 1999, forcat e NATO-s hynë në Kosovë dhe bota për herë të parë pa prova dërmuese të mizorive që forcat serbe kishin kryer; vlerësonte se “...duke shkatërruar sistematikisht shkollat, objektet e kultit dhe spitalet, forcat serbe u përpoqën të shkatërrojnë identitetin social dhe strukturën e shoqërisë shqiptare kosovare”.

Në dëshminë e ish-Presidentes Atifete Jahjaga para Komitetit për Punë të Jashtme të Kongresit amerikan, thuhet se gjatë Luftës së Kosovës ka pasur më shumë se 100 vrasje masive, 74 prej të cilave janë regjistruar, se u vranë brutalisht më shumë se 13,000 njerëz, duke përfshirë 1, 230 fëmijë nën 18 vjeç, ndërkaq ende vazhdojnë të jenë rreth 1600 të pagjetur. Më 10 nëntor 1999, sipas Departamentit të Shtetit të ShBA-së(1999), Kryeprokurorja e Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve për ish-Jugosllavinë (ICTY), Carla Del Ponte, deklaroi para Këshillit të Sigurimit të OKB-së se zyra e saj kishte marrë raporte për më shumë se 11,000 të vrarë në 529 varrezat masive dhe vende të vrasjeve të raportuara në Kosovë të ndarë në tre kategori të rëndësishme të viktimave: (1) ato të varrosurve në varre masive vendndodhjet e të cilave nuk dihen, (2) ekzistenca e një numri të konsiderueshëm i vendeve ku numri i saktë i trupave nuk mund të numërohet dhe (3) viktimat, trupat e të cilëve janë djegur ose shkatërruar nga forcat serbe. Në listën e personave të zhdukur me dhunë ishin evidentuar 6.057 raste. Tani, 23 vjet

² Vlerësime të delegacionit të Kosovës për negociatat e Vjenës, të cilat i posedon autori, si pjesë e ekspertëve për çështje ekonomike dhe financiare, 2006.

pas luftës kanë mbetur pa u zbuluar edhe 1.617 persona të zhdukur me dhunë.

Sipas studimit me 1197 familje dhe me 8605 persona (Spiegel, P, & Salama, P. 2000) rezulton se shkalla e vdekshmërisë nga shkurti, 1998, deri në qershor 1999 ishte rritur 2-3 herë nga periudha e paraluftës (që korrespondonte me 0.72 të vdekur në muaj në 1000 banorë). Shkalla e vdekshmërisë arriti kulmin në prill 1999 me 3.25 për 1000 banorë në muaj, që përkon me intensifikimi i fushatës serbe të “spastrimit etnik”. Konstatohet se të dhëna të tilla vdekshmërie mund të përdoren si prova se qeveritë dhe grupet ushtarake kanë shkëlur standardet ndërkombëtare të sjelljes gjatë luftës.

Studimi për vrasjet politike në Kosovë mars-qershor 1999 i mbështetur nga Qeveria e ShBA-së, sipas American Association for the Advancement of Science (2000, fq.7), nga hulumtimet (ABA/CEELI dhe AAAS)³, ku u intervistuan 3, 353 responentë konfirmojnë se vetëm gjatë periudhës 20 mars-12 qershor 1999, që korrespondon me fushatën ajrore të NATO-s, forcat serbe vranë rreth 10.500 njerëz, shumica dërmuese e tyre civil. Gjetjet nga ky studim tregojnë se shumica e vrasjeve të dokumentuara kanë ndodhur midis fundit të marsit dhe mesit të prillit 1999. Kjo kohë në një shkallë të konsiderueshme lidhet me flukset e refugjatëve, kur ishte zhvilluar një fushatë sistematike kundër popullatës shqiptare të Kosovës, andaj edhe intensiteti i vrasjeve është vënë në korrelacion me intensitetin e dëbimeve të popullsisë nga regjionet e caktuara. Dokumentohen 27 flukse refugjatësh nga Kosova, të cilat ndodhën në tre faza: faza e parë 24 mars - 6 prill, faza e dytë 7 - 23 prill dhe faza e tretë 24 prill - 11 maj (American Association for the Advancement of Science (2000, fq 10-13). Shpërndarja gjeografike e vrasjeve të dokumentuara në Kosovë nga 20 mars - 12 qershor 1999 tregojnë për një përqendrim substancialisht më të lartë të vrasjeve në komunën e Skenderajt dhe të Rahovecit.

Gjatë fazës së parë, vrasjet janë shënuar në tërë Kosovën, por përqendrim i veçantë ishte shënuar në komunat jugperëndimore, veçanërisht në Pejë, Gjakovë, Rahovec, Suharekë dhe Prizren. Në fazën e dytë, përqendrimi i vrasjeve është rritur në Kosovën Qendrore, veçanërisht në Istog, Drenas dhe Lipjan. Në fazën e tretë, përqendrimi i

³ American Association for the Advancement of Science (AAAS), Science and Human Rights Program or the American Bar Association's Central and East European Law Initiative (ABA/CEELI).

vrasjeve zhvendoset në pjesën verilindore të Kosovës, sidomos në Podujevë, Vushtrri dhe Mitrovicë.

Në dokumentin e Departamentit të Shtetit për pastrimin etnik në Kosovë (1999), si dhe në dokumentin e organizatës Human Right Watch, (2002) të titulluar “Nën Pushtetin e Urdhrave - Krimet e luftës në Kosovë” dokumentohen vuajtjet dhe përjetimet e shqiptarëve të dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe e refugjatëve. Nga anketat e kryera nga Human Right Watch me refugjatë dhe popullsinë civile, duket qartë se forcat ushtarake dhe policore serbe dhe njësitë paramilitare zbatuan planet shtetërore me një fushatë sistematike të dhunës, terrorit dhe gjenocidit me qëllime të spastrimit etnik. Format më karakteristike të kësaj dhune ishin: dëbimet e dhunshme, ekzekutimet masive, varrezat masive, zhvendosja e kufomave, vrasje të paramenduara, përdhunimet dhe abuzimet seksuale, përdorim i mburojave njerëzore, arrestimet dhe ndalimet arbitrare, shkatërrimi i pronësisë private dhe objekteve të kultit, djegiet dhe plaçkitjet, grabitjet, paraburgimet dhe puna e detyrueshme, shkeljet e neutralitetit mjekësor, pastrimi i identitetit, ndotja e depozitave ujore, por edhe shumë forma të tjera.

Në vitin 1998 dhe 1999 nga Kosova ndodhi deportimi më i madh i popullsisë në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Operacioni serb për spastrimin etnik “Patkoi” (Beaumont&Wintour 1999), kishte për qëllim që ushtria dhe policia serbe të shtrydhnin UÇK-në dhe civilët në një sulm të nisur nga tre anët, duke shkatërruar bazat dhe luftëtarët e UÇK-së dhe duke dëbuar popullsinë, ndërsa refugjatët të iknin përmes skajit të hapur jugperëndimor të patkoit në Maqedoni dhe Shqipëri. Operacioni u ngrit në terren në Kosovë, duke deportuar kolona të mëdha civilësh të lodhur, të dehidratuar dhe të rrahur përtej kufijve ndërkom-bëtarë shkruan “The Guardian”.

Gjatë fushatës së spastrimi etnik, në më pak se 2 muaj, afro 1 milion shqiptarë por edhe pakica të tjera joserbe të Kosovës u dëbuan nga Kosova dhe u dislokuan me dhunë në vendet fqinje, në Shqipëri dhe Maqedoni, por edhe në Mal të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë. Rreth gjysmë milioni njerëz u zhvendosën në territorin brenda Kosovës. Sipas Allen, B. (1999) emigrimi, madje para krizës aktuale të refugjatëve, ishte i madh. Rreth 350,000 njerëz u larguan nga Kosova ndërmjet viteve 1990 dhe 1995. Sipas UNHCR-së (1999), në maj të vitit 1999 ishin 862,979 shqiptarë të dëbuar nga Kosova, ndërsa midis 500 mijë deri në 600 mijë qytetarë u përballën me shpërngulje të brendshme, pa llogaritur të ikurit para muajit mars 1999. Rreth 440 mijë refugjatë shkuan në Shqipëri, rreth 320 mijë në Maqedoni (nga të cilët, 80 mijë u

transferuan në vende të treta joballkanike). Mali i Zi priti rreth 70 mijë refugjatë, ndërsa Bosnja e Hercegovina më shumë se 30 mijë. Në këtë shifër nuk ishin përfshirë ata që kishin kërkuar strehim në Evropë, para marsit të 1999.

Dëbimi në masë në pranverën e vitit 1999 u përcoll me *grabitje e plaçkitje*. Rëndom, qytetarët plaçkiteshin para se të dëboheshin apo gjatë dëbimit nga Kosova.

Sipas studimit të Bankës Botërore (2000), vlerësohet se “si rezultat i numrit të lartë të meshkujve që emigruan ose u vranë gjatë luftës, më shumë se 15 për qind e familjeve në Kosovë kanë mbetur me kryefamiljare gra, familje që mund të jenë ndër më të cenueshmet për sa u përket nevojave ekonomike dhe sociale, duke përfshirë punësimin, furnizimin me ushqim, arsimin dhe kujdesin shëndetësor”.

Dëshmitë dhe dokumentimet për masakrat serbe dhe *ekzekutimet masive* janë shumë të rënda. Nga masakra e familjes Jashari, e cila deri në frymën e fundit ia ktheu pushkën policisë dhe ushtrisë serbe; masakra e Reçakut, e cila e alarmoi botën për krimet kundër njerëzimit; masakra e Mejës me rreth 400 të vranë; masakra në burgun e Dubravës; e Krushës së Madhe; e Likoshanit dhe Çirezit; Qyshkut, Izbicës, Rezallës dhe Pokleikut; Sillovisë; Grashticës, Makovcit dhe Koliqit të Komunës së Prishtinës; Podujevës; Kotlinës; Nakaradës – F. Kosovë dhe shumë masakra të tjera të kobshme. Janë këta shembujt tragjikë që pasqyrojnë mentalitetin, sjelljen dhe veprimet e regjimit serb në Kosovë, por për fat të keq edhe hezitimin për një kohë të gjatë të bashkësisë ndërkombëtare për të ndalë krimet e Serbisë.

Forcat serbe *zhvarrosën nga varret masive* trupat e djegur, të shkatërruar në përpjekje për të shkatërruar provat dhe për të minimizuar dëshmitë për mizoritë e tyre. Në fjalimin e saj para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Carla Del Ponte⁴ theksoi se “Nuk do të jetë kurrë e mundur të marrim vesh shifrën e saktë të viktimave, për shkak të përpjekjeve të qëllimta për t’i djegur kufomat apo për t’i fshehur ato në rrugë të tjera”.

Përveç ekzekutimeve masive, forcat serbe kishin *paramenduar vrasje të veçanta*. Shënjestruan inteligjencën shqiptare, duke përfshirë udhëheqës politikë, profesorë, avokatë e mjekë.

⁴ Fjalim drejtuar Këshillit të Sigurimit nga Carla Del Ponte, prokurore, Gjykata Ndërkombëtare kundër Krimeve të Luftës në ish-Jugosllavi, 21 nëntor 2000, New York – marrë nga NËN PUSHTETIN E URDHRAVE Krimet e luftës në Kosovë, HUMAN RIGHTS WATCH, 2002, fq 566.

Në raportin e Human Rights Watch, (2000), "*Përdhunimi si një armë e spastrimit etnik*", tërheqin vëmendjen format e dhunës seksuale dhe përdhunimeve të rreth 20.000 grave në Kosovë në vitin 1999 si armë të luftës dhe instrumente të spastrimit etnik sistematik. Këto forma të dhunës vlerësohen se u përdorën qëllimisht si instrument për të terrorizuar popullatën civile, për të zhvatur para nga familjet dhe që t'i shtyjnë njerëzit të largohen nga shtëpitë e tyre dhe nga vendi. Human Rights Watch, përdhunimet dhe abuzimet seksuale i grupon në tri kategori: përdhunime të grave në shtëpitë dhe oborret e tyre në prani të anëtarëve të tjerë të familjes; përdhunime gjatë shpërnguljes brenda territorit të Kosovës, si dhe përdhunimet në dhomat e paraburgimit, në qendrat e ndalimit të përkohshëm apo shtëpitë e braktisura.

Në aksionet serbe u përdorën shqiptarët si mburoja njerëzore për të shoqëruar autokolonat dhe objektet ushtarake, në kundërshtim me konventën e Gjenevës. Të rinjtë dhe burrat i ndanin nga kolonat e refugjatëve dhe i detyronin të formonin një zonë tamponi rreth autokolonave serbe.

Edhe arrestimet dhe ndalimet arbitrare gjatë konfliktit të armatosur të vitit 1998 dhe në pjesë e parë të vitit 1999 kishin marrë përmasa të gjera. Burrat ndaheshin nga gratë dhe mbaheshin në qendra burgimi të improvizuara, në shkolla e fabrika, për një periudhë të caktuar kohë gjatë së cilës merreshin në pyetje, maltretoheshin, rriheshin dhe disa prej tyre vriteshin.

Vlerësohet se ishin shkatërruar shumë prona private dhe objekte të kultit. Rreth 40 për qind të pronave private ishin dëmtuar rëndë dhe u shkatërruan nga ushtria, policia dhe paraushtarakët serbë, të cilët për këto qëllime përdorën artileri, eksplozivë, zjarrvënie, buldozerë dhe mjete të tjera (UNHCR-së, nëntor 1999). Shkolla e xhamitë u sulmuan në mënyrë të ngjashme. Sipas një vlerësimi të dëmeve nga ana e Kombeve të Bashkuara në 649 shkolla të Kosovës, rezultoi që më shumë se një e pesta e shkollave të shqyrtuara ishin të dëmtuara rëndë dhe më shumë se 60% nga të dëmtuarat ishin të shkatërruara tërësisht. *Djegia e shtëpive ishte dukuri e përhapur*. Në vitin 1998 dhe 1999 u dogjën dhe u shkatërruan shumë vendbanime si përpjekje për të siguruar që popullsia shqiptare të mos ketë ku të kthehet. Një nga format më të bujshme të shkatërrimit të pronave civile e publike gjatë vitit 1998 e 1999 ishte praktika e përhapur e *ndotjes së depozitave të ujit*, e cila është e ndaluar nga ligjet e luftës. Sipas vlerësimeve ndërkombëtare të bazuara në dëshmitë e popullatës civile, forcat serbe e jugosllave i bënë

qëllimisht të papërdorshme burimet e ujit duke vendosur kimikate, kafshë të ngordhura, madje edhe kufoma njerëzish në ujë.

Në mënyrë sistematike forcat serbe ndanë burrat e moshës ushtarake, i *burgosën dhe i shfrytëzuan për punë të detyruar*. Shumë prej këtyre u detyruan të hapnin llogore, të pastronin bunkerë apo të kryenin punë të tjera krahu. Një pjesë e madhe e punës së bërë nga të paraburgosurit ishte e lidhur me objektivat strategjike të Ushtrisë Jugosllave.

Shkeljet e neutraliteti mjekësor nga forcat serbe përfshinin vrasjet, torturat, ndalimet, burgosjet dhe zhdukjet e mjekëve kosovarë.

Ndaj shqiptarëve u aplikua *pastrimi i identitetit*, duke i zhveshur sistematikisht nga dokumentet personale e pronësore, duke përfshirë pasaportat, titujt e pronësisë së shtëpive, banesave e tokës, targat e automjeteve, kartat e identitetit, librezat shëndetësore, patenta shoferi dhe çfarëdolloj dokumenti tjetër i pronësisë së pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme. Kjo metodë e dokumentuar e pastrimit të dokumenteve është dëshmi se Serbia ka synuar të zhveshë qytetarët e Kosovës nga dëshmitë, për ta bërë të pamundur kthimin e tyre në Kosovë.

Dhuna ushtarako-policore e një Federate dhe republike ndaj një populli të pushtuar

Luftën e armatosur në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999 e karakterizon një diversitet i gjerë i palëve të involvuara me interesa të veçanta (Krystman dhe tjerë 2015), si dhe një asimetri absolute e organizimit shtetëror dhe fuqisë ushtarake ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Nga *aspekti i organizimit shtetëror* në njërën anë ishte Republika Federale e Jugosllavisë⁵, Qeveria federale, Ministria Federale për Punë të Brendshme, Republika e Serbisë, Qeveria e Serbisë, Ministria e Brendshme e Serbisë. Karshi kësaj fuqie qëndronte *Republika e Kosovës (e shpallur shtet me Kushtetutën e 7 Shtatorit të vitit 1990 dhe me Referendumin gjithëpopullor të shtatorit të vitit 1991)* në krye me presidentin dr. Ibrahim Rugova i zgjedhur më 1992 dhe Qeveria e Republikës

⁵ Republika Federale e Jugosllavisë, President, Slobodan Millosheviç, Kryeministër, Momir Bullatoviç, zv.kryeministër, Nikolla Shainoviç, Ministër i brendshëm, Zoran Sokoloviç; Republika e Serbisë, President, Milan Milutinoviç, Kryeministër, Mirko Marjanoviç, Zv. Kryeministër, Milovan Bojiq, Ratko Markoviç, Dragan Tomiç, Vojislav Sheshel, Tomislav Nikoliç; ministër i Brendshëm i Serbisë, Veljko Strojilickoviç.

së Kosovës në mërgim, me kryeministër dr. Bujar Bukoshi, e formuar në tetor të vitit 1991.

Si forcë ushtarake, forca serbe përbëhej nga armata jugosllave, forca policore serbe, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë, njësitë paramilitare serbe: Tigrat e Arkanit, Shqiponjat e Bardha të Sheshelit, si dhe civilët e armatosur. Nga pala kosovare, luftonte *Ushtria Çlirimtare e Kosovës* e cila u organizua mbi baza vullnetare në zona të ndryshme, duke përfshirë edhe pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), të organizuar nga qeveria në mërgim, të cilët luftuan me emblemën e UÇK-së, por që në fakt as njëra dhe as tjetra nuk ishin ushtri të rregullta. Megjithëkëtë ka tendenca që për pasojat e luftës në Kosovë të barazohen palët ndërluftuese, masakrat e regjimit serb dhe jugosllav me gjithë makinerinë luftarake dhe policore me një organizim vullnetar për të mbrojtur shtëpitë, pronën, jetën dhe atdheun e tyre.

Masakrat e shtetit serb ndikuan që si palë të jashtme të involvohen: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut; Grupi i kontaktit i ish-Jugosllavisë (SHBA, Rusia, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia).

Në kushte të një pabarazie të plotë shtetërore e ushtarake, Kosova u ballafaqua me një makineri tepër të fuqishme të dhunës së cilës fillimisht iu përgjigj me mosdhunë dhe më vonë me përpjekje për rezistencë të armatosur. Një luftë e pabarabartë e diktuar nga shteti serb që kishte trajta gjenocidale u ndal me ndërhyrjen ushtarake të Aleancës Veri-atlantike, të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës me një përkrahje të fuqishme dhe domethënëse të Mbretërisë së Bashkuar.

Përfundime

Në tre dekadat e fundit të shekullit XX, Serbia intensifikoi përpjekjet dhe mori veprime të luftës për riokupimin e Kosovës dhe debimin e shqiptarëve. U fillua me kundërshtimet e autonomisë së Kosovës mbi ndryshimet që ndodhën në vitin 1974, me Librin e Kaltër të organizuar nga udhëheqja shtetërore dhe politike e Serbisë, vazhdoi me Memorandumin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë në vitin 1986, me suprimimin e dhunshëm të autonomisë në vitin 1989 dhe 1990 për të kulmuar me luftën e viteve 1998 dhe pjesën e parë të vitit 1999. Dhuna ishte e organizuar, e planifikuar dhe e operacionalizuar

nga shteti serb, kurse ekzekutohej nga ushtria jugosllave, policia e Serbisë dhe njësitë joformale si njësi paramilitare të organizuara, të financuara dhe të armatosura nga shteti sikurse edhe civilët e armatosur.

Shqiptarët e Kosovës kundërshtuan pushtimin serb, njëherë me politikë të jodhunës dhe më pastaj me luftë, kurse Serbia ndërmoi veprime të spastrimit etnik me vrasje dhe dëbim masiv të tyre. Dëbimi i më shumë se një milion shqiptarëve nga Kosova, vrasjet dhe ekzekutimet masive flasin për trajta të qarta të gjenocidit të shtetit serb në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999.

Dhuna politike serbe ndaj shqiptarëve, mbi bazë etnonacionaliste, për nga qëllimi dhe instrumentet e përdorura përkujtoi holokaustin e fundshekullit të njëzet dhe nxiti reagimin ndërkombëtar mbi baza humanitare.

Me gjithë krimet e kryera, shteti serb dhe institucionet serbe edhe pas më shumë se dy dekada nga përfundimi i luftës nuk kanë treguar ndjenja të fajit, nuk i kanë pranuar krimet e tyre dhe nuk kanë shprehur interesim për nisjen e procesit të pendesës. Ikja nga e vërteta për masakrat dhe gjenocidin vazhdon edhe sot e kësaj dite nga Serbia. Kjo sjellje e shtetit serb e bën fragjile paqen në Ballkan dhe në këtë pjesë të Evropës, sepse flet se ky shtet nuk ka hequr dorë dhe nuk është distancuar nga politikat e dhunës dhe krimet.

Referencat

- [1] Abrahams, F. (2001). *Under orders: War crimes in Kosovo*. Human Rights Watch. Teksti shqip: NËN PUSHTETIN E URDHRAVE Krimet e luftës në Kosovë, Përkthyer nga origjinali anglisht: Mustafa NANO, Virgjil MUÇI.
- [2] Abrahams, F. (2001). *Under orders: War crimes in Kosovo*. Human Rights Watch.(i përkthyer shqip nga origjinali anglisht nga Mustafa NANO, Virgjil MUÇI, 2002) fq 126-160.
- [3] Adolf, H. *Mein Kampf: Complete and unabridged, fully annotated Hardcover*: Reynal & Hitchcock (1940).
- [4] Allen, B. (1999). *Why Kosovo?: The Anatomy of a Needless War*. Canadian Centre for Policy Alternatives= Cantreanadien de politiques alternatives.
- [5] American Association for the Advancement of Science. (2000). Political killings in Kosova/Kosovo, March-June 1999: A cooperative report by the Central and East European Law initiative of the American Bar Association and the Science and Human Rights Program of the American Association for the Advancement of Science fq. 10-14.
- [6] AP News - Associated Press News, 8 prill, 1999.

- [7] Bajram Shatri. (2010). ARSIMI SHQIP NË KOSOVË 1990-1999 SHTËPIA-SHKOLLA – Sfidat dhe aspiratat-, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë 2010.
- [8] Beal, W. (2000). Human Rights Watch: Four Reports. *Counterpoise*, 4(3), 13.
- [9] Brenda Uekert, Rivers of Blood: A Comparative Study of Government Massacres (Westport, Conn., 1995), 16, 21.
- [10] Dutton, D. G. (2007). *The psychology of genocide, massacres, and extreme violence: Why normal people come to commit atrocities: Why normal people come to commit atrocities*. ABC-CLIO.
- [11] Dwyer, P. G., & Ryan, L. (2012). Introduction: the massacre and history. *Theaters of Violence: Massacres, Mass Killing and Atrocity throughout History*.
- [12] Forges, A. D. (1999). Leave none to tell the story: Genocide in Rwanda. *Human Rights Watch*, 1-595.
- [13] Freud, S. (1921). Group psychology and the analysis of the ego. The standard edition of the complete psychological works of Sigmund Freud. Vol. XVIII (1920-1922). Beyond the pleasure principle, group psychology and other Works. *Group Psychology and Other Works*. P, 65, 144.
- [14] Gallant, T. W. (2001). Levene (Mark) and Roberts (Penny), (Eds.), The Massacre in History. Oxford, Berghahn Books, 1999, 20 pp., 6 half-tones, maps, ISBN 1 57181934 7. *Crime, Histoire & Sociétés/Crime, History & Societies*, 5(1), 146-148.
- [15] Hardin, Russell. *One for all: The logic of group conflict*. Princeton University Press, 1997.
- [16] Henri Zukier, 'The Twisted Road to Genocide: On the Psychological Development of Evil during the Holocaust', *Social Research*, 61 (1994), 444.
- [17] Iacopino, V. (1999). *War crimes in Kosovo: a population-based assessment of human rights violations against Kosovar Albanians*. Physicians for Human Rights.
- [18] Ingram, H. J., & Reed, A. G. (2016). Lessons from history for counter-terrorism strategic communications. *International Centre for Counter-Terrorism Policy Brief*, 7(4). Fq 34-38
- [19] Jacobs, D. F., & Herderschee, J. (2002). Kosovo: Institutions and policies for reconstruction and growth. In *Kosovo*. International Monetary Fund.
- [20] KOSOVO'S WARTIME VICTIMS: THE QUEST FOR JUSTICE, HEARING BEFORE THE COMMITTEE ON FOREIGN AFFAIRS HOUSE OF REPRESENTATIVES ONE HUNDRED SIXTEENTH CONGRESS FIRST SESSION, April 30, 2019, Serial No. 116–28
- [21] La Cava, G., Nanetti, R., Schwandner-Sievers, S., Gjonca, A., Nezam, T., Balaj, B.,.... & Davis, D. (2000). CONFLICT AND CHANGE IN KOSOVO.
- [22] Ligji për transformimin e pronave u aprovua në Kuvendin e Serbisë, i shpallur në gazetën zyrtare të saj më 21 qershor 1997
- [23] Lemkin R. 1945. Genocide - A Modern Crime, *Free World*, Vol. 4 (April, 1945), p. 39- 43]
- [24] Lemkin R. (april 1946). Genocide. *American Scholar*, Volume 15, no. 2. p.227-230

- [25] Mider, D. (2014). Determinants of political violence: A study of the literature. *Journal of social science studies*, 1(2), 177-197, Warszawa. Fq. 177
- [26] Mider, D. (2014). Determinants of political violence: A study of the literature. *Journal of social science studies*, 1(2), 177-197, Warszawa. Fq. 189-190
- [27] Negash, M. H. (2013). Ethnic Identity and Conflicts: Lessons from the Kosovo Crisis. *Alternatives: Turkish Journal of International Relations*, 12(1), 65-76.
- [28] Physicians for Human Rights. (1999). War Crimes in Kosovo: A Population-Based Assessment of Human Rights Violations Against Kosovar Albanians.
- [29] Semelin, J. (2002). From massacre to the genocidal process. *International Social Science Journal*, 54(174), 433-442.
- [30] Spiegel, P. B., & Salama, P. (2000). War and mortality in Kosovo, 1998-99: an epidemiological testimony. *The Lancet*, 355(9222), 2204-2209.
- [31] Status Report, United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, 14 korrik 2000.
- [32] UNHCR GIS Unit, Prishtinë, Kosovë, "UNHCR Shelter verification: Agency coverage," 9 nëntor 1999
- [33] UNHCR Press Birefing Note: Kosovë, 13 prill 1999. 59. UNHCR Press Briefing Note: Kosovë, 13 maj 1999.
- [34] Statistikë nga: Kriza e refugjatëve në Kosovë: vlerësim i pavarur i UNHCR, gatishmëri për t'iu përgjigjur çdo emergjence," Njësia e analizave politike dhe vlerësimeve, UNHCR, shkurt 2000.
- [35] The Guardian: Milosevic and Operation Horseshoe, By *Peter Beaumont* and *Patrick Wintour* with reporting by Chris Bird in Pristina, John Henley in Paris, *John Hooper* in Rome, Sun 18 Jul 1999
- [36] United States. Department of State. (1999). *Erasing history: Ethnic cleansing in Kosovo*. Department of State. Prepared by the U.S. Department of State December 1999
- [37] United States. Department of State. (1999). *Erasing history: Ethnic cleansing in Kosovo*. Department of State. Prepared by the U.S. Department of State December 1999
- [38] United States. Department of State. (1999). *Erasing history: Ethnic cleansing in Kosovo*. Department of State. Prepared by the U.S. Department of State December 1999
- [39] Vlerësime të delegacionit të Kosovës për negociatat e Vjenës, të cilat i posedon autori, si pjesë e ekspertëve për çështje ekonomike dhe financiare, 2006.
- [40] Żakowska, M., & Nowakowska-Krystman, A. (2015). Conflict in Kosovo through the Conceptual Framework of Stakeholders.

Josef Martinsen

GJENOCIDI NË KOSOVË BAZUAR NË DOKUMENTACIONIN TIM

Abstrakt

Triologjia e Kosovës është dokumentim rreth asaj çfarë ka ndodhur në Kosovë më 1998 – 99 gjatë sulmeve të ushtrisë serbe të Milosheviçit në Kosovë kundër shqiptarëve të Kosovës.

Qëllimi i kësaj kumtese është sjellja përpara opinionit publik të së vërtetës rreth krimeve të luftës të kryera gjatë viteve 1998 – 99. Paqja, pajtimi dhe falja kanë kuptim vetëm me zbulimin e së vërtetës për ngjarjet e luftës dhe masakrat kundër civilëve të pambrojtur e të paarmatosur ku përfshihen fëmijë, gra, pleq dhe moshë e gjini të ndryshme që pësuan pa asnjë faj. Bazuar në detyrat e ushtruara, dokumentacionin tim të faktuar në periudhën e pasluftës janë ndriçuar shumë ngjarje që vërtetojnë tendencën e dhunës, spastrimit etnik dhe gjenocidit të organizuar shtetëror. Në këtë dokumentacion ekziston një numër i konsiderueshëm i fakteve që flasin për dhunë, vrasje, masakra, dhunime, varreza masive, persona të zhdukur, të pagjetur të cilat i kam siguruar në procedurat e kërkimit për të shkruar një libër rreth trupave të gjetur në puse në të gjithë Kosovën të titulluar “Dødsbrønnene I Kosovo” (Kosovë: Vdekja në puse) ishte botuar nga Syress Forlag, Norvegji më 2005. Në 2006 vazhduan kërkimet për të shkruar edhe një libër tjetër rreth Kosovës meqë 7 vjet pas luftës asgjë nuk kishte bërë UN/UNMIK-u për të vërtetuar përafërsisht rreth 400 varreza masive të regjistruara nga Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve në Hagë dhe e dërguar në UN. Në këtë temë pas 4 vjet hulumtimi në kërkim të fakteve më 2010 u publikua botimi nga Syress Forlag, Norvegji. Të gjitha faktet e mia rreth gjenocidit janë publikuar në tri vëllime: “The process after a war”, “Kosovo the wells of deaths” dhe “What happened in Kosovo 1998-1999”.

Fjalët çelës: Kosova, dhuna, masakrat, të vrarët, të pagjeturit, varreza masive.

Dear Kosova Academy, I would like to thank The Kosovaro – Swedish Scientific Institute. for inviting me to speak about my war crime documentation from 1998-99.

History was my favourite subject in school, back in the 1940-s. Back then, there was no internet, today I could easily find on the internet information about Kosova Academy first established in 1975.

Over the years in Kosova and Serbia I read some Albanian and Balkan history, I once came across the word “Bese” in Albanian as something sacred and represented an Albanian virtue. For us Norwegians we have something similar “a word is a word”.

During my lecture I may have a digression or two. (Digression, “act of deviating from the main subject matter in speaking”). Here you have the first digression:

The Albanians in the Balkans, unlike many people in Europe, are said to have taken care of Jews on the run from German Nazi’s persecution, during Second World War 1938-45. In Scandinavia, only the Danish and the Swedish people took care of the Jews on the run.

The Norwegians did the opposite, the local Norwegian police gathered Jews in secret planned actions. Early in the morning all Jews were gathered and put on a boat to Auschwitz Concentration Camp. On 25- 26 November 1942 more than 750 were sent and only 26 came back alive after the war. This is a heavy historical burden for Norway.

The intervention that turned the tide in Kosova

If NATO had not intervened in March 1999 and subjected former Yugoslavia to an extensive air bombing for over 78 days. I think most of the Kosova Albanian population would probably have been refugees all over Europe and in the rest of the world, and Kosova would have remained as part of Serbia in the rest of Yugoslavia.

Well, back to my subject.

In 1948 UN approved a definition to cover the term **Genocide**:

Fig 1

The United Nations Genocide Convention defines genocide as “any of the following acts committed with intent to destroy, in whole or in part, a national, ethnical, racial or religious group, such as:

- killing members of the group;
- causing serious bodily or mental harm to members of the group;

- deliberately inflicting on the group conditions of life calculated to bring about its physical destruction in whole or in part;
- imposing measures intended to prevent births within the group; and]
- forcibly transferring children of the group to another group."

In 1998, the ICTR (International crime tribunal Rwanda) set the important precedent that systematic rape is in fact a crime of genocide.

The international legal and political community have for some reason avoided using the term Genocide when it comes to crimes committed in Kosova in 1998-99, where 10600 unarmed civilians were deliberately hunted down and murdered. And around half of the Albanian population was deported and forcibly transferred out of Kosova. My documentation presented in 2010 www.truth-commission.com clearly shows that Genocide was committed. The asymmetric warfare launched by Yugoslavian army and the Serbs in Kosova under the Milosevic regime from 1998 - 99 resulted in these indictments and sentences:

Fig 2

On 26 February 2009, the following former police and military officials of the former Yugoslavia and Serbia were convicted by Trial Chamber III of the Tribunal for crimes against humanity committed in Kosova in 1999:

1. Former Yugoslav Deputy Prime Minister, Nikola Šainović, Yugoslav Army (VJ) General, Nebojša Pavković and Serbian police General Sreten Lukić were each sentenced to 22 years' imprisonment for crimes against humanity and violation of the laws or customs of war.

2. Yugoslav Army General, Vladimir Lazarević and Chief of the General Staff, Dragoljub Ojdanić were found guilty of aiding and abetting the commission of a number of charges of deportation and forcible transfer of the ethnic Albanian population of Kosova, and each sentenced to 15 years' imprisonment.

The Prosecution charged the five with crimes committed during a campaign of terror and violence directed against the ethnic Albanian population of Kosova in early 1999. Each of the accused was alleged to

have participated in a joint criminal enterprise, the purpose of which was to modify the ethnic balance in Kosova to ensure continued control by the Serbian authorities. The plan was to be executed by criminal means, including deportations, murders, forcible transfers, and persecutions of Kosova Albanians.”

When UNMIK took over control of Kosova they had no records of the population or archives that could facilitate the work of setting up lists of dead and missing. Most of the office inventory and technical equipment were gone.


The new authorities and others in Kosova who worked with dead and missing people were very dependent on the lists that were created by international organisations such as the Red Cross, the ICTY and other NGOs. Because three different languages were used, (English, Albanian and Serbian), the lists were to some extent deficient. Many who came and reported could not document who they were and whom they represented.

Serb military, police and paramilitary forces who participated in the forced expulsion of more than half of the civilian Albanian population, took by force all forms of personal ID and other documentation from the population that could prove they belonged in Kosova.

Fig 3

Before I started the book project, November 2006, regarding the 400 mass graves I contacted the Director at the Institute of History Dr. Jusuf Bajraktari and the Director of the Archives of Kosova, Dr. Jusuf Osmani and asked them for advice concerning my book project. To my surprise they said that I should start as soon as possible otherwise evidence could be lost, because it was already seven years after the war. They told me they were barred from acting on this and other cases by UNMIK and the local authorities at the time, since there were no allocated resources to their departments. It is worth mentioning that I first spoke with head of UNMIK JUSTICE section back in 2006, but they told me not to bother doing documentation and book because they had all needed information.

I asked Mr. Bajraktari and Mr. Osmani for a written recommendation for my book project which they issued, see below:

**Fig 4**

Data sources I used thanks to the recommendation issued by Dr. Jusuf Bajraktari Institute of History and Dr. Jusuf Osmani back in November 2006.

- 1 = International Committee Red Cross - Prishtina (ICRC)
- 2 = International Crime Tribunal for former Yugoslavia - the Hague (ICTY)
- 3 = Office for Missing Persons Forensic/UNMIK/EULEX - Prishtina (OMPF)
- 4 = Humanitarian Law Centre - Belgrade (HLC)
- 5 = Author (Josef Martinsen - research work in Kosova) (JM)
- 6 = International Justice - Human Rights Watch (HRW)

7 = No Peace Without Justice (NPWJ)

8 = International Crisis Group, (Reality Demands) Brussels (ICG)

9 = Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE)

10 = Council for Defence of Human Rights and Freedoms, Pristina (CDHRF)

Fig 5

Already early spring of 1998 Kosova Albanians were forced to leave their homes and villages due to heavy shelling against their houses and foot soldiers that came in after the shelling and forced the families out on the roads or to the forests and mountains and burned down their houses. The number of registered persons outside Kosova from March 1998 to February 1999:

March 1998	24 000
April 1998	170 000
October 1998	200 000
November 1998	175 000
January 1999	190 000
February 1999	210 000

Numbers of refugees displaced from Kosova 23 March-9 June 1999

From 23 March 1999 things escalated dramatically when USA, Britain and NATO started the announced bombing of rest Yugoslavia, including Serbia and Montenegro. Milosevic declared state of war and the Military was official in charge of all actions that took place in Kosova. I will not repeat the numbers but point out that in the course of about 4 months more than 800 thousand were forced out of Kosova.

(Kosova/Kosova As Seen, As Told (OSCE) registered the following number of people who fled or was forced out of Kosova.)

Fig 6

Supplementary document 7

Numbers of refugees displaced from Kosovo 23 March-9 June 1999
(Figures represent total arrivals on each given date)

	Montenegro	B-H	FYROM	Albania	HEP	Total
23 March	25,000	10,000	16,000	18,500		69,500
30 March	32,500	13,000	20,500	78,500		144,500
31 March	35,000	14,000	28,000	103,500		180,500
1 April	40,000	15,000	43,000	103,500		201,500
2 April	50,000	16,000	43,000	138,000		247,000
3 April	52,000	17,000	108,000	200,000		377,000
4 April	54,000	18,000	109,000	247,000		428,000
5 April	55,000	20,000	110,125	254,813		439,938
6 April	58,000	21,000	111,250	262,625		452,875
7 April	60,000	22,000	112,375	270,438		464,813
8 April	61,000	23,000	113,500	278,250		475,750
9 April	62,000	24,000	114,625	286,063		486,688
10 April	63,000	25,000	115,750	293,875		497,625
11 April	64,000	26,000	116,875	301,688		508,563
12 April	63,000	27,300	118,000	309,500	7,987	525,787
13 April	67,200	27,700	116,000	314,300	10,780	533,980
14 April						
21 April	70,000	32,300	130,000	57,000	16,911	606,211
28 April	63,300	15,000	142,650	367,200	22,084	610,234
5 May	61,700	17,600	211,340	404,200	28,654	723,494
12 May	64,400	18,500	231,200	427,000	40,518	781,618
19 May	64,000	20,000	226,800	433,300	52,643	796,743
26 May	64,700	21,500	252,600	439,600	63,575	841,975
2 June	68,400	21,700	248,900	442,600	74,014	855,614
9 June	69,700	21,700	247,400	444,200	79,979	862,979

Kosovo/Kosova As Seen, As Told (OSCE)

B-H: Bosnia-Herzegovina.

FYROM: the former Yugoslav Republic of Macedonia.

HEP: Humanitarian Evacuation Programme.

In addition, more than 100,000 Serb IDPs are estimated to have left Kosovo and to have been registered in Serbia and Montenegro

Source: UNHCR, Geneva, 15 October 1999.

Mass graves found in Serbia with Albanian victims

During 1998 and first six months of 1999 several thousand Kosova Albanians disappeared inside Kosova. More than 836 were found in mass graves in Serbia. The dead victims were transported from mass graves in Kosova on trucks to mass graves inside Serbia in order

to cover up criminal acts committed by Serbian military, police, and paramilitary forces. These covert activities were revealed when a lorry with dead bodies was involved in a traffic accident and the lorry ended in a river and dead Kosova Albanian bodies began to float in the river. More than two thousand Kosova Albanians are still missing. Here I have some pictures, showing a map section and photos of places where dead Albanians were found inside Serbia.

Fig 7




Fig 8 and 9

Batajnica

In this location in Batajnica mass graves were found, in long underground tunnels (50-100 m) which earlier were used to grow

mushrooms, now used to store bodies taken from mass graves in Kosova.

Fig.8



Fig 9



Photo: Dr. Arsim Sh. Gërxhaliu (2002)

Fig 10**Raska**

Additional information as late as 10 May 2010 from Serbia shows new mass grave found in Raska near the border to Kosova. (Photo Scanpix/Reuters)



All that I have presented point at Genocide. For further information concerning my documentation see:

www.truth-commission.com

Last part of my lecture

It is very strange how time has flown for me since 2010 when I presented my war crimes documentation. For everyone else also time has clearly flown, except for the raped women during the war in Kosova, especially for the first 423 raped women who found the courage to sign a document, when asked for by UNMIK and the local authorities, for them time has almost stood still. UNMIK and the new Albanian political authorities needed in 1999 documented evidence of abuses against civilians committed by the Serbs in Kosova in 1998-99. The group of 423 raped women signed and were promised protection, support and help in the local environment when they moved home, but help never came! Since 2010 after having the first meeting with some of the women who were raped, I understood that my work in Kosova could not end yet. A new page cannot be opened in the lives of these women without first filling the empty space that was created. The political leaders cannot move on in life with other tasks until given promises are fulfilled. For years I have sent letters to the previous and

current Prime Minister for the 423 female war victims, to compensate for the lack of support that was promised, but nothing happened.

Fig 11

Three books were written since 2003 by local female writers and I wonder how many politicians have read these books?

- *Histori te tmerrit 1998-1999 (History of Horror)* of Sanije Gashi (2010)

- *Rrefime Tronditëse 2003*, Luljeta Selimi (*Femrat e Dhunura Gjatë Luftës së Kosovës*)

- *Pa Apologji (Without Apology)* by F. Ramosaj (2005), Printed by Dukagjini

Well, here is the second digression:

(In religion, a **prophecy** is a message that has been communicated to a person by a supernatural entity. Here the other night I got a prophecy like this:

"There will rest a curse upon Kosova until the 423 female war victims have got their rightful excuse and compensation."

Thank you for listening.

Rudina Jasini

PJESËMARRJA E VIKTIMAVE SI PALË CIVILE NË PROCESET PENALE NDËRKOMBËTARE*

Abstrakt

Drejtësia për viktimat është cilësuar shpesh si *raison d'être* (fr. 'arsyeja e ekzistencës') dhe misioni më i lartë i mekanizmave të drejtësisë penale ndërkombëtare. Ky qëllim fisnik ka qenë në themel të punës së tribunaleve penale ndërkombëtare hibride dhe ad hoc, si dhe vetë Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN), por, përsëri, kritikantët se këta mekanizma nuk kanë bërë mjaftueshëm për viktimat e krimeve masive dhe krimeve të luftës nuk kanë munguar. Sfida më e madhe që këto institucione kanë hasur qëndron në ambiguitetin e asaj se çfarë do të thotë 'drejtësi për viktimat' dhe se çfarë forme merr kjo drejtësi në kontekstin e drejtësisë penale ndërkombëtare. Të kuptuarit të rolit dhe fushës së veprimit të së drejtave materiale dhe procedurale në mbrojtje të këtyre viktimave ka qenë një çështje e rëndësishme me të cilën pothuajse të gjitha tribunalet ndërkombëtare janë përballur, veçanërisht GJPN-ja. Duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të proceseve penale ndërkombëtare, duke përfshirë kufizimet e lëndës, strukturën dhe përbërjen e gjykatave penale ndërkombëtare, si dhe numrin e madh të çështjeve dhe natyrën e viktimizimit masiv – duke i dalluar ato në shumë aspekte të rëndësishme nga procedurat penale vendase – pjesëmarrja e viktimave në proceset penale ndërkombëtare ngre disa pyetje dhe tema unike e specifike, të cilat nga ana e tyre, siç do të tregojë ky artikull, sjellin sfida dhe përgjigje shumë komplekse. Padyshim, pjesëmarrja e viktimave është ende në faza zhvillimi në drejtësinë penale ndërkombëtare, dhe natyra e saj *sui generis* karakterizon të gjithë aplikimin e saj në praktikë.

Puna kërkimore lidhur me pjesëmarrjen e viktimave deri më tani ka treguar se aktualisht ekziston një nevojë kritike për standarde të mirëzhvilluara, në të dyja nivelet – ligjor dhe normativ- si dhe standarde të përgjithshme të cilat të udhëheqin në praktikë aplikimin e mekanizmit ligjor të 'pjesëmarrjes së viktimave'.

Fjalët çelës: Viktima, pjesëmarrja e Viktimave, e Drejta Penale Ndërkombëtare, Viktimologji, Drejtësi Tranzicionale

* Dr Rudina Jasini është studiuese e së drejtës penale ndërkombëtare dhe e të drejtave të njeriut pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Oxford. Gjithashtu ajo është avokate për mbrojtjen në çështjen *Thaci et al* pranë Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës në Hagë.

Drejtësia për viktimat është cilësuar shpesh si qëllimi dhe misioni më i lartë i mekanizmave të drejtësisë penale ndërkombëtare. Ky objektiv ka qenë në themel të punës së tribunaleve penale ndërkombëtare hibride dhe *ad hoc*, si dhe vetë Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN), por përsëri, kritikantët se këto mekanizma nuk kanë bërë mjaftueshëm për viktimat e krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës nuk kanë munguar.¹ Sfida më e madhe që këto institucione kanë hasur qëndron në ambiguitetin e asaj se çfarë do të thotë “drejtësi për viktimat” dhe se çfarë forme merr kjo drejtësi në kontekstin e drejtësisë penale ndërkombëtare. Të kuptuarit e rolit dhe fushës së veprimit të të drejtave materiale dhe procedurale në mbrojtje të këtyre viktimave ka qenë një çështje e rëndësishme me të cilën pothuajse të gjitha tribunalet ndërkombëtare janë përballur, veçanërisht GJPN-ja. Në krahasim me tribunalet e tjera, zhvillimi dhe aplikimi i regjimit të pjesëmarrjes së viktimave në GJPN ka qenë kryesisht horizontal dhe i decentralizuar në natyrë, pra dhomat e procedurës paraprake dhe dhomat e gjykimit kanë përcaktuar limitet e pjesëmarrjes së viktimave duke e interpretuar atë shpeshherë në mënyrë të ndryshme për çështje të ndryshme brenda së njëjtës situatë. Duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të proceseve penale ndërkombëtare, duke përfshirë kufizimet e lëndës, strukturën dhe përbërjen e gjykatave penale ndërkombëtare, si dhe numrin e madh të çështjeve dhe natyrën e viktimizimit masiv – duke i dalluar ato në shumë aspekte të rëndësishme nga procedurat penale vendëse – pjesëmarrja e viktimave në proceset penale ndërkombëtare ngre disa pyetje dhe tema unike e specifike, të cilat nga ana e tyre, siç do të tregojë ky artikull, sjellin sfida dhe përgjigje shumë komplekse. Padyshim, pjesëmarrja e viktimave është ende në faza zhvillimi në drejtësinë penale ndërkombëtare dhe natyra e saj *sui generis* ka karakterizuar të gjithë aplikimin e saj në praktikë.

Puna kërkimore lidhur me pjesëmarrjen e viktimave deri më tani ka treguar se aktualisht ekziston një nevojë kritike për standarde të mirëzhvilluara, në të dyja nivelet – ligjor dhe normativ- si dhe standarde të përgjithshme të cilat të udhëheqin në praktikë aplikimin e mekanizmit ligjor të ‘pjesëmarrjes së viktimave’. Përpos nevojës për të adresuar pyetjen themelore: “Çfarë roli duhet të luajë pjesëmarrja e viktimave në proceset gjyqësore penale ndërkombëtare?” specifikisht, ky artikull argumenton (të paktën në teori), se ndonëse pjesëmarrja e viktimave mund të çojë në realizimin e aspiratave të drejtësisë restauruese, mënyra

¹ M. Cherif Bassiouni, ‘Njohja Ndërkombëtare e të Drejtave të Viktimave’ (2006) 6 Human Rights Law Review 203.

në të cilën pjesëmarrja e viktimave është konceptuar dhe interpretuar deri më sot ngre pyetje të rëndësishme në lidhje me rolin dhe impaktin e këtij përfaqësimi mbi funksionalitetin e proceseve gjyqësore, të drejtave të akuzuarve dhe të drejtave të vetë viktimave.²

1. Hyrje

Njohja e të drejtave pjesëmarrëse të viktimave në proceset penale përbën një risi në të drejtën penale ndërkombëtare.³ Përfshirja e viktimave si palë civile (*partie civile*) në proceset gjyqësore penale ndërkombëtare shënjon një zhvillim tejet të rëndësishëm për të drejtat e viktimave. Ky zhvillim i evidentuar përgjatë viteve 1980 dhe 1990 ishte në fakt produkt i një lëvizjeje të gjerë dhe avancimeve paralele në sistemet ligjore vendore dhe ndërkombëtare, kundrejt një njohjeje më të madhe të të drejtave të viktimave. Ishte edhe një kundërpërgjigje për kritikën në rritje që vinin nga organizata të ndryshme lidhur me marginalizimin e viktimave në procesin e drejtësisë penale.⁴ Trendi i theksuar në rritje i përfaqësimit të viktimave në nivelin ndërkombëtar u reflektua në brendinë e Statutit të Romës dhe në punën e GJPN-së.⁵ GJPN-ja u kthye kështu në tribunalin e parë penal ndërkombëtar që mbështeti e miratoi pjesëmarrjen aktive të viktimave, nëpërmjet njohjes së tyre si 'pjesëmarrës' në procesin gjyqësor.⁶ Ky dimension i ri i të

² R. Jasini, 'Pjesëmarrja e viktimave në drejtësinë në tranzicion: çështja e Dhomave të Jashtëzakonshme në Gjykatën e Kamboxhias' (ECCC), raport i përgatitur për Impunity Watch, prill 2016.

Shih <https://www.impunitywatch.org/victim-participation-and-transition>

³ William A. Schabas, 'Prezantim me Gjykatën Penale Nderkombëtare' (edicioni 2 Cambridge University Press 2004) 328; Antonio Cassese, "Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare: Disa Reflektime Paraprake" (1999) 10 Gazeta Evropiane e së Drejtës Ndërkombëtare 144, 167; Shih gjithashtu Emily Haslam, 'Pjesëmarrja e Viktimave në Gjykatën Penale Ndërkombëtare: Një Triumf i Shpresës mbi Përvojën?' në Dominic McGoldrick, Peter Rowe dhe Eric Donnelly (eds), *Gjykata Permanente Penale Ndërkombëtare: Politikat ligjore dhe problemet* (Hart Publishing 2004) 315.

⁴ Lucia Zedner, *Drejtësia Penale*, Clarendon Law Series (Oxford University Press 2004) 143.

⁵ Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare, 1 korrik 2002, art 1. Shih <<http://www.icc-cpi.int/NR/rdonlyres/ADD16852-AEE9-4757-ABE7-9CDC7CF02886/283503/RomeStatutEng1.pdf>>

⁶ Ibid, art 68.3. Sipas Statutit të Romës, viktimave u jepet e drejta të "paraqesin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre" në Gjykatë dhe ta bëjnë këtë "aty ku preken interesat e tyre personale".

drejtave të viktimave u forcua edhe më tej në Dhomat e Jashtëzakonshme në Kamboxhia (ECCC), kryesisht ngaqë ky tribunal ofroi një karakterizim të paprecedentë të viktimave si ‘palë’ me të drejta të plota, e jo thjesht si pjesëmarrës në procesin gjyqësor.⁷ Gjithashtu, ky trend u reflektua edhe në Tribunalin Special për Libanin (TSL), të krijuar më vonë.⁸ Zhvillime të tilla, shoqëruar nga një ndryshim tërësor në njohjen e viktimave, pasqyrojnë gjerësisht rëndësinë në rritje të drejtësisë restauruese dhe konsolidimin e të drejtave të viktimave në sistemet e drejtësisë perëndimore.⁹ Evoluimi dhe fuqizimi i të drejtave të viktimave kanë gjetur shprehje në dy instrumente të rëndësishme ligjore ndërkombëtare: së pari, në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1985 mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit (Deklarata e Viktimave); dhe së dyti, në Parimet dhe Udhëzimet Themelore të vitit 2006 mbi të drejtën për zgjidhje juridike dhe dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare (Parimet Themelore), i cili është përshkruar si ‘një kod ligjor ndërkombëtar i të drejtave të viktimave, me fokus kryesor në viktimat e krimeve ndërkombëtare’.¹⁰ Një mori masash dhe reformash kanë kontribuar në rolin gjithnjë e më të spikatur që u jepet viktimave në të drejtën penale ndërkombëtare bashkëkohore.¹¹ Këto zhvillime kanë ardhur dhe janë ndikuar nga faktorë të shumtë, në veçanti Parimet Themelore, zgjerimi i të drejtave të viktimave në të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare, shoqëruar nga njohja në rritje e të drejtave të viktimave në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës Ndëramerikane të të Drejtave të Njeriut (IACtHR). Krijimi i gjykatave të ndryshme *ad hoc* dhe hibride, dhe më pas i GJPN-së, kanë dhënë kontribute të tjera të rëndësishme për progresin në këtë fushë, duke çuar në rritjen e të

⁷ Rregullat e brendshme të ECCC, r 23. Shih <http://www.eccc.gov.kh/sites/default/files/legal-documents/Internal_Rules_Rev_9_Eng.pdf> (aksesuar më 14 janar 2023).

⁸ Statuti i Tribunalit Special për Libanin, art. 28 (1), S/RES/1757 (2007). Shih <http://www.specialtribunalforlebanon.org/en/documents/TSL-documents/statute/223-statute-of-the-special-tribunal-for-lebanon>

⁹ Carolyn Hoyle, ‘Viktimat, Procesi Penal dhe Drejtësia Restauruese’, Mike Maguire, Rod Morgan dhe Robert Reiner (eds), *The Oxford Handbook of Criminology* (edicioni 5 Oxford University Press 2012) 398.

¹⁰ M. Cherif Bassiouni, ‘Njohja Ndërkombëtare e të Drejtave të Viktimave’ (2006) 6 Human Rights Law Review 203.

¹¹ William A. Schabas, *Prezantim me Gjykatën Penale Ndërkombëtare* (edicioni 2, Cambridge University Press 2004) 323.

drejtave themelore dhe procedurale për viktimat. Kjo vihet re dukshëm në të drejtat më gjithëpërfshirëse që u ofrohen viktimave në kontekstin e procesit gjyqësor, duke përmendur këtu, ndër të tjera, zbulimin e dokumenteve, mbrojtjen e viktimave dhe disponueshmërinë e mjeteve juridike, në veçanti kompensimet. Në të vërtetë, është pikërisht ECCC institucioni që u ka atribuar viktimave të krimeve formën më të zgjeruar dhe më të avancuar në të drejtën e pjesëmarrjes, të reflektuar në dhënien e të drejtës së tyre për të marrë pjesë si palë civile në proces dhe jo thjesht si dëshmitarë.

Teksa avokatët e të drejtave të viktimave dhe organizatat mbështetëse argumentojnë përgjithësisht se aty ku pjesëmarrja u jep viktimave mundësinë për të paraqitur pikëpamjet dhe vëzhgimet e tyre, duke rritur kështu perspektivat si të drejtësisë ndëshkuese dhe atë res-tauruese, një pjesëmarrje e tillë i jep edhe komunitetit ndërkombëtar një mundësi të rëndësishme për të përmbushur objektivin "jo vetëm për të sjellë kriminelët para drejtësisë, por edhe për të ndihmuar vetë viktimat të arrijnë drejtësi."¹² Megjithatë, duket se diskursi liberal mbi pjesëmarrjen e viktimave shpeshherë e ka zbehur nevojën për të pyetur në mënyrë kritike se si po zhvillohet kjo pjesëmarrje në praktikë dhe çfarë pasojash po sjell.

2. Avancimi i të drejtave të viktimave: modelet e pjesëmarrjes në drejtësinë penale kombëtare dhe ndërkombëtare

Zhvillimi i shtetit kombëtar modern e të centralizuar dhe ndikimi në rritje i mendimit retributivist në zhvillimin e sistemeve vendase të drejtësisë penale i anashkaloj gjithnjë e më shumë viktimat: fokusi ka qenë më shumë te shkelësi i ligjit dhe te shteti si hetues, prokuror, gjykatës dhe ekzekutues. Shqetësimi për të drejtat e viktimave u shpreh në sisteme të ndryshme ligjore, që u përkisnin si traditave civile ashtu edhe asaj anglo-saksone ("common law"). Për më tepër, traktatet rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut tradicionalisht kishin qasje legaliste,¹³ mungesa e shprehjes së referencave të sakta për të drejtat dhe interesat e viktimave të krimit konsiderohej si pengesë ndaj

¹² Shih http://www.iccpi.int/en_menus/icc/structure%20of%20the%20court/victims/Pages/victims%20and%20witnesses.aspx

¹³ M. Cherif Bassiouni, 'Njohja Ndërkombëtare e të Drejtave të Viktimave' (2006) 6(2) Human Rights Law Review 203, 204.

çdo mbrojtjeje në bazë të të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të të drejtave të njeriut. Arsyet që sollën një fokus më të madh dhe avancimin e të drejtave procedurale të viktimave në sistemet ligjore kombëtare gjatë viteve 1970 dhe 1980 ishin: zhvillimi i lëvizjes për të drejtat e viktimave, e viktimologjisë si një disiplinë më vete, e shkencave shoqërore dhe e doktrinës së të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në aktivizmin e organeve rajonale gjyqësore dhe jogjyqësore të të drejtave të njeriut, si dhe interpretimin e instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kështu, dispozitat ekzistuese në shumë sisteme të së drejtës civile u rikthyen, si modeli i palës civile në të drejtën gjermane dhe franceze, dhe u shtuan mekanizma të rinj, të tillë si deklaratat e viktimave (victim impact statements) në një sërë juridiksionesh të traditës anglo-saksone (common law). Është i pakundërshtueshëm fakti që teksa gjykatat penale ndërkombëtare po krijoheshin dhe zhvilloheshin, sistemet ligjore kombëtare shërbyen si modele. Në këtë kontekst, mund të vërehet qartazi një ndikim i ndërsjellë i sistemeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Natyra dalluese e krimeve ndërkombëtare dhe shoqërimi i tyre me viktimizimin masiv kanë qenë disa nga shtytësit kryesorë për zgjerimin dhe zhvillimin e të drejtave të viktimave në arenën ndërkombëtare. Ky zhvillim ka qenë pjesë e një procesi më të gjerë, i cili ka parë një evoluim gradual të rolit të luajtur nga viktimat, fillimisht si thjesht ankues dhe dëshmitar, më pas si dhënës të deklaratave të viktimës përpara marrjes së vendimit të gjyqimit dhe deri në njohjen e tyre si pjesëmarrës ose palë me të drejta të plota në procesin gjyqësor. Kulminacioni i këtij zhvillimi ka ardhur me njohjen e viktimave si palë civile në ECCC, e cila është edhe gjykata që u ka ofruar viktimave nivelin më të lartë të të drejtave procedurale.

2.1 Instrumentet e të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Kombet e Bashkuara kanë qenë aktorë kyç në avancimin e të drejtave të viktimave. Ndikimi i parimeve dhe punës së OKB-së është ndjerë si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar dhe ka ardhur në formën e dy instrumenteve ligjore të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.

2.1.1 Deklarata e viktimave të vitit 1985

Neni 8 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut parashikon se çdokush "ka të drejtën e një mjeti juridik efektiv nga gjykatat kombëtare kompetente për aktet që shkelin të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligji."¹⁴ Siç do të shihet më poshtë, dispozitat e përgjithshme në instrumente të ndryshme të të drejtave të njeriut në lidhje me të drejtën për një mjet efektiv juridik kanë qenë mjetet nëpërmjet të cilave janë krijuar dhe përpunuar të drejtat specifike për viktimat. Neni 8 ka qenë baza themelore për krijimin e Deklaratës së Viktimave,¹⁵ të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 29 nëntor 1985. Megjithëse nuk është ligjërish e detyrueshme, është cituar në shumë gjykata dhe tribunale kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.¹⁶ Deklarata ka pasur gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në hartimin e politikave kombëtare që synojnë rritjen e të drejtave të viktimave.¹⁷

Neni 1 i Deklaratës i përcakton viktimat si:

Personat që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëmtime, duke përfshirë lëndime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose shkelje të konsiderueshme të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve që janë në kundërshtim me ligjet penale që veprojnë brenda shteteve anëtare, duke përfshirë ato ligje që ndalojnë abuzimin e pushtetit.

Kështu, Deklarata u drejtohet viktimave të krimeve dhe të abuzimeve me pushtetin, gjë që reflektohet në strukturën e saj; pjesa A ka të bëjë me viktimat e krimit dhe pjesa B me viktimat e abuzimit me pushtetin. Duhet theksuar se referenca për përkufizimin e viktimave ndaj ligjeve që veprojnë në shtetet anëtare, qartëson se Deklarata është e aplikueshme për viktimat e veprave penale kombëtare dhe jo ato ndërkombëtare.

Pjesa A përmban një sërë të drejtash të rëndësishme për viktimat, duke përfshirë të drejtën për akses në drejtësi dhe trajtim të drejtë,¹⁸ si

¹⁴ E disponueshme në <http://www.un.org/en/documents/udhr/>.

¹⁵ Deklarata e Kombeve të Bashkuara të 1985-ës për Parimet Themelore të Drejtësisë për viktimat e krimit dhe shpërdorimit të pushtetit, A/RES/40/3.

¹⁶ Brianne McGonigle Leyh, *Drejtësia Proçedurale, Pjesëmarrja e Viktimave në Proçedurat Penale Ndërkombëtare* (Intersentia 2011) 96.

¹⁷ Shih për shembull Parimet dhe Udhëzimet mbi të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe Asistencë Ligjore, DOC/05/(XXX)247 (2001).

¹⁸ Deklarata e Viktimave, art. 4-7.

dhe të drejtat për restitutum,¹⁹ kompensim²⁰ dhe asistencë ligjore.²¹ Aty theksohet dinjiteti i viktimave²² dhe sigurohet masa për të drejtën e informacionit dhe asaj të asistencës. Neni 6 (b) parashtron se 'kur interesat e tyre personale preken, pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave duhet të shprehen dhe "të merren parasysh në fazat e duhura të procedurës", duke pasur parasysh këtu edhe të drejtat e të akuzuarve për një proces ligjor të rregullt. Siç do të shihet më poshtë, kjo gjuhë është përsëritur në instrumente të tjera për të drejtat e viktimave. Specifikisht, ndonëse Neni 7 nuk parashikon mekanizma të drejtësisë restauruese, ai gjithësesi u referohet "mekanizmave joformalë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", duke renditur kështu ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe asistencën për "pajtim dhe dëmshpërblim të viktimave".

Ndonëse është e qartë se Deklarata e Viktimave përmban të drejta të konsiderueshme për viktimat, e padyshim përbën një aspiratë fisnike në këtë aspekt, duhet theksuar se viktimave nuk u jepet ndonjë e drejtë e veçantë pjesëmarrjeje në proceset gjyqësore. Sipas Deklaratës, viktimat nuk kanë as të drejtën të kërkojnë rishikimin e vendimeve të prokurorisë. Një lexim më i detajuar i saj e bën të qartë, se shteteve u jepet një marzh i madh diskrecioni në implementim dhe, siç u theksua më lart, Deklarata nuk është as ligjërish e detyrueshme. Megjithatë, Deklarata e Viktimave përbën një deklaratë të rëndësishme parimore në fushën e të drejtave të viktimave në përgjithësi. Ajo përfaqëson përpjekjen e parë të suksesshme globale për të krijuar një instrument që përcakton standardet që shtetet duhet të kërkojnë të arrijnë brenda sistemeve të tyre ligjore kombëtare dhe ndikimi i saj mund të vërehet në një sërë kontekstesh. Deklarata e Viktimave gjithashtu ka influencuar zhvillimet e mëvonshme në këtë fushë, siç janë Parimet Themelore të vitit 2006.

2.1.2 Parimet themelore të vitit 2006

Ndryshe nga Deklarata e Viktimave, objektivi kryesor i Parimeve dhe Udhëzimeve Themelore të vitit 2006²³ është drejtësia penale

¹⁹ Ibid art. 8-11.

²⁰ Ibid art. 12-13.

²¹ Ibid art. 14-17.

²² Ibid art. 4.

²³ Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën për një mjet juridik dhe dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtës ndërkombëtare dhe shkeljeve të rënda të të drejtës ndërkombëtare humanitare, A/RES/60/147 (21 mars 2006).

ndërkombëtare. Ashtu si dhe Deklarata e Viktimave, Parimet nuk janë ligjërisht të detyrueshme,²⁴ megjithëse ato kanë për qëllim të pasqyrojnë gjerësisht 'detyrimet ligjore ekzistuese sipas së drejtës ndërkombëtare, të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare'.²⁵ Parimet themelore janë produkt i punës së dy ekspertëve të njohur ligjorë, të emëruar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut (UNHCR), Profesorët van Boven dhe Bassiouni.²⁶ Asambleja e Përgjithshme i miratoi ato me konsensus më 21 mars 2006.

Neni 8 i Parimeve Themelore i definon viktimat në terma shumë të ngjashëm me ato të Deklaratës së Viktimave. Megjithatë, ka dy dallime të rëndësishme midis këtyre dy instrumenteve: së pari, përkufizimi u referohet viktimave të 'shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare ose shkeljeve serioze të të drejtës ndërkombëtare humanitare', e jo shkeljeve të legjislacioneve kombëtare, duke reflektuar kështu edhe fokusin ndërkombëtar të Parimeve. Së dyti, ndryshe nga Deklarata e Viktimave, Parimet Themelore e zgjerojnë termin 'viktimë' duke përfshirë, aty ku shihet e përshtatshme, edhe anëtarët e familjes, personat në ngarkim dhe gjithë ata që janë përpjekur të ndihmojnë viktimën kryesore e që kanë pësuar dëm si pasojë. Ky definim përputhet me përshkrimin që i atribuohet termit 'viktimë' në shumicën e instrumenteve ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut.

Neni 11 përcakton strukturën për pjesën e mbetur të Parimeve Themelore, duke përfshirë në të drejtat që kanë viktimat: të drejtën e aksesit në drejtësi; të drejtën për kompensim të përshtatshëm, efektiv dhe të menjëhershëm; si dhe të drejtën e marrjes së informacionit. E drejta e aksesit në drejtësi zbatohet si mbi baza individuale, ashtu edhe ato kolektive.²⁷ E drejta dhe detyrimi i shteteve për të ofruar një zgjidhje efektive plotësohet nga një sërë detyrimesh pozitive drejtuar shteteve,

²⁴ Anne-Marie de Brouwer dhe Mikaela Heikkilä 'Çështjet e Viktimave: Pjesëmarrja, Mbrojtja, Dëmshpërblimi dhe Ndihma' në Göran Sluiter, Håkan Friman, Suzannah Linton, Sergey Vasiliev dhe Salvatore Zappalà (ed) *Procedura Penale Ndërkombëtare: Principe dhe Rregulla* (Oxford University Press 2013) 1337.

²⁵ UNHRC, "Draft Parimet Themelore dhe Udhëzimet mbi të Drejtën për Mjekim dhe Dëmshpërblim për Viktimat e Shkeljeve të të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut dhe të Drejtës Humanitare" UN Doc E/CN.4/2004/57, 26.

²⁶ Cherif Bassiouni, 'Njohja Ndërkombëtare e të Drejtave të Viktimave' (2006) 6 *Human Rights Law Review* 203, 249-250.

²⁷ Parimet Themelore, art. 13.

siç është detyrimi për të shpërndarë informacion.²⁸ Për më tepër, e drejta e aksesit në drejtësi nënkupton edhe detyrën e autoriteteve për të ndjekur penalisht, e cila zgjerohet edhe më tej në Nenin 4. Viktimat e krimeve ndërkombëtare kanë të drejtën e dëmshpërblimit, në të cilën përfshihen kthimi, kompensimi, rehabilitimi, satisfaksioni dhe garancia e mospërsëritjes²⁹; dëmshpërblimi duhet të jetë në proporcion me dëmin e pësuar.³⁰ Së fundmi, Parimet Themelore njohin të drejtën e viktimave për të kërkuar e gjetur të vërtetën, edhe pse Neni 24 nuk e lidh këtë të drejtë shprehimisht me ndonjë të drejtë procedurale ose të drejtë pjesëmarrjeje. Megjithatë, sipas fjalëve të Prof. Bassiounit, disa mendojnë se e drejta e 'viktimave' për të vërtetën shpaloset më së miri përmes një procesi penal, madje edhe në një situatë ku një shtet ofron mjete alternative korrigjuese siç janë komisionet për të zbuluar të vërtetën ("truth commissions").³¹ Katalogu i gjerë i Parimeve Themelore në lidhje me të drejtat e viktimave të krimeve ndërkombëtare është për t'u vlerësuar. Megjithëse ato nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëmarrjes së viktimave në proceset gjyqësore penale ndërkombëtare, mund të argumentohet se Parimet Themelore nënkuptojnë të drejtën e pjesëmarrjes, në veçanti të drejtën e aksesit në drejtësi dhe të drejtën për dëmshpërblim.

Tre instrumente rajonale të të drejtave të njeriut kanë qenë veçanërisht me ndikim në këtë fushë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ), Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (ACHR) dhe Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit (AfCHPR).

3. Viktimat dhe Drejtësia Penale Ndërkombëtare: modelet e pjesëmarrjes

Nocioni i ndjekjes penale ndërkombëtare të individëve, duke përfshirë zyrtarët e lartë shtetërorë, për shkeljet e të drejtave të njeriut daton që në periudhën pas Luftës së Parë Botërore.³² Megjithatë,

²⁸ Ibid art. 12.

²⁹ Ibid art. 18.

³⁰ Ibid art. 15.

³¹ M. Cherif Bassiouni, 'Njohja Ndërkombëtare e të Drejtave të Viktimave' (2006) 6 Human Rights Law Review 203, 265.

³² Antonio Cassese, *E Drejta Penale Ndërkombëtare* (edicioni 1 Oxford University Press 2003) 327.

përpjekjet për të krijuar institucione penale ndërkombëtare në atë kohë nuk dhanë rezultate të prekshme dhe në këtë drejtim ato mund të konsiderohen si të dështuara.³³ Këto përpjekje u materializuan vetëm në fund të Luftës së Dytë Botërore, me themelimin e gjykatave ushtarake të Nurembergut dhe Tokios, të cilat përfaqësonin, siç pohon Minow, 'mundësinë e dhënies së disa përgjigjeve ligjore, në vend të përgjigjeve të ardhura nga politika e pushtetit apo e agresionit ushtarak.'³⁴ Zhvillimi i të drejtës penale ndërkombëtare moderne dhe drejtësisë penale ndërkombëtare ka qenë një proces i ngadaltë dhe i mundimshëm, i ndarë në faza të ndryshme e të dallueshme nga njëra-tjetra, të cilat Cassese i kategorizon në: (i) përpjekjet e hershme të dështuara (1919-1945); (ii) ndjekjet penale pas Luftës së Dytë Botërore në kontekstin e Tribunalit të Nurembergut dhe Tokios (1945-1947); (iii) përpunimi i statutit për një gjykatë të përhershme nga Komisioni Ndërkombëtar; (iv) "rendi i ri botëror" pas Luftës së Ftohtë dhe krijimi i dy Tribunalëve *ad hoc* (1993-1994); dhe (v) hartimi i Statutit të GJPN-së (1994-1998). Duhet theksuar se deri në miratimin e Statutit të Romës të GJPN-së, viktimat – me të prekurit nga krimet ndërkombëtare, kanë qenë shpesh të marginalizuar dhe neglizhuar në gjykatat penale ndërkombëtare.³⁵ Kjo ka ardhur kryesisht për shkak të qasjes retribuese të drejtësisë penale ndërkombëtare dhe fokusit të saj në ndjekjen dhe dënimin e autorëve të krimeve ndërkombëtare. Seksioni në vijim eksploron zhvillimin e rolit dhe të drejtave materiale dhe procedurale që u ofrohen viktimave në të drejtën penale ndërkombëtare, duke filluar me Tribunalin e Nurembergut dhe Tokios; pastaj vazhdon me një shqyrtim të gjykatave *ad hoc* dhe hibride, duke përfshirë TPNJ, TPNR, SCSL, gjykatat në Timorin Lindor dhe në Kosovë; dhe përfundon me një pasqyrim të shkurtër të epokës së re të pjesëmarrjes aktive të viktimave. Analizimi i gjykatave

³³ Një shembull i përpjekjeve të tilla ishte propozimi i bërë në vitin 1919 nga Komisioni për Përgjegjësinë e Autorëve të Luftës dhe për Zbatimin e Dënimeve për të krijuar një "gjykatë të lartë të përbërë nga gjyqtarë të ardhur nga shumë kombe". Shih Raportin e Komisionit për Konferencën Preliminare të Paqes, ribotuar në (1920) 14 *American Journal of International Law* 116. Siç argumenton Cassese, 'përpjekje të tilla të hershme ishin të lavdërueshme për njohjen e tyre largpamëse të nevojës për një organ ndërkombëtar të drejtësisë penale. Megjithatë, këto nisma nuk mund të jepnin fryte në atë kohë ku koncepti i sovranitetit kishte një rëndësi jashtëzakonisht të lartë.'

³⁴ Martha Minow, *Midis Hakmarrjes Dhe Faljes: Përballja Me Historinë Pas Gjenocidit Dhe Dhunës Masive* (Beacon Press 1998) 127.

³⁵ Luke Moffett, *Drejtësia për viktimat para Gjykatës Ndërkombëtare Penale* (Routledge 2014) 58.

dhe tribunaleve të sipërpërmendura ka si qëllim vlerësimin e progresit të të drejtave të viktimave.

3.1 Tribunalet ushtarake të Nurembergut dhe Tokios

Lufta e Dytë Botërore është lufta më e përhapur dhe më vdekjeprurëse në histori, duke përfshirë më shumë se 30 vende dhe rezultuar në 50 deri në 85 milionë të vdekur ushtarakë dhe civilë. Pas saj, Fuqitë Aleate (Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Bashkimi Sovjetik) kërkuan që autorët të ndiqeshin penalisht dhe të mbanin përgjegjësi për krimet e tyre mizore.³⁶ Më 18 tetor 1945, Tribunali i Nurembergut, i njohur zyrtarisht si Gjykata Ushtarake Ndërkombëtare (IMT), u themelua nga aleatët me qëllim ndjekjen penale të anëtarëve të udhëheqjes politike, ushtarake dhe ekonomike të Gjermanisë naziste, të cilët dyshohet se kishin planifikuar, kryer ose marrë pjesë në Holokaust dhe krime të tjera të luftës.³⁷ Kjo u pasua nga themelimi i Tribunalit të Tokios, Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët (IMTFE), më 5 maj 1946 me qëllim ndjekjen penale të liderëve japonezë për krimet e kryera në Oqeanin Paqësor dhe Azi.³⁸ Gjyqet e mbajtura në këto gjykata shënuan një arritje historike në zhvillimin e të drejtës penale ndërkombëtare moderne dhe vazhdojnë edhe sot të ndikojnë në mënyrën sesi kjo e drejtë dhe drejtësia në vijim të një konflikti konceptohen.³⁹ Këto gjyqe kishin mision ofrimin e një drejtësie simbolike⁴⁰ për viktimat e krimeve më mizore, si dhe të

³⁶ Telford Taylor, *Anatomia e Gjyqeve të Nurembergut: Kujtime Personale* (Knopf Doubleday 1992) 32; M. Cherif Bassiouni, *Hyrje Në Të Drejtën Penale Ndërkombëtare* (Transnational Publishers 2003) 403. Shih gjithashtu Gary Bass, *Dora e Hakmarrjes: Politika e Tribunaleve të Krimeve të Luftës* (Princeton University Press 2001) 150-181.

³⁷ Krijuar nga Marrëveshja për Ndjekjen dhe Ndëshkimin e Kriminelëve të Mëdhenj të Luftës të Boshtit Evropian, dhe Karta e Gjykatës Ushtarake Ndërkombëtare, Londër, 8 gusht 1945 (Karta e Londrës).

³⁸ Krijuar nga Karta për Tribunalin Ushtarak Ndërkombëtar për Lindjen e Largët, Tokio, 19 janar 1946 (Karta e Tokios).

³⁹ Guénaël Mettraux, *Perspektiva mbi Gjyqin e Nurembergut* (edicioni 1 Oxford University Press 2008).

⁴⁰ Susanne Karstedt, 'Tribunali i Nurembergut dhe Shoqëria Gjermane: Drejtësia Ndërkombëtare dhe Gjykimi në nivel Kombëtar në Rindërtimet pas Konfliktit' në David A. Blumenthal dhe Timothy L. H. McCormack (eds), *Trashëgimia e Nurembergut: Ndikimi civil në hakmarrjen e institucionalizuar*, Humanitarian Law Series 13-35, (Martinus Nijhoff Publishers 2008) 18.

ndëshkonin zyrtarë të rangut të lartë në udhëheqjen naziste dhe japoneze.⁴¹

Të dyja Tribunalet u karakterizuan nga një qasje ndërgjyqëse tipike e sistemeve *common law*, kryesisht për shkak të ndikimit amerikan në hartimin e tyre. Ajo çka është më e rëndësishme është se në këto procese gjyqësore nuk ka pasur dispozita për pjesëmarrjen, mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave përveçse në lidhje me rolin e tyre si dëshmitarë. Për më tepër, nuk ka asnjë të dhënë që ideja e përfshirjes së viktimave si palë civile të jetë sugjeruar apo diskutuar ndonjëherë gjatë negociatave, madje as nga përfaqësues të shteteve që njohin pjesëmarrjen e palëve civile në sistemet e tyre ligjore vendëse. Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios kanë qenë subjekt i vlerësimeve por edhe kritikave. Ndonëse ndikimi i tyre në avancimin e së drejtës penale ndërkombëtare pranohet gjerësisht, gjyqet e mbajtura në këto Tribunale kanë qenë plot me mangësi ligjore.⁴² Një nga mangësitë kryesore ishte se këto procese gjyqësore nuk ofronin një forum për viktimat, edhe pse vuajtjet dhe dhimbja e viktimave u cituan dhe u përdorën në mënyrë rutinore gjatë negociatave që çuan në krijimin e Tribunaleve.

Tribunali i Nurembergut ashtu edhe i Tokios njohën viktimat e tre krimeve nën juridiksionin e tyre, përkatësisht: krimeve kundër paqes, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.⁴³ Gjithsej 94 dëshmitarë, përfshirë 14 viktima-dëshmitarë, dëshmuan para gjykatës.⁴⁴ Në IMT, viktimat luajtën një rol të kufizuar. Kjo ishte kryesisht rezultat i përdorimit dhe mbështetjes së madhe të Tribunalit në provat dokumentare dhe jo në dëshmitë e drejtpërdrejta. Situata ishte paksa ndryshe në IMTFE, ku gjyqtarët duhej të mbështeteshin më shumë në dëshmitë

⁴¹ Sam Garkawe, 'Roli dhe të drejtat e viktimave në Gjykatën Ushtarake Ndërkombëtare të Nurembergut', në Herbert Reginbogin, Christoph J. M. Safferling dhe Walter R. Hippel (eds), *Gjyqet e Nurembergut: E Drejta Penale Ndërkombëtare Që Nga Viti 1945* (Kluwer 2006) 86.

⁴² Kirsten Stellars, 'Drejtesia joperfekte në Nuremberg dhe Tokio' (2011) 21(4) *European Journal of International Law* 1085. Gjyqet në Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios kanë qenë subjekt i një numri të madh komentesh ligjore. Ka nga ata që besojnë, siç argumentoi Stellars, se "Lufta e Dytë Botërore ishte një ngjarje e jashtëzakonshme që kërkon mjete juridike të posaçme" dhe përgëzoi gjykatat për avancimin e ligjit ndërkombëtar. Të tjerët i dënuan për mangësitë e tyre ligjore dhe pohuan se disa nga akuzat ishin prapavepruese dhe zbatoheshin në mënyrë selektive' (në 1085).

⁴³ Karta e IMT Art 6; Karta e IMTEF Art 5.

⁴⁴ M. Cherif Bassiouni, *Hyrje në të Drejtën Penale Ndërkombëtare* (Transnational Publishers 2003) 403, 411.

e viktimave-dëshmitarë, për faktin se ata kishin më pak prova dokumentare në dispozicion (pasi japonezët kishin shkatërruar më parë shumicën e dokumenteve të tyre ushtarake). Në këto kushte, IMTFE dëgjoi 416 dëshmitarë, duke përfshirë 27 viktima-dëshmitarë dhe pranoi deklarata dhe deponime nga 779 individë të tjerë, shumë prej të cilëve ishin viktima. Përzgjedhja e viktimave që u thirrën për të dëshmuar vuri në dukje një mangësi tjetër të dukshme të gjykimeve në këto tribunale. Aty u thirrën vetëm viktimat e drejtpërdrejta, duke qenë se dëshmia e tyre do të ofronte një kontribut më të madh në vërtetimin e fajit të të akuzuarit. Përveç kësaj, asnjë viktimë e përdhunimit nuk u thirr në këto tribunale, pavarësisht se përdhunimi ishte një krim i përhapur në zonat e kontrolluara nga forcat naziste dhe japoneze.⁴⁵ Qasja selektive dhe përjashtuese e ndjekur nga këto tribunale u shfaq jo vetëm në lidhje me llojin e viktimave (direkte ose indirekte) dhe përjashtimin e viktimave të krimeve specifike, por edhe në dështimin e këtyre institucioneve për të njohur e përfaqësuar të gjitha viktimat e mizorive të kryera gjatë luftës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur merren parasysh krimet e kryera nga aleatët, si përdorimi i bombave atomike nga Shtetet e Bashkuara në Hiroshima dhe Nagasaki, si dhe përdhunimi i grave gjermane dhe shumë krime të tjera që kurrë nuk u hetuan dhe nuk u ndoqën penalisht.⁴⁶ Njohja tepër selektive e vuajtjeve të viktimave, e cila mbuloi të vërteta të rëndësishme dhe fakte historike, ka çuar në disa raste edhe në viktimizim dytësor të viktimave.

Në vendimet e tyre përfundimtare, Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios shpallën fajtorë për krime ndërkombëtare 19 zyrtarë të lartë nazistë dhe 25 liderë japonezë. Për herë të parë në nivel ndërkombëtar, vuajtjet e viktimave u njohën dhe u dënuan publikisht. Megjithatë, këto gjykime nuk u dhanë fuqi viktimave të Holokaustit dhe të krimeve të tjera të tmerrshme të Luftës së Dytë Botërore, duke mos iu përgjigjur në mënyrë adekuate nevojave të tyre dhe duke mos u dhënë viktimave të drejta më të mëdha procedurale dhe materiale.⁴⁷ Evolucionin e të

⁴⁵ Ibid Shih gjithashtu, Henry Nicola, "Dëshmitar i Përdhunimit: Kufijtë dhe Potenciali i Gjykimeve të Krimeve Ndërkombëtare të Luftës për Viktimat e Dhunës Seksuale Gjatë Luftës" (2009) 3 International Journal of Transitional Justice 114, 115.

⁴⁶ Christian Tomuschat, (2006) 4(4) Trashëgimia e Nurembergut, Journal of International Criminal Justice 830, 834.

⁴⁷ Veçanërisht në lidhje me dëmspërblimin, megjithëse kishte disa referenca në Nenin 28 të Kartës së Nurembergut dhe në Deklaratën e Potsdamit, një dokument përgatitor i Tribunalit të Tokios. Megjithatë asnjë nga gjykatat nuk arriti ta trajtojë çështjen dhe nuk pati referenca te tilla në gjyqe.

drejtave të viktimave në nivel ndërkombëtar ka pasqyruar në një farë mase evolucionin e vetë drejtësisë penale ndërkombëtare. Gjykatat e mëvonshme, siç do të shohim më poshtë, kanë kontribuar më shumë në avancimin e të drejtave dhe interesave të viktimave.

3.2 Dy gjykatat *ad hoc* për Jugosllavinë dhe Ruandën

Fundi i Luftës së Ftohtë, si dhe zhvillimi në rritje i doktrinës së të drejtave të njeriut kontribuan në një nevojë të shtuar për drejtësi penale ndërkombëtare në fillim të viteve 1990. Dhuna sistematike kundër civilëve që shpërtheu në ish-Jugosllavi dhe në Ruandë shërbeu, siç pohon Cassese, 'për të rindezur ndjenjën e zemërimit të ndjerë në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore.'⁴⁸ Si përgjigje ndaj krimeve të kryera në ish-Jugosllavi dhe Ruandë, Këshilli i Sigurimit të OKB-së krijoi dy gjykata *ad hoc* në përputhje me kompetencat e tij në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së; Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) në vitin 1993⁴⁹ dhe Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) në vitin 1994.⁵⁰ Kapitull VII i Kartës së OKB-së parashikon pikërisht marrjen e masave të nevojshme për ruajtjen ose rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Krijimi i këtyre dy gjykatave *ad hoc* solli një epokë të re dhe moderne në të drejtën penale ndërkombëtare dhe drejtësinë penale ndërkombëtare në përgjithësi. Në bazë të statuteve të tyre, këto tribunale kishin juridiksion mbi individët e akuzuar për shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës, shkeljeve të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.⁵¹ Procedurat e miratuara nga TPNJ dhe TPNR janë kryesisht ndërgjyqëse në natyrë. Kjo qasje u miratua pas diskutimeve të gjata ndërmjet hartuesve të Kodit të Procedurës dhe të Provave. Duke qenë se përpara krijimit të TPNJ-së nuk ka ekzistuar ndonjë kod i procedurës penale ndërkombëtare, gjyqtarëve iu besua hartimi i rregullave; u konsideruan propozimet e ndryshme të paraqitura nga shtete dhe organizata, si dhe draftet e paraqitura nga vetë gjyqtarët.⁵²

⁴⁸ Antonio Cassese, *E Drejta Penale Ndërkombëtare* (1st edn Oxford University Press 2003), 335.

⁴⁹ UNSC RES 808, UN Doc S/RES/808 (1993).

⁵⁰ Statuti për Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ruandën, UNSC RES 955, S/RES/955 Aneks (1994).

⁵¹ Statuti i TPNJ, art. 2-5; Statuti i TPNR, art. 2-4.

⁵² Shih Virginia Morris dhe Michael P. Scharf, *Një Udhëzues i Brendshëm për Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë* (Martinus Nijhoff

Në lidhje me të drejtat e viktimave, as Statuti dhe as Kodi i Procedurës dhe Provave së TPNJ-së dhe TPNR-së nuk parashikojnë ndonjë formë të përfshirjes aktive dhe të drejtpërdrejtë të viktimave, përveç rasteve si dëshmitarë. Është me interes të përmendet që gjatë hartimit të Statutit të TPNJ-së, u paraqit një propozim për lejimin e caktimit të avokatëve të veçantë për viktimat, por më vonë ai u refuzua.⁵³ Megjithatë, Statuti i TPNJ-së parashikon një sërë të drejtash procedurale, të tilla si e drejta për mbrojtje dhe mbështetje nën Nenin 22, dhe e drejta për kthim (restituim) nën Nenin 24(3). Dispozita pothuajse identike mbi të drejtat procedurale të viktimave janë parashikuar edhe në Statutin e TPNR, i cili është i ngjashëm në strukturë dhe përmbajtje me Statutin e TPNJ-së.⁵⁴ Në themel të strukturës dhe funksionimit të TPNJ-së si dhe TPNR-së ka pengesa dhe kufizime, të cilat kanë bërë që këto gjykata të hezitojnë që të zgjerojnë të drejtat pjesëmarrëse të viktimave përtej dispozitave ligjore ekzistuese. Ekzistojnë tri mënyra në të cilat viktimat mund të marrin pjesë përpara TPNJ-së dhe TPNR-së: si dëshmitarë; amici curiae; dhe si dhënës të Deklaratave të Viktimave.⁵⁵

3.2.1 Viktima-dëshmitarë

Viktima përkufizohet në të dyja tribunalet si 'person kundër të cilit pretendohet se është kryer një krim ndaj të cilit Tribunali ka juridiksion'.⁵⁶ Më shumë se 4.500 dëshmitarë kanë dëshmuar para TPNJ-së që nga gjykimi i parë i kësaj gjykate në 1996⁵⁷ dhe më shumë se 3.000 në TPNR.⁵⁸ Ndryshe nga provat e shumta dokumentare të Tribunalit të Nurembergut dhe Tokios, gjyqtarët në TPNJ dhe TPNR janë mbështetur më shumë në dëshmi, dhe kjo reflektohet qartazi në numrin e konsiderueshëm të viktimave të thirrur për të dëshmuar. Sipas studimeve të kryera nga Stover (2005) dhe Hodžić (2010), pjesëmarrja

Publishers 1995) 176. Sipas Morris dhe Scharf, SHBA-ja paraqiti 'rregullat e propozuar më gjithëpërfshirëse me komente'. Kjo mund të shpjegojë deri diku qasjen më ndërgjyqëse që aplikoi Tribunali.

⁵³ Ibid 167.

⁵⁴ Mark Drumbl, 'Ndëshkimi, Post-Gjenocidi: Nga Faji në Turp në Qytetari në Ruandë' (2000) 75(5) New York University Law Review 1221, 1231.

⁵⁵ Ibid.

⁵⁶ Kodi i Procedurës dhe Provave të TPNJ-së dhe TPNR-së, Rregulla e përbashkët 2(a).

⁵⁷ Statistikat e dëshmitarëve, TPNJ në <http://www.icty.org/sid/10175>.

⁵⁸ Shih Raportet Vjetore të TPNJ 1996-2014 për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së dhe Këshillin e Sigurimit.

e viktimave si dëshmitarë është karakterizuar nga një gamë e gjerë përvojash, si pozitive ashtu edhe negative.⁵⁹ Faktorë të ndryshëm kanë kontribuar në perceptimet dhe qëndrimet e tyre kundrejt pjesëmarrjes në proces, duke përfshirë:

Përvoja e tyre personale e dhënies së dëshmisë, trajtimi i perceptuar si preferencial i të akuzuarve në krahasim me viktimat, mungesa e njohurisë dhe të kuptuarit e këtyre mekanizmave proceduralë që lidhen me procesin dhe, më e rëndësishmja, kohëzgjatja e dënimeve të dhëna ndaj të akuzuarve dhe lirimi i parakohshëm i personave të dënuar.⁶⁰

Pavarësisht nga rëndësia e rolit të viktimave si 'protagonistë të fakteve', dhënia e dëshmisë mund të jetë shpesh dekurajuese për viktimat, duke pasur parasysh fokusin e ngushtë dhe strukturën procedurale të procesit të gjyqimit. Në TPNJ dhe TPNR, dëshmia e viktimave shumë shpesh ka qenë e kufizuar dhe e kontrolluar nga pyetjet e bëra, gjë që ka penguar aftësinë e viktimave për të treguar historinë e tyre në një formë narrative dhe në një mjedis të qetë e të sigurt.⁶¹ Kjo e metë e këtyre proceseve është veçanërisht me rëndësi po të marrim parasysh se një nga nevojat kryesore të viktimave është nevoja për të treguar historinë e tyre të vuajtjes, ndjesi që ndajnë pothuajse të gjitha viktimat e krimeve të gjenocidit dhe krimeve të luftës. Pikërisht në kuadrin e këtyre kritikave kundër TPNJ-së dhe TPNR-së, grupe të ndryshme avokatësh për të drejtat e viktimave filluan të bëjnë fushatë për njohje dhe përfaqësim më të madh të viktimave.

3.2.2 Amicus Curiae

Amicus curiae, që përkthehet në 'mik të gjykatës', është një mekanizëm ligjor sipas të cilit një individ ose organizatë, e cila nuk është palë në një proces gjyqësor, mund t'i paraqesë gjykatës informacion ose parashtrime në lidhje me çështjen. Rregulli 74 i Kodit të Procedurës dhe

⁵⁹ Eric Stover, *Dëshmitarët: Krimet e Luftës dhe Premtimi i Drejtësisë në Hagë* (University of Pennsylvania Press 2005); Refik Hodžić, "Të Jetosh Trashëgiminë e Krimeve Masive: Perspektiva e Viktimave Mbi Gjyqet e Krimeve të Luftës" (2010) 8 *Journal of International Criminal Justice* 113.

⁶⁰ Ibid Hodžić 123.

⁶¹ Brianne McGonigle Leyh, *Drejtësia Procedurale? Pjesëmarrja e viktimave në procesin penal ndërkombëtar* (Intersentia 2011) 141.

Provave të TPNJ-së dhe TPNR-së parashikon që nëse shihet e përshtatshme për gjykimin e duhur të çështjes, një Dhomë mund të ftojë ose t'i lejojë një shteti, organizate ose personi që të paraqitet para saj dhe të bëjë parashtrësia për çdo çështje të specifikuar nga vetë Dhoma. Tribunali ka diskrecion për të vendosur nëse do të pranojë ose refuzojë një kërkesë për të vepruar si *amicus* dhe një vendim i tillë varet 'nga rëndësia e informacionit në gjykimin e drejtë të çështjes'.⁶² *Amicus curiae* është aplikuar në procedurat në TPNJ dhe TPNR, dhe të dyja Tribunalet kanë ftuar 'miq' në çështje të ndryshme ligjore.⁶³ Në parim, organizatat për të drejtat e viktimave dhe viktimave mund të shfrytëzojnë mundësinë për të marrë pjesë si *amici curiae* në procesin penal.⁶⁴ Në praktikë, ata që veprojnë në emër të interesave të viktimave, kanë kërkuar të marrin pjesë si miq në disa raste. Dy aplikime të rëndësishme janë bërë në çështjen *Bagosora* në TPNR; së pari nga qeveria belge që kërkoi të marrë pjesë si *amicus* bazuar në "Të drejtën e belgëve ose pretenduesve të ligjshëm, ë...], për t'u paraqitur para Tribunalit si paditës dhe jo si dëshmitarë të thjeshtë ë...]"⁶⁵ dhe së dyti nga Qeveria e Ruandës që kërkoi të ndihmojë vërtetimin e fajit të të akuzuarit dhe në kërkimin e dëmshpërblimit për përvetësimin e paligjshëm të pronës.⁶⁶ Gjykata i refuzoi të dyja kërkesat teksa theksoi natyrën e parakohshme të tyre, duke qenë se diskutimi për dënimet dhe kthimin e pronës nuk mund të zhvillohej përpara përcaktimit të fajit të të akuzuarit. Këto dhe vendime të tjera të ngjashme nga TPNR-

⁶² Ibid 142.

⁶³ Shembuj të vendimeve që përmbajnë *amici curiae* përfshijnë: TPNJ, *Prokurori kundër Tadić*, Çështja nr. IT-94-1, Urdhri për mohimin e lejes për t'u paraqitur si *Amicus Curiae*, Dhoma Gjyqësore II, 25 nëntor 1996; *Prokurori kundër Blaškić*, Çështja nr. IT-95-14, Urdhër për dhënien e lejes për t'u paraqitur si *Amicus Curiae*, Dhoma Gjyqësore I, 11 prill 1997; *Prokurori kundër Furundžija*, Çështja nr. IT-95-17/1, Urdhri për dhënien e lejes për dosje *Amicus Curiae*, Dhoma Gjyqësore II, 10 nëntor 1998; *Prokurori kundër Furundžija*, Çështja nr. IT-95-17/1, Urdhri për dhënien e lejes për dosje *Amicus Curiae*, Dhoma Gjyqësore II, 11 nëntor 1998; Shih gjithashtu nga TPNR, *Prokurori kundër Akayesu*, Çështja nr. ICTR-96-4-T, Urdhri për dhënien e lejes për paraqitjen e *Amicus Curiae*, Dhoma Gjyqësore I, 12 shkurt 1998; *Prokurori kundër Musema*, Çështja nr. ICTR-96-13-T, Vendim mbi një kërkesë nga Afrikan Concern për leje për t'u paraqitur si *Amicus Curiae*, Dhoma Gjyqësore I, 17 mars 1999.

⁶⁴ Shih Virginia Morris dhe Michael P. Scharf, Një Udhëzues i Brendshëm për Tribunalin Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavine (Martinus Nijhoff Publishers 1995).

⁶⁵ TPNR, *Prokurori kundër Bagosora et al.*, Çështja nr. ICTR-96-7-T, Vendim mbi Aplikimin *Amicus Curiae* nga Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës, Dhoma Gjyqësore II, 6 qershor 1998, f. 2.

⁶⁶ TPNR, *Prokurori kundër Bagosora et al.*, Çështja nr. ICTR-96-41-T, Vendim mbi Kërkesën *Amicus Curiae* nga Qeveria e Ruandës, Dhoma Gjyqësore II, 13 tetor 2004.

ja dhe TPNJ nënvizojnë jo vetëm ndarjen e qartë midis fazave të përcaktimit të fajit dhe dënimit të praktikuar kryesisht në sistemet common law, por edhe hezitimin e Tribunaleve për të zgjeruar të drejtat procedurale të viktimave përtej atyre të dëshmitarëve, duke pasur parasysh ndikimin që ky zgjerim mund të ketë në të drejtat e të akuzuarit, si dhe në rolin që i është dhënë prokurorisë.

3.2.3 Deklaratat e viktimave

Roli i deklaratave të viktimave në juridiksionet e së drejtës anglo-saksone ka gjetur praktikë edhe në jurisprudencën e TPNJ-së dhe TPNR-së. Më konkretisht, edhe pse Statutet e TPNJ-së dhe TPNR-së nuk e parashikojnë pjesëmarrjen aktive të viktimave, të dyja Tribunalet kanë lejuar dhënien e deklaratave të viktimës në kuadër të dënimit të të akuzuarit. Për më tepër, Rregulli 92bis i Kodit të Procedurës dhe Provave të TPNJ-së dhe TPNR-së parashikon se:

- (a) një Dhomë Gjyqësore mund të pranojë, tërësisht ose pjesërisht, dëshminë e një dëshmitari në formën e një deklaratë me shkrim në vend të dëshmisë gojore e cila merret si provë në një çështje...
- (b) fakti se provat në fjalë kanë të bëjnë me impaktin e krimeve ndaj viktimave, është një faktor i pranimit të provave në formën e një deklaratë me shkrim.

Rëndësia e deklaratave të viktimave në fazën e dënimit gjatë procesit është domethënëse kur merret parasysh graviteti i krimeve të kryera. Në çështjen *Krstić* para TPNJ, Dhoma Gjyqësore argumentoi se, ‘vlerësimi i duhur i rrethanave dhe pasojave individuale] i jep ‘zë’ vuajtjeve të viktimave.’⁶⁷ Kështu, deklaratat iu dhanë një mundësi viktimave për t’u përcjellë gjyqtarëve dhimbjen e dëmin e ardhur nga krimet e kryera nga i akuzuari.

3.2.4 Mbrojtja e viktimave

Një nga aspektet më shqetësuese në pjesëmarrjen e viktimave në proceset gjyqësore është mbrojtja dhe siguria e tyre. Neni 20 i Statutit të

⁶⁷ TPNJ, *Prokurori kundër Krsitić*. Çështja nr. IT-98-33, Vendimi, Dhoma Gjyqësore I, 2 gusht 2001, para 703.

TPNJ-së dhe Neni 19 i Statutit të TPNR-së parashtrajnë se procedurat gjyqësore duhet të zhvillohen duke i dhënë 'vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve.' Për më tepër, Gjykatat duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, brenda dhe jashtë sallës së gjyqit, si dhe mbrojtjen e identitetit të tyre.⁶⁸ Përveç këtyre artikujve, dispozita që flasin për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve janë të parashtruara edhe në Kodin e Procedurës dhe Provave të TPNR-së. Padyshim, këto dispozita përfaqësojnë avancimin më të madh të të drejtave procedurale të viktimave që nga koha e krijimit të Tribunaleve të Nurembergut dhe Tokios. Një reformë tjetër e rëndësishme lidhet me krijimin e Seksionit të Viktimave dhe Dëshmitarëve (SVD) të TPNJ-së dhe Seksionit për Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Viktimave të TPNR-së (SMDV). Këto organe patën si qëllim inkurajimin e viktimave dhe dëshmitarëve për të dëshmuar, duke u ofruar atyre kushtet e nevojshme të sigurisë dhe një mjedis dinjitoz për të dëshmuar. Gjyqtarëve u është dashur që të vendosin një ekuilibër midis të drejtave të të akuzuarve për një gjykim publik dhe të drejtave të viktimave dhe dëshmitarëve për mbrojtje dhe siguri gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes për masat mbrojtëse për viktimat, çështjet e konfidencialitetit dhe anonimitetit. Jurisprudenca e TPNJ-së dhe TPNR-së është, në fakt, kaq e mbushur me vendime dhe interpretime të masave mbrojtëse për viktimat, sa që kjo temë mund lehtësisht të përbëjë një fushë të veçantë kërkimore. Gjithsesi, është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht nga përpjekjet e konsiderueshme të bëra nga të dy Tribunalet për të garantuar masa mbrojtëse funksionale për viktimat dhe dëshmitarët, ato kanë dështuar në këtë drejtim. Në shumë raste janë bërë kritika si ndaj TPNJ-së ashtu edhe ndaj TPNR-së, veçanërisht për sa i përket çështjes së viktimizimit dytësor.⁶⁹

3.2.5 Të drejtat themelore materiale të viktimave: Dëmshpërblimi

Në vitet e fundit, si TPNJ ashtu dhe TPR kanë ndërmarrë hapa të konsiderueshme në adresimin e kërkesave të viktimave. Pavarësisht nga

⁶⁸ TPNJ Neni. 22 i Statutit; Neni 21 i Statutit të TPNR.

⁶⁹ Për referenca specifike për çështjen e mbrojtjes, shih ndër të tjera, *Prokurori kundër Tadić*, Çështja Nr. IT-94-1, Vendimi mbi Mocionin e Prokurorit që kërkon marrjen e masave mbrojtëse për viktimat dhe dëshmitarët, 10 gusht 1995, paragrafët 46-5; *Prokurori kundër Ramush Haradinaj et al.*, Çështja nr. IT-04-84-A, Vendimi i Dhomës së Apelit, 21 korrik 2010, para 37.

këto përpjekje, të dyja tribunalet kanë miratuar një qasje tejet konservatore, e cila pasqyrohet më së miri në interpretimin e tyre të ngushtë të drejtësisë për viktimat. Mungesa e dëmshtëpërblimeve për viktimat është ndoshta shembulli më shqetësues i kësaj qasjeje. Megjithatë, e drejta për dëmshtëpërblim nuk ka qenë kurrë pjesë e mandateve të TPNJ-së dhe TPNR-së dhe asnjë nga Tribunalet nuk ka pasur juridiksion për të ofruar dëmshtëpërblime për viktimat. Në përgjigje të protestës së viktimave në lidhje me mungesën e dëmshtëpërblimeve, si TPNJ ashtu edhe TPNR, kanë bërë apel para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, megjithëse pa rezultat.⁷⁰ Padyshim që mungesa e veprimit nga ana e Këshillit të Sigurimit ka minuar qëllimet e tribunaleve për të dhënë drejtësi për viktimat. Këtë e pranoi edhe kryetari i TPNJ-së:

Mungesa e adresimit të duhur të kësaj çështjeje përbën një dështim serioz në dhënien e drejtësisë për viktimat e ish-Jugosllavisë. Gjykata nuk mund të sjellë paqe dhe pajtim në rajon vetëm nëpërmjet dhënies së vendimeve të saj, mjetet e tjera juridike duhet të plotësojnë gjykimet penale nëse do të arrihet paqja e qëndrueshme dhe një mjet i tillë duhet të jetë dëmshtëpërblimi i përshtatëm për vuajtjet e viktimave.⁷¹

Mangësi të tilla në përmbushjen e nevojave dhe pritshmërive të viktimave, veçanërisht në lidhje me dëmshtëpërblimet, nxjerrin në pah kufizimet e gjykatave penale ndërkombëtare, objektivi kryesor i të cilave është të ndjekin penalisht ata që janë përgjegjës për krimet e kryera, në vend që të ofrojnë një koncept më të gjerë të drejtësisë për viktimat, që përfshin edhe dëmshtëpërblimin e tyre.

3.3 Gjykatat hibride

Krijimi i tribunaleve *ad hoc* shënoi një epokë të re të drejtësisë penale ndërkombëtare, e cila pa një përhapje të institucioneve të ndryshme kriminale të ndërkombëtarizuara që u bënë pararendëse të Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Interesant është fakti se ky lloj

⁷⁰ Shih letrën e datës 12 tetor 2000 nga Presidenti i Tribunalit Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, S/2000/1063, 3 nëntor 2000; Letër e datës 9 nëntor 2000 nga Presidenti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, S/2000/1198, 15 dhjetor 2000.

⁷¹ Raporti i Përfundimit Dy-Vjetor për Këshillin e Sigurimit të OKB-së, S/2010/588, 19 nëntor 2010, paragrafi 78.

tribunali i ndërkombëtarizuar ka vazhduar të zgjerohet edhe pas GJPN-së, me krijimin e institucioneve si ECCC dhe TSL. Këto gjykata quhen zakonisht 'hibride' për shkak të strukturës së tyre unike që kombinon elemente ndërkombëtare dhe kombëtare.⁷² Disa nga gjykatat hibride që i paraprinë ECCC-së janë SCSL, Panelet Speciale për Krime të Rënda në Timorin Lindor dhe Panelet e UNMIK/EULEX-it për Krimet e Luftës në Kosovë. Secila prej këtyre gjykatave ka një qasje të veçantë në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave në proces. Megjithatë, ajo që mund të vërehet është se ka pasur një zgjerim dhe rritje graduale të të drejtave procedurale dhe materiale të viktimave, që kulminojnë me pjesëmarrjen e viktimave si palë civile në ECCC.

3.3.1 Gjykata Speciale për Sierra Leone

SCSL ishte një gjykatë *sui generis* e bazuar mbi një traktat dhe kishte juridiksion dhe strukturë të përzier. Kjo Gjykatë u themelua në vitin 2002, pas një konflikti 10-vjeçar në Sierra Leone.⁷³ Për sa u përket të drejtave të viktimave, Gjykata nuk ofroi ndonjë zhvillim të rëndësishëm, pasi aty viktimat mund të merrnin pjesë vetëm si dëshmitarë dhe çdo kërkesë për dëmshpërblim ose kompensim iu la gjykatave vendëse; një situatë e ngjashme me atë në TPNR dhe TPNJ.⁷⁴ Sidoqoftë, një zhvillim të rëndësishëm jashtë sistemit gjyqësor përbënte roli që iu dha viktimave në një mekanizëm jogjyqësor pas konfliktit, i ashtuquajtur Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin,⁷⁵ i cili u krijua në të njëjtën kohë me SCSL. Kombinimi i këtyre mekanizmave gjyqësorë dhe jogjyqësorë me role plotësuese pas konfliktit përbën progres në arritjen e objektivave më të gjera të drejtësisë për viktimat. Puna e

⁷² Klasifikimi i një gjykate si 'hibride' varet nga një sërë kriteresh, të cilat variojnë nga baza ligjore e gjykatës, juridiksioni i saj lëndor, përbërja e personelit të gjykatës dhe vendndodhja e saj brenda ose jashtë një sistemi gjyqësor vendës. Shih John Cerone dhe Clive Baldwin, 'Shpjegimi i Sistemit Gjyqësor të UNMIK-ut' në Cesare P. R. Romano, André Nollkaemper dhe Jann K. Kleffner (eds) Gjykatat Penale të Ndërkombëtarizuara: Sierra Leone, Timori Lindor, Kosova dhe Kamboxhia (edicioni 1 Oxford University Press 2004) 41, fusnota 2.

⁷³ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Krijimin e një Gjykate Speciale për Sierra Leone, UN SCOR, Sess. 55, 915th Mtg., UN Doc. S/2000/915(2000), para 9.

⁷⁴ Hakan Friman, 'E drejta Procedurale në Gjykatat Penale të Ndërkombëtarizuara', në Cesare P.R. Romano, André Nollkaemper dhe Jann K. Kleffner (eds), Gjykatat Penale të Ndërkombëtarizuara: Sierra Leone, Timori Lindor, Kosova dhe Kamboxhia (edicioni 1 Oxford University Press 2004) 351.

⁷⁵ Shih <http://www.sierraleonetr.org>.

këtyre organeve u karakterizua nga mbivendosje juridiksioni, si dhe kontradikta që rrodhën nga mungesa e përcaktimit dhe ndarjes së qartë të funksioneve që në fillim. Në kontekstin e nevojave dhe interesave të viktimave, mund vetëm të thuhet se Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin u ofroi viktimave një forum për të treguar historitë e tyre në një formë narrative, për të cilën SCSL ishte jo mjaftueshëm e përgatitur fillimisht për ta ofruar.

3.3.2 Timori Lindor: Panelet Speciale për Krime të Rënda

Pas shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut që ndodhën në Timorin Lindor në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së krijoi Administratën Transnacionale të Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (UNTAET).⁷⁶ Nën UNTAET, gjykatat e reja hibride të referuara si Panelet Speciale për Krimet e Rënda (SPSC) u krijuan në Dili. Ndonëse SPSC janë kritikuar për shumë mangësi institucionale, kur vjen puna te viktimat, këto gjykata aplikuan "një qasje të sofistikuar që u bën jehonë shumë zhvillimeve ndërkombëtare dhe praktikave kombëtare."⁷⁷ Më e rëndësishmja është e drejta e viktimave për pjesëmarrje që u shtri përtej modelit viktimë-dëshmitar. Në praktikë, kjo e drejtë përfshiu një sërë të drejtash të veçanta, ndër të tjera: të drejtën për të kërkuar hetime specifike, subjekt i diskrecionit të prokurorisë; të drejtën për t'u dëgjuar në një seancë rishikuese para gjyqtarit hetues dhe në çdo seancë për kërkesë për lirim me kusht; të drejtën për t'u përfaqësuar në gjykatë nga një avokat; të drejtën për t'u informuar për ecurinë e çështjes; të drejtën për të kërkuar rishikimin e vendimit të prokurorit për të mos vazhduar ndjekjen penale.⁷⁸ Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se kodi i procedurës penale i SPSC-së nuk ua dha viktimave të drejtën për të marrë pjesë si palë civile në gjykim. Pjesëmarrja e tyre përtej modelit viktimë-dëshmitar u lejua vetëm kur u konsiderua e përshtatshme nga gjyqtarët. Pavarësisht nga këto dispozita ligjore që synuan fuqizimin e viktimave, nuk rezultoi se ndonjë avokat që përfaqësonte viktimat, mori pjesë në proces. Një tjetër zhvillim i

⁷⁶ UNSC Res 1272, UN Doc S/RES/1272, 25 tetor 1999. Pas pavarësisë së Timorit Lindor nga Indonezia, Ushtria Kombëtare Indoneziane dhe një numër i milicive të Timorit filluan sulme të dhunshme kundër popullit të Timorit Lindor, gjë që rezultoi në vrasjen e mijërave dhe zhvendosjen e më shumë se 500,000 civilëve.

⁷⁷ Shih McGonigle (n 4) 152. UNTAET Reg 2000/15, 6 qershor 2000, seksionet 24-25.

⁷⁸ Shih UNTAET Reg 2000/30, 25 shtator 2000 (i ndryshuar nga Rregullorja UNTAET 2001/25 e 14 shtatorit 2001), seksionet 12 dhe 25.

rëndësishëm në lidhje me të drejtat themelore të viktimave është e drejta e tyre për dëmshpërblim. Seksioni 49.1 i Rezolutës së UNTAET parashikon kërkesat për kompensim nga viktimat. Megjithatë, pavarësisht nga vlera e këtyre të drejtave materiale, ato duket se ngelën vetëm në nivelin teorik. Mungesa e kapacitetit institucional dhe financimi i pamjaftueshëm e dëmtuan në thelb perspektivën për dëmshpërblim të vërtetë në kontekstin e këtyre tribunaleve.

3.3.3 Panelet e UNMIK/EULEX-it për krimet e luftës në Kosovë

Themelimi i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) pas luftës së Kosovës në ish-Jugosllavi (1998-1999) çoi në krijimin e një sistemi gjyqësor kosovar të ngarkuar me ruajtjen e ligjit dhe rendit civil, si dhe mbrojtjen e promovimin e të drejtave të njeriut.⁷⁹ Një detyrë e rëndësishme e këtij sistemi të ri gjyqësor ishte ndjekja penale dhe gjykimi i atyre që ishin përgjegjës për mizoritë e ndodhura në Kosovë. Për sa i përket strukturës dhe kornizës ligjore, ky sistem gjyqësor karakterizohej nga bashkëjetesa e personelit gjyqësor vendor dhe ndërkombëtar. Korniza ligjore e këtij sistemi u bazua pjesërisht në Rregulloren 1999/24 dhe pjesërisht në Kornizën Kushtetuese.⁸⁰ Sipas këtij sistemi të ri, gjyqtarët ndërkombëtarë u ulën në panele gjyqësore në mbarë Kosovën dhe kanë shqyrtuar çështje rast pas rasti. Panelet për krimet e luftës në Kosovë përbëjnë një sistem kompleks gjykatash, qasja e të cilave ndaj rolit të viktimave ishte udhëzuese në një sërë nivelesh. Me rëndësi është fakti se viktimat në bazë të këtij sistemi të ri gjyqësor, kishin të drejta të gjëra pjesëmarrëse, të paktën teorikisht: përveç modelit viktimë-ankues dhe viktimë-dëshmitar, viktimat kishin të drejtë të merrnin pjesë edhe si palë civile, prokurorë ndihmës, ose prokurorë privatë. Megjithatë, nga të dhënat në dispozicion duket se numri i viktimave që ka ushtruar këto të drejta është shumë i ulët. Numri ka mbetur i ulët edhe pasi Bashkimi Evropian zëvendësoi OKB-në dhe themeloi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).⁸¹

⁷⁹ UNSC Res 1244, UN Doc S/RES/1244 (1999) para 10.

⁸⁰ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24, 12 dhjetor 1999, dhe Kornizën Kushtetuese.

⁸¹ Këshilli i Bashkimit Evropian, Veprimi i Përbashkët 2008/124/CFSP mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX

3.4 Pjesëmarrja aktive e viktimës

Apelet e lobimet për më shumë të drejta procedurale dhe materiale për viktimat në nivel ndërkombëtar janë përmbushur me njohjen e rolit të viktimave të krimeve masive në drejtësinë penale ndërkombëtare, e cila ka ardhur në rritje. Kjo tendencë reflektohet në qasjen e gjykatave penale ndërkombëtare që janë krijuar së fundmi. Zhvillimi më i dukshëm ka qenë krijimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Përhershme,⁸² i cili është institucioni i parë ndërkombëtar i drejtësisë penale që parashikoi dhe aplikoi pjesëmarrjen aktive të viktimave në procedurat e saj dhe që parashikon në mënyrë të shprehur masat e dëmshpërblimit.⁸³ Ky evolucion shënoi një epokë të re në drejtësinë penale ndërkombëtare ku theksohet një qasje e orientuar drejt viktimës dhe që hapi rrugën për pjesëmarrjen e viktimave në ECCC dhe TSL.⁸⁴ Regjimi i pjesëmarrjes së viktimave në GJPN është vlerësuar si një arritje e madhe e drejtësisë penale ndërkombëtare moderne.⁸⁵ Megjithatë, siç ka treguar zbatimi në praktikë përmes jurisprudencës së saj në rritje, pjesëmarrja e viktimave mbetet një nga aspektet më të diskutueshme të GJPN-së dhe një element me të cilën kjo Gjykatë është përballur që nga fillimi i saj. Ky mekanizëm i ri ligjor i GJPN-së ka qenë gjithashtu edhe objekt i një fokusi të shtuar të debatit akademik dhe shkencor.

Kosovë, 4 shkurt 2008; Kosovë, Ligji Nr. 03/L-053 Për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Emërimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

⁸² Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, 1 korrik 2002, art. 1.

⁸³ Ibid art. 75.

⁸⁴ Tribunali Special për Libanin (TSL) u krijua më 30 maj 2007 sipas Rezolutës 1757 të KS të OKB-së, e cila përfshinte marrëveshjen ndërmjet OKB-së dhe Libanit për themelimin e TSL. Kuadri procedural i TSL lejon pjesëmarrjen e viktimave në të gjitha fazat e procedurës, duke përfshirë dënimin, por vetëm pas ngritjes së aktakuzës.

⁸⁵ Christine H. Chung, Pjesëmarrja e 'Viktimave' në Gjykatën Penale Ndërkombëtare: A Janë Koncesionet e Gjykatës duke e Turbulluar Premtimin?' (2008) 6 Northwestern Journal of International Human Rights 459. Shih gjithashtu, Christine Van den Wyngaert, 'Viktimat Para Gjykatave Penale Ndërkombëtare: Disa Pikëpamje dhe Shqetësime të një Gjyqtari të GJPN (2012) 44 Case Western Reserve International Law Journal 476.

4. Përfundime

Analiza e parashtruar në këtë artikull ka treguar se si natyra dhe karakteristikat e një sistemi juridik, si p.sh. të bazuarit më shumë në traditën e të drejtës anglo-saksone (common law) apo të të drejtës së kodifikuar, formëson dhe ndikon në shtrirjen dhe parametrat e të drejtave procedurale dhe materiale që u akordohen viktimave. Sistemet kombëtare dhe ndërkombëtare janë të ndërlidhura ngushtë dhe si rrjedhojë modelet e pjesëmarrjes së viktimave në një sistem shpesh ndërlidhen dhe përshtaten me një tjetër. Gjykatat penale ndërkombëtare janë përballur me një sfidë të konsiderueshme në harmonizimin e zgjerimit të të drejtave të viktimave me atë që Weber e ka quajtur "racionalitet formal", që do të thotë se gjykatat veprojnë në zbatim të standardeve të rrepta procedurale të procesit të rregullt ligjor, kryesisht të drejtuar ndaj të akuzuarve.⁸⁶ Kështu, teksa roli i viktimave në Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios ishte shumë i kufizuar dhe i ngelur në atë të dëshmitarëve, gjykatat e mëvonshme ndërkombëtare si Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën, statutet e të cilave u referohen në mënyrë të kufizuar të drejtave të viktimave, parashikuan të drejtën për të marrë pjesë në rolet e dëshmitarit, *amicus curiae* dhe ofruesit të deklaratave. Një dobësi e këtyre modeleve të pjesëmarrjes, në veçanti roli i viktimës-dëshmitar në një sistem në thelb ndërgjyqës, është se ato ofrojnë mundësi shumë të kufizuara për viktimat që të tregojnë historitë e tyre nga këndvështrimi i tyre, pasi dëshmia zakonisht nuk jepet në një format narrativ. Kritikën e bëra kundrejt këtyre gjykatave për të drejtat në dukje të kufizuara që ato u dhanë viktimave të krimeve masive, rezultuan në rritjen e të drejtave të viktimave në procedurat e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, Dhomat e Jashtë-zakonshme në Kamboxhia dhe Tribunali Special për Libanin. Qasja më inkuizitore e miratuar nga këto gjykata ka qenë e dobishme në këtë drejtim. Megjithatë, një sërë mangësish në aspektin e të drejtave themelore materiale të viktimave ende qëndrojnë. Dokumentet udhëzuese dhe praktikën në terren mund të mos përputhen gjithmonë, pasi përvoja e pjesëmarrjes së viktimave në shumë gjykata ka qenë e kufizuar. Së fundmi, duhet të theksohet gjithashtu se përpjekjet për të zhvilluar më tej të drejtat e viktimave nëpërmjet krijimit të mjeteve që sigurojnë dëmshpërblime janë minimale dhe ka të ngjarë të mbeten të kufizuara edhe në të ardhmen.

⁸⁶ Martin E. Spencer, 'Weber për Normat dhe Autoritetet Legjitime (1970) 21 British Journal of Sociology 123, 128.

Hivzi Islami

TENDENCAT SERBE PËR SHKATËRRIMIN E THEMELEVE TË JETËS SË SHQIPTARËVE

Abstrakt

Në artikull përfshihen këto pika të shqyrtimit: rrënimi i ish-shtetit nga forcat hegjemoniste nisi në Kosovë; spekulimet serbe rreth migrimeve të popullsisë; Maqedonia si model për ndjekjen dhe shpërnguljen e shqiptarëve; privilegjet serbe shtriheshin në tre nivele (kosovare, serbe dhe jugosllave); rrezikimi i perspektivës dhe qenies demografike shqiptare; programi segregacionist dhe racist serbo-jugosllav për Kosovën; ligji mbi pronësinë si presion për dëbimin e shqiptarëve dhe masat për vënien e baraspeshës etnike në Kosovë; kolonët serbë nga Kroacia dhe BeH dhe serbo-malazezët nga Shqipëria; objektivi themelor i shovinizmit serb ishte shkatërrimi i themeleve të jetës së shqiptarëve. Regjimi militarist serb u vërsul me të gjitha mjetet kundër identitetin etnik, historik dhe kulturor të shqiptarëve dhe kundër themeleve të jetës së tyre. Përmes deportimit masiv dhe zhdukjes së dokumenteve personale (të identitetit dhe të pronës) të shqiptarëve, ky regjim donte ta dehumanizonte gjithë popullin shqiptar të Kosovës dhe ta këpuste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të tyre, ta rrëronte një etni, një kulturë, një shoqëri me të gjitha institucionet e saj.

Fjalët çelës: Hegjemonizmi serb, shqiptarët, qenia demografike, programi racist, gjenocidi, migrimet, kolonët, dëbimi, dehumanizimi i një etnie, rrënimi i një shoqërie

1. Rrënimi i ish-shtetit nga forcat hegjemoniste nisi në Kosovë

Jugosllavia e Versajës (1918-1919), ashtu siç u krijua mbi bazë të forcës ushtarake dhe të politikës hegjemoniste serbe, ashtu edhe u shkatërrua nga veprimi i konceptit të shtetit unitarist e hegjemonist.¹ Serbia dhe serbët moti ishin përgatitur për rrënimin e Jugosllavisë komuniste. E prisnin vetëm vdekjen e Titos; ai vdiq më 4 maj 1980. Në gjithë sistemin e ish-Jugosllavisë Kosova ishte hallka më e dobët dhe këtu ishte mundësia më e përshtatshme për fillimin e rrënimit të ish-shtetit. Pas

¹ Më gjerë në: P. Garde, *Vie et mort de la Yougoslavie*, Fayard, Paris, 1992.

aneksimit të Kosovës me dhunë në vitin 1989, faktikisht u paralizua funksionimi kushtetues dhe legal i Kuvendit të Jugosllavisë, meqenëse Kosova me Kushtetutën e vitit 1974 kishte shkallë të lartë të pavarësisë nga Serbia dhe ishte element konstitutiv i ish-Federatës, sikundër që kishte të drejtën e vetos në këtë Federatë.

Serbia, qoftë me indiferencën, qoftë me mbështetjen e drejtpërdrejtë të institucioneve të ish-shtetit, vazhdoi me rrënimin e plotë të autonomisë (federative), suprimimin e organeve legale të pushtetit (Kuvendit, Qeverisë, Kryesisë), përjashtimin e shqiptarëve nga institucionet e sistemit, mbylljen e mjeteve të informimit, mbylljen e shkollave e të Universitetit, helmimin e nxënësve, përjashtimin masiv të shqiptarëve nga organizatat ekonomike, institucionet sociale, humanitare, shëndetësore, kulturore e shkencore, rrënimin e bazës ekonomike të Kosovës, plaçkitjen e teknologjisë dhe të pronës private të shqiptarëve dhe me masa të presionit policor, ushtarak, politik dhe ekonomik shpërnguli një numër të madh të shqiptarëve. Por ndaj të gjitha formave të dhunës dhe terrorit, shqiptarët u përgjigjën me sjellje jo të dhunshme si mjet për ta evituar konfliktin dhe për ta realizuar vullnetin politik të tyre.

Pas vitit 1981 regjimi nisi me vrasjen e demonstruesve, burgosjen masive të të rinjve, diferencimet dhe izolimet e intelektualëve, arrësimet arbitrare, torturat dhe keqtrajtimet e të burgosurve, helmimet e nxënësve, bastisjet dhe ekspeditat ndëshkuese. Kundër shqiptarëve filluan diskriminimet dhe një represion i egër policor dhe ushtarak. Metodot mesjetare të linçimit policor në Kosovë ishin në ekspansion: vetëm në periudhën 1981-1988 më se 584.000 shqiptarë u trajtuan në organet policore, kryesisht të rinj, deri në moshën 25 -vjeçare.² Ndërsa sa ishin burgosur e përpunuar në polici dhe dënuar në gjyqe pas këtij viti dhe sa ishin trajtuar nëpër këto organe në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës nuk dihej.

Ish-Federata dhe ish-republikat joserbe, të bindura se Serbia do të ndalet në Kosovë, i dhanë përkrahje të plotë veprimeve policore e ushtarake dhe e ndihmuan materialisht represionin dhe segregacionin ndaj shqiptarëve; e dhanë pëlqimin që në Kosovë të vihej gjendja e jashtëzakonshme, të likuidohej me forcë autonomia federale, të vendosej sistemi diskriminues e kolonial dhe të stimulohej politika e kolonizimit të serbëve dhe e spastrimit etnik të shqiptarëve me qëllim që të

² Raport i përgjegjësit të Punëve të Brendshme të Kosovës para delegatëve të Kuvendit të KSA të Kosovës, Rrahman Morina. Shih: Rilindja, 15. 10. 1988, Prishtinë.

ndërrohej struktura etnike e Kosovës. Milosheviçi e shfrytëzoi mirë këtë përkrahje të ish-Jugosllavisë dhe duke manipuluar me mitin për Kosovën dhe duke i instrumentalizuar serbët e Kosovës, e forcoi pushtetin, sikurse Vuçiçi sot.

Duke shpifur tezën mbi pozitën diskriminuuese, degraduese e inferiore të Serbisë e të serbëve në planin ekonomik, politik e juridik në ish-Jugosllavi, establishmenti militarist i Milosheviçit mobilizoi energjitë e popullit serb për konfrontim dhe luftëra me popujt e tjerë. Përkrahja që i dhanë republikat e tjera Serbisë kundër Kosovës dhe shqiptarëve shumë shpejt iu kthye të gjithave bumerang dhe kriza eskaloj në konfrontim të hapur të Serbisë e të serbëve me komunitetet e tjera etnike me synim të realizimit të projektit ekspansionist "*Të gjithë serbët në një shtet të vetëm*" – pra, në një "*Jugosllavi serbe*" apo "*Serbi të Madhe*". Në vitet 90 me shqiptarët konflikti mori përmasat e një konfrontimi të ashpër të shtetit jugosllav me gjithë popullin shqiptar, deri në luftën e hapur, të armatosur në vitin 1999. Pasi shteti ua mbylli shkollat dhe fakultetet, shqiptarët i organizuan institucionet paralele, kryesisht sistemin e arsimit, i cili funksiononte në më se 3.000 objekte private, dhe kjo ishte rezistenca më e madhe civile në Europë.

Mitingjet populiste, homogjenizimi dhe mobilizimi etnik i masave vazhdonte; Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve alarmonte opinionin serb për rrezikimin e popullit serb; u krijua psikozë e tmerrshme e rrezikimit"! Pushteti serb nxiti inteligjencien nacionaliste, të tubuar rreth Akademisë së Shkencave, Shoqatës së Shkrimtarëve, Universitetit të Beogradit, si dhe mediumet dhe Kishën ortodokse për konfrontime me të gjithë popujt joserbë. "Memorandumit i paraprinë trazirat e vitit 1981 në Kosovë, pastaj lëvizja e serbëve, të cilën e kishte nxitur dhe organizuar Dobrica Qosiqi, i cili e përforcoi rolin e 'babait' të kombit".³

BE-ja dhe bashkësia ndërkombëtare përgjithësisht, me konferencat për ish-Jugosllavinë, bënë gabime me pasojë të mëdha kur Kosovën nuk e trajtuan të barabartë me njësitë e tjera të ish-Federatës, por u nisën nga gjendja e krijuar pas vitit 1989, të vënë me mjete policore dhe ushtarake. Me indiferencën ndaj dhunës në Kosovë deri më 1991 dhe me pranimin e gjendjes faktike, të krijuar pas suprimimit të autonomisë federale, faktori ndërkombëtar e mbështeti *fait accompli* politikën ose politikën e aktit të kryer, që e kurajonte Serbinë në sjellje edhe më

³ L. Perović, *Dominantna i neželjena elita (Beleške o intelektualnoj i političkoj eliti u Srbiji – XX-XXI vek)*, II izdanje, Beograd, 2016, f. 45.

agresive ndaj shqiptarëve, ndërsa Milosheviçin e pranonte si një njeri të paqes dhe duke i bërë koncesione të vazhdueshme deri në fillim të vitit 1999, e largonte Serbinë nga dialogu serioz me shqiptarët në praninë e faktorit të jashtëm. Mjerisht BE-ja në mënyra të ndryshme këtë po e bënë edhe sot e gjithë ditën. “Diplomacia perëndimore ishte shndërruar në njëfarë teatri cinik” dhe “diplomacia pa forcën ishte bërë një armë e zbrazët, e pafuqishme dhe qesharake”, shkruante ambasadori i fundit (1992) i SHBA-së në Beograd, W. Zimmermann.⁴

Pas Marrëveshjes së Dejtonit (nëtor 1995), ShBA-ja arriti ta ndalë luftën në BeH, por ndonjë zgjidhje politike nuk u bë për këtë vend dhe Ballkani politikisht nuk u qetësua.⁵ Pas kësaj Marrëveshjeje “shqiptarët e Kosovës e kuptuan se pa luftë nuk do t’i realizonin kurrë synimet e tyre kombëtare. Ngase Marrëveshja e Dejtonit nuk e përfshiu Kosovën, dhe kjo do të dëshmohej si një gabim i madh. Përkrahësit e Marrëveshjes argumentojnë edhe sot e asaj dite me të drejtë, se po të ishte përfshirë Kosova, nuk do të ishte arritur kurrë Marrëveshja me Milosheviçin dhe Serbinë. Edhe kritikët në anën tjetër të spektrit argumentojnë gjithashtu me të drejtë, se mospërfshirja e Kosovës vetëm sa ka hapur shtegun për luftën e ardhshme. Nganjëherë diplomacia ishte përballur me detyra që nuk mund t’i zgjidhë, me situata tragjike. Dejtoni ishte një situatë e tillë”.⁶ Edhe Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright (1937-2022), që bëri përpjekje mbinjerëzore derisa u mor vendimi për bombardimin e forcave serbe për çlirimin e Kosovës dhe shpëtimin e shqiptarëve në vitin 1999, theksonte se pas Marrëveshjes së Dejtonit, shqiptarët u ndjenë të lënë anash, pasi kroatët, sllovenët, boshnjakët dhe maqedonasit u shkëputën nga Jugosllavia dhe krijuan shtetet e tyre. “Shqiptarët kishin të njëjtën dëshirë, por Marrëveshja e Dejtonit nuk bëri asgjë për ta”.⁷ Sipas saj, motoja e NATO-s ishte: “Serbët jashtë, NATO-ja brenda, refugjatët në shtëpi”.⁸

⁴ W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, Tiranë, 1996, f. 230-231.

⁵ Shih më gjerë kontributet shkencore në botimin: *Les Balkans après la bataille (Sous la direction de Jacques Rupnik)*, Espace international, Éditions Complexe, Paris, 1996, pp. 1-169; shih gjithashtu: P. Garde, *Les Balkans*, Dominos, Flammarion, Paris, 1999.

⁶ J. Fischer, *Vitet kuq-gjelbër. Politika e jashtme gjermane – nga Kosova e deri më 11 shtator*, Koha, Prishtinë, 2008, ff. 99-100.

⁷ *Zonja Sekretare (Autobiografi) Madeleine Albright*, (Përkthim nga anglishtja), Botimet Dudaj, Tiranë, 2004, f. 443.

⁸ Po aty, f. 479. Shih më gjerë faqet 441-497.

2. Spekulumet serbe rreth migrameve të popullsisë

Në gjithë Jugosllavinë komuniste, në periudhën 1945-1990 ndodhën lëvizje masive hapësinore dhe sociale të popullsisë në drejtime të ndryshme dhe nga të gjitha tipat e vendbanimeve. Në këtë periudhë u intensifikuan edhe migrimet e bashkësive të ndryshme kombëtare drejt qendrave të republikave dhe krahinave të atëhershme, ku ishin të përqendruara funksione të ndryshme. U krijuan bërthamat dhe territoret e centraliteteve kombëtare ose drejt “amave” kombëtare: *serbët* nga të gjitha territoret, para së gjithash nga BeH, Kroacia dhe Kosova shkonin në drejtim të Serbisë e të kryeqendrës së saj Beogradit dhe Vojvodinës e të kryeqendrës Novi Sadit; *kroatët* nga BeH dhe Serbia në drejtim të Kroacisë e të kryeqendrës Zagrebit; *myslimanët* nga Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia shkonin drejt BeH e të kryeqendrës së saj Sarajevës; *shqiptarët* nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës në drejtim të Kosovës dhe kryeqendrës së saj Prishtinës.

Popullsia e nacionaliteteve të mëdha ishte e orientuar nga metro-polet që ishin territorialisht afër, me gjuhë, konfesion, kulturë dhe veçori të afërta etnike dhe veçanërisht nëse territori apo qendra imigruese ofronte kushte më të mira jetësore.⁹ Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1981, më shumë se 9 milionë banorë e ndërruan vendin e lindjes, që përbënin 41,0% të popullsisë së gjithmbarshme të ish-Jugosllavisë, ndërsa kufijtë e ish-republikave dhe krahinave i kanë kaluar afër 2 milionë banorë, kryesisht pjesëtarë të atyre bashkësive etnike të cilët “amat” e tyre kombëtare i kishin në rajonet e tjera. Në Serbi kishin ardhur 637.399 banorë serbë nga territoret e tjera (nga Vojvodina 144.075 ose 22,6%, nga BeH 111.828 ose 17,3%, nga Kroacia 110.704 ose 17,3%, nga Kosova 110.675 ose 17,3%, nga Maqedonia 50.011 ose 7,8%, dhe nga Mali i Zi 42.755 ose 6,7%).¹⁰ Megjithatë, problem u bë vetëm shpërngulja e serbëve dhe malazezëve nga Kosova në Serbi, një shifër që e çonin deri në 400.000 veta, ndonëse në regjistrimin zyrtar të vitit 1991 ishin evidentuar 194.190 serbë rezidentë në Kosovë.¹¹

⁹ *Migracije stanovništva Jugoslavije*, Centar za demografska istraživanja, Institut društvenih nauka, Beograd, 1971; *The Population of Yugoslavia*, The Demographic Research Center, Institute of Social Sciences, Belgrade, 1974.

¹⁰ Burimi: materialet e regjistrimit të popullsisë të vitit 1981; i përpunoi autori.

¹¹ Burimi: *Popis stanovništva, domaćinstava i stanova u 1981. godini. Nacionalni sastav stanovništva po opštinama, Statistički bilten 1295*, Savezni zavod za statistiku, Beograd, 1982, f. 16; *Stanovništvo i domaćinstva SR Jugoslavije prema*

Në kuadër të fushatës së gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve pas vitit 1981 diskursi rreth migrameve në Kosovë dhe rreth saj mjerisht zhvillohej në mungesë të plotë të gjykimit racional, me një qasje joshkencore dhe shoviniste. I tërë diskursi rreth migrameve etnike përqendrohej në migrimet e serbëve dhe malazezëve, të cilët kinse ndiqeshin nga shqiptarët, ndërkaq migrimet dhe problemet jetësore të shqiptarëve plotësisht injoroheshin. Akuzat që ndaj shqiptarëve përsëriteshin si refren në jetën e përditshme, ishin shpifje shumë të rënda për popullin shqiptar, sepse ai synohej të paraqitej si komunitet gjenetiki i prirë për vepra antisociale dhe keqbërje, por fatmirësisht ato shqiptoheshin pa asnjë argument. Shqiptarët tashmë ishin shpallur fajtorë kujdestarë për gjithçka dhe komb i dyshimtë në ish-Jugosllavi, natyrisht përveç “shqiptarëve të ndershëm” dhe “me orientim jugosllav”.

Kulmi i spekulimeve është vlerësimi i Akademisë Serbe (SANU) në Memorandumin famëkeq të vitit 1986, ku thuhet: “Shpërngulja e serbëve nga Kosova dhe Metohia në Jugosllavinë Socialiste për nga vëllimi dhe karakteri i kapërcen të gjitha etapat e mëhershme të kësaj ndjekjeje të madhe të popullit serb. Jovan Cvijiqi, në kohën e tij, ka vlerësuar se në të gjitha dyndjet, prej asaj të madhes nën Arsenije Çernojeviqin në vitin 1690 e deri në vitet e para të shekullit tonë, janë përzënë më shumë se 500.000 serbë; nga ky numër midis viteve 1876 dhe 1912 rreth 150.000 serbë janë detyruar t'i braktisin vatrat e tyre nën terrorin e egër të bashibozukëve shqiptarë, lokalë dhe të privilegjuar. Gjatë luftës së fundit (Lufta II Botërore-H.I.) janë përzënë më tepër se 60.000 serbë, kolonistë dhe autoktonë, por pas luftës kjo valë e shpërnguljes ka përjetuar një baticë të vërtetë: në njëzet vitet e fundit Kosovën dhe Metohinë e kanë braktisur rreth 200.000 serbë. Pjesa e mbetur e popullit serb jo vetëm që vazhdimisht dhe me tempo të pandalur po e braktis vendin e vet, por, sipas të gjitha njohurive, e ndjekur përmes zullumeve dhe terrorit fizik, moral dhe psikik, përgatitet për eksodin përfundimtar. Për më pak se 10 vite të ardhshme, në qoftë se gjërat nuk ndryshojnë esencialisht, serbë më në Kosovë nuk do të ketë, ndërsa Kosova “etnikisht e pastër”, ky qëllim pa mëdyshje i manifestuar i racistëve shqiptaromëdhenj, i futur qysh në programet dhe aksionet e Lidhjes së Prizrenit 1878-1881, do të realizohet plotësisht”.¹²

Udhëheqja e paarsimuar dhe karrieriste e Kosovës, duke mos e ditur prapavijën politike të kësaj teze dhe duke mos e njohur karakterin

popisu 1991, Stanovništvo 47, Savezni zavod za statistiku, Centar za demografska istraživanja Instituta društvenih nauka, Beograd, 1995, f. 213.

¹² *Memorandum SANU, Beograd, 1986.*

e ndërlikuar të procesit të migrimeve, që në fillim, shumë lehtë, e pranoi vlerësimin e Serbisë se derisa të shpërngulej vetëm edhe një serb apo malazias nga Kosova, situata politike në Kosovë nuk mund të konsiderohej stabile! Arsytimi ishte një floskulë politike. Faktori kryesor i migrimeve ishte moszhvillimi ekonomik dhe shoqëror i Kosovës. Deri vonë pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë nuk është investuar në kapacitetet përpunuese dhe në degët intensive-punuese, që janë joshëse për rritjen e normës së punësimit të të dy gjinive. Ndonëse të gjitha synimet e zhvillimit ekonomik ishin të orientuara në zhvillimin e bujqësisë, megjithatë edhe kjo degë me gjithë kushtet e volitshme nuk u transformua; mbeti ekstensive, natyrale dhe autarkike. Me gjithë përpjekjet dhe të arriturat në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe veçanërisht të ngritjes së objekteve industriale dhe të infrastrukturës në vitet 70, që lidhej me avancimin e statusit të saj politiko-konstitucional në ish-Federatën Jugosllave, Kosova deri në shkatërrimin e ish-Jugosllavisë mbeti edhe në pikëpamje absolute edhe relative territori më i pazhvilluar dhe dallimet midis saj dhe rajoneve të tjera gjithnjë shtoheshin. P. sh. nga gjysma e viteve 80 ajo ishte gjashtë herë më pak e zhvilluar se Sllovenia, katër herë më pak e zhvilluar se Kroacia e Vojvodina, tri herë më pak se Serbia dhe mesatarja e ish-Jugosllavisë dhe dy herë më pak e zhvilluar se ish-republikat e tjera jo mjaft të zhvilluara (BeH, Mali i Zi dhe Maqedonia).

Janë tri probleme të mëdha që e karakterizuan zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës deri në përfundim të shek. XX: struktura jo e volitshme e ekonomisë, aftësia e dobët akumuluese dhe papunësia.¹³ Në vitet 80 e 90' të këtij shekulli Kosova u shndërrua në koloni dhe zonë të okupimit klasik serb. Nga mungesa e industrializimit dhe struktura kryesisht agrare e Kosovës, deri vonë pas Luftës së Dytë Botërore rezultoi një tip jo i volitshëm i strukturës ekonomike të popullsisë aktive, me dominim të sektorit primar, që u reflektua edhe në veçoritë e tjera të popullsisë dhe në rrjedhat e urbanizimit. Pasqyra e tipit të strukturës ekonomike midis Kosovës dhe territoreve të ish-Jugosllavisë tregon një dallim të madh. Sllovenia p. sh. kishte arritur ta reduktonte përqindjen e popullsisë bujqësore në rreth 20% në vitin 1971 (Kosova 51,1%) dhe në më pak se 10% në vitin 1981 (Kosova 24.6%). Niveli i kësaj popullsie në Slloveni ishte më i ulët më 1948 (46,7%) se sa në Kosovë në vitin 1971. Sllovenia kishte arritur tipin më të volitshëm të strukturës ekonomike në ish-Jugosllavi, me rënie të konsiderueshme të

¹³ N. Bashota, "Osnovni problemi privrede Kosova", Časopis *Pogledi*, (numër tematik: *Kosovo danas i sutra*), No. 2, Split, 1988, pp. 405-418.

sektorit primar dhe me rritje të ndjeshme të sektorit sekondar dhe terciaro-kuartar dhe pas saj vinin Kroacia e të tjerat, ndërsa Kosova mbeti në fund të shkallës ekonomike, me dominimin e sektorit primar në vitet 1961-1971 dhe me rritje të ndjeshme të numrit absolut të popullsisë agrare si fenomen më i pavolitshëm në procesin e zhvillimit ekonomik (tepricat agrare). Në vitin 1970 p. sh. brutoprodhimi kombëtar për kokë banori në Slloveni ishte 1.550 \$, ndërsa në Kosovë pesë herë më i ulët ose rreth 300 \$ (ish-Jugosllavia 860 \$).

Te serbët e Kosovës, ishte një situatë tjetër. Përveç Beogradit dhe qyteteve të tjera të mëdha, Serbia kishte edhe disa qendra të tjera ekonomike, urbane e kulturore në jug të saj, sikurse Vranja, Leskovci, Kurshumlia, Prokupla, Aleksinci, Krushevc, Kraleva, Çaçaku, Uzhica etj. Duke marrë parasysh afërsinë e tyre, në kuadër të migrimeve intensive fshat-qytet, popullata serbe e Kosovës kur vendoste ta braktiste fshatin shpërngulej drejtpërdrejt në këto qytete, ndërsa vetëm një numër i vogël vinte në qytetet e Kosovës. Identike ishte situata edhe me shqiptarët, të cilët, duke i braktisur fshatrat dhe qendrat urbane të Luginës së Preshevës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi drejtpërdrejt vinin në qytetet e mëdha të Kosovës, veçanërisht në Prishtinë. Fshatarët-bujqit serbë, me shitjen e pasurisë me çmime shumë të larta në Kosovë, blinin tokë, shtëpi, objekte ekonomike dhe mjete të punës në rajonet bujqësore, kryesisht rreth qyteteve me çmime shumëfish më të ulëta në raport me ato të shitjes, për çka edhe u mbeteshin mjete të bollshme për kursim. Serbët të cilët kishin mënyrë më të gjatë të jetës urbane në Kosovë, sipas rregullit, vendoseshin në qendrat e mëdha në Serbi, para së gjithash në Beograd dhe në rrethinën e tij, ku u ofronin kushte shumë më të volitshme dhe më cilësore të jetës e të punës. P. sh., sipas regjistrimit të vitit 1981, rreth 38% të popullsisë së shpërngulur nga Kosova janë ngulitur në rajonin e Beogradit.

Asnjë e dhënë nuk fliste në të mirë të tezës se serbët dhe malazezët në vitet 70 e 80 të shekullit të kaluar ishin të diskriminuar, ndërsa shqiptarët si shumicë e popullsisë të privilegjuar. Numri absolut i serbëve të punësuar në sektorin shoqëror ishte në rritje të vazhdueshme në këtë periudhë: në vitin 1970 32.739, më 1980 45.183 dhe në vitin 1986, në kohën e histerisë antishqiptare, 48.429 (në periudhën 1970-1986 punësimi i tyre kishte shënuar rritje për 47,9%). Sipas regjistrimit të vitit 1971 norma e punësimit ishte te malazezët 22,7, te serbët 14,3, te shqiptarët 5,8 dhe te turqit 5,0 (mesatarja kosovare 7,8), ndërsa në vitin 1981 kjo normë rritet te të gjithë, por shumë më e lartë ishte te malazezët (27,5) dhe serbët (21,5) sesa te shqiptarët (9,3) dhe turqit

(17,9). Ose, në vitin 1971, në sektorin shoqëror ishte i punësuar çdo i katërti malazias, çdo i shtati serb, çdo i nënti turk dhe çdo i shtatëmbëdhjeti shqiptar (mesatarja e Kosovës 8,9). Serbët dhe malazezët më tepër ishin të punësuar në administratë, në drejtorate, në banka, në kontabilitet, në mbrojtjen sociale e shëndetësore, në ish-BVI-të, pastaj si persona udhëheqës, në tregti, komunikacion, hotelieri dhe në veprimtaritë sekondare, ndërsa shqiptarët më tepër në veprimtaritë e sektorit primar (profesionet bujqësore) dhe në kurbet (ish-Jugosllavia dhe bota e jashtme).

Serbët dhe malazezët kishin shkallë më të lartë të urbanizimit dhe normë më të ulët të ruralitetit në Kosovë. Sipas regjistrimit të vitit 1961 në qytete jetonin 36,3% të malazezëve dhe 20,3% të serbëve, ndërsa në vitin 1981 këto përqindje rriten te malazezët në 70,0% dhe te serbët në 38,1%. Shqiptarët, përkundrazi, kishin shkallë më të ulët të urbanizimit dhe më të lartë të ruralitetit në Kosovë: në vitin 1961 16,7% dhe më 1981 28,9% e tyre jetonte në qytet (mesatarja kosovare 19,7% dhe 24,4%). Serbët dhe malazezët ishin të koncentruar në bërthamat e qendrave urbane, kryesisht në banesa shtetërore (mënyra urbane e jetës), kurse shqiptarët në periferitë e qyteteve dhe kryesisht në shtëpi private, shpeshherë pa elemente të sistemeve urbane (mënyra rurale e jetës). Sipas regjistrimit të vitit 1981, nga numri i përgjithshëm i banesave në pronësinë shoqërore në Prishtinë (8.075 banesa, që përbënte 1/3 e fondit të Kosovës), 41,0% u takonte shqiptarëve (ndaj 70,1% në popullsinë e qytetit), 38,0% serbëve (ndaj 15,6% në popullsi), 11,0% malazezëve (ndaj 3,8% në popullsi), 3,0% myslimanëve (ndaj 2,3% në popullsi), 2,0% turqve (ndaj 1,7% në popullsi) dhe 1,0% romëve (ndaj 1,4% në popullsi). Banesa shoqërore më tepër kishin malazezët (84,7% e tyre), “jugosllavët” (82,7%), serbët (70,3%) dhe myslimanët (60,5% të tyre), ndërsa më pak shqiptarët (26,9%) dhe turqit (35,9%).¹⁴

Për arsye të përmendura vlerësohet se prej vitit 1966-1981 nga Kosova janë shpërngulur drejtpërdrejt rreth 60.000 veta të të gjitha bashkësive etnike, ndërsa nga evidentimi i posaçëm prej vitit 1981-1988 Kosovën e kanë braktisur rreth 20.000 serbë; pjesa dërmuese e të shpërngulurve u ngulit në Serbi, kryesisht në zonën urbane të Beogradit (rreth 40%) dhe të qyteteve të tjera të mëdha e të mesme, që ofronin kushte shumë më të mira të jetës e të punës. Por për krejt këtë periudhë, edhe pse saldoja e migrimeve është negative, kishte edhe ardhje të

¹⁴ *Sociološka studija grada Prištine*, Ekonomski institut, Priština, 1986, ff. 40-41.

serbëve brenda migrimeve të martesave dhe stimulimit të rikolonizimit të Kosovës pas vitit 1981.

Pas rrënimit të sistemit kushtetues dhe mekanizmave të autonomitetit të Kosovës me dhunë, me tanke në mars të vitit 1989 nuk përmenden më “presionet” dhe “gjenocidi” shqiptar kundër serbomalazezëve me qëllim të ndjekjes së tyre nga Kosova (dhunimet, rrënimi i varrezave, zjarret, sulmet fizike, dëmet në fushë etj.). Pos konflikteve, që ishin të rëndomta në jetën e përbashkët, të ngarkuar me probleme socio-ekonomike, këto vepra as që ishin kryer ndonjëherë. “Presioni” i shqiptarëve ndaj serbëve e malazezëve ishte një shpifje e rëndë dhe mbi këtë konstruksion u krijua një klimë dhe strategji antishqiptare jo vetëm në Serbi, por në tërë ish-Jugosllavinë. Por kur strategjia “e presioneve” kundër serbëve pas Kosovës nisi të bartej në territorin e BeH, të Kroacisë dhe në viset e tjera, sipas nevojës së qëllimeve politike të Serbisë, çfarë ishte rasti me Kninin, Lubjanën, Stara Pazovën etj., atëherë politika serbe doli e zhveshur para opinionit jugosllav. Pushteti serb tash shpërnguljen e serbëve dhe të malazezëve nuk e problematizonte, sepse shqiptarët më nuk mund t'i fajësonte para botës dhe opinionit serb. Po ta pranonte faktin e shpërnguljes së serbëve pas aneksimit dhe okupimit të plotë të Kosovës, ky pushtet publikisht do ta pranonte politikën e tij të dështuar në Kosovë.

3. Maqedonia si model për ndjekjen dhe shpërnguljen e shqiptarëve

Serbia përmes ish-Federatës Jugosllave donte ta përdorte Maqedoninë si territor provues jo vetëm për ta kufizuar rritjen demografike të shqiptarëve, por edhe për ta reduktuar shkollimin shqip dhe perspektivën e përgjithshme të shqiptarëve në Kosovë. Menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë në vijën antishqiptare ishte krijuar blloku serbo-malazezo-maqedon, kurse pas gjysmës së këtyre viteve në këtë front ishin inkuadruar edhe boshnjakët, kroatët dhe sllovenët. Maqedonia sikur shihte frikë edhe më të madhe nga numri i shqiptarëve dhe dinamika e tyre natyrore demografike. Numri zyrtar i shqiptarëve në vitin 1981 në Maqedoni ishte 377.726 ose 19,8% në popullsinë e përgjithshme (në punësim merrnin pjesë vetëm me 6,7%).

Nën parullën kinse të nacionalizmit agresiv shqiptar, pushteti maqedon e theksonte vazhdimisht problemin e natalitetit të shqiptarëve dhe ardhjen e tyre “masive” nga Kosova në territorin e saj. E ndaloi

rreptësisht ardhjen e shqiptarëve nga Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare, ndërsa ndaj popullatës shqiptare në Maqedoni ndërmori një varg masash në reduktimin e të drejtave në lëmin e shkollimit e të komunikimit publik në gjuhën shqipe, në kufizimet në punësim, në shtesa të fëmijëve, në mbrojtje shëndetësore të fëmijëve “tepricë” etj. Ky pushtet nxori edhe ligjin për kufizimin e ardhjes të shqiptarëve në vendbanimet e Maqedonisë, ku përsëri, sikurse edhe te nataliteti, filloi nga Tetova.¹⁵ Ai frikësohej se nga shtimi mekanik (imigrimi) dhe shtimi natyror shqiptarët kinse do ta krijojnë “Kosovën e Dytë në Maqedoni, “Shqipërinë e Dytë” në Maqedoni dhe “Shqipërinë e Madhe”. Teza për “vërshimin” e shqiptarëve nga Kosova në Maqedoni shfrytëzohej si sulm i paparë kundër shqiptarëve të atjeshëm. Çdo kërkesë elementare njerëzore dhe kushtetuese e shqiptarëve nga politika zyrtare maqedonase dhe jugosllave kualifikohej si kërkesë “kundërrevolucionare”.

Kualifikimi i demonstratave të vitit 1981 si “kundërrevolucionare” ishte për atë kohë akuza më e rëndë për Kosovën dhe shqiptarët. Llatinka Peroviç theksonte se “Klasa politike jugosllave ra në provim në Kosovë. Nga presioni i një pjese të kreut politik jugosllav (si Lllazar Mojsov, kuadër nga Maqedonia, Raif Dizdareviq nga BeH, etj. - H. I.), por edhe të atij serb, edhe udhëheqja e Kosovës e pranoi, ndoshta me gjysmëzëri, por e pranoi fatkeqësisht, vlerësimin se demonstratat ishin kundërrevolucionare”!¹⁶ Pastaj pasoi gjithçka shkatërrimtare për Kosovën dhe shqiptarët në gjithë ish-Jugosllavinë.

Teza për “vërshimin” e shqiptarëve nga Kosova në Maqedoni shfrytëzohej si sulm i paparë kundër shqiptarëve të atjeshëm. Sa e sa herë është folur e shkruar pas vitit 1981 për tezën e rrejshme se vetëm në komunën e Tetovës në vitet e fundit nga Kosova kanë ardhur më tepër se 15.000 shqiptarë, ndonëse sipas regjistrimit zyrtar të vitit 1981 në tërë territorin e Maqedonisë nga Kosova kishin ardhur 21.245 veta

¹⁵ S. Drakulić, “Natalitet i represija”, *Danas*, br. 310, 26. siječnja 1988, Zagreb, f. 30.

¹⁶ Llatinka Peroviç vdiq në dhjetor të vitit 2022. Ishte politikane dhe historiane e njohur në Serbi dhe ish-Jugosllavi. Në vitet 1968-1972 ishte sekretare e Komitetit Qendror të LK të Serbisë. Në Etablissementin partiak dhe politik të Serbisë ishin tre ish-ambasadore dhe ministra të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, të shkolluar në Perëndim: Mirko Tepavac (ministër në këto vite), Marko Nikeziq Kryetar i Komitetit Qendror të LK të Serbisë, ambasador i Jugosllavisë në shumë vende, përfshirë SHBA, dhe Koça Popoviç, ambasador gjithashtu në shumë vende (dhe në ShBA) dhe ministër i Punëve të Jashtme. Të gjithë ishin properëndimorë dhe antirus. Të njohur si përfaqësues të rrymës liberale, kërkonin decentralizimin e pushtetit në Jugosllavi, zgjedhje të lira dhe rrjedhimisht heqjen e Titos, por dolën humbës dhe Titoja i hoqi ata.

në të gjitha periudhat (nga viti 1941 e më herët), ndërkaq ardhja më e madhe ishte shënuar në periudhën 1946-1970 (dominionin migrimet e martesave dhe motivi i punësimit), ndërsa sipas të dhënave të lajmërim-çlajmërimit, prej 1. 6.1983 deri më 31. 12. 1988 nga Kosova në Maqedoni kanë ardhur gjithsej 1.154 persona. Është e vërtetë se Maqedonia ishte “atraktive” për shqiptarët në vitet 50’ e 60’ të shekullit të kaluar, kur rridhte intensivisht shpërngulja për në Turqi, ku territor etapor ishte kjo republikë, përkatësisht kryeqyteti i saj Shkupi. Këtu ndërrohej përkatësia kombëtare në atë turke dhe këtu merreshin pasaportat dhe vizat (visikat). Për këto qëllime funksiononin shërbimet speciale ditën dhe natën, të cilat përgatitnin dokumentet e shpërnguljes. Për këto çështje do të bëhet fjalë te migrimet e jashtme dhe formimi i diasporës.

Numri i saktë i të ardhurve nga Kosova dhe nga viset e tjera në Maqedoni nuk dihet, sikundër që, siç theksuam, nuk dihet as numri i saktë i të shpërngulurve shqiptarë në Turqi, ngase këto të dhëna ishin fshehtësi shtetërore. Në rrethanat kur në mënyrë ekspansive shtoheshin përpjekjet për reduktimin e të drejtave të shqiptarëve dhe represionin e madh ndaj tyre në Maqedoni (burgosjet, përjashtimet e arsimitarëve nga puna, mbyllja e shkollave, rrënimi i mureve,¹⁷ ndjekja e zejtarëve privatë etj.) ishte krejtësisht e qartë se kjo republikë nuk mund të ishte atraktive për imigrantë shqiptarë nga Kosova dhe rajonet e tjera. Qëllimi i pushtetit maqedon, sikurse edhe i pushtetit serbo-jugosllav ishte që të krijohet klima e mosdurimit dhe ata të merrnin rrugën e braktisjes së vendit të tyre. Zinxhiri i shpërnguljes për në Turqi sikur pëlçiti para Plenumit IV të Brionëve (1.07.1966), kur u mënjanua nga pushteti policor e komunist A. Rankoviçi. “Para botës, Jugosllavia socialiste nuk mundi më të angazhohej për interesa ekstreme serbe, çfarë është ringjallja e Kosovës serbe”!¹⁸

Pas konfliktit të vitit 2001, për t’i fashitur tensionet ndëretnike dhe për ta përmirësuar pozitën e gjithmbarshme të shqiptarëve, në vitin 2004 u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit, nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, përmes së cilës duhej të realizoheshin të drejtat qytetare dhe kombëtare të shqiptarëve. Shumë dispozita të kësaj marrëveshjeje ende

¹⁷ Rrënimi i mureve të shqiptarëve ishte pjesë e elaboratit të V. Çubrilloviçit të vitit 1937. Ajo që mbeti pa u realizuar atëherë, pushteti komunist maqedon nisi ta realizojë pas vitit 1981. Fushata u ndal pas një incidenti në fshatin Haraçinë i cili përfundoi me një shqiptar të mbytur nga muri i rrënuar; masa e tubuar e mori arkivolin dhe u nis në këmbë për në Shkup para Kuvendit të Maqedonisë, ku e ekspozoi arkivolin.

¹⁸ Sh. Maliqi, “Nacionalizmima treba vaditi kvadratni koren”, *Thema*, nr. 7, Prishtinë, 1986, f. 44.

nuk janë zbatuar. Lufta politike e shqiptarëve për pozitën e tyre, përshtirë atë konstitutive, vazhdon. Që nga paraqitja e pluralizmit politik në ish-Jugosllavi edhe shqiptarët e Maqedonisë formuan partitë politike rreth të cilave u tubuan dhe i artikuluan kërkesat e tyre për barazi në të gjitha rrafshet. Që nga viti 1991, kur u formua shteti maqedonas, gjithnjë participuan në jetën institucionale, në Parlament dhe në Qeveri; të paktën një parti shqiptare gjithnjë ishte pjesëmarrëse në Qeveri. Por shteti maqedonas edhe në vitet 90 u soll keq me shqiptarët. Njëri nga antishqiptarët e përbetuar për shumë dekada, funksionari i lartë maqedonas, Stojan Andov, në një intervistë tash së fundi, deklaroi: “Për fat të keq, në vitin 1991 nën ndikimin e regjimit të trashëguar të Miloševiçit në Serbi, ne në Maqedoni nuk arritëm të mbledhim forcë që t’i kundërvihemi asaj propagande dhe për këtë shkak bëmë disa gabime, veçanërisht ndaj qytetarëve tanë shqiptarë” dhe “po të merreshim vesh me shqiptarët do të evitohej edhe konflikti i armatosur në vitin 2001. Gabimi i parë ishte që nuk u dakorduam me shqiptarët sesi si të quhej çështja e referendumit dhe ajo procedurë për ne maqedonasit na bën të marrim një përgjegjësi të madhe që shqiptarët nuk dolën në referendum në vitin 1991. Kjo çoi edhe te fakti se deputetët shqiptarë në Kuvend të mos votojnë për Kushtetutën e parë për Maqedoninë e pavarur”.¹⁹

4. Privilegjet serbe shtriheshin në tre nivele (kosovare, serbe dhe jugosllave)

Pas demonstratave masive të shqiptarëve në vitin 1981 pushteti serbo-jugosllav nisi të zbatojë programe konkrete zhvillimore vetëm për ato mjedise në Kosovë ku jetonin serbo-malazezët, ndërsa prej vitit 1987 formoi disa komuna të reja ku ose dominonin serbo-malazezët ose përbënin deri 50% në popullsinë e gjithmbarshme (Zubin Potoku, Zveçani, Fushë-Kosova, Shtimja, Shtërpca, Obiliqi, Novobërda, Graçanica), në të cilat menjëherë nisi ngritja e disa reparteve industriale dhe të infrastrukturës, ndërsa në komunën e Malishevës, si komunë e vetme e re që banohej nga shqiptarët, prej themelimit në vitin 1985 nuk ishte ngritur asnjë objekt industrial e infrastrukturor. Kështu vargoheshin monumentet segregacioniste, me pasoja të shumëfishta ekonomike e politike. Serbo-malazezët gëzonin privilegje nga tre nivele: kosovare, serbe dhe jugosllave, ndërsa shqiptarët përjetonin një brutalitet nga këto tre nivele, sikundër që përdhosej kultura dhe historia e tyre.

¹⁹ Intervista *tesheshi.com*, 8 nëntor 2015 (intervistoi Mensur Krasniqi).

Organet e shtetit partiak e policor ndërsenin nacionalizmin serb dhe askush nuk brengosej në shoqërinë jugosllave, as udhëheqja e Kosovës për emigrimin pa kthim të shqiptarëve nga Maqedonia, Mali i Zi dhe nga Kosova në SHBA dhe në vendet e zhvilluara të Evropës e as për ardhjen e tyre nga viset e tjera në Kosovë për shkak të sjelljeve brutale dhe reduktimit të arsimit në gjuhën shqipe të shqiptarëve nga viset e tjera, sikundër që askush nuk u dënua më asnjë ditë burg për ndjekjen e shqiptarëve në Serbi, thyerjes së dyqaneve të tyre (267 raste në periudhën 1984-1987), bojkotimin e shërbimeve, madje edhe vrasjen e tyre. Sipas të dhënave të Shoqatës për Popujt e Rrezikuar (Gesellschaft für Bedrohte Völker) në Göttingen (RF e Gjermanisë), vetëm deri në fund të viteve 80, për shkaqe ekonomike dhe politike, rreth 250.000 shqiptarë i kishin braktisur territoret e tyre në ish-Jugosllavi dhe ishin vendosur rreth 100.000 në Gjermaninë Federale, rreth 60.000 në Zvicër, rreth 40.000 në vendet e tjera perëndimore dhe rreth 50.000 në viset veriore të ish-Jugosllavisë.²⁰ Me dhjeta mijëra shqiptarë kërkonin azil politik në vendet perëndimore, ndërsa flitej e planifikohej debimi i qindra-mijëra shqiptarëve nga Kosova, kinse të ardhur nga Shqipëria etj.

Edhe Lidhja Socialiste e Kosovës ishte inkuadruar në ndjekjen e shqiptarëve. Ajo kërkonte që edhe për veprime të paverifikuara dhe pseudovepra, si dhe për konflikte të rëndomta në jetën e përditshme midis serbo-malazezëve dhe shqiptarëve. Këta të fundit të ndeshkeshin me norma të dyfishta: me ligje pozitive në fuqi dhe me norma negative zakonore, çfarë ishte p. sh. lëçitja. Profesori i Fakultetit të Drejtësisë, akademik Syrja Pupovci, i cili më parë si studiues i normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit ishte ngritur kundër aplikimit të normave dhe vetëdijes patriarkalo-feudale, në vitin 1986, në kohën e histerisë antishqiptare, me këmbëngulje kërkonte zbatimin e tyre ndaj shqiptarëve, madje, siç thoshte ai, “në mënyrë shembullore”,²¹ sikurse në mesjetë. Pupovci e dinte shumë mirë se lëçitjen si normë ndëshkimore të së drejtës zakonore të shqiptarëve, në fshatrat e Kosovës gjatë LNÇ-së, në luftë kundër partizanëve, e kishte zbatuar okupatori fashist, ku

²⁰ Këto të dhëna i kishte kumtuar Amnesty International (Londër), ndërsa i kishin botuar gazetat më të mëdha, si Frankfurter Allgemeine (Frankfurt), Corriere della Sera (Milano), Le Monde (Paris) etj. në vjeshtë e vitit 1988.

²¹ S. Pupovci, “Si të luftohen dukuritë dhe sjelljet devijonte në Kosovë”, *Rilindja*, 13. 12. 1986. Lidhur me këtë shih vështrimin kritik: H. Islami, “Albansko običajno pravo in socialističke norme (Ob zahtevi akademika Pupovcija po uveljavanju običajnih norm Zakonika Leke Dukagjinijsa danes), Časopis za kritiko znanosti, št. 103/104, Ljubljana, 1987, pp. 36-45.

familjet shqiptare, që kishin partizanë, lëçiteshin me dhunë nga farefisi, fqinjët dhe fshati. Ishte e pabesueshme sesa ishte diskrepanca e madhe në zbatimin e ligjeve ndaj shqiptarëve dhe ndaj të tjerëve për të njëjtat vepra. Për shqiptarët, p. sh. më se 10 herë shqiptoheshin dënime më të rënda sesa për serbët e malazezët: i mituri shqiptar nga fshati Plemetin afër Prishtinës për tentim dhunimi ndaj një të miture të kombësisë serbe (të kurdisur) u dënua me 10 vjet burg, ndërsa serbi i moshës madhore nga Staro Sello për dhunimin e një të miture shqiptare u dënua me vetëm një vit burg etj.²²

Në vazhden e ndjekjes së shqiptarëve duhet zënë në gojë inskenimet dhe shpifjet e përditshme të veprave keqbërëse të shqiptarëve ndaj serbëve, siç janë dhunimet, rrënimi i varrezave etj., për të cilat udhëheqësit e atëhershëm kosovarë nuk merrnin guximin të thoshin publikisht se janë gënjeshtër, madje, në disa raste, me përkrahjen pa rezervë që i jepnin, edhe vetë u prinin gënjeshtërve të tilla. Kështu, deri në shtator të vitit 1988, sipas përgjegjësve të organeve të Kosovës, u shpifën 12 raste të dhunimit të femrave serbo-malazeze nga ana e shqiptarëve, mbi të cilat ishte ngritur një strategji e tërë antishqiptare.²³ Çdo kriminaliteti, madje edhe në ekonomi, i jepej vula nacionale apo nacionaliste, dhe sipas skenarit të përgatitur më parë, fajtori *apriori* dihej – shqiptari! Kurrë nuk u organizuan biseda me mjekë, gjyqtarë, psikologë dhe me “dhunues” e “të dhunuara” që të sqarohej dhunimi si akt, si vepër penale dhe antinjerëzore.²⁴ Gjithashtu, kurrë nuk u dha emri i ndonjë shqiptari që “rrënoi” varrezat ortodokse serbe, sikundër

²² H. Islami, “Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje”, në botimin *Kosovo-Srbija-Jugoslavija*, Knjižna zbirka, KRT, Ljubljana, 1989, f. 66.

²³ “Rilindja”, 12.11.1988.

²⁴ Shqiptarët akuzoheshin edhe për raste perverse, çfarë ishte rasti Martinović, kur ky serb i sëmurë nga Gjilani, në maj të vitit 1985 në arën e tij, për motive vetëkënaqësie (perverse), kishte futur një shishe në prapanicë! Për këtë rast, të kualifikuar edhe si “gjenocid fizik” i shqiptarëve ndaj serbëve, u shkrua edhe një libër prej qindra faqesh. Shih: S. Stanojević, *Slučaj Martinović*, Beograd, 1986, ff. 1-485.

Edhe Akademia Serbe (SANU) në Memorandumin e saj e politizoi këtë rast deri në ekstrem për ta akuzuar pozitën kushtetuese-juridike të Kosovës, duke nënvizuar: “Rasti i Martinoviçit është i rëndësishëm jo vetëm për shkak të dhunës së veçantë, të paparë, që të përkujton kohët më të errëta turke të nguljes në hu, por edhe për shkak të refuzimit energjik që në procedurën e rregullt gjyqësore të vërtetohet dhe pranohet e vërteta. Në vend që të jetë shkas për të dëshmuar vlerat supreme të ligjit dhe të drejtave të njeriut, ky rast në Kosovë është kuptuar si rrethanë që të theksohet sovraniteti i Krahinës, të cilin ajo as sipas Kushtetutës nuk e ka, dhe, në anën tjetër, që RS të Serbisë t’i imponohet parimi “i mospërzierjes në punët e brendshme” të Krahinës, sikurse të jetë fjala për raportin ndërshtetëror, ndërkombëtar” (*Memorandum SANU*, Beograd, 1986).

që asnjë organizate ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut nuk iu ofruan të dhënat dhe faktet konkrete, siç janë emri i kryerësit të veprës, vendi, lloji i veprës etj., për shkeljen e të drejtave të serbëve nga ana e shqiptarëve me qëllim që të shpërnguleshin nga Kosova, edhe pse ato i kërkonin që nga viti 1981. Prof. Branko Horvat, autor i librit të njohur për çështjen e Kosovës (“Kosovsko pitanje”),²⁵ kërkonte të dhëna dhe sqarime për këto vepra, sesa janë etnikisht të inspiruara, por nuk erdhi deri tek ato, ngase kurrë nuk u bënë publike.²⁶

Nën parullën e stabilizimit të gjendjes në Kosovë dhe parandalimin e shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga “presionet” e shqiptarëve, u nxorën ligje speciale në Kosovë dhe atë pa pëlqimin e Kosovës e të shqiptarëve, si p.sh. ligji për gjuhën, përdorimin dhe formën e flamurit, shitblerjen, izolimin, shkollat dhe Universitetin, pensionimin e dhunshëm të arsimtarëve, kthimin e kolonëve e shumë ligje të tjera, me të cilat reduktoheshin të drejtat e shqiptarëve dhe shtoheshin represioni ndaj tyre.

Zbatimi i masave represive dhe okupimi policor e ushtarak në fund të viteve 80 arritën kulminacionin: qindra mijëra shqiptarë kaluan nëpër duar të policisë, qindra të vranë e të plagosur, dhjetëra e mijëra të përjashtuar nga puna, plaçkitjet e papara të parave e të kolektivave, qindra të izoluar, mijëra të helmuar, proceset e montuara politike dhe i ashtuquajturit diferencim ideor i karakterit inkuizicional, i zbatuar vetëm në periudhat më të errëta të vendeve të komunizmit ortodoks dhe të ndjekjeve staliniste. Protestat e më se gjysmë milioni shqiptarësh të Kosovës në nëntor të vitit 1988 ishin paralajmërimi i fundit se kështu nuk mund të vazhdohet më.²⁷

5. Rrezikimi i perspektivës dhe qenies demografike shqiptare

Në të gjitha synimet dhe projektet serbe të shek. XX ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, si pjesë të programit nacional serb, *pëlleshmëria e femrës shqiptare konsiderohej si një nga pengesat më të mëdha në*

²⁵ B. Horvat, *Kosovsko pitanje*, Globus, Zagreb, 1988 (dy botime).

²⁶ B. Horvat, “Fenomen mlade nacije i pitanja ekonomskog razvoja Kosova”, *Pogledi, Časopis za kritičku teoriju društva i kulture (Kosovo danas i sutra)*, No 2, Split, 1988, f. 467.

²⁷ H. Islami, “Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje”, në botimin *Kosovo-Srbija-Jugoslavija*, Knjižna zbirka, KRT, Ljubljana, 1989, f. 66.

mposhtjen e faktorit demografik shqiptar dhe në realizimin e aspiratave shtetomëdha serbe. Çubrilloviqi qysh në elaboratin e parë fashistoid kundër shqiptarëve e veçonte këtë element të rritjes demografike të shqiptarëve, duke nënvizuar se “Në rastin tonë duhet pasur parasyshtaq më parë që kemi të bëjmë me një racë të gjallë, të fuqishme dhe pjellore, për të cilën i ndjeri Cvijiq ka thënë se është raca më ekspansive në Ballkan dhe se pjellshmëria e grave shqiptare ka ngadhënjyer mbi politikën tonë të kolonizimit.” Politika e dëbimit të shqiptarëve vazhdoi gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit XX, por dhe pas Luftës së Dytë Botërore preokupim kryesor i Serbisë dhe i ish-Jugosllavisë ishte që problemi i shqiptarëve përsëri të zgjidhej me shpërngulje në Turqi, kryesisht në shkretirat e Anadollisë dhe me asimilim.

Qarqet serbe, pushtetore dhe të tjera, si kisha ortodokse, Shoqata e Shkrimtarëve, Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve, që ishin edhe nxitëset e dhunës e të krimeve në Kosovë, manipuluan shumë me shpërnguljen e serbëve nga Kosova. Por shpërngulja e tyre nga Kosova pas vitit 1966 nuk ishte bërë për shkak të presionit të shqiptarëve kundër tyre, kinse me qëllim të krijimit të “Kosovës etnikisht të pastër” dhe të “Shqipërisë së Madhe”, siç e paraqiste pushteti serbo-jugosllav komunist pas vitit 1981, por për shkak të humbjes së privilegjeve që gëzonin deri atëherë dhe mostolerimit të barazisë së shqiptarëve me ta, për shkaqe të pasigurisë së atyre serbëve që i përkisnin aparatit shtetëror e policor e që u kishin bërë shumë të këqija shqiptarëve (në kohën e sundimit të Rankoviçit), për arsye të gjendjes shumë më të mirë ekonomike në Serbi dhe fitimeve të mëdha nga shitja e pasurisë së patundshme në Kosovë dhe në mënyra të tjera. Një numër i madh i serbëve të shpërngulur ishte me origjinë kolonizuese, të valës së parë dhe valës së dytë të kolonizimit të Kosovës, prandaj edhe kthehej në vatrat e tyre, në Serbi dhe Mal të Zi. Një numër tjetër i serbëve të shpërngulur u përkiste eprorëve ushtarakë, të cilët, në kuadër të ndërrimit të vendit të shërbimit, evidencoheshin si të shpërngulur, madje nën "presion" të shqiptarëve.

Nga fillimi i viteve 80 të shek. XX, në kuadër të fushatës së gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve, ky pushtet, i përkrahur pa asnjë rezervë nga ish-republikat dhe popujt e tjerë joserbë, përsëri iu kthye diskursit, manipulimeve e spekulimeve rreth faktorit demografik shqiptar dhe aktiviteteve institucionale e publike kundër tij. Problemet demografike të shqiptarëve nuk shtroheshin me qëllim të përmirësimit të cilësisë së riprodhimit biologjik dhe të jetës sociale të shqiptarëve e të humanizimit të raporteve midis gjinive apo të zgjidhjes së drejtë të

çështjes së Kosovës, siç justifikohet atëherë. Të frikësuar nga numri i madh i shqiptarëve, shtrirja e gjerë dhe territorialisht kompakte dhe perspektiva e tyre demografike dhe kinse për shkak të rrezikimit të hapësirës serbo-jugosllave dhe prosperitetit gjeodemografik, kombëtar, politik dhe ekonomik të sllavëve të jugut, të gjitha qarqet ish-jugosllave nisën t'i numërojnë shqiptarët dhe ta shtrijnë shqiptarofobinë në të gjitha rajonet dhe shtresat shoqërore të sllavëve të jugut, veçanërisht të serbëve, maqedonëve dhe malazezëve. Çdo ngulitje të shqiptarëve në Serbinë e Jugut, në Maqedonisë Qendrore apo gjetiu e shpjegonin si “zgjerim të hartës nacionaliste të Shqipërisë së Madhe”.²⁸ Ish-shteti, me të gjitha mekanizmat e tij, duke financuar segregacionizmin dhe aparatit represiv, vazhdoi të angazhohej haptazi për mposhtjen e epërsisë numerike dhe reproduktive të shqiptarëve dhe të vënies së baraspeshës etnike përmes kolonizimit të serbëve dhe dëbimit të shqiptarëve. Në funksion të këtij qëllimi pasuan disa valë të kolonizimit të serbëve dhe të shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova. Në këtë mënyrë lufta kundër faktorit demografik shqiptar u bë pjesë përbërëse e strategjisë anti-shqiptare. Shqiptarofobia ishte aq transparente sa që nuk fshihej fare prapavija neomaltusianiste, raciste dhe gjenocidale.

Të gjitha institucionet serbe e jugosllave, nga ato politike e shtetërore e deri te ato shkencore, kulturore, publicistike, informative, kish-tare etj., nisën të shpifin teza të ndryshme, ndër të cilat më transparente ishin: se shqiptarët në mënyrë të organizuar po ua blejnë serbëve tokën dhe po lindin shumë fëmijë për shkaqe nacionaliste me qëllim që t'i ndjekin serbët nga Kosova dhe të krijojnë "Kosovën etnikisht të pastër" dhe "Shqipërinë e Madhe". Ndërkaq njëri ndër udhëheqësit më të lartë partiako-shtetëror i ish-Jugosllavisë, S. Dolanc (me kombësi slloven), nuk ngurroi të deklaronte: "Ne e njohim shumë mirë njërën nga parullat kryesore të irredentës: blej tokë dhe lind fëmijë".²⁹ Një nga konstrukcionet më transparente dhe njëkohësisht ndërsyese ishte teza e demografit të njohur serb, M. Macura, njërit nga autorët e "Memorandumit", i cili gjatë gjithë viteve 80 të shek. XX kishte qëndrim ekstrem dhe shovinist ndaj natalitetit të shqiptarëve: "Procesin eksploziv demografik, askush deri më sot nuk është përpjekur efektivisht ta qetësojë. Ky proces pa pengesë po përparon, me përkrahjen morale të ideologjisë secesioniste, të bazuar në ekskluzivitetin nacional, të përmbledhur në

²⁸ S. Šuvar, "Kosovska zbivanja i nacionalistička euforija", *NIN*, br. 600, Beograd, 1981, f. 15.

²⁹ S. Dolanc, anëtar i Kryesisë së RSFJ-së nga Sllovenia, intervistë në revistën "Teleks", Lublanë, nëntor 1988.

idenë për Kosovën etnikisht të pastër dhe kërkesën ekstreme që Kosova të bëhet Republikë”.³⁰

Indoktrinimi antinatalist dhe, në esencë, antishqiptar kishte marrë tashmë përmasa të gjera në të gjitha shtresat e shoqërisë serbo-jugosllave, duke e fyer rëndë femrën shqiptare, të cilën në çdo forum politik, në medime, në rrugë e cilësonin si "makinë për prodhimin e fëmijëve". Në mitingjet populiste nacionaliste, ku bëhej homogjenizimi dhe mobilizimi etnik i masave serbe dhe ku shfrytëzohej e tërë energjia e popullit "hyjnor" serb kundër shqiptarëve dhe përgatitjes për konfrontim me të gjithë popujt joserbë u nxorën parulla dhe kërkesa me përmbajtje thjesht raciste e gjenocidale, si p.sh. "Shqiptarët shumohen shumë, por farën e kanë të prishur", "Shqiptarët duhen dëbuar nga Kosova", "Shqiptarët duhen vrarë" etj.³¹ "Idetë e intelektualëve të krisur", theksonte ambasadori Zimmermann, "mbisundonin kudo në shoqërinë serbe, që nga dyqanxhinjtë e deri te fshatarët dhe gazetarët", për të vazhduar: "Më kujtohet një mbrëmje takova një historiane arti. Ishte grua e gjatë, tërheqëse dhe e ndjeshme, që kishte qenë në Nju-Jork shumë herë dhe e donte Amerikën dhe kulturën e saj. Pas një bisede të mrekullueshme për një rreth të gjerë çështjesh, unë e pyeta se si do ta trajtonte ajo problemin e Kosovës. 'Fare thjesht, - tha ajo.- Të vihen të gjithë shqiptarët në një mur dhe të pushkatohen'!"³²

Këto dhe kërkesat e tjera për zvogëlimin e natalitetit përmes të ashtuquajturit kontroll të lindjes dhe planifikim të familjes, shqiptarët i kuptuan shumë drejt: si kërkesa që hynin në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes së ish-shtetit ndaj tyre. Viktimologu i njohur kroat, atëherë rektor i Universitetit të Zagrebit, prof. Zvonimir Sheparoviq, ishte ndër njerëzit e rrallë në ish-Jugosllavi që mori guximin ta kualifikonte fushatën për "kontrollin e lindjes" dhe "planifikimin e familjes" te shqiptarët si angazhim gjenocidal. Ai shkruante: "Disa thirrje, të cilat vijnë nga brengosjet për shkak të ekspansionit biologjik të popullatës në mjedisin e pazhvilluar, çfarë është Kosova, se thirrjet e tilla njënacionale që të pengohet lindshmëria e numrit kaq të madh të

³⁰ M. Macura, *Perspektive, ciljevi i načela politike obnavljanja stanovništva* (proširene teze za uvodnu reč u diskusiji oko okruglog stola, 21. I 22. V. 1987), SANU, Beograd, 1987, ff. 11-12.

³¹ Histeria antishqiptare kishte arritur kulminacionin në mitingjet shoviniste serbe në pjesën e dytë të viteve 80 (H.Islami, "Demografski problemi Kosova i njihovo tumačenje", Zbornik *Kosovo-Srbija-Jugoslavija*, KRT, Ljubljana, 1989, ff. 42-43).

³² W. Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, Tiranë, 1996, ff. 17-18.

shqiptarëve... kanë diçka në vete që hyn në modelin gjenocidal të të menduarit dhe të sjelljes”.³³

Mirëpo, fatmirësisht, ashtu edhe siç pritej nga shqiptarët, nuk u përmbush asnjë rezultat i pritur nga regjimet fashistoide serbe.

Pasi u krijua atmosfera për fajësimin kolektiv të shqiptarëve, nga represioni i shtetit policor dhe partiak komunist pasoi një valë e konsiderueshme e ikjes së tyre, kryesisht e të rinjve, ndërsa pas nxjerrjes me dhunë nga puna të më se 150.000 punëtorëve shqiptarë prej vitit 1990 e këndeje, emigrimi për motive ekzistenciale u intensifikua edhe më tepër. Pasi pëlçiti lufta në Slloveni e Kroaci (1991) dhe në BeH (1992) ushtarët shqiptarë, duke mos dashur të luftojnë në anën e ushtrisë agresore serbo-jugosllave dhe kundër popujve të pafajshëm joserbë, e braktisën këtë ushtri dhe ikën kryesisht në vendet perëndimore. Një numër i madh i shqiptarëve gjeti strehim politik në këto vende, veçanërisht të rinjtë. Ish-APJ-ja, që nga viti 1981 kishte montuar shumë procese politike kundër ushtarëve shqiptarë, me ç'rast kishte burgosur dhe vrarë shumë shqiptarë, të cilët i kthente në arkivole hermetikisht të mbyllura, duke mos u ofruar dëshmi as familjeve e as opinionit për vrasjen e tyre.

Vala e re e terrorit me pretekst të kërkimit të armëve ishte faktori tjetër në funksion të drejtpërdrejtë të shpërnguljes së shqiptarëve. Në këtë funksion ishte edhe përjashtimi i punëtorëve shqiptarë nga puna, shkatërrimi i bazës ekonomike të Kosovës përmes plaçkitjes së fondeve dhe teknologjisë, taksat dhe dënimi i afaristëve shqiptarë, ndjekja e vazhdueshme e rekrutëve shqiptarë, si dhe okupimi i hapësirave shkollore dhe universitare për nxënësit dhe studentët shqiptarë dhe pengimi i funksionimit të arsimit shqiptar të të gjitha niveleve. Pas eksodit masiv të shqiptarëve të Kosovës nga ndërmarrjet gjenocidale serbe gjatë kohës së bombardimeve (24 mars deri 10 qershor 1999) shumë shqiptarë u strehuan në vende të ndryshme të Evropës dhe jashtë saj, ku një numër edhe mbeti atje. Por kjo mbetje e tyre duket se nuk e ka ndryshuar shumë gjendjen numerike në raport me atë të para 24 marsit 1999. Vlerësohet se sot jashtë hapësirës gjeoetnike të shqiptarëve në vendet perëndimore gjenden më shumë se 1 milion shqiptarë dhe rreth gjysma e tyre emigruan në këto pesë dekadat e fundit, ndërsa kur të përfshihet emigrimi nga Shqipëria, para së gjithash në Greqi dhe Itali, ky numër shkon në më se 2 milionë njerëz. Bashkatdhetarët tanë nuk kursyen

³³ Z. Šeparović, intervistë në revistën “Start”, nr. 526, Zagreb, 18. 03. 1989, f. 17.

asgjë për ta ndihmuar materialisht, moralisht, politikisht dhe ushtarakisht Kosovën e okupuar dhe shqiptarët e frustruar në të gjitha trojet etnike në ish-Jugosllavi, veçanërisht në vitet kur shpërthyen konfliktet dhe lufta midis shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë (1998-1999), shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe Serbisë (2000-2001) dhe pushtetit maqedonas dhe shqiptarëve (2001). Sot ky numër vetëm nga Kosova të paktën është dyfishuar.

6. Programi segregacionist dhe racist serbo-jugosllav për Kosovën

Regjimi serb derisa ekzistonte Jugosllavia (1991) arriti që të gjitha kërkesat e veta antishqiptare t'i shtrinte te të gjitha republikat dhe organet federative. Në vitin 1989 Kuvendi i Jugosllavisë aprovoi propozimin e Qeverisë Jugosllave, të drejtuar nga "reformatori" me kombësi kroate (Ante Markoviq), të ashtuquajturin "*Program Jugosllav për Kosovën*"! Përmes këtij Programi, në të vërtetë, filloi një valë më e re e kolonizimit të Kosovës dhe një fazë e re e kolonializmit në Kosovë. Kjo politikë e re ishte pjesë e programit ekstrem nacional serb, që gjithashtu kishte për qëllim instalimin e serbëve për ta vënë baraspeshën etnike në Kosovë. Në vitet 80 filloi ngritja e reparteve industriale në enklavat serbe dhe ndërtimi i objekteve segregacioniste të banimit në funksion të rikolonizimit. Kjo valë e kolonizimit filloi me sjelljen e policëve, të instruktorëve të lartë ushtarakë, të gjykatësve dhe administratorëve për t'i ndjekur e torturuar sa më tepër shqiptarët.

Ish-Federata dhe njësitë e saj në këtë mënyrë stimulonin repressionin dhe segregacionin në Kosovë dhe e ndihmonin realizimin e synimeve të kahmotshme të politikës hegjemoniste të Serbisë, rikolonizimin e Kosovës. Ndërkaq për shqiptarë ofrohej si ndihmë punësimi në miniera, në industrinë e rëndë, në shërbime komunale (pastrimi i rrugëve) dhe në ndërtimtari në Serbi dhe në rajonet e tjera të ish-Jugosllavisë kinse për ta përmirësuar situatën punuese dhe jetësore të tyre. Ishin këto vende të punës që refuzoheshin nga punëtorët e atjeshëm, sikurse edhe në botën e jashtme, që paguheshin pak, ndërsa kërkonin mund të madh fizik dhe me pasoja afatgjata negative për kondicionin e punës dhe shëndetin.

Politika shtetërore serbe në fillim të vitit 1990 nxori edhe ligje dhe hartoi projekte dhe programe hegjemoniste, destinimi kryesor i të cilave ishte ndërrimi i strukturës së popullsisë së Kosovës përmes

kolonizimit të serbëve dhe spastrimeve të qeta etnike të shqiptarëve. Ky program politik u miratua në Kuvendin e Serbisë dhe në Komitetin Qendror të LKS-së me një titull tepër perfid dhe cinik "Për paqe, liri, barazi, demokraci dhe prosperitet të Kosovës", që kur të krahasohet me dokumentet e politikës së atëhershme zyrtare serbe dhe veçanërisht me "Memorandumin" e Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve ndaj Kosovës del vërtet kopje e tyre: gënjeshtër, inskenime, akuza dhe tendenca për kolonizim dhe ndërrim të strukturës kombëtare të popullsisë me masa të ndryshme, para së gjithash me masa represive të aparatit shtetëror-polikor.

7. Ligji për pronësinë si presion për dëbimin e shqiptarëve dhe masat për vënien e baraspeshës etnike në Kosovë

Përveç nxjerrjes së ligjit të vitit 1991 mbi kushtet dhe mënyrën e ndarjes së tokave bujqësore në Kosovë, politikës së re kolonizuese dëshirohej t'i jepej forma tjetër institucionale me paralajmërimin e nxjerrjes së një ligji të ri kadastral për rregullimin e pronave të paluajtshme që nga viti 1945 e deri më sot, që mund t'i godiste shqiptarët më shumë se çdo ligj tjetër i deriatëhershëm i nxjerrë për këto qëllime. Nxjerrjen e këtij ligji pushteti serb e bënte me arsytim kinse "të vërtetojë pronësinë e vërtetë mbi patundshmëritë që i posedojnë qytetarët e Kosmetit dhe t'i korrigjojë gabimet eventuale. Është e njohur se pas vitit 1945 në krahinën tonë ka pasur regjistrime të ndryshme joligjore në librat kadastralë, pa dokumentacion juridik.³⁴ Qytetarët që posedojnë patundshmëri, do të jenë të obliguar që komisionit përkatës profesional t'ia dorëzojnë dokumentacionin juridik për shfrytëzimin ose pronësinë. Në qoftë se nuk posedojnë dokumentacionin e duhur, ata nuk do të mund ta fitojnë të drejtën e patundshmërisë në librat kadastralë. Në këtë mënyrë do të vërtetohet saktësisht se cilët janë shfrytëzuesit, ndërsa cilët janë pronarët e vërtetë të tokës".³⁵ Nga fondi i tokave, i cili do të formohej nga tokat komunale, tokat e organizatave bujqësore dhe nga tokat që do t'i falnin personat juridikë e fizikë, me këtë ligj parashihej që serbëve të Kosovës t'u jepej toka falas, ndërsa për ndërtimin e shtëpive do të siguroheshin kredi me afat kthimi prej 25 vjetësh.

³⁴ Deri në vitin 1966, siç dihet, administratën juridike si në nivel të komunave, ashtu edhe në nivel të Kosovës e udhëhiqnin vetë kuadrot serbe dhe malazeze.

³⁵ Gazeta e përditshme në gjuhën serbe: "Jedinstvo", 2. 2. 1995. Prishtina.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij dhe ligjeve të ngjashme ishte më se i qartë: ta intensifikonin kolonizimin e serbëve dhe t'i varfëronin shqiptarët në mënyrë që të shpërnguleshin, por edhe të krijoheshin tensionime të reja, meqenëse, me marrjen e tokave shqiptarët jo vetëm që do t'i godiste në bazën ekzistenciale, por edhe në rrafshin emocional dhe individualo-psikologjik, ku mund edhe të provokoheshin më lehtë, provokim ky i cili më vonë do të shuhej me gjak.

8. Kolonët serbë nga Kroacia dhe Bosnjë e Hercegovina dhe serbo-malazezët nga Shqipëria

Edhe pas shturjes së ish-Federatës jugosllave, objektivi kryesor i Serbisë mbetën aspiratat shtetomëdha dhe serbizimi i Kosovës. Menjëherë pas nxjerrjes së kësaj platforme, që kishte fuqinë e një programi nacional, politik dhe shtetëror serb, në vitin 1991 Kuvendi i Serbisë nxori ligjin për kushtet e ndarjes së tokave bujqësore në Kosovë me qëllim të realizimit të synimeve kolonizuese. Pas këtij viti, me qëllim të serbizimit të Kosovës, regjimi serb, krahas ndjekjes së shqiptarëve, nisi të sjellë edhe refugjatë-kolonistë nga Kroacia e BeH, si dhe serbo-malazezë nga Shqipëria.

Këta refugjatë-kolonë serbë pushteti okupues i vendosi në pjesë të ndryshme të Kosovës, më tepër në objektet arsimore, edukative e rekreative të nxënësve dhe studentëve dhe në objektet hoteliere e turistike. Përveç formimit të disa enklavave të vogla me kolonë (Deçan, Vushtrri, Klinë, Kishnicë), për kolonët e rinj parashihej ndarja e trojeve falas në Istog (Birim), Prishtinë, Gjilan, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Obiliq (Kastriot) etj. Numri prej 100.000 kolonëve serbë, që parashihte t'i instalonte regjimi i Millosheviçit në Kosovë, paraqiste valën më të fuqishme të paralajmëruar në vargun e valëve të kolonizimit të Kosovës midis dy Luftërave Botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Sipas këtij dekretligji kolonëve u ofroheshin kredi me kushte shumë të volitshme për ndërtimin e shtëpive, troje falas, vende të punës dhe shumë beneficione të tjera. Projekti pjesërisht gjeti zbatim, veçanërisht pas "Stuhisë" kroate më 5 gusht 1995, kur, me gjithë vullnetin e tyre, u instaluan në Kosovë disa mijëra serbë nga Kroacia.

Mirëpo, duke pasur parasysh qëllimin hegjemonist të Serbisë ndaj Kosovës, instrumentalizimin e kolonëve për qëllime ekskluzivisht politike, ardhjen e kolonëve nga një territor dhe atmosferë lufte, frustrimin e tyre, si dhe gjendjen e përgjithshme edhe ashtu të tensionuar për shkak

të terrorit serb ndaj shqiptarëve - edhe numri më i vogël i kolonëve mund të provokonte një konflikt të gjerë në Kosovë dhe në rajon. Pikërisht në kolonët me prejardhje nga Kraina, Lika, Bania, Korduni dhe viset e tjera karstike të ish-Jugosllavisë si "njerëz pa mirësjellje, të vrazhdë e agresivë", siç i cilësonte Çubrilloviçi, edhe llogaritej midis dy luftërave që "tipi violent dinarik", siç i vlerësonte Cvijçi, të shfrytëzohej për ndjekjen masive të shqiptarëve në Turqi. Fundja, kolonët e këtyre rajoneve, në të gjitha periudhat, veçanërisht në kohën e Rankoviçit dhe pas vitit 1981, janë shquar për sjelljet brutale ndaj shqiptarëve.

Formulimin më të qartë programor për krijimin e Serbisë së Madhe dhe serbizimin e plotë të Kosovës me dëbimin e shqiptarëve dhe kolonizimin me serbë e gjejmë në Programin e Partisë Radikale Serbe të Vojislav Sheshelit të vitit 1991.³⁶ Që në pikën e parë të tij thuhet se krijimi i shtetit serb "do të përfshijë tërë popullin serb, të gjitha tokat serbe, që do të thotë se ajo do t'i përfshijë përbrenda kufijve të saj njësinë e zvogëluar federale serbe, Malin e Zi, Bosnjën serbe, Hercegovinën serbe, Dubrovnikun serb, Dalmacinë serbe, Likën serbe, Kordunin serb, Banijën serbe, Sllavoninë serbe, Sremin Perëndimor serb, Baranjën serbe dhe Maqedoninë serbe". Në program kërkohet si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht largimi i "Serbisë së Madhe" nga Bashkimi Evropian dhe forcimi i lidhjeve ekonomikopolitike me vendet me sisteme ende dogmatike-staliniste: Rusinë, Kinën dhe Korenë e Veriut.³⁷

Një pikë i kushtohet Kosovës, por me 16 nënpika si masa kundër shqiptarëve dhe spastrimit të tyre etnik. Në funksion të spastrimit etnik të shqiptarëve janë këto masa: dëbimi i shqiptarëve "emigrantë" së bashku me pasardhësit, që kapin shifrën prej rreth 1,5 milionë shqiptarëve të Kosovës, dhënia pa pengesë e pasaportave në mënyrë që të shpërnguleshin, dëbimi i plotë i shqiptarëve në zonën deri 50 km në rripin kufitar me Shqipërinë, pengimi i gjithë shqiptarëve që kanë qëllime "separatiste", ngritja e minierave të thëngjillit dhe e kapaciteteve elektroenergjetike në zonat më dendur të banuara me shqiptarë për arsye shpërnguljeje, ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe për shqiptarët e mbetur, pengimi i lindshmërisë me masa antisociale dhe administrative etj.

³⁶ Marrë nga: "Program Srpske radikalne stranke", *Jugoslovenski pregled*, XXXIV, 1, Beograd, 1991.

³⁷ *Po aty*.

Ana tjetër e serbizimit të Kosovës, sipas programit të kësaj partie, konsiston me “zhvendosjen nga Serbia dhe vendosjen në Kosovë të akademive policore e ushtarake dhe institucioneve të tjera ushtarake” dhe “vendosjen e dhjetëra e mijëra oficerëve, nënoficerëve, policëve, punëtorëve shtetërorë dhe anëtarëve të familjeve të tyre”; të gjithë këtyre “do t’u ofroheshin apartamente të mëdha e konfore në Kosovë e Metohi si zgjidhje e përhershme për problemet e tyre të banimit”. Kolonëve serbë në Kosovë do t’u “jepej tokë e punëshme dhe shumë tokë ku ata mund të ndërtojnë shtëpi për familjet e tyre dhe për biznes”, ndërsa punëtorët serbë që do të punësoheshin në Kosovë, do të kishin të ardhura mesatare “dy herë më të larta se mesatarja e të ardhurave në pjesë të tjera të Serbisë” dhe lehtësime të tjera. Ndërkaq në “Universitetin e Prishtinës do të krijoheshin kushte shumë të favorshme për të studiuar vetëm në gjuhën serbe” etj., thuhet në Programin e Partisë Radikale Serbe, të drejtuar nga V. Shesheli.

9. Objektivit themelor i shovinizmit serb ishte shkatërrimi i themeleve të jetës së shqiptarëve

Veprimet gjenocidale të pushtetit serb jo vetëm që nuk u ndërpre, por ato u intensifikuan, duke marrë përmasa të krimit të vërtetë gjenocidal. Politika diskriminuese, segregacioniste dhe represive serbe dhe jugosllave e viteve 80 u zëvendësua në vitet 90 me të gjitha format dhe aktivitetet gjenocidale dhe me një politikë të përgatitur për një kohë të gjatë dhe të konceptuar mirë të krimit gjenocidal ndaj shqiptarëve. Ndërkaq, deri në ekzistimin e ish-Federatës Jugosllave, nën ombrellën e organeve të së cilës vepronte shovinizmi dhe terrori serb ndaj shqiptarëve, aktet e bollshme gjenocidale serbe në të gjitha sferat e jetës e të punës së shqiptarëve kamufloheshin dhe cilësoheshin si akte sporadike dhe si luftë kundër "individëve e grupeve nacionaliste, separatiste dhe terroriste shqiptare". Pas veprimeve të tilla gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve dukej se më shumë qëndronin idetë dhe synimet gjenocidale, sidomos në rrafshin demografik, çfarë ishte rasti me përpjekjet për të penguar procesin normal të lindshmërisë sesa projektet dhe programet e veprimit gjenocidal të drejtuar nga qendrat e pushtetit. Bashkësia ndërkombëtare nuk besonte madje as në përpjekjet dhe motivet gjenocidale e lëre më në aktet dhe elementet e krimit gjenocidal, çfarë ishte p. sh. spastrimi etnik i Kosovës dhe sulmet në substancën

biologjike e kombëtare të shqiptarëve, por fliste për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe atë vetëm pas vitit 1989.

Suprimimi i autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989 dhe së bashku me të rrënimi i të gjitha institucioneve politike, administrative, ekonomike, sociale, kulturore, shëndetësore, etj. dhe përjashtimi masiv i punëtorëve pas grevës së përgjithshme të 3 shtatorit 1990 tregonin qartë se nuk ishte fjala më për një pushtet që kishte si synim vetëm okupimin, kolonizimin dhe vënien e sistemit kolonialist në Kosovë, por diçka shumë më të tmerrshme: kishte për qëllim degradimin sistematik të shqiptarëve, varfërimin, rrezikimin e shëndetit, të ekzistencës biologjike dhe shpërnguljen e tyre.

Në vitin 1998 dhe veçanërisht në vitin 1999, në sytë e gjithë botës, idetë dhe synimet e kahmotshme të regjimeve dhe qarqeve të ndryshme serbe brenda tyre u shndërruan në gjenocid faktik masiv ndaj shqiptarëve. Sipas të dhënave ende jo të plota, më shumë se 15 mijë shqiptarë civilë, ku kishte fëmijë, gra dhe pleq, u vranë, u masakruan ose u dogjën të gjallë dhe u futën në qindra varreza masive; më shumë se 120.000 shtëpi, të shtrira në rreth 1100 vendbanime, u dogjën, u rrënuan e u dëmtuan; fshatra të tëra e shumë qendra urbane, me sistemet e tyre infrastrukturore, u shkatërruan; rreth një milion shqiptarë u deportuan jashtë Kosovës me mjete të ndryshme, me trena, kamionë, autobusë, vetura, këmbë nëpër male, gjithnjë rrugës duke u poshtëruar, torturuar e dhunuar; disa qindra mijëra të tjerë nën dhunë e kërcënime u ndoqën nga shtëpitë e tyre, duke bredhur brenda territorit të Kosovës, më tepër nëpër terrenet malore. Shumë varreza masive të shqiptarëve ende nuk janë hapur as në Kosovë e as në Serbi.

Regjimi fashistoid serb, me të gjitha mjetet u vërsul kundër identitetit etnik, historik dhe kulturor të shqiptarëve dhe kundër themeleve të jetës së tyre. Rrënimi i monumenteve kulturo-historike, p. sh. i 218 xhamive, i kompleksit memorial të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, zhdukja e busteve të figurave të shquara të rilindësve tanë dhe ndërrimi i gjithë onomastikës së Kosovës kishte për qëllim ringjalljen e miteve kishtare mesjetare serbe dhe serbizimin e plotë të Kosovës. Përmes deportimit masiv që i ngjante plotësisht deportimit të çifutëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe zhdukjes së dokumentacionit (letërnjoftimet, pasaportat, regjistrat kadastralë, librat amë të të lindurve, të kurorëzuarve dhe të të vdekurve, numrat personalë, librat e nënshtetësisë etj.) në pranverën e vitit 1999, ky regjim donte ta dehumanizonte njeriun e përkatësisë etnike shqiptare dhe gjithë bashkësinë shqiptare dhe ta këpuste çdo lidhje juridike të shqiptarëve me truallin gjeoetnik të

tyre, ta rrënonte një etni, një kulturë, një shoqëri me të gjitha institucionet e saj.

Të gjitha këto veprime, të qëllimshme e të dhunshme ndaj popullatës së etnikumit shqiptar, me të gjitha konventat ndërkombëtare, konsiderohen si krime gjenocidale, krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit, që shënojnë anën më të errët në historinë e njerëzimit dhe tragjedinë më të madhe në jetën e kombit që i ka përjetuar. Në kuadër të krimeve kundër njerëzimit, shpërngulja e qëllimshme, e planifikuar dhe e dhunshme e popullsisë në sistemet juridike të shumë vendeve, përfshirë edhe ato që vetë ushtrojnë gjenocid dhe nga vetë OKB-ja, konsiderohet krim gjenocidial.³⁸ Evitimi i kësaj tragjedie njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës u bë në saje të intervenimit të NATO-s, në krye me ShBA-në, dhe rezistencës së brendshme gjithëpopullore.

³⁸ Gazmend Zajmi, *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndeje*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 15 (Fjala e hyrjes e G. Zajmit).

Ksenofon Krisafi

TRAJTIMI I MASAKRAVE SERBE NË KOSOVË SIPAS TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE

Abstrakt

Diskutohet me tepri rreth çështjes nëse ato që serbët kryen gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999, ishin masakër, holokaust, krime luftime, gjenocid, spastrim etnik etj. Dallohet se prirja e tyre kryesore do të mohojë të vërtetat dhe të shmangë përgjegjësinë juridiko-ndërkombëtare të Serbisë. Në kushtet e pamundësisë për ta mohuar luftën dhe masakrën e madhe ndaj shqiptarëve, bëhen manipulime nëpërmjet zvogëlimit të shifrave të humbjeve njerëzore dhe dëmeve materiale, si dhe avancohen teorizime sofiste, pa mbështetje juridike. Abstraktohet nga e vërteta tragjike e provuar në kurriz nga shqiptarët dhe e konfirmuar nga ndërkombëtarët, serbë dhe të huaj, e delegojnë “shqetësimin” e tyre te domosdoshmëria e gjetjes së emërtimit të saktë juridik të asaj çka ndodhi në Kosovë dhe jo te dënimi autorëve të vrasjeve, mizorive, barbarive ndaj shqiptarëve. Pa dënuar krimin kërkohet me kujdes të skajshëm “cilësimi juridik adekuat”, i cili mundësisht të jetë sa më pak lëndues ndaj autorëve, të mos u hyjë atyre në hak. Këtij qëllimi i shërben edhe insistimi për ndërtimin e një simetrie fiktive ndërmjet krimeve serbe dhe rezistencës tërësisht të përligjur të shqiptarëve, që është pranuar edhe nga ndonjë segment i faktorit ndërkombëtar.

Në këtë kumtesë bëhen përpjekje për të përgënjeshtuar këtë farsë spekulative të Beogradit dhe aleatëve të vet, të fshehjes të së vërtetës. Për këtë qëllim analizohen në optikën juridiko-ndërkombëtare krimet kundër njerëzimit, ekzekutimet dhe vrasjet masive, masakrat, trajtimet degraduese dhe çnjerëzore, përdhunimet e grave dhe vajzave, shpërnguljet dhe dëbimet e qindra mijëra kosovarëve, të cilat morën format e spastrimit etnik, gjenocidit, gendercidit, urbicidit etj.

Si pjesë e argumentimit theksohet se krimet e Vuçiçit dhe bandës së tij nuk janë të vetme, as të reja dhe as të panjohura. Një vështrim i shpejtë retrospektiv në një hapësirë kohore rreth një shekull e gjysmë tregon se qëndrimet antishqiptare të serbëve, sikurse edhe të disa fqinjëve të tjerë, nuk kanë qenë aksidentale, por pjesë e platformave strategjike afatgjata për dëbimin, asimilimin, asgjësimin fizik të shqiptarëve dhe spastrimin e tyre etnik. Fatkeqësisht ato nuk kanë reshtur dhe janë kryer në sytë e faktorit ndërkombëtar. Prandaj, vetëm gjatë viteve 1878-2021, Serbia ka kryer së paku tre gjenocide ndaj shqiptarëve. Jo më pak zullume kanë bërë edhe fqinjët e tjerë. Beogradi guxon të bëhet trim dhe të kërcënojë ose të ndërmarrë fushata kriminale ndaj shqiptarëve dhe popujve të tjerë sepse, deri në Luftën e Kosovës, madje në ndonjë rast edhe pas saj, është ndërjerë i inkurajuar nga indiferentizmi i disa prej Fuqive të Mëdha. Në disa raste të dërguarit e posaçëm të BE-së, Borell dhe Lajçak, të pranishëm në takimet Kuri-Vuçiç, kanë

qëndruar inertë ndaj veprimeve megalomane të këtij të fundit. Ndërkohë që përballë qëndrimeve të tilla kryeneçe të fajtorëve të damkosur si të tillë nga organizatat ndërkombëtare, shtetet, opinioni publik etj, vazhdojnë ritin e neveritshëm, përsëritjen e thirrjes standard, që palët duhet të gjejnë zgjidhje. Zgjidhja vjen vetëm nga plotësimi nga pala kosovare të kërkesave tekanjoze serbe. Kërkohej, siç dihet, me insistim si condition sine quoi non themelimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe. Por përvoja dëshmon thënien profetike të Abdyl Frashërit se paqja e vërtetë në rajon do të vijë vetëm kur shqiptarët të trajtohen si të barabartë me të tjerët.

Fjalët çelës: Kosova, Serbia, Masakrat, e drejta ndërkombëtare

Në historinë njerëzore, hasen raste krimesh masive të kryera nga bashkësi ose shtete të ndryshme ndaj të tjerëve për t'i pushtuar e nënshtruar ose për t'i detyruar që të pushonin së ekzistuari si grupe të veçanta racore, fetare, etnike, kombëtare etj.

Shqiptarët, të ndodhur në kryqëzimet strategjike veri – jug dhe lindje – perëndim të kontinentit europian, kanë qenë ndër viktimat e përhershme të krimeve të fqinjëve të vet. Të parët e tyre u sulmuan nga hordhitë barbare sllave kur zbritën në Ballkan dhe iu pushtuan trojet, vijuan me inkursionet e ushtrive të car Stefan Dushanit, me agresionet për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, vazhduan me mizoritë e luftërave ballkanike dhe në periudhën pas tyre, më tej me Luftën e Parë Botërore dhe vazhdimin e platformave strategjike afatgjata, me synim kryesor asimilimin, asgjësimin fizik, dëbimin dhe spastrimin etnik të shqiptarëve. Gjenocidi serb nuk ka reshtur për asnjë çast. Vazhdon ende me të ashtuquajturin spastrim të listave të gjendjes civile nga shqiptarët në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc.

Një edicion i posaçëm i gjenocidit serb në Kosovë ishte agresioni i pashembullt, i ndërmarrë në vitet 1998-1999. Politikanë, diplomatë, juristë, studiues ose publicistë, kryesisht serbo-sllavë, kanë hedhur për diskutim çështjen nëse ato që u kryen në atë kohë, ishin vrasje të zakonshme, masakër e thjeshtë, holokaust, krime lufte, spastrim etnik apo gjenocid etj. Politika serbe dhe e ndonjë prej aleatëve të saj, i konsiderojnë reagime normale.

Në këtë punim bëhen përpjekje për të përgënjeshtuar spekulimet për fshehjen ose relativizimin e së vërtetës. Analizohen në optikën juridiko-ndërkombëtare të vërtetat historike për krimet kundër njerëzimit, ekzekutimet dhe vrasjet masive, masakrat, holokausti, trajtimet degraduese dhe çnjerëzore, përdhunimet e grave dhe vajzave, shpërnguljet dhe dëbimet e qindra mijëra kosovarëve, të cilat morën format e spastrimit etnik, gjenocidit, gendercidit, urbicidit, holodomorit¹ etj.

Çështja nëse janë ose jo të pranishme elementet e veprës penale të gjenocidit, në krimet serbe në Kosovë, është bërë objekt monografish dhe studimesh të shumta me karakter juridiko-penal e juridiko-ndërkombëtar. Në disa prej tyre që mbajnë në kopertinë emra penalistësh dhe ndërkombëtaristësh të shquar, nuk është vështirë të dallohet që midis tyre ka jo pak punime që duket sikur janë bërë me porosi. Porositësit duhet të kenë qenë klientë të fuqishëm nga sfera e oligarkisë politike, ushtarake, ekonomike, diplomatike, krimit të organizuar, jurisprudencës së korruptuar etj. Këta, duke shkëlur mbi dhimbjet, duke shpërfillur vuajtjet e viktimave të veprave të shteteve agresore, i janë përveshur avokatisë së gjenocidit, spastrimit etnik, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit.

Pjesë e bibliografisë juridiko-ndërkombëtare për gjenocidin, janë edhe punime të disa autorëve nga hapësirat shqiptare. Ndonjëri, ndoshta edhe me plagë të rënda në rrethin e vet familjar e miqësor nga këto krime, mund të përligjej që, të operonte nëpërmjet arsytimeve të përgjithshme emocionale. Por janë karakterizuar nga qëndrime parimore. Është e vështirë të guxosh t'i renditësh sipas kontributeve që sjellin. Cilido prej tyre meriton lëvdata. Veçohet libri i kolegut dhe mikut, akademik Arsim Bajrami, *Gjenocidi i Serbisë në Kosovë, aspekte*

¹ Holodomor, term specifik, i përdorur në fund të viteve 1980, shkaktimi i vdekjes nëpërmjet urisë, zi buke, e shkakuar qëllimisht për të sjellë vuajtje dhe vdekje. Nëpërmjet interpretimit të zgjeruar të nenit 2 (c) të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkrimin e Krimit të Gjenocidit, është konsideruar një nga format e gjenocidit, sepse bëhet fjalë për veprime ose mosveprime të qëllimshme që krijojnë kushte jetese që çojnë në shkatërrimin fizik, tërësisht ose pjesërisht, të një grupi kombëtar, etnik, fetar ose racor, siç ndodhi në Ukrainë në vitet 1932-1933, u shkaktoi vdekja e rreth 3,3 deri në 5 milionë njerëz ose në ish- B.Sovjetik vdiqën 5,5 deri në 8,7 milionë njerëz.

juridike,² si një studim tërësor, gati ezaurues, cilësor, nga më të mirët, ndoshta më i miri deri më sot në literaturën juridike shqiptare.

Dy personalitete të së drejtës ndërkombëtare nga hapësirat shqiptare që kanë shkruar gjithashtu me kompetencë të spikatur profesionale për këtë çështje janë edhe profesori, kolegu dhe miku im i nderuar, i ndjeri prof. dr. Arben Puto, si dhe i ndjeri prof. dr. Zejnullah Gruda.³ Meritojnë të citohen ditari mbresëlënës i luftës, i Teuta Hadrit, i hedhur në një libër me dy vëllime, me titullin *Krimi që pashë me sytë e mi*⁴ si dhe libri *Mashtrimi i Madh*, me autor politologun dhe personalitetin e shquar Bardhyl Mahmuti.⁵

Evidentimi i gjenocidit serb në Kosovë, shërben, ndër të tjera, që brezat e ardhshëm ta njohin më mirë historinë e të kaluarës së etërve dhe gjyshërve të vet, të ndërgjegjësohen për të respektuar kujtimin e viktimave dhe të mbijetuarve të gjenocidit dhe të mbajnë qëndrimin e duhur ndaj atyre që ua vranë njerëzit dhe ua shkretuan vendin.

Dokumentimi dhe argumentimi në aspektin juridiko-penal, juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar do t'i shërbejë edhe përgënjeshtimit dhe denoncimit të përpjekjeve të serbëve dhe protektorëve të tyre për mohimin ose relativizimin e gjenocidit në Kosovë. Në këtë mënyrë shpresohet që drejtuesit aktualë të Serbisë të detyrohen të pranojnë autorësinë e pakontestueshme të gjenocidit të tyre, të njohin dhe të përballojnë përgjegjësitë përkatëse, politike, juridike, morale dhe ekonomike për çka u kanë bërë shqiptarëve, të kërkojnë falje, të japin garanci për mospërsëritjen e akteve të tilla në të ardhmen, të dënojnë autorët ose bashkautorët. Në këtë aspekt, Serbia ka rrugë të gjatë për të bërë për t'u qytetëruar, edukuar dhe demokratizuar, përndryshe ajo do të mbetet vatra e molepsur në Ballkan, burim konfliktesh e luftërash.

Me këtë qëllim, në vijim shtjellohen në optikën juridiko-ndërkombëtare dhe në kontekstin historik krimet e rënda serbe kundër

² Arsim Bajrami, *Genocidi i Serbisë në Kosovë, aspekte juridike*, ASHAK, Prishtinë, 2023.

³ Zejnullah Gruda, *Shfaqja dhe historiku i Gjenocidit*, botuar në Buletinin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut - Prishtinë Viti X, Nr. 15 1 prill (30 qershor 2000), p. 29-42.

⁴ Teuta Hadri, *Krimi që pashë me sytë e mi*, Botimet Dudaj, 2016.

⁵ Bardhyl Mahmuti, *Mashtrimi i Madh*, Çabej, 2015.

njerëzimit, ekzekutimet dhe vrasjet masive, masakrat, trajtimet degraduese dhe çnjerëzore, përdhunimet e grave dhe vajzave, shpërnguljet dhe dëbimet e qindra mijëra kosovarëve, të cilat morën format e spastrimit etnik dhe pa mëdyshje të gjenocidit etj.

Gjenocidi krim mizor

Jean Paul Sartre e konsideron gjenocidin po aq të vjetër sa ç'është vetë njerëzimi.⁶ Si cilësim i një veprë penale me përmasa dhe tipare ekstreme dhe si koncept i afërt me kuptimin aktual përmendet për herë të parë në një varg traktatesh dy e shumëpalshe, para dhe pas sistemit të Traktateve të Paqes të Westfalisë, 1648. Më vonë, më 1789, u bë pjesë e një debati në punimet e Asamblesë kombëtare revolucionare të Francës, ku Robespieri, e përshkroi Luigjin XVI, si “kriminel kundër njerëzimit”.⁷

Sanksionimi juridik si vepër penale e grupit të krimeve të luftës, pa emërtimin e sotëm, do të vinte në fundin e Luftës së Parë Botërore. Lordi Curzon, në mbledhjen e Kabinetit Mbretëror britanik të Luftës, të datës 20 nëntor 1918, propozoi vënien para përgjegjësisë penale ndërkombëtare të Kaizerit dhe udhëheqësve të tjerë të Gjermanisë.⁸

U rimor nga Konferenca e Paqes, e cila më 25 janar 1919, krijoi Komisionin për përgjegjësinë e autorëve të krimeve të luftës dhe zbatimin e dënimeve.⁹ Një varg krimesh lufte, ndër të cilat edhe ato që më pas do të quheshin gjenocid, u konsideruan “shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës dhe të drejtës së luftës” si dhe “përpjekje për të shkombëtarizuar banorët e territoreve të pushtuara”.¹⁰ Me shprehjen e mësipërme Komisioni iu referua edhe disa shkeljeve të kryera në Serbi nga autoritetet bullgare, gjermane dhe austriake. Akuzoheshin se ndalonin, madje i rrihnin serbët që përdornin fjalën “mirëmëngjes” në

⁶ Jean Paul Sartre, *On genocide*, Citohet nga Richard A. Falk, Gabriel Kolko. Robert Jay Liftons, *Crime of War*, New York: Rondon House, 1971, f. 534, cit. nga William A. Schabas, *Genocidi ne te drejten ndërkombëtare, krimet e krimeve*, Cambridge, University Press, 2000, f. 17.

⁷ Maximilian Robespierre, *Oeuvres IX*, Paris, Presses Universitaires de France, 1952, p.130. Citohet nga William A. Schabas, *Vep.cit* f. 34.

⁸ Citohet nga William A. Schabas, *Genocidi ne te drejten ndërkombëtare, krimet e krimeve*, Cambridge, University Press, 2000, f. 17.

⁹ Seth P. Tillman, *Anglo-American relations at the Paris Conference of 1919*, Princeton University Press, 1961, p. 312.

¹⁰ Po aty.

gjuhën e vet, si dhe ua shkatërronin atyre monumentet fetare, institucionet bamirëse, arsimore, historike, arkivat kishtare, gjyqësore etj.¹¹

Në atë kohë delegacionet shqiptare që ndiqnin punimet e Konferencës së Parisit, shtronin me forcë shqetësimin për krimet që kryenin serbët, malazezët, maqedonasit e grekët në trojet shqiptare dhe *kërkonin ndërhyrjen e diplomacisë së Fuqive të Mëdha, posaçërisht të Konferencës së Paqes*, për ndalimin e tyre. Por, ndërsa bullgarët, austriakët e gjermanët akuzoheshin për shkelje të ligjeve dhe të zakoneve të luftës, sepse nuk ua lejonin serbëve përdorimin në gjuhën e vet të fjalës “mirëmëngjes”, nga ana tjetër serbët, malazezët, maqedonasit dhe grekët, ua mohonin shqiptarëve jo vetëm “mirëmëngjesin” në gjuhën e tyre, por krejt gjuhën, ua mbyllnin shkollat, ua shkatërronin institucionet fetare, kulturore, madje ua merrnin edhe jetën. Këto nuk ziheshin fare në gojë, pa le më që nuk bëhej fjalë që ata të ndëshkoheshin ose të qortoheshin.

Rasti i mësipërm nuk mund të mos tërheqë vëmendjen për standardet e dyfishta që zbatoheshin në vlerësimin dhe gjykimin e situatave të njëjta të ndodhura në vende të ndryshme që zbatoheshin atëherë, sikurse më parë e më pas. Madje nuk ishin vetëm shqiptarët që shpërfilleshin, por edhe të tjerë. Atëherë kishte ndodhur një tjetër ngjarje tronditëse, gjenocidi armen, “shfarosja e çmendur dhe e pashembullt”, siç e ka quajtur Papa Françesku, “të Keqen e Madhe”, apo “Krimin e Madh”, që iu mori jetën rreth 1 deri 1.5 milionë armenëve.¹² Ndaj tmerreve që provuan armenët nuk u reagua, siç do të duhej, nuk u veprua për dënimin e “përgjegjësve për luftën dhe për shkeljet e rënda të ligjeve të luftës”, megjithëse, siç thoshte Lloyd George, “po rritej çdo ditë e me shumë ndjenja se lufta në vetvete ishte krim kundër njerëzimit”.¹³

Në vitin 1944, kur Europën e kishte mbërthyer murtaja nazi-fashiste, fantazia vrastare e së cilës kishte tejkaluar çdo kufi të imagjinatës njerëzore, u përdor për herë të parë emërtimi *gjenocid* si definicion i këtij krimi të përbindshëm. Ishte avokati polak Raphael Lemkin, i cili politikën shfarosëse të nazistëve, veçanërisht ndaj hebrenjve, i përkufizoi gjenocid, fjalë e krijuar nga bashkimi i “*gen*”, *genos*

¹¹ *Violations of the law and customs of war, Reports of Majority and Dissenting Reports of America and Japanese Members of the Commission of Responsibilities, Conference of Paris, 1919*, Oxford, Clarendon Press, 1919, p. 23, 39, 48.

¹² Vatican News, Dita e përkujtimit të gjenocidit armen, 24 prill 2019.

¹³ David Lloyd George, *The Truth About the Peace Treaties*, Vol.I, Londres: Victor Gollanez, 1938, pp.93, 96.

(greqisht) - “racë/fis” dhe “cid”, *occidere* (latinisht) - “të vrasësh”. Lemkin udhëhoqi edhe një fushatë ndërkombëtare për ta cilësuar gjenocidin si vepër penale.

Përpyekja e tij u konkretizua në Gjyqin e Nurembergut kundër drejtuesve të lartë nazistë, ku termi “gjenocid”, u përmend për herë të parë si krim. Ata akuzoheshin për “krime kundër njerëzimit” dhe jo direkt për “gjenocid”, por në aktakuzat ndaj tyre, ai ishte përdorur për herë të parë, qoftë edhe në kontekst përkufizues.

Edhe pas Nurembergut, krimi si gjenocid vazhdoi të trondiste ndërgjegjen e shoqërisë njerëzore, kryesisht në kontinente të tjera. Kurse dekada më vonë, në fundin e shekullit XX, ai u rikthye në Europë. E sollën serbët të akuzuarit e përhershëm për gjenocid, fillimisht në Bosnjë dhe pastaj në Kosovë.

Disa vjet më vonë, gjenocidi u adoptua si koncept dhe institut i së drejtës ndërkombëtare, si një nga llojet e krimeve kundër njerëzimit. Ajo e përfshiu atë në korpusin e vet për të kontribuar, për aq sa mundej si *soft law*, për parandalimin dhe dënimin e akteve të gjenocidit. Në fillim, përpjekjet u përqendruan në përpunimin teorik-juridik të elementëve përbërës të krimit si gjenocid dhe pranimin e emërtimit të tij formal në të drejtën ndërkombëtare, kohë që përkon me vitet 1944–1948.

Pas Luftës së Dytë Botërore çështja e gjenocidit nuk ka mbetur asnjëherë jashtë vëmendjes së forumeve ndërkombëtare. Kur bashkësia botërore krijoi OKB-në, si forum tek i cili u mbështetën shpresa të shumta për paqen dhe sigurinë e popujve, me besim se fatkeqësia e madhe që sapo kishte kaluar, nuk do të përsëritej më në të ardhmen, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në vitin 1946 miratoi një rezolutë, ku trajtonte edhe çështje që kishin të bënin me gjenocidin. Ajo e përfshinte gjenocidin në grupin e krimeve të luftës, që kryhet si rregull në kohë lufte, gjatë konflikteve të armatosura, por edhe në kohë paqeje.

Disa vjet më pas, gjenocidi u adoptua si koncept dhe institut i së drejtës ndërkombëtare dhe u përfshi në grupin e krimeve kundër njerëzimit.

Në literaturën juridiko-ndërkombëtare, atë historike dhe në publicistikë, qarkullojnë disa përcaktime. Ato e konsiderojnë gjenocidin të turpshëm, krim të shëmtuar, problem themelor i të drejtave të njeriut,¹⁴ mohim i së drejtës për ekzistencë të grupeve të tëra, në po atë mënyrë që vrasja paraqet mohim të së drejtës për jetë të qenieve njerëzore,¹⁵

¹⁴ Benjamin Ehitaker, Citohet nga William A. Schabas.

¹⁵ Rezoluta e AP OKB, 96(1), qershor 1946, Citohet nga William A. Schabas.

sulm frontal kundër vlerës e jetës njerëzore, kundër një vlere abstrakte të mbrojtur në mënyra të ndryshme nga krimi që quhet vrasje.¹⁶ Uinston Çerçilli e quante “krim pa emër”¹⁷, Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ruandën, “krimin e krimeve”,¹⁸ Christian Tomuschat “krimi më i tmerrshëm dhe më mizor në kuadër të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme”.¹⁹ Raportuesi i Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare (KDN), James Crawford, ndërkombëtarist nga më të shquarit e epokës sonë, në vitin 1994, thoshte se “gjenocidi është krimi më i keq..., ndër ata që cilësohen si “krim i krimeve”,...”.²⁰

Gjenocidi ka qenë për shumë kohë temë debatesh të nxehta edhe në punimet e organeve që merren me kodifikimin e së drejtës ndërkombëtare. Fjala është për KDN-në, i cili ka punuar prej më shumë se gjysmë shekulli me projektin e “Përgjegjësisë së shtetit për fakte ndërkombëtarisht të kundërligjshme”. Në kërkim të zgjidhjeve të përshtatshme janë hedhur për diskutim fjala vjen konceptet “krime shtetërore” ose “gjenocid civil” etj. Por diskutimet e stërzgjatura rreth 70-vjeçare, janë përmbyllur duke e përjashtuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të gjenocidit në “projektet” e përgatitura. Anëtarët e tij kanë përsëritur se përgjegjësia e shtetit është një institut juridiko-ndërkombëtar me karakter të theksuar politik dhe tepër i vështirë për t’u kodifikuar.

Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit

Si konkretizim i angazhimit të forumeve ndërkombëtare në periudhën e Pasluftës së Dytë Botërore për kodifikimin e çështjeve që kanë të bëjnë me krimin si gjenocid erdhi në dritë një dokument me karakter të posaçëm, Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit. U miratua më 9 dhjetor 1948 nga OKB-ja dhe hyri në fuqi më 12 janar 1951, pas kalimit të 3 muajve nga depozitimi i instrumentit të 20-të të ratifikimit/aderimit.²¹

¹⁶ Mordechai Kremnitzer, Citohehet nga William A. Schabas, Vep.cit, f. 23.

¹⁷ Citohehet nga William A. Schabas, Vep.cit. f. 31.

¹⁸ Prosecutor v. Kambanda, Case no ICTR - 97 - 23

¹⁹ Citohehet nga William A. Schabas, Vep.cit, f. 120.

²⁰ Citohehet nga William A. Schabas, Vep.cit, f. 120.

²¹ Citohehet nga William A. Schabas, Vep.cit, f. 19. Palë e Konventës është edhe Shqipëria, që prej 12 majit 1955. Me ligjin Nr.8489, datë 19.5.1999, ajo tërhoqi rezervën që kishte bërë për nenin IX të Konventës, për heqjen dorë nga rezerva e

Pothuajse në të gjitha aktet juridiko-ndërkombëtare, ku trajtohet ose ceket gjenocidi, riprodhohet i njëjti përkufizim i tij, i cili ka si prirje themelore karakterin restriktiv dhe kufizues të elementëve të veprës penale, rrethit të autorëve dhe sanksionit ndëshkues. Procedurat juridike me të cilat shoqërohet vënia para përgjegjësisë penale e personave të akuzuar për gjenocid dhe në përgjithësi për krime lufte, janë të ngarkuara me formalitete të tepruara. Si rezultat, ndodh që nuk dënohen persona, të cilët opinioni i gjerë i ka identifikuar si kriminelë mizorë.

Gjuha juridike, e personifikuar përgjithësisht mirë në dispozitat e Konventës për Gjenocidin, si rregull karakterizohet nga njëlloj shtangësie, në kuptimin që nuk është e lehtë për të ndërhyrë për ta përshtatur me nevojat ose dëshirat për ndëshkimin e akteve të individëve të veçantë. Personat e interesuar mund të ndodhen përpara një situatë, kur njihen botërisht raste të vrasjes së qindra, ndoshta mijëra njerëzve, kur është identifikuar edhe autori ose autorët, por autoriteti kompetent gjyqësor e ka të vështirë për të shqiptuar dënimin e merituar, sepse në përfundim të hetimit gjyqësor nuk janë gjetur dhe nuk janë bashkuar dot të gjithë elementët e domosdoshëm që kërkon kjo figurë krimi specifike, gjenocidi. Për shkak të një vargu rrethanash, gjykata, mund të mos e ketë të lehtë të zbulojë dhe të argumentojë juridikisht që autori/autorët kanë pasur si qëllim zhdukjen e plotë ose të pjesshme të një grupi kombëtar, etnik, racor ose religjioz edhe pse ai/ata iu kanë marrë jetën shumë njerëzve të pafajshëm. Por, paradoksisht, ky fakt nuk mjafton për të marrë vendimin e dënimit për të mbyllur prapa hekurave shkaktarët e kësaj tragjedie. Kushti i lartpërmendur është *conditio sine quoi non*, sepse gjenocidi ka fokus tjetër, ai nuk ka të bëjë me vrasjen e individëve, por me “shkatërrimin e grupeve”.²²

Sipas Konventës, personat e akuzuar si autorë aktesh gjenocidi “duhet të gjykohen nga gjykatat kompetente të shtetit në territorin e të cilit është kryer akti, ose nga një gjykatë ndërkombëtare penale kompetente.” Kjo ndodhi me krijimin e gjykatave ndërkombëtare për gjykimin e personave të akuzuar si kriminelë në ish-Jugosllavi, në Ruanda, Kamboxhia etj.²³

juridiksionit të detyrueshëm të GJND. <http://www.parlament.al/komkuv/ligjet/ligjet.html>.

²² Philippe Sands, - *Koncepti juridik i gjenocidit në konfliktet ndëretnike*, transmetuar nga Radio *Europa e Lire*, më 19 mars, 2013.

²³ William A. Schabas, *Gjenocidi në të drejtën ndërkombëtare, krimet e krimeve*, Cambridge, University Press, 2000, f. 519.

Çështja e gjenocidit, ndoshta edhe për shkak të vështirësive që ndeshen vazhdimisht për vënien para përgjegjësisë së merituar të dhjetëra e ndoshta më shumë autorëve, gjendet ende në rendin e ditës të KDN-së, ku ndeshen opinione të ndryshme nga përfaqësues shtetesh, si edhe nga studiues të famshëm të së drejtës ndërkombëtare.

Në vitin 1998, James Crawford thoshte se përmendja nga Gjykata e "çdo forme të përgjegjësisë shtetërore", nuk duhet shikuar si diçka që ka të bëjë me përgjegjësinë penale shtetërore për *gjenocid*, por më shumë me veshjen e fajësisë ndaj shtetit si të tillë.²⁴ Një tjetër ndërkombëtarist i dëgjuar, René Cassin, e ka konsideruar Konventën mbi Gjenocidin si zbatim specifik të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut.²⁵ Pothuajse të njëjtin mendim shfaq edhe kolegu i tyre, Alain Pellet²⁶ etj.

Në Preambulën e Konventës thuhet se shtetet palë zotohen të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe ndëshkuar gjenocidin, fatkeqësinë nga e cila duhet çliruar njerëzimi (neni 1).

Gjenocid, sipas Konventës, cilësohet çdo akt që kryhet me qëllim zhdukjen e plotë ose të pjesshme të një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar. Të tillë mund të jenë: a) vrasja e anëtarëve të grupit; b) shkaktimi dëmtimeve serioze fizike dhe psikike anëtarëve të grupit; c) imponimi i kushteve të jetesës së planifikuar për shkatërrimin fizik total ose të pjesshëm të grupit; d) vendosja e masave që kanë si qëllim pengimin e lindjeve brenda grupit; e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në një grup tjetër (neni 2). Konventa përcakton se janë akte të dënueshme a) gjenocidi; b) bashkëpunimi për kryerjen e gjenocidit; c) nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike për kryerje të gjenocidit; d) tentativa për kryerje të gjenocidit dhe e) pjesëmarrja në gjenocid (neni 3).

Personat që vërtetohen se kryejnë gjenocid ose ndonjë nga aktet e tjera të lartpërmendura, do të dënohen pavarësisht nëse janë pushtetarë, zyrtarë publikë ose individë privatë, (neni 4).

Në zbatim të nenit 5 të Konventës dhe në përputhje me kushtetutat e tyre, palët pranojnë që të miratojnë në legjislationet e tyre të brendshme, normat e duhura juridike për dënimin e personave fajtorë për gjenocid. Gjykimi i tyre do të bëhet nga një gjykatë kompetente e shtetit

²⁴ Raporti i pare *Mbi përgjegjësinë shtetërore*, nga James Crawford, Raportues i posaçëm. Citohet nga William A. Schabas, *Genocidi në të drejtën ndërkombëtare, krimet e krimeve*, Cambridge, University Press, 2000, f. 518.

²⁵ UN DOC. E/CN.4/ SR 311, f.5.

²⁶ Raport i Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi punimet e sesionit të 49, 12 maj-18 qershor 1997, UN Doc. A/52/10, parag. 76.

në territorin e të cilit është kryer akti ose nga gjykata ndërkombëtare penale, që mund të kenë juridiksion ndaj palës përkatëse, e cila e ka pranuar juridiksionin e saj (neni 6). Kështu u veprua me gjykatat për gjykimin e personave të akuzuar si kriminelë luftime në ish-Jugosllavi, në Ruanda, Kamboxhia etj.²⁷ Gjenocidi nuk mund të cilësohet krim politik për qëllime ekstradimi. Në raste të tilla palët do të mundësojnë ekstradimin në përputhje me ligjet e tyre dhe marrëveshjet në fuqi (neni 7). Secila palë e Konventës mund t'u kërkojë organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara që të ndërmarrin veprime në përputhje me Kartën e OKB-së, për të parandaluar dhe përfunduar aktet e caktuara gjenocidale (neni 8).

Konventa, me gjithë vlerësimet pozitive që ka pasur në adresë të saj, e gjykuar në dritën e realiteteve aktuale dhe përvojave të grumbulluara nga njerëzimi në përpjekje për dënimin shembullor të krimeve si gjenocid, është kritikuar për disa çështje të trajtuara prej saj. Fjala vjen, thuhet se nuk mund të përballojë të gjitha sfidat që kanë të bëjnë me gjenocidin, me të cilat ndeshet sot njerëzimi. Ajo nuk shprehet për vepra të tilla të tmerrshme si tortura, zhdukja, skllavërimi, puna e fëmijëve, aparteidi, prostitucioni i dhunshëm etj.²⁸ E metë tjetër e Konventës konsiderohet fakti që ajo zbatohet vetëm për “grupet kombëtare, racore, etnike dhe fetare” dhe lihen jashtë “grupet politike dhe sociale”, grupet ideologjike, gjuhësore, ekonomike, gjinore, fisnore etj.²⁹ Lihen jashtë gjithashtu spastrimi etnik, gjenocidi kulturor,³⁰ etnocidi, ekocidi, shkatërrimi i mjedisit.³¹

Është e natyrshme që jo vetëm në Konventën e Gjenocidit, por edhe në akte të tjera që kanë të bëjnë me të, të ketë inkonvenienca, sepse që prej kohës së përgatitjes dhe miratimit të saj e deri në ditët tona, kanë kaluar rreth 75 vjet. Bota, politikat, institucionet, mentalitetet njerëzore, mjetet dhe mënyrat e komunikimit kanë ndryshuar. Nuk përjashtohet që edhe përmbajtja dhe problematika e gjenocidit të ketë evoluar.

Janë edhe disa akte të tjera juridiko-ndërkombëtare që eventuaisht mund të shërbejnë si instrumente plotësuese për një shqyrtim sa më të plotë për ndëshkimin juridik të rasteve të gjenocidit. Midis tyre përmendet Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve e trajtimeve të

²⁷ William A. Schabas, *Vep.cit.*, f. 519.

²⁸ William A. Schabas, *Vep.cit.*, f. 214.

²⁹ William A. Schabas, *Vep.cit.*, f. 124.

³⁰ William A. Schabas, *Vep.cit.*, f. 218.

³¹ William A. Schabas, *Vep.cit.*, f. 244.

tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese (1987),³² Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit Racor etj.

Gjenocidi në legjislacionet penale të shteteve

Përkufizimi standard i nenit 2 të Konventës është adoptuar edhe në ligjet penale të shumë shteteve. Fjala vjen Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë e parashikon gjenocidin si krim. Dispozitat e tij janë të zbatueshme edhe për shtetasit e huaj, që kanë kryer krime gjenocidiale dhe që eventualisht ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në varësi të vendit ku ata e kanë kryer veprën si dhe të legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar, mund të procedohet ndalimi, gjykimi ose dënimi apo kur është rasti ekstradimi në një vend tjetër ose në ndonjë gjykatë ndërkombëtare. (neni 7/a).

Gjithashtu, në Shqipëri parashihet dënim me heqje lirie tre deri në gjashtë vjet për ofrimin në publik ose shpërndarjen e qëllimshme, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, të materialeve që mohojnë, minimizojnë në mënyrë të ndjeshme, miratojnë ose justifikojnë akte, që përbëjnë gjenocid ose krim kundër njerëzimit (neni 74/a).

Kosova gjithashtu, megjithëse akoma nuk është palë nënshkruese e Konventës³³, e ka përfshirë gjenocidin në Kodin Penal (neni 142), i cili ka parashikuar në nenin 154, sanksionet për kryerjen e gjenocidit. Kushdo që organizon një grup me qëllim kryerjen e gjenocidit dënohet me heqje lirie nga një deri në dhjetë vjet. Kushdo që bëhet anëtar i një grupi të tillë, dënohet me heqje lirie nga një deri në pesë vjet. Personi që denoncon grupin para se të kryhet gjenocidi përfiton nga aplikimi i rrethanave lehtësuese. Në një rast të tillë, personi denoncues mund të lirohet tërësisht nga dënimi ose dënohet me heqje lirie jo më shumë se tri vjet.

Sanksione të njëjta ose të afërta zbatohen edhe për krimet kundër njerëzimit dhe krimet kundër luftës, të cilat, në aspektin juridik, klasifikohen në të njëjtën kategori si gjenocidi.

Gjenocidi nuk parashkruhet

Për shkak të karakterit dhe pasojave veçanërisht të rënda me të cilat shoqërohet gjenocidi nuk mund të parashkruhet.³⁴ Fjala vjen Kodi

³² 1465 UNTS 85.

³³ Deri në vjeshtën e vitit 2023.

³⁴ Me parashkrim nënkuptohet mosfillimi i ndjekjes penale ose moskryerja e dënimit për një vepër a kundërvajtje penale me kalimin e një kohe të caktuar, të parashikuar nga ligji.

Penal i Kosovës ka përcaktuar se nuk zbatohet asnjë afat i parashkrimit për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit ose për vepra të tjera penale, të cilat, sipas të drejtës ndërkombëtare, nuk parashkruhen (neni 104).

Kodi Penal i Shqipërisë, për sa i takon mosparashkrimit të ndjekjes penale nuk përmend gjenocidin, por u jep vend krimeve të luftës dhe atyre kundër njerëzimit (neni 67).

Një hap i rëndësishëm i bashkësisë ndërkombëtare për ndeshkimin e krimeve si gjenocid dhe autorëve të tyre ishte themelimi në vitet 1991-1998 i gjykatave ndërkombëtare penale, objekt veprimtarie i të cilave ishte edhe gjykimi dhe dënimi i këtij krimi. Ato u krijuan si organe *ad hoc* nga Këshilli i Sigurimit, për gjykimin e personave të akuzuar për gjenocid dhe krime lufte në ish-Jugosllavi dhe në Ruandë. Gjenocidi është trajtuar edhe në Statutin e Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, si dhe në akte të tjera, madje edhe në legjislacionet e brendshme të shumë shteteve.

Gjenocidi serb në Kosovë pjesë e platformës antishqiptare

Aspektet teoriko-juridike i krimit të gjenocidit, të trajtuara shkurt më sipër, janë evidentuar edhe në veprat e kryera gjatë agresionit permanent serb ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

Në vitet 1878-2021 Serbia ka kryer së paku 3 gjenocide ndaj shqiptarëve. Vepra e saj kriminale në Kosovë, i përmban të plota dhe tërësisht të shprehura tiparet e gjenocidit edhe në aspektin formalo-juridik.

Një skanim të politikës gjenocidale serbe në Kosovë e në Ballkan e ka bërë Ismail Kadare, edhe pse me fare pak rreshta. Ai ka studiuar deri në hollësitë më skajore zhvillimet dhe politikën serbe dhe shkruan se “ekziston një urrejtje e lashtë e serbëve kundër shqiptarëve, një psikozë e vërtetë. Kjo, gjatë 10 vjetëve të fundit, është ringjallur përsëri nga Milosheviçi dhe përkrahësit e tij, të cilët urrejtjen e kanë shpallur si “obligim kombëtar” të serbëve. Dhe kjo urrejtje është simbol dhe bazë e politikës së serbëve jo vetëm në Kosovë, por në mbarë ish-Jugosllavinë”.³⁵

Politika gjenocidale serbe në Kosovë ka ndjekur platformën strategjike të shfarosjes, të pagëzuar *Naçertania*, që i atribuohet Ilija

³⁵ Ismail Kadare, 17. 10. 1998.

Garashaninit, të detajuar më vonë në planin gjenocidal afatgjatë nga eksponentë të tillë, si Pashiçi, Nikolla, Çubrilloviçi, Andriçi, Rankoviçi, Mugosha, Tempo, Joviçi, Trajkoviçi, Milosheviçi, Vuçiçi etj. Synimi final është zhdukja biologjike e kombit shqiptar, dëbimi nga trojet etnike, shoqëruar me shkatërrimin e pronës dhe pasurisë së tyre.³⁶

Beogradi, i vetëdijshëm për mëkatet e rënda që rëndojnë ndër-gjegjen e tij kombëtare, është kujdesur maksimalisht për makiazhimin e barbarive që ka kryer. Nuk ia ka dalë, sepse juridikisht ato janë cilësuar krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Këtë e kanë sanksionuar edhe institucione gjyqësore ndërkombëtare, si Gjykata Ndërkombëtare Penale për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi etj. Në nëntor 2017, Petar Mlladiç, “kasapi i Ballkanit”, një prej bashkëpunëtorëve të Milosheviçit, gjithashtu pjesë e të njëjtit ekip, ku ishin edhe Vuçiçi e Daçiçi, u dënua me burgim të përjetshëm për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe *gjenocid*.

Gjenocidi serb në Kosovë - retrospektivë historike

Lajmet e para të gjenocidit serb, të kryer në përmasa masive, u përkasin së paku fillimeve të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Kronikat e kohës pasqyrojnë episode të tmerrshme për shfarosjen e shqiptarëve. Një prej tyre vjen i përshkruar në kohë reale, nga një autor serb, pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në këto fushata. Është Dimitrije Mita Petroviç, libri i të cilit në formën e një ditari, i mbetur dorëshkrim dhe i botuar në vitin 1979, përshkruan tragjedi të përgjakshme gjenocidi, spastrimi etnik dhe dëbimit të shqiptarëve nga trojet e veta, që sot ndodhen në Serbi. Sipas tij, ushtria serbe, në vitet 1876-1878, në zbatim të urdhrave të Beogradit, vrau, dëboi, shpërnguli me forcë rreth 300 mijë shqiptarë, shifër të cilën studime të tjera e denoncojnë si larg të vërtetës historike, duke e çuar në së paku 830 mijë vetë. Rrjedhojë e saj ishte vrasja e 70 mijë njerëzve, që banonin në afro 700 fshatra dhe qytete, vetëm në krahinën e Toplicës. Autori tregon se si i vranë, dëbuan dhe shpërngulën arnautët (shqiptarët) nga Toplica, Leskovci, Nishi, Vranja etj³⁷, duke

³⁶ Arsim Bajrami, *Genocidi i Serbisë në Kosovë, aspekte juridike*, ASHAK, Prishtinë, 2023.

³⁷ Dimitrije Petroviç, - “*Борбе у Топлицу 1877-1878*”, (*Luftimet në Toplicë 1877-1878*), Beograd 1879. (Citohet sipas Sylë Ukshinit). Përkthyesi i librit, Hamit Gurguri, thotë se libri i parë, ku bënin pjesë 37 skica, vizatime, fotografi, portrete dhe plane për luftën në Javor, të cilat u zhdukën, u botua nga Muzeu në Çaçak,

zbrazur trojet me shumicë shqiptare, si: Jagodina, Kosanica, Piroti, Qupria, Pllana, Krushevc, Surdulica, Prokuplja, Kurshumlia etj.³⁸ Popullsia shqiptare, e mbetur gjallë, u detyrua të zhvendosej në jug të Kosovës dhe në Maqedoni. Faqet e *Luftimeve në Toplicë 1877-1878*, janë të mbushura nga urrejtja etnike, e konkretizuar në djegie dhe shkatërrim shtëpish, të mbjellash, pasurish, rrëmbimin e njerëzve, tortura mizore, trajtime çnjerëzore, uri, etje, përdhunime, gjymtime, vrasje, prerje kokash etj. Në librin e lartpërmendur shkruhet se “turq/shqiptarë nuk ka (në mbetur më) deri në Prokuplje. Fshatrat janë të zbrazura. Në Petroc kaluam pranë shtëpive të shpeshta të arnautëve, në të cilat nuk ishte askush. Këmbësoria e artileria tashmë ishin të llogoruara afër rrugës, duke vënë rojën kodrinave, ndërsa tërë kalorësia ishte vendosur nëpër shtëpitë e zbrazëta të arnautëve”.³⁹

Raste të tilla shtrihen në kohë në të gjithë historinë e marrëdhënies midis shqiptarëve dhe serbëve dhe kanë ndodhur pothuajse në të gjitha trevat shqiptare. U institucionalizuan me Naçertanien, vazhduan pas Kongresit të Berlinit, 1878, kur shovinistët serbë e malazezë, tentuan të realizonin, atëherë e më vonë, shpërnguljen masive të popullsisë shqiptare nga trojet e veta. Vrasja dhe shpërngulja e tyre ishte shpallur hapur si “mision nacional”.⁴⁰ “Sa më pak (shqiptarë) të mbeten në vendin tonë, - thoshte princi Milan i Serbisë, - aq më i madh do të jetë shërbimi që do t’i bëhet “atdheut” dhe “sa më tepër shqiptarë të shpërngulen aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut”.⁴¹

Me qindra kërkesa, protesta, lutje e peticione iu drejtuan në atë kohë Kongresit të Berlinit dhe kancelarive të Fuqive të mëdha nga shqiptarët, viktimat të kësaj barbarie institucionale. Aty viheshin në dukje mizoritë, me të cilat serbët e malazezët shoqëronin politikën e tyre shfarosëse e asimiluese ndaj shqiptarëve. Në njërin prej tyre thuhej se “malazezët pas armëpushimit pushtuan një shumicë të fshatrave tona, shkretuan vreshtat, pemët frutore dhe rrafshuan me tokë shtëpitë ... Dhe çka nuk është parë të ketë ndodhur deri më sot në asnjë komb, ata thyen edhe gurët e varreve tona dhe faltoret na i shndërruan në pijetore”⁴².

në vitin 1955. Libri i dytë u kushtohet luftimeve në Toplicë, Nish dhe Piroti, në vitet 1877-1878, të shoqëruara me shpronësime, shpërngulje dhe shfarosje.

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ *Historia e Shqipërisë*, Vëll.II, Tiranë 1965, fq.145.

⁴¹ Po aty.

⁴² *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Përgatitur nga Stefanaq Pollo e Selami Pulaha, Tiranë 1978, fq.30.

“Tirania që po na shtyp, thuhej në një protestë tjetër, - mund të krahasohet me tregimet për barbarizmat që kanë ndodhur qëmoti... Bashk-atdhetarët tanë, viktimat të mizorive që ngjallin mëshirën e njerëzimit na copëtojnë zemrën me ulërimat e tyre dhe padrejtësitë, mizoritë që na bien mbi kokë janë mbeturina të qëllimit të vjetër që ushqejnë sllavët kundër nesh. Lutemi fort, pra, në emër të të drejtave njerëzore dhe të qytetërimit të tregoni ndaj nesh mëshirën, dhembshurinë dhe mbrojtjen tuaj, që kështu të mos biem nën zgjedhën e rëndë të armiqve, qëllimi hakmarrës i të cilëve do të na shfaroste”. “Ne duam të jemi gjer në vdekje vetëm ata që jemi”⁴³.

Dhembjen e tyre e vuajti mbarë populli shqiptar kudo që ndodhej. Kërkesat, protestat, lutjet dhe petitionet do të vërshonin nga çdo skaj i Shqipërisë, bilë edhe nga shqiptarët me banim në vende të huaja. Në këtë mënyrë çështja e shqiptarëve që mbetën në kufijtë e Serbisë e të Malit të Zi, mori vetvetiu një karakter të padyshimtë juridiko-ndërkombëtar. Është kjo arsyeja pse, për të përballuar politikën e asimilimit e të asgjësimit fizik nga ana e qeverive shoviniste serbe e malazeze, ata iu drejtuan edhe të drejtës ndërkombëtare, e cila nuk mundi t’iu ofronte asnjë ndihmë, çka bëri që ata të organizoheshin, të rrëmbenin armët për t’i dalë zot vetvetes.

Një autor tjetër serb, Aleksa Bogosavleviç, në librin “*Për shqiptarët*”, të shkruar më 1897, flet për një formë më të rafinuar të këtij krimi, atë të ndryshimit të toponimisë, duke ndryshuar emërtimet shqipe me ato serbe, siç ishte bërë me Bregun e Bardhë ose të Artë, të zëvendësuar, siç thotë ai, me emërtimin serb Novo Bërda. Në këtë mënyrë ishte vepruar edhe më një numër tjetër terriroresh shqiptare, emrat e të cilëve u ndryshuan menjëherë pas pushtimit nga serbët.

Skenari i zhdukjes së shqiptarëve do të vazhdonte me akte të tjera nga anëtarët e aleancës ballkanike në fillim të shekullit të kaluar, në kohën e luftërave ballkanike, ku role parësore kishin fqinjët në veri e në jug. Kur u bë e qartë se objektivi i tyre nuk po realizohej, secili u përpoq të arrinte qëllimet e veta nëpërmjet dy rrugëve, pushtimit dhe spastrimit etnik të trojeve shqiptare vënies së faktorit ndërkombëtar para faktit të

⁴³ Po aty, f. 51-52.

kryer dhe insistimit për sanksionimin e aneksimeve në tryezën e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës 1912-1913.

Gjenocidi serb në shtypin e kohës

Kronika e dhimbshme e masakrave ndaj shqiptarëve, si pjesë e gjenocidit dhe strategjisë serbe të spastrimit etnik ka qenë e pranishme në faqet e shtypit të kohës dhe në veprat e një vargu autorësh nga vende të ndryshme. Aty mësohen hollësi për veprime të paimagjinueshme të kryera ndaj shqiptarëve. Jens Reuter shprehet se “serbët i konsideronin tokat e reja të fituara më 1912/13 si vend i vjetër serb dhe shqiptarët që banonin atje si një trup i huaj kombëtar... burgosjet, keqpërdorimet, madje dhe likuidimi fizik i shqiptarëve të veçantë kanë qenë në rendin e ditës... Të gjitha planet e qeverisë synonin likuidimin e këtij grupi popullsie, nëpërmjet asimilimit të plotë, dëbimit të detyruar ose asgjësimi fizik”.⁴⁴ Në ato kohë ushtritë serbe dhe malazeze shtypën me egërsi përpjekjet për qëndresë nga ana e udhëheqësve shqiptarë,⁴⁵ duke vrarë me mijëra njerëz të pafajshëm. Argjipeshkvi i Shkupit, Lazër Mjeda, në raportin dërguar Vatikanit, tregon se shqiptarët e vrarë deri në atë kohë, arrinin në 25.000 vetë. Në shtypin evropian citohej pothuajse e njëjta shifër prej afro 20. 000 viktimash vetëm në fillim të dhjetorit 1912.⁴⁶

Në një artikull të Schiemann, botuar te “*Crusading*” lexohet se “... pamja që na shfaqet është veçanërisht shumë brengosëse. Serbët po zhvillojnë kundër shqiptarëve një luftë të formës së gjenocidit. Ata duan me shpirt që ta shfarosin tërë kombin, me rrënjë e me degë...”⁴⁷.

Një mjek rumun, i quajtur Leonte, në numrin e 6 janarit 1913 të “*Adeverul*” të Bukureshtit, shkruante se mizoritë e armatës serbe kundër shqiptarët, që ai i kishte parë vetë, kishin qenë shumë më të trishtueshme sesa mund të imagjinohen. “Këta njerëz të shkretë, thotë ai, duke ecur rrugëve, rrëzoheshin për tokë nga rraskapitja, uria dhe etja, kurse ushtarët serbë në ato çaste ua ngulnin bajonetat në fyt duke iu shkuar gjaku curril dhe duke mbetur rrugëve plot kufoma të pavarrosura. Edhe

⁴⁴ Jens Reuter, *Shqiptarët në Jugosllavi*, shtëpia botuese “BOTIMPEX”, Tiranë 2003, f. 30.

⁴⁵ Tim Judah, *Kosova – Luftë dhe hakmarrje*, shtypur në “KOHA Print”, Prishtinë 2002, f. 40.

⁴⁶ Noel Malkolm, *Kosova*, KOHA-Prishtinë & Shtëpia e librit-Tiranë, Botimi i dytë, 2001, f. 265.

⁴⁷ Leo Freundlich, *Golgota Shqiptare*, shtëpia botuese “LILO”, Tiranë, 1995, f. 41.

fushat, ishin mbuluar me kufoma të trupave të vrarë, duke përfshirë të rinj, gra por edhe fëmijë.”⁴⁸ Ai përshkruan edhe masakrat e bëra nga serbët në Kumanovë, Prizren e gjetiu që ishin pothuajse të njëjta me to.⁴⁹

Gazeta “*Humanité*” e Parisit publikoi një shpjegim zyrtar, i cili ishte komunikuar në Konsullatën e Selanikut, ku tregohet për grabitjet, shkatërrimet dhe masakrat e serbëve në Shqipëri. Aty vihet në pah shkatërrimi i 31 lokaliteteve shqiptare, plaçkitja e të gjitha lokaliteteve në rajonin e Kratovës dhe Koçanit, si dhe djegia dhe vrasja e popullatës shqiptare. Gazeta shkruan se në “rajonin e Kavadarcit (Kavadar), nga gjithsej 98 fshatra, u dogjën dhe u shkatërruan 34 prej tyre... ndërkaq në Drenovë, të gjithë banorët ishin vrarë. Midis këtij vendi dhe Palikurës ishin zbuluar me radhë shumë varreza, ku prej disave duke-shin kokat e nxjerra jashtë. Të fundit ishin varret e martirëve të cilët ishin varrosur për së gjalli.”⁵⁰

Leo Freundlich, autori i *Golgothas shqiptare*, sjell dëshmi rrëqethëse, duke përshkruar kronikat e gazetave evropiane për krimet e forcave serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë në vitet 1912-1913. “Më 12 nëntor të 1912-ës, gazeta “*Daily Chronicle*”, thotë ai, kishte raportuar se masakrimi i mijëra shqiptarëve, i kryer nga serbët, ishte fakt i pamohueshëm. Afër Shkupit – 2000 shqiptarë myslimanë dhe 5000 të tjerë jo larg Prizrenit u masakruan. Shumë fshatrave u ishte vënë flaka dhe banorët e tyre ishin masakruar. Kur shtëpitë kontrolloheshin për armë, shqiptarët vriteshin në mënyrën më të thjeshtë edhe pse kurrfarë arme nuk kishin gjetur në shtëpitë e tyre. Serbët bënë të qartë se shqiptarët myslimanë duhen zhdukur dhe çrënjësuar. Ata pohonin se kjo është mënyra më efektive për ta qetësuar vendin.”⁵¹

I njëjti autor i referohet korrespondentit të gazetës “*Riget*”, danezit Fric Magnusen, i cili raportonte nga Shkupi se “Makina e luftës në Maqedoni ka si tipar kryesor vrasjen e popullatës shqiptare. Ushtria ka shpërthyer në një luftë të llahtarshme *gjenocidi*. Sipas deklaratave të oficerëve dhe ushtarëve, 3 000 shqiptarë janë masakruar në zonën midis Kumanovës dhe Shkupit, 5000 të tjerë përqark Prishtinës. Fshatrat shqiptare rrethohen dhe u vihet flaka. Pastaj serbët presin. Presin cilindo

⁴⁸ Leo Freundlich, Po aty.

⁴⁹ Leo Freundlich, Po aty.

⁵⁰ Leo Freundlich, Po aty.

⁵¹ Leo Freundlich, Po aty.

që tenton të dalë i gjallë pa u përvëlur dhe e mbysin. Serbët mburren për këtë gjueti njerëzish”.⁵²

Në Ferizaj pati 12. 000 mijë viktime...⁵³. Në krahinën e Lumës forcat serbe shkatërruan 27 fshatra dhe vranë krejt banorët, pa kursyer as fëmijët. Leo Freundlich shkruan se “Këtu u kryen mizoritë më të tmerrshme që një lufta shfarosëse kundër shqiptarëve. Këtu ndodhi që gratë dhe fëmijët, të mbështjellë me kashtë, u dogjën të lidhur përpara syve të burrave dhe baballarëve të tyre të lidhur këmbë e duar. Gra shtatzëna janë shpërthyer në mes në mënyrën më të llahtarshme dhe fëmijët e palindur janë ngritur përpjetë me bajoneta. Edhe të dorëzuarit vriteshin si në “kasaphanë”.⁵⁴ Më tej, duke iu referuar të dërguarit të posaçëm të “*Daily Telegraph*”, ai shkruan se “historia e botës deri tani nuk njihet persekutime më të fëlliqura sesa pasojën e llahtarisë së duarve dhe shpirtit të gjeneralit Jankoviç. Të frymëzuar prej egërsisë së tyre të tmerrshme, ata kanë mbytur popull të pambrojtur: gra, pleq, fëmijë, bile edhe foshnja në gjirin e nënës. Oficerët serbë, të rrëmbyer nga furia e pushtimeve, kanë shpallur se ka vetëm një rrugë: sipas tyre, paqja më efektive në Shqipëri mund të arrihet duke i shfarosur krejtësisht shqiptarët”.⁵⁵

Edith Durham shkruan se “Në krahinën e Gostivarit u dogjën me vajgur fshatrat dhe u hodhën në flakë me majat e bajonetave ata që kishin mundur të shpëtonin; ka fshatra me 100, 150, ose 200 shtëpi, ku nuk mund të gjendej asnjë frymë. I mbledhin njerëzit me togje nga 40 ose 50 veta dhe i shkojnë në bajonetë deri tek i fundit.⁵⁶ Gazeta “*Përlindja e Shqipërisë*” e 1 shtatorit 1913 shkruante se afër Shkupit u therën 20 mijë shqiptarë.⁵⁷

Njëkohësisht me këto veprime dhe si rrjedhojë direkte e tyre, dhjetëra mijë të tjerë u larguan nga trevat shqiptare të pushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi. Sipas raporteve që i dërgoheshin Vjenës, në tetor 1913, “në Gash e Krasniqe,... u rrënuan 1 500 shtëpi dhe popullata e terrorizuar u arratis në brendi të Shqipërisë”. Largimi i përkohshëm i popullsisë nga zonat e operacioneve shfarosëse që i vetmi mjet

⁵² Leo Freundlich, Po aty, f. 43.

⁵³ Leo Freundlich, Po aty, f. 46.

⁵⁴ Leo Freundlich, Po aty, f. 49.

⁵⁵ Leo Freundlich, Po aty, f. 51-52 .

⁵⁶ Citohet nga Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe Qëndresa shqiptare*, Shtëpia botuese “Lumi-T”, Gjakovë, 1991, f. 202

⁵⁷ Gazeta “*Përlindja e Shqipërisë*”, nr. 14, datë 1/27 vjeshtë I, 1913

shpëtimi...⁵⁸ Sipas anketave të Institutit “Carnegie” të New York-ut, shifra arrinte në rreth 125.000 vetë, kurse sipas statistikave zyrtare të autoriteteve shqiptare, numri i viktimave shqiptare të masakruara prej ushtrive serbo-malazeze në vitin 1912 i kalonte të 200. 000 vetët.⁵⁹

Në një raport të publikuar nga amerikani Howard James flitet për tragjeditë e shqiptarëve në jugun e vendit, nga tetori i vitit 1913, ku ishin djegur ose hedhur në erë më shumë se 300 fshatra me 35 mijë shtëpi dhe kishin mbetur pa strehë më shumë se 330 mijë veta. Sipas llogaritjeve të tij, ishin vrarë, therur me thikë, me bajonetë ose djegur plot 20 mijë burra, gra e fëmijë nga andartët grekë, bashkë me ata të Spiro Milos. E njëjta gjendje tragjike ishte edhe në Kosovë, ku serbët masakruan dhe vranë dhjetëra mijëra njerëz të pafajshëm dhe dëbuan me forcë mijëra të tjerë nga trojet e tyre etnike.⁶⁰

Në një telegram që i drejtohej Kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës nga Gjakova thuhej: “Dje mori fund kryengritja në Malësinë e Gjakovës, pas 12 ditë luftërash të ashpra dëshpëronjëse. Forca të mëdha ushtarësh serbë e malazezë hynë në viset shqiptare, duke bërë barbarizma të panumërta. Malësia e Gjakovës mbaroi fare. Pritet të vijnë këtu pesëmbëdhjetë mijë njerëz. Ju lutemi merrni masa!”⁶¹

“Përlindja e Shqipërisë”, e datës 5 nëntor 1913, bënte fjalë për një miting në Vlorë, për të denoncuar aktet e ushtrive greke, që zbatoheshin pothuajse në mënyrë identike edhe në jug të vendit, në tokat e pushtuara prej tyre. Për sa u përket zhvillimeve tragjike në Veri, shkruante se “ushtima e dhimbshme e ankimeve dhe psherëtimave, të të plagosunve e t’atyne që po heqin shpirt tash dhjetë muej, ndër male e fusha, të mjerave vise të Kosovës e të Dibrës, ende s’asht sosun e që një e therme (masakre) tjetër, ma egërsore, e një të shtrydhun ma mizuer, po mbulon me gjak të pafajshëm vendet e Jugut, të rame në zgjedhën e mënishme të të huejit”.⁶²

⁵⁸ Shaban Braha, Vep.cit f. 205, 209, 211, 212.

⁵⁹ Tahir Zaimi, *Tallazet e jetës dhe lotët e zemrës*, Bruxelles, 1970, f. 105-106.

⁶⁰ I. Elezi, *Trashëgimia kulturore juridike e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar*, Telegrafi -16 Tetor, 2017.

⁶¹ *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërorë të RPSH, Tiranë, 1963, f. 230.

⁶² *Qeveria e Përkohshme*, vep. e cit. f. 246.

“Krijimi i Shqipërisë - rrezik për Ballkanin”

Krahas kësaj barbarie institucionale, që do të vazhdonte edhe më pas, me porosi të kryeministrit Nikolla Pashiç, diplomacia serbe vepronte intensivisht në kryeqendrat e diplomacisë europiane, për të argumentuar arsyen e vrasjes së shqiptarëve. Hapur dhe pa asnjë ekuivoke kjo thuhej në letrën që Pashiçi, i drejtonte ministrit të vet në Petërburg, më 21 janar 1913, ku shkruhej, “se shteti shqiptar nuk duhet të ekzistojë fare, ndërsa territoret e tij duhet të ndahen patjetër në mes Serbisë dhe Greqisë”.⁶³ “Krijimi i Shqipërisë përbën një rrezik të madh, jo vetëm për serbët, por për krejt Lidhjen Ballkanike”.⁶⁴ Sipas tij, vetëm kështu Ballkani do të kishte paqe, njëherazi do të ndërpriteshin pretendimet hegjemoniste të Italisë dhe të Austro-Hungarisë.⁶⁵

Serbia e shpaloste zyrtarisht synimin e saj për zhdukjen e Shqipërisë edhe në Memorandumin e paraqitur në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, ku shprehej se Shkodra, Ulqini, Kotorri, Tivari, Peja, Gjakova, Deçani dhe gjithë zona tjetër e Kosovës dhe e Rrafshit të Dukagjinit i përkisnin Serbisë. “Përkufizimi i Shqipërisë ashtu siç e kemi propozuar ne, - vazhdohej në Memorandum, do të kënaqte të drejtat historike dhe interesat e ligjshme të kombit serb dhe në këtë mënyrë do t’i jepte atij mundësi të ishte një nga garantuesit kryesorë të paqes, të rendit dhe të përparimit kulturor e ekonomik në Ballkan”.⁶⁶ Ajo nuk hezitonte të kërkonte dhunshëm plotësimin e çdo pretendimi, pavarësisht se sakrifikoheshin interesat e Shqipërisë, çka, për fat të keq, Konferenca e përmbushi. Për vendimin e Konferencës Kadare thotë se ai ishte “dhurata që iu bë terroristëve serbë...”. Dhënia “si shpërblim e gjysmës së Shqipërisë, është një nga krimet më të mëdha në historinë e njerëzimit. Sa më shpejt që bota e qytetëruar ta çlirojë veten e saj nga ky krim, aq më mirë do të jetë”.⁶⁷

Ndërkohë që në Londër ambasadorët e gjashtë Fuqive të Mëdha, sugjestionoheshin me idetë e madhësisë së kombit serb, të

⁶³ Vladeta Gjorgjeviç, *Arnauti i Velike Sile*, Beograd 1913, botimi në frengjisht *V.Georgievitch, Les Albanais et les Grandes Puissances*, Paris, 1913; Sekula Drleviç, *Ballkanski sukobi 1905–1941*, Zagreb 1941, f. 63; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (1912–1918)*, vëll II, Tiranë 1987, f. 28.

⁶⁴ Arben Puto, vep.cit. po aty.

⁶⁵ Arben Puto, vep.cit. po aty.

⁶⁶ Citohet nga Arben Puto, vep.cit. fq. 194-195, 216.

⁶⁷ Bedri Islami, *Kosova dhe Kadare*, Gazeta Dita, 6 qershor 2023.

vetëviktimizuar nga të ashtuquajturit invazione të shqiptarëve, u hodh në qarkullim edhe një literaturë e bollshme antishqiptare, denigruese, me frymë tepër agresive.⁶⁸

Gjenocidi, shpërnguljet, veprimet shfarosëse si pjesë e skenarit antishqiptar mbetën konstante e pandryshuar e politikës së Beogradit e Cetinës gjatë, në mbarim dhe pas Luftës së Parë Botërore, të cilën serbët e menduan si një oportunitet të përshtatshëm për arritjen e asaj çka nuk ishte realizuar ende nga *Naçertania* e 1844.⁶⁹

The Expulsion of the Albanians – Vaso Çubriloviç

Në 1937, del në skenë memorandum i “*Dëbimi (shpërngulja) i shqiptarëve*”, i prezantuar nën autoritetin e Akademisë Serbe të Beogradit, me emrin e të ashtuquajturit akademik Vaso Çubriloviç.⁷⁰ Ishte përgatitur për t’iu vënë në dispozicion qeverisë jugosllave të Milan Stojadinoviçit, së cilës iu dorëzua më 7 mars të atij viti. Propozohen metodat e përndjekjes dhe të dëbimit fizik të shqiptarëve nga Kosova për në Turqi dhe në Shqipëri. Është një platformë e përpunuar deri në

⁶⁸ Shih p.sh. V. Georgievitch *Les Albanais et les Grandes Puissances*, vep.cit. Balkanicus, *Le probleme albanais, la Serbie et l’Autriche-Hongrie*, Paris, 1913 – *Problemi shqiptar, Serbia dhe Austro-Hungaria*; J. Tomitch, *Les Albanais en Vieille-Serbie et dans le Sandjak de Novi-Pazar*, Paris 1913 – *Shqiptarët në Serbinë e Vjetër dhe në Sanxhak e Novi Pazar*: J.Cvijic, *Ballkanski rat i Srbija, Beograd, 1912*, - *Lufta ballkanike dhe Serbia*; J. Hadzi-Vasiljevic, *Juzna Stara Srbija*, Kniga 2, Beograd, 1912 - *Serbia e Jugut etj.* - Citoheh sipas Arben Puto, vep.cit, fq. 61.

⁶⁹ Më 21 maj 1919, në Konferencën e Paqes në Paris, u trajtua Raporti kolonelit Miles, i cili përshkruante masakrat serbe ndaj shqiptarëve në Malin e Zi, pasi ato ishin penguar dhe zona në fjalë ishte pastruar tërësisht nga shqiptarët dy muaj para se ai të shkonte në Malin e Zi. Sipas tij, provat e vetme të arritshme ishin ato të të debuarve shqiptarë pranë Shkodrës e deklaratimet e zyrtarëve serbë e malazeze.

⁷⁰ *1937, Vaso Cubrilovic: The Expulsion of the Albanians – Memorandum*, Taken from Iseljavanje Arnauta. Manuscript in the Institute of Military History of the Yugoslav People’s Army (Vojno Istorijski Institut JNA). Archives of the former Yugoslav Army (Arhiv Bivše Jugoslovenske Vojske), Belgrade, 7 March 1937, No. 2, Fasc. 4, Box 69, 19 pp. Retranslated from the Serbo-Croatian by Robert Elsie, on the basis of an existing English version. First published in R. Elsie, *Gathering Clouds: the Roots of Ethnic Cleansing in Kosovo and Macedonia*, Dukagjini Balkan Books (Peja 2002), p. 97-130.ç .

detaje për realizimin e spastrimit etnik të shqiptarëve, me synim zgjidhjen përfundimtare të “problemit shqiptar”. Dukej sikur Beogradi nuk dëshironte të rezervonte asnjë mundësi manovrimi, shfaqjesimi ose bishtnimi të përgjegjesisë për politikën mizore gjenocidale që kishte projektuar për të shfarosur shqiptarët. Aty shkruhej, e zeza mbi të bardhë, “në qoftë se supozojmë se *zhvendosja graduale e shqiptarëve* në kolonizimin tonë të vazhdueshëm është joefikase, atëherë ne na mbetet vetëm një rrugëdalje - që t’i *shpërngulim* ata në masë të mëdha”. Kjo platformë antishqiptare përkonte me pikëpamjet dhe qëndrimet e disa prej politikanëve serbë më ekstremistë, fashistë e nazistë, si Vojislav Marinković, kryeministër (1932-1934), Milan Stojadinović, Dimitrie Lotić.⁷¹

Manifesti antishqiptar i Çubriloviçit, mori fuqi juridike detyruese, sepse pjesë të rëndësishme të tij u kthyen në platformë institucionale dhe në legjislacion zyrtar nga ana e autoriteteve të Beogradit. Ai parashikonte ndër të tjera konfiskimin e tokave të shqiptarëve, vënien e tyre në kushte të rënda me qëllim që t’iu bëhej jeta e pamundur dhe të detyroheshin të shpërnguleheshin. Sërish motivi thuhej pa ndrojtje, nëse liheshin mund të bëheshin “një grup aktiv kombëtar, jashtëzakonisht i rrezikshëm për interesat tona (serbe) kombëtare dhe shtetërore”.⁷² Propozohej *kolonizimi* i Kosovës me 470 mijë kolonë, në të njëjtën kohë edhe *dëbimi i 300 mijë shqiptarëve* nga trojet e veta amtare, dënimi i tyre për kontrabandë, prerje pyjesh, dëme në ara, për qentë e palidhur, dëbimi nga puna shtetërore, private dhe të bashkësive, konfiskimi i kullotave, keqtrajtimi i klerikëve të tyre, shndërrimi i xhamive në stalla bagëtish, prishja e varrezave, vënia e zjarreve fshehurazi në lagje, fshatra, qytete etj.⁷³ Në zbatim të “*Dëbimit (shpërnguljes) të shqiptarëve*”, do të zyrtarizohej cilësimi i tyre si turq dhe do të organizohej dëbimi në Turqi, sipas “Konventës jugosllavo-turke”, nënshkruar më 11 korrik të vitit 1938.⁷⁴

E njëjta tablo u përsërit pas vitit ‘48, kur mijëra prej tyre, viktima të dhunës serbe dhe të zhgënjyer nga moszgjdhja e çështjes kombëtare, braktisën vendin dhe shkuan në mërgim.

⁷¹ Sami Arifi, *Projektet për shfarosjen e shqiptarëve në Jugosllavi*, Redaksia 2L ONLINE 17 Janar, 2018.

⁷² 1937, *Vaso Cubrilovic: The Expulsion of the Albanians – Memorandum*.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Sipas Akif Bajramit, midis viteve 1918-1941, u dëbuan në Turqi rreth 240 mijë kosovarë, të “shitur” si turq. Ato vazhduan me gjenocidin ndaj shqiptareve të mbetur ende në territoret e veta në Serbi, Vranjë, Leskovc, Sanxhak, Nish, etj.

Për përmasat e shpërnguljeve sistematike të shqiptarëve qarkullojnë versione të ndryshme. Thuhet, fjala vjen, se nga mesi i viteve '70 të shekullit të kaluar e deri në fillimet e këtij shekulli, nga Kosova janë larguar rreth 800. 000 vetë. Është një shpopullim, një ikje e përmasave të papara në Evropën e kësaj kohe. Politika e Beogradit e inkurajimit të emigrimit drejt vendeve perëndimore largoi nga vatrat amtare mijëra të rinj të Kosovës, që ndjeheshin të huaj në atdheun e vet. Të tjerë ikën për t'iu shpëtuar burgjeve dhe keqtrajttimeve.

Lufta e Kosovës, 1998-1999, edicion i gjenocideve të shkuara

Zjarri gjenocidist që ndezi Milosheviçi në kohën e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, sidomos në Bosnjë e Hercegovinë, ishte planifikuar të bartej drejt jugut, në Kosovë, ku do të shfaqej me pasoja shumë të rënda.

Akti më i fundit i deritanishëm, i skenarit antishqiptar të gjenocidit dhe spastrimit etnik, i zbatuar gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999 ishte përpunuar dhe realizuar në mënyrë gati identike si 150 vjet më parë. I tillë është vlerësuar edhe nga faktori ndërkombëtar. Dëshmohet pa vështirësi nga një dokument që mban datën 9 shtator 1999 dhe intesturën e OKB-së. Ai nuk lë asnjë pretekst për akuza për mungesë objektiviteti nga ana e palës serbe dhe protektorëve të saj. Nuk mund të atakohet as për proshqiptarizëm, sepse është përgatitur “flakë për flakë”, në kohën kur ngjarjet sapo kishin ndodhur dhe nuk ishte shumë e lehtë të fshiheshin. Veç kësaj, një ndër drejtuesit e grupit që punoi për identifikimin në vend të gjendjes dhe që hartoi Raportin, ishte çeku Jiri Dienstbier, i afërt dhe me lidhje me Beogradin.⁷⁵ Dokumenti në fjalë emërtohet *Raporti i Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut*

⁷⁵ Te Jiri Dienstbier dallohej një prirje antishqiptare, e shfaqur në mbrojtjen e palëkundur të Serbisë dhe të serbëve. Kadareja në shkrimin e botuar te *Le Monde*, më 14 dhjetor 1999, thoshte se gjyshi i tij, Emil Hajek, kishte ardhur nga Serbia, në vitet '30 të shekullit XIX dhe kishte themeluar Akademinë Muzikore. Së bashku me një pjesë të familjes së vet kishte jetuar në Çeki derisa vdiq. Vajza e tij e quajtur Anna Dienstbier, duhet të ishte e ëma e Jiri Dienstbierit. Të dhëna nga burime të tjera tregonin se një pjesë e rrethit të vet familjar jetonte e punonte në Serbi, duke pasur madje edhe pozita të rëndësishme në herarkinë zyrtare e partiake të Beogradit. Tezja e Dienstbier-it (motra e nënës) banonte në Beograd dhe ishte një ndër drejtueset kryesore të partisë së Mira Markoviç - Milosheviç, kurse burri i tezes mbante postin e kryeredaktorit të gazetës serbe *Politika*.

*mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë (Republika Federale e Jugosllavisë).*⁷⁶

Nëse këtij Raporti do t'i hiqej titulli, datat dhe emrat nuk do të ishte çudi që të mendohej se ai bënte fjalë për ngjarje të ndodhura në territoret shqiptare të Serbisë në periudhën midis Kongresit të Berlinit dhe Luftës së Dytë Botërore. Ai përmban një koleksion faktesh, ndodhish, krimesh të pakontestueshme, që ishin kryer nga serbët në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 dhe dëshmon se deri ku shkonte imagjinata institucionale, cinike dhe çnjerëzore e regjimit serb, e sistemit të organeve dhe organizmave shtetërorë e parashtetërorë dhe e disa mijëra njerëzve në shërbim të tyre.⁷⁷ Të inkuadruar në njësi ushtarake, paraushtarake e policore, si dhe në banda kriminelësh, të indoktrinuar fuqimisht dhe të ushqyer me shovinizëm, me ndjenjat e urrejtjes etnike e njerëzore, ata u bënë shprehës të instikteve kriminale dhe sjelljeve mizore ndaj shqiptarëve, me qëllimin e mbrapshtë, për t'i shfarosur, për t'ua marrë atdheun, tokën, shtëpinë, jetën. Midis rasteve të përmendura është edhe vrasja makabre e avokatit Bajram Kelmendi dhe dy djemve të tij. Thuhet se “zotit Kelmendi iu kërkua të vriste një nga djemtë e tij dhe kur ai nuk pranoi iu kërkua djalit të tij të madh që të vriste babanë, por ai gjithashtu refuzoi. Pastaj oficerët e policisë i kërkuan Bajram Kelmendit se cilin nga djemtë duhet të vrisnin të parin dhe me gjithë thirrjen e dëshpëruar të avokatit, qëlluan dy djemtë e tij dhe 30 sekonda më vonë, e qëlluan edhe atë.”⁷⁸

Raporti përmban episode të tjera, që sjellin ndërmend skenat e të kaluarës serbe antishqiptare, të cekura më sipër. Ato ngjajnë tërësisht me holokaustin nazist të Luftës së Dytë Botërore. Në të lexohet fjala vjen se “Në komunën e Gjilanit, më 6 prill, pesë burra që ishin kthyer

⁷⁶ QUESTIONS OF THE VIOLATION OF HUMAN RIGHTS AND FUNDAMENTAL FREEDOMS IN ANY PART OF THE WORLD, Report of the High Commissioner for Human Rights on the situation of human rights in Kosovo, Federal Republic of Yugoslavia. Economic and Social Council, Distr. General, E/CN.4/2000/10, 27 September 1999, Commission on Human Rights, Fifty-sixth session, Item 9 of the provisional agenda, Questions of the violation of human rights and fundamental freedoms in any part of the world. Raportin e lartpërmendur, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka, autori e ka përkthyer në shqip dhe e ka përfshirë gati integralisht në librin e vet, Ksenofon KRISAFI, NË GJENEVË PËR KOSOVËN, Fjalime në institucionet ndërkombëtare (1998-2002), UMSH/ /ONUFRI, Tiranë, 2018, f.179-263.

⁷⁷ Është për të ardhur keq që disa prej tyre, mbushur me mëkate të pashlyeshme njerëzore, vazhdojnë edhe sot të drejtojnë politikën dhe shtetin serb.

⁷⁸ Ksenofon KRISAFI, NË GJENEVË PËR KOSOVËN, Fjalime në institucionet ndërkombëtare (1998-2002), UMSH/ /ONUFRI, Tiranë, 2018, f.179-263.

në fshatin e tyre, u urdhëruan nga forcat paraushtarake të shtriheshin me fytyrë të mbuluar dhe më pas u qëlluan për vdekje. Në Smolusa (Smallushë) në komunën e Lipjanit, pas një raundi të parë të zhvendosjes së detyruar, një grup banorësh vendosën të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Grupet paramilitare dhe forcat policore u kthyen në fshat dhe i vranë. Ngjarje të ngjashme u raportuan në Viti (Vitina), Verban (Vërban, Viti-Kllokot) dhe Stagova (Stagovo). Në fshatin Gladno Selo (Gllansellë), komuna e Glllogocit (Drenasit), paraushtarakët iu vunë zjarrin shtëpive duke vrarë kështu më shumë se 45 civilë, kryesisht gra të moshuara. Në Suharekë, gjatë zhvendosjes janë vrarë deri në 350 civilë. Në Prishtinë, ndërsa i shtynin njerëzit drejt stacionit hekurudhor, policia vrau disa civilë. Në Grashticë, 30 të rinj u nxorën jashtë një karvani dhe u vranë. Në Kralan, dy grave të plagosura iu kërkua të zbrisnin nga një traktor dhe meqenëse ato, për shkak të lëndimeve që kishin marrë nuk mundën, u dogjën të gjalla në traktor. Në Koliq, forcat serbe hapën zjarr drejt një grupi të IDPs, duke vrarë 91 prej tyre. Në fshatin Vrbovac, komuna e Glllogocit, pas tërheqjes së UÇK-së, një grup prej rreth 50 civilësh u kapën, u urdhëruan të mblidheshin në rresht, u torturuan dhe u pushkatuan nga forcat paraushtarake. Në Skënderaj (Srbicë), pas ofensivës së UÇK-së dhe tërheqjes pasuese, u vranë 5 burra të moshuar. Në Pusto Selo (Pastasel) pas luftimeve midis UÇK-së dhe serbëve në zonë, forcat serbe dyshohet se, pasi poshtëruan dhe i keqtrajtuan 106 persona, i pushkatuan. Në fillim të prillit policia është parë të transportojë rreth 40 trupa në Fushë-Kosovë. Grupe paraushtarakësh dhe disa romë janë parë në Kaçanik të hapnin gropa me buldozerë, pas masakrës në “përroin e Reçakut”. Në Sllovi, komuna e Lipjanit, forcat serbe varrosën 16 trupa dhe një ditë më pas urdhëruan të afërmit e të ekzekutuarve që t’i zhvarrosnin trupat dhe t’i rivarrosnin në një varrezë. Dyshohet se romët varrosnin trupat e shqiptarëve të Kosovës të ekzekutuar në Rezallë, komuna e Skënderajt, pasi ishin zhvarrosur nga forcat serbe.⁷⁹

Në Raport pohohet gjithashtu se “*raportohet që mercenarët rusë kanë qenë të pranishëm dhe aktivë në Kosovë në anën e forcave serbe. Rusët ishin të pranishëm edhe në vende të tjera, në Glllogoc, Gjakovë, Skënderaj - korsivi i autorit.*⁸⁰

Gratë dhe fëmijët ishin viktimat të vrasjeve dhe ekzekutimeve.⁸¹ (Ata) janë ndarë nga të afërmit meshkuj dhe janë ekspozuar ndaj

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Po aty.

keqtrajttimeve brutale. Për më tepër, duket se djemtë e rinj të dyshuar si pjesëtarë të UÇK-së janë marrë në pyetje, janë torturuar dhe ndonjëherë janë vrarë pa marrë parasysh moshën e tyre. Katërmbëdhjetë persona të intervistuar folën për përdhunimin e konfirmuar ose të dyshuar dhe për shumë raste të dhunimeve seksuale. Duke pasur parasysh mentalitetin e lidhur me dhunën seksuale në kulturën shqiptare, është e arsyeshme të supozohet se numri i incidenteve të kësaj natyre mund të jetë më i lartë sesa rastet që pasqyrohen në raportet publike. Në Çirez, ku ishin zhvendosur gra dhe vajza të reja, u morën për një natë nga ushtarët e ushtrisë. Në raste të tjera, gratë janë marrë dhe janë përdhunuar nga ushtarët serbë që kanë sulmuar grupet e personave të zhvendosur, shumë paraushtarake hipën në tren dhe përdhunuan 10-15 vajza të reja para të gjithëve, duke përfshirë fëmijët e vegjël. Dhunimet e grave e të vajzave shqiptare, nuk ishin akte të rralla e të izoluara, por pjesë e skenarit për vrasjen dhe zhdukjen e një populli të tërë. U përdorën si arsenal luftime, instrument dhune për spastrimin etnik sistematik. Juridikisht ishin krime kundër njerëzimit⁸².

Sipas njoftimeve të shumta, duket se ka pasur sistematikisht raste të gjymtimit të grave, të cilave u janë prerë veshët dhe gishtërinjtë. Në Gladno Selo (Gllanasellë), për shembull, kur u sulmua fshati, shumë gra u vranë dhe iu prenë veshët. Në këtë fazë është e vështirë të përcaktohet nëse ky ritual makabër kishte një domethënie të veçantë ose ishte një akt i thjeshtë sadizmi.”⁸³

Sipas Raportit, zhvendosja dhe dëbimi i shqiptarëve etnikë nga Kosova, si raste të spastrimit etnik dhe veprimet e gjenocidit të ndërmarra nga ana e forcave serbe, kanë “ndodhur në një klimë paligjshmërie dhe shpërfilljeje totale të jetës dhe dinjitetit njerëzor, që rezultoi me një nivel jashtëzakonisht të lartë të dhunës... (dhe) janë kryer ekzekutime pa dallim ndaj civilëve, kryesisht nga forcat e policisë dhe ato paraushtarake.”⁸⁴

⁸² Në krimin kundër njerëzimit bëjnë pjesë vrasja, shfarosja, marrja rob, dëbimi, burgosja, torturimi, dhunimi, ndjekja mbi baza politike, racore e fetare dhe veprimet e tjera jonjerëzore. Në luftën e Kosovës ato u shfaqën në formën e dëbimit të popullatës, masakrave, spastrimit etnik, dhunimeve, plaçkitjeve, helmimit të puseve, fshehjes së kufomave, fshirjes së identitetit, keqpërdorimit të civilëve dhe punës së dhunshme, shkatërrimit të vendbanimeve dhe minimit të terrenit. Të gjitha ata ishin pjesë e një skenari të përgatitur dhe realizuar nga një kompleks organesh dhe institucioneve politike, ushtarake, juridike, gjyqësore, diplomatike, akademike, shkencore, kulturore deri edhe klerikale etj.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty.

Për të zbatuar kriteret e “objektivitetit” dhe të paanësisë false, në pjesë të caktuara të Raportit, janë pasqyruar edhe disa raste ekcesesh, abuzimesh ose krimesh të kryera nga ana e individëve, të konsideruar pjesëtarë të shumicës shqiptare ndaj serbëve, romëve dhe bashkësive të tjera etnike. Parë në tërësinë e tyre dhe krahasuar me “Golgotën” serbe në Kosovë, duket se te ndonjë prej hartuesve të Raportit, ekzistonte prirja për të ndërtuar simetri fiktive. Rasteve të abuzimeve të shqiptarëve, natyrisht të palejueshme nëse kanë qenë të vërteta, iu është mëshuar me tepri të skajshme. Theksimi, rritja në numër dhe shumëfishimi i veprimtarive antiligjore të supozura si të kryera prej shqiptarëve, nuk është bërë rastësisht. Qëllimi ka qenë të zbehen krimet serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, të minimizohen si numër dhe si shkallë mizorie dhe mundësisht të harrohen. Ato të kujtojnë përpjekjet e bëra në shumë raste nga Jiri Dienstbier, raportuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB për Jugosllavinë, i cili, siç është vënë në dukje edhe në fjalimet dhe ndërhyrjet zyrtare të përfaqësuesve të shtetit shqiptar në forumet e KDNj, dilte në rolin e avokatit të flaktë të Serbisë dhe të serbëve.

Fushata e spastrimit etnik të Kosovës, metodat fashiste të përdorura nga regjimi i Milosheviçit në Kosovë dhe ndërhyrja e NATO-s, janë analizuar edhe nga G. Stoessinger, i cili Serbinë e Milosheviçit, e krahason me Gjermaninë e Hitlerit.⁸⁵

Timothy Garton Ash, shkruan “Milosheviçi si Hitleri: Epo, jo saktësisht. Milosheviçi është lideri më i rrezikshëm evropian i viteve 1990. Ai është një kërcënim, një bandit, një horr postkomunist që ka manipuluar në mënyrë cinike nacionalizmin. Ai ka gjak në duart e veta. Por shteti i tij nuk ka as fuqi dhe as vullnet ideologjik për të pushtuar Evropën. Ndërsa Gjermania nën Hitlerin u bë gjithnjë e më e madhe, Jugosllavia nën Milosheviçin është tkurrur. Elementi i së vërtetës në këtë analogji është pika e Presidentit Clinton për zbutjen: sa më gjatë të shtyni qëndrimin ndaj diktatorëve agresivë, aq më i lartë është çmimi. Nëse do ta kishim quajtur blofin e Hitlerit kur ai rimilitarizoi Rheinland në 1936, mund të ishin kursyer 50 milionë jetë. Nëse do të kishim qëndruar kundër Milosheviçit kur forcat e tij rrethuan qytetin kroat të

⁸⁵ Nga egërsia naziste e Hitlerit, duket se Milosheviçit i munguan vetëm dhomat e gazit të Aushvicit dhe Birkenaut, të cilat i kompensoi me përdorimin e furrënantave si varreza kolektive dhe në vend të hebrenjve pati myslimanë.

Vukovarit në vjeshtën e vitit 1991, ndoshta një çerek milionë burra, gra dhe fëmijë mund të ishin ende gjallë. Por ne - evropianoperëndimorët dhe amerikanët - nuk e bëmë, dhe kështu ne tani përballemi me perspektivën e.....⁸⁶

Naçertania & *The Expulsion of the Albanians* sërish në fuqi

Terrorizmi i organizuar shtetëror dhe dhuna e përditshme nga ana e autoriteteve serbe në vitet 1998-1999, e çoi popullin e Kosovës në kufijtë ekstremë të ekzistencës. Qeveria e Beogradit veç dëbimit të rreth një milion shqiptarëve, vrau e masakroi më shumë se 12 mijë persona, burgosi, torturoi, dhunoi e përdhunoi mijëra të tjerë, dogji e shkatërroi dhjetëra mijëra shtëpi e ekonomi bujqësore, me shpresën se do ta zhbënte përfundimisht Kosovën.

Shpërnguljet ose dëbimet e shqiptarëve të Kosovës, nuk mbaruan as në 1999, kur nga territori i Kosovës u larguan serbët dhe u suprimua pushteti i tyre gjenocidist antishqiptar. Vazhdojnë edhe sot e kësaj dite në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, me të famshmin proces të spastrimit të listave.

Ajo vazhdon sepse, në disa qarqe politike si dhe në të drejtën ndërkombëtare, kjo nuk quhet me emrin e vërtetë “gjenocid”.

Gjithçka u përmend më sipër, ndoshta me tepri, por jo pa qëllim, mund të shërbente thjesht si një narrativë e zakonshme me karakter historik. Ajo do ta përmbushte misionin e vet për pasqyrimin shkencor të të vërtetave objektive të së shkuarës, pavarësisht nga realitetet e trishta që përcjellin në ditët e sotme. Mjerisht kjo e shkuar, nuk ka qenë e mundur të harrohet, sepse përsëritet pafundësisht duke mbërritur pothuajse i njëjtë deri në ditët tona. Ritualit gjenocidist, i përzgjedhur për realizimin antiligjor të zmadhimit territorial nga ana e fqinjëve, ka hyrë tashmë në arsenalin e tyre politik, ushtarak e juridik dhe prodhon jo vetëm viktima, por edhe paqëndrueshmëri politike rajonale dhe probleme permanente për paqen dhe sigurinë.

Çështja për të cilën po flitet, e përfytyruar në një mjedis kombëtar dhe në një kohë tjetër, do të paraqiste *à priori* vështirësi jo të pakta për

⁸⁶ Timothy Garton Ash, - *The new Adolf Hitler?* TIME magazine, CNN/All Politics with Congressional Quarterly, march 29, 1999.

t'u trajtuar me profesionalizëm, përgjegjshmëri politike dhe "drejtësi morale", nëse mund të flitet për ekzistencën e një të tillë. E gjykuar juridikisht me aparenca paanësie dhe objektiviteti, do të përballohej me domosdoshmërinë e prezantimit të provave dhe argumenteve juridike dhe formalisht ndoshta mund të ishte e vështirë për t'i klasifikuar si gjenocid krimet serbe në Kosovë. Por ndërgjegjja e cilitdo që do të merrej me këtë çështje, do të lehtësohej nëse do të hiqte dorë për një çast nga dogmatizmi formal juridik, ndonjëherë asfiksues.

Arsyetimi nëse krimet serbe në Kosovë morën apo jo format e gjenocidit, mund të vazhdohet duke iu drejtuar kodeve penale të shteteve. Ata, si rregull, vrasjen e një individi e ndëshkojnë me dënime nga më të zakonshmit deri te më ekstremet. Ndërsa në praktikën e disa shteteve dhe të gjykatave ndërkombëtare, për krimin si gjenocid, gjenden vendime që do të ishte shumë pak të quhen cinike dhe qesharake. Sepse të akuzuarit për vrasjen e mijëra e qindra mijëra njerëzve të pafajshëm, janë dënuar me disa vjet heqje lirie. Shembulli vjen që prej Luftës së Dytë Botërore, e cila nuk ka precedent në histori. Në mbarim të saj, vetëm disa dhjetëra, ndoshta qindra vetë, u dënuan me vdekje ose me heqje lirie. Por, vdekja ose heqja e lirisë së tyre nuk vlen kurrë dhe as e zbut dot dhimbjen që shkakton vdekja ose gjymtimi i më shumë se 50 milionë vetëve, që ishte bilanci tragjik i saj.

Është e vërtetë që çështja e kualifikimit juridik të gjenocidit serb në Kosovë, nuk është e lehtë të bëhet, nëse insistohet që të kërkohen dhe të argumentohen të gjithë elementët e parashikuar formalisht si pjesë e veprës penale. Por, cilësimi nuk mund të bëhet mekanikisht, duke mbyllur sytë, duke abstraktuar nga realiteti historik dhe aktual i raporteve serbo-shqiptare, si dhe nga bilanci tragjik që u ekspozua përmbledhtas në faqet e mësipërme.

Si gjithmonë edhe në vitet 1989-1999, Beogradi vuri në veprim mekanizmat e shfarosjes së bashkësisë kombëtare shqiptare, nëpërmjet vrasjeve masive dhe individuale, torturave fizike e psikike, shpërnguljeve të dhunshme, përdhunimeve seksuale, vendosjes së popullsisë civile në kushte që shkaktonin vdekjen (katastrofën humanitare), parandalimin e qëllimshëm të plotësimin të nevojave shëndetësore, ndarjen e dhunshme të fëmijëve nga prindërit e tyre, ndryshimi i përbërjes demografike etj, juridikisht nuk janë gjë tjetër veçse gjenocid. Ishin pjesë e strategjisë politike të Beogradit, që të shkatërrohej plotësisht ose pjesërisht, identiteti dhe ekzistenca e shqiptarëve në territorin e Kosovës.

Ekspozeja e tablosë rrëqethëse të krimeve makabre sistematike të Serbisë në Kosovë, e bën të panevojshme qëmtimin e hollësive të tjera

rreth qëllimit të shprehur, që të provojnë formalisht gjenocidin.⁸⁷ Mijëra viktimat e barbarisë serbe në Kosovë, krimi mizor i gjenocidit dhe jo vetëm atij, janë shprehje të së vërtetës së trishtë që Serbia është shndërruar në sinonim të gjenocidit dhe të spastrimit etnik.

Shkaqet e gjenocidit serb kundër shqiptarëve

Ata që janë në krye të shteteve dhe që me veprimet ose mosveprimet e tyre shkaktojnë vdekjen e shtetasve të vet ose të shteteve të tjerë, mundohen të pastrojnë ndërgjegjen duke inskenuar motive. Kështu ka ndodhur edhe me Serbinë. Për ta institucionalizuar juridikisht platformën e gjenocidit antishqiptar, serbët përpunuan dhe përhapën edhe disa pseudoshkaqe, që në fakt janë shpifje dhe fyerje të ulëta. Janë “preambula” e të gjitha platformave antishqiptare të hedhura në qarullim për indoktrinimin e opinionit dhe frymëzimin e falangave serbe të krimit. Nuk mund të ketë asnjë shkak që të përlligjë jo më vrasjen e një populli të tërë, por as edhe të një individi të vetëm. Prandaj, bota e qytetëruar e ka nxjerrë me kohë jashtë ligjit luftën si mjet të zgjidhjes së konflikteve. Madje ajo nuk përlligj as vrasjen e keqbërësit, cilido qoftë ai dhe cilido qoftë vepra penale që ka kryer. Është kjo arsyeja pse në shumicën e vendeve vdekja është përjashtuar nga lista e llojeve të dënimit penal.

Mirëpo, në shoqërinë njerëzore, pavarësisht nga progresi i pamohueshëm që është bërë, mohimi i padrejtë i jetës, vazhdon të ekzistojë, sepse ekzistojnë luftërat ndërmjet shteteve, ekzistojnë legjislacione kombëtare, që vazhdojnë të mbajnë ende në kodet e tyre penale dënimin me vdekje etj.

Shkaqet e përdorura rëndom nga Beogradi për ta mashtruar botën për krimin e vet sistematik ndaj shqiptarëve, nuk kanë të bëjnë as me nxjerrjen e luftës jashtë ligjit as edhe me heqjen nga legjislacioni penal të dënimit me vdekje. Janë shkaqe të tjera, realisht të paqena, që kanë të bëjnë me thelbin e politikës tradicionale serbe dhe raportet me fqinjët.

Së pari, janë përmendur etiketimet negative ndaj shqiptarëve, të përhapura nëpërmjet një propagande intensive për ngritjen nga hiçi të

⁸⁷ Një arsye tjetër ka të bëjë me faktin se është pothuajse e pamundur hyrja e studuesve në dosjet e gjenocidit serb ndaj shqiptarëve në arkivat e Beogradit, për sa kohë që në pushtet vazhdojnë të jenë pasuesit dhe bashkëpunëtorët e Milosheviçit, Aleksandër Vuçiçit, Ivica Daçiçit etj. Atyre nuk iu intereson qasja në arkivat serbe e të tjerëve që mund të ekspozojnë provat e fajësisë së tyre.

një skenari, ku spikat urrejtja dhe veprimtaria, krejt të pavërteta, të shqiptarëve ndaj serbëve. “Që të shpëtojë” Serbia dhe Ballkani këta “njerëz të këqij” duhen zhdukur.

Së dyti, vjen pretendimi se veprimet antishqiptare të Beogradit ndaj shqiptarëve kanë qenë “të imponuara” për të mbrojtur pakicën serbe në Kosovë, e cila, siç thuhet nga Serbia, nuk gëzon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Edhe ky nuk është shkak, por pretekst pa mbështetje, sepse pakica serbe në Kosovë i gëzon të drejtat dhe liritë e njeriut më shumë se çdo pakicë tjetër në botë. Megjithatë, serbët me këtë pretekst fals kanë siguruar mbështetjen e pakushtëzuar të ndër-kombëtarëve, jo vetëm për t’i shpëtuar ndëshkimeve për krimet e kryera, por edhe për të imponuar si *conditio sine quoi non*, kërkesën për krijimin e të ashtuquajturit *Asociacion të komunave me shumicë serbe* në Kosovë, si diversion permanent ndaj shtetshmërisë së Kosovës. Insistimi nuk ka të bëjë me interesimin e sinqertë të Beogradit për pakicën serbe në Kosovë, por me planin e tij strategjik të integritit gradual të Asociacionit në të ashtuquajturën *Bota serbe*.

Në këtë mënyrë skifterët e shovinizmit të *Botës serbe* synojnë të realizojnë ëndrrën e tyre, zhdukjen e shqiptarëve nga Kosova, e cila, siç pohon shkrimtari Matija Beqkoviç, “për mendësinë serbe... është fjala më e shtrenjtë”. Vuk Drashkoviçi shkon edhe më tej në falsitet, duke thënë se “kjo fushë për shqiptarët është gjeografi, kurse për serbët gurra e kulturës së tyre, epi dhe Feja, Alfa dhe Omega e ekzistencës së tyre”.⁸⁸

Megjithatë, në propagandën si dhe në terrin obskurantist anti-shqiptar që ka kapluar politikën serbe, nuk mungojnë zërat që guxojnë të thonë të vërtetën. Një prej tyre është studiuja serbe Olivera Milosavljeviçi,⁸⁹ e përmendur sidomos për qëndrimet kritike ndaj historio-grafisë bashkëkohore serbe dhe prekjen e miteve kombëtare të historisë serbe. Ajo shkruan se “me politikën pushtuese të qeverisë serbe ndaj arbanasve, në kufirin perëndimor të Serbisë janë krijuar marrëdhënie të tilla që në të ardhmen e afërt vështirë se mund të pritet paqe dhe gjendje e qëndrueshme. Shtypi ynë, në një garë katastrofale për të ndihmuar një politikë të referuar dhe ekzekutuar në mënyrë të neveritshme, me muaj dhe vite ka përhapur mendime tendencioze për arbanasit. Ky është edhe sot mjeti i vetëm me të cilin shtypi shovinist krijon te populli serb urrejtjen ndaj arnautëve “të egër”, duke fshehur, si nepërka këmbët e

⁸⁸ Bedri Islami, Kosova dhe Kadare, Dita, 6 qershor 2023.

⁸⁹ *Historiana serbe 'trondit' Serbinë me këtë deklaratë për shqiptarët*, VOAL, Voice of Albanians, September 21, 2017. ZgjuhuShqiptar.info.

egërsirës, atë që populli serb ka bërë ndaj tyre.⁹⁰ Mjaft me gënjeshtër, thotë ajo, shqiptarët janë autoktonë.

Masakra e Reçakut gjenocid i mirëfilltë

Pavarësisht nga mënyrat brutale apo të rafinuara të përdorura nga Beogradi dhe aleatët e tij, për të mohuar ose justifikuar gjenocidin dhe krimet e luftës në Kosovë, nuk kanë munguar asnjëherë provat dhe dëshmitarët okularë. Për shembull, për një nga krimet e para të periudhës së luftës së Kosovës, 1998-1999, posaçërisht për masakrën e Reçakut, ka një dëshmitar veçanërisht të kualifikuar dhe tërësisht të paanshëm. Është dëshmitari okular, Uilliam Uoker, i cili, pas asaj që pa, ngriti në këmbë opinionin publik botëror, alarmoi politikën në të gjitha skajet e rruzullit dhe kërkoi dënimin e ashpër të kriminelëve që strehoheshin në Beograd. Ai pohoi se “ajo që pashë më bën ta përcaktojë pa ngurrim këtë rast si masakër, si krim kundër njerëzimit”.⁹¹

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ *Koha net*, 15 janar 2023, Walker: Masakra e Reçakut bëri botën ta kuptonte se çfarë po ndodhte në Kosovë. Walker ka thënë se Masakra e Reçakut ishte moment kthese për Kosovën. “Jo se ishte masakra e parë apo e fundit në këtë vend, por, për një numër arsyesh, gjërat u bënë bashkë. Ditën tjetër e gjithë bota kuptoi për Reçakun. Ishte në ballinat e të gjithë botës. Në Serbi, Qeveria e Beogradit e z. Milosheviç dhe z. Vuçiç, nisën të bëjnë gjërat që të kujdeseshin që bota të mos dëgjonte për Reçakun apo ta pranonte versionin e tyre. Por, falë Zotit kjo nuk ndodhi. Mediumet botërore erdhën, transmetuan pamjet e asaj që po ndodhte në Kosovë, e si rrjedhojë erdhi intervenimi i NATO-s. Edhe pse nuk jam jurist, ajo që pashë më bën ta përcaktoj pa ngurrim këtë rast si masakër, si krim kundër njerëzimit”, deklaroi Walkeri në konferencën e tij për shtyp.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në përvjetorin e 24-t të masakrës së Reçakut, tha se autori i saj, Serbia, vazhdon të shfaqë narrativa mohuese, duke tentuar ta falsifikojë rolin e saj dhe bashkëpunëtorë të tjerë të tij, që e mohojnë gjenocidin, ëndërrojnë përsëritjen e tij. Por krimi kundër njerëzimit, i kryer në fshatin Reçak të Shtimes, më 15 janar të vitit 1999, nuk mund të fshihet, as të mjeçullohet dhe as të amnistohet”. Më 5 dhjetor 2019, Aleksandar Vuçiç, presidenti aktual i Serbisë, që atëbotë ishte ministër i Informativë, ka deklaruar se masakra e Reçakut ishte fabrikim dhe falsifikim. Ai që dikur ishte zv.president i gruas së Milosheviçit e më pas edhe ministër i Punëve të Brendshme, ndërsa sot shef i inteligjencës së shtetit serb, saktësisht me datë 10 dhjetor 2021, në ditën e të drejtave universale ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e përsërit atë që e thotë presidenti i Serbisë. Ata që e mohojnë gjenocidin, ëndërrojnë për përsëritjen e tij”, ka thënë Kurti.

Kurti ka theksuar se “duke u thirrur në dëshmitë e kohës, në deklaratat e 63 dëshmitarëve të intervistuar dhe në provat e Tribunalit të Hagës, Prokuroria e Kosovës ka lëshuar fletarreste ndërkombëtare për 18 persona, serbë, që dyshohen

Masakra u cilësua e tillë edhe në dokumentet e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, si dhe në tekstin e aktakuzës kundër Milosheviçit, Milutinoviçit, Shainoviçit, Ojdaniçit dhe Stojkoviçit, të akuzuar për krime kundër njerëzimit, shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës.

Zbulimi i mënyrës çnjerëzore të masakrës së Reçakut, e detyroi Beogradin të gënjente trashë duke pohuar se e kishte kryer vetë UÇK-ja, e cila “i kishte veshur viktimat e saj me rroba civile, në mënyrë që ta mashtronte opinionin publik ndërkombëtar”. Ai arriti deri në absurd duke pretenduar se në të kishte marrë pjesë edhe William Walker si bashkëpunëtor i CIA-s. Këtë mashtrim ai do ta hidhte poshtë një vit më pas, duke thënë se “Këto teori kompleti, të gjitha së bashku, janë një marrëzi e kulluar.”⁹²

Bashkësia ndërkombëtare, e cila për vlerësimin e ngjarjes së Reçakut, u mbështet në deklaratat zyrtare të OSBE-së, shprehu indinjatë dhe neveri ndaj veprimit të forcave serbe. Por ajo nuk ishte as e para dhe as e fundit masakër, krim ndërkombëtar dhe akt i padyshimtë gjenocidi. Ajo ishte një ndër edicionet më të fundit të krimeve antishqiptare që kishin nisur që kur sllavët vunë për herë të parë këmbët në Ballkan dhe në trojet e shqiptarëve.

Beogradi e ka pranuar gjenocidin antishqiptar

Përfaqësuesit e gjenocidit serb, delinkuentë të përhershëm, nuk janë treguar konsekuentë në gënjeshtat e shpërndara për të mohuar ose përligjur krimet që kanë bërë. Pak më sipër u tha se serbet ia faturuan UÇK-së masakrën e Reçakut dhe më pas amerikanit Walker, që guxoi

për pjesëmarrje në kryerjen e masakrës së Reçakut”. Ai shtoi se shteti i Kosovës nuk i amnistion kriminelët e as nuk i harron krimet e luftës. “Kufomat e më të dashurve tanë të 15 janarit 1999 u mbrojtën edhe nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës sepse ne e dimë që pasi na vrisnin civilët dëshironin t’i rrëmbenin kufomat, i kemi edhe 11 ushtarë të UÇK-së të vrarë duke i mbrojtur kufomat e 45 civilëve”, ka thënë Kurti. Presidentja Vjosa Omani, deklaroi se institucionet e Kosovës e kanë detyrim për të siguruar drejtësi për të gjitha viktimat gjithandej Kosovës. “Historia e gjithsecilit prej tyre është histori e vetë Kosovës”. Ende nuk dihet fati i më shumë se 1600 të zhdukurve me dhunë në Kosovë gjatë luftës. “Serbia e presidentit të sotëm Vuçiç, që ishte ministër i Propagandës, i mban të fshehta të dhënat, duke dëshmuar se asnjëherë nuk ka ndryshuar as mendësi dhe as qëllim”. Ka tendenca të mëdha nga Serbia për të falsifikuar historinë tha Osmani.

⁹² *Berliner Zeitung*, 8.4.2000.

dhe tha të vërtetën. Herë të tjera kanë pretenduar se në rastet kur, *in extremis* mund të kenë kryer “ndonjë” akt gjenocidi, kanë qenë të detyruar për t’u mbrojtur nga “gjenocidi” i shqiptarëve, që ekziston vetëm në fantazinë e tyre perverse etj.

Verbëria antishqiptare, instiktet kriminale, ideologjia dhe politika e tyre ekspansioniste në Kosovë, e bëjnë të panevojshme për të rrëmuar në arkiva e biblioteka. Sepse janë vetë udhëheqësit kryesorë të shtetit serb që, jo vetëm pohojnë autorësinë e gjenocidit dhe çdo krimi që ata kanë bërë, por nuk e kanë problem të shpjegojnë se, nëpërmjet krimeve të gjenocidit, spastrimit etnik, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, kanë dashur të realizojnë pikërisht zbrazjen e plotë të trojeve shqiptare, ato që deklarorin dekada më parë, princi Millan, Nikolla Pashiç, Vaso Çubriloviç etj. Këtë ia konfirmoi haptas gjeneralit Wesley Clark, personifikimi i gjenocidit serb, Milosheviçi, duke thënë që “nëse ju na lini, ne do t’i vrasim të gjithë shqiptarët ashtu siç i vramë më 1946”.⁹³ I ndodhur në krye të një shteti gjithë mëkate, nuk e ka problem jo vetëm të pohojë se do të vazhdojë vrasjet e shqiptarëve, por edhe të konfirmojë se këtë gjë paraardhësit e tij e kanë bërë edhe më parë, duke përmendur vitin 1946. Bashkëpunëtori i tij, zëvendëskryeministri, Vojislav Sheshel, thoshte: “Nëse NATO-ja vendos të na bombardojë, nëse Amerika vendos të vazhdojë me këtë agresion, serbët do të vuajnë, por në Kosovë nuk do të ketë më shqiptarë”.⁹⁴ Si një ndër arkitektët e shovinizmit dhe gjenocidit serb, ai përmendet edhe për formulimin e parimit: “Aty ku ka varre serbe, duhet të jetë tokë serbe”.⁹⁵

Deklarimet e mësipërme, që vijnë nga goja e një prej drejtuesve më të lartë të shtetit, janë një tjetër argument për të kuptuar thelbin gjenocidal të politikës serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, të realizuara në aksionet për dëbimin dhe shkatërrimin e tyre, siç është shprehur ish-Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan⁹⁶.

⁹³ Sipas dëshmisë së Wesley Clark në Tribunalin e Hagës, - “*Waging Modern War-Bosnia, Kosovo, and the Future of Conflict*” – September 21, 2002 by Wesley Clark.

⁹⁴ *Vojislav Shesheli: Nxitësi i venitur për një “Serbi të madhe”,* Marija Ristic, Belgrade, BIRN March 29, 2016.

⁹⁵ Po aty.

⁹⁶ Kofi Anan thotë se “fushata (serbe) para së gjithash kishte qëllim të largojë dhe të vrasë sa më shumë shqiptarë të Kosovës”. Bashkësia ndërkombëtare, e ndodhur përballë politikës agresive të Milosheviçit, u vu në mbrojtje të popullsisë civile, për të cilën flet edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, në librin - “*Interventions: A Life in War and Peace*”, Penguin Books, 2012.

Simetria e pakuptimtë, Serbia agresore vs Kosova viktimë

Ka kohë që vazhdon gjykimi i udhëheqësve të ish UÇK-së në Dhomat e Specializuara për Kosovën, në Hagë. Ajo kërkon prova se ata dhe njësitë e komanduara prej tyre, kishin shkelur normat e së drejtës humanitare dhe kishin kryer krime lufte dhe gjenocid, për të cilat duhet të mbanin përgjegjësi. Injorohej fakti që UÇK-ja nuk ishte strukturë institucionale e ndonjë shteti. Nuk ishte as aksiomë terroriste me theks islamik, siç cilësohej nga institucionet politike dhe mediatike të shtetit serb.

Luftëtarët e UÇK-së, me mbështetjen dhe ndihmën e fuqishme të NATO-s, SHBA-së, BE-së dhe faktorit ndërkombëtar në përgjithësi, luftuan për çlirimin e atdheut nga okupatori serb. Prandaj, qoftë edhe për këtë fakt, nuk mund të barazohen një shtet shekullor, me institucione, ushtri, polici, gjykata, legjislacion, staf, buxhet etj, dhe mbi të gjitha me një të kaluar të përgjakshme, nga njëra anë me një strukturë tejet të brishtë, siç ishte UÇK-ja. Ajo u krijua spontanisht si formacion vullnetar, shprehje e revoltës dhe masave të vetëmbrojtjes së ligjshme të shqiptarëve të pafajshëm, e mobilizuar dhe e organizuar për t'i bërë ballë tërbimit shovinist serb, nga ana tjetër. Sepse “kur një popull ndodhet në gjendjen e një grigje të pambrojtur përballë ujkut, ëndrra e tij më sublime është shfaqja e një shpëtimtari, e një dalzotësi. Kur populli i Kosovës u gjend

Duke rikujtuar agresionin e Serbisë ndaj Kosovës, Kofi Annan, shprehet se qysh në vitet 1980, ishin një varg aktesh represive që po kryheshin në kuadrin e gjenocidit të heshtur ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në procesin gjyqësor në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, pala kosovare deklaroi se vetëm gjatë viteve 1990-1995 më shumë se 133 mijë shqiptarë u dëbuan nga vendet e tyre të punës, 25 mijë vetë u dëbuan nga shtëpitë dhe bizneset e tyre u plaçkitën, u vodhën ose u dogjën, 20 mijë u keqtrajtuat, u burgosën ose u bënë objekt të keqtrajtimit, rreth 2 mijë u vranë dhe më shumë se 250 mijë të tjerë emigruan në shtetet e Evropës Perëndimore për shkak të rrezikimit të ekzistencës dhe të mbijetesës. Ndërsa ndalimi i shkollave, gazetave, radio-televizioneve kombëtare kishte për qëllim shkombëtarizimin, përkatësisht zhdukjen e identitetit kombëtar. Beograd bëri përpjekje edhe për ndryshimin e mjedisit fizik, duke shkatërruar çdo dëshmi dhe prani të monumenteve kulturore dhe të një civilizimi joserb. Shkatërrimi sistematik i xhamive ose kishave katolike ishte një veprim i planifikuar që të asgjësonte praninë e gjatë me shekuj të shqiptarëve; shkatërrimin e bibliotekave, shkollave, si dhe të objekteve të ndryshme të trashëgimisë kombëtare shqiptare kishte për qëllim asgjësimin e një kulture, e cila është ruajtur përmes komponentëve kombëtarë të popullsisë. Kjo fushatë, në të cilën shqiptarët jetonin në një sistem apartheidi, synonte të shkatërronte ekzistencën e shqiptarëve dhe kulturën e tyre. Human Rights Watch, në një raport të pasluftës, konstaton se shkatërrimi i pronës civile nga trupat e qeverisë jugosllave/serbe në 1999, ishte i përhapur gjithandej. Duke cituar një sondazh të UNHCR-së të nëntorit të vitit 1999, raporton se pothuajse 40 për qind e të gjitha shtëpive të banimit në Kosovë janë dëmtuar rëndë ose janë shkatërruar plotësisht.

kështu, grigjë e pambrojtur përpara kasapit serb, UÇK-ja u bë dalzotëse e saj. Askush s'mund t'ia heqë dot kurrë asaj emrin e madh dalzotës".⁹⁷

UÇK-ja, brenda mundësive dhe kushteve në të cilat veproi, zbatoi rregullat e zhvillimit të luftës me agresorin e vendit të vet. Ishin njësitet e ushtrisë dhe policisë së agresorit ato që duhet të zbatonin rigorozisht normat që buronin nga legjislacioni i brendshëm i shtetit serb dhe nga konventat ndërkombëtare ku ai është palë. Mirëpo, aktet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare pas verifikimeve që kanë bërë në vend, kanë konstatuar se ushtria, policia, gjyqësori, në përgjithësi, shteti dhe shoqëria serbe, i kanë dhunuar vrazhdë, kanë kryer krime lufte, gjenocid dhe spastrim etnik ndaj shqiptarëve, e cila, më e pakta që mund të thuhet, ka tërhequr vëmendjen e disa qarqeve politike e ashtuquajtura "Politika e 'bothsides-ism'", e konkretizuar në gjyqin e luftëtarëve të UÇK-së në Hagë dhe, së fundi, në ndëshkimin e Kosovës me sanksione për refuzimin e ultimatumëve të Vuçiçit, që i transmetohen nga disa emisarë ndërkombëtarë. Ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, thotë se Bashkimi Evropian duhet të heqë dorë në mënyrë imediate nga qasja ku bën përgjegjës të barabartë Kosovën dhe Serbinë. BE-ja mund ta zgjidhë problemin, por ajo duhet të heqë dorë nga zakoni i saj i 'bothsides-ism'.⁹⁸

Kjo thirrje vjen edhe nga të tjerë personalitete nga vende europiane. Ata nuk e pranojnë ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet Serbisë fajtoresh dhe Kosovës viktime.⁹⁹ Disa ligjvënës evropianë dhe amerikanë, përmes një letre drejtuar Sekretarit Amerikan të Shtetit, Antony Blinken dhe shefit të diplomacisë së BE Joseph Borrel, kërkojnë që Perëndimi të ashpërsojë qasjen ndaj Beogradit dhe të shmangin politikat që qendërojnë Serbinë në Beograd.¹⁰⁰

⁹⁷ Bedri Islami, *Kosova dhe Kadare*, Gazeta Dita, 6 qershor 2023.

⁹⁸ Ndaj propagandës së Vuçiçit, i cili në një rast thoshte se populli serb në Kosovë i është nënshtruar "përndjekjes më të tmerrshme" në 15 vitet e fundit, Miroslav Lajçak, nuk kundërshtoi, por lavdëroi "bisedën e sinqertë dhe të hapur" me presidentin serb. Media Index - RTV Presheva, <https://www.rtvpresheva.com>, Aug 7, 2023, f. 18.

⁹⁹ Në një letër, të firmosur nga drejtuesit e Komisioneve për Marrëdhënie me Jashtë, Michael Roth, i Bundestagut gjerman dhe Bob Menendez, në Senatin amerikan, kërkohet të hiqet dorë nga "kënaqja" e Beogradit dhe politikave që Beogradin e shndërrojnë në epiqendër të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në raport me Kosovën. *Menendez dhe Roth letër Borrellit e Blinkenit: Duhet qasje e ashpër ndaj Serbisë! Jo politikë që bën Beogradin qendër të Ballkanit*, Gazeta Tema 6 gusht 2023.

¹⁰⁰ Dreni Himbeqa, - *BE duhet të heqë dorë nga barazimi i fajit, në rastet kur Serbia ka më shumë faj* – Intervistë ekskluzive me Greg Delawie, ish-ambasador i SHBA-së në Kosovë, Albanianpost.com, 2 Janar 2023. "Both sides-ism" ose

Në sinkron me të është edhe qëndrimi i avokatit serb, Çedomir Stojkoviç. Ai ka thënë se “masat ndëshkuese” të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Kosovës do të përdoren nga regjimi antiperëndimor në Serbi në favor të Ruisë dhe politikave nacionaliste e shoviniste serbe. “Unë jam qytetar i Serbisë dhe mund të flas për vendin tim. Ajo që mund të them është se nëse BE-ja dhe ShBA-të vendosin sanksione kundër Kosovës, ekstremistët në vendin tim do ta përdorin atë për qëllime të tyre. Dhe kjo është arsyeja pse është diçka e keqe”.¹⁰¹

Por, më hapur vlerësimin e këtyre zhvillimeve e bën gazeta prestigjioze *Der Spiegel*, në një shkrim me titullin *Zjarrvënësi i Ballkanit e ka emrin Aleksandar Vuçiç*. Këtë, thuhet në shkrim, e kupton kush merr vesh serbisht dhe kush e përcjell fushatën urrejtëse të kanaleve televizive të regjimit të Vuçiçit.¹⁰²

Atë që Vuçiçi rezervohet ta thotë, e shpreh haptas Vulini, proklamuesi i konceptit të “Botës serbe”, të inspiruar nga “Bota ruse” e Putinit. Mundësia e vetme që Ballkani të ketë qëndrueshmëri është që serbët të jetojnë në një shtet, sepse, sipas tij, “të gjitha konfliktet në Ballkan fillojnë me diskriminimin e serbëve. Aty ku i respektojnë të drejtat e serbëve, nuk kanë problem me ‘botën serbe’”.¹⁰³

Politika e Beogradit ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, e përfaqësuar nga Vuçiçi, Daçiçi, Vulini etj, e asistuar fuqimisht edhe nga kisha serbe dhe vetë patriarku Porfirije¹⁰⁴ mbetet konstante edhe në ditët tona. Madje nën drejtimin e Vuçiçit mohimi i gjenocidit është bërë institucional.¹⁰⁵

“False Balance” është situata kur dikush, në këtë rast BE-ja, përpiket ta ndajë fajin dhe përgjegjësinë te të dyja palët.

¹⁰¹ Stojkoviç: *Të sanksionohet regjimi i Vuçiçit, krijon tensione në Kosovë për të ruajtur pushtetin*, gazeta Tema, 6 Gusht 2023.

¹⁰² *Der Spiegel - Zjarrvënësi i Ballkanit e ka emrin Aleksandar Vuçiç*, SOT.COM.AL 6 Gusht 2023.

¹⁰³ Radio Evropa e Lirë, <https://www.evropaelire.org/aleks...>, Jul 12, 2022 - “*Të gjitha konfliktet në Ballkan fillojnë me diskriminimin e serbëve*”.

¹⁰⁴ Përfaqësues të Kishës serbe e interpretojnë si heroizëm dhunën dhe vrasjet masive të shqiptarëve. Peshkopi Pahomija, në Manastirin e Shën Nikollës në Vranjë të Serbisë, nderoi të dënuarin e Gjykatës së Hagës për krime lufte në Kosovë, Vladimir Lazareviç-in, duke ia akorduar atij urdhrin e dëshmorëve të Surdulicës, për “nxitje të filantropisë dhe vlerave ortodokse”. Kjo nuk është hera e parë që Lazareviç-i nderohet në Serbi, në një kohë kur në faqen e Tribunalit të Hagës për Krime të Luftës në Ish-Jugosllavi shkruhet se “ish-komandanti i ushtrisë serbe në Kosovë, gjeneral Vladimir Lazareviç-i, ishte dënuar nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për përgjegjësi komanduese me 14 vjet burg për krimet në Kosovë, si komandant i korpusit të Prishtinës, e pastaj edhe komandant i armatës së tretë të ushtrisë jugosllave më 1998 dhe 1999.” Këta i merr në mbrojtje shteti, shoqëria dhe kisha serbe.

¹⁰⁵ *Der Spiegel - Zjarrvënësi i Ballkanit e ka emrin Aleksandar Vuçiç*, SOT.COM.AL 6 Gusht 2023.

Miti fals i të ashtuquajturit “gjenocid shqiptar”

Simetria false, e ekspozuar gjerësisht këto kohë, vjen nga kohë të hershme, si pjesë e strategjisë kombëtare, politike, gjeostrategjike serbe dhe nis kur Beogradi përpunonte platformën nacionaliste serbe “Naçertanije”, thelbi i së cilës ishte zgjerimi serb dhe asgjësimi i fqinjëve, posaçërisht i shqiptarëve. Ajo u përqafua, u plotësua, u redaktua dhe u ndoq nga të tjerë nacionalistë serbë, si Vuk Stefanoviçi Karaxhiçi, Jovan Cvijiçi, Vladan Gjorgjeviçi, Stojan Novakoviçi, Nikolla Stojanoviçi, Stevan Moleviçi, Dobrica Qosiçi, Vasa Çubriloviçi, Pavle Joviçi, Antonije Isakoviçi, Dushan Kanaziri, Mihajlo Markoviçi, Dejan Medakoviçi, Mirosllav dhe Nikolla Pantiçi, Radovan Samarxhiçi, Lubisha Rakiçi, Vasilije Kresiçi, Miomir Vukobratoviçi, Stojan Gjeliçi etj.

Ideologjia dhe doktrina antishqiptare u konvertua në politikë shtetërore strategjike nga arkitektët e politikës së egër nacionaliste e shoviniste serbe Karagjorgjeviçët, Nikolla Pashiçi, Aleksandër Rankoviçi, Slobodan Milosheviçi dhe aktualisht grupi i Aleksandër Vuçiçit.

Ata kanë synuar që Serbia të zgjerohet, mundësisht në kufijtë e Stefan Dushanit, të marrë rolin historik të Piemontit ballkanik dhe të faktorit dominues në gadishull etj.¹⁰⁶

Studiuesja Olivera Milosavljeviçi, e përmendur më lart, e cila trajton shkarazi edhe disa nga shkaqet e gjenocidit permanent serb përkundrejt shqiptarëve, ka ekspozuar të analizuar qartë dhe bindshëm, por edhe me një kurajo të admirueshme, një literaturë impresionuese të prodhuar nga makineria propagandistike serbe, kushtuar një miti fals rreth të ashtuquajturit gjenocid shqiptar.

Të dhënat dhe analizat shumë interesante që ka parashtruar tregojnë përpjekjet e Beogradit për ndërtimin e një simetrie gjenocidi, spastrimi etnik dhe krimesh imagjinare shqiptare ndaj serbëve. Serbët shpresojnë “të shpëtojnë fytyrën”, tërësisht të ndotur nga krimet e tyre ndaj shqiptarëve. Por, e pamundur, sepse ndryshe nga sa ndodh me skenarët e falsifikuar serbë, krimet e tyre të vërteta ndaj shqiptarëve vijnë gjithë drithërimë prej atyre vetë, nga historianë, akademikë, profesorë, ushtarakë, politikanë, diplomatë etj, si dhe nga disa dhjetëra, ndoshta qindra autorë të huaj.

¹⁰⁶ Sipas Xhelal Zejneli, Luftrat ballkanike- krimet serbe ndaj shqiptarëve, në Ars Albanica, portal kulturor, 2021, *Historiana serbe 'trondit' Serbinë me këtë deklaratë për shqiptarët*, VOAL, September 21, 2017, ZgjohuShqiptar.info.

Politika zyrtare e Beogradit ka kultivuar idenë që shqiptarët janë “armiqtë” më të mëdhenj të popullit serb, për shkak të “primitivizmit” dhe të urrejtjes ndaj tij. Ai u bë viktimë e një “plani për shkatërrimin e tij fizik”, çka bëri që nga mesi i viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar emri shqiptar të identifikohet me fjalët “gjenocid”, “shtypje”, “plaçkitje”, “dhunim”.¹⁰⁷ Kurse lëvizja politike shqiptare u damkos si “agresive, pushtuese, revanshiste, konservatore dhe nacionaliste”. Qëllimi i saj ishte shkatërrimi i popullit serb nëpërmjet “vrasjeve, dëbimit, fshirjes së ndërgjegjes historike”, përvetësimi i tokës serbe. Ithtar i kësaj fryme urrejtjeje, Dimitrije Bogdanoviçi, mashtron duke thënë se vendosja e shqiptarëve në tokat serbe, nga shekulli XVII deri në kohën tonë, ka lënë “gjurmë të përgjakshme të dhunës në ndërgjegjen historike të popullit serb”. Pretendon se ka pasqyruar më raste konkrete shtypjen, masakrat, plaçkitjen dhe “dëbimin e serbëve nga toka e tyre”.¹⁰⁸

Kjo tezë absurde, pa asnjë pikë takimi me realitetet historike, është përvetësuar dhe përhapur me zell të veçantë edhe nga autorë të tjerë serbë. Një prej tyre, i quajtur Radovan Samarxhiç, pretendon se “arbanasit” – shqiptarët u shtynë nga turqit, qysh në shekullin XVI, për t’u futur në atdheun e vjetër të serbëve si “pykë shkatërruese”. Ata, përsërit ai, kanë shtypur popullin serb me “vrasje, plaçkitje, me djegien e tërë fshatrave, me vjedhjen e tokës dhe islamizim të dhunshëm”¹⁰⁹. Veprat antiserbe, të supozuara si të kryera nga shqiptarët, por vetëm në imagjinatën serbe, i quajtori Marko Mladenoviçi, i cilëson gjenocid dhe aparteid.¹¹⁰

Atanasije Jevtiçi, një tjetër “studiuës” i angazhuar në fushatën e ndërtimit të kësaj simetrie fiktive, thotë se prej kohësh qëllimi i shqiptarëve në Kosovë ka qenë: “Sa më shumë tokë, sa më shumë fëmijë dhe sa më shumë armë”, sepse fëmijët shqiptarë jo vetëm janë “manipuluar, por në thellësi janë mbushur me urrejtje për gjithçka që është serbe dhe e krishterë në Kosovë dhe Metohi”, për shkak të “frymës primitive fisnore” dhe “frymës myslimane”, të edukuar prej prindërve dhe mësuesve.¹¹¹

¹⁰⁷ Citohet sipas Xhelal Zejnelli, Lufëtrat ballkanike- krimet serbe ndaj shqiptarëve, në *Ars Albanica*, portal kulturor.

¹⁰⁸ Dimitrije Bogdanoviç, 1985, citohet sipas *Historiania serbe ‘trondit’ Serbinë me këtë deklaratë për shqiptarët*, VOAL, Voice of Albanians, September 21, 2017. ZgjohuShqiptar.info.

¹⁰⁹ Radovan Samarxhiç, 1989:123, 253, citohet sipas *Historiania ...*

¹¹⁰ Marko Mladenoviç, 1989:63–69, citohet sipas *Historiania ...*

¹¹¹ Atanasije Jevtiç 1992:542–544, citohet sipas *Historiania s...*

Një Samarxhiç tjetër, me emrin Nikola, pjesë e këtij kori anti-shqiptar, ka “zbuluar” natyrën e egër të arbanasve, fuqinë fantastike për riprodhim, urrejtjen çnjerzore, orgjitë e përgjakshme etj.¹¹²

Miodrag Joviçiq në një shkrim kushtuar serbëve dhe shqiptarëve në shekullin XX, thotë se shqiptarët janë “arnautët”, mizorë dhe grabitës, me prirje për dhunë dhe gjak.¹¹³ Të gjitha shtresave të popullsisë shqiptare “iu ka hyrë në gjak dhuna, por edhe urrejtja ndaj popullsisë serbe, e cila është fajtoare vetëm se është gjallë”.¹¹⁴

Nëpërmjet këtij vështrimi vertikal në botimet e lartpërmendura si dhe në të tjera, vërehet një gjuhë e standardizuar në leksikun e vet, e dominuar nga mllefi dhe helmi kundër shqiptarëve, të cilët përkufizohen si “armiqtë e gjakut të Serbisë dhe të serbëve”, bartës të “shovinizmit dhe racizmit agresiv”. Me ta është e pamundur bashkëjetesa normale, për shkak se ata ndiejnë “urrejtje të thellë ndaj Serbisë dhe serbëve” dhe “sjelljen e tyre gjenocidale” e kanë “prirje shekullore”.¹¹⁵ “Studiuesit” e lartpërmendur serbë shkruajnë se “në themelet e të gjitha lëvizjeve arbanase” gjatë shekullit XIX, qëndron gjenocidi i hapur i shqiptarëve “ndaj popullit serb”.¹¹⁶ Ai është shfaqur në “dhunën agresive dhe shkatërruese ndaj çdo gjëje që ishte serbe”, në “plaçkitje, vrasje, përdhunime dhe rrëmbime të grave”, në intolerancën etnike dhe fetare, në sjelljen “e tyre, okupuese dhe përvetësuese”.¹¹⁷ Këto i thonë ata që pretendojnë të jenë pjesë e botës të civilizuar, ata që i venë një rrugë në Beograd emrin e Ratko Mlladiçit, kasapit të Ballkanit, atij që masakroi barbarisht disa mijëra boshnjakë. Ky është gjest dhe veprim që flet dhe dëshmon për gjithçka.

Operacioni Patkoi – aksion i mirëfilltë gjenocidi

Midis qindra e mijëra fakteve që përgënjeshtrojnë propagandën e Beogradit dhe që tregojnë se kush kreu gjenocid dhe spastrim etnik,

¹¹² Nikola Samarxhiç, 1990:56, 60, citohet sipas *Historiania ...*

¹¹³ Miodrag Joviçiq, 1991a:138–139,143–146,151–153, citohet sipas *Historiania ...*

¹¹⁴ Po aty.

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Batakoviç, 1992a:453, citohet sipas *Historiania serbe ‘trondit’ Serbinë me këtë deklaratë për shqiptarët*, VOAL, Voice of Albanians, September 21, 2017. *Zgjuhu Shqiptar.info*.

¹¹⁷ Jevtiq, 1992:542, citohet sipas *Historiania serbe ‘trondit’ Serbinë me këtë deklaratë për shqiptarët*, VOAL, Voice of Albanians, September 21, 2017. *Zgjuhu Shqiptar.info*.

është edhe *Operacioni Patkoi*, i njohur si pjesë e planit të përgjithshëm strategjik të Milosheviçit. Duke i rrethuar shqiptarët brenda një patkoi gjigant, do t'i detyronte të largoheshin nga vendi i tyre, do t'i dëbonte nga Kosova. Duke iu grisur në dalje të kufirit çdo lloj dokumenti identifikimi, pronësie, banke etj që mund të posedonin, do t'i shndërronte të gjithë në askush, pa asnjë mundësi dhe të drejtë për t'u rikthyer në Kosovë.¹¹⁸ E “pastruar” nga shqiptarët ajo do të shndërrohej në “*terra pulita*” dhe, siç kishte predikuar Çubriloviçi në vitin 1937, do t'iu vihej në dispozicion kolonëve serbë. Në këtë mënyrë do të “zgjidhte” në mënyrë radikale problemin shqiptar, për ta mbyllur atë njëherë e përgjithmonë, sipas metodave tradicionale antishqiptare, në dobi të Serbisë së Madhe.

Një pjesë e asaj çka po ndodhte në ato kohë, e dokumentuar nga qindra dëshmitarë okularë, përveç Raportit të Komisionit të Drejtave të Njeriut të OKB-së, të shtatorit 1999, gjendet edhe në një raport të posaçëm, botuar nga *New York Times*, më 29 maj 1999, të titulluar “*Tmerri sipas dizajnit*”.¹¹⁹

Aty shkruhet ndër të tjera: “Kjo nuk është toka juaj – nuk do ta shihni më kurrë”, iu bërtisnin serbët shqiptarëve të rraskapitur nga tmerri dhe lodhja, para se të dëboheshin nga Kosova. “Shkoni te NATO-ja juaj – shkoni te Klintoni juaj.”¹²⁰ Nga fundi i majit, afër 1 milion shqiptarë ishin dëbuar nga Kosova. Ky ishte realisht gjenocid i mirëfilltë, kurse sharjet dhe fyerjet e Beogradit, në mbrojtje të krimeve të veta, janë asgjë, janë vetëm një pretekst banal.

Fjalë dhe jo fakte, kundër shqiptarëve

Në këto mjedise, me gjithë zellin e treguar nga kalemxhinjtë e Beogradit, përfshirë edhe një pjesë të Akademisë Serbe, nuk ka qenë e mundur të ekspozohet as edhe një “naçertanie”, memorandum i tipit Çubriloviç, operacion “patkoi” ose qoftë edhe ndonjë skenar tjetër apo episod konkret, ku të flitet për kryerje vrasjesh, shfarosjesh, masakrash, gjenocidi, spastrimi etnik etj. ndaj serbëve që të kenë për autorë shqiptarët. Nuk gjendet asnjë rresht për ngjarje të kësaj natyre në ngar-kim të shqiptarëve edhe në dokumentet e organizatave ndërkombëtare. Nuk ka, sepse nuk ka pasur asnjë rast të tillë. Kurse për serbët, krimet e

¹¹⁸ John G. Stoessinger, - “Why Nations Go to War”, 11 th edition, 2010.

¹¹⁹ *New York Times*, on May 29, 1999, “*Horror by Design.*”

¹²⁰ Kosovo and Miloseviç's downfall.

të cilëve ndaj shqiptarëve janë të panumërt, janë të pafundme edhe dokumentet e Këshillit të Sigurimit, Asamblesë së Përgjithshme, ish-Komisionit të Drejtave të Njeriut të OKB-së, si dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, universale e rajonale.

Gjithçka që u trajtua më sipër dëshmon se Beogradi nuk ka hequr dhe me sa duket nuk heq dorë nga strategjia arkaike e aneksimit të Kosovës me çdo mjet e me çdo kusht. Në shërbim të saj serbët kanë mobilizuar politikën, ushtrinë, njësitet paraushtarake, policinë, gjykatat, prokurorinë, shërbimin inteligjent, akademinë etj, kanë falsifikuar historinë, kanë përdorur fenë ortodokse dhe institucionet e saj. E kanë trajtuar Kosovën si mitin e një lavdie pa lavdi dhe jo si realitet shqiptar. Por, siç shprehet Milutin Cerović, Kosova në Serbi tash e një kohë ekziston vetëm si mit, ndërsa Kosova e vërtetë, sot ekziston si shoqëri mjaft mirë e rregulluar,¹²¹ si shtet i pavarur, si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, i njohur nga rreth 120 shtete dhe disa organizata ndërkombëtare. Kohet moderne kanë zhvlerësuar duke çuar drejt fundit shtrembërimet groteske serbe të realiteteve historike. Ndryshe nga më parë kur “të mundurit, ashtu si në vitin 1389, edhe disa shekuj më vonë, pas humbjes, kishin nxituar të shkruanin një histori tjetër, veçse kësaj radhe nuk kishin pasur përballë turmat me çallma laramane të osmanëve, por një strukturë ushtarake, më të fuqishmen e kohës, që, për herë të parë ishin ngritur për të mbrojtur një popull që ishte drejt asgjësimit dhe që do të provonte gjenocidin. Nëse nuk u bë masakra e dëshiruar, kjo ka të bëjë me zgjimin e ndërgjegjes së botës, ringritjen e dëshmisë së ndëshkimit të së keqes, rikthimin në kahun e së mbarës të 28 qershorit të vitit 1389, dhe ndodhi mrekullia, “Mbi Fushën e Mëllenjave është ngritur Flamuri i Evropës!”¹²²

¹²¹ Milutin Cerović Već decenijama od velikosrpske propagande slušamo lažne i izmišljene priče o “svetom Kosovu”. Aktuelno.me, <https://www.aktuelno.me>, Aug 8, 2023, Shkrimi citohet nga gazeta *Koha*, 11 gusht 2023.

¹²² Bedri Islami, *Kosova dhe Kadare*, Gazeta Dita, 6 qershor 2023.

Arsim Bajrami

GJENOCIDI I SERBISË NË KOSOVË: NDËRMARRJE E PËRBASHKËT SHTETËRORE KRIMINALE

Abstrakt

Gjenocidi i Serbisë në Kosovë i implementuar gjatë vitit 1998/1999 në aspektin penal juridik ka qenë një ndërmarrje kriminale e organizuar nga shteti serb. Vetë etimologjia e krimeve të gjenocidit paraqet një krim që synon zhdukjen e pjeshme apo të tërësishme të një grupi etnik në baza etnike, racore, fetare apo motive të tjera. Në këtë kontekst, shihet se krimet e gjenocidit mund t'i kryejë vetëm shteti sipas një plani gjenocidial. Gjenocidi i Serbisë në Kosovë ka qenë i planifikuar me shëku, i organizuar dhe i implementuar me një vullnet dhe plan të shtetit serb në vitin 1998-1999, kur u manifestuan të gjitha format e krimit të gjenocidit.

Duke qenë një ndërmarrje kriminale e shtetit serb, gjenocidi i Serbisë në Kosovë ka pasur për qëllim spastrimin etnik të Kosovës me deportimin e më shumë se një milion shqiptarëve, vrasje dhe masakra barbare, me vrasjen e më shumë se trembëdhjetë mijë qytetarëve të Kosovës, djegiet dhe shkatërrimet e pronave private dhe pasurisë së shqiptarëve. Po ashtu, ky gjenocid synonte shkatërrimin e identitetit, kulturës, sistemit të arsimit, dhe krijimi i situatës së varfërisë, ndjenjës së skllavërisë, humbjes së identitetit, e deri te shkatërrimi i institucioneve që do të udhëhiqnin dhe organizonin popullin shqiptar të Kosovës. Synimet e gjenocidit serb, në fakt ishin pushtimi i plotë i territorit të Kosovës, serbizimi i saj dhe shkatërrimi i substancës etnike, kombëtare dhe biologjike të shqiptarëve.

Në kuptimin e Konventës së OKB-së për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit janë përcaktuar pesë kritere të trajtimit të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit si gjenocid. Këto kritere janë të standardizuara, pothuajse në të gjitha aktet relevante, filluar nga Statuti i Romës, Konventat Europiane, e deri te legjislacioni penal i shteteve, ku praktikisht kodifikohen kriteret për trajtimin e një krimi si një krim gjenocidial.

Janë pesë kritere të cilat përbëjnë figurën e veprës penale të gjenocidit dhe me këtë rast ne po i përsërisim ato: a) Vrasja e anëtarëve të grupit; b) Shkaktimi i dëmtimeve serioze fizike dhe psikike (mentale të anëtarëve të grupit); c) Imponimi i kushteve të jetesës, të planifikuara për shkatërrimin fizik total apo të pjeshëm të grupit; d) Imponimi i masave me qëllim të pengimit të riprodhimit të thjeshtë brenda grupit; e) Transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga një grup në grupin tjetër.

Këto pesë kritere, të përkufizimit penal juridik të krimit të gjenocidit, në luftën e Kosovës janë të plotësuar të gjitha dhe atë në mënyrë komulative. Në aspektin juridik ka prova të plota, me të cilat konfirmohet, argumentohet dhe

vërtetohet se të pesë kriteret e përcaktuara sipas Konventës së OKB-së, janë konsumuar në krimet gjenocidiale të Serbisë në Kosovë. Ky studim synon të argumentojë secilin nga këto kriteret, me fakte, me prova relevante juridike dhe konfirmon plotësimin e të gjitha kushteve të kësaj Konvente, në luftën e fundit në Kosovë. Në të vërtetë, brutaliteti i gjenocidit serb në Kosovë, i parë më herët edhe në luftën e Bosnjës, ka ndikuar që bashkësia ndërkombëtare të bëjë një ndërhyrjen preventive me fushatën e bombardimeve ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë me qëllim që të mos lejojë dëmet e pariparueshme të një gjenocidi klasik që Serbia e ushtronte në Kosovë. Ekzistencën e gjenocidit në Kosovë e konfirmon konsensusi ndërkombëtar i demokracive perëndimore, që të fillojë ndërhyrja më e madhe ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore, ndaj Serbisë dhe ish-Jugosllavisë për të parandaluar pasojat e krimeve të gjenocidit serb. Falë këtij intervenimi dhe luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Serbia nuk arriti të përfundojë planin shtetëror gjenocidal dhe pranoi kapitullimin në Marrëveshjen e Kumanovës, me ç'rast u mundësua çlirimi i Kosovës, administrimi ndërkombëtar i saj në periudhën kalimtare dhe së fundi edhe pavarësia e Kosovës.

Fjalët çelës: Serbia, Kosova, gjenocidi, krimet, etnike, Tribunali Ndërkombëtar.

Konteksti i politikës gjenocidiale në Kosovë

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore ishte një ngjarje që i dha fund luftës në nivel ndërkombëtar, mirëpo nuk i zgjidhi konfliktet në territoret ballkanike që datonin nga kohërat e mëhershme. Shqiptarët në ish-Federatën e Jugosllavisë kërkonin t'i gëzonin të drejtat e tyre që ua kishin mohuar gjatë gjithë kohës së okupimit.

Pikënisja e fazave në piramidën e gjenocidit që u ndoqën kundër shqiptarëve në ish-Federatën Jugosllave janë politika pushtuese, asimiluese, segreguese, diskriminuese, persekutuese, deportuese, përgatitja për terror, shfarosja, klasifikimi stigmatizues, dehumanizmi dhe mohimi gjenocidal, të cilat janë në kundërshtim me konventat ndërkombëtare. Politika e qeverisë federative jugosllave ishte politikë antishqiptare dhe shkaktoi pezëm e pakënaqësi të mëdha në mesin e shqiptarëve. Shpërthimi i pakënaqësive të akumuluar kundrejt qeverisë jugosllave ishte shprehur përmes demonstratave dhe protestave në periudha të ndryshme kohore, por më të njohurat janë gjithëpërfshirja masive e popullatës në demonstratat e vitit 1968, 1981, 1989 dhe në vazhdimësi.

Në periudhën kur në Evropë ishin bërë përpjekjet për ta rrëzuar sistemin komunist, në Kosovë shqiptarët bënë përpjekje për ta përmirësuar dhe avancuar statusin e vet. Në mënyrë paqësore, më 11 mars

të vitit 1981 studentët kërkonin përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtim të barabartë me nacionalitetet e tjera në Federatë. Përgjigjja nga forcat e ushtrisë jugosllave/serbe kundër këtyre kërkesave të studentëve ishte brutale. Vrasjet dhe burgosjet masive kundër shqiptarëve edhe më tej e thelluan dhe e zgjeruan tensionimin e raporteve midis qeveritarëve dhe shtetasve të etnisë shqiptare. Demonstratat masovike të shqiptarëve ishin të njëpasnjëshme gjatë dy muajve, mars-prill të vitit 1981, por, megjithatë, populli i Kosovës nuk arriti t'i plotësonte kërkesat e veta kombëtare.

Masat e dhunshme që u përdorën ndaj demonstruesve në pranverën e vitit 1981 nga urdhrat e Qeverisë së ish-Federatës Jugosllave paraqitën një eskalim të përdorimit të dhunës në mënyrë të hapur. Përndjekjet dhe vrasjet kryheshin me synim të realizimit të politikës gjenocidale serbe kundër shqiptarëve, politikë e cila, në atë periudhë kohore mori formën e ushtrimit të gjenocidit transparent. Me këtë politikë gjenocidale që u ndoq nga regjimi i atëhershëm serb/jugosllav u kryen veprime gjenocidale kundër shqiptarëve deri në fund të vitit 1999. Kjo periudhë kohore, që nga viti 1981 e deri te viti 1999 dëshmon se, gjenocidi serb ishte një gjenocid transparent dhe ushtrohej kundër kërkesave të shqiptarëve për të drejta elementare, kombëtare, të cilat, ishin të garantuara me ligje e me konventa ndërkombëtare.

Gjenocidi i Serbisë në Kosovë, ndërmarrje e përbashkët kriminale (NPK) dhe gjenocidale e shtetit serb

Në jurisprudencën penale 'Ndërmarrje e përbashkët kriminale (NPK) është tipike për krimet në përmasa të gjenocidit. Gjenocidi asnjëherë nuk është një krim i thjeshtë apo një vrasje, të cilën mund ta kryejë një individ. Ndërmarrja e përbashkët kriminale e cila, kryen gjenocid, si rregull përfshin anëtarë të një projekti gjenocidal, një numër të madh personash, e në veçanti, udhëheqës politikë e ushtarakë, të cilët nuk kryen drejtpërdrejt krime gjenocidale. Ish-presidenti i TPN-së për ish-Jugosllavi, Antonio Cassese, thekson: "me rastin e deportimit të civilëve ose të të burgosurve të luftës në një kamp përqendrimi, një komandant mund të nxjerrë urdhrin, disa oficerë mund ta organizojnë transportin, të tjerët mund të kujdesen për ushqim dhe ujë të pijshëm, të tjerët mund të kryejnë mbikëqyrjen e të burgosurve për ta parandaluar ikjen e tyre, të tjerët mund t'i kontrollojnë të burgosurit për gjërat e vlefshme ose sende të tjera para deportimit etj. Të gjithë pjesëmarrësit

në një veprim të këtillë të përbashkët janë po aq përgjegjës nëse ata: 1. Marrin pjesë në aksion pa marrë parasysh pozitën ose kontributin e tyre dhe përveç kësaj 2. synojnë dhe angazhohen në projektin e përbashkët kriminal”.¹ Prandaj, të gjithë ata duhet të trajtohen si përgjegjës, edhe pse në shkallë të ndryshme të fajësisë mund të merren parasysh në fazën e dënimit. Arsyetimi para këtij parimi ligjor është i qartë: a). secili prej tyre është i domosdoshëm për arritjen e rezultatit përfundimtar dhe në anën tjetër b). do të ishte vështirë të bëhet dallimi brenda shkallës së përgjegjësisë penale, përveç për qëllime dënimi.²

Në jurisprudencën penale ndërkombëtare njihen disa lloje të ndërmarrjes së përbashkët kriminale³, por NPK-ja që ka kryer gjenocidin në Kosovë, paraqet një model të një grupi kriminal, të përbërë nga zyrtarët kryesorë shtetërorë dhe ushtarakë të Serbisë, të cilët gjatë viteve 1998-1999 u bashkuan në grupin e përbashkët kriminal dhe kryen gjenocid në Kosovë.

Siç u tha edhe në shqyrtimet paraprake, gjenocidi i Serbisë në Kosovë ka qenë një plan i orkestruar dhe i dizajnuar nga zyrtarët më të lartë në institucionet shtetërore, kulturore, edukative dhe fetare të shtetit serb me qëllim të shfarosjes së shqiptarëve dhe spastrimit etnik të territorit të Kosovës, dhe kjo, në të tri format shtetërore të organizimit politik të ish-Jugosllavisë, duke filluar nga mbretëria e Karagjorgjëve (mbretëria serbo-kroate-slllovene), pastaj Jugosllavia e Titos apo Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë e deri te Serbia pas viteve nëntëdhjetë, në vazhdimësi, pra, gjenocidi ka qenë një projekt shtetëror i Serbisë.

Pra, ka ekzistuar një politikë e dizajnuar, e orkestruar dhe e implementuar e shtetit serb me qëllim të shfarosjes së shqiptarëve, në mënyrë që të kryhet spastrimi etnik, të ndërrohet harta demografike e Kosovës dhe të mundësohet kolonizimi, me qëllim të popullimit të Kosovës me popullsi sllave. Projekti i gjenocidit të Serbisë, si politikë zyrtare e shtetit serb ka paraqitur një ndërmarrje kriminale të shtetit serb që është implementuar nga të gjitha strukturat shtetërore, politike dhe struktura të tjera të shoqërisë serbe. Pra, ka ekzistuar një vullnet i plotë që në vazhdimësi ndaj shqiptarëve të Kosovës të udhëhiqet një politikë

¹ A. Cassese i cituar në C. Harding 2007. Criminal enterprise, Individuals, Organisations Criminal Responsibility Devon, WILAN Publishing, fq.180. (Anton Vukpalaj, Fshehja e Krimin, ASHAK, fq.146, Prishtinë, 2021).

² Po aty.

³ Shih më gjerësisht për llojet e ndërmarrjeve të përbashkëtakriminale Anton Vukpalaj, “Fshehja e Krimin”, bot. ASHAK, fq.151, Prishtinë, 2021).

shfarosëse dhe ndaj tyre të ushtrohet një terror dhe dhunë sistematike, përfshirë këtu: vrasje masive, burgosje, tortura, maltretime, dhunime seksuale, djegien e shtëpive, largimin nga puna, plaçkitjen e pronës, shkatërrimin e institucioneve kulturore, edukative, shkatërrimin e objekteve të trashëgimisë fetare dhe ndërmarrjen e një varg masash të tjera në mënyrë që të shkatërrohet substanca biologjike e popullit shqiptar dhe të fshihet çdo gjurmë e autoktonisë së tyre në trojet etnike. Tani, njëzet e dy vjet pasi forcat ushtarake të NATO-s, të komanduara nga gjenerali Vesli Klark, në mbështetje të luftës së UÇK-së, e shpëtuan Kosovën nga gjenocidi serb, “qartë shihet se përveç hakmarrjes për qëndresën e shqiptarëve në dekada, serbët tentuan të realizonin objektivin e tyre më madhor politik: shpopullimin e Kosovës nga shqiptarët dhe serbizimin e fizionomisë së saj demografike”.⁴

Siç u cek edhe në shqyrtimet historike, kjo politikë ka pasur tri faza të implementimit faktik:

Faza e parë ka qenë dizajnimi apo konceptimi ideor i gjenocidit i cili fillon nga Ilija Garashanini e tutje, kur janë hartuar me dhjetëra projekte serbe për kryerjen e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Periudha e dytë fillon kryesisht nga vitet 90, aty ku fillon të finalizohet dhe të përgatitet implementimi faktik i gjenocidit klasik dhe të paparë, fazë që fillon me ardhjen e Slobodan Milosheviçit në pushtet dhe me instalimin e politikës së nacionalizmit serbomadh që në epiqendër kishte shqiptarofobinë apo projektin e shkatërrimit të shqiptarëve.

Faza e tretë, është periudha e vitit 1998-1999, kur kemi edhe zbatimin konkret të gjenocidit në luftën e fundit, në të cilën Serbia me mekanizmin dhe aparatën e saj represiv, ushtroi *de facto* të gjitha veprimet e gjenocidit, veprime këto të përcaktuara nga Konventa e OKB-së e vitit 1948 si krime gjenocidale. Pra, në fakt, gjenocidi i Serbisë në Kosovë si ndërmarrje kriminale i shtetit serb ka qenë një strategji e sofistikuar, e përgatitur me vite që kulmoi në vitet 1998-1999. Me tepër se 2/3 e popullit shqiptar të Kosovës iu nënshtruan këtij gjenocidi klasik, i cili tentonte ta zhbënte Kosovën, ta shkatërronte substancën etnike dhe biologjike të shqiptarëve dhe ta popullonte atë me kolonë serbë të ardhur nga luftërat e ish-Jugosllavisë si nga: Kroacia, Bosnja, në mënyrë që të ndërrohet esencialisht përbërja demografike e Kosovës.

⁴ Shih më gjerë: Paul Mojzes, “*Balkan Genocides. Holocaust and Ethnic Cleansing in the Twentieth Century*” (“Gjenocidet ballkanike, Holokausti dhe spastrimet etnike në shekullin XX”), SHBA, 2007.

Ne aspektin penalo-juridik, organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës përcakton se:

1. “Kushdo që organizon një grup me qëllim të kryerjes së ndonjë prej veprave penale nga nenet 148-156 të këtij Kodi, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

2. Kushdo që bëhet anëtar i grupit nga paragrafi 1. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

3. Anëtari i grupit nga paragrafi 1. i këtij neni që e paraqet grupin para se të ketë kryer veprë penale, dënohet me burgim deri në tri (3) vjet ose mund të lirohet nga dënimi.⁵

Nëse grupi është organizuar, për të kryer gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës, për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe të këtyre veprave penale dhe për shkaqe kriminale e politike, në këso raste, Kodi Penal i Kosovës veprën e tillë e parasheh si veprë penale të posaçme⁶. Zgjidhja e këtillë e Kodit Penal është e bazuar në dispozitat e Statutit të Gjykatës Ushtarake të Nurembergut për gjykimin e kryesve të krimeve në Luftën e Dytë Botërore. Gjithashtu ky inkriminim është paraparë edhe në Statutin e Tribunalit të Hagës dhe në Statutin e Romës të vitit 1998. Në dispozitat e këtyre statuteve janë të parapara krime dhe shtytja, organizimi, marrëveshja dhe planifikimi i kryerjes së krimeve dhe gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Në nenin 160, Kodi Penal i parasheh dy forma të kryerjes së kësaj veprë penale: 1) organizimin e grupit për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës dhe 2) anëtarësimi në grupin e tillë⁷. Organizimi i grupit i paraparë në këtë paragraf, në fakt, është një lloj veprimi përgatitor për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Organizimi i grupit mund të shprehet me aktivitete të ndryshme të cilat ndërmerren me qëllim të krijimit të grupit dhe të kushteve për veprimtarinë e tij. Në sensin e këtij inkriminimi, organizimi i grupit për kryerjen e veprave penale të cekura në këtë nen, për shembull, mund të konsiderohen rekrutimi i anëtarëve të grupit, furnizimi me armë apo mjete për kryerjen e këtyre krimeve dhe mjeteve të tjera të domosdoshme për punën e grupit, përgatitja e planit për veprimtarinë e grupit, tubimin e anëtarëve të grupit në hapësirën e caktuar etj. Siç cekëm më sipër, kjo formë e veprës penale

⁵ Kodi Penal i Kosovës Neni 160.

⁶ Po aty., neni 160.

⁷ Ismet Salihu, Hilmi Zhitia, Fejzullah Hasani, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, botimi 1, German cooperation Giz, fq. 797-798, Prishtinë, 2014.

është e karakterit të veprimeve përgatitore dhe si e tillë është e ndeshkueshme⁸.

Vepra konsiderohet se është kryer me faktin e krijimit të grupit. Nocioni i grupit duhet nënkuptuar në kuptimin e gjerë, me të cilin nënkuptohen organizatat kriminale, bandat apo ndonjë formë tjetër e bashkimit kriminal⁹.

Anëtarësimi në grupin për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, është formë e dytë e kësaj vepre penale. Kjo formë e veprës penale konsiderohet se është kryer në rastet kur, ndonjë person në mënyra të ndryshme e manifeston vullnetin e vet që të bëhet anëtar i grupit të këtillë kriminal dhe anëtarësohet në të. Kjo mund të bëhet me deklaratën e tij eksplicite apo në mënyrë faktike, përkatësisht me sjellje të caktuara nga të cilat pa mëdyshje mund të konkludohet se kryesi me vetëdije dhe me vullnetin e tij i takon grupit të këtillë¹⁰. Kryesi i këtyre dy formave të veprave penale mund të jetë çdo person. Vepra mund të kryhet vetëm me dashje. Përmbajtja e dashjes dallon varësisht prej formës së veprës penale¹¹. Në këtë paragraf është paraparë nëse anëtari i grupit e zbulon grupin para se të ketë kryer vepër penale në llogari të grupit ose e ka ndihmuar grupin për kryerjen e veprës penale, dënohet me burgim deri në tre vjet, por gjykata edhe mund ta lirojë nga dënimi. Mundësia e dënimit më të butë apo e lirimit nga dënimi i paraparë në këtë paragraf është fakultativ dhe është paraparë për shkaqe kriminale-politike me qëllim që t'i stimulojë personat t'i zbulojnë këto organizata kriminale¹².

Duke qenë një projekt kriminal shtetëror, gjenocidi i shtetit serb në Kosovë alarmoi komunitetin ndërkombëtar dhe botën demokratike e cila, duke parë veprimet gjenocidale të pushtetit serb në Kosovë, bëri intervenimin më të madh ushtarak pas Luftës së Dytë Botërore, duke aktivizuar bombardimet e NATO-s mbi territorin e ish-Jugosllavisë, përfshirë territorin e Kosovës dhe të Serbisë. Ky bombardim synonte ta ndalojë makinerinë vrastare serbe, e cila po ushtronte gjenocid dhe po terrorizonte në mënyrë barbare popullsinë civile shqiptare në luftën e armatosur të UÇK-së për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ky intervenim nuk do të ishte i mundur sikur të mos ishte prezent manifestimi i metodave më barbare gjenocidale të Serbisë në Kosovë. Lejimi i një

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

gjenocidi të tillë pas Luftës së Bosnjës do të mundësonte një holokaust të dytë të përmasave të Luftës së Dytë Botërore dhe do të shkaktonte probleme serioze në bashkësinë ndërkombëtare.

Fazat e kryerjes së gjenocidit në Kosovë

Gjenocidi është krim që kryhet në disa faza. Krimet gjenocidale përgatiten dhe planifikohen një kohë të gjatë. Ato nuk janë krime *ad hoc*, të cilat kryhen gjatë një operacioni luftarak, apo luftë ndëretnike. Në raste të këtilla kemi të bëjmë me krime të zakonshme lufte, përkatësisht krime kundër njerëzimit. Gjenocidi, si rregull, planifikohet për një kohë të gjatë, organizohet dhe kryhet sipas një plani shtetëror sistematik dhe përfshin një proces të gjatë të diskriminimit, trajtimit barbar, qoftë në aspektin juridik apo atë politik. Krimet gjenocidale përfshijnë një proces të gjatë të planifikimit shtetëror deri tek ekzekutimi faktik dhe klasik i gjenocidit. Krimet gjenocidale nuk mund t'i kryejë një individ apo grup kriminal, por vetëm shteti me aparatit e tij represiv.

Krimet dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë kanë kaluar në disa faza, siç janë:

1. Konceptimi ideor i politikës gjenocidale të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës;
2. Okupimi i Kosovës dhe pushtimi i saj nga tri regjimet politike jugosllave;
3. Trajtimi diskriminues i shqiptarëve, vrasjet, deportimet, shpërnguljet e dhunshme, shkelja masive e të drejtave kombëtare;
4. Rianeksimi kushtetues i Kosovës pas Konferencës së Bujanit;
5. Reforma agrare dhe politikat e kolonizimit të Kosovës si parapërgatitje për gjenocid;
6. Diskriminimi kushtetues i shqiptarëve në funksion të përgatitjes së gjenocidit;
7. Rrënim i rendit kushtetues, riokupimi dhe shkatërrimi institucional i Kosovës pas 23 marsit 1989;
8. Vendosja e Kosovës në gjendje të jashtëzakonshme dhe fillim i akteve të para gjenocidale në periudhën 1990-1997;
9. Implementimi faktik i gjenocidit gjatë luftës së vitit 1998-1999 dhe

10. Mohimi aktual, në vazhdimësi, i krimeve dhe gjenocidit nga Serbia.

Të gjitha këto faza të gjenocidit serb në Kosovë, do të trajtohen në këtë studim. Me këtë rast do të analizojmë fazat e gjenocidit sipas dr. Gregory Stanton, duke i ndërlidhur ato me gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Gjenocidi është krim që kryhet në disa faza. Shkencëtarët thonë që ka dhjetë faza të gjenocidit. Faza e parë, është ndarja e shoqërisë në “ne” dhe “ata”, faza e dytë, është simbolizmi i “atyre”, faza e tretë, është diskriminimi i vazhdueshëm i “atyre”, faza e katërt, është dehumanizimi i “atyre”, personifikimi me kafshë, insekte, sëmundje, faza e pestë, është organizimi i procesit gjenocidal, faza e gjashtë, është polarizimi i popullatës përmes propagandës dhe gjuhës së urrejtjes, faza e shtatë, është përgatitja e procesit të shfarosjes, faza e tetë, është persekutimi i viktimave dhe grumbullimi në vendet e shfarosjes, faza e nëntë, është vetë procesi i shfarosjes dhe faza e dhjetë, është mohimi i gjenocidit. Të gjitha këto faza janë të dukshme dhe të identifikueshme në krimet që ndodhën në Kosovë e të cilat përkujtohen çdo 15 Janar, në ditën kur ndodhi masakra e Reçakut, në ditën kombëtare të përkujtimit të gjenocidit shtetëror serb, në Kosovë. Mohimi dhe mospranimi i këtij krimi nga shteti serb, së bashku me mospranimin dhe mohimin e gjenocidit në Srebrenicë dhe krimeve të tjera e vulosin fazën përfundimtare të krimeve që kanë ndodhur. Gjenocidi mund të quhet me emër tjetër, mund të injorohet, mund të mohohet, por nuk mund të zhduket nga memorja kolektive e një populli.¹³

Fazat e gjenocidit sipas Genocide Watch - konteksti i Kosovës

Sipas Presidentit të “Genocide Watch”, Stanton, gjenocidi zhvillohet në tetë faza¹⁴. Le t’i analizojmë këto tetë faza në kontekstin e gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

1. Klasifikimi: njerëzit ndahen në “**ne dhe ata**”¹⁵. Ky proces në rastin e Kosovës ishte kontinuel në ish-Jugosllavi. Shqiptarët ishin të

¹³ Stanton, H. Gregory (2020) “*The Ten Stages of Genocide*”.

¹⁴ Dr. Gregory Stanton, President i Genocide Watch, është profesor hulumtues në studimet e gjenocidit në George Mason University, Arlington, Virginia, USA dhe President i Genocide Watch.

¹⁵ Stanton, H. Gregory (2020) “*The Ten Stages of Genocide*”.

klasifikuar si pakicë kombëtare me etiketime fyese dhe shoviniste si popull i paemancipuar, i paformuar politikisht dhe i rrezikshëm për shtetin.¹⁶ Edhe pse kombi i tretë për nga madhësia pas serbëve dhe kroatëve, shqiptarët, trajtoheshin si pakicë kombëtare dhe i nënshtroheshin diskriminimit nacional dhe terrorit shtetëror. Në të vërtetë, klasifikimi në "ne dhe ata" që përdor dr. Gregory Stanton, në Kosovë stigmatizonte shqiptarët si popull i nivelit të ulët, duke kontestuar dhe mohuar identitetin e tyre kombëtar dhe duke zbatuar politikën nënshtroese dhe diskriminuese ndaj tyre për shkak të përkatësisë etnike. Madje ky stigmatizim, nganjëherë merr edhe karakter etnocidal dhe psikologjik, duke i trajtuar "*shqiptarët primitivë dhe të prapambetur*"¹⁷ si produkt i mjedisit gjeografik që i bëri të paaftë për jetë shtetërore të pavarur.¹⁸ Për më tepër, një tjetër ultranacionalist serb thekson se "shqiptarët kanë disa veçori psikike, të cilat i bëjnë njerëz të paqytetëruar, anarkist, plaçkitës, të vrazhdë, të gjerë dhe pa vetëdije kombëtare. Ndër ta mbretëron hakmarrja dhe vëllavrasja".¹⁹ Ky demonizim i shqiptarëve në historio-grafinë serbe "me dimensione psikologjike" ka përfunduar shpesh me akte të gjenocidit. Me këtë sindrom janë ngritur determinantet e gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve.²⁰

2. Simbolizmi: "Kur të kombinohen me urrejtje, simbolet mund të asociohen mbi anëtarët keqdashës të grupeve viktime...Për të luftuar simbolizmin, simbolet e urrejtjes mund të ndalohen me ligj, si dhe gjuha e urrejtjes." Kjo fazë e përgatitjes së gjenocidit ndaj shqiptarëve ishte konsistente në ish-Jugosllavi, e cila ndalonte simbolet identitare të shqiptarëve, ata i identifikonte me simbole dhe shprehje denigruese dhe fyese si "terroristë", "irredentistë", "separatistë", "shqiptaromëdhenj", "kanibalistë" dhe shprehje të tjera fyese dhe denigruese²¹.

¹⁶ Ky klasifikim, përpos qasjes denigruese politike, kishte edhe karakter legal dhe kushtetues. Që nga themelimi i RSFJ-së në vitin 1945, e deri te shpërbërja e saj në vitet 90, edhe pse shqiptarët në ish-Jugosllavi ishin kombi i tretë për nga madhësia, menjëherë pas serbëve dhe kroatëve, ata trajtoheshin si pakicë kombëtare në mënyrë diskriminuese pa të drejta kolektive politike, të cilat u njiheshin kombeve të tjera numerikisht më të vogla.

¹⁷ Kryeministrja serbe Bërnabiç kishte deklaruar se "shqiptarët janë njerëz të ardhur nga mali". <https://politiko.al/i-quajti-shqiptaret-njerez-te-ardhur-nga-mali-si-i-pergjigjet-gazetari-shqiptar-kryeministres-serbe-video/>.

¹⁸ Vladan Djordjevic, *Arnauti I velike sile*, Beograd, 1913, fq. 39.

¹⁹ Jovan Cvejic, *Balkansko polustrovo i juznoslavenske zemlje*, Beograd, 1966.

²⁰ Akademik Pajazit Nushi, *Determinantet psikosociale të gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve dhe struktura kognitive e tyre*, ASHAK, 1995, fq.45.

²¹ Me dhjetëra terma fyes Serbia kishte krjuar për të trajtuar shqiptarët si racë e keqe që duhet zhdukur si "nacionalistë", "irredentistë", "fundamentalistë islamë" "shiftari",

3. Dehumanizimi: "Dehumanizimi mundëson tejkalimin e nevrisë normale njerëzore." Gjenocidi i Serbisë në Kosovë, krahas brutalitetit dhe terrorit shtetëror synonte skllavërimin e shqiptarëve dhe trajtimin e tyre dehumanizues dhe mohues. Trajtimi dehumanizues si fazë e trajtimit gjenocidal synon rrezikimin e ekzistencës biologjike, vënien në pozitë varfëruese, mungesën e ushqimeve, kushteve jetësore të banimit dhe trajtimit tjetër johuman. Një qasje e tillë ndaj shqiptarëve ka qenë tipike me shekuj për shqiptarët e Kosovës, të cilët janë ballafaquar me trajtim skllavërues, poshtërim dhe luftë për mbijetesë fizike²².

4. Organizimi: "*Gjenocidi është gjithmonë i organizuar.* Forca të veçanta ushtarake apo paramilitare shpesh armatosen dhe trajnohen. Për të kaluar këtë fazë, anëtarësimi në këto grupe duhet të ndalohet me ligj." Ky tipar i veprimit gjenocidal në rastin e Kosovës është shumë transparent dhe botërisht i ditur, sepse shteti serb ka qenë ideator, organizator dhe implementues i politikave gjenocidale ndaj shqiptarëve të Kosovës. Gjenocidi serb në Kosovë ka qenë ndërmarrje shtetërore dhe krim i organizuar gjenocidal, për zbatimin e të cilit kanë qenë të mobilizuar të gjitha resurset shtetërore dhe ushtarake, përfshirë këtu, edhe mobilizimin dhe armatosjen selektive të popullsisë civile me qëllim të zbatimit të projektit gjenocidal. Për më shumë, forcat e rregullta ushtarake, formacionet joformale kriminale, qytetarë serbë të mobilizuar dhe të armatosur kanë qenë të trajnuar në mënyrë të veçantë se si duhet kryer krime gjenocidale ndaj shqiptarëve.²³

5. Polarizimi: "Grupet urryese shpërndajnë propagandë polarizuese. Ndalimi i kësaj arrihet nëpërmjet mbrojtjes së udhëheqësve të moderuar ose ndihmesës së grupeve për të drejtat e njeriut." Polarizimi si tipar i gjenocidit serb është krijuar nëpërmjet propagandës mediale të

"arnaut", "terroristë", "irredentistë", "separatistë", "shqiptaromëdhenj", "kanibalistë" dhe shprehje të tjera fyese me të cilat shqiptarët simbolizoheshin dhe stigmatizoheshin si popull primitiv.

²² Dehumanizimi i shqiptarëve pas viteve 90, pas largimit masiv të shqiptarëve nga puna pas okupimit serb ka qenë një dukuri masive e cila ka prekur identitetin dhe integritetin personal dhe familjar të shumë shqiptarëve. Të ballafaquar me politikën e aparteidit dhe segregacionit, shqiptarët u ballafaquan me varfëri ekstreme dhe luftë për mbijetesë biologjike. Jo pak intelektualë, madje edhe profesorë universitarë në luftë për ekzistencë braktisën profesionet e tyre dhe punonin si taksistë veturash, shitës në treg, punëtorë krahu etj. Kjo qasje dehumanizuese, sipas Planit gjenocidal kishte për qëllim skllavërimin e shqiptarëve dhe detyrimin e tyre ta braktisin Kosovën në luftë për ekzistencë.

²³ Krahas organizimit të planit gjenocidal, në Serbi gjate viteve 1998-1999, të gjitha resurset shtetërore ishin në dispozicion të zbatimit të kësaj fushate gjenocidale.

orkestruar nga shteti në funksion të stigmatizimit të shqiptarëve në baza etnike dhe krijimit të opinionit publik për arsyeshmërinë e trajtimit represiv kolektiv ndaj tyre. Në kuadrin e këtij trajtim gjenocidal, Serbia çdo herë ka qenë në kërkim të të ashtuquajturave “shqiptarë të ndershëm”, të cilët i kundërvihen kombit të vet dhe shërbejnë si marionetë lojale për të legjitimuar veprimet gjenocidale.²⁴

6. Identifikimi: "Viktimat identifikohen dhe ndahen në bazë të identitetit etnik apo religjioz... Në këtë fazë, një alarm i gjenocidit duhet të thirret..." Objekt i gjenocidit serb kanë qenë qytetarët e Kosovës të identifikuar si shqiptarë. Pra, jo bindjet politike, sociale e kulturore, por identifikimi i tyre si shqiptarë dhe kualifikimi i tyre gjenocidal si “racë e keqe”, e cila duhet zhdukur me të gjitha mjetet në dispozicion. Masakrat shekullore, vrasjet barbare e mizore, inkuizicioni morbid ndaj shqiptarëve e ka origjinën te identifikimi i tyre etnik si shqiptarë.²⁵

7. Asgjësimi: ndërmarrja gjenocidale serbe në Kosovë kishte për synim asgjësimi fizik kolektiv të shqiptarëve, shfarosjen e tyre dhe parandalimin e kthimit të tyre në trojet etnike, me qëllim që me kalimin e kohës të zhduket kujtesa për ekzistencën e tyre kolektive në Kosovë. Më vonë do të shihet se operacioni gjenocidal “Patkoi” kishte si synim kryesor asgjësimin dhe shfarosjen kolektive të shqiptarëve nga trojet etnike të tyre dhe popullzimin e Kosovës me serbë dhe popuj të tjerë joautoktonë.²⁶

8. Mohimi: “Autorët e krimit... mohojnë kryerjen e ndonjë krimi... Përgjigjja ndaj mohimit është dënimi nga një tribunal ndërkom-bëtar apo gjyq kombëtar.”²⁷ Mohimi i krimeve dhe gjenocidit paraqet një formë të bashkëpjesëmarrjes në krim dhe gjenocid. Disa legjislacione penale e sanksionojnë mohimin e gjenocidit si krim kundër

²⁴ Tendencat serbe për t’i polarizuar shqiptarët në baza fetare si të krishterë dhe myslimanë, si “pacifistë” dhe “terroristë”, si të moderuar, të ndershëm apo si radikalë e nacionalistë kishin dështuar, sepse shqiptarët si komb ishin viktimë e politikave gjenocidale dhe këto përpjekje përçarëse serbe ndaj shqiptarëve kishin dështuar.

²⁵ Gjatë fushatës së veprimeve gjenocidale, Serbia kishte identifikuar shqiptarët si komb që duhej shfarosur me metoda gjenocidale. Grupet e tjera etnike, të cilat jetojnë tradicionalisht në Kosovë nuk ishin target i veprimeve gjenocidale.

²⁶ Asgjësimi i shqiptarëve nga trojet e tyre etnike, kishte përsynim dekompozimin dhe shthurjen institucionale të tyre, deportimet e dhunshme dhe ndërmarrjen e masave për parandalimin e kthimit të tyre në territoret etnike. Kjo bëhej me qëllim spastrimi etnik, okupimi dhe ndryshimit demokratik të popullësisë së Kosovës.

²⁷ Stanton, H. Gregory (2020), po aty.

njerëzimit dhe parashikojnë dënime të larta për autorët e kësaj vepre penale.²⁸

Në rastin e Kosovës, mohimi i gjenocidit paraqet një politikë zyrtare të shtetit serb. Jo vetëm që nuk ka treguar asnjë reflektim për përgjegjësinë shtetërore për krimet dhe gjenocidin në Kosovë, por Serbia aktualisht mohon krimet e kryera dhe vazhdon me retorikën gjenocidale të viteve 90. Filluar nga Presidenti Vuçiç, e deri te zyrtarët e tjerë serbë në nivel të Serbisë, por edhe atyre në Kosovë vazhdojnë ta mohojnë gjenocidin e kryer dhe në kontinuitet nxisin urrejtje etnike ndaj shqiptarëve. Në anën tjetër, protagonistëve dhe autorëve të gjenocidit në Serbi u ndërtohen mite si heronj kombëtarë dhe emrat e tyre portretizohen dhe mitizohen në folklorin serb dhe ikonografinë fetare e forma të tjera. Nuk ka pasur raste të inkriminimit penal të personave që publikisht mohojnë apo i arsyetojnë krimet dhe gjenocidin. Një përjashtim të izoluar paraqet rasti i një ministri serb në qeverinë e Kosovës, i cili ishte shkarkuar për shkak të mohimit të masakrës së Reçakut dhe deklaratave të tjera fyese ndaj shqiptarëve. Mohimi dhe mospranimi i këtij krimi nga shteti serb, së bashku me mospranimin dhe mohimin e gjenocidit në Srebrenicë dhe krimeve të tjera e vulosin fazën përfundimtare të krimeve që kanë ndodhur.

Plani gjenocidal i Serbisë në Kosovë²⁹

Element thelbësor i gjenocidit është ekzistenca e planit gjenocidal. Konventa e Gjenocidit, krahas 5 kritereve konstitutive të figurës së veprës penale të gjenocidit, parasheh si element esencial ekzistimin e planit apo projektit gjenocidal. Edhe Rafael Lemkin, si dhe studiues të tjerë, të cilët janë marrë me studimin e aspekteve teorike të gjenocidit, e theksojnë si element konstitutiv dhe kryesor, për krimet dhe gjenocidin, ekzistimin e një plani gjenocidal, si një plan zyrtar dhe i orkestruar nga shteti.

Në miratimin e tij fillestar, si ligj ndërkombëtar, në Kongresin e Gjenevës, Rafael Lemkin, themelues i veprës penale të gjenocidit ka

²⁸ Serbia jo vetëm që kreu gjenocid në Kosovë, por ajo vazhdon të mohojë krimet e kryera ndaj shqiptarëve dhe destrucionin e shtetit të Kosovës duke e kërcënuar atë me agresion kushtetues dhe riokupim të sërishëm.

²⁹ Duke qenë se ky studim është i pari këtij lloji në Kosovë, që pretendon të zbërthejë Planin e Gjenocidit të Serbisë në Kosovë, kjo analizë reflekton pikëpamjet personale të autorit dhe nuk mbështetet në asnjë burim zyrtar dhe jozyrtar.

thënë: “gjenocid nuk do të thotë shkatërrim i menjëhershëm i një kombi përveç kur arrihet vrasja masive e të gjithë anëtarëve të një kombi. Përkundrazi, gjenocidi nënkupton një plan të koordinuar të veprimeve të ndryshme me qëllim të shkatërrimit të bazave thelbësore të jetesës së grupeve kombëtare me qëllim të shkatërrimit të vetë grupeve. Qëllimi i këtij plani është shpërbërja e institucioneve politike dhe sociale, kulturore, gjuhësore, ndjenjave kombëtare, religjionit dhe mbijetesës ekonomike të grupeve kombëtare dhe shkatërrimin e sigurisë personale, lirisë, shëndetësisë, dinjitetit e madje edhe jetët e individëve të cilët janë pjesë e grupeve të tilla³⁰”. Edhe sipas profesorëve eminentë shqiptarë të së drejtës penale, prof. Ismet Elezi dhe prof. Ismet Salihu, si kusht për ekzistimin e gjenocidit është “*Zbatimi të një plani të paramenduar, që synon shkatërrimin e tërësishëm apo të pjesshëm të një grupi nacional, etnik, racor apo fetar, i drejtuar nga organet e një shteti*”³¹

Plani gjenocidal duhet të paraqesë një projekt zyrtar shtetëror, i cili përfshin një fushatë të orkestruar³² nga shteti, kundrejt një grupi, përkatësisht kombi me synim të shfarosjes së tij dhe dëmtimi esencial të substancës së tij biologjike.³³ Serbia, para se të fillojë fazën e fundit të implementimit të gjenocidit, gjatë viteve 1998/1999 e kishte të operacionalizuar në detaje planin gjenocidal ndaj shqiptarëve të Kosovës. Ai plan, synonte spastrimin etnik dhe dhunën shtetëror me tipare të gjenocidit klasik. Ky nuk ishte një plan luftarak, për një fitore ushtarake ndaj UÇK-së që zhvillonte një luftë çlirimtare apo NATO-s që bombardonte caqet serbe, por një plan i sofistikuar për shfarosje masive të shqiptarëve. Nisur nga kjo, në frymën e Konventës së Gjenocidit, nuk është esenciale për krimet si gjenocid numri i të vrarëve, të masakruarve, të deportuarve dhunshëm, por fakti se ka ekzistuar apo jo një plan gjenocidal, i cili është vënë në aktivizim gjatë luftës apo konfliktit të armatosur. Së fundmi, siç kemi theksuar edhe më herët, gjenocidi mund të kryhet edhe në kohë paqe kur ndaj një grupi etnik apo kombi zbatohen politika gjenocidale.

Plani i Gjenocidit i Serbisë në Kosovë nuk paraqet një dokument të vetëm të kodifikuar. Duke qenë se ky studim, paraqet projektin e parë

³⁰ Raphael Lemkin, *Axis Rule in Occupied Europe (Wash., D.C.: Carnegie Endowment for International Peace, 1944), fq. 79.

²⁵⁷ Sidorela Jança “Çfarë është GJENOCIDI?”.
https://www.academia.edu/6971739/Cfare_eshte_GJENOCIDI.

³¹ Po aty.

³² Poaty.

³³ Shih më gjerësisht dr. Gregory H. Stanton “The Purposes of Genocide Research”, 2014.

hulumtues në këtë temë, do të bëjmë përpjekje të zërthejmë elementet e planit gjenocidal. Janë dhjetë elemente kryesore të këtij plani.

1. Platforma politike e PGJ
2. Plani operativ policor-ushtarak
3. Konsensusi shtetëror dhe ushtarak
4. Bartësit e zbatimit të Planit Gjenocidal
5. Metodologjia e Planit Gjenocidal
6. Periudha kohore e zbatimit të Planit Gjenocidal
7. Objektivat e Planit Gjenocidal
8. Financimi i Planit Gjenocidal
9. Zhdukja e gjurmëve të gjenocidit
10. Mohimi i gjenocidit

1. Platforma politike e Planit Gjenocidal

Platforma politike për të kryer gjenocid është ndërtuar historikisht si pjesë e ideologjisë shoviniste dhe fashiste ndaj shqiptarëve.

Serbia përmes ideologjisë së klerofashizmit ortodoks serb i ka ideuar të gjitha projektet e qeverive serbe për të pushtuar, aneksuar, përmes gjenocidit, territoret shqiptare. Në thelb të asaj ideologjie serbo-madhe, pra, me fokus të veçantë të shqiptarofobisë, ishte dhe fuqishëm vazhdon të jetë urrejtja ndaj shqiptarëve, si racë, si qenie njerëzore dhe, para së gjithash, si komb. Ka shënime se, së paku janë 24 plane e programe të hapura e të fshehta për zhdukjen e shqiptarëve, duke filluar nga “Naçertania” e Ilija Garashaninit (1844); “Gorski vijenac” i P. P. Njegoshit (1846); “Srbi svi i svuda” i V. Karaxhiçit (1849), projektet e Jovan Cvejiçit (1912 e 1921), të përpunuara më vonë nga Vasa Çubri-loviçi në elaboratin e tij: “Manjinski problemi u Jugoslaviji” (1937; 1944); “Elaborat o Albaniji” i Ivo Andriçit (1939); “Homogena Srbija” e Stevan Moleviçit (1941); Programi i çetnikëve të Drazha Mihajloviçit (1941); deri te Plani “Patkoi” (1999) për zhdukjen dhe dëbimin e të gjithë shqiptarëve nga Kosova. Për konceptin për “Serbinë e Madhe” elita politike, intelektuale dhe kishtarë kanë përgatitur platforma, plane e programe të shumta, të cilat në kohë të përshtatshme i ka zbatuar shteti, duke kryer krime makabre, në përmasa gjenocidi. Pjesë e kësaj ideologjie ishte edhe “Libri i Kaltër” dhe “Memorandumi i ASSHA”. Platforma e gjenocidit e ndërtuar në dy shekujt e fundit gjeti finalizimin

e saj në fund të viteve 80, kur fillon shkatërimi i Federatës Jugosllave dhe në skenë doli nacionalizmi serb në krye me Slllobodan Miloševićin. Në esencën e platformës serbe për të kryer gjenocid ndaj shqiptarëve të Kosovës ishin dhe vazhdojnë të jenë, pretendimet territoriale për të okupuar territorin e saj dhe shkatërruar çdo aspiratë të shqiptarëve për liri, barazi dhe pavarësinë e Kosovës.

2. Plani operativ policor-ushtarak

Elementi i dytë i planit gjenocidal të Serbisë në Kosovë ishte plani operativ policor-ushtarak për zbatimin e platformës politike, serbe për fushatën e gjenocidit në Kosovë. Ky plan u përgatit në qarqet më të larta ushtarake dhe policore të RF të Jugosllavisë dhe Serbisë. Ai përfshinte, një varg të operacioneve ushtarake dhe policore për të riokupuar Kosovën, duke filluar fushatën gjenocidale dhe realizimin e objektivave të tjera të planit gjenocidal. Plani ka filluar të implementohet më 5 korrik 1990. Tri ditë pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, me vendim të Kuvendit federativ dhe organeve të Serbisë në Kosovë u dërguan njësitë speciale të policisë. Fillimisht, Serbia okupoi të gjitha institucionet legjitime të Kosovës, duke i larguar dhunshëm me forca policore shqiptarët nga vendet e tyre të punës, për të vazhduar me instalimin e masave të dhunshme dhe kontroll policor të të gjitha institucioneve publike të Kosovës. Pas pastrimit etnik të institucioneve dhe okupimit të tyre, Serbia në funksion të përgatitjes së fushatës gjenocidale e vazhdoi politikën e represionit shtetëror, i cili u intensifikua sidomos pas përfundimit të agresionit të saj në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Humbja e tri luftërave agresive të Serbisë, bëri që ajo të koncentrojë më shumë se 100.000 trupa ushtarake dhe policore në Kosovë. Ato në emër të “gjoja luftës kundër UÇK-së” filluan fushatën e spastrimit etnik dhe veprimeve të tjera gjenocidale. Këtyre trupave iu bashkëngjitën edhe grupet kriminale (formacione paramilitare) të ardhura nga Kroacia dhe Bosnja, të cilat sipas një plani shtetëror, do të kryenin krimet më barbare në Kosovë kundër shqiptarëve. Dalja publike e UÇK-së, ishte një pretekst që Serbia të fillojë fazën e fundit të planit gjenocidal. Duhet të kujtojmë se vetëm brenda një dekade, që domethënë brenda viteve 1990-1999, Serbia ka dekretuar 4 projekte që kanë pasur si qëllim jo vetëm luftën propagandistike, përçarjen, survejimin, kriminalizimin por edhe gjenocidin e shpopullimin e shqiptarëve:

- Projekti “Gërshërët” i cili kishte objektiv infiltrimin dhe kontrollin e jetës dhe të skenës politike të Kosovës;
- Projekti “Kafshimi i miut” i cili kishte objektiv infiltrimin dhe shkatërrimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
- Projekti “Patkoi” i cili kishte qëllim spastrimin definitiv etnik të Kosovës;
- Si dhe planin e njohur me emrin “Leopardi” përmes të cilit zbatohesh një metodë e sinkronizuar nga ushtria, policia dhe militarët serbë: “frikëso dhe sulmo, fut nëpër bodrume njerëz të pambrojtur në fshat ose në një lagje të qytetit, në mënyrë që të lëvizë pastaj nga frika e tërë popullsia”.

3. Konsensusi shtetëror dhe ushtarak

Gjenocidi serb në Kosovë u orkestrua nga shteti serb. Lufta e vitit 1998-99 ishte, në të vërtetë, faza e tretë e projektit gjenocidal të Serbisë në Kosovë kur, në të vërtetë, u bë implementimi faktik i politikës zyrtare të Serbisë për të shkatërruar Kosovën dhe shqiptarët. Ky plan u dizajnuar në qarqet më të larta shtetërore ushtarake, politike dhe fetare të Serbisë. Plani, kishte të sofistikuar të gjitha veprimet e dhunshme të shtetit serb që do t'i ndërmerre ndaj shqiptarëve për qëllime gjenocidale. Mund të thuhet se, ai plan, në aspektin ushtarak ishte i përpunuar në qarqet më të larta të ushtrisë serbe dhe se ai ishte si një plan sekret për të cilin dinte kryesisht kreu shtetëror serb, ushtarak dhe njerëz të informuar nga afër, për politika gjenocidale të Serbisë në Kosovë. U potencua edhe më lart, i ashtuquajtur plan, apo plani i koduar “Patkoi”. Ky plan u zbulua edhe nga institucionet ndërkombëtare dhe nënkuptonte vrasjen masive të shqiptarëve të Kosovës, spastrimin etnik me depërtimin e dhunshëm të shqiptarëve jashtë kufijve etnikë të Kosovës. Plani bazohet në politikën e “tokës së djegur” dhe ndërmarrjen e një varg masash represive me qëllim të shfarosjes së shqiptarëve për shkak të përkatësisë etnike, shkatërrimit të të gjitha institucioneve të Kosovës dhe ndërmarrjen e masave të tjera me qëllim të humbjes së identitetit të shqiptarëve të Kosovës dhe parandalimit të dëshirës së tyre për kthim në territorin e Kosovës. Plani “Patkoi”, për të cilin dy vjet më herët një ish-udhëheqës komunist maqedon Kiro Gligorov³⁴, kishte alarmuar që

³⁴ Kiro Gligorov ishte udhëheqës LKJ-së në Jugosllavi dhe Maqedoni. Ai shumë më herët kishte njohuri për planin serb të gjenocidit “Patkoi” dhe kishte alarmuar për krizën

po përgatitet një eksod masiv i më shumë se një milion shqiptarëve për në Maqedoni, u mbajt sekret dhe ai u bë transparent në fillim të luftës në Kosovë. Me fillimin e luftës, Serbia aktivizoi aparatit represiv me vrasje, masakra, tortura, djegie të fshatrave dhe qyteteve të Kosovës, shkatërrim të pronës publike dhe private, deportim të dhunshëm të shqiptarëve për në Shqipëri dhe Maqedoni. Me spastrim masiv etnik, plaçkitje të pronave shqiptare dhe ndërmarrjen e masave për zhdukjen e identitetit të shqiptarëve synohej të realizohet një nga qëllimet e gjenocidit, parandalimin e dëshirës së popullit shqiptar të Kosovës për t'u kthyer në trojet e veta etnike shekullore në Kosovë.

Krimet në masë, vrasja e shqiptarëve të paarmatosur, pleq, gra e fëmijë, plaçkitja e pasurisë së tyre, djegia dhe shkatërrimi i vendbanimeve shqiptare, spastrimi etnik dhe shpërngulja e popullatës shqiptare nga toka e tyre-Kosova (1998-1999) dhe dhunimi i mijëra femrave shqiptare, nuk ishin veprime aksidentale-spontane, por të organizuara e planifikuara mirë nga Serbia si shtet. Gjenocidi në Kosovë u krye sipas një plani kolektiv shtetëror, të cilin Shtabi kriminal i Milosheviçit e kishte emërtuar "Potkovica"-Plani "PATKOI".³⁵ Në realizimin e këtij plani famëkeq, Serbia mobilizoi të gjitha resurset njerëzore dhe teknologjike, si: administratën shtetërore, transportin publik, mjetet financiare, mediet, gjyqësinë dhe mbi të gjitha, strukturën e gjerë ushtarake-policore e paramilitare. Duke filluar nga korpusi ushtarak i Prishtinës, që përbënte superstrukturën e Armatës së tretë serbe në Kosovë, Korpusin 21 të Nishit, Korpusin 37 të Uzhicës, Korpusin 24 të Kragujevcit, Korpusin special dhe Armatën e parë të Beogradit, Korpusin e dytë të Podgoricës, strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, policinë e rregullt të Kosovës, Forcat speciale të policisë. Po ashtu, pjesë e aparatit represiv ishin dhe forcat e ashtuquajtura antiterroriste, Shërbimin e Sigurimit Serb (UDB-ja), dhe njësitë e ashtuquajtura paramilitare, "Shkorpionët", "Tigrat e Arkanit", "Beli Orlovi" (Shqiponjat e Bardha) të Vojislav Sheshelit, "Beretat e Kuqe", njësitë kriminale të serbëve lokalë etj.³⁶

Në aspektin penalo-juridik, gjenocidi i Serbisë në Kosovë paraqet një krim shtetëror të ushtruar me një dashje dhe vullnet të plotë të shtetit

humanitare, e cila do ta godiste Maqedoninë me deportimin e dhunshëm të rreth 1 milion shqiptarëve në territorin e Maqedonisë. Për herë të parë ai e bëri publike informatën për planin "PATKOI" të Milosheviçit që po i krijonte "korridoret përplasëse".

³⁵ Sheradin Berisha, Gjenocidi si krim kundër njerëzimit dhe përmasat e gjenocidit serb në Kosovë (1998-1999).

³⁶ Po aty.

serb nëpërmjet institucioneve të tij shtetërore, politike, ushtarake dhe mekanizmave brutalë represivë që u përdorën për këtë çështje. Shteti serb, me politikën e tij të gjenocidit ndaj Kosovës kishte ndërtuar një konsensus të plotë të shoqërisë serbe, të njëjtë me situatat e fashizmit të vitit 1941-1945, duke krijuar kauza të rrejshme për gjoja rrezikimin e serbëve në Kosovë, ngjashëm siç kishte bërë edhe Gjermania e Hitlerit në kohën e fashizmit. Në aspektin penalo-juridik, kryes i veprës së gjenocidit në Kosovë është vetë shteti serb. Kurse individët, të cilët, kanë drejtuar politikën e gjenocidit serb në Kosovë, duke filluar nga presidenti Milosheviç, qeveria, parlamenti, strukturat ushtarake, komanduese, pastaj të ashtuquajturat, formacione joformale, kanë qenë dorë e zgjatur apo instrumente të shtetit serb, duke zbatuar planin shtetëror gjenocidal ndaj shqiptarëve. Nisur nga kjo, përgjegjësia penale për gjenocidin e ushtruar nga Serbia në Kosovë i takon shtetit serb si person juridik dhe si subjekt shtetëror. Kurse përgjegjësia individuale për krimet dhe gjenocidin i ngarkon personat apo individët të cilët kanë udhëhequr fushatën e gjenocidit, qoftë në aspektin e drejtimit politik dhe shtetëror, apo zbatimin praktik të veprimeve gjenocidale. Është shumë lehtë të provohet se gjenocidi i Serbisë në Kosovë ka qenë plan shtetëror i dizajnuar në detaje, faza dhe në forma konkrete të zbatimit të tij. Nga vitet 1990 - 1998, ky plan kishte filluar të bëhet transparent dhe të zbatohet në faza. Fillimisht, në fazën e parë nga 5 korriku i vitit 1990, Serbia shkatërroi autonominë e Kosovës, që ishte ngritur në bazë të Kushtetutës të vitit 1974, e riokupoi sërish Kosovën dhe bëri puç kushtetues duke okupuar të gjitha institucionet kushtetuese, legjitime të Kosovës. Pas riokupimit të Kosovës, shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe marrjes nën kontroll të të gjitha institucioneve të Kosovës, Serbia zbatoi politikën e spastrimit etnik, duke larguar nga puna qindra dhe mijëra shqiptarë, duke mbyllur të gjitha institucionet shtetërore, qeverisëse, edukative, kulturore, informative, shëndetësore dhe veprime të tjera të cilat ishin veprime gjenocidale të kombinuara me një aparteid klasik dhe diskriminim të shqiptarëve në baza etnike.

Menjëherë, pas riokupimit të Kosovës, shteti serb filloi zbatimin e politikave represive ndaj shqiptarëve, të cilat synonin ta përgatitsnin momentumin faktik për implementimin klasik të gjenocidit serb në Kosovë. Pas daljes në skenë të UÇK-së, Serbia në pamundësi që të ballafaqohej me këtë guerilë patriotike shqiptare, e cila u vu në funksion të luftës mbrojtëse, filloi zbatimin e masakrave dhe veprimeve të tjera terrorizuese ndaj popullsisë civile. Me këtë, filloi faza e fundit dhe e tretë e implementimit faktik të gjenocidit. Natyrisht, në këtë fazë shteti

serb implementoi të gjitha planet e saj shtetërore për të arritur objektivat e plota të gjenocidit. Nga aspekti i së Drejtës Ndërkombëtare Penale, shteti serb gjatë viteve 1998-1999, përdori dhe zbatoi të gjitha metodat brutale të gjenocidit, të përcaktuara me Konventën e OKB-së së vitit 1948 për krime dhe gjenocid.

4. Bartësit e zbatimit të planit gjenocidal

Implementimi i gjenocidit shtetëror të Serbisë në Kosovë u realizua nga institucionet më të larta shtetërore të këtij shteti. Në skemën piramidale gjenocidale, në krye të kësaj ndërmarrjeje kriminale qëndronte, Slobodan Milosheviçi, i cili në fund ishte vetëm një implementues faktik i një projekti shtetëror të dizajnuar me shekuj e në mënyrë të veçantë, gjatë vitit 1990-1998. Slobodan Milosheviçi, arriti të homogjenizonte popullin serb dhe shoqërinë serbe në projektin e tij gjenocidal ndaj Kosovës. Ai u vu në krye të një skeme piramidale, e cila mbi bazën e nacionalizmit dhe shovinizmit serb ndaj shqiptarëve filloi zbatimin klasik dhe faktik të gjenocidit në Kosovë. Krahas Slobodan Milosheviçit, në zinxhirin institucional të gjenocidit serb ishte qeveria serbe, Kuvendi i Serbisë, ushtria e rregullt, policia, formacionet joformale kriminale të financuara nga Serbia, Kisha Ortodokse Serbe, Akademia Serbe e Shkencave, partitë politike, qoftë ato të pozitës apo opozitës dhe të gjitha institucionet e tjera politike dhe jopolitike të shtetit serb.

Hierarkia e gjenocidit serb në Kosovë paraqet një skemë kriminale zinxhimore, institucionale e cila, sipas një renditjeje të lirë do të mund të dukej kështu:

1. Slobodan Milosheviçi, president i Serbisë, udhëheqës dhe urdhërdhënës kryesor i gjenocidit;

2. Kuvendi dhe Qeveria e Serbisë

1. Armata Popullore e Jugosllavisë e konvertuar në Ushtrinë e Serbisë, si implementuese e drejtpërdrejtë e okupimit të Kosovës dhe ushtruese e krimeve gjenocidale;

2. Policia e Serbisë me të gjitha njësitë e saj speciale,

3. Njësitë joformale kriminale,

4. Kisha Ortodokse Serbe,

5. Pjesëtarët e të ashtuquajturës mbrojtje territoriale në Serbi;

6. Serbët lokalë të Kosovës

7. Mercenarët
8. Mediet serbe në krye me RTS-në, Gazetën, “Politika”, etj.

5. Metodologjia e planit gjenocidal

Metodologjia e zbatimit të planit për gjenocid ka qenë e përpunuar në detaje dhe të gjitha krimet janë kryer sipas një skenari të paraparë më parë. Për më tepër, në vazhden e fushatës gjenocidale, presidenti serb Milutinoviç kishte sjellë një pako të dekretëve me fuqi ligjore, të cilat ishin në funksion të zbatimit të gjenocidit. Madje edhe TPNJ në rastin e akuzimit të grupit drejtues të gjenocidit (Milosheviçi dhe të tjerët) kishte theksuar se këto dekrete, të nxjerra gjatë luftës në Kosovë ishin në funksion të spastrimit etnik, deportimeve të dhunshme, zhdukjes së identitetit të shqiptarëve dhe krimeve të tjera.

Në kuadër të metodologjisë së zbatimit të planit gjenocidal, fillimisht ishin ndarë veprimet kriminale që do t'i kryenin: formacionet e rregullta ushtarake, forcat speciale policore, grupet kriminale (paramilitare) të ardhura nga Kroacia e Bosnja dhe serbët lokalë. Pra, ka ekzistuar një plan i detajuar i veprimit kriminal dhe ndarja e detajuar e angazhimeve të secilit segment të aparatit gjenocidal që pasohej në dy kritere:

- a. Kriterin territorial
- b. Llojin e krimeve gjenocidale

Sipas kriterit territorial, forcat e ushtrisë së rregullt ishin të pozicionuara në tërë territorin e Kosovës, në veçanti, në zonat ku UÇK-ja zhvillonte luftë mbrojtëse. Garnizone të tëra të ushtrisë federale dhe serbe ishin dislokuar në të gjitha komunat e Kosovës, në mënyrë të veçantë në Drenicë, Dukagjin, Pashtrik, Llap e zona të tjera ku vepronte UÇK-ja. Njësitë e specializuara policore kishin disa baza të stacionimit, dhe vepronin me metoda lëvizëse duke kryer masakra, deportime të dhunshme dhe djegie masive të fshatrave dhe qyteteve të Kosovës. Kurse, njësitë joformale dhe bandat kriminale, sipas ndarjes së punëve me planin gjenocidal, ishin ekzekutuese të krimeve më të rënda, masakrave, djegies së kufomave, dhunimeve seksuale, djegies së fshatrave e qyteteve, plaçkitjeve masive dhe krimeve të tjera. Asgjë nga krimet gjenocidale serbe nuk ka qenë e rastësishme dhe spontane. Gjithçka ishte e planifikuar dhe koordinuar në detaje, që nga ndarja e punëve dhe zonave ku kryheshin veprimet gjenocidale e gjerë te koalicioni i

sofistikuar kriminal i ushtrisë së rregullt, policisë speciale dhe bandave kriminale. Kjo vërtetohet edhe me ngjashmëritë e protokollit kriminal që është zbatuar në kuadër të PGJ në Kosovë. Krimet dhe zhdukja e gjurmëve të tyre, ishin strategji të planifikuara që nga kreu i shtetit, Slobodan Milosheviçi, Shtabi i Përgjithshëm dhe nivelet e tjera për eliminimin e shqiptarëve dhe spastrimin etnik të Kosovës. Sistemi i spastrimit etnik të Kosovës ishte i përpunuar dhe zbatohet me përpikëmeri: granatoheshin fshatrat, hynin policia, ushtria e paramilitarë të ngjyrave të ndryshme, vrisnin e nxirrnin njerëzit prej shtëpive, plaçkisnin gjithçka që mund të merrej e bartej: para, vetura, traktorë, motokultivatorë, makina, orendi e pastaj i spërkatnin me benzinë dhe u jepnin flakën shtëpive, ndonjëherë edhe me njerëzit brenda. Policë e paramilitarë, në mesin e të cilëve kishte edhe shumë kriminelë nga luftërat e Bosnjës e të Kroacisë, vinin në Kosovë për të vrarë e plaçkitur. Plaçkën e ndanin edhe me komandantët e tyre.³⁷

Si elemente të përbashkëta të këtij protokollit kriminal ishin:

- Vrasja joselektive e shqiptarëve,
- Masakrat barbare joselektive të civilëve,
- Djegia e kufomave,
- Djegia e fshatrave dhe qyteteve,
- Rrethimi i fshatrave e qyteteve,
- Grumbullim i banorëve të fshatrave në një vend,
- Klasifikimi i banorëve sipas moshave,
- Ekzekutim joselektiv i meshkujve prej moshës 18 deri 70 vjeç,
- Grumbullimi i kufomave dhe operacioni i bartjes së tyre në varrezat masive në Serbi.
- Nxjerrja nga turma e vajzave dhe grave shqiptare dhe dhunimi seksual i tyre,
- Vrasja e fëmijëve në prani të familjareve të tyre,
- Krijimi i kolonave dhe deportimi i civilëve përtej kufirit, në Maqedoni dhe Shqipëri,
- Përdorimi i trenave dhe linjës hekurudhore Prishtinë-Fushë Kosovë-Shkup për deportimin e dhunshëm dhe zbrazjen e Kosovës,

³⁷ Adil Fetahu: Narrativ real për politikën gjenocidale serbe kundër shqiptarëve, 03/02/2022.

- Plaçkitja e pasurisë së qytetarëve gjatë deportimit të dhunshëm, marrja e të hollave, arit dhe gjërave të tjera me vlerë,
- Marrja dhe djegia e dokumenteve personale: letërnjoftimeve, lejet e qarkullimit të automjeteve, pasaportave dhe dokumenteve të tjera personale me qëllim të pamundësisë së kthimit,
- Veprimet e tjera kriminale.

Madje edhe Gjykata e Lartë në Beograd, njësia për krime lufte në Rastin K-PO₂ numër 48/10, konfirmon ekzistimin e skenarit gjenocidal i cili, gjerësisht është zbatuar në krimet gjenocidale në tërë territorin e Kosovës. Në aktgjykimin me të cilin grupi kriminal shpallet fajtor dhe dënohet, mes të tjerash, thuhet se ky grup kriminal:

- ka ndërmarrë sulme kundër banorëve civilë, gjë që pati si pasojë vdekje dhe lëndime të rënda të shumë civilëve dhe pasuria e civilëve është plaçkitur, janë kontrolluar shtëpi familjare të pronarëve civilë shqiptarë, i kanë dëbuar këta civilë nga shtëpitë e tyre dhe i kanë detyruar ata që të grumbullohen, në një apo shumë vende në fshatrat e sulmuara, ku me dhunë i kanë ndarë personat e aftë ushtarakë, meshkujt, të cilët dhe i kanë vrarë³⁸;

- Kanë shtënë me armë prapa kokës dhe para këmbëve të banorëve civilë të kombësisë shqiptare dhe i kanë detyruar që në këmbë ose në rimorkio të traktorëve të lëshojnë vendbanimet e tyre, nga shkak që lidhej me luftën;

- Në mënyrë kundërligjshme dhe me vetëdëshirë i kanë shkatërruar në masë të gjerë pasuritë e civilëve, gjë që nuk është e lejueshme për nevojat ushtarake, i kanë djegur shtëpitë e familjeve shqiptare me qëllim që banorët e dëbuar të mos kanë ku të kthehen.

Kurse në fshatrat Qyshk, Plavlan dhe Zahaq ua kanë marrë dokumentet personale civilëve, të cilat i kanë shkatërruar dhe kanë kryer plaçkitje ndaj civilëve të nacionalitetit shqiptar, i kanë djegur mbetjet mortore të civilëve të vrarë, me qëllim që të mos ketë mundësi të kryhet identifikimi i tyre për t'i fshehur vrasjet e kryera³⁹.

³⁸ Republika e Serbisë Gjykata e Lartë Beograd, Njësia për Krime Lufte, K-po₂ numër 48/10, pika a, data 11.02.2014 B e o g r a d, Ustanička 29.

³⁹ Për krimet e këtij grupi famkeq, që ka bërë vrasje makabre në fshatrat Qyshk, Plavlan dhe Zahaq kanë qenë të akuzuar; Miladinoviç Toplica, Popoviç Miladinoviç, Sreçko Katranoviç, Bogiqeviç Borban, Sokiq Abdullah, Nikoliç Milojkko, Momiç Ranko, Mishiç Ranko, Mishiç Sinisha, dhe Bulatoviç Dejan.

Në aktgjykimin e këtij rasti makabër, mes të tjerash, thuhet “kanë privuar nga jeta civilët, duke shtënë mbi ta me pushkët e tyre dhe pasi e kanë kryer pushkatimin, i akuzuari Milojkko Nikoliç, duke shkelur mbi trupat e kufomave dhe të të plagosurve, ka therur dhe ka vërtetuar kush nga të pushkatuarit po jep shenjë jete dhe mbi kokat e tyre ka hapur zjarr nga pushka e tij automatike dhe i kanë privuar nga jeta së paku 42 veta.⁴⁰ Si veprime tipike dhe skenar i protokollit gjenocidal në këtë rast përmenden këto veprime: vrasjet, masakrat, djegia e kufomave, rrethim i fshatrave dhe ndarja e burrave dhe e të rriturve nga turma, vrasja masive dhe pushkatimi i civilëve, deportimi i dhunshëm për në Shqipëri dhe Mal të Zi, plaçkitja e civilëve, zhdukja e letërnjoftimeve, djegia e shtëpive dhe veprime të tjera kriminale. Ky grup famëkeq, pothuajse të njëjtin skenar gjenocidal e ka zbatuar në të gjitha fshatrat e Dukagjinit.⁴¹

Nisur nga kjo, mund të konstatojmë, se krimet gjenocidale kanë pas pothuajse një skenar të njëjtë në gjithë territorin e Kosovës. Madje për këtë skenar kriminal kishte edhe protokolle të shkruara nga ushtria mbi bazën e dekreteve të cilat i nxori Presidenti i atëhershëm Milan Milutinović gjatë kohës së luftës. Për realizimin e këtij skenari gjenocidal ishin angazhuar 4 eshalone represive:

- APJ dhe ushtria serbe të stacionuara në pikat strategjike të Kosovës për gjoja, luftimin e UÇK-së;

- Njësitë speciale të policisë serbe të stacionuara në shumë punkte policore dhe të angazhuara në fushatën e krimeve sistematike në tërë territorin e Kosovës;

- Grupet kriminale (formacionet paramilitare), të cilat sipas ndarjes së detyrave me PGJ ishin të ngarkuara për krimet më barbare ndaj civilëve, masakrat, djegiet e kufomave, djegiet e fshatrave, deportimet e dhunshme, plaçkitjet etj;

- Serbët lokalë dhe mercenarët rusë, të cilët bashkëpunonin me tri strukturat kriminale të lartcekura në fushatën gjenocidale.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Në fund, Gjykata ka dënuar anëtarët e grupit si vijon të akuzuar: Toplica Miladinović, të akuzuarin. Dejan Bullatović dhe i akuzuari, Milojkko Nikoliç me dënim me burg në afat prej 20 vjetësh, të akuzuarin. Toplica Miladinović, të akuzuarit Ranko Momiç me dënim, me burg, në afat prej 15, të akuzuarit Abdullah Sokiç, me dënim me burg në afat prej 12 vjetësh, të akuzuarit, Sreçko Popović me dënim me burg, me afat prej 10 vjetësh dhe të akuzuarit Slavisha Kastratović dhe Boban Bogiqeviç me dënim me burg në afat prej 2 vjetësh.

Në protokollin e krimeve gjenocidale ishin renditur veprimet dhe krimet që duhet të kryhen, duke filluar nga vrasjet në masë dhe masakrat barbare ndaj civilëve, rrethimin e fshatrave dhe lagjeve, klasifikimin e civilëve sipas moshave, ekzekutimin e tyre, djegien e kufomave, deportimin e dhunshëm për Shqipëri e Maqedoni, djegien e letërnjoftimeve, ndarje nga masa të vajzave të reja e grave dhe dhunimin e tyre seksual, plaçkitja e civilëve (vjedhja e parave, arit e stolive të tjera) dhe pasurisë së tyre (vjedhja e veturave, e televizorëve, aparateve elektrike me vlerë etj.), djegia e fshatrave e qyteteve, si dhe krimet e tjera kriminale.

6. Periudha kohore e zbatimit të planit

Në aspektin kohor, plani gjenocidal është vënë në zbatim gjatë viteve 1998-1999, deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, kur Serbia pranoi kushtet e kapitullimit të vendosura nga NATO-ja. Gjatë këtyre dy viteve, në kuadër të planit gjenocidal, Serbia ka zbatuar fushatën e gjenocidit në Kosovë, duke kryer të gjitha krimet, siç i njeh, KPDKGJ e OKB-së. Gjatë këtyre 2 vjetëve, Serbia ka kryer më shumë se 400 masakra në tërë territorin e Kosovës, ka deportuar më shumë se 1 milion qytetarë dhe ka zbatuar skenarin e “Tokës së djegur” në Kosovë.

7. Objektivat e planit gjenocidal

Plani gjenocidal ka pasur këta objektiva kryesorë:

- Vrasjet masive të popullsisë civile në Kosovë ;
- Masakrat ndaj popullsisë civile ;
- Deportimin dhe shpopullimin e Kosovës;
- Ndryshimin e përbërjes demografike në Kosovë;
- Shkatërrimin e identitetit të shqiptarëve dhe pamundësimin e kthimit të tyre në territoret etnike;
- Plaçkitjen e pasurisë publike dhe pronave private të qytetarëve të Kosovës;
- Dhunimet seksuale ndaj vajzave dhe grave shqiptare;
- Varrezat masive në Kosovë dhe Serbi ;
- Zhdukjen e gjurmëve të gjenocidit me djegien dhe asgjësimin e kufomave në tërë territorin e Kosovës ;

- Transferimin, përmes njësiteve policore dhe ushtarake, të kufomave në varrezat masive në Serbi, krejt me qëllim, të zhdukjes së gjurmëve të gjenocidit ;
- Plaçkitjen e fondeve pensionale, fondeve të tjera publike, shkatërrimin e ndërmarrjeve ekonomike dhe pasurive të tjera në Kosovë ;
- Mohimin e gjenocidit me fshehjen e kriminelëve dhe ekzekutorëve të tjerë të krimeve gjenocidale ;
- Veprimet e tjera gjenocidale të përcaktuara në planin gjenocidal.

8. Financimi i planit gjenocidal

Gjenocidi i shtetit serb në Kosovë, si një krim shtetëror u financua drejtpërdrejt nga shteti i Serbisë, i cili mobilizoi të gjitha resurset në dispozicion për të realizuar këtë projekt kriminal. Shteti serb mobilizoi tërë potencialin e tij ushtarak, policor të formacioneve të rregullta dhe atyre joformale, duke bërë edhe një mobilizim të popullsisë, me qëllim të realizimit të projektit gjenocidal. Kjo ndërmarrje kriminale u financua drejtpërdrejt nga buxheti i Serbisë, i cili vuri në dispozicion të gjitha fondet për realizimin e gjenocidit. Madje, edhe të ashtuquajturat formacione paramilitare, për të cilat theksuam se *de facto* kanë qenë formacione joformale kriminale të Serbisë, financoheshin drejtpërdrejt nga buxheti i Serbisë në forma të ndryshme, qoftë në formë të donacioneve që ndërmarrjet publike serbe ua jepnin këtyre organizatave kriminale, qoftë duke ua vënë atyre në dispozicion resurset e ushtrisë së rregullt, apo edhe nga fondet e krijuara nga plaçkitja e pronës shtetërore, publike e private në Kosovë. Duke qenë, ndërmarrje shtetërore, gjenocidi i Serbisë në Kosovë, në të gjitha segmentet e implementimit të tij ka qenë drejtpërdrejt i financuar nga shteti serb.

Serbia si organizatore, ekzekutuese dhe financuese e gjenocidit, krahas përgjegjësisë për kryerjen e gjenocidit është e detyruar të paguajë të gjitha dëmet e luftës të shkaktuara në Kosovë dhe ta kthejë tërë pasurinë e plaçkitur gjatë luftës. Kosova, krahas padisë për gjenocid që kreu shteti serb në Kosovë, në një moment të përshtatshëm politik, pashmangshëm duhet të adresojë edhe kërkesën për pagimin e dëmeve të luftës, reparacioneve të luftës, kthimin e fondeve dhe mjeteve të plaçkitura në Kosovë. Kjo është një kërkesë legjitime e Kosovës ndaj

Serbisë. Serbia si humbëse e luftës, bëri plaçkitje të të gjitha fondeve ekzistuese në Kosovë dhe njëkohësisht u shkaktoi dëme të pariparueshme ekonomive familjare, ndërmarrjeve publike, duke dëmtuar kështu edhe pronën publike të Republikës së Kosovës.

9. Zhdukja e gjurmëve të gjenocidit

Zhdukja e gjurmëve të gjenocidit ka qenë faza e fundit e planit gjenocidal. Dihet botërisht se strategjia e fshehjes së krimit si gjenocid ka për qëllim shmangien nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e atyre që janë të përfshirë në kryerjen e gjenocidit gjatë vitit 1998. Forcat pushtuese serbe, trupat e shqiptarëve, pasi i vrisnin e i masakronin, i digjinin nëpër shtëpitë e oborret e tyre në puse (bunare) të ujit të pijshëm apo gropa të gëlqeres, i varrosën në varreza masive e i zhvarrosën për t'i zhdukur pa gjurmë. Gjatë vitit 1999, një pjesë të madhe të kufomave të civilëve shqiptarë (fëmijë, gra e pleq) të vrarë e të masakruar nga forcat okupuese serbe, u transportuan me kamionë frigorifer për në Serbi, duke u varrosur në varreza sekrete masive në poligonet e policisë e të ushtrisë serbo-jugosllave. Ky veprim kriminal synonte t'i zhdukte dhe shkatërrojë provat e gjenocidit të Serbisë ndaj shqiptarëve. E tërë kjo u bë në kuadër të operacionit sekret "Spastrimi" ("Čišćenje"), për të cilin Milosheviçi dhe "Shtabi Strategjik" i tij kishte marrë vendim që në mars të vitit 1999. Në atë operacion, për zhdukjen e gjurmëve të krimeve, kanë marrë pjesë strukturat më të larta shtetërore të Serbisë dhe të ish-mbetjes jugosllave (RFJ).

Deri më tani, në këto varreza sekrete masive në Serbi, janë gjetur trupat dhe mbetjet mortore të rreth, 1000 civilëve shqiptarë nga anë të ndryshme të Kosovës, disa prej të cilëve i kishin zhvarrosur nga Kosova për në Serbi, por kishte edhe trupa të shqiptarëve të vrarë, që këto varreza sekrete masive i kishin varreza të para⁴².

Në kohën kur Serbia kreu gjenocid në Kosovë, Aleksandër Vuçiç, në cilësinë e ministrit të Informatave në qeverinë e atëhershme të Serbisë, dhe Ivica Daçiq, në cilësinë e zëdhënësit të Partisë Socialiste të Milosheviçit, ishin dy figurat politike më të angazhuara në strategjinë e fshehjes së gjurmëve të gjenocidit serb kundër shqiptarëve. Pas përfundimit të luftës dhe tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, shteti

⁴² **Fetnete Ramosaj**, *Kundër harresës-gjenocidi i Serbisë në Kosovë-pa analogji-me fakte kundër shpifjeve / "Serbian crimes in Kosova - WITHOUT APOLOGY - Facts Against Defamations"* (Vëllimi i parë, shqip/anglisht), botoi "Fokusi", Prishtinë, 2005).

serb vazhdoi strategjinë e njëjtë të mohimit të gjenocidit. Kështu, 23 vjet pas kryerjes së masakrave në Abri, në Prekaz, në Reçak, në Izbicë, në Rezallë, në Krushë të Madhe e në Krushë të Vogël, në Mej, në Rugovë të Hasit, dhe shumë akteve gjenocidale anekënd Kosovës, ende jetojnë të lirë vrasësit e 1392 fëmijëve, të 1739 grave dhe mijëra civilëve të tjerë të moshave të ndryshme dhe ata që zbatuan dhunë seksuale ndaj më shumë se 20.000 grave shqiptare. Në kohën kur, shumëkush pret përmylljen e dialogut me Serbinë dhe ndriçimin e fatit të më tepër se 1600 civilëve shqiptarë të zhdukur nga forcat serbe, ish- zëdhënësi i Slobodan Milosheviçit, Ivica Daçiç, tani në cilësinë e liderit të Partisë Socialiste të Milosheviçit, dhe nga funksionet më të larta të shtetit serb drejtoi gishtin kundër atyre qytetarëve të Serbisë, të cilët marrin guximin të tregojnë se ku janë të fshehura kufomat e civilëve shqiptarë, të vrarë gjatë zbatimit të gjenocidit në Kosovë. “Zhvarrosja e kufomave të viktimave, shkatërrimi i tyre, transportimi dhe fshehja në Serbi, si dhe propaganda e krijuar për ta mohuar natyrën kriminale të spastrimit etnik dhe veprave penale individuale, kanë qenë pjesë përbërëse e strategjisë së lidërshiptit serb për të krijuar territore etnikisht të pastra dhe për t’i vendosur ato nën kontrollin e tyre”.⁴³ Kjo ndërmarrje ka qenë sistematike dhe fshehja ose zhdukja e krimit përmes fshehjes së kufomave të viktimave dhe shkatërrimit të dokumenteve dhe provave të tjera ka qenë faza e fundit e një procesi, i cili më pas është shoqëruar me deklaratat mohuese dhe me refuzim zyrtar për t’u distancuar nga kjo e kaluar.⁴⁴ Në funksion të fshehjes së gjurmëve të krimit, regjimi serb po bën obstrukcion në kthimin e mbetjeve mortore të të vrarëve, të cilët janë varrosur në varrezat masive në Serbi. Ajo ka emëruar në krye të Komisionit për të pagjetur një person për të cilin ekzistojnë dëshmi se ka qenë drejtpërdrejt i involvuar në krimet serbe, madje edhe në vrasjen e akademikut Fehmi Agani.⁴⁵

⁴³ Anton Vukpalaj. *Fshehja e krimit, politika serbe e mashtrimeve të mëdha në Kosovë*, fq.17, bot. ASHAK, Prishtinë 2021.

⁴⁴ E Sulajgic, 2010 *Ehtnic Cleasing, Politics, Policy, Violence, Serb Ethnic Cleasing Compaing IN Former Ygosslavia*, Berlin, Nomos, fq.197 (cituar sipas Anton Vukpalaj, vepra e cituar, fq.18).

⁴⁵ Shukri Aliu një veprimtar shqiptar, i cili ka qenë dëshmitar në gjykimin e Milosheviçit në një intervistë në mediet kosovare, ka akuzuar Odaloviçin për vrasjen e akademik Fehmi Aganit. Ai ka deklaruar; “Velko Odaloviçi është përgjegjës për një vrasje që na ka ndodhur jashtëzakonisht e rëndë profesor Fehmi Aganin. Ky së bashku me një shqiptar / Serbofilin, bashkëpunëtorin besnik të regjimit pushtues, kriminal serb/ Selim Gugjufi, më 6 maj 1999 kanë shkuar në shtëpinë e Fehmi Aganit, i janë drejtuar gruas së tij të ndjerës Sadije Agani, i kanë ofruar ndihmë për varrimin kinse, Fehmi Aganin, e ka vrarë ushtria e UÇK-së. Ajo i ka përzënë prej shtëpisë dhe u ka thënë se, kurrfarë

10. Mohimi i gjenocidit

Mohimi i gjenocidit të Serbisë në Kosovë është pjesë e planit gjenocidial, që ka për qëllim mospranimin e përgjegjësisë për krimet e kryera, mungesën e faljes publike për viktimat e gjenocidit dhe tendencën për të shtrembëruar të vërtetën e luftës në Kosovë. Krahas tendencës së zhdukjes së gjurmëve të krimeve gjenocidale, Serbia, jo vetëm që mohon gjenocidin në Kosovë dhe Bosnjë, por vazhdon retorikën fashiste duke, lartësuar dhe mitizuar figurat e kriminelëve kryesorë, të cilët kanë orkestëruar fushatën gjenocidale në këto dy shtete të pavarura. Në Serbi dhe Republikën Serbe në Bosnjë e Hercegovinë, në sheshet e rrugëve dhe vendet e tjera publike, mitizohen kriminelët e luftës si Ratko Mladiç, Radovan Karaxhiç, Slobodan Milosheviç, Sheshel, Arkan e të tjerë. Këtu qëndron demagogjia e politikanëve serbë, të cilët sot thërrasin për paqe e integritime evropiane. Edhe pse Vuçiçi, herë-herë e përmend paqen, ndërkohë që, disa nga ministrat e tij përdorin retorikë më të ashpër nacionaliste, ata të gjithë mendojnë njësoj për sa i takon politikës së qeverisë në lidhje me Srebrenicën, Reçakun dhe vendet e tjera simbole të gjenocidit serb. “Është ky një mekanizëm për të manipuluar ndjenjat e njerëzve të zakonshëm. Regjimi në mënyrë artificiale e ndan veten në disa fytyra për të mbuluar të gjitha pozicionet. Kështu që Vuçiçi duket sikur është një faktor stabiliteti dhe bashkëpunëtorët e tij si agresivë, qen që lehin⁴⁶. Megjithatë, Vuçiçi s’ka thënë kurrë që ata s’kanë të drejtë⁴⁷,

ndihme prej jush s’dua se ju e keni kryer atë vepër”, ka thënë Aliu. “Veprën e ka kryer njësitë për operacione speciale të Kosovës. Është baba e bir, Obrat Vjeshtica me gjithë djalin, këta janë kryesorët. Ai njëri nga ata që ka marrë pjesë në vrasje, unë jam i pari që po i zbuloj. E për krejt këto më i informuari është Velko Odaloviç. Fehmi Agani është vrarë në fshatin Suhodoll të Lipjanit. “Mirë u bë që kjo ditë erdh me zbulu edhe këtë”, ka thënë Aliu. <https://kosovaim.ee/shukri-aiiu-zbulon-detaje-nga-vdekja-e-profesor-fehmi-aganit-prapa-kësaj-qëndrojnë-një-shqiptar-dhe-një-serb/>.

⁴⁶ **Rade Radovanoviç**: Vuçiçin, që ishte ministër për informata, autori që ishte reporter i luftës dhe shef i përfaqësimit së Radios Evropa e Lirë, në Beograd, ka pasur shumë takime, sidomos gjatë kohës së bombardimeve të NATO-s. Për karakterin e Vuçiçit, autori thotë se, ishte dhe mbeti një radikal pervers, pa karakter, lavdaç, cinik, frikacak, i pabesë. Gjatë luftës në Bosnjë, Vuçiçi publikisht ka deklaruar se për një serb të vrarë, do t’i vrasim 100 myslimanë! Si ministër për informata, ishte një censor që dënonte dhe mbyllte gazetat e pavarura (merr shembëll gazetën “Danas”). Pas rënies së regjimit të Milosheviçit, Vuçiçi organizoi aksione për përkrahjen dhe mbrojtjen e kriminelëve të luftës, pastaj e braktisi Partinë Radikale Serbe (të Sheshelit), por mbeti një radikal filiz, formoi partinë tjetër dhe arriti në postin e kryeministrit e të kryetarit të Serbisë. *Qeshja nën trekëmbëshin e varjes, roman historik, botoi “Koha”, Prishtinë, 2021.*

⁴⁷ Mohimi i gjenocidit nga Serbia, një tjetër fiasko i përvitshëm,

“Të vetëdijshëm, për faktin se nuk mund të ketë pajtim pa pranimin e krimeve dhe përgjegjësive dhe se gjuha e urrejtjes, lartësimi i kriminelëve të luftës dhe revizionizmi ose mohimi i plotë i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës të vendosura nga vendimet përfundimtare gjyqësore minon rregullin e ligjit dhe përfaqëson një pengesë të drejtpërdrejtë për paqen, pajtimin dhe ndërtimin e besimit dhe në fund të fundit minon perspektivat për një të ardhme të sigurt, paqësore për Bosnjën dhe Hercegovinën”⁴⁸

Mohimi sistematik i masakrave, minimizimi i tyre, paraqitja e civilëve të masakruar si luftëtarë, justifikimi i krimeve dhe më pastaj edhe fshehja e kufomave të civilëve të masakruar “e kanë karakterizuar politikën serbe në Kosovë në vitet 1998-1999. Këto praktika ishin përdorur me parë edhe në Bosnjë”.⁴⁹ Serbia, jo vetëm që, ende nuk ka kërkuar falje për krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidin e kryer në Kosovë, por vazhdon të mbajë të fshehur fatin e mijëra shqiptarëve të zhdukur nga lufta e fundit. “Në një ditë si kjo, vlen të theksohet se asnjë strategji e relativizimit dhe asnjë politikë e mohimit, që sot mjerisht mbizotëron në Serbi, nuk mund të ndryshojë të vërtetën e luftës së fundit dhe as t’i zhbëjë krimet makabre të kryera nga Serbia në Kosovë”⁵⁰. Përkushtimi për një të ardhme paqësore nuk nënkupton edhe harresën për gjenocidin e kryer nga Serbia në Kosovë. Nderimi i viktimave, kërkim-falja nga ana e Serbisë e zbardhja e plotë e së vërtetës së luftës së fundit në Kosovë, mbi të gjitha, njohja ndërkombëtare e Serbisë për Republikën e Kosovës, është parakusht për pajtim dhe paqe të qëndrueshme.

Përfaqësuesi i Lartë “në largim” i Bosnjës dhe Hercegovinës, Valentin Inzko, ka vendosur ndryshimet në Kodin Penal të Bosnjës, të cilat ndalojnë mohimin e gjenocidit dhe lavdërimin e kriminelëve të luftës. Vendimi vjen disa ditë para se Inzko të largohet nga zyra dhe t’ia dorëzojë detyrën diplomatit gjerman, Christian Schmidt. Ndryshimet e ligjit që vendosi Përfaqësuesi i Lartë, ndër të tjera, përcaktojnë dënimin me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, për atë që “fol publikisht,

<https://balkaninsight.com/sq/2016/07/07/mohimi-i-gjenocidit-nga-serbia>.

⁴⁸ Klevis Hoxhaj, Ndalohet mohimi i gjenocidit në Bosnjë,

<https://albanianpost.com/bih-ndalohet-mohimi-i-gjenocidit-ne-bosnje/>.

⁴⁹ Po aty, fq.14.

⁵⁰ Gent Cakaj, ish-ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme në Republikën e Shqipërisë, kumtesë për shtyp e MEPJ, në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit, Tiranë 09/12/2020.

mohon, banalizon ose përpiqet të justifikojë një krim të gjenocidit, krime kundër njerëzimit ose një krim lufte”⁵¹.

Në deklaratën e përbashkët të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian, Josep Borrell dhe komisionerit Oliver Varhelyi, në 27-vjetorin e gjenocidit të Srebrenicës, thuhet se në Evropë, nuk ka vend për mohimin e gjenocidit dhe glorifikimin e kriminelëve të luftës. Sipas Borrell-it dhe Varhelyi-t, “agresioni i pajustificuar dhe i paprovokuar i Rusisë kundër Ukrainës ka rikthyer një luftë brutale në kontinent”. “Është më shumë se kurrë detyra jonë ta kujtojmë gjenocidin e Srebrenicës, si pjesë e historisë sonë të përbashkët evropiane”, thuhet në deklaratën e përbashkët. Sipas kësaj deklarate, vrasjet masive dhe krimet e luftës në Ukrainë sjellin kujtime të gjalla të atyre që u dëshmuan në luftë në Ballkanin Perëndimor në vitet '90.⁵² Deklarata identike kanë dhënë edhe përfaqësuesit e BE-së me rastin e përvjetorit të Masakrës së Reçakut, duke iu kundërvënë deklaratave të zyrtarëve serbë në Serbi dhe Kosovë, të cilët mohojnë krimet e kryera.

⁵¹ Po aty.

⁵² Mergesa Redenica, Borrell dhe Varhelyi: Në Evropë, s’ka vend për mohim të gjenocidit.10 korrik, 2022.

Frashër Demaj

MASAKRA E REÇAKUT, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT

Abstrakt

Sulmet e vazhdueshme të forcave serbe ndaj popullsisë civile shqiptare vazhduan me intensitet të shtuar edhe në fillim të vitit 1999. Më 15 janar 1999 forcat e policisë dhe ushtrisë serbe sulmuan fshatin Reçak të komunës së Shtimes. Në Reçak në fillim të vitit përveç banorëve të përhershëm ishin strehuar edhe banorë të fshatrave të tjera të zhvendosur për shkak të ofensivave serbe. Policia serbe u fut me dhunë nëpër shtëpitë e shqiptarëve, i kishin nxjerrë jashtë banorët, disa prej të cilëve ishin planifikuar që të ekzekutoheshin. Në Kodrën e Bebushit mbi fshatin Reçak u ekzekutuan dhe u masakruan 42 persona civilë të pafajshëm, kurse 26 të tjerë burra, gra e fëmijë mbetën të plagosur nga ndërhyrja brutale e forcave serbe.

Misioni i vëzhguesve ndërkombëtarë që funksiononte në kuadër të OSBE-së që drejtohej nga ambasadori Wiliam Walker doli në vendin e ngjarjes dhe e pa me sytë e vet masakrën e forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë. Në deklarin publik para mediave vendore e ndërkombëtare, Walker e cilësoi këtë brutalitet shtetëror të masakrimit të qytetarëve të pambrojtur si krim kundër njerëzimit. Më 17 janar pushteti serb kishte dërguar në vendin e ngjarjes prokuroren e Prishtinës për t'i marrë trupat e masakruar për obduksion në qendrën spitalore të Prishtinës. Kjo ngarendje e shpejtë nënkuptonte se regjimi serb po mendohej që të falsifikonte provat në mënyrë që Masakrën e Reçakut ta përdorte politikisht si një argument kundër shqiptarëve dhe ta fshehte dorën e krimit. Kurse shqiptarët kërkuan që obduksionin e trupave të masakruar ta bënin mjekët shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Në fund forcat serbe i morën trupat e shqiptarëve të masakruar i dërguan në Prishtinë, por e vërteta rreth kësaj masakre u përhap në gjithë botën. Për Masakrën e Reçakut dhanë lajme mediet më prestigjioze ndërkombëtare.

Fjalët çelës: Masakra e Reçakut, policia dhe ushtria serbe, misioni verifikues i OSBE-së, Wiliam Walker.

Mosrespektimi i njëanshëm i marrëveshjes Hollbruk-Milosheviç

Në gjysmën e dytë të vitit 1998 dhe fillimin e vitit 1999, forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe në të cilat bënin pjesë serbë

lokalë nga Kosova, të tjerë të ardhur nga Serbia dhe forca mercenare, intensifikuan veprimet e tyre kundër shqiptarëve duke sulmuar fshatra të tëra me qëllim të vrasjes dhe dëbimit të shqiptarëve nga shtëpitë e tyre. Kjo situatë kishte alarmuar strukturat politike, diplomatike dhe ushtarake ndërkombëtare. SHBA-ja dhe shtetet më të fuqishme anëtare të NATO-s ishin të bindura se Slobodan Milosheviç¹ e kupton vetëm gjuhën e forcës dhe ka frikë nga ndërhyrja ushtarake e NATO-s në “RFJ”. Për të qartësuar pozicionet e Aleancës Veriatlantike, Richard Hollbroke dhe përfaqësues të Këshillit të NATO-s kishin vizituar Milosheviçin në Beograd. Synimet kryesore të politikës amerikane ishin arritja e një marrëveshjeje politike përmes “diplomacisë detyruese”. Milosheviç kishte pranuar marrëveshjen me ndërkombëtares që në përmbajtjen e saj parashihte hyrjen e Misionit Verifikues në Kosovë, zvogëlimin e numrit të trupave policore dhe ushtarake serbe dhe lejimin e kthimit të shqiptarëve civilë të zhvendosur në shtëpitë e tyre.

Fillimi i vitit 1999 nisi me një fushatë terrori kundër popullsisë civile shqiptare, e organizuar ekskluzivisht nga shteti serb.² Këto forca funksiononin në një hierarki të komandimit duke filluar nga presidenti i RFJ-së Slobodan Milosheviç, vartësit e tij politikë dhe struktura komanduese ushtarake dhe policore. Madje me miratimin e tij u funksionalizuan edhe forcat paramilitare të cilat organizuan edhe parada në prezencën e tij dhe strukturave shtetërore serbe.³ Forcat serbe duke ushtruar dhunë, terror dhe masakra kundër popullsisë civile shqiptare kishin për qëllim vrasjen, eliminimin fizik, frikësimin dhe futjen e

¹ Slobodan Milosheviç, (20 gusht 1941- 11 mars 2006) i lindur në Pozharevc. Studioi për drejtësi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit. Kryetar i Serbisë 1989-1997; Kryetar i Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ-së) nga 15 korriku 1997 deri më 6 tetor 2000. Si Kryetar i RFJ-së ai gjithashtu ishte Kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes së RFJ-së dhe Komandant Suprem i Ushtrisë Jugosllave. Milosheviç u padit në maj të vitit 1999, gjatë Luftës së Kosovës nga Gjykata Penale Ndërkombëtare e OKB-së për ish-Jugosllavinë për krime kundër njerëzimit në Kosovë. Një vit e gjysmë më vonë u shtuan akuzat për shkelje të ligjeve apo zakoneve të luftës, shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës në Kroaci dhe Bosnjë dhe gjenocid në Bosnjë. Gjykimi nuk përfundoi për shkak të vdekjes së tij.

² Josef Martinsen, What happened in Kosovo? 1998-1999, A documentacion, Oslo 2010, f. 5.

³ Gjyqi i presidentit, Slobodan Milosheviçit kishte filluar më 12 shkurt të vitit 2002, në Gjykatën e Krimeve të Luftës të Kombeve të Bashkuara në Hagë, në Holandë, nën akuzat për gjenocid dhe krime lufte në Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë. Gjykimi mbeti i papërfunduar meqë ai u gjet i vdekur në burg në moshën 64-vjeçare, siç u tha zyrtarisht “nga një atak kardiak” në qelinë e tij, më 11 mars, 2006.

panikut në popullsinë civile që sa më shumë të shpërngulen përmes deportimit masiv, konfiskimit të dokumenteve të identitetit dhe shkatërrimin e tyre për t'ua pamundësuar rikthimin për mungesë dokumentesh të identifikimit.⁴ Marrja e dokumenteve të identifikimit nga forcat serbe praktikohet në momentin e dëbimit nga shtëpitë e tyre në fshatra e qytete si dhe në pikëkalimet kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Konfiskime të tilla u bënë edhe gjatë kalimit të shqiptarëve me qëllim strehimi në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës. Pra tendenca kryesore e dëbimit ishte pastrimi etnik i Kosovës nga shqiptarët dhe rikonizimi i saj që Serbia synonte ta bënte për të tretën herë brenda disa dekadave (reforma agrare dhe kolonizimi i Kosovës në periudhën midis dy luftërave botërore dhe kolonizimi me refugjatë serbë nga Kroacia dhe Bosnjë e Hercegovina gjatë luftërave të viteve 90).

Masakra e Reçakut dhe disa masakra të tjera në Kosovë ndodhën në një kohë kur ishte nënshkruar Marrëveshja Milosheviç-Hollbruk për tërheqjen e pjeshme të forcave serbe, armëpushimin dhe arritjen e paqes me ndërmjetësimin e diplomacisë amerikane. I dërguari i SHBA-së Riçard Hollbruk⁵ pas më shumë se nëntë ditë e pesëmbëdhjetë orë diskutimesh intensive, arriti marrëveshje për Kosovën me presidentin jugosllav Slobodan Milosheviçin duke arritur që të evitohet kërcënimi

⁴ Josef Martinsen, vep e cit... f. 5.

⁵ Richard Holbrooke, Richard Charles Albert Holbrooke, (24 prill 1941- 13 dhjetor 2010), ishte diplomat amerikan. Lindi në qytetin e Nju Jorkut nga një çift hebrej evropian. Familja e tij kishte ikur nga nazistët në vitet 1930. Richardi pasi kreu studimet në Universitetin Brown më 1962, ai iu bashkua Shërbimit të Jashtëm dhe u dërgua në Vietnam deri në vitin 1966. Ai shërbeu si drejtor i Korpusit të Paqes në Marok nga 1970 deri në 1972. U emërua më 1977 nga presidenti Jimmy Carter në detyrën e ndihmëssekretar të shtetit për çështjet e Azisë Lindore dhe Paqësorit. Holbrooke shërbeu në administratën e presidentit Bill Clinton si ambasador në Gjermani (1993–94) dhe ndihmëssekretar i Shtetit për çështjet evropiane dhe kanadeze (1994–95). Në atë rol, ai e kaloi pjesën më të madhe të kohës së tij duke u fokusuar në Ballkan dhe ishte negociatori kryesor i SHBA-së midis palëve ndërluftuese në konfliktin në ish-Jugosllavi. Në 1997, megjithatë, ai u emërua i dërguar i posaçëm në Qipro, ku u përpoq të ndërmjetësonte një zgjidhje të mosmarrëveshjes dy dekadash mbi atë ishull midis Greqisë dhe Turqisë. Ai ndërmjetësoi Marrëveshjen e Dejtonit (1995) për t'i dhënë fund konfliktit në Bosnjë dhe Hercegovinë, shërbeu si ambasador i SHBA-së në Kombet e Bashkuara (OKB; 1999–2001) dhe ishte përfaqësues special në Afganistan dhe Pakistan (2009–10) në administratën e presidentit Barack Obama. Richard Holbrooke ishte i angazhuar nga presidenti Clinton si negociator për zgjidhjen e çështjes së Kosovës 1998-1999.

i NATO-s për sulme ajrore.⁶ Milosheviçi ishte i vetëdijshtë për veprimet politike që po ndërmernte, sepse disa javë më parë NATO-ja shkoi në prag të përdorimit të fuqisë ajrore ndaj forcave serbe në Kosovë, Serbi dhe brenda Republikës Federale të Jugosllavisë.⁷ Milosheviçi pranoi edhe kërkesat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që Jugosllavia t'i japë fund luftimeve në Kosovë, të tërheqë forcat e sigurisë të dislokuara atje që nga shkurti i kaluar, të sigurojë qasje të papenguar në agjencitë ndërkombëtare të ndihmës, të bashkëpunojë me Gjykatën e Hagës për krimet e luftës dhe të fillojë një proces serioz të dialogut për zgjidhjen e problemit të Kosovës.⁸ Këto lëshime, Milosheviçi i pranoi si rezultat i kërcënimit të minutës së fundit të NATO-s për të nisur sulme shkatërruese ajrore kundër Serbisë. Kjo dinakëri tij e bindi edhe diplomatin më me përvojë të SHBA-së gjatë sesioneve të negociatave maratonë të zhvilluara në Beograd.⁹ Hollbruku pavarësisht se nuk besonte shumë në Milosheviçin, ishte i inkurajuar të vazhdonte procesin negociator për të mos lejuar një Srebrenicë të dytë e cila po përgatitej nga regjimi serb dhe mund të ndodhte lehtësisht në Kosovë.

Ndërkohë situata në Kosovë përshkallëzohej çdo ditë e më shumë. Ritmi relativisht i ngadaltë i vendosjes së verifikuesve ndërkombëtarë të paarmatosur nga OSBE-ja dhe një forcë reagimi të armatosur për t'i mbrojtur ata nga NATO-ja i inkurajonte forcat serbe. Pra, situata në Kosovë vazhdonte të jetë dinamike, ku serbët besonin se përdorimi i dhunës ende mund të sjellë përfitime për ta. Kurse shqiptarët besonin në forcat e pakta të tyre të organizuara nga UÇK-ja dhe në faktorin ndërkombëtar, kryesisht tek amerikanët.¹⁰ Ushtria dhe policia serbe sipas raporteve shqiptare dhe disa qarqeve ndërkombëtare shfrytëzonte mungesën e prezencës vëzhguese ndërkombëtare dhe çdo ditë ushtronte dhunë e terror të përcjellë me vrasje dhe masakra të popullsisë civile në gjithë territorin e Kosovës. Pra Milosheviçi hiqej se ishte i interesuar për bisedime paqësore, kurse nga ana tjetër vazhdonte çdo ditë të dërgonte forca ushtarake e policore në Kosovë. Me këto veprime ai

⁶ Ivo H. Daalder (ambasador i SHBA në NATO 2009-2013), *Peace at any price? Kosovo deal costs Milosevic little, is unlikely to resolve crisis, sunday, October 18, 1998.*

⁷ James Gow, *Kosovo after the Holbrooke–Milosevic Agreement. What Now?*, *The International Spectator*, Volume XXXIII No. 4 (October-December 1998).

⁸ Po aty.

⁹ Me gjerësisht shih: Marc Weller, *The Holbrooke Agreement and the OSCE Verification Mission*, Oxford University Press, published on march 2009.

¹⁰ James Gow, *Kosovo after the Holbrooke–Milosevic Agreement...* Volume XXXIII No. 4 (October-December 1998).

njëanshëm hoqi dorë nga respektimi i marrëveshjes me diplomatin amerikan Hollbruk. Mosrespektimi i marrëveshjes dhe vazhdimi i luftës kryesisht kundër popullsisë civile irritoi edhe më shumë diplomacinë ndërkombëtare, sidomos amerikanët të cilët diskutonin çdo ditë edhe për opsione të tjera kundër Serbisë së pabindur në seriozitetin dhe gati-shmërinë amerikane për ndërhyrje ushtarake. Milosheviçi inkurajohej edhe nga diplomacia ruse dhe ishte i bindur se ShBA-ja nuk do të futej në konflikt politik e diplomatik me Rusinë për shkak të Kosovës.

Sulmet e policisë dhe ushtrisë serbe dhe masakra e Reçakut

Masakra e Reçakut dhe masakrat e tjera në Kosovë ndodhën në praninë anëtarëve të Misionit Vëzhgues Ndërkombëtar që funksiononte në kuadër të OSBE-së dhe misioneve të tjera përfaqësuese siç ishte Misioni Vëzhgues Diplomatik (KDOM).¹¹ ShBA-ja kishte angazhuar Të Ngarkuarin me Punë të ShBA-së në Beograd, Richard Miles. Miles dhe homologu i tij rus filluan Misionin e Vëzhgimit Diplomatik të Kosovës më 6 korrik 1998. Misioni kishte për qëllim të vëzhgojë dhe raportojë për lirinë e përgjithshme të lëvizjes dhe kushtet e sigurisë në mbarë Kosovën. KDOM synonte të ndihmojë në ndërtimin e besimit në të gjithë rajonin duke ofruar një prani të hapur ndërkombëtare të ekipeve të vëzhguesve jondërhyrës.¹² KDOM ishte një institucion i krijuar dhe i integruar nën drejtimin politik të një grupi koordinues të përbërë nga ambasadorët e vendeve të Grupit të Kontaktit në Beograd, si dhe ambasadorët e Austrisë (që përfaqëson presidencën e BE-së) dhe Polonisë (që përfaqëson Kryesuesin në detyrë të OSBE-së).¹³ Pra, prezenca shumëkombëshe përmes misioneve të veta në Kosovë kishte për qëllim njoftimin e qeverive të tyre me të vërtetën që po ndodhte në Kosovë. Gjithashtu, kjo prezencë ishte opionencë serioze ndaj regjimit serb mbi të vërtetën e ngjarjeve në Kosovë. Misionet ndërkombëtare do

¹¹ U.S Department of State, Kosovo Diplomatic Observer Mission (KDOM), https://1997-2001.state.gov/regions/eur/fs_980708_kom.html, hulumtuar me 20.4.2023.

¹² Government of Canada, <https://www.canada.ca/en/department-national-defence/-services/military-history/history-heritage/past-operations/europe/-perserverance.html>, hulumtuar me 20.4.2023.

¹³ U.S Department of State, Kosovo Diplomatic Observer Mission (KDOM), https://1997-2001.state.gov/regions/eur/fs_980708_kom.html, hulumtuar me 20.4.2023.

t'ia pamundësonin Milosheviçit servimin e të pavërtetës përmes medie-ve të kontrolluara në opinionin demokratik ndërkombëtar.

Reçaku, një nga fshatrat e Shtimes shtrihej në një pozitë gjeografike rreth 2 kilometra në jugperëndim të qendrës komunale, në skajin lindor të maleve të Carralevës.¹⁴ Fshati kishte afër stacionin policor të instaluar nga Serbia dhe në afërsi rreth 350 metra nga Pishat e Shtimes ishin të stacionuara forcat ushtarake serbe që të dyja së bashku përbënin kërcënim serioz për banorët e komunës së Shtimes dhe komunave përreth.

Forcat policore dhe ushtarake serbe në fillim të janarit 1999 intensifikuan veprimet e tyre të dhunshme në territorin e komunës së Shtimes dhe Ferizajt. Më 10.1.1999 një ekspeditë policore e ushtarake rrethoi fshatin Slivovë duke bastisur e demoluar rreth 70 shtëpi. Për pasojë u arrestuan 15 banorë dhe u rrahën e u maltretuan fizikisht shumë qytetar shqiptarë. Të nesërmen më 11 janar në Shtime u arrestuan 6 qytetarë shqiptarë dhe një numër i madh u keqtrajtuar, njërin prej të cilëve (Metush Hamdi Bislimin 25 vjeç) e fusin në bagazhin e automjetit dhe e marrin me vete në drejtim të postkomandës policore. Kurse 10 kamionë ushtarakë nga Shtimja u vazhduan në drejtim të Grykës së Carralevës.¹⁵ Të gjitha këto veprime brutale dhe lëvizje ushtarake e policore ishin një paralajmërim se forcat serbe po përgatiteshin të ndër-marrin aksione të mëdha në vendbanimet shqiptare. Konfliktit me përmasa të mëdha në relacionin Shtime-Ferizaj i druhashin edhe misionarët vëzhgues të cilët më vonë u deklaruan për situatën e sigurisë në prag të Masakrës së Reçakut. Më 15.1.1999 forcat serbe në orët e hershme të mëngjesit rreth orës 6:30, me transporterë, autoblanda, tanke, gjuajtës kundërajror dhe mjete të tjera luftarake sulmuan fshatrat Belincë, Reçak, Petrovë dhe Mollopolc të komunës së Shtimes.¹⁶ Forcat serbe fillimisht nisen granatimin e këtyre fshatrave nga pozicionet e tyre te Pishat e Shtimes, nga Kryqi i Belincit dhe Kodra e Gështenjave për të vazhduar pastaj me këmbësori. Ata kishin bllokuar hyrje-daljet në Shtime dhe bllokuar rrugët magjistrale Shtime-Suharekë e Shtime-

¹⁴ Grup autorësh, Leksikon, Vendbanimet e Kosoves, Tabloja fizike-hapsinore, demografike dhe funksionale, Vëllimi III, Vendbanimet Rurale (M-ZH), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2020, f. 323.

¹⁵ Ruzhdi Jashari, reporter I luftës, Informatë nr. 59 e datës 11.1.1999.

¹⁶ Yugoslav Government War Crimes in Racak, <https://www.hrw.org/legacy/campaigns/kosovo98/racak.shtml>, hulumtuar më 19 prill 2023.

Ferizaj.¹⁷ Këtë bllokadë e bënë për arsye strategjike duke krijuar perimetrin e sigurisë dhe duke e pamundësuar afrimin e forcave të UÇK-së që operonin në atë zonë. Këtyre sulmeve serbe iu ishin përgjigjur luftëtarët e UÇK-së që ishin numerikisht më pak dhe me armatime të lehta që nënkuptonte vështirësi të mëdha për t'u përballur me forcat serbe dhe për të mbrojtur me sukses popullsinë civile. Sipas dëshmitarëve ndërkombëtarë që ndodheshin në vendin e ngjarjes për të vëzhguar situatën, forcat serbe kishin zënë pozicione luftimi me tanke, autoblanda dhe mjete të tjera luftarake në vendin e quajtur Kodra e Gështenjave (Chesnut Hill). Kurse te Pishat e Shtimes kishte forca të tjera të mobilizuara dhe në gatishmëri ushtarake duke pritur urdhrin për sulm.¹⁸

Fshati Raçak, para masakrës kishte një popullsi prej rreth 2,000 banorësh. Gjatë ofensivës në shkallë të gjerë të qeverisë së Serbisë në gusht 1998, policia serbe granatoi Raçakun dhe disa objekte familjare u plaçkitën dhe u dogjën. Që atëherë, shumica e popullsisë ka jetuar në Shtime ose në fshatrat e tjera në rrethinën e Ferizajt.¹⁹ Në Raçak në fillim të vitit përveç banorëve të përhershëm ishin strehuar edhe banorë të fshatrave të tjera të zhvendosur për shkak të ofensivave serbe. Policia dhe ushtria serbe e shoqëruar edhe nga serbë lokalë që ishin mobilizuar, pas granatimeve u fut me dhunë nëpër shtëpitë e shqiptarëve. Ata i ndanë familjet, burrat të cilët kishin planifikuar që t'i ekzekutonin. Para se t'i vrisnin ata u torturuan mizorisht. Në Kodrën e Bebushit mbi fshatin Raçak u ekzekutuan dhe u masakruan 42 persona civilë të pafajshëm, kurse 26 të tjerë burra, gra e fëmijë mbetën të plagosur.²⁰ Shqiptarët e ekzekutuar në mesin e të cilëve kishte edhe gra e fëmijë, u masakruan në mënyrat më çnjerëzore. Atyre iu prenë dhe iu hoqën pjesë të trupit, si: sytë, kokat, zemrën, thyerje këmbësh e shpërfytyrime nga më të ndryshmet.

Misioni i vëzhguesve ndërkombëtarë që funksiononte në kuadër të OSBE-së që drejtohej nga ambasadori Wiliam Walker²¹ doli në

¹⁷ Ruzhdi Jashari, reporter i luftës, Informatë nr. 60, me datë 15.1.1999.

¹⁸ Josef Martinsen, What happened in Kosovo... f. 33.

¹⁹ Yugoslav Government War Crimes in Racak, <https://www.hrw.org/legacy/campaigns/kosovo98/racak.shtml>, hulumtuar më 19 prill 2023.

²⁰ Fjalori Enciklopedik i Kosovës II, L-ZH, Prishtinë 2018, f. 1058-59.

²¹ Wiliam Walker ka lindur në Kearny, New Jersey. Studioi Arkitekturë dhe Shkenca Politike në Universitetin e Kalifornisë Jugore dhe Universitetin e Kalifornisë, Los Angeles (UCLA). Si oficer i Shërbimit të Jashtëm, ai ka shërbyer kryesisht në Amerikën Latine, sidomos në Bolivi, Brazil, El Salvador, Honduras,

vendin e ngjarjes dhe e pa me sytë e vet masakrën e forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë. Ambasadori Walker shoqërohej edhe nga persona të tjerë që ishin pjesë e misionit dhe nga gazetarë të mediave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ai hyri në oborrin e një shtëpie dhe me sytë e tij e pa trupin e pa kokë të Banush Azemit dhe deklaroi se “kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time”.²² Walker i shoqëruar nga fshatarët civilë u ngjit shpatit për të shkuar te vendi ku sipas informacioneve ishte kryer masakra serbe ndaj popullsisë civile shqiptare, të cilët ishin marrë të gjallë dhe ishin dërguar aty për t’u vrarë e masakruar. Ai dhe shoqëruesit e tij panë me sytë e tyre duke u bërë dëshmitarë të drejtpërdrejtë të veprimeve kriminale të policisë dhe ushtrisë së shtetit të Serbisë. Shefi i Misionit të OSBE-së, ambasadori Wiliam Walker

Peru. Ai ishte Inspektor i Shërbimit të Jashtëm në Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm nga viti 1978 deri në vitin 1980 dhe funksionar i Departamentit të Shtetit në Këshillin e Marrëdhënieve me Jashtë në Nju Jork nga viti 1977 deri në vitin 1988. Agjent i CIA-s. Nga viti 1985 deri në vitin 1988, ai shërbeu si Zëvendës-ndihmës Sekretar i Shtetit në Byronë e Çështjeve Ndëramerikane, me përgjegjësi për marrëdhëniet me Amerikën Qendrore dhe Panamanë. Nga viti 1988 deri në vitin 1992, ai shërbeu si Ambasador në El Salvador. Në gusht të vitit 1997, Walker u emërua si përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe u emërua në krye të Administratës Tranzicionale të Kombeve të Bashkuara për Sllavoninë Lindore, Baranja dhe Sremin Perëndimor. Ai udhëhoqi një mision të përbërë nga rreth 800 civilë të OKB-së dhe 2,500 paqeruajtës dhe administratorë ushtarakë. Walker më pas u emërua në krye të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, duke udhëhequr rreth 1400 personelë ndërkombëtarë dhe 1500 vendas midis tetorit 1998 dhe qershorit 1999 së bashku me gjeneral-majorin britanik John Drewienkiewicz, këshilltarin ushtarak të Walker-it. Pas masakrës së Reçakut të 45 shqiptarëve të Kosovës në janar 1999, Walker-i vizitoi vendin dhe e quajti atë një "mizori të papërshkrueshme" dhe "krim kundër njerëzimit." Më 18 janar 1999, qeveria e RFJ-së e akuzoi atë duke e shpallur atë persona non grata dhe duke e urdhëruar atë të largohej nga vendi. Një javë më vonë, mbi ndërhyrjen e Këshillit Evropian dhe Federatës Ruse, kryeministri i FR Jugosllavisë Momir Bullatović ngriu vendimin. Masakra e Reçakut ishte një incident thelbësor në shtytjen e NATO-s në nisjen e fushatës së saj bombarduese kundër Jugosllavisë. Më 24 nëntor 2008, ai u bë qytetar nderi i Republikës së Shqipërisë, titulli i dhënë nga Presidenti Bamir Topi. Më 15 janar 2009, në 10 -vjëtorin e Masakrës së Reçakut, ai u nderua me Medaljen e Artë të Lirisë nga Presidenti dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës. Në janar të vitit 2017 u ngrit një statujë e Walker-it në fshatin Reçak të Kosovës. Në janar 2023, Presidenti i Shqipërisë Bajram Begaj i dha Walker-it një nga çmimet më të larta të kombit, Kalorësin e Urdhrit të Flamurit.

²² Ylber Bajraktari, Wiliam Walker në Reçak, thekson se “kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time” dhe pyet: 45 të vrarë- a është jo përgjigja jugosllave ndaj tetë ushtarëve të liruar nga UÇK-ja?, Koha Ditore nr. 600- viti III, Prishtinë 17 janar 1999.

pasi pa me sy shumicën e të masakruarve në konferencën me gazetarë deklaroi: “Duke parë kufomat jam i bindur që ky është një ekzekutim. Këta njerëz të vrarë mua më duken si bujq, si punëtorë, si fshatarë që definitivisht nuk e kanë merituar të vdesin kështu dhe nuk më intereson cili ka qenë motivi”. Në vazhdim të komunikimit me medie ambasadori theksoi “Të shohësh kufomat me fytyra të shkatërruara që si duket janë bërë për shkak armëve që janë mbajtur në kokat e tyre, t’i shohësh 15 në gropë, dhe në një mënyrë të ekzekutuar mendoj që më nevojiten disa minuta para se të përcaktohem se çka dua të them” tha Wiliam Walker.²³ Ambasadori pastaj u ndal me bashkëpunëtorët e tij për t’u konsultuar para se të ktheheshin në Prishtinë duke premtuar se pas marrjes së informacioneve të plota në vendin e ngjarjes do të organizonte sërish konferencë shtypi në Prishtinë.²⁴ Në konferencën e dytë ambasadori Walker duke ripërsëritur qëndrimin e tij të bazuar në skenat e llahtarshme të Masakrës së Reçakut deklaroi “Personalisht nuk kam fjalë të përshkruaj revoltën time, si dhe të atyre që ishin me mua për atë që mund të cilësohet si krim i papërshtatshëm. Asnjëri prej tyre nuk ishte i veshur ndryshe përveç në rroba civile, të gjithë dukeshin si fshatarë të vuajtur dhe njerëz të thjeshtë. Edhe pse nuk jam jurist, nga ato që kam parë nuk ngurroj ta kualifikoj ngjarjen si masakër dhe krim kundër njerëzimit”.²⁵

Vëzhguesit ndërkombëtarë konstatonin se ato ditë në disa lokalitete në Reçak ishin gjetur trupat e 45 shqiptarëve prej të cilëve 3 gra dhe 1 fëmijë. Bazuar në faktet e gjetura në teren misioni verifikues ndërkombëtar akuzuan forcat serbe për krimet e tmerrshme në rajonin e Shtimes që ishte rreth 30 kilometra larg nga kryeqyteti i Kosovës. Walkeri gjithashtu vazhdonte me akuza kundër shtetit serb duke ua rikujtuar se disa ditë më parë UÇK-ja ka liruar 8 ushtarët jugosllavë të zënë rob, kurse jugosllavët me këto veprime po i shkatërrojnë përpjekjet ndërkombëtare për ndërtimin e besimit reciprok në mes të palëve. Sipas tij Masakra e Reçakut e ka kthyer në pikën zero besimin e njerëzve se mund të krijohet një situatë e paqes dhe t’u hapet rrugë negociatave për zgjidhje paqësore të problemit. Prandaj komuniteti ndërkombëtar duhet t’i dënojë ashpër këto veprime kriminale, kurse Qeveria e RFJ-së duhet t’i identifikojë dhe t’i nxjerrë para gjyqit të gjithë pjesëtarët e policisë dhe armatës jugosllave që kanë marrë pjesë në këtë krim. Walkeri i bënte thirrje edhe Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve të Luftës për

²³ Po aty.

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

territorin e ish-Jugosllavisë që sa më parë të vijnë në vendin e ngjarjes, të mbledhin prova, t'i hetojnë krimet dhe akterët t'i nxjerrin para drejtësisë në mënyrë që ata të marrin dënimin e merituar.

Ambasadori amerikan kishte udhëzuar misionin verifikues për të qëndruar në Reçak edhe ditën e shtunë më 16 janar për të përcjellë situatën e sigurisë dhe pengimin e forcave serbe për të vazhduar masakrat ndaj civilëve shqiptarë. Gjithashtu, ai kishte kontaktuar edhe me forcat e UÇK-së të cilëve u kishte tërhequr vërejtjen se pavarësisht nga dhimbja, nervoza, emocionet dhe frustrimi të tregojnë vetëpërmbytje dhe të mos hakmerren.²⁶ Kurse qeveria e Beogradit në shenjë hakmarrjeje ndaj ambasadorit Walker, e shpalli person “non grata”, kurse prokurorës së Gjykatës Ndërkombëtare për krimet e luftës në Jugosllavi, Louise Arbour, nuk iu lejua hyrja në Kosovë.²⁷ Konstatimi i Walker-it ishte përkrahur nga raporti zyrtar i Misionit Verifikues në Kosovë që deklaronte se forcat jugosllave janë përgjegjëse për krimin në Reçak.

Për shkak të qëndrimeve të tyre korrekte në përshkrimin e ngjarjeve, shumica e anëtarëve të misionit vëzhgues dhe përkthyesit e tyre pavarësisht nga nacionaliteti ishin të kërcënuar nga policia, ushtria dhe paramilitarët serbë. Këto konstatime i vërteton edhe Edward Sullivan, vëzhgues i KDOM-it, i cili në një intervistë kishte deklaruar se “gjatë kryerjes së detyrës sime herë pas herë në gjoksin tim më janë drejtuar kallashnikovë nga policët serbë dhe ushtria jugosllave”.²⁸ Pavarësisht nga tendencat për t'i frikësuar dhe kërcënuar me jetë, misionarët vëzhgues vazhduan misionin e tyre në shërbim të humanizmit duke e konsideruar si vlerë të civilizimit të demokracive të zhvilluara të qytetërimit perëndimor. Vëzhguesit, afër kufomave të të masakruarve gjetën letërnjoftime të dëmtuara nga plumbat dhe bajonetat, kuleta të zbrazëta, pako të zbrazëta cigaresh etj. që nënkupton se ata përveç se u vranë dhe masakruan, u vodhën për së vdekuri nga forcat serbe.²⁹

Në anët tjetër pas ultimatumit serb ndaj ambasadorit Walker që për 48 orë ta lëshonte Kosovën, e vizituan Beogradin dy gjeneralët me të lartë të NATO-s, Wesley Clark komandant suprem i NATO-s dhe

²⁶ Po aty.

²⁷ Arsim Bajrami, *Gjenocidi i Serbisë në Kosovë, Aspekte juridike*, ASHAK, Prishtinë 2023, f. 456.

²⁸ *Masakra e Reçakut, krim kundër njerëzimit*, Shtime 2004, f. 195.

²⁹ Nebi Qena, “Masakër në Reçak, Identifikohen 38 nga 48 viktimat civile të ofenzivës së policisë dhe ushtrisë serbe në fshatin Reçak”, *Koha Ditore*, nr. 600-viti III, e diel 17 janar 1999.

gjenerali gjerman Klaus Nauman kryesues i Komitetit ushtarak të NATO-s të cilët në takim me Milosheviçin kërcënuan se Aleanca është e përgatitur për të sulmuar ushtarakisht. Temë e rëndësishme e takimit ishte edhe çështja e ambasadorit Walker dhe hyrja e kryeprokurores ndërkombëtare Luis Arbor në Kosovë për të hetuar Masakrën e Reçakut.³⁰ Megjithatë, sipas James Rubin-it, zëdhënës i Stejt Departmentit, ky takim nuk i dha rezultatet e pritura, prandaj gjeneralët do të takohen me ambasadorët e vendeve të NATO-s për të diskutuar rrjedhën e bisedimeve. Pra Milosheviçi vazhdonte tentativat e tij për fshehjen e krimeve serbe në Kosovë, kalkulimet politike e diplomatike për të evituar sulmet eventuale të NATO-s dhe mashtrimet në dialog me ndërkombëtarët. Ai nuk u përmbahej zotimeve të tij që dilnin si rezultat i dialogut me ndërkombëtarët, por gjithmonë pas largimit të tyre nga Beogradi “harronte” marrëveshjet dhe vazhdonte diskursin nacional-shovinist në opinionin publik serb për të përmbushur apetitet e qarqeve të ndryshme në kuadër të konsumit të përditshëm nationalist në Serbi.

Reagimi i politikës evropiane dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare ndaj veprimeve të forcave serbe në Reçak

Masakra e forcave serbe ndaj shqiptarëve civilë në Reçak u gjykua si veprim kriminal dhe i papranueshëm për shtetet dhe popujt e qytetërimit evropian. Shumica e shteteve evropiane reagues me tone të ashpra ndaj Serbisë, përmes qeverive të tyre, ministrive të jashtme, ambasadave dhe përfaqësive të tjera diplomatike, si dhe përmes instancave të institucioneve të përbashkëta evropiane. Masakrën e Reçakut, me tone të ashpra e dënoi edhe kryesuesi i OSBE-së, norvegjezi Knud Volebek i cili deklaroi se përkrah fuqishëm konstatimin e ambasadorit Walker dhe mban përgjegjës forcat jugosllave për masakrimin e shqiptarëve civilë të paarmatosur. Edhe ministri i jashtëm gjerman, Joschka Fischer, në letrën e tij drejtuar presidentit jugosllav Slobodan Milosheviç, në emër të Bashkimit Evropian i quante shokuese ngjarjet dhe veprimet e policisë dhe ushtrisë jugosllave ditëve të fundit, sidomos vrasjet masive si në rastin e Reçakut që janë të pajustificueshme dhe të papranueshme për Bashkimin Evropian.

Fisher kërkonte nga Milosheviçi që menjëherë të anulohet vendimi për shpalljen person non grata të kryesuesit të Misionit Verifikues

³⁰ Times 1999.

Ndërkombëtar Wiliam Walker; të respektohen në tërësi të gjitha marrëveshjet e nënshkruara me OSBE-në dhe NATO-n; të ndërmerren masa konkrete për sigurimin e jetës së personelit ndërkombëtar në Kosovë; të bashkëpunohet pa asnjë kusht me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve të Luftës dhe të lejohet hyrja dhe veprimtaria e papenguar e prokurores Louis Arbour.³¹ Ai në emër të Bashkimit Evropian kërkonte nga Milosheviçi që të mos manipulohet me Masakrën e Reçakut sepse të vrarët dhe të masakruarit nuk ishin pjesëtarë të UÇK-së. Kjo bie në kundërshtim me të vërtetën sepse vëzhguesit e paanshëm të OSBE-së, raportojnë për 45 civilë të paarmatosur shqiptarë të cilët u vranë dhe masakruan në fshatin Reçak.³²

Dhe në fund kërkohet që ekzekutorët e masakrës së Reçakut bashkë me urdhërdhënësit dhe ushtarakët që kanë marrë pjesë të pezullohen nga detyra deri në zbardhjen e plotë të ngjarjes.³³ Masakra e Reçakut u dënua ashpër edhe nga kryeministri italian Massimo D' Alema, i cili këto akte i konsideronte të papranueshme. Në këtë linjë u deklarua edhe ministri i Punëve të Jashtme të Italisë, Lamberto Dini, në komunikim me homologët e tij evropianë. Ministri i Jashtëm britanik, Robin Kuk, duke dënuar aktet e dhunshme të forcave serbe dhe masakrimin e shqiptarëve civilë të paarmatosur kërkonte që palët të ulen në dialog për të gjetur zgjidhje paqësore. Kurse Sekretari gjeneral i NATO-s Javier Solana deklaronte se “është i shokuar nga kjo masakër”.³⁴

Masakrën e Reçakut e dënoi edhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe bëri thirrje për një hetim të menjëhershëm të vrasjeve. Në mbledhjen e KS të OKB-së u kërkua nga Milosheviçi edhe shfuqizimi i vendimit për dëbimin e ambasadorit Walker. Në vazhdimësinë e gjykimeve ndërkombëtare ishte edhe reagimi në unison i vendeve të Grupit të Kontaktit të cilët dolën me një deklaratë të përbashkët ku dënuan masakrimin e shqiptarëve në Reçak dhe kërkuan hetimin ndërkombëtar të ngjarjes dhe iu bënë thirrje palëve për uljen e tensioneve dhe për vazhdimin e dialogut në tavolinën e bisedimeve. Të gjashtë vendet e Grupit të Kontaktit i bënë thirrje qeverisë së Beogradit dhe shqiptarëve që të ulen së bashku për të diskutuar në mënyrë konstruktive një plan ndërkombëtar për ta zgjidhur krizën.

³¹ Më gjerësisht: J. Fischer, *Vitet kuq-gjelbër. Politika e jashtme gjermane – nga Kosova e deri më 11 shtator*, Prishtinë, 2008.

³² Beqë Cufaj, Tmerret si ai në Reçak, shkaktajnë pezëm dhe ndjenjë të thellë neverie, *Koha Ditore* 22 janar 1999.

³³ Po aty.

³⁴ *Koha Jonë*, Tiranë me 17 janar 1999.

Edhe Human Rights Watch si një organizatë prestigjioze hidhte poshtë pretendimet e qeverisë së Beogradit dhe konstatonte se të masakruarit ishin civilë të vrarë e jo siç pretendon qeveria serbe dhe jugosllave se ata ishin luftëtarë të UÇK-së.³⁵ Pra forcat serbe janë përgjegjëse për krimet e luftës në Reçak, sepse ata bënë ekzekutime të kundërligjshme. Notë proteste i kishte dërguar Ambasadës së “RFJ”-së edhe Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë. Diplomacia shqiptare hidhte poshtë spekulimet dhe propagandën e Beogradit për “vrasjen e bandave terroriste“, duke akuzuar policinë dhe ushtrinë serbe për vrasjen e civilëve të pafajshëm dhe kërkonte ndërhyrjen urgjente nga bashkësia ndërkombëtare për të ndihmuar popullin e Kosovës që po masakrohej nga forcat serbe.³⁶ Kryeministri i Shqipërisë Pandeli Majko i kishte dërguar letër presidentit të ShBA-së Klinton që i kërkonte ndërhyrjen ushtarake të ShBA-së dhe NATO-s për të shpëtuar popullin e Kosovës nga shfarosja që po i kanosej çdo ditë e më shumë nga brutaliteti dhe masakrat e forcave serbe anembanë Kosovës.³⁷ Reagime të ngjashme pati edhe nga organizata të tjera joqeveritare që në fokus të veprimtarisë së tyre kishin mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Reagimi i Departamentit të Shtetit dhe presidentit Klinton për Masakrën e Reçakut

Informatat për Masakrën e Reçakut në pasditen e 15 janarit, i pranoi me shqetësim edhe Shtëpia e Bardhë në Uashingtonin. Lajmin e kishin trajtuar këshilltarët kryesorë të politikës së jashtme të Presidentit Clinton kurse Sekretarja e Shtetit Madeleine K. Albright po bënte presion për t’i bindur presidentin për të rritur presionin për ndërhyrjen e ShBA-së dhe NATO-s në Kosovë.³⁸

Të gjithë autoritetet e Shtëpisë së Bardhë atë ditë kishin nxjerrë një konkluzion të përbashkët duke konstatuar se presidenti jugosllav Slobodan Milosheviç nuk po i mban, premtimet e tij por vazhdon me aksione kundër shqiptarëve etnikë. Albright deklaronte se me Milosheviçin nuk funksiononte dhe kishte ardhur koha për të lidhur kërcënimin e forcës me një zgjidhje politike gjithëpërfshirëse midis Serbisë

³⁵ Human Rights Watch (hrw.org), 25.5.2023.

³⁶ Dhimitër Th Brisku, Kosova, Ditari viti 1999, Tiranë, f. 31.

³⁷ Zëri i Popullit, Tiranë me 19 janar 1999.

³⁸ Barton Gellman, Slaughter in Racak Changed Kosovo Policy, Washington Post, Sunday, April 18, 1999.

dhe Kosovës, sepse kjo ishte e vetmja mënyrë për të siguruar një paqe të qëndrueshme.³⁹ Sekretarja e shtetit kërkoi gjithashtu që sa më shpejt të revidohet vendimi për dëbimin e ambasadorit Walker në mënyrë që ai të rifillojë punën e tij në drejtimin e rreth 700 monitoruesve ndërkombëtarë. Ajo i rikujtoi Milosheviçit se “urdhri aktivizues” për përdorimin e forcës ushtarake ndaj RFJ mbetet në fuqi.⁴⁰

Albright-i dhe disa personalitete të tjera të Stejt Departamentit kërkonin rishikim të vendimmarrjes në Uashington dhe Bruksel. Sipas tyre Reçaku e transformoi politikën në Ballkan të Perëndimit, duke qenë një ngjarje e veçantë dhe e papranueshme dhe demaskoi demagogjinë dhe politikën e dhunës serbe ndaj shqiptarëve. Ajo duke marrë shkas nga brutaliteti i forcave serbe në Masakrën e Reçakut dënonte me forcë regjimin e Beogradit dhe kërkonte që ShBA-ja të merret me thelbin e problemit që është zgjidhja e çështjes së Kosovës dhe rënia e Milosheviçit i cili përdori kartën e Kosovës dhe nacionalizmit serb për të forcuar pushtetin e tij, prandaj Kosova duhet të jetë fundi politik i tij.

Presidenti amerikan Klinton pas marrjes së informacioneve për masakrën e Reçakut, më 16 janar 1999 e dënoi vrasjen e civilëve shqiptarë duke e quajtur si masakër të qëllimshme të forcave serbe. Në deklaratën e plotë të presidentit thuhej:” Ky ishte akt i qëllimshëm i vrasjes, i disejnuar për të mbjellë frikë te popullsia e Kosovës. Është qartazi një përdhunim i premtimeve që autoritetet serbe i dhanë NATO-s. Nuk mund të ketë asnjë justifikim për këto veprime”.⁴¹ Në fund të deklaratës së tij presidenti amerikan deklaroi se është në kontakt të përhershëm me sekretarin e NATO- s dhe do të punohet intensivisht për ndalimin e dhunës dhe represionit në Kosovë. Nga ana tjetër presidenti i bënte thirrje palës kosovare dhe asaj serbe që të ulen në tavolinën e bisedimeve për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore.

Përpjekjet serbe për fshehjen e krimit

Që nga fillimi i luftës në Kosovë, politika serbe përdori strategjinë e stigmatizimit të shqiptarëve si terroristë, për t’i pasur duart e lira të ushtronte dhunë e terror ndaj tyre. Krimet e njësiteve të uniformuara serbe, si policë, ushtarë e shpesh herë edhe paramilitarë të kryera ndaj civilëve shqiptarë paraqiteshin nga propaganda serbe si “dëm

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Më gjerësisht: *Madeleine Albright, Zonja Sekretare (Autobiografi)*, Tiranë, 2004.

⁴¹ Koha Ditore, e diel 17 janar 1999.

kolateral”⁴². Bazuar në këto konstruksione propagandistike, pushteti okupator serb akuzoi shqiptarët dhe bashkësinë ndërkombëtare për kurdisje të masakrës së Reçakut. Propaganda serbe e quante inskenim të shqiptarëve dhe Wiliam Walker-it gjithë ngjarjen e tmerrshme të ndodhur në Reçak.

Beogradi pas protestave ndërkombëtare për masakrën, u mundua që të fshehë dorën e krimit sepse druhej nga një gjykim kolektiv ndërkombëtar. Pushteti serb instrumentalizoi mediet në gjuhën serbe në Kosovë e posaçërisht ato në Serbi që ishin të lidhura me pushtetin, që të propagandonin edhe më shumë dhe masakrën e Reçakut ta paraqesin si luftë të forcave serbe kundër “bandave terroriste” të UÇK-së. Në të njëjtën linjë me politikën ditore të qeverisë së Beogradit ishin edhe disa medie malazeze të afërta me regjimin e Milosheviçit.

Më 17 janar 1999, pushteti serb kishte dërguar në vendin e ngjarjes prokuroren e Prishtinës, Danica Marinkoviç, për t’i marrë trupat e masakruar për obduksion në qendrën spitalore të Prishtinës. Kjo ngarendje e shpejtë nënkuptonte se regjimi serb po mendohej që të falsifikonte provat në mënyrë që Masakrën e Reçakut ta përdorte politikisht si një argument kundër shqiptarëve dhe ta fshehte dorën e krimit. Tendencat e prokurores serbe e cila kishte marrë urdhrat politikë i demaskoi Michael Pedersen nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, i cili ishte informuar nga të afërmit e viktimave për manipulimet e prokurores Marinkoviç, e cila kishte refuzuar që t’ua dorëzonte familjarëve kufomat e të varurëve. Autoritetet serbe druheshin nga publiciteti negativ që do të shkaktonte funerali dhe varrosja e viktimave në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vend.⁴³ Kurse shqiptarët kërkuan që obduksionin e trupave të masakruar ta bënin mjekët shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Në fund forcat serbe i morën trupat e shqiptarëve të masakruar i dërguan në Prishtinë, por e vërteta rreth kësaj masakre u përhap në gjithë botën. Pavarësisht nga pretendimet serbe për të fshehur dorën e krimit, forcat ndërkombëtare-vëzhguesit i kishin përgjuar radiolidhjet dhe lidhjet telefonike në të cilat ishin dëgjuar të jepeshin urdhra për ndërhyrje brutale ndaj shqiptarëve pas vrasjes së tre ushtarëve serbë. Në këto përgjime ishin dëgjuar edhe Nikolla Shainoviçi, zëvendëskryeministër dhe gjenerali Sreten Lluqiçi, ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë duke urdhëruar oficerët e policisë dhe ushtrisë që këto vrasje të duken si pasojë e luftimeve në mes trupave

⁴² Anton Vukpalaj, *Fshehja e krimit, Politika serbe e mashtrimeve të mëdha në Kosovë*, Prishtinë 2021, f. 31.

⁴³ Reuters 8 shkurt 1999.

qeveritare dhe forcave separatiste të UÇK-së.⁴⁴ Forcat serbe i morën kufomat dhe i dërguan në Institutin e Patologjisë në Prishtinë për obduksion në mënyrë që t'i nxirrnin rezultatet e falsifikuara me porosi të politikës milosheviçiane. Për shkak të presionit ndërkombëtar ata u detyruan të ftonin ekspertë ndërkombëtarë. Në fillim u ftuan patologë bjellorusë e pas tyre edhe specialistë finlandezë të patologjisë. Serbët duke u bazuar në miqësinë e tyre me bjellorusët shpresonin në rezultate të favorshme për ta. Mirëpo ishte grupi finlandez i kryesuar nga dr. Helena Ranta që kishte bërë ekzaminimin e disa kufomave të masakruara, dhe pas rezultateve të analizave konstatuan se këta njerëz nuk janë vrarë në luftime, por janë ekzekutuar nga afërsia.⁴⁵ Me këto konstatime përpjekjet e Beogradit nga 15 janari kur u ekzekutuan dhe masakruan civilët shqiptarë e deri me 11 shkurt shkuan huq. Politika milosheviçiane përfundimisht humbi çdo shpresë për manipulimin e rezultateve të obduksionit dhe fshehjen e dorës së krimit.

Të masakruarit, të vrarët dhe të plagosurit në Reçak

Në masakrën e Reçakut u vranë dhe u masakrua në mënyrën më mizore:

Ahmet Izet Ahmeti
 Ahmet Zenun Mustafa
 Ajet Minush Brahimi
 Arif Murat Metushi
 Bajram Haki Xheladini
 Bajram Sokol Mehmeti
 Bajrush Nesret Shabani
 Banush Azem Azemi
 Bujar Hanefi Hajrizi
 Eshref Halim Jakupi
 Fatmir Faik Ramadani
 Hajrizi Brahim Brahimi
 Haki Murat Metushi
 Hakip Imer Imeri

⁴⁴ Washington Post 28 janar 1999.

⁴⁵ Shekulli, Tiranë me 23 janar 1999.

Halim Riza Beqiri
Hanumshahe Bajram Mehmeti
Hanumshahe Sadik Mujota
Haqif Shefki Hysenaj
Jashar Milaim Salihu
Lutfi Hasan Bilalli
Lute Asllani
Mehmet Qerim Jakupi
Mufail Mehdi Hajrizi
Muhamet Faik Syla
Muhamet Hafiz Mustafa
Murtez Ramiz Ymeri
Mustafë Beqë Asllani
Nazmi Nuhë Imeri
Nexhat Faik Ramadani
Njazi Sherif Zymeri
Ragip Jahir Bajrami
Raif Milaim Salihu
Rizah Maliq Beqiri
Sabri Murat Metushi
Sadik Xhemë Osmani
Sahide Haki Metushi
Salih Faik Ramadani
Sheremet Shyqeri Syla
Shukri Milaim Salihu
Shyqeri Ismajl Syla
Skender Sylejman Halili
Xheladin Ahmet Jakupi
Zenel Shefqet Beqiri

Duke mbrojtur trupat e të masakruarve në vendin e krimit, më 19 janar 1999 u vranë edhe Ahmet Kaçiku dhe Vezir Jashari.⁴⁶

⁴⁶ *Masakra e Reçakut, krim kundër njerëzimit*, Shtime 2004, f. 57.

Përveç të vrarëve dhe të masakruarve në Reçak, gjatë ofensivës serbe mbetën të plagosur edhe 12 qytetarë të tjerë me plagë të lehta dhe të rënda.

Bajram Fazli Qerimi
 Destan Rashit Rashiti
 Elhami Bajram Mehmeti (fëmijë 10 vjeç)
 Fetihe Shefqet Beqiri
 Florie Hajriz Hajrizi
 Hamdi Bilall Bilalli (fëmijë 14 vjeç)
 Hasan Maliq Bilalli
 Haxhi Banush Azemi (fëmijë 15 vjeç)
 Hysen Sabri Metushi
 Makfire Kadri Hajrizi
 Nazmi Nebih Mehmeti
 Zuhrie Shefqet Beqiri

Të mbijetuar të masakrës së Reçakut të cilët u rrahën dhe u torturuan me metodat më çnjerëzore janë:

Ali Qazimi
 Alush Mustafa
 Arben Jakupi
 Bilall Bilalli
 Hetem Rrustemi
 Imer Hakipi
 Imri Jakupi
 Mehdi Bilalli
 Nusret Shabani
 Osman F. Osmani
 Ramë Shabani
 Sabit Shaqiri⁴⁷

Në përpjekje për të mbrojtur popullsinë civile nga masakra serbe u vranë edhe 9 ushtarë të UÇK-së:

Ali Rakip Beqa

⁴⁷ *Masakra e Reçakut, krim kundër njerëzimit*, Shtime 2004, f. 57.

Enver Hyzri Rashiti
Ismail Luma
Kadri Shyqeri Syla
Mehmet Zenun Mustafa
Nazim Kokollari
Sadik Murat Mujota
Shaqir Zejnë Berisha
Skender Nezir Qarri.⁴⁸

Të plagosur nga radhët e UÇK-së, të cilët luftuan kundër forcave serbe në mbrojtje të popullsisë civile prej 15 deri më 20 janar 1999 ishin:

Afet Hasan Bilalli
Ramadan Mehë Hysenaj
Njazi Sadik Mujota
Shaban Zymer Ndrecaj
Zaim Halim Jakupi
Afrim Xhemajl Syla
Luan Salihu
Adem Musli Musliu
Xhevat Qarri
Zymer Jemin Lubovci
Xhevdet Zeqir Sejdiu.⁴⁹

Deri në fund të luftës kur u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës dhe hynë trupat e NATO-s në Kosovë, nga Reçaku, Shtimja dhe Zona Operative e Nerodimës u vranë dhe u plagosën edhe shumë qytetarë civilë dhe ushtarë të UÇK-së.

Mediet ndërkombëtare për masakrën e Reçakut

Mediet ndërkombëtare i kushtuan vëmendje të veçantë Masakrës së Reçakut dhe ngjarjeve që vijuan në ditët në vazhdim. Agjencitë prestigjioze në ballinat e tyre botuan tmerret e përjetuara nga popullsia civile në masakrën e Reçakut. “Washington Post” krahas shkrimit

⁴⁸ Po aty, f. 57.

⁴⁹ Po aty, f. 58.

kishte botuar edhe një fotografi të familjarëve me trupat e pajetë të masakruarve.⁵⁰ Ky medium kishte realizuar edhe një reportazh dhe intervistë me ambasadorin Walker, i cili e kishte krahasuar masakrën e Reçakut me vrasjen brutale të 6 priftërinjve jezuitë dhe dy grave të pafajshme në El Salvador nga ushtria, në kohën kur shërbente si ambasador i SHBA-së në këtë vend. Prandaj thoshte Walker-i nuk mundet dhe nuk do të hesht për vrasjen e fshatarëve të pafajshëm nga forcat serbe. Gazeta franceze “Liberation” më 27 janar 1999 në një artikull të gjatë të titulluar “Masakra në Reçak-tregim i një dëshmitari kyç” kishte realizuar intervistë me një vëzhgues ndërkombëtar i cili kishte deklaruar se ata e kishin përcjellë ofensivën serbe nga një largësi prej 2 kilometrash nga vendi i ngjarjes. Pas tërheqjes së forcave serbe vëzhguesit kishin parë me sytë e tyre se ishin masakruar tmerrësisht shumë fshatarë të paarmatosur.⁵¹ Më 21 janar 1999 “Le Monde” shtronte pyetjen: “ nëse forcat serbe kanë luftuar kundër UÇK-së dhe kanë vrarë terroristë, atëherë pse Serbia nuk i lejon prokurorët për të bërë hetim të paanshëm ndërkombëtar” për të gjetur të vërtetën rreth ngjarjeve në Reçak.⁵² Kurse “Newsweek International” më 1 shkurt 1999 duke iu referuar burimeve të Human Rights Watch akuzonte për urdhërdhënie direkt zëvendëskryeministrin jugosllav Nikolla Shainoviç dhe ministrin e Punëve të Brendshme të Serbisë Sreten Lluqiç.⁵³

Masakrës së Reçakut i kushtuan vëmendje të veçantë edhe medie e tjera ndërkombëtare si: “The New York Times”, BBC, CNN, “Euro News”, “The Associated Press”, “Reuters”, “The Times”, “Newsweek”, “Die Welt”, “Der Spiegel”, “Frankfurter Allgemeine”, “Tageszeitung”, “Sudeutsche Zeitung”, “Berliner Zeitung”, “Le Figaro”, etj. Këto medime në lajmet e para dhe në ballinat e tyre botuan tmerrret e përjetuara nga popullsia civile në masakrën e Reçakut.

⁵⁰ Barton Gellman, *Slaughter in Racak Changed Kosovo Policy*, Washington Post, Sunday, April 18, 1999.

⁵¹ Liberation më 27 janar 1999.

⁵² Le Monde 21 janar 1999.

⁵³ Newsweek International më 1 shkurt 1999.

Salih Krasniqi

KRIMET SERBE NDAJ PACIENTËVE DHE PERSONELIT SHËNDETËSOR SHQIPTAR

Abstrakt

Më 20 qershor të vitit 1999, kur forcat e NATO-s hynë në Kosovë, personeli mjekësor i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në mënyrë të organizuar u kthyen në klinikat e Fakultetit të Mjekësisë. Me gjetjen e dokumentacionit të lënë pas nga personeli mjekësor serb, u gjet regjistri i të sëmurëve dhe të plagosurve që ishin trajtuar nëpër klinika. U gjetën shumë fakte që ishte shkelur e përdhosur betimi i Hipokratit nga ana e personelit shëndetësor serb që punonin në klinika të ndryshme mjekësore. Në dokumentacionet e gjetura dhe në regjistra dëshmohej për veprimet barbare me përmasa të gjenocidit të pushtetit, policisë dhe ushtrisë serbe ndaj pacientëve dhe personelit shëndetësor të QKUK-së gjatë luftës së Kosovës.

Në QKUK u ushtruan të gjitha format e dhunës dhe të presionit ndaj pacientëve dhe personelin shëndetësor në njërin nga institucionet më të mëdha dhe më të rëndësishme të shëndetësisë në Kosovë nga vitit 1998 e deri më 20 qershor 1999.

Brenda këtij punimi do të trajtohen çështje që faktojnë shkatërrimin e sistemit shëndetësor; të dhënat për pacientë nga protokollat e të sëmurëve në QKUK; fëmijët e plagosur dhe të lënduar të pranuar në klinikat kirurgjike të spitalit të Prishtinës nga 01.05.1998 deri 20.06.1999; të plagosurit në repartin e kirurgjisë vaskulare të cilët akuzoheshin si “Terroristë”; të dhënat e më shumë se 31 të burgosur të plagosur në masakrën e Burgut të Dubravës; keqtrajtimi, frikësimi dhe largimi i detyruar i mjekëve dhe i pacientëve nga Spitali i Prishtinës, si dhe vrasjet dhe zhdukjet e mjekëve shqiptarë nga ana e pushtetit të Serbisë përmes aparatit të dhunës, bartës të të cilit ishin policia, ushtria dhe formacionet paramilitare serbe.

Fjalët çelës: Mjekësia, QKUK, pacientët, të plagosurit, dhuna, dëbimi.

Helmimi - akt gjenocidi ndaj fëmijëve shqiptarë

Helmimi i fëmijëve, i nxënësve dhe studentëve shqiptarë, i cili filloi më 21 mars 1989, nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare sistemohej në aktet më barbare dhe më gjenocidale që mund të kenë ndodhur në Evropën e civilizuar në pesë dekadat e fundit. Ky helmim u bë në paqe, ndaj qytetarëve që me asgjë nuk provokuan nxitje lufte, e për këtë,

askush nuk u mor në përgjegjësi, bile as nuk u organizua kurrfarë forme e hetimeve për zbulimin e aktorëve të krimit. Mosorganizimi i hetimeve për konstatimin e së vërtetës, objektivisht e shton dyshimin se këtë e ka bërë vetë shteti ish - jugosllav. Helmimi la pasoja tepër të rënda të 7.421 të rinj kryesisht shqiptarë. Frustrimet, traumat dhe psikoza e krijuar u bartën në farefisën e familjeve, të viktimave të helmimit, e nga ato dhe përmes tyre, në tërë popullatën shqiptare.

Akti i helmimit masiv të shqiptarët, me gjithë karakterin e vet kriminal, brutalitetin dhe vrazhdësinë, nuk u dënua nga opinioni botëror.

Duke pasur parasysh këtë dhe duke u nisur nga neni 2 i Konventës ndërkombëtare për pengimin dhe dënimin e krimit, nënshkruese e së cilës ishte edhe ish-Jugosllavia (ku thuhet me gjenocid nënkuptohet edhe akti me të cilin dënohet krimi nëse: "qëllimisht shkaktohen pasoja dhe plagë të rënda psikike dhe fizike të pjesëtarët e bashkësisë etnike". Atëherë pa kurrfarë dyshimi del se me këtë veprë kundër popullatës shqiptare u ushtrua vepra më e rëndë e gjenocidit klasik.

Në nenin 1 të Konventës së cituar thuhet: "Si akt krimi gjenocidi është në kundërshtim të plotë me frymën dhe qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe të civilizimit. Me fjalë të tjera, kjo nuk është veprë gjenocidi vetëm ndaj shqiptarëve dhe qytetarëve të tjerë të Kosovës, por njëkohësisht është veprë kundër njerëzimit, kundër parimeve të proklamuarra dhe të miratuara të Kombeve të Bashkuara.

Duke marrë parasysh krimin e bërë dhe duke u nisur nga nenet 1, 2 dhe 3 të Konventës për pengimin dhe dënimin e krimit si gjenocid, organet dhe institucionet ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, organet dhe institucionet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive elementare të njeriut, kanë obligim të kërkojnë të organizohen hetimet për helmimet dhe aktorët e kësaj veprë të qiten para Gjyqit ndërkombëtar.

Edhe organet e ish - Jugosllavisë në të tri nivelet e organizimit të atëhershëm (krahinor, republikan dhe federativ), duke u mbështetur në Konventën e përmendur, por edhe në Ligjin penal të ish-Jugosllavisë, kanë pasur obligim që t'i organizojnë hetimet, me qëllim që të zbulohen aktorët e këtij krimi dhe ndaj tyre të merren masa ligjore. Sjelljet barbare të policisë ndaj viktimave të helmimeve, pengimi i tyre që të mjekoheshin në institutet shëndetësore, maltretimi fizik i atyre që u ndihmonin të helmuarve, bastisja e Kishës katolike në Ferizaj, por edhe në vende të tjera vetëm pse ato u kishin ofruar ndihmë të helmuarve, tregon se shteti kishte gisht në helmime.

Analizat laboratorike të gjakut, të bëra në dy laboratorët e Parisit, video - filmat dhe xhirimet e tjera "tregojnë se fjala është për helme kimike të luftës" dhe se "ky krim është bërë nga agjentët e Beogradit, me siguri agjentë ushtarakë", deklaroi dr. Bernar Benedeti. Rezultate të njëjta nxjerr edhe A. Heyndrickx, drejtor i Laboratoriumit Ndërkombëtar të Universitetit ILUR, ekspert i KB dhe drejtor i projektit UNIDO në shkencat toksikologjike dhe të ambientit. Ai, në Konferencën e Parisit, që i është kushtuar luftës biologjike dhe asaj kimike, në janar të vitit 1993, deklaroi se "në Kosovë u bë intoksikimi masiv i fëmijëve shqiptarë si rrjedhojë e përdorimit të gazrave neurotoksike nga regjimi serb". A. Heyndrickx në intervistën dhënë revistës "Zm" helmimin e konsideron akt gjenocidi dhe kërkon që të shqyrtohet në Tribunalin e Hagës.¹

Vendosja e masave të dhunshme në Fakultetin e Mjekësisë

Më 2 prill 1990, në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë u vendosën "masat e dhunshme", me 40 mjekë të emëruar nga Serbia, të cilët e marrin udhëheqjen e institucionit.

Dhuna vazhdoi me mbylljen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë për studentët dhe pedagogët shqiptarë. Deri në tetor të vitit 1991, i larguan 67.8 për qind të personelit akademik, duke pamundësuar ligjerimin në gjuhën shqipe. Nga Klinika e Gjinekologjisë u përjashtuan të gjithë profesorët, asistentët, mjekët dhe infermierët shqiptarë. Nga Kirurgjia dhe Ortopedia u përjashtuan më shumë se 80 për qind e stafit shqiptar. Nga këto masa nuk shpëtuan as klinikat e tjera, si Katedra e Mjekësisë Preventive. Deri në dhjetor të vitit 1990, në shkallë vendi u përjashtuan nga puna 2500 punëtorë shëndetësorë.²

Me mbylljen e Fakultetit të Mjekësisë, në vitin shkollor 1990/91, përfundimisht u realizua edhe ideja shoviniste për rrënimin e "Bastionit të nacionalizmit shqiptar". Policia serbo-jugosllave, me dhunë nxori nga puna punëtorët shëndetësorë, duke i sharë, duke i rrahur, duke i keqtrajtuar dhe duke i arrestuar. Më së keqi e pësuan klinikat e mëdha si: Kirurgjia, Ortopedia, Gjinekologjia, Pediatria, Internoja, Neuro-psikiatria dhe institutet paraklinike.³

¹ Halim Hyseni, "E vërteta për helmimet në Kosovë (1987 - 1990)", Prishtinë 1996, f. 20-23.

² Prof. Dr. Isuf Dedushaj, "Enciklopedi"... f. 6.

³ Prof. Dr. Isuf Dedushaj, "50 -vjetori i Fakultetit të Mjekësisë 1960-2019. gjenerata e parë",... f. 24.

Zhvillimi i sistemit shëndetësor paralel gjatë viteve 90

Para vitit 1989, sistemi shëndetësor i Kosovës, ishte shtetëror dhe shumë i centralizuar nën autoritetin e Ministrisë Federale Jugosllave të Shëndetit dhe Ministrisë së Shëndetit të Serbisë. Në qendër të këtij sistemi ishte shkolla e mjekësisë dhe spitali i kujdesit terciar në Prishtinë, të cilët gjithashtu i udhëzonin rastet në Beograd, Zagreb dhe Nish. Përpos spitaleve regjionale, në nivelin komunal, sistemi përfshinte edhe shtëpitë e shëndetit (kujdesi primar dhe sekondar për pacientë të jashtëm) dhe ambulancat (qendrat e kujdesit shëndetësor primar).

Sistemi shëndetësor i Kosovës financohej nga shteti nëpërmjet sigurimit shëndetësor dhe të gjithë pjesëtarët e sistemit, përfshirë mjekët, ishin punëtorë me rrogë të qeverisë. Studentët shqiptarë të mjekësisë mund të studionin në gjuhën e tyre, përpos nëse mungonte ndonjë profesor i cili fliste shqipen. Puna klinike kryhej në gjuhën e mjekut dhe të pacientit. Shumica e mjekëve serbë nuk flisnin shqip.

Suspendimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989 pati pasoja të thella për ofruesit shqiptarë të kujdesit shëndetësor dhe për pacientët. Brenda vitit, përafërsisht 2,000 mjekë dhe punëtorë shëndetësorë shqiptarë etnikë u larguan me dhunë nga pozitat menaxheriale në klinikat dhe në spitalet e Kosovës. Specialistët e mjekësisë dhe të kirurgjisë, të cilët vazhduan të ishin të punësuar në spitalet shtetërore serbe, ishin zbritur në status të klasit të dytë.

Mjekët shqiptarë reagueshan duke krijuar sisteme shëndetësore paralele në Kosovë, të bazuara në praktikat e tarifave për shërbime. Duke qenë se tarifat të cilat duhet të paguheshin për shërbime ishin të parritshme për shumë shqiptarë kosovarë, Shoqata “Nëna Terezë”, një organizatë joqeveritare shqiptare, themeloi rrjetin e rreth 100 ambulancave në Kosovë për të ofruar kujdesin primar dhe shërbime të maternitetit, të cilat u shërbyen 350,000 njerëzve. Ambulancat e “Nënë Terezës” furnizoheshin nga donacionet nga diaspora dhe nga OJQ-të ndërkombëtare, si Mjekët Pa Kufij (MSF), Caritas, Medi Swiss dhe Ekuilibre. Më vonë, organizatat bamirëse vendosën shërbime pa pagesë, përfshirë Kryqin e Kuq të Kosovës, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), Mjekët e Botës dhe Farmacistët pa Kufij.

Mjekët shqiptarë me përvojë panë se mundësitë e tyre për zhvillim të vazhdueshëm profesional ishin zvogëluar së tepërmi. Studentët të cilët kërkonin edukim shëndetësor, mund të kishin qasje në shkollën

e mjekësisë të sistemit paralel, por ky sistem mund të ofronte vetëm mundësi të kufizuara për mësimin klinik. Deri në fund të viteve 1990, komuniteti mjekësor i shqiptarëve të Kosovës përbëhej prej tri grupesh të ndryshme: mjekët e rinj me trajnim klinik nga sistemi paralel; mjekët të cilët ishin të trajnuar mirë para vitit 1990 në Kosovë apo diku tjetër në ish-Jugosllavi dhe tani kishin praktikën e tyre në klinikat e tyre private të cilat i kishin ndërtuar me fondet personale; dhe mjekët e vjetër (përgjithësisht nga 55 deri në 60 vjet apo më të vjetër), pak prej të cilëve ishin ende në punë, të cilët kishin poste formale në shkollën mjekësore kosovare dhe trajnimi dhe përvoja e të cilëve datonte nga vitet 1970 apo më herët.

Përpos një numri të vogël të mjekëve shqiptarë të Kosovës, të cilët mbetën të punësuar në sistemin shtetëror, klinikat e “Nënë Terezës” e shfrytëzuan sistemin shtetëror për testet laboratorike dhe për udhëzimet për kujdes të specializuar dhe për hospitalizim. Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet sistemit zyrtar shtetëror dhe sistemit shëndetësor të ndarë shqiptar ishte i vendosur në një sfond të mosbesimit të thellë. Meqenëse aq shumë shqiptarë ishin larguar nga puna, e cila u mundësonte atyre kartën e sigurimi shëndetësor, më shumë se gjysma e humbën sigurimin shëndetësor. Për më tepër, shumë pacientë shqiptarë frikësoheshin të shkonin në objektet e uzurpuara, siç është evidentuar me numrin relativisht të lartë të lindjeve në shtëpi gjatë kësaj periudhe dhe zvogëlimin e vaksinimeve (më pak se 30 për qind ishin përfshirë), të cilat mund të administroheshin legalisht vetëm nga sistemi zyrtar shtetëror. Shqiptarët të cilët ishin më të pasur, mund të siguronin kujdes shëndetësor nëpërmjet praktikave të mjekëve shqiptarë me tarifa për shërbim. Shqiptarët e varfër, ndërkaq, duhej të mbështeteshin në kujdesin bamirës të ofruar nga Shoqata ‘Nëna Terezë’ dhe agjencitë e tjera bamirëse. Derisa e plotësonin një nevojë të rëndësishme, këto shërbime nuk ishin zëvendësim adekuat për mjekësinë e vazhdueshme primare, nuk e plotësuan nevojën për shërbime spitalore, ishin sporadike, dhe nuk ishin të koordinuara për të mbështetur sistemet e vjetra.⁴

⁴ Prof. Ass. Dr. Salih Krasniqi: *Krimet e luftës kundër pacientëve dhe personelit mjekësor, të kryera nga forcat policore dhe ushtarake serbe në QKUK gjatë periudhës 1998-1999 (libri II, me plotësime)*, Prishtinë 2022.

Arrestimet e paligjshme të mjekëve, torturat dhe gjykimet e rreme të improvizuara

Rastet në të cilat mjekët ishin ndaluar dhe u ishin nënshtruar formave të torturës dhe formave të tjera të trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor dhe degradues, përfshijnë si në vijim:

Dr. Shani Bajraktari. Ishte oftalmolog. Ai kishte ofruar ndihmë mjekësore për ushtarët e UÇK-së në një klinikë. Një inspektor nga sigurimi i shtetit e kishte marrë në pyetje dr. Bajraktarin lidhur me lidhjet e tij me UÇK-në, përfshirë një vizitë në spitalin e UÇK-së në Gajrak ku ai kishte shkuar për t'u kujdesur për një grua me një lëndim serioz të syrit.

Dr. Bajraktari u ndalua përsëri më 28 shtator 1998. Këtë herë ai ishte sjellë në qendrën e ndalimit ku “ishte rrahur mizorisht” derisa e kishte humbur vetëdijen. Derisa marrja në pyetje kishte vazhduar, autoritetet serbe i kishin treguar një deklaratë të bërë nga dikush tjetër se ai kishte punuar në një klinikë të UÇK-së dhe kishin vazhduar ta rrahin derisa e kishte nënshkruar pohimin. Kur doli para gjykatësit ai i mohoi akuzat dhe u rrah përsëri në sallën e gjykimit. Ai u mbajt pastaj në një dhomë prej 22 metrash katrorë, me 37 të ndaluar të tjerë dhe pa pajisje sanitare. Më vonë ai u dërgua në një qeli e cila kishte katër njerëz.

Dr. Bajraktari u akuzua për – *akt të terrorizmit nga neni 125 i Kodit Penal të Jugosllavisë*”. Prokurori kërkoi burgim në kohëzgjatje prej 15 vjetësh..⁵

Pas tre muajsh në paraburgim, më 29 janar 1999 në seancën gjyqësore, fqinjët serbë të dr. Bajraktarit dëshmuan në të mirë të tij. Në një vendim të marrë me shumicë votash (3-2) dr. Bajraktari u dënua me 3 vjet burgim. Në ndërkohë, ai u lirua me kusht duke pritur vendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Serbisë. Ai bashkë me gruan e tij u largua nëpër male dhe kaloi në Shqipëri.

⁵ Më gjerësisht shih: Prof. Ass. Dr. Salih Krasniqi: *Krimet e luftës kundër pacientëve dhe personelit mjekësor, të kryera nga forcat policore dhe ushtarake serbe në QKUK gjatë periudhës 1998-1999 (Libri II, me plotësime)*, Prishtinë 2022.

Dr. Luan Jaha drejtoi një klinikë afër Rahovecit. Në korrik të vitit 1998, pas ofensivës së Rahovecit, dr. Jaha, bashkëshortja e tij Vlora (mjeke pediatre) dhe dy fëmijët e tyre të vegjël ikën në Malishevë. Ai u kujdes për të sëmurët dhe për të plagosurit në një objekt të improvizuar. Më 17 gusht 1998, derisa po kthehej në Rahovec, ai ishte vënë re nga një polic i cili një herë kishte qenë pacient i tij. Dr. Jaha ishte vënë nën pranga, ishte marrë në arrest dhe ishte sjellë në stacionin e policisë në Prizren. Ai ishte marrë në pyetje në lidhje me aktivitetet e tij, ishte akuzuar për organizimin e shërbimeve mjekësore të UÇK-së dhe për marrjen e pengjeve serbe në ambulancën e tij në Rahovec. Kur dr. Jaha i kishte mohuar akuzat, ai ishte rrahur me shkopinj gome. Pastaj ai ishte dërguar në një qeli të vogël me 20 deri 30 të burgosur të tjerë. Atyre u ishte dhënë pak ujë dhe ushqimi ishte shumë i pakët. Një kovë shfrytëzohej si pajisje e banjës.

Tri ditë rresht ai ishte marrë në pyetje në lidhje me aktivitetet e tij dhe të mjekëve të tjerë, të cilët punonin në atë rreth. Duke e maltretuar fizikisht, i kishin shkaktuar hematoma në këmbët e në duar, me ç'rast e kishte humbur vetëdijen pas zënies së frymës me thes plastike. Atij po ashtu i ishte mohuar kujdesi mjekësor.

Ai kishte kërkuar që të shkonte te mjeku në Prizren. Kur kjo i ishte lejuar, ai kishte kërkuar nga mjeku që t'i jepte një vërtetim me shkrim se ai ishte rrahur. Mjeku kishte refuzuar. Dr. Jaha gjithashtu kishte kërkuar analgjetikë dhe sedativë të cilat po ashtu ishin mohuar. Ai ishte dërguar në gjykatë për t'i dëgjuar akuzat e hetuesve ku avokati i dr. Jahës i kishte thënë gjykatës se klienti i tij ishte rrahur.

Dr. Jaha kishte raportuar se sesionet e torturës kishin ndodhur çdo natë jashtë qelive dhe korridoreve të burgut. Ai gjithashtu kishte dëgjuar britma dhe zëra, të cilat ai kishte menduar se vinin nga rrahjet e të burgosurve. Pas një muaji e gjysmë, dr. Jaha ishte liruar dhe të gjitha akuzat për terrorizëm të ngritura ndaj tij ishin hedhur poshtë.⁶

Dr. Fehmi Vula ishte kirurg i përgjithshëm i mirënjohur dhe ish-kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës. Në vitin 1998 ai ishte drejtor i spitalit të Gjakovës. Në maj të vitit 1998, policia e sigurimit të shtetit serb erdhi në zyrën e tij dhe kërkoi nga ai që t'i shoqëronte ata në kërkim të dy policëve serbë të cilët ishin zhdukur, duke supozuar se ai mund të shfrytëzonte autoritetin e tij në komunitet për të siguruar lirimin e tyre. Ata u kërcënuan se do ta vrisnin nëse policët nuk do të ktheheshin. Pas

⁶ Po aty.

tri ditësh kërkimi dhe pasi nuk mundën t'i gjejnë policët, i thanë se ai ishte i lirë për t'u larguar. Por para se të largohej nga stacioni i policisë u arrestua. Hetuesit e akuzuan se u kishte dhënë ndihmë mjekësore ushtarëve të plagosur të UÇK-së prapa linjave të betejave, për blerje armësh për UÇK-në.

Dr. Vula u mbajt për tri ditë në burgun e Gjakovës, në bodrumin e stacionit policor. Ai e përshkroi qelinë e tij "si një nevojtoare pa tualet" ku të gjithë duhej të urinonin dhe të bënë nevojën aty. Nuk kishte drita, as karrige apo krevate në burgun e bodrumit. Dr. Vula ishte transferuar pastaj në Prizren dhe ishte sjellë para gjykatësit hetues, i cili i kishte thënë se deklaratat të cilat ai i kishte bërë derisa ishte në burg nuk do të përdorehin. Dr. Vula i kishte thënë gjykatësit se ai kishte qenë në fshatin e kontrolluar nga UÇK-ja, por në atë kohë nuk kishte pasur luftime. Ai kishte shpjeguar se një minë tokësore kishte vlarë pesë civilë dhe kishte plagosur edhe pesë të tjerë. Mjekët lokalë kishin kërkuar ndihmën e tij. Gjykatësi lëshoi një urdhër për ta mbajtur dr. Vulën në paraburgim për 30 ditë, i cili pastaj i ishte vazhduar për 60 ditë, në pritje të hetimeve.

Pas 49 ditësh në Prizren, dr. Vula ishte transferuar në Pejë. Në Pejë e dërguan para një gjykatësi tjetër hetues, i cili urdhëroi që dr. Vula të mbahej në paraburgim për një kohë të pacaktuar derisa të ishte nën hetime. Gjashtë javë më vonë, dr. Vula ishte transferuar përsëri, në Mitrovicë. Gjykimi i dr. Vulës, fillimisht i caktuar për 20 tetor 1998, ishte shtyrë për 3 nëntor 1998 dhe prapë kishte përfshirë akuzat për terrorizëm. Prokurori kërkoi nga gjykata që ta dënonte dr. Vulën me 10 vjet burgim. Në gjykim, drejtori serb i spitalit të Gjakovës dhe tre qytetarë të tjerë dëshmuan në të mirë të tij. Pas dëgjimit të provave, gjykata e shpalli fajtor dhe e dënoi me pesë muaj dhe e liroi për kohën të cilën e kishte mbajtur.⁷

Dr. Afrim Avdaj ishte kirurg i përgjithshëm i cili, pas trajnimit në Sarajevë, ishte ftuar të kthehej në vendin e tij të lindjes, Verrin, një fshat 6 km prej Prizrenit, për të ndihmuar për ofrimin e shërbimeve mjekësore për ushtarët e plagosur të UÇK-së. Ai arriti më 2 maj 1998. Në mes të korrikut, ai ishte ndaluar dhe mbajtur në qendrën e paraburgimit, së bashku me 50 shqiptarë të tjerë. Dr. Avdaj ishte dërguar në burg dhe ishte rrahur keq. Rojat kishin bërë një vijë dhe ai i shihte të burgosurit duke vrapuar në vijë derisa rriheshin me shkopin, me

⁷ Po aty.

grushte, me pushkë. Dr. Avdaj ishte akuzuar për vrasjen e një polici. Kur ishte sjellë para gjykatës tri ditë pas arrestimit, ai kishte thënë se e kishte nënshkruar deklaratën vetëm për shkak të kërcënimit me torturë. Megjithatë, gjykatësi e aprovoi aktakuzën dhe e dërgoi atë prapë në burg, ku ai qëndroi për më shumë se pesë muaj. Më 22 dhjetor, dr. Avdaj pati seancën e tretë dëgjimore, dhe ai prapë mohoi gjithçka. Derisa po i afrohej gjashtë muajve, periudhës maksimale të paraburgimit pa gjykim, gjykatësi e liroi atë. Dr. Avdaj tha se me gjithë torturat dhe pranimet, autoritetet serbe kurrë nuk e kishin kuptuar se ai kishte punuar si mjek për UÇK-në dhe nuk e kishin akuzuar me një vepër të bazuar në atë punë.⁸

Dr. Zaim Gashi ishte mjek i praktikës së përgjithshme, i cili gjatë viteve '90 ushtroi praktikën në fshatin Sferkë e më vonë në qendrën shëndetësore në Klinë. Më 1997 ai vendosi të specializonte në mjekësinë e emergjencës. E përfundoi trajnimin një vit më vonë, dhe punoi në Kpuz. Më 1998 Kpuzi u bombardua me artileri serbe, sepse ata thoshin se ishte afër zonave të kontrolluara nga UÇK-ja. Gjatë disa javëve në vijim, dr. Gashi lëvizi prej një vendi në një vend, duke shkuar nganjëherë në fshatin e tij, i cili atëherë kontrollohej nga UÇK-ja. Ai ishte i vetmi mjek për 25,000 banorë, përfshirë personat e zhvendosur, qytetarët lokalë dhe pjesëtarët e UÇK-së. Atje ai ushtroi praktikën e tij në rrethana të vështira, përfshirë edhe mungesën e furnizimeve dhe pajisjeve.

Më 15 korrik 1998 transporti për në qytet ishte ndërprerë nga një sulm dhe për gjashtë javët në vijim pati beteja rreth Sferkës, përfshirë edhe sulme artilerie në fshat në fillim të gushtit. Deri në fillim të shtatorit forcat serbe morën qytetin dhe dr. Gashi iku në Panorc. Mirëpo, pak javë më vonë forcat serbe hynë në Panorc, duke e djegur dhe grabitur. Aty u zu rob ai dhe shqiptarët e tjerë civilë. Burrat ishin dërguar në shkollën fillore dhe mbaheshin në klasa, ku ishin kërcënuar dhe disa ishin rrahur. Forcat serbe kuptuan se ai ishte mjek dhe e detyruan dr. Gashin të trajtonte njërin prej ushtarëve të tyre të plagosur. Pas një kohe, ai dhe njerëz të tjerë ishin dërguar në Pejë. Atje ai ishte marrë në pyetje dhe ishte rrahur në shuplakat e duarve dhe pjesë të tjera të trupit.

⁸ Më gjerësisht shih: Prof. Ass. Dr. Salih Krasniqi: *Krimet e luftës kundër pacientëve dhe personelit mjekësor, të kryera nga forcat policore dhe ushtarake serbe në QKUK gjatë periudhës 1998-1999* (Libri II, me plotësime), Prishtinë 2022.

Pas një muaji, ai u soll para gjykatësit, ku i mohoi akuzat kundër tij dhe ndërkohë u transferua në Lipjan. Aty u rrah mizorisht. Ai kaloi dy muaj atje dhe tre muaj të tjerë në Gjakovë.

Duke mos pranuar për asgjë dr. Gashi e përmendi betimin e Hipokratit para gjykatësve, por policia thanë se ai nuk kishte obligim t'u ofronte kujdes mjekësor terroristëve. Dr. Gashi u dënua me gjashtë muaj dhe u lirua për kohën të cilën ishte mbajtur në burg.⁹

Dëbimi i mjekëve dhe i pacientëve nga Spitali i Prishtinës

Derisa intervenimi i NATO-s po afrohej, serbët e armatosur - shumë prej tyre në dukje civilë - papritmas u paraqitën në rrugët e Prishtinës dhe bashkë me forcat policore e paramilitare serbe, grabitën dhe dogjën shitoret dhe klinikat shëndetësore të shqiptarëve. Tanket serbe, transportuesit e blinduar të personelit, dhe automjetet e civilëve të armatosur mbushën rrugët. Në mëngjesin e 25 marsit 1999, pas fillimit të fushatës së NATO-s, drejtori serb i Spitalit të Prishtinës ftoi të gjithë personelin në mbledhje. Automjetet ushtarake serbe ishin parkuar para spitalit dhe ushtarët serbë të armatosur dhe paramilitarët patrullonin ambientet e spitalit. Disa mjekëve shqiptarë u ishte tërhequr vërejtja prej kolegëve miqësorë që të mos merrnin pjesë në mbledhje, edhe pse një numër i vogël vendosën të shkojnë. Së paku një duzinë viktimash serbe të bombardimit gjatë natës po trajtoheshin në zonën e viktimave. Në mbledhje, dr. Grbiç i shkarkoi mjekët shqiptarë dhe i urdhëroi që të largoheshin menjëherë. Ai po ashtu i liroi të gjithë pacientët shqiptarë për të krijuar hapësirë për viktimat serbe. Mjekët shqiptarë, duke u frikësuar për sigurinë e tyre personale, e lëshuan spitalin menjëherë.

Pacientët, shumë prej tyre me sëmundje serioze, ishin po ashtu subjekt i dëbimit të pakundërshtueshëm edhe pse gjendja e tyre klinike nuk e lejonte atë. Në mesin e pacientëve të larguar ishin dy të rinj të cilët pranonin terapi intravenoze për meningjitin tuberkuloz (TB); një grua me “sepsë gjinekologjike” dhe rreth 10 pacientë të cilët ishin plagosur rëndë në një eksplozim në treg dhe ishin pak ditë pas operacionit, amputimeve dhe eksplorimeve abdominale.

Më 28 mars, dr. Fllanza Gjinolli dëgjoi të shtëna përgjatë rrugës që çonte te selia e ICRC-së së Prishtinës. Ata panë tym dhe zjarr që po

⁹ Po aty, f. 156 – 161.

vinte nga kodrat e Sofalisë, një lagje e Prishtinës dhe dëgjuan të shtëna me armë dhe granata. Automjetet e policisë serbe u afruan atëherë, duke shtënë me armë në të gjitha drejtimet. Rreth orës një pas dite, një grua 23 -vjeçare e zhvendosur nga rrethi i Deçanit ishte qëlluar me plumb, i cili kishte përfunduar në pjesën e poshtme të kurrizit torakal të saj. Një infermier i spitalit shtetëror të Prishtinës, një shqiptar, nxitoi që ta ndihmonte atë, e mori në shtëpi e pastaj e thirri dr. Talat Gjinollin për ndihmë. Ai shkoi në shtëpi dhe e ekzaminoi atë; gruaja ishte hypotensive dhe paraplegjike, por mund të merrte frymë. Kishte qenë shumë e rrezikshme për të për të ardhur dhe për ta vizituar dhe ai nuk kishte çfarë të bënte duke pasur parasysh të shtënat dhe trafikun.

Në ditët e para pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, mijëra shqiptarë në Prishtinë ishin përzënë nga shtëpitë e tyre. Grupe të njerëzve të armatosur do të sulleshin nëpër dyert e shtëpive, do të vendosnin tytën e kallashnikovëve në ballin apo në faqen e një fëmije dhe do t'i urdhëronin qytetarët që të largoheshin menjëherë. Banorët shpeshherë nuk kishin kohë as për t'i mbledhur rrobat, dokumentet dhe gjerat e tjera të vlefshme. Atyre u thuhej që të mos mundohen për t'i mbyllur banesat e tyre, sepse ishte e qartë se shtëpitë do të grabiteshin pasi të largoheshin ata. Sulmuesit kërkonin marka gjermane në këmbim të jetës së njerëzve. Disa familje ishin lejuar që të largoheshin me vetura; të tjerëve u ishte ndaluar qasja te veturat e tyre dhe ishin detyruar që të largoheshin në këmbë. Ata që rezistonin, qëlloheshin me armë, shpesh para familjeve të tyre.¹⁰

Të dhënat për pacientë nga protokollet e të sëmurëve nga QKUK-ja

Në mesin e pacientëve në spital, gjenden shumë persona të plagosur, të keqtrajtuar, të rrahur, të lidhur për krevate apo për radiatorë, të cilëve ua fikën cigaret në duar e në trup, të vvarë, të zhdukur etj. Po ashtu, në evidencat e pasqyruara, rezultojnë shumë pacientë për të cilët nuk disponohet me të dhëna të plota, të bëra siç duket me qëllim nga përgjegjësit serbë.

Gjithsej në protokolle janë rreth 6114 pacientë shqiptarë të trajtuar në Kirurgji dhe Ortopedi nga numri total prej 10543 pacientëve.

¹⁰ Perilous Medicine: The Legacy of Oppression and Conflict on Health in Kosovo June 2009 A Report by Physicians for Human Rights, f. 22-34.

Nga këta pacientë në këtë punim janë të gjetur shënime 1239 prej tyre.

Nga ta janë 372 femra, 856 meshkuj, 11 pacientë N.N., 36 pacientë pa datëlindje, 31 pacientë nga burgu i Dubravës, 17 pacientë të cilëve në rubrikën e profesionit u është shkruar fjala “terrorist”, 402 prej tyre ishin fëmijë deri 17 vjeç dhe 741 të rritur.

Mosha e 1239 pacientëve të përfshirë ishte nga disa ditë (fëmija i porsalindur) deri në 88 -vjeçare.

Mosha mesatare ishte 27.3 vjeçe.

Diagnozat e 1239 pacientëve të përfshirë në këtë studim ishin:

- Plagë sklopetare (me armë zjarri) =104
- Plagë eksplozive (me armë eksplozive) = 123
- Plagë të tjera = 508
- Të padiagnostifikuar = 504
- Gjithsejt = 1239

Vdekjet e pacientëve të përfshirë:

- Femra = 25
- Meshkuj = 87
- Gjithsej = 112 ose 11.06%

Në këtë numër nuk janë përfshirë edhe 45 punëtorë shëndetësorë të vrarë apo të zhdukur.

Derisa konflikti po shkallëzohej në vitin 1998, diskriminimi u intensifikua, qasja u kufizua tepër shumë dhe kur pacientët arrinin të kenë qasje ata kërcënoheshin e madje edhe keqtrajtoheshin fizikisht. Disa pacientë ishin dëbuar para kohe nga spitalet dhe ishin burgosur, në kundërshtim me urdhrat e mjekut. Pacientët kanë raportuar se policia serbe, rojtarët, e madje edhe personeli i spitalit i kishin rrahur pacientët shqiptarë, i kishin lidhur me zinxhirë për krevatesh apo për radiatorësh, apo i kishin djegur me cigare. Ata po ashtu kishin ndërhyrë rregullisht në ofrimin e kujdesit mjekësor për pacientët shqiptarë. Pacientët nga zonat e konfliktit shpeshherë vendoseshin nën vëzhgim apo nën roje të vazhdueshme të ushtarëve apo të policëve serbë.

Physicians for Human Rights (PHR apo Mjekët për të Drejtat e Njeriut)¹¹ kanë dokumentuar 23 raporte të dorës së parë për keqtrajtimet e pacientëve nga ana e autoriteteve serbe në vitin 1998-99. Shqiptarët më të rrezikuar për keqtrajtim fizik në sistemin shëndetësor ishin burrat të cilët vinin nga zonat e konfliktit, për të cilët autoritetet serbe duket se besonin se janë mbështetës të UÇK-së apo luftëtarë. Megjithatë, të gjithë pacientët shqiptarë, pa marrë parasysh gjininë apo qytetin e origjinës apo lidhjen me luftën, ishin të rrezikuar për t'u keqtrajtuar fizikisht gjatë qëndrimit të tyre në objektet shëndetësore. Policët dhe rojtarët serbë i rrihnin pacientët në tualete, në korridore, apo derisa ishin në krevatet e tyre në spital. Ata kishin fikur cigaret në pacientët postoperativë dhe kishin djegur organet e tyre gjenitale, këmbët, krahët dhe varrë të hapura. Në një rast, policia kishte filluar një sulm në një njësi të kujdesit intensiv me 30 policë të armatosur dhe e kishte mbajtur një pacient me respirator në shënjestër të armës. Shumë prej këtyre keqtrajtimitëve kishin ndodhur kur mjekët nuk ishin të pranishëm. Mjekët të cilët kishin provuar t'i mbrojnë pacientët e tyre, ishin kërcënuar me jetë nga policët.

Vrasjet dhe zhdukjet e mjekëve

Gjatë periudhës shkurt 1998 deri në shkurt 1999, PHR-ja ka dokumentuar tri vrasje të mjekëve dhe një i cili ishte zhdukur. Provat tregojnë se së paku dy prej tyre ishin bërë cak për arsye se ishin mjekë. Në të gjitha rastet, provat tregojnë se forcat serbe ishin përgjegjëse. Vrasja dhe zhdukja e këtyre mjekëve terrorizoi komunitetin mjekësor të shqiptarëve të Kosovës dhe në atë kohë shërbeu si një përkujtues i vazhdueshëm për mjekët për rreziqet të cilat i bart me vete ushtrimi i detyrave të mjekut.

Në mesin e të vrarëve dhe të zhdukurve janë:

Nr.	Emri e mbiemri	M	Vdekja	Mënyra	Vend-banimi	Profesioni
1	Dr. Hafir Shala 1960	38	I zhdukur	I zhdukur	Drenas	Mjek
2	Dr. Hazir Avdyli Malaj, 1941	57	I vrarë		Tropojë	Mjek

¹¹ Perilous Medicine: The Legacy of Oppression and Conflict on Health in Kosovo June 2009 A Report by Physicians for Human Rights, faqe 22-34.

Nr.	Emri e mbiemri	M	Vdekja	Mënyra	Vend- banimi	Profesioni
3	Dr.Lec Leci- Gradica, 1954	44	I vrarë	I masakruar	Drenas	Mjek
4	Dr. Shpëtim Robaj, 1957	41	I vrarë		Prishtinë	Anesteziolog
5	Dr. Nuredin Zejnullahu, 1949	49	I vrarë		Pejë	Internist
6	Dr.Xhevat Gashi, 1953	46	I vrarë		Pejë	Mjek
7	Dr. Izet Hima, 1939	60	I masakruar	I zhdukur	Gjakovë	Kirurg
8	Dr.Fahredin Sh.Hoti, 1953	46	I vrarë		Rahovec	Gjinekolog
9	Dr. Fatmir Krasniqi, 1956	43	I vrarë	I zhdukur	F. Kosovë	Mjek
10	Dr.Lah A. Islami, 1967	32	I vrarë	I zhdukur	Gjakovë	Mjek
11	Dr.Vesel Xh. Elezi, 1958	41	I vrarë		Ferizaj	Fiziatër
12	Dr. Masar I. Radoniqi, 1942	57	I vrarë		Gjakovë	Stomatolog
13	Dr.Adem Ademi, 1948	51		I zhdukur	Mitrovicë	Kirurg
14	Dr.Fatmir B. Fazliu, 1966	33		I zhdukur	Skenderaj	Mjek
15	Dr. Bedri B. Beqaj, 1963	36	I vrarë		Gjakovë	Gjinekolog
16	Dr. Rexhep S.Hajdaraj, 1962	37	I vrarë		Deçan	Mjek
17	Dr.Faton Q. Huma, 1962	37	I vrarë		Gjakovë	Stomatolog
18	Dr. Igballe A. Oshlani, 1954	45	E vrarë		Vushtrri	Kardiolog
19	Dr. Zijaudin I. Haxhijaj, 1951	48		I zhdukur	Pejë	Pulmolog
20	Mr.Ph. Blerim Dema, 1966	33	I vrarë		Kaçanik	Farmakolog

Nr.	INFERMIERËT	M				
1	Beqir M. Jakupi, 1939	60	I vrarë	I masakruar	Orllan	Infermier
2	Nesim S. Popaj, 1965	34	I vrarë		Rahovec	Tek. Radiologjisë
3	Halil Kyçyku, 1951	48	I vrarë		Suharekë	Infermier
4	Fatime M. Berisha, 1956	43	E vrarë	E zhdukur	Suharekë	Infermiere
5	Avdi Sahit Berisha, 1953	46	I vrarë	I zhdukur	Suharekë	Infermier
6	Murat F Suka, 1944	55	I vrarë		Bllacë	Tek. i stomatologjisë
7	Bekim L. Thaçi, 1968	31	I vrarë		Rahovec	Teknik i farmacisë
8	Zaim Q. Bajrami 1963	36	I vrarë		Skenderaj	Infermier
9	Bujar Sh. Thaçi, 1978	21	I vrarë		Rahovec	Infermier
10	Jeton A.Kabashi, 1981	18	I vrarë		Rahovec	Infermier
11	Arsim Poniku, 1979	19	I vrarë		Prizren	Infermier
12	Bahri M. Kryeziu, 1966	33	I vrarë		Gjakovë	Infermier
13	Mentor Leposhtica, 1976	23	I vrarë		Prishtinë	Infermier
14	Burim Selmanaj, 1979	20	I vrarë	I zhdukur	Gjakovë	Infermier

Nr.	STUDENTËT E MJEKËSISË				
1	Njazi Ibrahim Zenuni, 1975	24	I vrarë		
2	Imri Habit Halili, 1976	23	I vrarë		
3	Hidajet Hasan Mazreku, 1975	24	I vrarë		
4	Azem Hamit Babiqi, 1968	31	I vrarë		
5	Agron Hamdi Krasniqi, 1972	27	I vrarë		
6	Sejdi Hasan Gërxhaliu, 1970	29	I vrarë		
7	Visar Krasniqi, 1981	20	I vrarë		
8	Ismajl Xh. Ismajli, 1954	45	I vrarë		absolvent

NDIHMËS MJEKU						
1	Asret S. Poniku, 1964	34	I vranë		Prizren	Ndihmës saniteti në UÇK
2	Sokol S. Mazreku, 1953	46		I zhdukur	Malishevë	Ndihmës në Sh.Sh
3	Hamdi S. Berisha, 1946	53	I vranë	I zhdukur	Suharekë	Ndihmës në Sh.Sh

Në Kosovë, forcat serbe vranë 1392 fëmijë

Statistikat e organizatave humanitare ndërkombëtare, që kanë vepruar në Kosovë, në fund të vitit 1999, i kanë publikuar të dhënat e tyre se si pasojë e luftës 27 mijë fëmijë kanë mbetur jetimë, 12 mijë prej të cilëve pa asnjërin prind. Gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), nga organizatat e ndryshme humanitare është konstatuar se 20 për qind e viktimave të luftës janë fëmijët dhe se përqindja e viktimave fëmijë në Kosovë për 5 për qind është më e lartë se ajo e të gjitha vendeve të pushtuara nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore.¹²

Forcat ushtarake, policore dhe paramilitare kanë vranë rreth 11.840 persona. Në mesin e tyre, 1 mijë e 392 janë fëmijë, prej të cilëve 296 kanë qenë nën moshën 5-vjeçare.¹³

Krimet e shtetit të Serbisë në luftë me Kosovën, përveç vrasjes së shumë shtetasve kosovarë, kanë prekur edhe shumë fëmijë, të cilët u vranë madje edhe në bankat shkollore nga forcat serbe. Vetëm në komunën e Podujevës, sipas shoqatës për persona të zhdukur “Përkore”, gjatë luftës në Kosovë janë afro 70 fëmijë të vranë në bankat shkollore. Prej tyre 20 ishin në klasë të parë dhe të tjerët nga e dyta deri në të tetën. Shkolla fillore “Isa Boletini” në Podujevë është më e prekura në rrethinë sa i përket vrasjes së nxënësve. Në këtë shkollë në qershor të vitit 1999 forcat serbe u morën jetën rreth 9 nxënësve të cilët gjendeshin në objektin e shkollës. Të gjithë ata ishin në klasë të tretë.¹⁴ “Sipas antropologëve ndërkombëtarë, të cilët i kanë mbikëqyruar zhvarrimet në Serbi, vetëm në varrezat sekrete masive në poligonet e kazermës “13 Maji” në Batajnicë, të paktën trupat e 82 civilëve shqiptarë, kryesisht fëmijë e të rinj, para se të përfundonin në atë varrezë

¹² Nexhat Çoçaj, Shtigjeve të lirisë, Prizren, 2009, f. 98.

¹³ Më gjerësisht: Jusuf Osmani, Krimet e Serbisë në Kosovë (1998 – 1999, Prishtinë 2012.

¹⁴ <https://lajmi.net/ne-kosove-forcat-serbe-vrane-1392-femije/>.

sekrete masive, ishin trajtuar në spitale, duke e ngritur dyshimin e bazuar se atyre paraprkisht u janë marrë organet”.¹⁵

Fëmijët e plagosur dhe të lënduar të pranuar në klinikat kirurgjike të spitalit të Prishtinës nga 01.05.1998 deri 20.06.1999

Ekziston një numër i konsiderueshëm i fëmijëve të plagosur gjatë luftës në Kosovë 1998-1999 me armë zjarri, me mjete eksplozive dhe me mjete të tjera nga 01.05.1998 deri më 20.06.1999 që janë trajtuar në Spitalin e Prishtinës. Numri gjithsej është **402**. Prej tyre **138** femra dhe **264** meshkuj. Këta fëmijë kanë qenë të hospitalizuar nëpër klinikat e spitalit të Prishtinës. Nga numri i përgjithshëm prej **402** pacientëve, kanë vdekur në spital **16 fëmijë**, të plagosur me armë zjarri (sklopetare) janë **22**, nga armë eksplozive janë **22**, me mjete të tjera janë **211** dhe pa diagnozë janë **147**. Protokollat të cilat janë shfrytëzuar, janë nga Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve, Kirurgjisë Torakale, Neurokirurgjisë, Ortopedisë, Kujdesit Intensiv, sallës së operacioneve urgjente, nga Protokollat e Pranimit. Këto të dhëna janë nxjerrë nga protokollat e Klinikave gjegjëse nga 01.05.1998 deri më 20.06.1999.

Një shembull nga 402 fëmijët e plagosur:

Shkurte Maliqi, 1998, 6-muajshe, nga Likoshani i Drenasit. Kjo vajzë pranohet në kujdesin intensiv me 23.09.1998 e më pas transferohet në Neurokirurgji më 24.09.1998 me diagnozën **Dg: Vulnus sclopetarium regio frontalis lat.dex. Fractura oss. frontalis lateris dextri. Susp. Ruptura bulbi oculi dex. (Plagë me armë zjarri në kokë në regjionin ballor djathtas. Thyerje e kockës ballore nga ana e djathtë. Shpërthim i dyshimtë i kokërdhokut të syrit të djathtë).**

Nuk kam të dhëna për fatin e saj.

5654	U	Maliqi	0706	1998	front.	8610		COCK
5654	U	Maliqi				987		
						1610		11 (EUP)

Fig.112. Shkurte Maliqi, 1998 (6-muajshe) Nr. 5654. Protokollit i pranimit në Mjekimin Intensiv, 24.09.1998

¹⁵ <https://www.epokaere.com/gjenocidi-i-pandeshkuar-i-serbise-kunder-shqiptareve-gjate-luftes-ne-kosove-nuk-ishte-as-i-pari-as-i-rastit/>: Fetnete Ramosaj – Fjalë e autores në promovimin e librit “KUNDËR HARRESËS – GJENOCIDI I SERBISË NË KOSOVË 1998-1999”, (shqip-anglisht), organizuar nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, në bashkëpunim me Komunën e Çairit në Shkup.




Fig.112/1. Shkurte Maliqi, 1998 (6-muajshe) Nr. 701/5654. Data e pranimit në Mjekimin Intensiv: 22.09.1998




Fig.112/2. Shkurte Maliqi, 1998 (6-muajshe). Nr. 726/5654. Data e pranimit në Neurokirurgji, 23.09.1998

Diagnoza në Neurokirurgji është kjo. **Dg: Vulnus sclopetarium capitis reg. frontalis dex. Ruptura bulbi OD. Op: Craniotomia simplex reg. frontobazalis dex. Suttura durae.** (Plagë me armë zjarri në kokë në regjionin ballor djathtas. Shpërthim i kokërdhokut të syrit të djathtë. Operimi: Hapja kirurgjike e kafkës e thjesht në regjionin ballor-bazal djathtas. Qepja e durës).

Pra mund të shihet se nuk janë kursyer as fëmijët 6 muajsh nga policia serbe ku me armë zjarri revole apo automatik i kanë plagosur ku shihet në bazë të diagnozave të përshkruara.

Të plagosurit në repartin e kirurgjisë vaskulare (QKUK) të cilët identifikoheshin si “terroristë”

Në këtë grup bëjnë pjesë **17** persona të cilët kanë pasur tretman mjekësor më ndryshe nga të tjerët, në kuptimin negativ. Kanë qenë të lidhur për shtrati apo për radiator, kanë pasur maltretime të përditshme nga policia dhe gardianët, paramilitarët, si dhe nga vetë pacientët serbë që kanë qenë të hospitalizuar si të plagosur gjatë luftës. Ka pasur edhe shumë të tjerë që kanë pësuar ngjashëm. Është për t’u habitur se si edhe te një fëmijë **17** vjeçar shkruhet profesioni “Terrorist”. Ky është Naim Qufaj, i lindur më 1981.

Të dhënat nga rubrikat e protokollit të Repartit të Kirurgjisë Vaskulare, në këtë repart çuditërisht e kanë pasur të shënuar fjalën terrorist në rubrikën e profesionit. Këta pacientë kanë qenë nën vëzhgimin e policisë serbe 24 orë dhe të keqtrajtuar me metoda më të ndryshme.

Të plagosurit me “profesionin terrorist”

1. **Qerim Jetishi, 1965, 33 vjeçar, nga Gjakova.**
2. **Arsim Hasimi, 1973, 25 vjeçar, nga Shtimja.**
3. **Mehdi Limani, 1960, 38 vjeçar, nga Shtimja.**
4. **Islam Thaçi, 1972, 26 vjeçar, nga Prizreni.**
5. **Agim Jaha 1967, 21 vjeçar, Klinë.**
6. **Gjokë Ndrecaj,¹⁶ 1962, 36 vjeçar, nga fshati Bitesh, komuna e Gjakovës. I vrar në burgun e Dubravës më 19.05.1999.**
7. **Arsim Tolaj, 1980, 18 vjeçar, nga Prejlepi i Deçanit.**
8. **Naim Qufaj (1981), 17 vjeçar, nga lagjja “Dardania” e Pejës.**
9. **Arben Bobani, 1977, 21 vjeçar, nga Gjakova.**
10. **Valon Gexha, 1976, 22 vjeçar, nga Gjakova.**
11. **Arbër Spahiu, 1976, 22 vjeçar, nga Gjakova.**
12. **Avdi Krasniqi, 1954, 44 vjeçar, nga Komuna e Drenasit.**
13. **Veli Vrellaku, 1975, 23 vjeçar, nga Drenasi.**
14. **Bislim Bislimaj, 1957, 41 vjeçar, Viti.**
15. **Muhamet Kiçina, 1976, 23 vjeçar, nga Drenasi.**
16. **Avni Haziri, 1973, 26 vjeçar, Ferizaj.**
17. **Fehmi Veliqi, 1974, 25 vjeçar, nga fshati Polluzhë Komuna e Drenasit. I vdekur në QKUK dhe i zhdukur deri 2003.**

Një shembull nga 17 të plagosur “Terrorist:

Naim Qufaj (1981), 17 vjeçar, nga lagjja “Dardania” e Pejës.

Naimi ishte ushtar i UÇK-së dhe gjatë luftimeve kishte marrë plagë në kraharorin e djathtë. Është mjekuar në Spitalin e UÇK-së në Kryshec të Pejës. Pas sulmeve të forcave ushtarake-policore serbe, zona ku ishte i vendosur spitali bie nën kontrollin e policisë dhe të ushtrisë serbe, me ç’rast disa nga të plagosurit zihen robër. Policia serbe dhe KNKK i marrin dhe i dërgojnë së pari në spitalin e Pejës. Prej andej disa i sjellin në spitalin e Prishtinës. Ndër ta është edhe Naim Qufajn,

¹⁶ Në librin e protokollit i shkruan se është i lindur në vitin 1972, por Gjokë Ndrecaj është lindur në vitin 1962.

të cilin e sjellin në Kirurgjinë Vaskulare, edhe pse plagët i kishte në kraharon dhe duhej të mjekohej në Kirurgjinë Torakale. Pacienti është pranuar në Kirurgjinë Vaskulare më 16 shtator 1998, me diagnozën **Dg: Pyopneumothorax compresiva lat.dex. (Qelb dhe ajër i lirë me shtypje në kraharonin e djathtë)**. Në protokollin e pranimit në Repartin e Kirurgjisë Vaskulare, te rubrika e profesionit i shkruante fjala **“TERRORIST”**, sikurse dhe shumë të tjerëve.

5485	U	16.09.98	1981	16.09.98	29.09.98	15.10.98	20p.

Fig.8. Naim Qufaj, 1981. Protokollin e pranimit nr. 5485 në Kirurgjinë Torakale, më 16.09.1998

757/5485	Naim Qufaj	1981	Dec	Terrorist	Pyopneumothorax compresiva l. dex	16.9.98	29.9.98	B
----------	------------	------	-----	-----------	-----------------------------------	---------	---------	---

Fig.8/1. Naim Qufaj, 1981. Protokollin Nr. 757/5485, i datës 16.09.1998 - Kirurgjia Vaskulare. Në këtë Klinikë shef ishte Prof. dr. Sadri Bajraktari, kurse unë (dr. Salih Sh. Krasniqi) dhe dr. Valbon Gashi, ishim mjekë reparti.

Pacientët mbi moshën 18-vjeçare të hospitalizuar në Spitalin e Prishtinës

Numri i këtyre pacientëve është **741 persona**. Nga ta **220** femra dhe **521** meshkuj. Këta pacientë mbi moshën 18-vjeçare kanë qenë të hospitalizuar nëpër klinikat e Spitalit të Prishtinës në periudhën e lartcekur. Nga numri i përgjithshëm prej **741** pacientëve, pacientë që kanë vdekur në spital janë **81**, të plagosur me armë zjarri (sklopetare) janë **64**, nga armë eksplozive janë **65**, me mjete të tjera janë **272** dhe pa diagnozë janë **340**. Protokollet të cilat janë shfrytëzuar, janë nga Kirurgjia Abdominale A, B, HB, C, Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve, Kirurgjisë Torakale, Neurokirurgjisë, Ortopedisë, Kujdesit Intensiv, sallës së operacioneve urgjente, nga Protokollet e Pranimit.

Këto të dhëna janë nxjerrë nga protokollet e klinikave përkatëse nga 01.05.1998 deri më 20.06.1999.

Një shembull nga 741 pacientë mbi moshën 18 -vjeçare:

Argjent Bakri. 1979, 19 vjeçar nga fshati Ponoshec - Gjakovë. Është pranuar në Mjekimin Intensiv më 04.05.1998. Diagnoza e pranimit shkruan **Dg: Vulnus sclopetarium hemithoracis lat.dex. Schock haemorrhagicus. (Plagë me armë zjarri në kraharorin e djathtë. Shok gjakderdhës).** Transferohet në Kirurgjinë Torakale më 06.05.1998. Diagnoza në Kirurgjinë Torakale ishte **Dg: Vulnus sclopetarium hemithoracis l.dex. Haemathopneumthorax traumatica l.dex. Schock haemorrhagicus. Op: Thoracostomia. (Plagë me armë zjarri në kraharorin e djathtë. Gjak dhe ajër të lirë në kraharorin e djathtë nga lëndimi. Shok gjakderdhës. Operimi: Formim gojëze në kraharor).**

04.05.1998	Argjent Bakri	04.05.1998	Gjakovë	05.05.98	ATC	18.06.98	004
------------	---------------	------------	---------	----------	-----	----------	-----

Fig. 3. Argjent Bakri, 1979. Nr. 2641. Protokollu i pranimit në Mjekimin Intensiv, 04.05.1998

Argjent Bakri	2641	04.05.1998	si Ponosheca	hino përvetno	Dg: Vulnus sclopetarium hemithoracis lat dex. Schock haemorrhagicus.	na 6.11.98	PRIMO AT-2641
---------------	------	------------	--------------	---------------	--	------------	---------------

Fig. 3/1. Argjent Bakri, 1979. Nr. 345/2641. Data në Mjekimin Intensiv: 04.05.1998

Argjent Bakri, 1979 (18 vjeçar), Gjakovë. Në rubrikën e diagnozës shkruan **Dg: Vulnus sclopetarium hemithoracis lat.dex. Haemathopneumothorax traumatica lat.dex. Shock haemorrhagicus. Op: Thoracostomia. (Plagë me armë zjarri në kraharorin e djathtë. Grumbullim gjaku dhe ajri në kraharorin e djathtë për shkak të lëndimit. Shok nga gjakderdhja. Operimi: Hapja kirurgjike e një vrime në kraharor).** Të dhëna të tjera nuk ka.¹⁷

¹⁷ Three Persons Wounded at Ponoshevc on Monday, One of Them Dies in Hospital PRISHTINA, May 5 (KIC) - The Kosovar border villages in the municipality of Gjakova came under resumed Serb gunfire yesterday. At 16:00 hrs, the village of Pepoc, a mile away from Ponoshevc village, was attacked yesterday. In the evening hours, the village of Ponoshec was shelled intermittently by Serb forces. Three local residents of Ponoshevc, an Albanian woman Razë Neziri (1936), and two Roma community members, father and son Binak Bakri (1941) and Argjent Bakri (1978), wounded during the Serb attack, were taken to the Gjakova hospital last evening, local sources said. They were victims of Serb




Fig. 3/2. Argjend Bakri, 1979. Nr. 229/2641. Data në Kirurgjinë Torakale:
06-29.05.1998

Të dhënat e më shumë se 31 të burgosurve të plagosur në burgun e Dubravës

Plagët e këtyre pacientëve kanë qenë të ndryshme, varësisht se me çfarë mjetesh janë kryer. Kishte plagë eksplozive, sklopetare, me mjete të mprehta dhe me ato të topitura.

Mosha më e vjetër e pacientit ishte 50 -vjeçare, kurse më i ri ishte 20 -vjeçar. Mosha mesatare për 29 pacientë ishte 33.6 vjeç, kurse te 2 pacientë nuk kishte datëlindje të shënuar.

Për shqiptarët e plagosur, që kanë qenë në burgun e Dubravës së Istogut, të cilët nga policia serbe, ishin sjellë në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare në Prishtinë, është karakteristikë se të gjithë të burgosurit shqiptarë kishin pësuar plagë, sipas policisë serbe, nga projektilet e NATO-s. Ndhimja e parë mjekësore u është dhënë pas 4 ditësh e disave edhe deri 20 ditëve pas plagosjes. Sipas shënimeve, në historitë e sëmundjes shkruan se bombardimi ka ndodhur më 22.05.1999. Kurse të plagosurit shqiptarë i kanë sjellë prej 26.05.1999 deri më 10.06.1999. Qëndrimi i të plagosurve në Kirurgji ka qenë prej 1-15 ditë, duke arsyetuar se nuk ka vend për të plagosur dhe sërish të plagosurit shkruan se i kanë kthyer në burg, por te disa nuk shkruan se në cilin burg. Thuhet se të plagosurit janë si pasojë e bombardimit të NATO-s, por harrojnë

indiscriminate firing on the houses in the village, and not against the Albanian terrorists, as the Serb propaganda alleges. Sources in Gjakova said the Serb ('Yugoslav') forces resumed their firing on villages in the area today morning. Serb forces have been stationed in a local school building at Ponoshevc village and in some houses abandoned by local Albanians. Fresh Serb troops have reported heading for the border area with Albania today morning. In the past few weeks, especially over the past several days, heavy Serb forces, including paramilitary units, have been building up in the area. Meanwhile, the town of Gjakova itself has continued to be tightly sealed off by Serb police, and the people routinely intimidated and ill-treated. A bus driver of "Emin Duraku" textile factory was beaten up brutally while driving workers to the factory on Monday morning.

se kanë sjellë pacientë që kanë pasur plagë nga armë zjarri të kalibrit të vogël, si revole apo pushkë automatike dhe pacientë të rrahur pa plagë. Është për t'u çuditur se si NATO-ja ka mundur t'i plagosë vetëm shqiptarët në burg e jo edhe serbët, siç ishin rojet, të burgosurit serbë dhe policët e burgut, pasi në protokoll të të sëmurëve nuk kemi të dhëna për ta".¹⁸

Sipas të dhënave, dihet se ka pasur afër 300 të plagosur shqiptarë në burgun e Dubravës nga 19.05.1999 deri më 22.05.1999. Në kirurgji i kanë sjellë vetëm 31 të plagosur apo 1/10 e të plagosurve.

Sipas të dhënave, një numër të plagosurve apo të rrahurve i kanë ekzekutuar në ambulancën dhe në kuzhinën e burgut të Dubravës.

Në spitalin e burgut, ku ishin dërguar pesëmbëdhjetë të plagosur rëndë për shërim, kriminelët edhe mbi të plagosurit rëndë shtinë prapë me revole në kokë dhe të gjithë i lanë të vdekur para syve të personelit shëndetësor. Më në fund, grupet paramilitare dhe të gardianëve ordinerë, me të arritur në lokalet e kuzhinës së burgut, ku ishin grumbulluar një pjesë e mirë e të burgosurve shqiptarë, të cilët i shpëtuan masakrave të mëparshme, mbi ta pa kurrfarë paralajmërimi zbrazën rafalë automatikësh, ku mbeten të vrarë dhe të plagosur rëndë e lehtë shumë të burgosur shqiptarë.¹⁹

Pacientët e sjellë në spitalin e Prishtinës kishin një tretman mjekësor aspak human, si nga ana e gardianëve, policëve serbë apo nga personeli mjekësor.

Dy pacientë gjatë mjekimit gjejnë vdekjen për shkak të vonesës në trajtim, si dhe trajtimit joadekuat në spitalin e Prishtinës.

Njëri pacient, pas lirimimit nga spitali i Prishtinës, nga torturat vdes ditën e 11 në burgun e Pozharevcit.

Pacientët e pamjekuar i kanë larguar nga spitali dhe sërish i kanë dërguar nëpër burgjet e Serbisë.

Lirimin nga Spitali i Prishtinës e kanë bërë mjekët, në koordinim me stafin e burgut, kinse nuk ka vende për pacientë. Sipas të dhënave të të plagosurve, tretmani mjekësor në spitalin e Prishtinës, në Kirurgjinë Vaskulare, ishte i mjerueshëm. Tretmani mjekësor ishte me

¹⁸ Dr.Salih Sh.Krasniqi, "Krimet dhe keqtrajtimet e pacientëve dhe personelit mjekësor në qendrën klinike universitare të Kosovës nga forcat policore dhe ushtarake të Serbisë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999" botuar në Prishtinë, 2018, f. 200.

¹⁹ www.forumishqiptar.com/threads/123223 Hasan Hasanramaj Masakra në Burgun e Dubravës ose Purgatori i Dante Aligerit, faqe 3.

maltretime, të lidhur për duar me njëri-tjetrin, rrahje nga gardianët e policët, fjalë fyese nga personeli mjekësor, mosofrim i ndihmës mjekësore adekuate etj.

Pacientët e plagosur në burgun e Dubravës të Istogut që milicia serbe i solli në QKUK

1. **Vehbi Kurtalani, 1976**, 23 vjeçar, nga Gjilani.
2. **Bedri Kukalaj, 1978**, 21 vjeçar, nga Prejlepi i Deçanit.
3. **Agim Ibraj, 1976**, 23 vjeçar, nga Peja.
4. **Bujar Himaj, 1968**, 31 vjeçar, nga Gjakova. Vdes në burgun e Pozbarevci nga torturat.
5. **Nazmi Haliti, 1954, 45 vjeçar**, nga Ferizaj.
6. **Fatmir Kokollari, 1968 (duhet 1973), 26 vjeçar**, nga Suhareka.
7. **Avdullah Cunaj, 1964**, 35 vjeçar, nga Prizreni.
8. **Ali Gashi, 1955**, 44 vjeçar, nga Suhareka. Vdes në QKUK.
9. **Bajram Bajraj, 1954, 45 vjeçar, Suharekë.**
10. **Besnik Kuki, 1949**, nga Prizreni.
11. **Hysni Dautaj**, pa datëlindje, pa adresë.
12. **Ajet Ibraj, 1974**, 25 vjeçar, nga komuna e Pejës.
13. **Gani Selani, 1946**, 53 vjeçar, nga Vushtrria.
14. **Ahmet Demiri, 1964**, 35 vjeçar, Gjilani.
15. **Hysen Latifaj, 1964, 35 vjeçar**, nga Prejlepi i Deçanit.
16. **Isa Topalli, 1971**, 28 vjeçar, nga Drenasi.
17. **Ibrahim Ferizi, 1974**, 25 vjeçar, nga Peja.
18. **Agim Hulaj, 1960, 39 vjeçar**, nga Deçani.
19. **Bashkim Haziraj, 1978**, 21 vjeçar, nga Suhareka.
20. **Haki Haziraj, 1964**, 35 vjeçar, nga Drenasi.
21. **Avni Memia, 1960**, 39 vjeçar, nga Tropoja e Shqipërisë.
22. **Nysret Hoti, 1970**, 29 vjeçar, nga Rahoveci.
23. **Musli Avdyli, 1960**, 39 vjeçar, nga Ferizaj.
24. **Bujar Sylaj, 1978**, 21 vjeçar, nga Tropoja e Shqipërisë.
25. **Mujë Tafilaj, 1968**, 31 vjeçar, nga Klina. Vdes në QKUK.
26. **Fadil Dabiqaj, 1959**, 40 vjeçar, Prejlep-Deçan.

27. **Armond Koshi, 1963**, 36 vjeçar, Gjakovë.
28. **Xhemsat Shehaj, 1962**, 37 vjeçar, nga Deçani.
29. **Fazli Myftar Franca, 1971**, 28 vjeçar, nga Tërsteniku i Drenasit.
30. **Sylejman Bytyçi, 1982**, (duhet me qenë 1952, pra 47 vjeçar), nga Ferizaj.
31. **Adnan Topalli, 1979**, 20 vjeçar, nga Rahoveci.

Një shembull nga 31 pacientë (të burgosur nga burgu i Dubravës së Istogut):

Haki Haziraj. 1964, 35 vjeçar, nga Drenasi (Gllogoci). Këtë pacient të plagosur në Kirurgjinë Vaskulare e ka sjellë policia serbe më 31.05.1999 nga Burgu i Dubravës së Istogut. Në historinë e sëmundjes shkruan se pacienti është plagosur 9 ditë para se ta sjellin në Kirurgji, nga bombardimi i NATO-s, edhe pse në diagnozë shkruan se plagët janë shkaktuar nga armë zjarri e jo nga granata. Diagnoza e shkruar në protokoll është: **Dg: Vulnus sclopetarium regio femoris anterolateralis et colli lat.dex. Infectio vulneris. Sepsis. Corpus alienum regio femoris. Op: Exploratio vulneris. Debridment. Evacuatio corporis alieni. (Plagë nga armë zjarri i kofshës së djathtë. Infeksion i plagës. Sepsë Trup i huaj në kofshë. Operimi. Eksplorimi i plagës. Pastrimi. Heqja e trupit të huaj).** Pas 10 ditësh qëndrimi në Kirurgji, pacientin e merr personeli i burgut dhe e dërgon në të njëjtin burg si shkruan në fletëlëshim.

2305	Haku Haziraj	1964	Troc.	10.06	99	Back
2305	Haku Haziraj					Surp?

Fig.20. Haki Haziraj,1964. Protokoll i pranimit në Kirurgjinë Vaskulare, Nr. 2305, i datës 31.05.1999

2305	Haki Haziraj	1964	Vulnus sclopetarium regio femoris. antea.	31.5	10.6	10
				99	99	

Fig.20/1. Haki Haziraj, 1964. Protokoll i Kirurgjisë Vaskulare Nr. 314/2305, i datës 31.05.1999-10.06.1999

Pacientët N.N (PA EMËR), të hospitalizuar nga 01.05.1998 deri më 20.06.1999 në Spitalin e Prishtinës (kirurgji dhe ortopedi).

Numri gjithsej është **11**. Këta pacientë N.N (pa emër) kanë qenë të hospitalizuar nëpër klinikat e spitalit të Prishtinës në periudhën e lartcekur. Nga numri i përgjithshëm prej **11** pacientëve, pacientë që kanë vdekur në spital janë **5**, të plagosur me armë zjarri (sklopetare) janë **2**, nga armë eksplozive janë **2**, me mjete të tjera janë **1** dhe pa diagnozë janë **6**. Protokollat të cilat janë shfrytëzuar, janë nga Kirurgjia Abdominale A, B, HB, C, Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve, Kirurgjisë Torakale, Neurokirurgjisë, Ortopedisë, Kujdesit Intensiv, sallës së operacioneve urgjente, nga Protokollat e Pranimit. Këto të dhëna janë nxjerrë nga protokollat e Klinikave përkatëse nga 01.05.1998 deri më 20.06.1999.

Një shembull nga 11 pacientët N.N.

Foshnje pa emër. 1999, nga Obiliqi. Është pranuar në Neurokirurgji më 10.03.1999. Mungojnë të dhënat e tjera për këtë pacient.

1296	11.1	1999	Obiliq	16.03	99	Neurokirurgji
	11.03.1999					

Fig. 3. N.N. foshnjë, 1999. Nr. 1296. Protokollat i pranimit në Neurokirurgji më 10.03.1999

158		1999	Obiliq			
-----	--	------	--------	--	--	--

Fig. 3/1. N.N. foshnjë, 1999. Nr. 158/1296. Protokollat i Neurokirurgjisë i datës 10.03.1999

Mimoza Shahini

TRAJTIMET E SPECIALIZUARA TË TË MBIJETUARVE TË MASAKRAVE DHE GJENOCIDIT NË KOSOVË

*Kur efektet e traumës nuk zgjidhen në një brez,
kur injorohet dhe nuk ka mbështetje në trajtimin e saj,
trauma do të kalojë nga një brez në tjetrin*
Prof. ass. Mimoza Shahini 2023

Abstrakt

Kosova e pasluftës është përballur me vështirësinë e organizimit të shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarit e masakrave. Natyrisht, mungesa e shërbimeve të specializuara e ka bërë edhe më të ndërlikuar vazhdimin e vuajtjeve psikologjike për të gjithë ata që kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve traumatike të lidhura me luftën, si vrasje, masakra, tortura, abuzime, humbje të pjesëve të trupit nga rënia në mina, dhuna seksuale, humbja e fëmijëve, zhdukja e familjarëve, si dhe shumë ngjarje që kanë lënë gjurmë në kujtesën dhe funksionimin e tyre në përgjithësi.

Intervenimi në të mbijetuarit e masakrave ka lidhje me eksplorimin e shumë ndjenjave si dehumanizim, humbje e shpresës, fuqia e se drejtës/padrejtësisë, përjetim ekstrem i traumës, drejtësia sociale, kuptimi që i jepet masakrave dhe të rënëve në ngjarje të tilla, faji i mbijetesës, kufiri midis jetës dhe vdekjes. Disa teori janë zhvilluar për t'u përballur me kompleksitetin e ndikimeve psikologjike të traumave që lidhen me ekspozimin ndaj luftës duke u munduar të ndërtojnë modele të reja të shpjegimit të reagimit ndaj traumës dhe ndërkohë të gjenden mënyra efektive të ballafaqimit me to. Këto modele marrin në konsideratë ndërveprimin kompleks të faktorëve psikosocialë të shumtë dhe reciprokë, të lidhur me politikën dhe ekologjike, të cilët njëkohësisht ndikojnë në fushat kryesore të jetës së të mbijetuarve.

Kjo na bën ne profesionistëve të hulumtojmë sa më shumë në krijimin e një sistemi i cili nuk mbështet vetëm tek individi, por të ofrojmë shërbime të cilat prezantojnë dimensionet e kohës dhe marrëdhëniet ndërvepruese midis një të mbijetuarit dhe mjedisit të tij/saj ekologjik, në diskutimin në lidhje me traumën duke qenë të vetëdijshëm se sekuencat traumatike mund të ndryshojnë në kontekste të ndryshme dhe në kohë të ndryshme përgjatë jetës.

Ajo që duhet që profesionistët e fushës së shëndetit mendor, por dhe organizatave humanitare gjatë marrjes me të mbijetuar, të mbështetemi në provat shkencore që janë në dispozicion. Ka prova të forta që ndërhyrjet psikosociale ofrojnë lehtësim të konsiderueshëm të simptomave të çrregullimit Posttraumatik, depresionin, ankthin, shqetësimet psikosomatike, mendimet vetëvrasëse, vetëmjekimin apo abuzimi me alkool. Trajtimet kognitive-sjellëse, këshillimit mbështetës, terapia e ekspozimit është studiuar në numrin

më të madh të provave dhe ka treguar vazhdimisht efekte të dobishme. Trajtimet e kombinuara të ekspozimit dhe terapisë njohëse tregojnë avantazhe të vogla por të qëndrueshme mbi secilën nga ndërhyrjet vetëm. Kuptimi i mekanizmave përkatës psikobiologjikë dhe mënyra se si ato shpalosen me kalimin e kohës është e rëndësishme për të kuptuar se si të identifikohet më mirë rreziku, të promovohet elasticiteti dhe të trajtohet aty ku është e nevojshme, si dhe si të përshtaten ndërhyrjet në mënyrë optimale.

Fjalët çelës: vuajtje, psikologjike, vrasje, masakra, tortura, abuzime, trajtim i specializuar.

Krimet si gjenocidi dhe masakrimi konsiderohen si aktet më të rënda kundër njerëzimit, pasi bazohen në besimin se aktet e lidhura me to prekin dinjitetin thelbësor të qenieve njerëzore. Dinjiteti njerëzor është vlera e qenësishme e çdo individi. Ajo thekson barazinë, autonominë, paprekshmërinë dhe respektin, duke udhëhequr qenien drejt mënyrës se si i trajtojmë të tjerët dhe veten në raport me ta. Tortura përshkruhet si “përdorim i dehumanizimit nga ana e pushtetit dhe është një instrument shtypjeje dhe dërmimi në nivelin personal apo kolektiv. Masakrat dhe torturat zakonisht ndodhin në një kontekst ku faktorët socialë dhe psikologjikë janë bashkuar për të lejuar dehumanizimin dhe etiketimin negativ të grupeve të synuara dhe ku bindja e individëve që kryejnë veprime të tilla bëhet arsye për të vepruar, zakonisht nën petkun e patriotizmit.

Ky kontekst tregon se si të mbijetuarit e masakrave dhe krimeve kanë ndjenja lënduese dërmuese dhe ndikime të qëndrueshme në mirëqenien e tyre. Mbështetja dhe ndjeshmëria ndaj tyre është thelbësore për mbijetesë dhe shërim.

Edhe 23 vjet pas luftës, Kosova ende ka vështirësi për të arritur tek e vërteta e asaj që përgjaku dhe poshtëroi mjedisin tonë ku një pjesë e popullatës akoma edhe sot lufton për të vendosur drejtësi për krimet e kryera gjatë luftës. Pas përfundimit të luftës, evidencat tregojnë që trauma masive shkakton një shkatërrim kaq të larmishëm dhe kompleks, saqë vetëm një kornizë shumëdimensionale, shumëdisiplinore, integruese mund ta përshkruajë atë në mënyrë të përshtatshme dhe të formësojë ndërhyrje efikase.

Identiteti i një individi ngërthen një ndërveprim kompleks të sferave ose sistemeve të shumta, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ato biologjike, intrapsikike, familjare, politike, ekonomike, kulturore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këto sisteme bashkëjetojnë në mënyrë dinamike përgjatë dimensionit kohor për të krijuar një konceptim të vazhdueshëm të jetës nga e kaluara në të tashmen e në të ardhmen. Kjo trajektore është edhe fokus i intervenimit psikiatrik dhe psikologjik duke u dhënë mundësi të mbijetuarve të krijojnë një kuptim të ri që u ndihmon të përballen me problemet që lidhen me traumën por jo vetëm.

Intervenimet e fokusuara në të mbijetuarit e torturave, dhunimeve dhe masakrave, plagë që qëndrojnë të hapura për shkak të ndjenjave, si faji, turpi, nënçmimi, si dhe mungesa e ndjenjës së dobishmërisë janë burimi më i fuqishëm i ndalimit të kalimit të traumës nga një gjeneratë në tjetrën.

1.0 Intervenimet menjëherë pas përfundimit të luftës

Menjëherë pas përfundimit të luftës ndihma profesionale ndaj viktimave u ofrua nga Departamenti i Neuropsikiatrisë në Prishtinë, në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nga profesionistë të cilët kishin më shumë qasje biologjike, pa protokolle të trajtimit të të mbijetuarve të masakrave apo dhunës fizike dhe seksuale gjatë luftës dhe nuk kishin infrastrukturën për të mbështetur ata që nuk kërkonin ndihmë jashtë institucioneve. Shërbimet e shëndetit mendor përfaqësoheshin nga 19 neuropsikiatërë dhe shumë pak psikologë dhe punonjës socialë. Ndërkohë shërbimet profesionale në terren mbuloheshin nga më shumë se 700 OJQ ndërkombëtare dhe kombëtare, shumë prej të cilave punësonin punëtorë profesionistë të shëndetit mendor me kompetenca, përkushtim dhe ndjeshmëri të niveleve të ndryshme (Minear, van Baarda dhe Sommers, 2000).

Ndërkohë intervenimet në krizë nuk janë shoqëruar nga protokollat për mjekët profesionistë për trajtimin, referimet dhe raportimin e të mbijetuarve të masakrave apo dhunimet. Kjo ka bërë që pjesa më e madhe e të mbijetuarve t'u drejtoheshin organizatave të cilat kishin më shumë orientim në mbështetje me materiale të cilat siguronin mbijetesën sesa ofronin mbështetje psikologjike apo psikiatrike dhe, mbi të gjitha, nuk ishin të koordinuara në nivel nacional. Ka disa dëshmi (Jones, Rrustemi, Shahini dhe Uka, 2003) që nganjëherë janë bërë dëme së bashku me një përmirësim të situatës, kjo për shkak se jetëgjatësia mesatare e një projekti ndërkombëtar në Kosovë ishte nga një deri në dy vjet, shpesh me ndryshimin e burimeve njerëzore në më pak se

gjashtë muaj. Kjo e ka bërë shumë të vështirë krijimin e besimit në mbështetjen që u ofrohej:

“Ishte e vështirë që të mendoja për veten, për atë që më kishte ndodhur, më duhej të vrapoja gjithë ditën nëpër organizata për të siguruar ushqim, veshmbathje për fëmijët. Shtëpinë ma kishin djegur e nuk kisha mundësi për ta ndërtuar, na premtonin se do të na e rindërtonin, por duhet të presim kur të na vij rendi” ky është rrëfimi i një ish-veterani të luftës në Kosovë 5 vjet pas përfundimit të luftës.

Faza e parë e ndërhyrjes ishte me shumë mangësi:

- Spitalet kishin mungesë të programeve dhe protokolleve të trajnimit për të gjithë personelin spitalor për të drejtat dhe nevojat e viktimave të krimit, si dhe respektimin e një kodi etik, i cili do t'i bënte të mbijetuarit të ndiheshin të pastigmatizuar.

- Pamundësi të përfshirjes së familjes dhe komunitetit për të drejtat e të mbijetuarve.

- Intervistat e përsëritura të viktimave nga profesionistë të ndryshëm.

- Mungesë e trajtimeve të specializuara për të mbijetuarit e dhunës nga stafi i shëndetit mendor.

- Mungesë e respektimit të konfidencialitetit dhe privatësisë së të gjitha viktimave, veçanërisht në rastet e dhunës seksuale.

Në një mjedis të tillë të mbijetuarit e masakrave kanë kaluar në një sërë fazash në procesin e tyre të rimëkëmbjes dhe shërimit edhe pse ato nuk janë rigjide në shpërndarje për disa të mbijetuar, përvojat unike dhe traumatike të masakrave mund të rezultojnë në faza të ndryshme të rikuperimit. Këtu janë disa faza të mundshme të cilat janë fokus i ndërhyrjeve terapeutike:

Trauma dhe dhimbja e thellë- të mbijetuarit e masakrave kishin përjetuar një shkallë të pashembullt të dhimbjes dhe humbjes. Kjo i bënte ata të kishin nivele të larta të ankthit, depresionit dhe simptoma të PTSD-së. Të mbijetuarit e krimeve në luftë shpesh kanë ndjenja të frikës dhe pasigurisë. Ata mund të jenë të frikësuar për sigurinë e tyre dhe të familjes së tyre, dhe kjo ndjenjë e frikës mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të besuar në të tjerët dhe për të ndarë me ta emocionet dhe ndjenjat e tyre.

Vizioni negativ - i vetes te të mbijetuarit e torturave shpjegohet nga trauma dhe dhimbja që ata kanë përjetuar gjatë torturës. Në shumë raste, tortura mund të shkaktojë një ndjenjë të ndrydhjes dhe

inferioritetit të të mbijetuarit dhe ata mund të ndihen se nuk janë më vlerë si njerëz ose nuk kanë më ndonjë kuptim në jetë. Kjo mund të ndodhë për shkak të ndjenjës së humbjes së kontrollit dhe autonomisë së tyre gjatë torturës, duke i bërë ata të ndjehen të dobët dhe të pavlefshëm.

Mënyra e mbijetesës - gjatë masakrave, shumë të mbijetuar u detyruan të përqendroheshin në nevojat e tyre themelore për mbijetesë, si gjetja e ushqimit, ujit, strehimit dhe sigurisë. Kjo mendësi mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të luftës, pasi të mbijetuarit përpiqen të mbijetojnë dhe të përshtaten me një realitet të ri dhe të rindërtojnë jetën e tyre.

Tronditja dhe mosbesimi - pasi kishin përjetuar trauma dhe humbje të mëdha, të mbijetuarit ishin në përpjekje të pajtoheshin me atë që kishte ndodhur. Shumë prej tyre kishin vështirësi të besonin se ia kishin dalë të kalonin një ngjarje të tmerrshme dhe nuk mund të luftonin me fajin e të mbijetuarit. Problemet e komunikimit me të mbijetuarit e krimeve të luftës ishin ndjenjat e frikës dhe të mosbesimit, probleme në komunikimin me të tjerët, ndjesia e ndarjes nga shoqëria, probleme në marrjen e vendimeve dhe ndjenjat e izolimit dhe e vetmisë. Shumë prej tyre iu vinte keq të flisnin për ato që kishin përjetuar, që të mos shpërndanin ndjenjat e frikës dhe të mosbesimit të tyre te të tjerët.

Mpirja emocionale - disa të mbijetuar kishin përjetime të mpirjes emocionale ose shpëputje nga ajo që u kishte ndodhur duke e përdorur si një mekanizëm përballues. Kjo e bënte të pamundur shprehjen e emocioneve të tyre dhe në mënyrë të veçantë të kishin vështirësi në lidhjen me të tjerët. Ishte e evidente në takimet grupore apo individuale që të mbijetuarit ishin të ndarë në mes botës emocionale dhe njohëse, mekanizëm ky që të mbijetuarit i ndihmon për të fituar kohë për t'i dhënë kuptim dehumanizimit të përjetuar.

Kërkimi për drejtësi - shumë prej të mbijetuarve të masakrave dëshirojnë që kriminelët të ndëshkohen dhe të dënohen për veprat e tyre. Kjo ishte dhe vazhdon të jetë një pasojë e ndjenjave të pakompromis për drejtësi e cila kombinohet me ndjenjën e thellë të fajit që kanë mbijetuar dhe njëkohësisht ndjenjat e izolimit dhe mosmbështetjes nga institucionet.

Riintegrimi - shumë të mbijetuar të masakrave duhej të linin shtëpitë, familjet dhe komunitetet e tyre. Ndërsa rindërtonin jetën e tyre, ata luftonin për t'u riintegruar në shoqëri dhe për të gjetur një ndjenjë përkatësie ndërkohë që disa prej tyre përballëshin me diskriminimin ose paragjykimin bazuar në përvojat e tyre si të mbijetuar të masakrave.

Menjëherë pas përfundimit të luftës shumë prej tyre për shkak të frikës së paragjyqimeve nuk kërkuan ndihmë as në organizatat e huaja si viktimat, por përdorën kërkesën e ndihmës për mbijetesën dhe një fenomen që ka ndodhur po pas luftës, disa prej viktimave i drejtoheshin shërbimeve profesionale përmes një anëtari tjetër të familjes, në veçanti duke sjellë fëmijët e tyre, duke qenë se kjo ishte më pak stigmatizuese.

Qëndrueshmëria dhe rritja - pavarësisht sfidave dhe pengesave të shumta, shumë të mbijetuar të masakrave kanë treguar qëndrueshmëri dhe forcë të jashtëzakonshme. Ata kanë gjetur mënyra për t'u lidhur me të tjerët që kanë ndarë përvojat e tyre, dhe të gjenin kuptimin e mbijetesës së tyre dhe të krijojnë një ndjenjë të re qëllimi dhe identiteti.

Kjo fazë është gjithashtu e fokusuar në trajtimin e çrregullimeve, si stresi pas traumës, depresioni, ankthi, çrregullimet e gjumit, si dhe çrregullime të tjera psikiatrike. Qasja në këtë fazë ka qenë më shumë e fokusuar, në debriefing/ zbrazjen, si dhe mbështetje psikosociale të ofruar nga organizatat në terren.

Trajtimi farmakologjik ka qenë mjaft i shprehur në atë fazë. Vlen të theksohet se në këtë fazë pothuajse të gjithë personat që kanë kërkuar ndihmë kanë pasur kërkesë për përdorim të medikamenteve dhe njëkohësisht kemi mjaft raporte të vetëmjekimit me benzodiazepina.

2.0. Faza e dytë

Në një kontekst të tillë ku shumë nga të mbijetuarit nuk kishin mundësi të merrnin shërbimet e duhura, disa iniciativa qenë nga organizatat ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve vendore për trajtime të specializuara rreth përpunimit të traumës për viktimat e masakrave dhe të mbijetuarve të torturave.

Për shkak se traumat e luftës dhe torturave janë shumë të ndryshme nga trauma e zakonshme, ato kërkojnë një trajtim të specializuar dhe të ndjeshëm ndaj kulturës dhe kontekstit në të cilin ndodhen të mbijetuarit, duke krijuar konfuzion te profesionistët të cilët trajnoheshin me teknika të cilat nuk ishin të aplikueshme për mjedisin tonë duke favorizuar në disa raste edhe traumatizim sekondar, për shkak të mungesës së kompetencës së profesionistëve.

Studimet kanë treguar se efektet e luftërave në shëndetin mendor, shëndetin fizik, sigurinë ekonomike dhe stabilitetin politik janë afatgjata. Për këtë arsye ishte e qartë se shërbimet dhe trajtimet duhet të kenë një qasje holistike dhe të adresojnë të gjitha aspektet e shëndetit

mendor dhe emocional të personit, duke përfshirë edhe nevojat e tyre të shëndetit fizik dhe ndihmën sociale. Specialistët u ballafaquan me sfida për t'i aplikuar ato teknika. Problemet të cilat filluan të ishin prezente te të mbijetuarit e masakrave dhe torturave ishin të shumëllojshme, si çrregullimi i stresit posttraumatik, ankthi, depresioni, abuzimi i alkoolit dhe substancave, rritja e shkallës së vetëvrasjeve etj.

PTSD (çrregullimi i stresit post-traumatik):

Çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD) mund të ndodhë te njerëzit që kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitar të një ngjarjeje traumatike, një seri ngjarjesh ose një sërë rrethanash. Një individ mund ta përjetojë këtë si emocionalisht ose fizikisht të dëmshme ose kërcënuese për jetën dhe mund të ndikojë në mirëqenien mendore, fizike, sociale dhe/ose shpirtërore. Manifestimet e sindromës së stresit post-traumatik mund të ndryshojnë sipas kulturës dhe gjuhës së personit që ka përjetuar ngjarjen traumatike. Shumë studime sugjerojnë se ashpërsia dhe lloji i simptomave të paraqitura mund të pasqyrojnë mënyrën se si masakra apo tortura është perceptuar nga i mbijetuari, natyra e faktorëve stresues pas atyre eksperiencave, si dhe shkalla e mbështetjes sociale të marrë nga i mbijetuari. Në Kosovë pas luftës ka pasur disa organizata të cilat kanë ofruar qasje të mbështetjes familjare, seancat e të cilave janë mbështetur në edukimin psikosocial të klientëve, si dhe fuqizimin e rrethit familjar për të mbështetur viktimat.

2. Ankthi dhe depresioni - këto dy çrregullime janë raportuar me numër të rritur në popullatën civile pas luftës. Hulumtimet e kryera në kontekstin e Kosovës tregojnë se prevalenca e ankthit dhe depresionit sillet nga 33.6% në 47.6% o (Kamberi et al., 2019; Arenliu et al., 2016; Priebe et al., 2010). Të mbijetuarit e torturës mund të vuajnë nga ankthi dhe depresioni si rezultat i traumave të rënda që kanë përjetuar, si dhe kontekstit familjar, social dhe ekonomik që e formësojnë jetën e tyre. Kjo është konfirmuar edhe nga Kashdan, Todd B., Nexhmedin Morina dhe Stefan Priebe (2009) të cilët gjetën se çrregullimet psikiatrike u shoqëruan me shmangie më të madhe eksperimentale dhe shqetësim psikologjik dhe cilësi më të ulët të jetës.

5. Probleme shëndetësore fizike - të mbijetuarit e torturës mund të vuajnë edhe nga probleme shëndetësore fizike, si plagët dhe lëndimet e marra gjatë torturave, sëmundjet infektive si pasojë e kushteve higjienike dhe mungesës së ujit dhe ushqimit. Një gjetje interesante në kontekstin e Kosovës në një studim të realizuar me veteranët e luftës 8 vjet pas përfundimit të luftës, ku shumë pjesëmarrës raportuan se kishin probleme emocionale dhe më shumë se një problem shëndetësor dhe se

nuk kishin kërkuar ndihmë mjekësore. Studimi ka sugjeruar se kjo mund të vinte pikërisht nga vështirësitë në qasjen në shërbimet mjekësore në Kosovë, pasi nuk kishte institucione të specializuara për të punuar me veteranët dhe niveli relativisht i lartë i stigmës. Ndërkohë, që është raportuar nivel i lartë i përdorimit të medikamenteve pa përshkrim të mjekut, për të qetësuar dhimbjet e ndryshme.

Këto rezultate kanë qenë në përputhje me studimet e tjera (Schell & Marshall, 2008), të cilat zbuluan se barrierat ndaj kujdesit përfshinin, në mënyrë të përafërt, shqetësimet rreth konfidencialitetit dhe diskriminimit, preferencat për t'u mbështetur te familja dhe miqtë, shqetësimet për efektivitetin ose efektet anësore të trajtimeve.

6. Abuzimi i alkoolit dhe substancave - disa të mbijetuar iu drejtuan alkoolit për të vetëmjekuar dhe përkohësisht ikin nga emocionet shqetësuese, kujtimet traumatike ose simptomat e kushteve të shëndetit mendor, si ankthi ose depresioni. Gjithashtu, mbështetja tek alkooli mund të sigurojë një ndjenjë afatshkurtër relaksimi dhe lehtësimi të stresit apo mund të sigurojë një arratisje të përkohshme nga sfidat ose përgjegjësitë e jetës, duke ofruar një ndjenjë lirie dhe lehtësimi. Është e rëndësishme të theksohet se ndërsa alkooli mund të ofrojë lehtësim të përkohshëm, ai nuk është një strategji e shëndetshme ose efektive e përballimit afatgjatë, pasi mund të çojë në një sërë pasojash negative, duke përfshirë varësinë, gjykimin e dëmtuar, çështjet shëndetësore dhe përkeqësimin e problemeve të shëndetit mendor ose mpirjen nga dhimbja e traumës së tyre.

7. Çështjet e marrëdhënieve - të mbijetuarit kishin vështirësi t'u besonin të tjerëve ose të krijonin marrëdhënie të ngushta për shkak të përvojave të tyre. Ata gjithashtu luftonin me ndjenjat e izolimit ose vetmisë. E kishin të vështirë të besonin të tjerët apo të krijonin lidhje përmbajtësore me të tjerët.

8. Humbja, vdekja **dhe zhdukja e fëmijëve** - në kohën e luftës në mungesë të tyre nuk ishte më një moment traumatik, por krijimi i një perspektive traumatike e cila ndikon në formësimin e besimeve familjare, këndvështrimin për domosdoshmërinë dhe mbikëqyrjen prindërore dhe formësimin jetësor të prindërve në kërkim të përmbushjes së hapësirës boshe që kishte krijuar humbja e fëmijëve.

Humbja e fëmijëve në shumë familje kishte krijuar te prindërit një nevojë për të përmbushur ekzistencën përmes ripërtëritjes së emrit, lindjeve të reja me qëllim të kompensimit, por që, në të vërtetë, shpesh krijonte një burim stresi të vazhdueshëm.

9. Suicidi dhe vetëvrasja - ekziston një debat i konsiderueshëm për arsyen e rritjes së rrezikut të vetëvrasjes te të mbijetuarit e traumës. Ndërsa disa studime sugjerojnë se rreziku i vetëvrasjes është më i lartë në mesin e atyre që përjetuan trauma për shkak të simptomave të PTSD-së (Ferrada-Noli, at all (1998); Amir, at all 1999), të tjerë pretendojnë se rreziku i vetëvrasjes është më i lartë te këta individë për shkak të kushteve psikiatrike të lidhura (Fontana, A., & Rosenheck, & Rosenheck 2004; Robison, B. K. 2002).

Shumë nga klientët edhe pse kishin kaluar më shumë se 8 vjet pas përfundimit të luftës, vazhdonin të përdornin ndarjen në mes të të menduarit dhe emocioneve dhe bënin një përzgjedhje në mes tyre, duke u përqendruar vetëm në mendime me të cilat 'shkëputeshin' nga bota përreth, duke shmangur diçka që ua kujtonte traumën e tyre, edhe nëse ai objekt ose aktivitet nuk ishte i rrezikshëm ose kërcënues në vetvete. Ky mekanizëm ka qenë sfida më e rëndësishme në aspektin e trajtimit të viktimave, dhe që në fakt i krijonin vazhdimësi efekteve të traumës së përjetuar. Edhe sot mbas 23 vjetëve, profesionistët e shëndetit mendor vazhdojnë të punojnë me klientë që nuk e kanë përpunuar traumën.

3.0 Zhvillimi i intervenimeve të specializuara për t'iu përgjigjur kësaj sfide

Terapia familjare - ndihmon të mbijetuarit e masakrave në përmirësimin e marrëdhënieve familjare dhe ndihmon në trajtimin e traumës së tyre nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit. Kjo lloj terapie përfshin të gjithë anëtarët e familjes dhe ndihmon në kuptimin e rolit që secili person luan në funksionimin e familjes. Terapia familjare ndihmon të mbijetuarit të mësojnë mënyra të reja për të komunikuar dhe për të zgjidhur konfliktet në një mënyrë të shëndetshme. Kjo terapi mund të ndihmojë në lehtësimin e simptomave të PTSD-së dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së të mbijetuarve të masakrave.

Trajtimi farmakologjik - ilaçet psikiatrike mund të ndihmojnë në trajtimin e simptomave të ankthit, depresionit dhe PTSD-së te të mbijetuarit e torturës. Këto barna mund të jenë të ndryshme, si për llojin e simptomave të trajtuara, ashtu edhe për dozat dhe efektet anësore.

Terapia kognitive-përbaluese (CBT) - është një lloj psikoterapie që fokusohet në lidhjen midis mendimeve, sjelljeve dhe emocioneve. Synon të ndihmojë individë që të identifikojnë dhe ndryshojnë mendimet dhe sjelljet negative ose të padobishme, duke çuar në

përmirësimin e rregullimit emocional dhe shëndetit mendor. Kjo qasje përmirëson aftësitë e tyre të komunikimit, të menaxhimit të konflikteve dhe të zhvillimit të marrëdhënieve më të shëndetshme.

Terapia në grup - terapia grupore është një teknikë efektive e trajtimit që mund të ndihmojë në zbutjen e efekteve të traumave psikologjike. Kjo lloj terapie përfshin një grup të vogël njerëzish që kanë përjetuar traumën, të cilët punojnë së bashku me një terapist për të adresuar simptomat dhe ndjenjat e tyre.

Një prej përfitimeve të terapisë grupore është se pjesëmarrësit ndihen të lidhur dhe të kuptuar nga të tjerët që kanë përjetuar eksperiencën e njëjtë. Kjo mund të ndihmojë në zbutjen e ndjenjës së izolimit dhe në rritjen e besimit dhe ndjenjës së bashkëpunimit. Pjesëmarrësit mund të ndihen të ndihmuar dhe të inkurajuar nga të tjerët të cilët po përpiqen të përballen me të njëjtin problem.

Terapia e artit - terapia e artit mund të ndihmojë të mbijetuarit e dhunës seksuale të shprehin ndjenjat e tyre dhe të lehtësojë tensionin dhe ankthin.

Trauma terapia - është një formë e ndihmës shpirtërore dhe emocionale që mund të ndihmojë të mbijetuarit e masakrave për të trajtuar dhimbjen dhe ankthin e tyre dhe për të ndërtuar një jetë të re të plotësuar me shpresë dhe qëllime. Kjo mund të bëhet nëpërmjet seancave të terapisë individuale ose në grupe dhe përfshin trajtimin e simptomave të ankthit, depresionit, gjumit dhe flashbacks, si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të ndjehet në kontroll të jetës.

Trauma terapia mund të jetë një proces i vështirë dhe i ngarkuar, por me ndihmën e një terapeuti të specializuar në këtë fushë, të mbijetuarit e masakrave mund të ndryshojnë mënyrën e tyre të menduarit dhe të reagojnë ndaj ngjarjeve traumësore. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i trajtimit të traumës është që të mbijetuarit të kenë një ndjenjë të sigurisë dhe besimit në mjedisin ku jetojnë, si dhe që të kenë mundësi të lidhen me komunitetin dhe me burime të tjera të ndihmës dhe mbështetjes.

4.0 Qëndrimet e shoqërisë formësojnë efikasitetin e qasjes multidisiplinare

Qëndrimet e shoqërisë ndaj mbijetuesve të masakrave të luftës mund të ndryshojnë gjerësisht në varësi të kontekstit kulturor, politik

dhe historik. Në përgjithësi, është e rëndësishme që shoqëria të tregojë empati dhe respekt ndaj të mbijetuarve të masakrave të luftës dhe të ofrojë ndihmë dhe mbështetje. Kjo mbështetje mund të përfshijë trajtime dhe shërbime psikologjike të specializuara të ofruara mbështetur mbi evidencë shkencore, krijimi i një strategjie kombëtare për trajtimin e të traumatizuarve të luftës, krijimi i programeve mbështetëse në aspektet sociale dhe ekonomike dhe, mbi të gjitha, respektim të të drejtave të tyre dhe njohje të vuajtjeve të tyre pa u keqpërdorur politikisht.

Përballja me të kaluarën dhe kapërcimi i vuajtjeve psikologjike në një mënyrë të qëndrueshme është e mundur vetëm mbi bazën e të vërtetës dhe duke e shkundur paradigmen sipas së cilës vetëm një komunitet i caktuar është ndikuar nga krimet e ndodhura gjatë luftës.

E vërteta është pjesë e procesit të shërimit; ajo ndihmon në kthimin e dinjitetit personal, ndryshon perceptimin shoqëror, jep trajtim të barabartë për të gjithë dhe lufton pandëshkueshmërinë dhe mohimin publik.

Ja disa shembuj se si shoqëria ka reaguar ndaj mbijetuesve të masakrave të luftës në kontekste të ndryshme:

1. Bosnja dhe Hercegovina: pas Luftës së Bosnjës në vitet 1990, shumë mbijetues të masakrave të luftës u përballën me diskriminim dhe marginalizim nga shoqëria. Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY) u themelua për të ndjekur në drejtësi ata që ishin përgjegjës për krime lufte, por shumë boshnjakë ndjenin se drejtësia nuk po bëhej. Në vitet e fundit, ka pasur një lëvizje rritëse për të njohur dhe mbështetur nevojat e mbijetuesve të masakrave të luftës, duke përfshirë përpjekjet për të dokumentuar dhe komemoruar atrocitetet që ndodhën.

2. Ruanda - pas gjenocidit në vitin 1994, qeveria dhe shoqëria civile ruandeze kanë bërë përpjekje të rëndësishme për të mbështetur mbijetuesit e masakrave të luftës. Kjo përfshin ofrimin e këshillimit dhe shërbimeve të shëndetit mendor, si dhe themelimin e një programi kombëtar për riparim. Megjithatë, disa mbijetues vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe stigmatizim në komunitetet e tyre.

3. Kamboxhia - mbijetuesit e regjimit Khmer Rouge në vitet 1970 fillimisht u përballën me stigmë dhe heshtje të rëndë nga shoqëria kamboxhiane. Megjithatë, në vitet e fundit, ka pasur njohje dhe mbështetje më të madhe për mbijetuesit e masakrave të luftës, duke përfshirë themelimin e një gjykate Khmer Rouge për të ndjekur në drejtësi

ata që ishin përgjegjës për atrocitetet. Megjithatë, shumë mbijetues vazhdojnë të luftojnë me varfërinë dhe mungesën e qasjes në shërbime bazike. Në përgjithësi, përgjigjja e shoqërisë ndaj mbijetuesve të masakrave të luftës është komplekse dhe mund të ndryshojë gjerësisht në varësi të kontekstit.

Ka një numër në rritje të provave që mbështesin përdorimin e një qasjeje multidisiplinare në trajtimin e të mbijetuarve të masakrave të luftës. Një qasje e tillë përfshin një ekip profesionistësh nga fusha të ndryshme, duke përfshirë psikologjinë, psikiatrinë, punën sociale dhe mjekësinë, duke punuar së bashku për të ofruar kujdes të plotë për të mbijetuarit. Një studim i kryer në Bosnjë dhe Hercegovinë zbuloi se një qasje multidisiplinare për trajtimin e të mbijetuarve të traumave të lidhura me luftën çoi në përmirësime të rëndësishme në rezultatet e shëndetit mendor, duke përfshirë reduktimin e simptomave të depressionit, ankthit dhe PTSD-së (Priebe et al., 2010). Një studim tjetër i kryer në Kroaci zbuloi se një qasje ekipore multidisiplinare, e cila përfshinte ndërhyrje farmakologjike dhe psikologjike, ishte efektive në reduktimin e simptomave të PTSD-së te të mbijetuarit e traumave të luftës (Kraljevic et al., 2012).

Për më tepër, një rishikim i literaturës për trajtimin e të mbijetuarve të traumave të luftës zbuloi se një qasje multidisiplinare është më efektive sesa ndërhyrjet me një modalitet, të tilla si vetëm mjekimi ose psikoterapia (Mollica et al., 2007). Autorët e rishikimit vunë në dukje se një qasje shumëdisiplinore lejon përshtatjen e trajtimit me nevojat specifike të të mbijetuarit individual, gjë që është thelbësore për kujdesin efektiv.

5.0 Pse duhet qasje multidisiplinare?

Në përgjithësi, provat sugjerojnë se një qasje multidisiplinare për trajtimin e të mbijetuarve të masakrave të luftës është efektive dhe e nevojshme për ofrimin e kujdesit gjithëpërfshirës që adreson nevojat komplekse dhe të ndryshme të të mbijetuarve.

Sfida kryesore me të cilën institucionet e shëndetit mendor duhet të fokusohen janë trajtimi i specializuar i të mbijetuarve të krimeve të luftës për shkak të ndërprerjes së transmetimit të traumave nga një gjeneratë në tjetrën.

Trauma ndër breza mund të përkufizohet si "përjetimi dhe kujtimi subjektiv i ngjarjeve në mendjen e një individi ose në jetën e një

komuniteti, të kaluar nga të rriturit tek fëmijët në procese ciklike" (Atkinson, Nelson dhe Atkinson 2010).

Trauma masive shkakton një shkatërrim kaq të larmishëm dhe kompleks sa që vetëm një kornizë shumëdimensionale mund ta përshkruajë atë në mënyrë adekuate. Kellerman (2015) kur shpjegon traumën transgjenerative, bën dallimin midis procesit të transmetimit, duke iu referuar mënyrës se si trauma transmetohet nëpër breza dhe përmbajtjes së transmetimit.

Ky transferim mund të ndodhë përmes mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë:

1. **Ndryshimet epigjenetike** - trauma mund të shkaktojë ndryshime në shprehjen e gjeneve, të cilat mund t'u kalojnë pasardhësve. Këto ndryshime mund të ndikojnë në rregullimin e hormoneve të stresit, duke çuar në një rritje të ndjeshmërisë ndaj ankthit, depresionit dhe çrregullimeve të tjera të shëndetit mendor.

2. **Sjellja e prindërve** - të mbijetuarit që kanë përvoja traumatike mund të ndryshojnë ndjenjën e vetes dhe ndjenjën e besimit të tjerët. Kjo perspektivë e re për botën e formëson negativisht stilin e tyre prindëror si autoritarian, neglizhues apo liberal. Stili prindëror ndikon në stilin e lidhjes midis prindit dhe pasardhësve. Stili i komunikimit familjar mund të ndikohet nga përvojat traumatike dhe mund të shprehët drejtpërdrejt apo tërthorazi tek anëtarët e tjerë të familjes. Kjo situatë ndikon në atmosferën e dialogut familjar. Në hulumtimet e mëparshme (Danieli, Norris, Lindert, Paisner, Engdahl, et al., 2015), identifikuan dallime të qarta midis:

stilit të viktimës (që karakterizohet me mbërthim në rapturën që ka shkaktuar eksperiencën traumatike, paqëndrueshmëri emocionale dhe mbimbrotje),

stilit të mpirë (shkëputje emocionale, konspiracion dhe heshtje brenda familjes dhe intolerancë ndaj dobësisë), dhe

stilit të luftëtarit (vlerësimi dhe ruajtja e identitetit dhe vlerësimi i mjeshtërisë dhe drejtësisë).

3. **Socializimi** - individët e traumatizuar mund t'ua përcjellin përvojat e tyre fëmijëve të tyre nëpërmjet socializimit. Kjo mund të ndodhë përmes transmetimit të besimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve kulturore që përjetësojnë efektet e traumës.

4. *Faktorët psikologjikë* - individët e traumatizuar mund të përjetojnë vështirësi në rregullimin e emocioneve dhe sjelljes së tyre, të cilat mund të ndikojnë në stilin e tyre të prindërimit dhe të ndikojnë në zhvillimin emocional të fëmijëve të tyre.

Të mbijetuarit me të cilët kemi punuar në Kosovë janë detyruar të kultivojnë ndjenjën stoike të heroizmit dhe të përkushtimit ndaj atdheut, por shumë prej tyre nuk kanë qenë në gjendje të përcjellin atë që realisht ndjejnë në lidhje me realitetin: qëllimin për të mbrojtur familjen e tyre dhe në veçanti fëmijët e tyre. Shumë prej tyre mbetën pa mbështetje institucionale. Ata siguruan mbijetesën e familjes së tyre me shumë vështirësi. Ne supozuam se ata zhvilluan një gjuhë të pashprehur që i mbronte nga presioni shoqëror, por në të njëjtën kohë i ndihmoi të bënin një dallim midis realitetit dhe botës së tyre të brendshme” (Shahini M, Ahmetaj A, Charles, 2016).

Konkluzione

Është thelbësore të theksohet se çdo individ është unik dhe ajo që funksionon më mirë për një të mbijetuar, mund të mos jetë aq efektive për një tjetër. Zgjedhja e trajtimit duhet t'u përshtatet nevojave, preferencave dhe rrethanave specifike të secilit person që ka mbijetuar. Për më tepër, një kombinim i qasjeve të ndryshme mund të jetë më i dobishëm për disa individë, pasi adreson kompleksin e eksperiencës traumatike dhe lidhshmërinë me mjedisin ku jeton dhe zhvillon veprimtarinë e tij/saj. Për rezultate më të mira, është thelbësore që trajtimi i të mbijetuarve të ofrohet nga profesionistë të kualifikuar të shëndetit mendor me përvojë në terapinë e traumës dhe praktikat e bazuara në dëshmi. Procesi i trajtimit duhet të jetë bashkëpunues dhe i bazuar në një aleancë të fortë terapeutike midis të mbijetuarit dhe ofruesit të tij të shëndetit mendor. Vlerësimi dhe monitorimi i rregullt i progresit janë gjithashtu të rëndësishëm për të siguruar efektivitetin e metodës së zgjedhur të trajtimit. Vëmendja ndaj faktorëve të rrezikut dhe ndërhyrja e hershme do të jetë e nevojshme për të parandaluar sëmundje të ngjashme psikologjike afatgjate.

Në arritjen e një përfshirjeje sa më të gjerë të komponentëve integruar, është e domosdoshme që të kemi një strategji nacionale për trajtimin e të gjitha viktimave të luftës.

Bibliographia

- [1] Minear, Larry, Ted Van Baarda, and Marc Sommers. *NATO and humanitarian action in the Kosovo crisis*. Thomas J. Watson Jr. Institute for International Studies, 2000
- [2] Jones, Lynne, Alban Rrustemi, Mimoza Shahini, and Aferdita Uka. "Mental health services for war-affected children: report of a survey in Kosovo." *The British Journal of Psychiatry* 183, no. 6 (2003): 540-546
- [3] Kamberi, Haxhi, Naim Jerliu, Vanesa Sefa, and Genc Burazeri. "Depression, anxiety and socio-demographic factors among hospitalized patients in Gjakova region, Kosovo." *Journal of Science, Humanities and Arts-JOSHA* 6, no. 4 (2019).
- [4] Arenliu, Aliriza, Kaltrina Kelmendi, and Dashamir Berxulli. "Gender differences in depression symptoms: Findings from a population survey in Kosovo—A country in transition." *Psychological Thought* 9, no. 2 (2016).
- [5] Priebe, Stefan, Marija Bogic, Dean Ajdukovic, Tanja Franciskovic, Gian Maria Galeazzi, Abdulah Kucukalic, Dusica Lecic-Tosevski et al. "Mental disorders following war in the Balkans: a study in 5 countries." *Archives of general psychiatry* 67, no. 5 (2010): 518-528
- [6] Kashdan, Todd B., Nexhmedin Morina, and Stefan Priebe. "Post-traumatic stress disorder, social anxiety disorder, and depression in survivors of the Kosovo War: Experiential avoidance as a contributor to distress and quality of life." *Journal of anxiety disorders* 23, no. 2 (2009): 185-196
- [7] Schell, Terry L., and Grant N. Marshall. "Survey of individuals previously deployed for OEF/OIF." *Invisible wounds of war: Psychological and cognitive injuries, their consequences, and services to assist recovery* (2008): 87-115.
- [8] Ferrada-Noli, Marcello, Marie Asberg, Kari Ormstad, Tom Lundin, and Elisabet Sundbom. "Suicidal behavior after severe trauma. Part 1: PTSD diagnoses, psychiatric comorbidity, and assessments of suicidal behavior." *Journal of Traumatic Stress: Official Publication of The International Society for Traumatic Stress Studies* 11, no. 1 (1998): 103-112.
- [9] Amir, Marianne, and Rachel Lev-Wiesel. "Time does not heal all wounds: Quality of life and psychological distress of people who survived the Holocaust as children 55 years later." *Journal of Traumatic Stress: Official Publication of the International Society for Traumatic Stress Studies* 16, no. 3 (2003): 295-299.
- [10] Fontana, Alan, and Robert Rosenheck. "Trauma, change in strength of religious faith, and mental health service use among veterans treated for

- PTSD." *The Journal of nervous and mental disease* 192, no. 9 (2004): 579-584.
- [11] Robison, Bryan Keith. *Suicide risk in Vietnam veterans with posttraumatic stress disorder*. Pepperdine University, 2002.
- [12] Mollica, Richard F., Kathleen Rey Caridad, and Michael P. Massagli. "Longitudinal study of posttraumatic stress disorder, depression, and changes in traumatic memories over time in Bosnian refugees." *The Journal of nervous and mental disease* 195, no. 7 (2007): 572-579.
- [13] Atkinson, Judy, Jeff Nelson, and Caroline Atkinson. "Trauma, transgenerational transfer and effects on community wellbeing." *Working together: Aboriginal and Torres Strait Islander mental health and wellbeing principles and practice* (2010): 135-144.
- [14] Kellermann, Natan PF. "Epigenetic transgenerational transmission of Holocaust trauma: A Review." *Retrieved October 8* (2015): 2016.
- [15] Danieli, Yael, Fran H. Norris, Jutta Lindert, Vera Paisner, Brian Engdahl, and Julia Richter. "The Danieli Inventory of Multigenerational Legacies of Trauma, Part I: Survivors' posttrauma adaptational styles in their children's eyes." *Journal of psychiatric research* 68 (2015): 167-175.
- [16] Shahini, Mimoza, Adelina Ahmeti, and Laurie L. Charlés. "Family Therapy in Postwar Kosova: Reforming Cultural Values in New Family Dynamics." *Family Therapy in Global Humanitarian Contexts: Voices and Issues from the Field* (2016): 65-76.

Muhamedin Kullashi

NDRIÇIMI DHE MOHIMI I KRIMEVE NË KOSOVË
NGA DISA RRYMA POLITIKE E INTELEKTUALE
FRANCEZE NË VITET 1998-99

Abstrakt

Në kumtesën tonë kemi theksuar se intervenimi i NATO-s në Kosovë, gjatë muajve mars-qershor 1999, provokoi debate të ashpra në opinionin publik evropian dhe veçanërisht në atë të Francës. Këto debate e polemika u fokusuan rreth legjitimitetit dhe legalitetit të intervenimit, pastaj rreth shkaqeve dhe rrjedhimeve të shkaktuara, si edhe për peshën politike dhe etike të këtij aksioni sa për Ballkanin po aq edhe për Evropën. Polemikata e ngarkuara me tensione e pasione bën që të vijëzohen linja të reja të fronteve: e djathta republikane e sovraniste u bashkua me të majtën komuniste, e majta ekstreme (*Ligue communiste révolutionnaire* dhe *Lutte ouvrière*) u bë bashkë me të djathtën ekstreme kundër gjithë atyre që mbështetnin intervenimin.

Në këtë kontekst kemi synuar, veç të tjerave, të shkoqisim dhe zbërthejmë fenomenin e revizionizmit, si rrymë që mohonte realitetin e krimeve në Kosovë, të kryera nga regjimi serb. Jemi orvatur të kuptojmë këtë formë të re të revizionizmit që lindi në rrethana të luftës së Kosovës dhe *polarizimeve politike* në rrafshin ndërkombëtar lidhur me legjitimitetin e intervenimit. Interpretimet e ndryshme, shpesh diametralisht të kundërta, mund të ndihmojnë të kuptohen qëndrimet, që janë zhvilluar në Francë, ndaj intervenimit të NATO-s në Kosovë.

Në fakt, sa editorialistët e mëdhenj (të *Le Monde* dhe *Libération*, bie fjala) po aq edhe disa liderë të qeverive perëndimore kanë mbështetur vendimin për intervenim duke u nisur nga një analizë e politikës së regjimit serb në dhjetëvjetëshin e fundit. Kësodore, Presidenti i Francës Jacques Chirac, në fjalimet e veta ka ofruar sqarime të qarta dhe koherente sa i takon vazhdimësisë së politikës së spastrimit etnik (të cilën e quajti « barbari e organizuar ») dhe rreziqet që ajo i përmban jo vetëm për stabilitetin dhe paqen në Ballkan, por edhe për ato të Evropës. Në anën tjetër, nuk ishin të pakta rrymat politike e intelektuale që mohonin apo i justifikonin krimet e bëra ndaj shqiptarëve e Kosovës në atë periudhë kohore.

Fjalët çelës: mohimi i krimeve, intervenimi i NATO-s, polarizimet politike, revizionizmi

Krimi i paralajmëruar në Kosovë

Më 30 mars 1998 botuam bashkë me sociologen dhe antropologen e shquar parisienne, Véronique Nahoum-Grappe, në të përditshmen prestigjioze *Libération*, artikullin me titull *Kosova: krimi i paralajmëruar*. Ky titull shoqërohej me nëntitullin “*Agresioni, i përgatitur tani e dhjetë vjet i takon qëllimit strategjik të regjimit serb, spastrimit etnik të Kosovës*”.

Që në fillim të artikullit sqaruam se Milosheviçi ka dëshmuar, në veçanti që nga viti 1991, çfarë politike ai zbaton: në terren, forcat e tij speciale (policia me tanke të blinduara dhe njësitë paramilitare) e « spastrojnë » një zonë përmes terrorit; ndërkaq në negociata me ndërkombëtarët, ai bën premtime të pavërteta, krijon përshtypjen se nuk është i interesuar për konflikte. Në fakt, që nga viti 1988, Milosheviçi kishte ndezur shumë zjarre, duke shkaktuar gjakderdhje e rrënime. Në ndërkohë, Serbia e tij “e madh”e po tkurrej gjithnjë e më shumë: Mali i Zi, Vojvodina e Sanxhaku kërkonin të pavarësoheshin. Dhe pikërisht brenda këtij konteksti, ai hidhet në operacionin e tij të fundit, në « spastrimin » e Kosovës.

Këtu rikujtuam se spastrimi i rrafshnaltës së Drenicës nga shqiptarët kishte filluar më 25 mars, në kohën kur Grupi i Kontaktit për ish-Jugosllavinë i dha edhe një muaj afat diktatorit serb për ta « nisur një dialog » me përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës; pra dy muaj afat, ndonëse vetëm një ditë apo për një natë u mjaftojnë shpesh vrasësve për krimet e tyre. Në këto rrethana as që mund të shtrohej kërkesa që forcat speciale ta braktisin zonën në të cilën kishin masakruar në kushte të tmerrshme së paku 80 persona, duke i kallur shtëpitë e tyre dhe aty ku, siç duket, ato synonin të vendosin, me ndihmën e njësive të veçanta, një linjë të ndarjes së territorit.

Saktësuam më tej se agresioni i filluar në mars të vitit 1998 ishte paralajmëruar nga disa burime tani e disa muaj.

Ky agresion, siç nënvizuar, i takon objektivit strategjik të regjimit serb: spastrimit etnik të **territorit** të Kosovës, pas spastrimit të gjitha institucioneve ku punonin shqiptarët: duke filluar nga shkollat e deri te Kuvendi. Ky projekt nuk ishte sekret: ai ishte trajtuar dhe përpunuar publikisht në debatet parlamentare në Serbi, në qarqet shkencore akademike, në konferencat shkencore dhe ato të partive politike të Serbisë dhe në medie. Faza e parë e realizimit të tij u intensifikua në vitin 1989, me suprimimin kundërkushtetues të autonomisë së Kosovës,

i shoqëruar me « spastrimin » masiv të institucioneve nga shqiptarët. Kësodore, siç theksuam, duke u nisur nga korriku i vitit 1990 u dëbuan me dhunë 90% e shqiptarëve nga të gjitha fushat e jetës sociale dhe ekonomike: nga arsimit, shëndetësia, mediet, kultura, ekonomia. Vetëm nga fusha u arsimit u dëbuan 450.000 nxënës, studentë e mësime të shqiptarë. Fati i njëjtë i goditi edhe mjekët, gazetarët e të gjitha medie, gjyqtarët e ekspertët e drejtësisë, me dhjetëra mijëra punëtorë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Organizatave të ndryshme ndërkombëtare, nga më prestigjiozet, e cilësuan këtë situatë të krijuar nga regjimi serb me termin « apartheid ». Kësodore *Konfederata e sindikatave të lira*, në raportin e saj « Dëbimet nga puna dhe spastrimi etnik në Kosovë » (Bruxelles, 1993), kishte vënë në pah qartazi se spastrimi etnik i institucioneve nuk kishte për qëllim mbajtjen e një gjendjeje diskriminuese, por se ai synonte një ndryshim radikal të strukturës etnike në Kosovë. Represioni sistematik (përveç vrasjeve, mijëra të burgosur politikë), pengesa që regjimi i kishte vënë shërbimit mjekësor, të drejtës për të punuar, si dhe çdo aktiviteti shoqëror, kulturor e sportiv, e madje edhe shpërndarjes së ndihmave humanitare, kishin për qëllim ngulfatjen e popullsisë shqiptare, duke ia bërë kësaj jetën të padurueshme, me qëllim që ta detyrojë të largohet nga Kosova.

Shtuam më tej se gjatë më se një decenie, propaganda e Beogradit kishte zhvilluar një energji shumë të madhe për ta mbështetur legjitimitetin e dëbimit të shqiptarëve të Kosovës. « Argumente » të ndryshme historike dhe politike ishin të shoqëruara me propozime konkrete për ndryshimin e dhunshëm të strukturës etnike të Kosovës. Kësisoj, në Deklaratën e Konferencës për popullsinë, cila u mbajt në mbarim të muajit prill 1995 në Prishtinë, në prani të autoriteteve politike e shkencore të Serbisë, u kërkua haptazi dëbimi i 400.000 shqiptarëve dhe zëvendësimi i tyre me po aq serbë.

Mirëpo kufizimet e këtij plani të spastrimit etnik, i shtynë disa intelektualë dhe politikanë në Beograd ta riaktualizojnë çështjen e ndarjes së Kosovës. Propagandistët e kësaj ideje (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë, Shoqata e Shkrimtarëve e Serbisë dhe Presidenti i saj Aleksandër Despiç, si dhe shkrimtari, të cilin Milosheviçi e bëri President të ish-Jugosllavisë Federale, Dobrica Qosiç, etj.) e prezantuan *ndarjen* si një zgjidhje që do të duhej t'ia mundësonte Serbisë që ta ruajë së paku pjesën më të madhe të Kosovës.

Për ta arsyetuar këtë projekt, zyrtarët dhe intelektualët serbë e shoqëronin atë me teorinë mbi « gjenocidin e popullit serb » nga shqiptarët në Jugosllavinë e Titos.¹

Debatet në disa medie gjatë bombardimeve të NATO-s

Opinionii publik parisien dhe francez në përgjithësi u trondit fuqimisht nga imazhet me shqiptarët e Kosovës të deportuar kah Maqedonia, Shqipëria dhe Mali i Zi në prill e maj të vitit 1999. Këto imazhe rrëqethëse rikujtuan së pari imazhet e Luftës së Dytë Botërore e pastaj edhe disa eksode të tjera masive të popullsisë të përndjekura, në kontinente të ndryshme pas Luftës së Dytë Botërore. Të gjitha rrëfimet e tjera për krimet në Kosovë, që kishin arritur gjatë viteve të fundit, me gjithë ndërprerjet në kohë, dyshimet se janë apo nuk janë të vërteta, sikur u kapërcyen nga *erupsioni* që shkaktuan imazhet e fundit në opinion: raportet e gazetarëve të kanalit të parë TF1 dhe FR2, Patrick Bourat dhe Isabelle Lemonier, ofruan dëshmi impulsive që ndriçonin mirë situatën tragjike të kosovarëve.

Në emisionin e gazetares së shquar, Christine Okrent, nga mbairimi i muajit prill në *France 3* u zhvillua një debat lidhur me qëllimet dhe pasojat e intervenimit të NATO-s. Ishin të pranishëm M. Wurmeser, prijës i rrymës reformiste të Partisë Komuniste Franceze, Olivier Duhamel, politolog dhe deputet evropian, Alain Madelain, Kryetar i Partisë Liberale, ndërkaq në dupleks nga Brukseli ishin Havier Solana, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dhe Ema Bonino, zyrtare e BE-së. Në këtë emision pata rastin të saktësoj disa aspekte të strategjisë politike e ushtarake të regjimit serb ndaj Kosovës.

Intelektualët dhe politikanët francezë, që kishin qëndrim kritik ndaj ideologjisë dhe veprimeve regjimit serb, kritikuan protestat kundër intervenimit të NATO-s të cilat u organizuan në Francë nga Partia Komuniste, e cila bënte pjesë në koalicionin qeveritar me socialistët dhe të verdhët, por edhe nga partitë e së majtës ekstreme. Parulla e tyre kryesore ishte « kundër luftës ». Në reagimet tona theksuam se ishte e çuditshme se si qëndrimi i tyre kundër luftës nuk u manifestua atëherë kur makineria ushtarake e Milosheviçit që nga fillimi i vitit 1998, shkatërronte fshatrat shqiptare në Kosovë dhe masakronte banorët e tyre apo i dëbonte jashtë Kosovës; ndërkaq ata u ngritën kundër luftës së

¹ *Libération*, Paris, 30 mars 1998.

NATO-s, e cila godiste këtë makineri, pikërisht me qëllim që të *ndalet* lufta.

Në paraqitjen tona publike vinim në pah se kësisoj protestuesit nuk kishin fije brengje morale pse mbështesnin një regjim që ishte dëshmuar edhe me krimet masive në Kroaci dhe në Bosnjë. Më pastaj, kemi shpjeguar shkurtazi *konstituimin* e këtij tipi të ri të regjimit të Milosheviçit me tipare totalitare dhe me objektivin strategjik « një shtet për të gjithë serbët » të Ballkanit, duke saktësuar se ky regjim u zhvillua në vitet '80 me zhbërjen me dhunë dhe me spastrime etnike të institucioneve të Kosovës si njësi federative e ish-Jugosllavisë.

Konferenca shkencore për kampet dhe gjenocidet në Sorbonë

Kjo konferencë shkencore u organizua nga profesorja Catherine Coquio, e cila ligjëronte letërsinë krahasimtare në Universitetin Sorbona IV në Paris dhe profesori Irving Wolfarth, profesor i letërsisë gjermane në Universitetin e Reims-it. Një rrjet i profesorëve të shquar evropianë e amerikanë zhvilluan kërkime shkencore të thelluara, gjatë viteve '90 në Francë, rreth tri temave kryesore: « Letërsia dhe dituritë në sprovë të kampeve », pastaj « Demokracitë, gjenocidet dhe krimet kundër njerëzimit » dhe së treti « Shfarosja dhe politika ». Në vitin 1997, C. Coquio, me bashkëpunëtorët e vet themeloi « Shoqatën ndërkom-bëtare të kërkimeve për krimet kundër njerëzimit dhe gjenocideve » - AIRCRIGE.

Në këtë konferencë treditore folën 35 profesorë dhe hulumtues të shquar nga vende të ndryshme të Evropës Perëndimore dhe ShBA-së (Yves Ternon, Omer Bartov nga Universiteti Rutgers në ShBA, Jean Bollack, profesor në Universitetin e Lille-it, Claudine Kahan, profesore e letërsisë krahasuese në Universitetin Yal (ShBA), (nobelisti 1997) shkrintari i madh, Imre Kertesz, (në moshën 15 -vjeçare e mbyllën në kampin Auschwitz-it, e pastaj në Buchenwald), Georges Molinié, profesor i gjuhësisë franceze (PIV, Sorbona), Claude Mouchard, profesor i letërsisë në Parisi 8, Tzvetan Todorov, hulumtues në CNRS, veç të tjerave, autor i librit *Përballë ekstremes*.

Në vitin 1999 kumtesat e kësaj konference u botuan në librin voluminoz me titull *Parler des camps, penser les génocides (Të flasësh për kampet, të mendosh gjenocidet)* (f.1-669) nga Shtëpia Botuese prestigjioze « Albin Michel » në Paris. Libri ndahet në dy kaptina. E

para trajton temën e kampeve dhe gjenocideve dhe sot, konceptet për Perëndimin dhe dyfishet e tij, çështjet e universalizimit, kolonizimit dhe dekolonizimit e shfarosjes.²

Interpretimet e gjenocideve

Në kaptinën e parë Georges Benssoussan shkruan « *Për një lexim politik të Shoah-së* », Alain Brossat për *Masakrat dhe gjenocidet: kushtet e rrëfimit*, Enzo Traverso për *mëvetësinë e Auschwitz-it*; Denise Mendez merr në shqyrtim *traditën perëndimore të universalizimit dhe diskriminimet raciale*; Sadek Sellam analizon kolonializmin të kolonellëve dhe kampet dhe shfarosjet në Algjeri; Monique Gendreaushkruan këtu për kolonializmin dhe të drejtën ndërkombëtare; Daniel Binswanger, për çështjen e historisë në poezinë e Paul Celan, ndërkaq François Turner për kodin poetik të shfarosjes; Claudine Kahan për turpin e dëshmitarit; Myriam Revaut d'Allones për sprovën e kampeve dhe imagjinatën e të ngjashmes; Claude Mouchard, për lidhjen si jolidhje në romanin « Kadidish » të Kertesz-it, ndërkaq Catherinie Coquio zberthen çështjen e të folurit në kamp dhe të folurit për kampet. etj.

Artikulli im, i botuar në kaptinën e parë, ka për titull: *Spastrimi etnik dhe gjenocidi në ish-Jugosllavi*, (f.264-288).

Në nëntitull i kam dhënë dy citate. Njëri është nxjerrë nga « Memorandumi » i Vasa Çubriloviçit mbi *Dëbimin e shqiptarëve*, 1937: « Kur Gjermania mund të dëbojë dhjetëra mijëra hebrenj dhe kur Rusia zhvendos miliona njerëz nga një pjesë e kontinentit në tjetrin, dëbimi i disa qindra mijëra shqiptarëve nuk do shkaktojë shpërthimin e një lufte botërore ». Citati i dytë është marrë nga një dokument i Kishës ortodokse serbe me titull « Letër e hapur « armiqve të Serbisë së përgjakur e të martirizuar, 1989: « Do të bëjmë gjithë atë që është e mundur për të çrrenjosur fiset e tyre dhe trashëgimtarët e tyre, në mënyrë që historia t'i mos i përmendë kurrë më ».³

Në pjesën e parë, me titull « Kriza e Jugosllavisë dhe çështja e Kosovës » kam shtjelluar pikëpamjen se fillimi i mbarimit të Jugosllavisë do të nisët dhe do të përfundojë në Kosovë. Nisja, në vitin 1981 në Kosovë, me demonstratat dhe pakënaqësitë e shqiptarëve do të

² *Parler des camps, penser les génocides* (f.1-669), Albin Michel, Paris, 1999.

³ *Parler des camps, penser les génocides*, f.264.

cilësohet me një varg të krizave, e cila do të shprijë te shpartallimi i Jugosllavisë.

Riaktivizimi i mitit të Betejës së Kosovës (1389), si nxitje për hakmarrje dhe « ripushtimin e Kosovës », në « pastërtinë » e saj që implikonte, në mënyrë gjithnjë e më eksplicite, në ligjërieme politike jo vetëm të qeveritarëve, por edhe të elitave intelektuale e kishtarë të Serbisë zuri vend edhe miti për « infiltrimin e shqiptarëve nga Shqipëria në Kosovë, në saje të një « marrëveshjeje sekrete » midis Titos dhe Enver Hoxhës.

« Besëlidhja » (« zavet ») tradicionale e Kosovës, e kultivuar nga elitat nacionaliste e kishtarë, përmbante kërkesën për një luftë të re për shtetin serb, siç e përsëritnin elitat intelektuale dhe artistët e Serbisë, krahas politikanëve. Dobrica Qosiçi shpesh e përsëriste në shkrimet dhe fjalimet e veta tezën se « serbët kanë humbur në paqe atë që e kanë fituar me luftë ». Ky riinterpretim i mitit për një betejë të humbur e paraqet Kosovën me një figurë që ka dy anë: një « varrezë mbi tokë » dhe një « perandori qiellore » si « varrezë e të gjitha viktimave serbe gjatë historisë ». Ndërkaq, Matija Bećković, poet dhe akademik i njohur i Beogradit shkruante: « Varreza është shenjtëria më e madhe dhe kisha më e moçme e popullit serb. Varreza është besimi ynë më i gjatë dhe më i vendosur ».⁴

Një vel i revizionizmit për Kosovën

Më 3 maj të vitit 2000 bashkë me sociologun Véronique-Nahoum Grappe, filozofin Alain Brossat dhe politologun Jean-Yves Potel botuam në të përditshmen *Le Monde* artikullin *Një vel i revizionimit mbi Kosovën*.

Në qasjet e disa intelektualëve dhe gazetarëve francezë ndaj ngjarjeve dramatike në Kosovë u shfaq gjithnjë e më shumë prirja për ta riaktualizuar qasjen revizioniste në shpjegimin e dhunës që pushteti serb ushtronte kundër shqiptarëve të Kosovës.

Këta intelektualë e politikan riaktivizuan, në fakt, një dispozitiv, qëllimi i të cilit ishte që të *banalizohen* dhe fundja të *mohohen* krimet e regjimit serb në Kosovë në periudhën 1990-1999. Duke marrë parasysh edhe shkrimet e disa gazetarëve dhe intelektualëve (si Régis Debray

⁴ R. Rajic, në artikullin « Crkva i sprsko pitanje » (« Kisha dhe çështja serbe ») i botuar në revistën « Republika » f.121-122, Beograd,1995.

fjala vjen) kemi theksuar se këtu merr formë një *revizionizëm* i cili synon në fillim, jo thjesht t'i mohojë të gjitha krimet, por të mbajë një *atmosferë të dyshimit të përgjithësuar* lidhur me dëshmitarët, viktimat dhe rrëfimet e tyre për atë që ka ndodhur dhe që kanë përjetuar. Një revizionizëm tinëzar dhe dinak, që mëton të nxjerrë përfitime nga *simulimi i një qëndrimi neutral* dhe t'u referohet gjoja skrupujve të deontologjisë gazetareske. Gazetarët e intelektualët e kësaj rryme hidhnin dyshime mbi *realitetin* e krimeve ndaj shqiptarëve edhe duke evokuar *fragjilitetin e dëshmitarëve* dhe të dëshmimeve, duke përhapur insinuimin se më së miri është "të mos ia mbajmë anën asnjërës, as palës tjetër, sepse siç pohonin ajo « e vetmja gjë që është e sigurt është se asgjë nuk është e sigurt ». E kjo do të thotë se duhet të abstenojmë nga gjykimet dhe vlerësimet për atë që ka ndodhur në Kosovë, e sidomos të heqim dorë nga kërkesat për mbështetje të shqiptarëve nga vendet perëndimore, në radhë të parë. Kësodore, mesazhi i shkrimeve të tilla implikon se ne nuk duhet të jemi dëshmitarë të dëshmitarëve të pasigurt, konfuzë, që i ngatërrojnë datat e ngjarjeve, që nuk janë të saktë në përshkrimin e rrethanave.

Kemi nënvizuar këtu se « kjo metodë është dhe mbetet metoda e revizionizmit të djeshëm dhe atij të sotëm; pasi pësoi disfatë dhe u kriminalizua në frontin e së kaluarës (gjenocidi për hebrejtë), revizionizmi u riparaqit papritmas ndaj mynxyrës së sotme, ndaj krimeve masive ndaj shqiptarëve. Kjo qasje mëtonte t'i mohojë apo së paku t'i banalizojë ato krime; mu këtu ku ne duhet të ballafaqohemi me të padurueshmen, ta gjykojmë dhe t'i rezistojmë vendosmërisht ».

Kemi theksuar se shumica e operacioneve të falsifikimit, të dezinformimit dhe të *çrealizimit (déréalisation)* që i praktikonte, fjala vjen gazetarja Elisabeth Lévy sikurse edhe sociologu Régis Debray, linguisti Noam Chomsky, mujorja *Le Monde diplomatique*, synon ta *zhbëjë realitetin* e ngjarjeve. Sikurse të gjitha revizionizmat e tjerë edhe ky pretendon se nëse dëshmia nuk është aq e sigurt, nuk mund të jemi të sigurt as për realitetin e krimit. Dërdëllitje kjo e mefshtë për numrin e viktimave, për rrethanat e vdekjes së tyre, duke u orvatur të tregojë se krimi totalitar s'ka si të dëshmohet; ata donin të *mohojë* karakterin e tij të paraparë, të planifikuar, emërtimin e një armiku objektiv si fajtor, si dhe t'i mjegullojnë situatat e rrethanat për t'i fshirë gjurmët e krimeve.

Këta autorë që në shkrimet e tyre kultivonin revizionizmin ndaj krimeve që janë bërë kundër shqiptarëve të Kosovës, bënin çmos të gjejnë arsye të justifikime për persekutuesit dhe kriminelët, t'i japin të drejtë *sovrانيتit* të shtetit serb për të gjitha krimet barbare që

bëheshin në emër të tij, e në anën tjetër asnjë mirëkuptim për vullnetin e një populli tjetër që të mos pranojë dhunën dhe nënshtrimin, që të jetojë i lirë. Ky revizionizëm bashkonte në gjirin e vet intelektualë të rrymave të ndryshme politike, ultra të majtë e të majtë, të qendrës, të djathtës dhe të djathtës ekstreme.⁵

Në vazhdim të artikullit kemi theksuar se intervenimi i NATO-s në Kosovë, gjatë muajve mars-qershor 1999, provokoi debate të ashpra në opinionin publik evropian dhe veçanërisht në atë të Francës. Ky debat u fokusua rreth legjitimitetit dhe legalitetit të intervenimit, pastaj rreth shkaqeve dhe rrjedhimeve të shkaktuara, si edhe për peshën politike dhe etike të këtij aksioni sa për Ballkanin po aq edhe për Evropën. Polemikak e ngarkuara me tensione e pasione bën që të vijëzohen linja të reja të fronteve politike: e djathta republikane e sovraniste u bashkua me të majtën komuniste, e majta ekstreme (*Ligue communiste révolutionnaire* dhe *Lutte ouvrière*) u bë bashkë me të djathtën ekstreme kundër gjithë atyre që mbështetnin intervenimin.

Termi dhe nocioni « revizionizëm » u përdor, bashkë me termin « negacionizëm » në luftërat ideologjike e politike lidhur me mohimin e krimeve që regjimi nazist gjerman i kishte bërë kundër hebrenjve e Evropës. I pari cilësohet me përpjekjet që ta arsyetojë mohimin e disa krimeve, tanimë të dëshmuara, në saje të interpretimi më kompleks të ngjarjeve historike. Mohimi apo minimizimi i krimeve të dëshmuara në Kosovë realizohej në paraqitjet publike, në saje të falsifikimit apo thjesht injorimit të të dhënave, me *diskreditimin e dëshmitarëve* dhe me qëndrimin cinik ndaj krimeve të rënda.

Ndërkaq, intelektualët që kishin qasje tjetër ndaj ngjarjeve të Kosovës, në paraqitjet e tyre në konferenca apo në medie zhvillonin një analizë kritike të pikëpamjeve që kultivonin forma të ndryshme të mohimit apo të revidimit të plotë të karakterit të krimeve që i ka bërë regjimi serb në Kosovë.

Për disa pjesëmarrës të këtyre debateve, mohimi i krimeve del si argument me të cilin ata synonin të denoncojnë « qëllimet imperialiste » të ShBA-së dhe disa shteteve të tjera perëndimore ndaj Ballkanit. Për

⁵ *Le monde diplomatique*, në 20-vjetorin e bombardimeve të NATO-s kundër caqeve ushtarake të regjimit të Milosheviçit, botoi një artikull me një titull të madh « Gënjeshtra më e madhe e shekullit XX » quhej arsyeja e bombardimeve: mohimi i krimeve, ndonëse ato ishin dëshmuar nga shumë organizata ndërkombëtare e media të disa vendeve gazetarë edhe në terren. Persistimi i kësaj gazete, gjatë 20 vjetëve është dëshmi e një shkalle të lartë të *verbërisë intelektuale* dhe *shurdhësisë morale* karshi krimeve ekstreme.

disa të tjerë, si sovranistët, fjala vjen, (ministri Jean-Pierre Chevenment, sociologu Debray, historiani Max Gallo, ish-ministri Charles Pasqua etj.) çfarëdo injerence në punët e brendshme të një « shteti sovran » është e papranueshme. Në rastin e Kosovës ky argument merr trajtën e pranimit të së drejtës të një regjimi të egër kriminal që t'i terrorizojë dhe masakrojë popullsinë civile, në emër të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të një shteti. Shumica e kundërshtarëve të intervenimit të NATO-s – « revolucionarët » e së majtës ekstreme, pacifistët apo sovranistët – manifestuan për herë të parë publikisht një pozicion kundër luftërave në ish-Jugosllavi pikërisht në fillimin e bombardimeve ajrore kundër makinerisë ushtarake e policore të Milosheviçit. Kurse gjatë bombardimeve të kësaj makinerie kundër popullsisë civile në Vukovar, në Sarajevë e në Kosovë gjatë një decenie, ata heshtën me një heshtje « të virtytshme ». E tani ata dolën nëpër rrugët e Parisit, Romës e qyteteve të tjera evropiane, për të protestuar kundër vendimit të fuqive të mëdha që ta pengojnë ushtrinë dhe policinë e regjimit serb që të vazhdojë krimet masive kundër shqiptarëve të Kosovës. E këtë pozicion të vetin ata e mbulonin me vello të virtytit, guximit dhe dinjitetit, sinonime këto të kundërvënies ndaj « fuqive imperialiste », të përkufizuara si vetë mishërimi i së keqes.

Aspekti shqetësues i këtij *revizionizmi* ndaj krimeve të kryera në Kosovë ka të bëjë me përmasat e mëdha në të cilat ai u manifestua gjatë disa vjetëve. Një rrymë e gazetarëve, shkrimtarëve e politikanëve francezë praktikonte publikisht banalizimin, falsifikimin apo mohimin e krimeve, e njëherazi afishonte një qëndrim gjoja « të paanshëm » në këtë konflikt, duke simuluar “përpyekjen” për të qenë “objektiv dhe kritik” ndaj manipulimeve. Mirëpo, ajo që hetohej qartazi në shkrimet e tyre, ishte pikërisht mungesa e vullnetit për të parë e pranuar krimet masive të regjimit të Milosheviçit në Kosovë, krime që ishin konfirmuar nga shumë organizata ndërkombëtare të specializuara në hulumtimin e krimeve kundër civilëve.

Këtu do ta marr parasysh shkurtazi shembullin e sociologut Régis Debray, përkatësisht letrën që ai ia dërgoi Presidentit Jacques Chirac, e botuar në *Le Monde* (13 maj, 1999), artikullin e gazetares Elisabeth Lévy, i botuar në revistën *Le Débat* (mars, 2000) e njëherësh edhe reagimet e dy historianëve francezë me nam, Pierre Nora dhe Pierre Vidal-Naquet.

Régis Debray, pas një vizite *tre ditore* në Kosovë, në fillim të bombardimeve ajrore të NATO-s, deshi t'ia sjellë botës të vërtetën për atë që po ndodh në Kosovë, pasi ajo ishte « e mashtruar ». Në artikullin

e tij « Letër e një udhëtari Presidentit të Republikës », ai merr pozën e intelektualit kritik, që kultivon brengën për ta kuptuar një realitet kompleks dhe për ta informuar mirë opinionin me fuqinë e arsyes së tij kundrejt mistifikimeve dhe paragjykimeve. “E vërteta” e parë që ia sjell opinionit në artikullin e tij përmban pohimin se « nuk ka spastrim etnik në Kosovë », se ai nuk kishte parë diçka të tillë atje. Ai njëherazi shton se nuk ka pasur represion veç tre ditëve të para, madje të kryera nga « elemente të pakontrolluara ». Ky represion « i kufizuar, sipas tij, ishte i provokuar nga goditjet ajrore të NATO-s, sepse, para tyre nuk kishte pasur kurrfarë vrasjesh nëpër rrugë: askush nuk ikte kah Maqedonia dhe Shqipëria ». Në anën tjetër, deportimet e qindra mijëra shqiptarëve të Kosovës nga ushtria dhe policia e Milosheviçit nuk ishin për Debray-n veçse një domosdoshmëri « për t’i larguar *manu militari* kolonën e pestë të NATO-s, përkatësisht UÇK-në. Ai pohon madje se shkatërrimi i lejeve të njoftimit të të deportuarve ka thjesht për qëllim të pengojë « infiltrimin e terroristëve. Kësodore ai e përvetëson një element të propagandës së regjimit serb, thuajse të ishte zëdhënës i tij. Këtë rol ai e shfaq edhe atëherë kur merr pjesë në lojën morbide të Milosheviçit në manipulimin e *Vjetarit statistikor* të Serbisë (nga viti 1991) dhe ekspertëve demografikë të Beogradit, të cilët e zvogëljuan me lehtësi për disa *qindra mijëra numrin* e shqiptarëve në Kosovë. Debray përvetëson njëherësh një qëndrim të Milosheviçit (deklarata e Milosheviçit e dhjetorit 1998 ku bëhet ky zvogëlim) sikurse edhe mohimin e praktikës së spastrimit etnik.

Debray, i cili hiqej si analist kritik e objektiv, arriti t’i përvetësojë me sukses të gjitha pikëpamjet e regjimit serb për Kosovën, duke shpërfillur raportet e shumta të organizatave ndërkombëtare që kanë zhvilluar kërkime në terren, përfshirë edhe ato të Beogradit, si *Fondi për të Drejtën Humanitare* (i udhëhequr nga Natasha Kandiç) dhe *Komiteti i Helsinkit* i Serbisë (i udhëhequr nga Sonja Biserko).⁶

Sociologu Alain Joxe, profesor i gjeopolitikës në *Ecole des Hautes Etudes en Sciences sociales*, botoi një artikull në *Le Monde* më 14 maj 1999 si reagim ndaj letrës së Debray-së dërguar Presidentit Chirac. Joxe i bën vërejtje Debray- se ka « zgjedhur kampin e atyre që e kritikojnë ndërhyrjen e NATO-s », e kësisoj « t’i mbrojë agresorët serbë, të cilët i paraqet si të agresuar, duke i mohuar krimet që këta i kanë bërë kundër kosovarëve ». Derisa « forcat serbe vazhdojnë në Kosovë operacionin e tyre të spastrimit etnik » ai « ka marrë guximin

⁶ Po aty, f.212-213.

t'i shkruajë Chirac-ut kësisoj: « Kam arsye të mendoj, zotëri President, se këto fjalë janë një mashtrim ». Në fakt, siç vë në pah Joxe, Debray është angazhuar në « fushatën revizioniste » duke u « mbështetur në qarqet serbe të propagandës, të cilat i njohim mirë ».

Debray e paraqet UÇK-në si « lëvizje terroriste » duke mos hetuar se UÇK-ja « zhvillon një luftë çlirimtare kundër një kolonializmi fashist ». Joxe i bën më tutje vërejtje Debray-s se « u është bashkuar revizionistëve » duke reduktuar numrin e shqiptarëve të Kosovës për disa qindra mijëra e në anën duke i stërmadhuar shifrat e serbëve të Kosovës. Qëllimi i tij me manipulimin e këtyre shifrave « është që të mundë të thotë se nëse shqiptarët do të kenë mundësinë të kthehen në Kosovë, atëherë ata do të dalin si pushtues ». Sidomos pse « policia serbe në kufi ua kishte marrë lejet e njoftimit, targat e veturave, dokumentet kadastrale të pronësisë ». Me « kretenizëm internacional » Joxe e ka parasysh aleancën e kundërshtarëve të intervenimit të NATO-s kundër makinerisë ushtarake serbe, si lëvizje ndërkombëtare « anti-imperialiste ».

Motivet e mohimit të krimeve

Artikulli i gazetares Elysabeth Lévy, me titullin « Kosova: lehtësia e padurueshme e informimit » është një shembull drastik i *revizionizmit*, përkatësisht i mohimit të krimeve kundër Kosovës, i botuar në revistën shkencore « Le Débat », i drejtuar nga filozofi i shquar Marcel Gauchet dhe historiani e akademiku Pierre Norra. Për të dhënë një « shpjegim objektiv të çështjes së Kosovës, Gauchet dhe Nora e ftuan gazetaren Lévy, e cila shkruante për javoren « Marianne ». Kjo gazetarë ishte bërë e njohur sidomos për angazhimin e saj të vrullshëm në mohimin e spastrimeve etnike dhe krimeve të tjera sa në Bosnjë po aq edhe në Kosovë.

Në përgjigjen time, dërguar revistës *Le Debat* ndaj këtij artikulli kam theksuar se artikulli i revistës *Le Débat* pretendon të jetë një analizë kritike e medieeve që kanë shkruar apo prezantuar ngjarjet e Kosovës. Ajo paraqet në fillim me kujdes procedimet e nevojshme « metodologjike » për « prodhimin e informacionit », të cilat i paskan munguar gati të gjitha medieeve jo vetëm në Francë, por edhe në vende të tjera të Evropës që kanë shkruar për luftën në Kosovë. Duke i njohur shkrimet e mëparshme të gazetares sikurse edhe ato të filozofit Gauchet, nuk e kisha vështirë ta diktojë se pjesët që mëtojnë të lënë përshtypje të një « rigoroziteti » të analizës, janë të shkruara nga i dyti, ndonëse

artikulli këtu afishon vetëm një autor. Autorët ndërtojnë në këtë artikull një imazh për të gjitha mediet si prodhues të një prezantimi « të njënashëm » të situatës në Kosovë. Mirëpo, madje edhe nga një lexim i sipërfaqshëm i shtypit të vendeve të ndryshme për këto ngjarje vështirë se do të kishim një përshtypje se ato janë të një kallëpi. Më parë mendoj se mund të themi se brenda shtypit francez hetohet një *shumësi e pikëshikimeve*, e grilave të leximit, dhe divergjencave, për aspekte të ndryshme të çështjes së Kosovës.

Me vullnetin e saj « për të ditur se çka ka ndodhur në të vërtetë »⁷ në Kosovë, ajo konstaton se deri më sot « s’kemi veç disa të dhëna fragmentare, disa « varreza të supozuara », të cilat mund t’i ngjajnë « Timisoarave të vogla ». Tani e kemi të qartë *tonin* e analizës kritike të këtyre autorëve. Në fakt, Tribunali Penal Ndërkombëtar ka evidentuar më se 500 varreza.

Këto përfundime për *karakterin* e operacioneve të zbatuara nga regjimi serb e vënë në pah shumë shpejt « objektivitetin » e analizës së saj: hetime të shumta të ekspertëve të të drejtave të njeriut (këta bartës të « vetëdijes së rreme »: është kjo formulë e M. Gauchet-së, në shkrime të tjera), të realizuara nga organizata prestigjioze ndërkombëtare në terren (si FIDH e Parisit, *Federata Ndërkombëtare e Helsinkit*, *Amnesty International*, *Human Rights Watch*, *Médecins sans frontières*, etj.) vënë në dukje në mënyrë bindëse se që nga fillimi i operacioneve në Drenicë, në shkurt të vitit 1988 krimet kishin një karakter *masiv* dhe se *viktimat* në të shumtën e rasteve, ishin *civilë*. Sipas raporteve të këtyre organizatave, në Drenicë u masakruan familje të tëra, prej foshnjave deri të pleqtë e plakat.

Po kështu, represioni i viteve 1980 i regjimit të Beogradit në Kosovë nuk rezymohet kurrsesi në akte individuale e të izoluara, ngase e godet gjithë popullsinë shqiptare, pa dallim moshe, gjinie apo profesioni. Leximi i raporteve dhe i analizave të shumta të organizmave ndërkombëtarë e konfirmon këtë. Ndërtimi i sistemit të aparteidit në Kosovë në vitet 1989-1999 nënkuptonte spastrimin etnik të të gjitha institucioneve nga shqiptarët. Kjo ndërmarrje, që zbatohet nëpërmjet shumë aksioneve të regjimit serb, nxjerr në shesh qartazi natyrën e politikës së regjimit serb ndaj Kosovës: ajo cilësohet me planifikimin e konfirmuar gjatë realizimit dhjetëvjeçar të saj.⁸

⁷ Po aty, f.5.

⁸ Po aty, f.222.

Lidhur me këtë do të përmendi tani një raport të organizatës britanike *Institute War and Peace Reporting* (I.W.P.R.). Në dokumentin kushtuar krizës së Ballkanit nr.130, i 4 prillit 2000, thuhet se në saje të një raporti të shërbimeve sekrete të ushtrisë serbe ku figurojnë edhe disa intervista me oficerë të lartë, ajo që është tejet shqetësuese ka të bëjë dëshmitë e verifikuara të oficerëve të lartë që tregojnë se njësitë e ushtrisë serbe (V.J.) janë përgjegjëse për vdekjen e së paku 800 fëmijëve shqiptarë të moshës më pak se 5 vjet. Disa nga oficerët e intervistuar, siç thuhet në raport, shpjeguan se kjo intervistë ishte zhvilluar për të vlerësuar gatishmërinë e tyre lidhur me një intervenim të mundshëm ushtarak në Mal të Zi. Këtë raport, në fakt, ia dërgoi institutit britanik gazetari beogradas Miroslav Filipoviç: duke e njohur angazhimin politik të këtij gazetari, raportin shumë sekret të strukturave të larta të ushtrisë serbe, ia kishte përcjellë një oficer. Pasi këtë raport e publikoi IWPR në Londër, Filipoviçi u arrestua dhe u dënua nga Gjykata ushtarake me 7 vjet burg; mirëpo pas arrestimit të Milosheviçit dhe dërgimit të tij në Hag, ai u lirua nga qeveria e përkohshme e Kryeministrit Djinciç. Më vonë, në vitin 2003 Djindjiçin e vranë pjesëtarët e parmilitarëve famëkeq “Bereta e kuqe”, pasi ky kishte hapur hetime për krimet e tyre.

Në këtë raport, disa oficerë kanë përshkruar ngjarje konkrete në Kosovë, në të cilat janë vrarë shumë civilë e mjaft shpesh fëmijë. Kësodore, këto dëshmi të oficerëve serbë vetëm sa konfirmojnë raportet e shumta të organizatave ndërkombëtare lidhur me natyrën e krimeve të kryera në Kosovë nga trupat serbe. Ndërkaq, banalizimi apo mohimi i krimeve të regjimit të Beogradit shpaloset në artikujt e intelektualëve dhe gazetarëve që kishin zgjedhur të mbështesin regjimin e Milosheviçit. Ata mohonin përmasat dhe egërsinë e krimeve të këtij regjimi, edhe para fillimit të bombardimeve të NATO-s, jo vetëm në Kroaci dhe në Bosnjë, por edhe në Kosovë.

Vullneti për të mohuar apo banalizuar krimet e regjimit të Milosheviçit del shumë i theksuar në artikujt e autorëve të kësaj rryme negacioniste. Ata përsërisin pohimin se Milosheviçi « paska qenë shtyrë me dinakëri që ta bëjë krimin ».⁹

⁹ Olivier Mongin dhe Antoine Garapon në artikullin e tyre për krimet në Kosovë, i botuar në librin *Le Kosovo, un drame annoncé* thekson se: « shkatërrimi i të gjitha dokumenteve të shqiptarëve të deportuar synonte mohimin e realitetit të tyre: mohimi, ta përsërisim, është pjesë e vetë procesit të krimit kundër njerëzimit. Krimi që ka lindur shqiptar, mjafton për ta dënua në deportim dhe masakrim » (f.265).

Mohimi i krimit, në shkrimet dhe paraqitjet në media, shpesh shoqëroheshin me **arsyetimin** e masakrave: aksionet e regjimit serb paraqiteshin si një përgjigje apo një provokim, qoftë i shqiptarëve të Kosovës, qoftë i fuqive të mëdha. Dhe ky pohim përputhet plotësisht me pohimet e regjimit të Milosheviçit. Natyrisht, pavërtetësinë e këtyre pohimeve nuk e nxjerrim thjesht nga fakti se ato burojnë nga aparati propagandues serb. Pavërtetësia e këtij shpjegimi dhe interpretimi ishte nxjerrë në shesh ka kohë nga analizat kritike dhe të hollësishme edhe të disa gazetarëve e intelektualëve dhe hulumtuesve shkencorë të Beogradit (B. Bogdanovic, I. Colovic, S. Inic, M. Kovac, V. Pesic, etj.), të Zagrebit (B. Horvat) apo nga Lubjana (R. Mocnik, S. Graber etj.), por po ashtu edhe të Parisit dhe New-York-ut. E kemi fjalën për analiza të thelluara të ideologjisë së regjimit serb, të natyrës së tij, të praktikave politike dhe ushtarake të tij, si dhe të mënyrës së funksionimit të tij.¹⁰

Ndërkaq, njëra nga konkluzat për domosdonë e dëbimit të 400.000 shqiptarëve dhe vendosjen e po aq serbëve në Kosovë¹¹ u bë publike në një Konferencë “shkencore” prezantimin e së cilës e bëri edhe e përditshmja *Jedinstvo*.¹¹

Në anën tjetër në raportin (§156, qysh më 10 shkurt 1993) Tadeusz Mazowiecki, raportues special i OKB-së thuhet se në Kosovë « një numër i caktuar i ligjeve diskriminuese inkurajojnë një politikë që i takon aparteidit, etnocidit e madje edhe gjenocidit » (§: masat që synojnë ta pengojnë natalitetin te shqiptarët).¹²

Angazhimi i historianit Pierre Norra në mohimin e krimeve në Kosovë

Pas publikimit të artikullit të gazetares E. Lévy, ia dërgova redaksisë përgjigjen time.

Në disa artikuj të tjerë kemi vënë në pah ngjashmëritë në ligjërime dhe praktika midis politikës gjenocidale të regjimit serb në Kosovë me gjenocidin e hebrenjve nga nacistët, me gjenocidin në Ruandë ose atë të kmerëve të kuq, si përvoja të ndryshme të shfarosjeve të programuara; por përveç ngjashmërive kemi vënë në pah edhe specifikat e praktikave gjenocidale ndaj shqiptarëve të Kosovës: fjala vjen, tiparet karakteristike të ligjërimeve politike të regjimit serb edhe të intelektualëve serbë që kanë përgatitur dhe legjitimuar spastrimin etnik të institucioneve të Kosovës dhe të territorit të saj.

¹⁰ Po aty, f.224.

¹¹ « Jedinstvo », Prishtinë, 4-5 prill 1995.

¹² Po aty, f.227.

Mirëpo përgjigja ime nuk u botua në muajt e parë të vitit 2000. Filozofi i shquar francez Claude Lefort e takoi akademikun Nora dhe i kërkoi ta botojë përgjigjen time. Lefort më njoftoi se Nora kishte pranuar ta botojë artikullin tim. Megjithatë, botimi u vonua. Pas një kohe “pata nderin” të marrë një telefonatë nga z. Nora: ai më propozoi që ta botojë përgjigjen time në javoren “Marianne”. Nuk u pajtova me këtë propozim duke cekur se përgjigja duhet të botohet në revistën ku kishte dalë artikulli për Kosovën.

Në vazhdim të bisedës, historiani Nora e shtroi edhe një “argument” tjetër që më habiti edhe më shumë: më tha se do të ishte mirë që unë ta tërheq artikullin, ngase kishin kaluar disa muaj nga botimi i artikullit ndaj të cilit reagoja. « Jo z. Nora, i thashë, ju e dini mirë se objekti i polemikës këtu është pikërisht çështja e mohimit të krimeve masive kundër civilëve dhe ato s’kanë si të harrohen ». Në fakt, vepra më e çmuar e historianit dhe akademikut Nora, vepër kolektive në disa vëllime mban titullin *Les lieux de la mémoire (Vendet e kujtesës, 1984-1992)*, e çmuar në përmasa ndërkombëtare. Si autor i konceptit “lieu de mémoire” (vend i kujtesës), ai thekson se një “objekt” bëhet vend i kujtesës kur i ikën harresës, fjala vjen, me vendosjen e një pllake përkujtimore dhe kur një bashkësi e përshkon atë me afektin e vet dhe me emocionet e veta”. Dhe ja tani që autori i këtij koncepti orvatej të më bindë ta lëmë anash përgjigjen ndaj mohimit-harresës së krimit, krim që i kishte mobilizuar OKB-në, NATO-n dhe shumë shtete e organizma ndërkombëtarë. Implikimet që mund të nxirren nga kjo kundërthënie e këtij autori me qëndrimet e tij të afirmuara nuk janë të pakta: do të thosha se, në këtë mënyrë, Nora sikur donte të thoshte se ato krime atje *sikur nuk ia vlejnë të shënohen* apo të shpëputen nga harresa. Në saje të të cilit kriter?!

Gauchet e Nora megjithatë e panë veten të detyruar, nga presioni i disa intelektualëve francezë me ndikim, ta botojnë përgjigjen time në numrin nëntor-dhjetor të vitit 2000.

Debatet dhe polemikat rreth krimit të Reçakut

Në muajt mars dhe prill të vitit 1999 në hapësirën publike të Francës u zhvilluan debate e polemika rreth krimit që trupat serbe kryen kundër civilëve shqiptarë në fshatin Reçak. Intensifikimi i këtyre polemikave në qarqe të ndryshme politike, intelektuale e mediatike vuri në pah se *polarizimi* kryesor kishte të bëjë me interpretimin e kësaj

ngjarjeje të rëndë dhe me domethënien e saj në rrjedhën e proceseve politike jo vetëm në Francë, por edhe në nivelin evropian dhe ndër-kombëtar. Pësha e kësaj ngjarjeje shpërfaqej si faktor që mund të ndikojë në *kristalizimin* e vendimit të fuqive perëndimore që, më në fund, pas cikleve të krimeve të regjimit serb në Kosovë, të ndërmerret kundër tij një intervenim ushtarak i Aleancës Veriatlantike. Mbështetësit e regjimit serb në Francë, në nivele të ndryshme, u mobilizuan rreth çështjes së krimit në Reçak, për ta parapenguar rrjedhën e ngjarjeve në drejtim të një intervenimi në të cilin Franca mund të merrte pjesë. Së këndejmi, ithtarët e këtij orientimi politik do të fokusohen në përdorimin publik të « argumenteve », të cilat synonin të provojnë se krimi i Reçakut ishte një kurdisje e thjeshtë e mbështetësve të intervenimit të NATO-s kundër Serbisë.

Brenda këtyre debateve u shqua reagimi i historianit të madh francez Pierre-Vidal Naquet. Ai ishte i njohur për vepra në të cilat, gjatë shumë viteve, kishte ofruar analiza kritike të politikës koloniale të Francës në Afrikë, e në veçanti, në Algjeri (fjala vjen në librin *Tortura gjatë Republikës së pestë*). Në anën tjetër, ai kishte botuar vepra të çmuara për çështje të ndryshme të kulturës antike greke.

Më 28 prill 1999 ai botoi artikullin në revistën *L'Evenement du jeudi* me titull: « Reçak: një Timisioara e re? ». Ai shkruan këtu: « Polemika bën bujë lidhur me masakrën në Reçak, ky fshat i Kosovës ku u gjetën nja 40 trupa me koka të prera. A është fjala për një Timisioara e re, sipas emrit të këtij qyteti rumun ku, nga fundi i vitit 1989, u nxorën kufomat nga morgu i një spitali për ta paraqitur sikur të ishte një masakër? Në fakt, nuk mund të përjashtohet mundësia që në Kosovë të ketë pasur një mizanskenë. Rebelët shqiptarë nuk janë të shenjtë. Mbetet fakti që pushteti serb, në kundërshtim me çfarëdo drejtësie e konsideron Kosovën si një vend serb, ndonëse është e qartë se ai vend është i banuar nga shqiptarët.

Sipas disa miqve të mi, mediet nxitojnë shpesh t'i akuzojnë serbët, vetëm serbët, gjithmonë serbët. Nga ana ime mendoj se shpërthimi i Jugosllavisë ishte një katastrofë, viktima të së cilës ishin një numër i madh i jugosllavëve (që u takonin familjeve mikste). Milosheviçin e konsideroj si një kriminel i cili hapur e ka shkatërruar Federatën, mirëpo, Tudjmani, presidenti kroat nuk është më i mirë. E kemi parë se si veptoi ai kur e pushtoi « Krajinën » duke shkaktuar dëbimin e së paku 200.000 serbëve me bashkëfajësinë e kundërshtarit të vet në Beograd. « Total-nacionalizmi » - shprehje kjo e Edgar Morin-it – më pak a më shumë i lidhur me mafinë, është një sëmundje e përhapur gjithandej. A

do të hapet rruga nesër për një Shqipëri të Madhe, e cila do ta shkatërronte po ashtu edhe Maqedoninë dhe një pjesë të Malit të Zi? Vazhdoj të shpresoj, ndonëse ka pak gjasa, që një zgjidhje e re federative do të paraqitet një ditë në Ballkan. Dimitrov kishte ëndërruar për këtë opsion, e kjo shkaktoi një përçarje me Stalinin dhe me Enver Hoxhën. Sido që të jetë, nëse duam ta kuptojmë Shqipërinë, le ta lexojmë atëherë librin e dy vëzhguesve miqësorë, që të dy historianë, Pierre dhe Bruno Cabanes, babai dhe i biri, *Pasionet shqiptare: prej Berishës te Kosova* (botuar nga *Odile Jacob*). Do të shohim se çka fshihet mbrapa diskurseve më shkencore, përfshirë kur ato kanë të bëjnë me antikitetin më të moçëm ».

Polemika me historianin Vidal-Naquet

Në fillim të muajit maj ia dërgova një reagim javores *L'Evenement du jeudi*, por ata nuk e botuan. Gjeta mundësinë ta botoj reagimin në revistën për çështje të kulturës *Drôle d'époque* (prill, 1999). Redaksia e kësaj reviste e kontaktoi Vidal-Naquet-n, ia dërgoi reagimin tim dhe i ofroi atij një mundësi për përgjigje. Në përgjigjen e tij ai u orvat ta paraqesë komentin e vet si keqkuptim dhe deshë të më bind « se ka simpati për shqiptarët dhe se për këtë mund ta pyesja Kadarenë ».

Në këtë reagim kam shkruar:

« I nderuar zotëri Pierre-Vidal Naquet,

Artikulli juaj i fundit në *L'Evenement du jeudi* më befasoi mjaft. Në këtë artikull ju e krahasoni masakrën e Reçakut me atë të Timisioarës, duke na rikujtuar se në atë qytet rumun, nga fundi i vitit 1989, « u nxorën nga morgu kufoma për ta krijuar përshtypjen se është fjala për një masakër ». Mbi çka e mbështetni ju këtë krahasim? Disa gazetarë francezë patën shfaqur disa dyshime, në një moment, ndaj konstatimit të përfaqësuesve të OSB-së. Asnjëri nga elementet që evokuan Renaud Girard dhe Cristophe Chatâlot nuk u ka rezistuar argumenteve të hulumtimit, i cili u zhvillua në vendin e ngjarjes nga ekspertët e OSBE-së, si dhe nga dëshmitë e disa gazetarëve të tjerë (të *Independent* dhe të *New York Herald Tribune*, bie fjala). Vetë Châtelot solli, disa ditë pas versionit të parë, elemente që vetëm sa konfirmuan

pohimet e anëtarëve të OSBE-së dhe ekspertëve amerikanë të trupit diplomatik që kanë zhvilluar hulumtimin e tyre (shih artikullin e Pierre Hazan në gazetën *Libération*, më 27 janar). E megjithatë, një pjesë e medieeve, sidomos ato elektronike, gjatë disa ditëve shprehnin kënaqësi me mundësinë e një « mizanskene ». Raporti i OSBE-së, i cili iu shpërnda gazetarëve në Vjenë më 21 janar, konfirmon se në Reçak ka ndodhur një masakër e 45 civilëve shqiptarë. Sipas këtij raporti, gati gjysma e viktimave është vrarë nga afërsia. Midis viktimave janë edhe dy fëmijë, një grua dhe disa pleq. U gjet një viktimë me kokë të prerë (e jo 4 siç pohoni ju). Disa nga viktimat janë vrarë duke provuar të ikin, pra në një distancë prej 100 deri në 150 metra. Disa trupa ishin zhvendosur, ç'është e vërteta, por nga anëtarët e familjeve të tyre që i kanë vendosur në shtëpitë e tyre, sipas dëshmisë së ekspertit amerikan. Shefi i misionit të OSBE-së, gjenerali Wiliam Walker (ai nuk është as gazetar e as një humanitar sentimental) e ka cilësuar në disa raste këtë masakër si një « krim kundër njerëzimit ». Sipas versionit të regjimit të Beogradit, personat e vrarë nuk ishin civilë, por luftëtarë të UÇK-së; anëtarët e saj ua kishin hequr uniformat dhe ua kishin veshur teshat e civilëve. Eksperti amerikan pohon se kjo tezë është e paqëndrueshme, sepse fotografitë tregojnë qartazi korrespondimin midis vrimave të teshave dhe goditjeve të plumbave në trupat e tyre. Pasi trupat e tyre ishin goditur nga shumë plumba, ndryshimi i veshjeve nuk ka pasur mundësi të duket i bindshëm. Disa gazeta të Beogradit kanë pohuar (nuk dihet në saje të të cilave të dhëna) se viktimat kanë qenë të vrarë nga vetë shqiptarët.

Mirëpo, nuk e kam të qartë se në ç'mënyrë ju keni arritur ta bëni krahasimin e kësaj situatë me Timisioarën. Madje edhe versioni zyrtar i Beogradit nuk e bën të mundur këtë krahasim. Asnjëra nga qeveritë perëndimore nuk e ka akredituar tezën e regjimit të Beogradit për Reçakun, ndonëse, zakonisht, ata kanë prirjen që t'i barazojnë mekanikisht përgjegjësitë e aktorëve kosovarë dhe atyre të regjimit serb. Madje edhe Rusia, këtë herë, e dënoi qartazi masakrën dhe i kërkoi regjimit të Beogradit që ta lejojë hetimin e ekspertëve të Tribunalit Penal Ndërkombëtar. Ka tani një vit, besoj që e dini këtë, se regjimi i Beogradit nuk u lejon ekspertëve të Tribunalit që të zhvillojnë hetime për krimet në Kosovë, ndonëse rezoluta e Këshillit të Sigurimit e obligon për këtë. A thua përse?

Kësodore, të njëjtit policë që i kanë vrarë fshatarët e Reçakut, i kanë dërguar në spitalin e Prishtinës dhe qysh në ditën e parë të autopsisë, « objektiviteti » i mjekëve serbë u shfaq me deklaratën, e cila përsërit konstatimin e zyrtarëve të regjimit: viktimat nuk janë vrarë nga

afërsia. Një muaj pas ekspertizës së tyre, ata kanë shtuar në komunikatën zyrtare se « viktimat nuk janë masakruar, por se me gjasë zogjtë dhe minjtë i kanë prishur fytyrat e tyre ». Ndonëse kufomat kishin qenë të zbuluara disa orë pas krimit.

Ekspertët finlandezë të mjekësisë ligjore, pas autopsisë së 40 kufomave, konstatojnë në raportin e tyre, i publikuar më 16 mars 1999, se « viktimat janë civilë që nuk kanë marrë pjesë në luftime » dhe se « ata nuk kanë qenë të gjymtuar *post mortem* ». Helen Ranta, shefja e kësaj ekipe, e cilëson këtë krim si « krim kundër njerëzimit », duke iu bashkuar kësisoj kualifikimit që kishte bërë OSBE-ja ».

Më lejoni t'ua kujtoj se sipas komunikatës së *Komisariatit të Lartë për Refugjatët* (HCR), i publikuar në Gjenevë më 2 shkurt, më se 45.000 shqiptarë u dëbuan nga shtëpitë e tyre, pas operacioneve të forcave serbe kundër fshatrave të shqiptarëve (të cilësuar si « bastione ») gjatë vetëm muajit janar. Veç kësaj, që nga fillimi i operacioneve ushtarake të regjimit të Beogradit, tani e një vit kanë ndodhur shumë krime të ngjashme (në Prekaz, Obri, Lubeniq, Likoc etj.), siç kanë konstatuar organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe disa prej të cilave janë nga Beogradi (*Komiteti i Helsinkit* i Serbisë dhe *Fondi për të Drejtën Humanitare*). Kësisoj, krimi i Reçakut nuk është një përjashtim. Që nga shkurti i vitit 1998, gati gjysma e fshatrave të Kosovës (400 prej 900 fshatrave) janë shkatërruar qoftë tërësisht, qoftë kanë mbetur shumë të rrënuara. Sipas raporteve të *FIDH* dhe *France-Liberté* midis muajve mars dhe shtator 1998, janë kallur shtëpitë e fshatarëve, banorët shqiptarë të të cilëve u dëbuan gjatë bombardimeve.

Instanca të ndryshme ndërkombëtare (Komisioni i të Drejtave të Njeriut i OKB-së, Parlamenti Evropian, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Kongresi Amerikan etj.) e kanë cilësuar këtë politikë të regjimit të Beogradit si « spastrim etnik », « masakra të popullsisive civile », « politikë e shkatërrimeve » etj. Nga 2000 viktimat e kësaj lufte, më shumë se 80% janë civilë. Më se 300.000 shqiptarë janë dëbuar nga shtëpitë e tyre, sipas Komisarariatit të Lartë të OKB-së për Refugjatët. *Human Right Watch* citon artikullin e Christophe Châtelot në *Le Monde* i 29 janarit, sipas të cilit « që nga shkurti 1988, më se 50 persona u ekzekutuan nga forcat speciale pas arrestimit të tyre. Tani një vit ka 2000 të burgosur politikë të rinj shqiptarë në burgjet e Serbisë. Shtatë të burgosur politikë kanë vdekur nga torturat: « Kjo praktikë është sistematike », sipas shoqatës *Médecins du monde* (cituar nga « Washington Post » i 28 janarit: « Masakra e Reçakut ka qenë e urdhëruar në nivel të lartë nga autoritetet serbe, të cilat pastaj janë orvatur ta

maskojnë atë »). Më kujtohet se dikur, ju keni pas shkruar një libër interesant për torturën e pushtetit kolonial francez në Algjeri. Përballë terrorit sistematik dhe afatgjatë të regjimit serb (që nga viti 1981), shqiptarët kanë zhvilluar një rezistencë politike dhe paqësore. Ky është një fenomen i ri në Ballkan, sipas konstatimeve të shumë analistëve perëndimorë që nuk janë doemos proshqiptarë. Rezistenca e armatosur u paraqit 15 vjet më vonë, gjatë të cilave Kosova ishte në mëshirën e regjimit serb: deklaratat dhe rezolutat që e dënonin këtë terror, Milosheviçit nuk i dukeshin bindëse. Natyrisht që shqiptarët, jo vetëm « rebelët » siç i quani ju (ndoshta mund të quhen « rezistentët ose kryengritësit e armatosur »), por as pacifistët nuk janë « të shenjtë »; do të mund të bëheshin kritika të ndryshme, por këto nuk do të mund ta arsyetonin në asnjë mënyrë praktikën politike të regjimit serb. Faktet janë të dukshme, propaganda nuk po arrin t'i *derealizojë* plotësisht. Një gazetar dhe poet serb, Miodrag Stanisavljeviç, në javoren e Aleancës Qytetare të Serbisë *Republika*, në artikullin « Bestialiteti dhe paftyrësia » shkruan: « Zëdhënësit e regjimit thonë se madje edhe nëse ka të zhvendosur (që është sipas tyre, një shprehje e keqe, ngase duhet të thuhet ata që përkohësisht i kanë braktisur shtëpitë e tyre) kjo nuk është për shkak të luftëtarëve tanë trima, por për faktin se popullsia shqiptare ik nën presionin e sulmeve të terroristëve shqiptarë. Sipas regjimit, terroristët shqiptarë e ndjekin vetë popullsinë e vet me qëllim që t'i satanizojnë serbët ». Do shtoja po ashtu se as rikujtimi i përgjegjësive të Tudjmanit ndaj serbëve nuk do të mund ta zhbënte realitetin e krimeve të Milosheviçit. Ky regjim, siç dihet, ka bërë përpjekje të mëdha për t'i shoqëruar krimet e veta me arsyetimin e tyre cinik. Ju dhe disa nga miqtë tuaj, mendoni se mediet « shumë lehtë i akuzojnë serbët, vetëm serbët, gjithmonë serbët ». Megjithëkëtë, mendoj se mund të pohohet me më shumë argumente se mediet, sikurse edhe kancelaritë, shpesh kanë praktikuar skemat *apriori*, të cilat *barazojnë mekanikisht* përgjegjësitë e aktorëve në këtë luftë; formula « palët ndërluftuese » shpërfill kësisoj një analizë *aposteriori*, e cila do të duhej t'i vërë në pah ngjarjet dhe aksionet *konkrete* të aktorëve. Janë sidomos organizata të shumta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por edhe gazetarët lucidë dhe të guximshëm që kanë ndihmuar që të kuptohet *realiteti i ngjarjeve* përtej skemave komode, të cilat reduktohen në banalitetin e thënies « atje të gjithë janë të këqij ». Sikur të provonim, fjala vjen, të zbatojmë këtë skemë në situatën e Luftës së Dytë Botërore, do të na dilte një imazh i çoroditur për atë tragjedi. Më duhet të shtoj se nuk e kam të qartë as aludimin tuaj të Shqipëria e Madhe. Doni të thoni se politika e regjimit serb do të mund të interpretohej si një luftë kundër « Shqipërisë

së Madhe »? Kjo fantazmë, sa në kokat e disa grupeve vendore, po aq edhe në kokat e perëndimorëve nuk përket me realitetin e ngjarjeve në terren. Problemi qendror, i cili absorbon të gjitha energjitë e shqiptarëve të Kosovës është si të dilet nga një sundim i gjatë dhe i egër. Kërkesa plebishitare e tyre është *pavarësia e Kosovës*. Kjo kërkesë, sipas shumë hulumtuesve perëndimorë (si Noël Malcolm, Roy Gutman, Paul Garde etj.) është së paku po aq legjitime sa ajo e sllovenëve, kroatëve e boshnjakëve dhe maqedonasve për pavarësinë e vendit të tyre. Kjo kërkesë e kosovarëve është në radhë të parë përgjigje ndaj një terrori total të regjimit serb, terror që republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, nuk e kanë përjetuar para luftërave. Por edhe për shkak të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë në njësitë e saj përbërëse, merita kryesore e së cilës i takon, siç e dini, vetë Milosheviçit. Ndonëse kjo nuk është përgjegjësia e tij kryesore: pati edhe shpërbërje të Çekoslovakisë, por kjo nuk u realizua përmes *spastrimit etnik dhe krimeve masive kundër popullsisë civile*, dhe ky nuk ishte faji i gazetarëve. Projektet për ndërtimin e shteteve-kombe, në kuptimin që i jepet në Evropën Lindore, ku kufijtë duhej të përputheshin me shumicën apo me të gjithë pjesëtarët e një populli i takojnë historisë politike të Ballkanit. Megjithatë, e sidomos tani pas dështimit të projekteve për një Serbi të Madhe, si dhe për një Kroaci të Madhe, asnjë parti politike serioze në Kosovë e në Shqipëri nuk e kultivon këtë synim. Nëse Serbia, me gjithë potencialin e fuqishëm ushtarak dhe mbështetjen ndërkombëtare që kishte, nuk e realizoi këtë projekt, si mund të supozojmë që shqiptarët do ta realizonin atë projekt: ata nuk kanë as fuqinë ushtarake e as nuk mund të shpresojnë se do të mund të kishin ndonjë mbështetje për këtë projekt. Megjithatë, ajo që është e sigurt është se propaganda e regjimit të Beogradit rregullisht e aktivizon këtë supozim para perëndimorëve për ta *diskualifikuar* kërkesën e Kosovës për pavarësi. Në anën tjetër, t’jua rikujtoj se përfaqësuesi politik i UÇK-së, z. Adem Demaçi, i burgosur politik gjatë 28 vjetëve, fitues i çmimit Saharov i Parlamentit Evropian, zhvilloi para dy vjetësh, në një dokument, projektin embrionar të një Konfederate Ballkanike (« Ballkania »), e përbërë nga Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, së cilës do të mund t’i bashkoheshin edhe Bosnja dhe Maqedonia. Mirëpo ky projekt nuk pati ndonjë jehonë të rëndësishme.

Ajo që është e çuditshme, është se përballë kësaj politike prej më shumë se një decenie të terrorit sistematik, të aparteidit në Evropë dhe spastrimit etnik të Kosovës nga regjimi serb, ju si historian i madh nuk keni bërë as përpjekjen më të vogël për të reaguuar, sa e di unë ».

Mirëpo, të gjitha supozimet dhe parashikimet e historianit Vidal-Naquet dolën të gabuara. Në realitet, intervenimi ajror i NATO-s që zgjati vetëm tre muaj arriti t'i realizojë të gjitha objektivat e definuara: regjimi i Beogradit u godit në mënyrë shumë efikase në pikat e tij strategjike; edhe vetëm paralajmërimi gojor se trupat tokësore amerikane po përgatiten për intervenim tokësor, mjaftoi për t'ia hequr të gjitha hezitimet Milosheviçit: ai nënshkroi kapitullimin, Kosova u çlirua nga Serbia dhe afro 1 milion shqiptarë u kthyen në vendin e tyre në radhë të parë në saje të intervenimit të NATO-s!

Kontestimi i mohimit të krimit nga Beogradi

Më 23 qershor 2001 botuam bashkë me sociologen Véronique Nahoum-Grappe, filozofin Alain Brossat dhe politologun Jean-Yves Potel në të përditshmen prestigjioze *Le Monde* artikullin me titull « Krime dhe mohime: Beogradi po lëviz ». ¹³ (*Crimes et dénis: Belgrade bouge*).

Në fillim të këtij artikulli kemi cekur se shtypi dhe autoritetet e Beogradit janë duke dhënë këto ditë informata të sakta sa i takon mënyrës se si, madje edhe para ndërhyrjes së NATO-s, autoritetet më të larta politike dhe ushtarake serbe kishin planifikuar *zhdukjen mëto-dike* të trupave dhe viktimave të masakrave etnike. Këto fakte ishin denoncuar në opinionin publik edhe më parë nga gazetari Miroslav Filipoviç (i cili u dënua me 7 vjet burg nga regjimi i Milosheviçit për këto shkrime) e njëherazi qenë konfirmuar nga hetuesit e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në vitet 1999 dhe 2000. Këta nxorën në shesh vendimin dhe organizimin konkret për *fshirjen metodike të gjurmëve të krimeve* të kryera nga ushtarakët dhe paramilitarët serbë në Kosovë; e tani këto të dhëna publikohen nga vetë shteti serb.

Ky denoncim është padyshim një mënyrë për ta përgatitur opinionin, i cili është ende nën ndikimin tragjik të propagandës së luftës që të pajtohen me nevojën për një proces gjyqësor të mirëfilltë kundër Milosheviçit, e madje edhe transferimin e tij në Hagë.

Duke evokuar zbulimin e një kamioni-frigorifer me 83 kufoma të grave, fëmijëve, pleqve dhe disa njerëzve me uniforma të UÇK-së, javorja « NIN » e Beogradit, më 7 qershor, citon ministrin e Punëve të Brendshme të Serbisë, Dushan Mihajloviç, në një konferencë për medie: « Në saje të informatave të konfirmuara që i kemi mbledhur kufomat e kamionit-frigorifer, i cili u nxor nga thellësitë e Danubit, nuk janë të vetmet, ngase

¹³ *Le Monde*, 23 qershor, Paris.

janë zbuluar edhe viktimat të tjera. E gjithë kjo është monstruoze. Ata në mënyrë sistematike zhvarrosnin kufomat në Kosovë».

Dhe ky person, i cili sipas funksionit që ka, është fort mirë i informuar për këto praktika, vazhdon: « Është fjala këtu për krime që janë fshehur sistematikisht. Kemi vështirësi për t'i mbledhur të dhënat. Do të jap një fakt që e ilustron këtë situatë: ka pasur edhe trupa që janë varrosur nën një autostradë. Tani po punojmë në mbledhjen e fakteve për Tribunalin. Indicie serioze na shtojnë të mendojmë se me rastin e një mbledhjeje të organizuar nga Milosheviçi, në mars të vitit 1999, ishte marrë vendimi për « sanimin e terrenit », gjë që do të thotë se është marrë vendimi të eliminohen të gjitha viktimat që kanë mundur ta zgjojnë interesimin e hetuesve të Tribunalit Penal Ndërkombëtar. Kjo detyrë i ishte caktuar ministrit të Punëve të Brendshme Vlastimir Djordjeviç, i cili ia barti këtë detyrë ndihmësit të vet gjeneralit Vlastimir Djordjeviç dhe shefit të policisë kriminale Iliç. Në këtë mënyrë është realizuar largimi i kufomave të viktimave të dhunës në Kosovë ». Është fjala këtu për çaste në të cilat në opinionin publik shpërthejnë të dhëna, rrëfime e pranime nga zyrtarët e regjimit, të cilët ka mbetur një grimë ndërgjegje morale: Mihajloviç tha në këtë konferencë se ditë të tëra nuk ka mundur të flinte kur i ka zbuluar këto fakte.

Të njëjtën ditë javorja « Vreme » duke i komentuar të njëjtat informata, shtonte se kufomat që janë gjetur në kamionin-frigorifer, mbanin gjurmë të torturave dhe përfundonte: « Ky është vetëm njëri nga rastet në të cilin shihet se si janë orvatur qëllimisht t'i fshehin gjurmët e krimeve të bëra në Kosovë ».

Më 9 qershor, gazeta « Glas javnosti » theksonte se gjenerali Djordjeviç, të cilin e akuzoi ministri i Punëve të Brendshme, iku dhe u strehua në Moskë. Këto informata konfirmojnë, edhe një herë, karakterin e jashtëzakonshëm të krimeve të bëra në ish-Jugosllavi në suaza të operacioneve të spastrimit etnik: obsesioni i fshirjes së gjurmëve, pas operacionit të ndarjes së gjakrave, pas atij të « spastrimit » të territorit, që janë shenja të kimit neototalitar. Beteja rreth vlerësimit të shifrave, e cila duhej të propozonte një shkallë të pranueshmërisë së krimeve do të bazohet mbi vendosjen e raporteve të numrit të të zhdukurve, nga numri i trupave të gjetur në varreza masive dhe tërësia e dëshmimeve të mbledhura në mënyrë të besueshme, do të trajtohet nga historianët e ardhshëm. Ata do të mund të përfitojnë nga puna profesionale e policëve dhe hetuesve gjyqësorë të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.¹⁴

¹⁴ Shih më hollësisht në librin tim *Cështja e Kosovës në hapësirën publike të Francës*, ASHAK, 2021.

Teki Kurti

MASAKRAT SERBE NË KOSOVË SIPAS MEDIEVE NDËRKOMBËTARE (1998-1999)

Abstrakt

Mediet ndërkombëtare vënë në dukje se rebelimi i shqiptarëve të Kosovës filloi të mobilizohej në mbrojtje të etnisë së vet pas vitit 1988, vit kur presidenti i Serbisë Milosheviçi tërhoqi autonominë e Kosovës.

Represioni serb filloi me pushimin nga puna të shqiptarëve në organet shtetërore dhe ndërmarrjet publike, si dhe mësuesit e fëmijët shqiptarë u ndanë nga nxënësit dhe mësuesit serbë.

Rezistenca paqësore e shqiptarëve të Kosovës ndaj masakrave të autoriteteve serbe nga viti 1989-1995 u shndërrua në vetëmbrojtje të armatosur, nga e cila më pas u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Vitet 1998-1999 janë dhe vitet e krimeve masive të regjimit ushtarak serb mbi popullsinë e Kosovës.

Mizoritë e panumërta të kryera nga policia, grupet paraushtarake dhe ushtria kundër shqiptarëve krijoi valë të vazhdueshme refugjatësh, situatë që u bë e njohur në mbarë botën nga mediet ndërkombëtare.

Mediet publikuan para opinionit botëror ofensivën masive të qeverisë serbe dhe jugosllave në Kosovë, e cila filloi katër ditë para se NATO-ja të niste bombardimin ndaj Serbisë me motivacionin për shpërngulje me forcë nga trojet e veta të më shumë se 850.000 shqiptarëve etnikë.

Sipas mediave ndërkombëtare masakrat serbe ndaj shqiptarëve kishin tri motive të qarta:

Së pari, procesi i spastrimit etnik.

Së dyti, vrasja dhe asgjësimi i luftëtarëve të UÇK-së dhe atyre që i ndihmonin ata.

Së treti, masakra për hakmarrje. Tregues domethënës është masakra e Reçakut ndaj grave, fëmijëve e burrave, të cilët i vranë e më pas u gjymtuan trupat. Ambasadori Ulliam Uoker atë kohë u shpreh: *“Nuk ngurroj ta përshkruaj ngjarjen si masakër, krim kundër njerëzimit.”*

Fjalët çelës: masakrat, mediat ndërkombëtare, civilët shqiptarë, NATO, lufta.

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vuri në lëvizje diplomacinë ndërkombëtare në të gjithë Evropën, ashtu edhe në ShBA, duke aktivizuar forcat e NATO-s për të ndërhyrë për çlirimin e popullit kosovar. Mediet ndërkombëtare dhe kryesisht ato të vendeve demokratike kanë ndjekur me vëmendje dhe kanë shkruar për masakrat serbe në Kosovë që në mars-prill 1981, kur kërkesat e shqiptarëve për liri e të drejta demokratike, për marrjen e Statusit të Republikës u shtypën me dhunë policore e me tanket e dërguara nga Beogradi, gjë që shkaktoi gjakderdhje. Mediet nënvizojnë gjithashtu edhe faktin se, Beogradi me ushtri dhe tanke në vitin 1989, si dhe me amendamente antikushtetuese i reduktoi Kosovës edhe autonominë që i siguronte Kushtetuta e vitit 1974.

Mediet theksojnë se shqiptarët revoltën e tyre e shprehën në mënyrë paqësore me një referendum për Republikë të pavarur. Media franceze (*Perspective Monde*)¹ vinte në dukje faktin se dhuna dhe gjenocidi serb kundër shqiptarët u bënë të padurueshme dhe në skenë doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës. “Serbia reagoi duke intensifikuar ndërhyrjen e saj. Qindra mijëra shqiptarë marrin rrugën e mërgimit, dhuna arriti një kulm të ri”, theksonte ajo.²

Shtypi francez në faqet e tij të datës 30 mars 1998³, duke cituar Muhamedin Kullashi-n, shkruan se: Beogradi ka refuzuar iniciativat e diplomatëve evropianë dhe amerikanë për hapjen e dialogut për çështjen e Kosovës dhe se përdorimi sistematik i represionit tregon që Milosheviçi nuk e ka braktisur projektin e spastrimit etnik. Shkrimi mbyllet me indinjatën që “si ka mundësi që të habitet dikush për zgjedhjen e rezistencës së armatosur të shqiptarëve të Kosovës kur ky pitbull Milosheviçi edhe me kokën e prerë nuk e lëshon kockën e tij të përgjakur”.

Edhe shtypi kanadez vlerëson se nuk duhet të ketë dyshim që problemi vjen nga Beogradi dhe çështjen e Kosovës e quan si “çështje ekskluzivisht serbe”⁴. Pra kjo qasje e shtypit kanadez vjen si rezultat i mosnjohjes së historisë së zhvillimeve politike dhe problemit të çështjes së Kosovës.

Ndërsa disa medie të Greqisë në analizën që i bëjnë këtyre ngjarjeve, nënvizojnë se 24 marsi i vitit 1999 që lidhet me sulmet ajrore të NATO-s kundër pozicioneve ushtarake serbe është “operacioni i parë

¹ *Perspective Monde*, 1 shkurt 1998.

² Po aty.

³ *Liberation* (Francë), 30 mars 1998, p.8.

⁴ *Le Devoir* (Quebec, Kanada), 17 mars 1998, f.8

ushtarak kundër një shteti sovran që erdhi si përgjigje ndaj një vale të re spastrimi etnik të nisur nga forcat serbe kundër shqiptarëve.”⁵

Në kundërshtim me faktet historike artikullshkruesi e cilëson Kosovën me tone të njëanshme duke vlerësuar se “Rajoni i Kosovës ishte në mesjetë, zemra e Serbisë”. Pra, kjo referencë vjen si rezultat i ndikimit dhe miqësisë së hershme në mes të Serbisë dhe Greqisë.

Gjithashtu, shkrimi mundohet të justifikojë represionin serb ndaj shqiptarëve si kundërsulm ndaj aksioneve të UÇK-së, të cilët me blerjen e armëve nga Shqipëria shtuan sulmet ndaj policisë dhe ushtrisë serbe. Shkrimi e vë theksin në vitin 1998, ku UÇK-ja nisi sulmet në gjithë hapësirën e Kosovës duke marrë kontrollin gati në gjysmën e saj.

Kurse media kroate⁶ akuzon hapur Serbinë si shtet organizator i krimeve në Kosovë. Kështu për krimin monstruoz të 26 marsit 1999 të ndodhur në Suharekë ku u masakruan 48 persona, shkrimi akuzon Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Aty jepen të dhëna nga gjyqi i Hagës ku pranohet hapur se shqiptarët ishin civilë dhe nuk kanë qëlluar ndaj serbëve. Nga dëshmitë e të akuzuarve vihet në dukje se spastrimi etnik ishte krim i organizuar nga shteti.

Disa medie ngrënë dyshime për numrin e viktimave të raportuara nga NATO-ja.

Kështu, sipas “La Republica” italiane thuhet se, shifra njëmbëdhjetë mijë e deklaruar nga NATO-ja, mund të jetë mashtrim për të justifikuar luftën. Po sipas kësaj medie, mbështetur te vullnetarët e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, të cilët kanë grumbulluar dëshmi për krimet e kryera gjatë dhe pas luftës, rezulton se: “forcat serbe kanë vepruar me synimin për t’i shpëtuar më pas një gjyqi ndërkombëtar. Kamuflojnë uniformat e tyre, shpërndanin kufomat e të vrarëve.” Shkurt serbët u kujdesën për të fshehur krimet dhe përgjegjësitë.⁷ Forcat paramilitare u punësuan për reprezaljet më brutale: ku gjakoseshin trupa të gjymtuar të civilëve shqiptarë. Pra ky medium italian ngrë alarmin se vetë shteti serb i ka përgatitur dhe paguar forcat paramilitare për të ushtruar dhunë e terror ndaj popullsisë shqiptare.

⁵ Sansimera, <https://www.sansimera.gr/articles/1463>.

⁶ <https://zencrnom.org/sr/kampanje-i-koalicije/32-zenska-mirovna-koalicija/369-od-organizovanog-zlocina-do-organiovane-lazi>.

⁷ La Republica (1999), Kosovo, le fosse dell’orrore fanno paura all’occidente, <https://www.repubblica.it/online/mondo/fossa/fossa/fossa.html> .

Media italiane jep të dhëna për 7000-8000 shqiptarë të masakruar e të zhdukur gjatë luftës.⁸ Po kjo medie ka konstatuar se Milosheviçi kishte marrë peng rreth 1800 shqiptarë, të cilët nuk i dorëzonte pasi frikësohej nga dëshmitë e tyre, pra nga ajo që ata dinin dhe kishin parë.

Masakrat serbe në Kosovë, njoftojnë mediet, nuk kishin të sosur. Kështu mijëra shqiptarë u ndoqën përtej kufirit, djegia e shtëpive dhe dokumentet e identitetit kanë për t'i shkatërruar e për t'i shpërndarë, pra do të çrrënjoset një grup njerëzor që në jurisprudencë quhet gjenocid, konstatojnë mediet italiane.

Media britanike kur trajton masakrat serbe në Kosovë fokusohet në shumë drejtime, por në detaje trajton masakrën e Reçakut, si një rast të veçantë që ofron mundësinë për të analizuar në thellësi ndikimin që ka raportimi i medieve mbi faktorët politikë, me peshë për zgjidhjen e krizave ndërkombëtare.⁹

Duke iu referuar ambasadorit të misionit verifikues të OSBE-së, William Wolker-it, mediet nënvizojnë faktin se, ai, menjëherë pasi vizitoi vendin e masakrës, e quan masakrën “krim kundër njerëzimit”.¹⁰

Media britanike ironizon dhe medien serbe që kontrollohet nga Beogradi, e cila kërkon që krime të tilla t'i propagandojë si rezultat i luftës së forcave të sigurisë dhe “terroristëve”, ndërsa gjymtimi i kufomave kishte të bënte me një komplot të ndërtuar nga UÇK-ja në përpjekje për të diskredituar Serbinë.

Media britanike jep fakte rrëqethëse rreth masakrës së kryer nga grupi “Çakallët” në fshatin Qyshk në vitin 1999. Shkrimi nënvizon faktin se, serbët mblodhën banorët, fëmijë, gra dhe burra dhe pasi i ndanë meshkujt, i mbyllën në shtëpi, i qëlluan me armë dhe ua vunë zjarrin duke djegur trupat e tyre.

Për masakrën e Reçakut kanë shkruar edhe dhjetëra medie nga e gjithë bota demokratike, të cilat u referohen drejtpërdrejt korrespondentëve të BBC-së e të CNN-it në terren, të cilët vëzhguan nga afër këtë masakër çnjerëzore.

Sipas korrespondentëve të CNN-it pas deklaratës shokuese të William Wolker-it, si ish- kreu i misionit monitorues, e cila i kushtoi shtrenjtë, Beogradi urdhëroi largimin e tij nga vendi, ndërsa i gjithë ekipi i OSBE-së ishte i shënjestruar e nën vëzhgim.

⁸ Po aty.

⁹ <https://reliefweb.int/report/serbia/fear-and-loathing-belgrade-what-serbian-state-media-say-about-kosovars>.

¹⁰ Po aty.

Pamjet që transmetuan mediet nga terreni tronditën gjithë opinionin botëror. CNN-i nënvizoi faktin se Presidenti i SHBA, Bill Clinton, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana dënuan vrasjet çnjerëzore ndaj civilëve shqiptarë.

Britania kërkoi një takim të Grupit të Kontaktit gjashtë vendesh për Jugosllavinë, që të diskutonte masakrën e fundit të 45 shqiptarëve etnikë në provincën e Kosovës, duke iu referuar këtu CNN-it që publikon deklaratën zyrtare të Sekretarit të Jashtëm, Robin Cook.¹¹

Për masakrat serbe në Kosovë një rol të veçantë në informimin e opinionit botëror kanë luajtur edhe njoftimet e herëpashershme në median *online* të Organizatës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut. Ajo e informonte publikun mbi ndryshimet që ndodhnin në aparatin e sigurimit dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, gjë që tregonte se Serbia po përgatitej për ofensivë. Ajo jep të dhëna për aksionet e policisë, ushtrisë dhe armatosjen e civilëve serbë etnikë.

Media shkruan për aksionet përreth Vushtrrisë dhe Podujevës që filluan në fund të shkurtit dhe vazhduan gjatë marsit. Ajo vë në dukje se periudha e bombardimeve të NATO-s shënoi sulme të papara kundër civilëve dhe shpërnguljen me forcë të më shumë se 850.000 shqiptarëve etnikë nga Kosova.

Shkrimi nënvizon faktin që luftimet u zhvendosën nga zonat fshatare në ato qytetare dhe se Slobodan Milosheviçi, duke përfitur nga bombardimet, mendoi të shtypte UÇK-në dhe bazat e tyre në popull¹² si dhe të shpërngulte me forcë një pjesë të mirë të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Media duke u mbështetur te të dhënat e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), publikon shifra tronditëse, kur në harkun kohor prej tre javësh u shpërngulën nga Kosova 525 787 refugjatë, të cilët u vendosën në vendet fqinje. Në total shifra arriti 862 979 shqiptarë të larguar dhe mijëra të tjerë të zhvendosur brenda Kosovës.

Informacioni jep të dhëna për masakrat e shumta ndaj civilëve sidomos në ato zona, të cilat ishin të njohura për lidhje e mbështetje të veçantë ndaj UÇK-së, si komunat e Glllogocit e Skënderajt në krahinën

¹¹ CNN (1999) "Britain calls for urgent meeting on Kosovo massacre" <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9901/18/kosovo.reax.01/index.html> .

¹² Sipas Human Rights Watch, <https://www.hrw.org/legacy/albanian/kosovo2001/summary.pdf> .

e Drenicës. Po ashtu flitet për vrasje masive, shpërngulje me forcë dhe shkatërrim pasurie për komunat jugperëndimore të Gjakovës, Raho-vecit dhe Suharekës, si baza të UÇK-së. Komuna e Pejës dhe Lipjanit që kishin jo pak serbë ishin piketuar për shpërnguljen masive të shqiptarëve etnikë. Po ashtu shkrimi vazhdon të pasqyrojë edhe vrasjet e shumta në zonën e Sllovisë, Ribarit, Lubeniqit, Qyshkut dhe qytetit të Pejës.

Media nënvizon faktin që vrasjet ishin të mirëplanifikuara për të terrorizuar popullsinë që të largohej nga Kosova. Shkrimi trajton edhe faktin që në komunën e Istogut pati shpërngulje masive të shqiptarëve vendas drejt Malit të Zi, të nxitura nga djegia dhe grabitja e shtëpive të tyre.

Në Istog ndodhi një ndër ngjarjet më të përgjakshme të luftës, ku forcat serbe vranë në maj të vitit 1999 më shumë se 90 shqiptarë etnikë të burgosur në Burgun e Dubravës. Qytete të mëdha u “spastruan” duke përdorur autobusë, trenat dhe karvanë të gjatë traktorësh që u drejtoshin kufijve.

Human Rights Watch dokumentoi praktikën e njohur të “spastrimit të identitetit”: refugjatëve shpesh u merreshin dokumentet e identifikimit dhe u hiqnin targat e makinave e traktorëve para se të kalonin kufirin.

Kështu, në këtë mënyrë serbët synonin të ndryshonin demografinë e Kosovës gjë që të çonte në ndarjen e Kosovës në dy pjesë, një për serbët dhe një për shqiptarët. Së dyti, serbët me shpërnguljen, mendonin të destabilizonin dy vendet fqinje Shqipërinë dhe Maqedoninë. Së treti, serbët synonin që të pengonin një sulm të NATO-s nga toka.

Human Right Watch, duke analizuar vrasjet e civilëve, konkludon se ato kishin tre motive të qarta:

1 - Përshpejtimi i procesit të “spastrimit” nëpërmjet kërcënimit dhe frikës;

2 - Eliminimi i UÇK-së. Udhëheqësve politikë, aktivistëve të të drejtave të njeriut, biznesmenë etj.

3 - Vrasje për hakmarrje ndaj humbjeve që pësuan prej UÇK-së.

Në këtë luftë për liri të shqiptarëve etnikë bien në sy, që në njërën anë, ishte NATO-ja e shqiptarët, nga ana tjetër, serbët, dhe të paidentifikuar ndoshta për një periudhë, Rusia dhe Kina.

Por, njëkohësisht nga vargu i informacioneve nga të katër anët, rezulton dhe një qendër tjetër lufte, ajo mediatike, e cila kishte dhe ka si synim të sundimin e opinionit publik ndërkombëtar. “Lufta mediatike bëhet me fjalë ose më mirë me interpretime dhe ‘vlerësime’ të fakteve që kanë ndodhur”.¹³

Si përfundim, konkludojmë, që roli i medias ndërkombëtare ka qenë i jashtëzakonshëm në informimin e opinionit botëror rreth masakrave serbe ndaj popullsisë civile të shqiptarëve të Kosovës. Në këtë kuadër konstatojmë se kishte edhe medie të njëanshme që nga mosnjohja ose për qëllime të caktuara ishin vënë në krah të demagogjisë dhe makinerisë vrastare serbe.

Mund të themi me bindje të plotë, që ishte media ajo që vuri në lëvizje organizatat më të fuqishme të botës, si OSBE-ë, Organizatën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Këshillin e Sigurimit, të gjitha kancelaritë evropiane, e mbi të gjitha ShBA-ë, që udhëhoqën organizatën më të fuqishme politiko-ushtarake të botës, NATO-n në mbështetje të popullsisë së pambrojtur të Kosovës ku bashkë me UÇK-në dhe elitën kosovare, çliruan dhe themeluan ëndrrën e brezave të tërë, Republikën e Lirë të Kosovës.

¹³ Limes(2000), La Guerra Dei Media: Come contare i morti in Kosov?, <https://www.limesonline.com/cartaceo/la-guerra-dei-media-come-contare-i-morti-in-Kosovo>.

Ismet Salihu

MASAKRAT E FORCAVE SERBE NË KOSOVË DHE PERSONAT E ZHDUKUR 1998-1999

Abstrakt

- Suprimimi i autonomisë së Kosovës në mënyrë kundërkushtetuese në mars të vitit 1989;
- Kundërshtimi dhe rezistenca e popullatës shumicë shqiptare ndaj suprimimit të autonomisë së Kosovës;
- Instalimi i regjimit të apartedit ndaj popullatës shumicë të Kosovës nga regjimi i Beogradit;
- Rezistenca paqësore e shqiptarëve ndaj regjimit të apartheitit të instaluar nga regjimi i Serbisë;
- Ndërtimi i sistemit paralel në sferën e arsimit, shkencës, kulturës, ekonomisë, si dhe formimit të celulave të para të rezistencës së armatosur;
- Formimi i celulave të para të UÇK-ës në fillim të vitit 1977 dhe lufta e armatosur e UÇK-ës gjatë vitit 1988 deri më 12 qershor 1999.
- Krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit ndaj popullatës civile shqiptare nga forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe ndaj popullatës civile shqiptare;
- Gjenocidi i forcave serbe ndaj popullatës shqiptare;
- Masakrat e forcave serbe ndaj popullatës shqiptare pothuaj në të gjitha trevat e Kosovës me elemente substancionale të krimit të gjenocidit;
- Regjionet e Kosovës ku janë kryer masakrat më të mëdha nga forcat serbe
- Metodatat naziste, fashiste për evitimin, fshehjen dhe zhdukjen e gjurmëve të krimeve, e sidomos të masakrave të kryera nga forcat serbe;
- Si rrjedhojë e veprimeve të forcave serbe me qëllim të zhdukjes së provave të krimeve serbe, e sidomos të masakrave, menjëherë pas luftës, në Kosovë janë evidentuar 6200 persona të zhdukur.
- Lokacionet ku deri më tani është gjetur numri më i madh i mbetjeve mortore të shqiptarëve të vrarë;
- Angazhimi i deritashëm i vendorëve dhe ndërkombëtarëve në gjetjen e personave të zhdukur
- Përjetimi dhe ankthi i familjarëve të personave të zhdukur.

Fjalët çelës: masakrat, Kosova, personat e zhdukur, forcat serbe, UÇK.

1. Statusi i popullsisë civile gjatë luftës sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacioneve nacionale

1. Me konventat më relevante ndërkombëtare, si dhe me ligjet nacionale popullsia civile gjatë kohës së luftë konsiderohet e tërë ajo popullsi që nuk është e angazhuar në luftë. Sipas këtyre konventave dhe legjislacioneve nacionale popullsia civile është e mbrojtur dhe çdo vrasje, keqtrajtim dhe krime të tjera, konsiderohen krime të luftës dhe si të tilla janë të ndëshkuara me të drejtën penale ndërkombëtare dhe me të drejtat penale nacionale. Megjithëkëtë, forcat policore, ushtarake dhe *paramilitare* gjatë viteve 1998 dhe 1999 numrin më të madh të krimeve të luftës, krime kundër njerëzimit dhe krime të gjenocidit e kanë kryer pikërisht ndaj popullatës civile shqiptare. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe të luftës forcat serbe në mënyrën më barbare dhe fashiste të mentalitetit nazist krimet më të shumta dhe bestiale i kanë kryer pikërisht ndaj popullsisë civile, madje edhe ndaj femrave, të moshuarve dhe fëmijëve. Llogaritet se gjatë luftës forcat serbe kanë vrarë rreth 12.000 persona, pjesëtarë të popullsisë civile. Në mesin e kësaj popullsie civile, kanë vrarë 1. 271 fëmijë, madje edhe foshnje. Në mesin e këtyre fëmijëve të vrarë, edhe sot e kësaj dite 136 fëmijë janë të pagjetur.¹

2. Masakrat e forcave serbe ndaj popullatës civile shqiptare

Një numër i konsiderueshëm i viktimave të popullatës shqiptare janë vrarë në masakrat e forcave serbe anë e mbanë Kosovës, por më së tepërmi në regjionin e Drenicës dhe të Dukagjinit. Unë me këtë rast po e prezantoj shkurtimisht masakrën e forcave serbe në fshatin Pastasel të komunës së Rahovecit, duke cekur vendin dhe kohën e disa prej masakrave më të mëdha, më të llahtarshme ku forcat serbe në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend vranë madje edhe më shumë se 100 shqiptarë të pafajshëm.

3. Masakrat serbe ndaj popullatës civile në fshatin Pastasel të komunës së Rahovecit më 31 mars 1999

Më 31 mars të vitit 1999 forcat serbe rrethuan fshatin Pastasel të komunës së Rahovecit. Aty 120 pjesëtarë të forcave serbe i ndanë gratë

¹ Jusuf Osmani, Krimet e Serbisë në Kosovë (1998 – 1999, Prishtinë 2012, f. 60-90.

dhe fëmijët nga burrat dhe i urdhëruan të gjitha gjësendet, e sidomos paratë t'ua dorëzojnë policëve serbë. Pastaj i rreshtuan dhe i afruan afër një përroit dhe i pushkatuan menjëherë 15 veta. Pas disa minutave e urdhëruan grupin e dytë që gjithashtu të shkojnë afër përroit dhe me ironi u thanë se edhe ju do të notoni në këtë përrua që ishte plot me ujë dhe i pushkatuan. Kësisoj nga 119 burra të ndaluar, 106 nga ta i pushkatuan. Prej 106 të pushkatuarve 2 të vranë i hodhën në bunar. Nga 106 të pushkatuarit edhe sot e kësaj dite, 6 janë të pagjetur, ndërsa pesë persona të tjerë nuk ka qenë e mundur të identifikohen nga se kanë qenë tërësisht të djegur dhe janë gjetur vetëm eshtrat e tyre të karbonizuar.

Përveç kësaj masakre, forcat serbe vazhduan pushkatimin e shqiptarëve edhe në pjesë të tjera të fshatit. Menjëherë pas kësaj masakre, forcat serbe trupat e të pushkatuarve i dogjën. Pas kësaj masakre dhe pushkatimeve të mëpastajme të personave të tjerë të fshatit, forcat serbe ia vunë zjarrin, i dogjën pothuaj të gjitha shtëpitë e këtij fshati.²

Masakra të këtilla u kryen: në Abri të Epërme të Drenasit ku më 26 shtator 1998 u vranë e u masakruan 26 anëtarë të familjes Deliu, prej tyre 10 fëmijë; masakra e Qirezit dhe Likoshanit më 28 shkurt 1998, ku u vranë dhe u masakruan 24 civilë shqiptarë; masakra e familjes Deliu më 26 shtator 1998, ku u vranë dhe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu, shumica prej tyre gra, fëmijë dhe pleq; masakra e Reçakut më 15 janar 1999 ku u vranë dhe masakruan 42 banorë civilë shqiptarë; masakra në fshatin Rakovinë të komunës së Gjakovës e kryer më 24 maj 1999, ku vra i ati, me gruan dhe 3 fëmijët; masakra në lagjen "Dardania" ku më 27 mars u vranë 40 veta; masakra në *Krushë të Madhe* më 26 mars 1999 ku u vranë e u masakruan 243 civilë, 64 prej të cilëve edhe sot e kësaj dite janë të pagjetur; masakra në *Krushë të Vogël* e kryer më 25 dhe 26 mars 1999 ku u vranë dhe masakruan 113 banorë të këtij fshati; masakra më 26 mars 1999 në Suharekë ndaj familjes Berisha dhe të tjerë ku u vranë 48 banorë civilë; masakra në burgun e Dubravës gjatë bombardimit të NATO-s, ku në mënyrë barbare forcat serbe vranë 130 të burgosur shqiptarë. Krahas vrasjes së banorëve të *Krushës së Vogël*, forcat serbe ia vunë zjarrin dhe i dogjën 145 shtëpi, vetëm 8 shtëpi i shpëtuan zjarrit: masakra e Celinës më 25 dhe 26 mars 1999 ku u keqtrajtuat dhe u vranë 82 civilë, prej tyre 7 gra

² Shkodran Imeraj, Masakra serbe në fshatin Pastasel të komunës së Rahovecit, vepër në dorëshkrim, fq.66.

dhe 11 fëmijë të moshës 2 deri 4 vjeç; masakra e Mejes dhe Korenicë ku u vranë 376 veta.³

Llogaritet se në tërë Kosovën gjatë viti 1998 dhe 1999 janë kryer më tepër se 100 masakra. Studiuesi Jusuf Osmani, në veprën e tij *Krimet serbe në Kosovë*, në faqet 64 – 74 e cek vendin, datën dhe numrin e 103 masakrave të kryera në mbarë territorin e Kosovës gjatë vitit 1998-1999.

Andaj është e pamundur që në këtë prezantim të prezantohen të gjitha masakrat e forcave serbe të kryera gjatë vitit 1998 dhe 1999.

Mirëpo duhet theksuar se regjimi i Serbisë, masakrat dhe vrasjen masive të shqiptarëve e ka pasur politikë sistematike edhe gjatë tërë shekullit XX, që nga viti 1912, ku brenda ditës ose javës, ka masakruar dhe vrarë me qindra apo edhe me mijëra shqiptarë të Kosovës. Kështu për shembull në 10 e 11 janar të vitit 1921, në brezin kufitar me Serbinë, në fshatin *Prapashticë dhe Keçekollë*, brenda 48 orëve forcat serbe në mënyrë mizore i vranë dhe i masakruan 1530 civilë shqiptarë, pa dallim moshe e gjinie, që nga foshnjat deri te të moshuarit më shumë se tetëdhjetë vjet. Është gjithashtu e tmerrshme masakra e Tivarit e kryer me 16, 24 dhe 27 mars të vitit 1945 ku u vranë dhe u masakruan rreth 1700 shqiptarë, trupat e të cilëve u zhvendosën në vende të tjera, për t'i zhdukur gjurmët e krimeve.⁴

Komponent tejet makabër, i trishtë dhe jashtëzakonisht i tmerrshëm është vrasja e fëmijëve. Siç u cek më sipër, gjatë vitit 1998-1999 forcat serbe kanë vrarë 1271 fëmijë. Ka pasur raste që fëmijë janë vrarë në prani të prindërve dhe të afërmeve të tyre, e pastaj janë vrarë edhe prindërit. Duhet cekur se vrasja e fëmijëve nuk është e episodike por sistematike. Një grua shqiptare e ka dëgjuar paramilitarin serb duke thënë; po citoj “duhet të vriten të gjithë fëmijët, sepse këta, nëse rriten, do të hakmerren.”⁵

Njëri nga shovinistët dhe udhëheqës i lartë politik i Serbisë, në një prononcim të tij lidhur me përbërjen etnike shqiptare të Kosovës dhe ndryshimin e saj, në vitet 1930 thotë, po citojmë: “ atë që mund ta ndryshojmë përbërjen etnike në luftë për 40 ditë, në paqe nuk mund ta arrijmë për 40 vjet.” Duke e zbatuar këtë koncept pastrimin etnik, vrasjet dhe masakrat masovike kanë qenë një ndër metodat tipike të cilat regjimi i Serbisë i ka përdorur ndaj shqiptarëve të Kosovës sidomos

³ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë...*, f. 64.

⁴ Fitnete Ramosaj, *Kundër harresës, Prishtinë*, f. 34-40.

⁵ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë...* 47.

gjatë luftës së viteve 1912-18, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë luftës së fundit të vitit 1998 – 1999.

4. Varrezat masive të të vrarëve shqiptarë nga forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe

Me qëllim që t'i humbnin, t'i asgjësonin gjurmët e krimeve, e sidomos të masakrave ndaj shqiptarëve, forcat serbe hapën varreza masive në territorin e Kosovës dhe të Serbisë ku i varrosën me qindra e mijëra trupa të shqiptarëve të vrarë. Këso varreza masive u hapën për të vrarët në masakrat në Gjakovë, Izbicë, Krushë të madhe, Krushë të Vogël, Suharekë, Poklek, Kotlinë, Pastasel etj. Varreza masive u hapën edhe në territorin e Serbisë në poligonin e Njësisë Speciale Anti-terroriste të MUP-it të Serbisë në Batajnicë, Bajna Bashtë, në Petrovo Sello, në Rashkë, në Rudnicë dhe në lokacione të tjera të Serbisë. Deri në vitin 2018 në territorin e Kosovës janë zbuluar 137 varreza masive, ku në një varrezë të këtilla u gjetën 5 deri në 158 kufoma.⁶

Për të bërë të pamundur identifikimin e mëpastajmë të këtyre varrezave masive me trupa të të vrarëve shqiptarë, regjimi i Serbisë ka urdhëruar që mbi këto varreza masive të hidhet rërë dhe të shtrohet asfalt. Rast i shtruarjes asfalt mbi varrezat masive është varreza masive në Rudnicë dhe në Rashkë.⁷

Ka pasur raste që trupat e të vrarëve shqiptarë janë hedhur edhe nëpër lumenj, siç është rasti i kamionit frigorifer me trupat e të vrarëve shqiptarë i hedhur në lumin Danub i cili në ndërkohë doli në sipërfaqe të lumit në të cilin ndodheshin 86 kufoma të grave, fëmijëve dhe pleqve shqiptarë të Kosovës, të vrarë e të masakruar nga forcat serbe.⁸

Si mënyrë e asgjësimit të gjurmëve të krimeve makabre të forcave serbe janë edhe djegia e trupave të të vrarëve shqiptarë në furrat e shkretoreve në Zveçan. Lidhur me këtë në emisionin dokumentar me titull “djegia e gjurmëve”, të stacionit amerikan National Publik Radio i emituar më 25 maj 2001, thekson se forcat serbe dhe jugosllave në mënyrë sistematike transportonin kufomat e shqiptarëve kosovarë në kompleksin Trepça ku janë djegur ndërmjet 1.200 deri 1.500 kufoma.⁹

⁶ Fitnete Ramosaj, Kundër harresës... f. 34-40.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Jusuf Osmani, Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë... f. 76.

4. Hedhja në bunarë e trupave të të vrarëve shqiptarë nga forcat serbe

Bestialiteti dhe mentaliteti fashist i forcave serbe ndaj shqiptarëve është manifestuar edhe me hedhjen e trupave të të vrarëve shqiptarë, madje edhe të gjallëve në puset, bunarët anë e mbanë Kosovës, pastaj hedhja e eksplozivit apo të mbeturinave në këto puse me qëllim të zhdukjes së këtyre krimeve. Këto veprime fashiste të forcave serbe i konstaton veprimtari dhe humanisti norvegjez Josef Martinsen në librin e tij me titull Puset e VDEKJES NË KOSOVË. Humanisti norvegjez Martinson, menjëherë pas luftës ka ardhur me një ekip të posaçëm, ekip ky që në dhjetëra puse, bunarë anë e mbanë Kosovës ka zbuluar dhe ka nxjerrë nga bunarët trupat e të vrarëve shqiptarë dhe të hedhur në bunarë. Në mesinë e dhjetëra rasteve të hedhjes së të vrarëve shqiptarë në bunarë është rasti i hedhjes së shqiptarëve në bunarë në fshatin Kotlinë të komunës së Kaçanikut. Në këtë fshat ekipi i udhëhequr nga veprimtari Martinsen ka identifikuar në dy bunarë të fshatit Kotlinë më 10 shtator të vitit 1999 ka nxjerrë 26 trupa të të vrarëve shqiptarë të moshës midis 13 deri 60 vjeçare. Me këtë rast, ky ekip ka konstatuar se forcat serbe pasi i kanë hedhur 26 trupat e të vrarëve shqiptarë, në këta bunarë, kanë gjuajtur eksploziv me të cilin janë rrafshuar bunarët, kështu që disa ditë është dashur të hiqet dheu dhe të zbulohen dhe të identifikohen kufomat.¹⁰

Ekipi i ndërkombëtarëve të Norvegjisë, i ndihmuar edhe nga ndërkombëtarë, nga bunarët e fshatrave të Kosovës pas luftës i ka nxjerrë rreth 450 kufoma të shqiptarëve të vrarë.¹¹

5. Personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë 1998/1999

Nocioni i personit të zhdukur. Në nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së për Mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukjet me dhunë është përcaktuar nocioni i personit të zhdukur ku thuhet: “me zhdukje me dhunë nënkuptohet arrestimi, burgosja, rrëmbimi ose çdo formë tjetër heqjeje lirie nga agjentë të shtetit apo nga persona të tjerë a grupe personash, që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, pasuar nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose

¹⁰ Josef Martinsen, Puset e vdekjes në Kosovë, përkthim në shqip, 2011, f. 24-25.

¹¹ Po aty.

nga fshehja e fatit të personit të zhdukur a e vendit ku gjendet ai duke e mohuar nga mbrojtja e ligjit.”

Përkufizim të ngjashëm për personat e zhdukur përcakton edhe dispozita e nenit 7 të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

Termi personat e zhdukur me të njëjtin përkufizim sikundër dy aktet juridike të cekura përdoret edhe në Ligjin e Kosovës për personat e zhdukur (Ligji Nr.4/L-023).

Familjarët e të zhdukurve të Kosovës kanë kërkuar që emërtimi i “i zhdukur” të zëvendësohet me emërtimin “i pagjetur”. Termi “i pagjetur” dhe termi “i zhdukur” shpesh përdoret në formë sinonimi. Por në perceptimin e familjarëve të këtij lloj krimi, vërehet tendenca dhe dëshira e përdorimit të termit “i pagjetur”, thjesht për shkak të aspektit psikologjik, ngase familjarët nuk pajtohen se janë të zhdukur, por mendojnë dhe shpresojnë se një ditë do t’i gjejnë të afërmit e tyre.¹²

Që nga përfundimi i luftës deri në fillim të nëntorit të vitit 2014, Kryqi Kuq Ndërkombëtar ka evidentuar **6024** persona të zhdukur. Në këtë numër bëjnë pjesë edhe **948** personat të cilët u gjendën gjallë në burgjet e Serbisë. Me presionin e madh ndërkombëtar, këta 948 persona pas disa muajve të çlirimit të Kosovës u liruan nga burgjet serbe. Aktualisht, edhe sot e kësaj dite, pas 24 vjetësh të përfundimit të luftës, 1639 persona janë të zhdukur, prej tyre 91 fëmijë.¹³

6. Mënyrat e zhdukjes së dhunshme të shqiptarëve të vrarë nga forcat serbe

Mënyrat e zhdukjes së dhunshme të shqiptarëve të Kosovës gjatë luftës kanë qenë të ndryshme dhe në shumicën e rasteve shumë barbare, shumë mizore dhe të egra. Në shumë raste personat janë ndalur dhe kidnapuar nga kolonat duke ikur nga shtëpitë e tyre, ose janë nxjerrë nga shtëpitë e tyre dhe kurrë më nuk janë gjetur. Në disa raste, njerëzit i kanë vrarë dhe i kanë varrosur në vende të fshehta. Ka pasur raste që janë marrë fëmijët nga duart e nënës apo të atit dhe janë zhdukur, ndërsa

¹² Ismet Salihu-Pajazit Nushi, Personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë 1998/99, Prishtinë 2015, fq. 16-17.

¹³ Po aty.

disa prej tyre në ndërkohë janë gjetur në varreza klandestine individuale apo në varreza masive.¹⁴

Formë tjetër e zhdukjes së dhunshme ka qenë edhe më bestiale, mizore, ngase pasi forcat serbe femrat shqiptare i kanë dhunuar, i kanë ekzekutuar dhe i kanë varrosur në varreza klandestine, madje ka pasur raste që pasi i kanë dhunuar i kanë hedhur në lumenj ose bunarë.¹⁵

Karakteristikë e përbashkët për të gjitha mënyrat e zhdukjes është se kanë qenë të planifikuara dhe të organizuara dhe janë kryer në mënyrë sistematike nga forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe. Ministria e policisë e Serbisë paraprakisht i ka përgatitur, ka hapur varrezat masive në Serbi. Nga Kosova me mjete të ndryshme transporti i kanë transportuar kufomat e shqiptarëve të vrarë dhe i kanë varrosur në varreza masive në Serbi. Lidhur me këtë, me aktgjykimin e Tribunalit të Hagës, është shpallur fajtor ministri i Policisë së Serbisë për shkak se me dijen dhe urdhrin e tij është bërë zhvarrosja dhe transportimi i 889 kufomave të shqiptarëve të vrarë nga Kosova dhe është bërë rivarrimi në varreza masive në Serbi.¹⁶

Varrosja e përkohshme dhe zhvarrosja ka qenë një formë e posaçme e zhdukjes së gjurmëve të të vrarëve. Raste të këtilla janë ato në Gjakovë, Izbicë, Suharekë, Rezallë, Çikatovë të Vjetër, Rudnicë të Rashkës etj. Gjithashtu të këtilla janë rastet e varrezave masive në Batajnicë, në Petrovo Sello, në Bajina Bashta dhe Rashkë të Serbisë. Nga këto katër lokacione të varrezave masive në Serbi, janë nxjerrë 901 mbetje mortore të të vrarëve shqiptarë të Kosovës.¹⁷

Zhvarrosjen e të vrarëve shqiptarë dhe rivarrimin e tyre, në varrezat masive në Serbi, policia serbe e ka bërë sipas planit të përgatitur dhe në mënyrë sistematike gjatë tërë kohës së luftës, me qëllim të fshehjes së gjurmëve të krimeve të luftës. Këtë veprimtari kriminale, pushteti serb e ka ushtruar me logon “**sanacia terena**”, **sanim të terenit**, që në brendinë e kësaj veprimtarie është nënkuptuar mbledhja e të vrarëve, si dhe zhvarrosja e të vrarëve dhe rivarrosja e tyre në varrezat masive në territorin e Serbisë.¹⁸

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë...* f. 76 – 77.

¹⁷ Fitnete Ramosaj, *Kundër harresës...* f. 268-271.

¹⁸ Ismet Salihu-Pajazit Nushi, *Personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë 1998/99...* f. 23-24.

Eglantina Kraja Bardhi

DHUNA DHE PËRDHUNIMET NGA FORCAT SERBE GJATË LUFTËS NË KOSOVË 1998-1999

Abstrakt

Duke pasur parasysh humbjet njerëzore dhe dëmet ekonomike / infrastrukturore, konflikti / lufta e viteve 1998 - 99 që ndodhi në mes të etnisë shqiptare dhe asaj serbe në Kosovë ishte një ndër konfliktet më të mëdha në Ballkan, në gjysmën e dytë të shekullit XX.

Një gjendje e tillë vështirësoi edhe më shumë jetën e të mbijetuarve nga lufta duke marrë parasysh humbjet e të afërmeve të tyre, humbje të pasurisë, shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut, dhunimet, eksodit të shpërnguljeve dhe problemeve psikologjike që rezultuan nga trauma. Rritja e përjetimeve të stresit post-traumatik, traumës psikologjike, ankthit, depresionit, sjelljes agresive, janë vetëm disa nga çështjet e shëndetit mental që janë evidentuar nëpër hulumtime të natyrave të ndryshme (Kashdan T.B., Morina N. & Priebe S. 2009; KRTC, 2006).

Sulmet sistematike kundër popullsisë civile, vrasja e më shumë se 13 000 shqiptarëve, dhunimi i 20 000 grave shqiptare, vrasja e 1392 fëmijëve, vrasja e 1739 grave, vrasja e 10 000 civilëve të tjerë shqiptarë dhe zhdukja e 1653 kufomave civile” (Mahmuti, 2015:293). kishin si synim realizimin e këtij plani.

Një numri i konsiderueshëm i hulumtimeve tregojnë se përdhunimet e kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë 1998-1999 zhvillojnë një varg problemesh si në jetën emocionale dhe problemeve në sjellje dhe se këto efekte janë më të fuqishme nëse personat kanë përjetuar përvoja të rënda traumatike gjatë luftës.

Serbët duke aplikuar përdhunimin e grave shqiptare si mjet lufte, donin të vrisnin edhe moralin shqiptar. “Ky ishte kulmi i mizorisë njerëzore, një mënyrë e njohur edhe më parë, por asnjëherë qëllimi kryesor i përdhunimit nuk u kthye si ndihmës kryesor i një doktrine: thyerjes morale të një populli. Jo vetëm i grave, siç mund të merret në vështrim të parë, por, në radhë të parë, i burrave. Jo vetëm për brezin që po pësonte goditjen, por po aq edhe për brezin e ardhshëm”

Sipas Protokollit Ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikt, “dhuna seksuale është formë e urreyer e dhunës, që përfshin përdhunimin dhe sulme të tjera të natyrës seksuale, të kryer kundër grave dhe vajzave, burrave dhe djemve, që mund të ketë pasoja brutale, ku përfshihen pasojat fizike dhe psikologjike për të mbijetuarit dhe dëshmitarët, por mund të ketë ndikim të thellë destabilizues në komunitetet dhe popullatat në tërësi” (assets.publishing.service.gov.uk/).

Dhuna seksuale mund të ketë pasoja fizike dhe psikologjike afatgjata. Në disa raste, viktimat e dhunës seksuale, si dhe dëshmitarët, nën ndikimin e ngarkesës emocionale humbin arsyen e gjykimit, që mund të çojë në humbjen e dëshirës për jetë. Trajtimi i viktimave të dhunës seksuale nga institucionet relevante në këtë rast është jetik.

Fjalët çelës: dhuna, përdhunimet, forcat serbe, traumat, pasojat.

Konflikti i brendshëm në Jugosllavi, i cili filloi në Slloveni, lufta në Kroaci dhe agresioni i Serbisë në Bosnjë – Hercegovinë dhe në Kosovë shënoi fundin dhe shpërbërjen përfundimtare të Federatës Jugosllave.

Që nga 1992, agresioni serb e ktheu rajonin, e sidomos Bosnjën dhe Kosovën, “në një kazan që ziente, ku serbët prinin në larje të hesapeve të vjetra, në një mënyrë të egër”.¹ Gjithsesi, kjo egërsi serbe burimin e kishte te lëvizja politiko-kulturore serbe, që ishte zhvilluar mes dy Luftërave Botërore. Kjo lëvizje përhapte ide të kontaminuara për dominimin serb kundër popujve tjerë në Ballkan. Janë pikërisht këto ide, që quan në krimet barbare serbe gjatë luftës në Kosovë”.²

Në Kosovë, ushtria serbe përdori të gjitha format e dhunës dhe represionit kundër popullsisë shqiptare, duke ritheksuar urrejtjen shekullore ndaj tyre. Duken vërtet shekuj larg, por njësoj si atëherë, ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës, ushtria serbe ka kryer masakra dhunime, përdhunime, therje fëmijësh dhe krime të tjera monstruoze. Kjo dhunë e përsëritur, ka lënë pasojë të jashtëzakonshme në popullsinë shqiptare të Kosovës.

Jetën e të mbijetuarve nga lufta, e vështirësuan edhe më shumë humbjet e të afërmve, personat e zhdukur, të pagjeturit, përdhunimet, problemet psikologjike si shkak-pasojë e luftës etj. që rezultuan me trauma nga më të ndryshmet. Rritja e përjetimeve të stresit post-traumatik, traumës psikologjike, ankthit, depresionit, sjelljes agresive, janë vetëm disa nga çështjet e shëndetit mendor që janë evidentuar nëpër hulumtime të natyrave të ndryshme.

Dhunimet dhe përdhunimet e kryera nga forcat militare dhe paramilitare serbe, kanë ndikuar dhe në jetën sociale të viktimave të mbijetuara të kësaj dhune. Dhunimet nuk kanë kursyer as vajza të mitura të moshës 10-11 vjeçare, qëllimi kryesor i të cilave ishte terrorizimi i popullsisë civile dhe largimi i saj drejt territoreve kryesisht të Shqipërisë, dhe më pas të Maqedonisë me synim përfundimtar shpopullimin e Kosovës nga elementi shqiptar.

Sulmet sistematike kundër popullsisë civile, vrasja e më shumë se 13.000 shqiptarëve, dhunimi i 20.000 grave shqiptare, vrasja e 1392 fëmijëve, vrasja e 1739 grave, vrasja e 10.000 civilëve të tjerë shqiptarë dhe zhdukja e 1653 kufomave civile kishin si synim realizimin e këtij plani.³

¹ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë 2019, f. 195.

² Arbër Xhaferi, *Kombi, identiteti dhe shteti*, Prishtinë 2005, f. 322-323.

³ Më gjerësisht: Ismet Salihu-Pajazit Nushi, *Personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë 1998/99*, Prishtinë 2015; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë*

Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), gjatë tre javëve të para të bombardimeve të NATO-s, 525,787 refugjatë nga Kosova vërshuan në vendet fqinje, kryesisht në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi. Sipas statistikave, forcat serbe shpërngulën 862,979 shqiptarë etnikë nga Kosova dhe disa qindra mijëra të tjerë u zhvendosën brenda për brenda Kosovës, përveç atyre që ishin zhvendosur para marsit 1999. Më shumë se 80% e gjithë popullsisë së Kosovës – 90% e së cilës përbëhej nga shqiptarë - u zhvendosën nga shtëpitë e tyre.⁴

Një numri i konsiderueshëm i hulumtimeve tregojnë se përdhunimet e kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë 1998-1999 zhvillojnë një varg problemesh, si në jetën emocionale dhe problemeve në sjellje, dhe se këto efekte janë më të fuqishme nëse personat kanë përjetuar përvoja të rënda traumatike gjatë luftës.

Dhuna seksuale është e rrënjosur te diskriminimi me bazë gjinore. Bazuar në rolet stereotipike seksuale, dhuna seksuale përdoret për të nënshtruar dhe poshtëruar viktimat që i nënshtrohen kësaj dhune. Dama e lidhur me dhunën seksuale, e ndërlidhur edhe me diskriminimin ekzistues të bazuar në gjini, i ekspozon viktimat ndaj një pafuqie të përjetshme dhe marginalizimit. Gjatë konfliktit, dhuna seksuale dhe ajo e bazuar në gjini shpesh është përdorur si një armë lufte. Gratë dhe burrat që mbijetojnë efektet e menjëhershme të kësaj dhune luftojnë me trauma afatgjate, pasiguri, pafuqi ekonomike dhe sociale, si dhe me sfida të shumta për të fituar drejtësinë dhe një mjet juridik efektiv, si një të drejtë të tyre të pamohueshme. Në situata të tilla, të mbijetuarit e kanë të vështirë, ose janë penguar, të rilidhen apo vendosin raporte normale me familjen e tyre, miqtë dhe komunitetin.

Sipas raportit të Human Rights Watch, përdhunimet e kryera në Kosovë mund të grupohen në 3 kategori:

Përdhunime të kryera në shtëpitë e veta grave, përdhunime të kryera gjatë largimit dhe përdhunime të kryera gjatë ndalimeve. Në kategorinë e parë, forcat e sigurimit hynin në shtëpitë private dhe përdhunonin gratë para anëtarëve të familjes, në oborr apo në dhomën ngjitur. Në kategorinë e dytë, njerëz të dëbuar që endeshin në këmbë apo me traktor ndaloheshin, grabiteshin dhe kërcënoheshin nga Ushtria

(1998 – 1999, Prishtinë 2012; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë*; Josef Martinsen, *What happened in Kosovo? 1998-1999, A documentation*, Oslo 2010.

⁴ Human Rights Watch, October 2001.

jugosllave, policia serbe apo paramilitarët. Në qoftë se familjet nuk mund të japin para, atëherë forcat e sigurimit iu thoshin që vajzat e tyre do të merreshin dhe përdhunoheshin. Në disa raste, edhe pse familjet kishin dhënë para, atyre iu ishin rrëmbyer vajzat. *Në kategorinë e tretë, dhunimet u kryen në qendrat e përkohshme të ndalimeve në vende të tilla, si në shtëpi apo hambarë të braktisur.*⁵

Sipas Protokollit Ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikt, “dhuna seksuale është formë e urryer e dhunës, që përfshin përdhunimin dhe sulme të tjera të natyrës seksuale, të kryer kundër grave dhe vajzave, burrave dhe djemve, që mund të ketë pasoja brutale, ku përfshihen pasojat fizike dhe psikologjike për të mbijetuarit dhe dëshmitarët, por mund të ketë ndikim të thellë destabilizues në komunitetet dhe popullatat në tërësi”.⁶

Dhuna seksuale mund të ketë pasoja fizike dhe psikologjike afatgjata. Në disa raste, viktimat e dhunës seksuale, si dhe familjarët dëshmitarë të dhunimeve, nën ndikimin e ngarkesës emocionale humbin arsyen dhe nuk arrijnë të gjykojnë apo të mendojnë me pozitivitet për jetën e tyre. Ata shfaqin shenja të një depresioni të thellë, dhe kjo çon në humbjen e dëshirës për jetë. Trajtimi i viktimave të dhunës seksuale nga institucionet relevante në këtë rast është jetik. Përjetimet e grave, vajzave dhe burrave të dhunuar kanë qenë tragjike dhe me shumë ndikime në jetën e tyre. Sipas rrëfimit të përjetimeve të tyre, njëra vajzë ishte dhunuar në sytë e prindërve dhe ata më pas, nga dhimbja e madhe humbën jetën duke lënë një plagë tjetër të thellë te vajza e tyre.

Nënat janë dhunuar në sytë e fëmijëve duke shkaktuar kështu trauma për të dyja palët, trauma të cilat kanë qenë shumë të vështira për t’u tejkaluar, pasi mentaliteti shoqëror, i detyronte viktimat të heshtnin. Sfida tjetër ka qenë dhe përballja me shoqërinë dhe vetveten.

Sipas studimit të ndërmarrë nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës, mbi traumën ndërbrezore, është vërtetuar që kjo traumë mund të trashëgohet te fëmijët e parë të lindur pas ngjarjes traumatike.⁷

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka bërë të ditur se në Ballkan (Kosovë, Kroaci e Bosnjë) janë dhunuar seksualisht 60. 000 femra. “Megjithatë, kjo organizatë më 1992, pas një presioni publik për përdhunimet në ish-Jugosllavi, ndikoi që në vitin 2008, Këshilli i Sigurimit

⁵ Human Rights Watch, October 2001.

⁶ assets.publishing.service.gov.uk/, 2023.

⁷ Shih: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës.

të miratojë Rezolutën 1820, e cila përdhunimet dhe format e tjera të dhunës seksuale i njohu si krime lufte dhe krime kundër njerëzimit”.⁸

Sot, nuk mjafton vetëm njohja e përdhunimeve si krime lufte, por duhet ndihmë konkrete jo vetëm për viktimat, por edhe për fëmijët e tyre tashmë të rritur. Viktimat e dhunës seksuale në Kosovë aktualisht marrin pensione të dhëna nga shteti, por ndihma psikologjike e këtyre viktimave është e lokalizuar në organizata joqeveritare.

Plagë të pambyllura janë dhe dhunimet e meshkujve nga ushtria serbe. Përballja me këtë traumë është shumëfish e mundimshme dhe duhet kohë që viktimat të flasin për këtë ngjarje. Si gratë, ashtu dhe burrat e dhunuar kanë vuajtur peshën e një drejtësie të vonuar, dhe kjo u shton atyre dhe familjeve të tyre dhimbje akoma edhe më të mëdha.

Ndërmjet marsit dhe dhjetorit 1999, Human Rights Watch kreu më shumë se 600 intervista me viktimat dhe dëshmitarë të shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare në Kosovë. Intervistat u kryen nga hulumtuesit e Human Rights Watch, zakonisht me një përkthyes, në Shqipëri dhe Maqedoni midis 28 marsit dhe 12 qershorit 1999 dhe në Kosovë midis 12 qershorit dhe 31 dhjetorit 1999. Të intervistuarit u pëzgjodhën në bazë të njohurive të tyre mbi abuzimet specifike brenda krahinës (zonës). Të gjitha intervistat u kryen me qëllim të nxjerrjes së narrativave të hapura të asaj që i intervistuari kishte parë apo përjetuar brenda Kosovës ndërmjet 20 marsit dhe 12 qershorit 1999, e jo përmes pyetësorëve të standardizuar. U krijua një bazë të dhënash, e cila është e disponueshme për përdorim publik.⁹

Me 5.122 shkelje të raportuara, ndarja me forcë e burrave, grave dhe fëmijëve ishte shkelja më e shpeshtë e raportuar ndër viktimat ose dëshmitarët. 4,485 shkelje të raportuara, ishte forma e dytë më e zakonshme, gjë që është e kuptueshme duke pasur parasysh se ishte një shkelje dominuese e konfliktit - më shumë se 850,000 shqiptarë kosovarë u dëbuan nga Kosova, sipas UNHCR-së, dhe mijëra të tjerë u zhvendosën brenda vendit. Shkelja e tretë më e shpeshtë ishte paraburgimi me 3,478 shkelje të raportuara, pasuar nga ekzekutimet jashtëgjyqësore me 3,453 shkelje.

Raportet e ardhshme nga Human Rights Watch dhe të tjerët mund të fokusohen në modelet e këtyre shkeljeve: kur dhe ku kanë ndodhur me kalimin e kohës dhe në çfarë rrethanash. Gjithashtu me interes është nëse disa shkelje kanë pasur tendencë të bëhen të izoluara apo së bashku

⁸ <https://www.koha.net/>, 2023.

⁹ <http://hrdata.aaas.org>, 2023.

me shkelje të tjera. Megjithatë, për hir të thjeshtësisë, ky raport fokusohet vetëm në një nga llojet e shkeljeve, edhe pse më të rëndat nga krimet: ekzekutimet.

Një analizë e ekzekutimeve jashtëgjyqësore


Duhet të theksohet se ekzekutimet jashtëgjyqësore nga aktorët shtetërorë-vrasje të qëllimshme pa proces gjyqësor - mund të mbi-raportohen në lidhje me shkeljet e tjera, pasi studiuesit e Human Rights Watch kërkuan në mënyrë aktive të dokumentonin vrasje të tilla të qëllimshme. Në të njëjtën kohë, shumë ekzekutime jashtëgjyqësore të kryera në Kosovë qartazi nuk janë përfshirë në 3,453 raste; vetëm si shembull, informacionet për vrasjet në shkallë të gjerë në Beleg, Goden, Kaçanik dhe Podujevë nuk janë përfshirë në këto të dhëna. Përveç kësaj, trupat e disa njerëzve të raportuar të humbur nga Human Rights Watch gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave janë zbuluar që atëherë. Pavarësisht nga këto shqetësime, sasia e informacionit për ekzekutimet e mbledhura nga Human Rights Watch është mjaft e madhe për të nxjerrë disa përfundime domethënëse rreth modelit të vrasjeve nga forcat serbe dhe jugosllave. Në 3,453 ekzekutimet e dokumentuara, Human Rights Watch mori emrat e 916 personave, ose 27% e viktimave. Pjesa tjetër e viktimave janë të pidentifikuara nga deshmitarët.¹⁰

Gjinia e viktimave të ekzekutimit

Siç është e qartë nga rastet e dokumentuara në kapitujt e tjerë të këtij raporti, forcat serbe dhe jugosllave ekzekutuan në mënyrë të përmblendhur meshkujt në një shkallë shumë më të lartë se femrat. Nga 3,453 viktimat e ekzekutimit të raportuara në Human Rights Watch, gjinia e viktimës ishte e njohur për 2,232 persona (65%). Nga këto 2,232 viktima, 2,055 prej njerëzve ishin meshkuj (92%) dhe 177 ishin femra (8%).¹¹

¹⁰ Human Rights Watch, October 2001.

¹¹ Human Rights Watch, October 2001.

Grafiku 2: Gjinia e viktimave të ekzekutimit

Këto gjetje do të priteshin nëse të dhënat do të trajtonin vdekjet në luftime apo edhe ekzekutimet e përmbledhura të luftëtarëve, pasi forcat e UÇK-së ishin kryesisht meshkuj. Por, siç e bëjnë të qartë studimet e rasteve në kapitujt e tjerë, shumica dërrmuese e viktimave të ekzekutimit të përmbledhur ishin civilë që nuk morën pjesë në luftime. Merrni, për shembull, vrasjet e afërsisht nëntëdhjetë të burgosurve në burgun e Dubravës ose afërsisht 300 burrat e marrë nga kolonat e refugjatëve dhe të vrarë në Mejë.

Është e qartë se kjo paraqet një shenjestrin të meshkujve shqiptarë. Ky konstatim përforcohet nga fakti se, gjatë bombardimeve të NATO-s, shumë meshkuj ishin ose të fshehur brenda Kosovës, duke luftuar me UÇK-në, ose jetonin jashtë vendit, ndërsa gratë kishin më shumë gjasa të kishin qëndruar në shtëpi gjatë luftës, ku përbënin pjesën më të ndjeshme për t'u abuzuar. Rastet studimore tregojnë se si burrat vriteshin shpesh nga forcat qeveritare të sigurisë pasi ishin ndarë nga gratë dhe fëmijët, si në Bellacerkë, Izbicë, Qyshk, Pastasel, Meje, Korenicë etj. Ekzekutimet e femrave, megjithatë, më shpesh ndodhën në vrasje në grup (siç është ekzekutimi i një familjeje të tërë) dhe jo nga shenjestrinimi i qëllimshëm i grave. Vrasja e 12 anëtarëve të familjes Gërxhaliu më 31 maj në Studime ose e familjes Berisha në Suharekë më 25 mars janë shembuj ku një familje burra, gra dhe fëmijë janë vrarë së bashku. Me fjalë të tjera, gratë kishin më shumë gjasa të vriteshin në grupe për të cilat vrasësit nuk bënin dallim midis gjinisë ose moshës, duke përfshirë kështu disa viktime femra më të reja.

Ekzekutimet e grave ishin të lidhura me dhunën seksuale që përfshinte viktime femra më të reja. Fatkeqësisht, është e pamundur të vërtetohet kjo teori me të dhënat e mbledhura. Edhe pse Human Rights Watch ruante anonimatin për përdhunimin dhe dhunën seksuale në bazën e të dhënave, gjë që teorikisht do të lejonte një analizë nëse ekzekutimet e femrave dhe dhuna seksuale prireshin të ndodhnin në të njëjtën kohë, natyra e ndjeshme e dhunës seksuale në shoqërinë shqiptare kosovare i dha të dhënat ndërmjet rreshtave, mbi ato krime të pabesueshme, dhe jo drejtpërdrejt, sipas komenteve të Human Rights Watch. Me fjalë të tjera, dhuna seksuale ishte nënraportuar si në dëshmi ashtu edhe në database-in e të dhënave.¹²

Dhuna seksuale u përdor në mënyrë sistematike në konfliktet e armatosura në ish-Jugosllavi. Vetëm dy dekada më vonë, qeveritë e rajonit, së bashku me organizatat e shoqërisë civile dhe të mbijetuarit, po bëjnë përpjekje gjithëpërfshirëse për të zbatuar programe të plota dhe komplete të reparacioneve. Për dy dekada, organizatat e grave, grupet me bazë në komunitet, si dhe vetë të mbijetuarit kanë punuar shumë për të krijuar mekanizma mbështetës për të mbijetuarit dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre në mekanizmat e drejtësisë në nivel vendi, nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar. Së fundi, qeveritë kanë filluar të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për të siguruar mjete efektive juridike, duke përfshirë reparacionet për të mbijetuarit, siç janë mbështetja financiare, pagat mujore, qasja në shërbimet shëndetësore dhe asistencë sociale.

Shembujt e përdhunimit të vajzave dhe grave gjatë viteve të luftës në Kosovë (1998-1999) janë të shumtë. Asnjëherë deri më sot nuk janë zbuluar të gjitha për shkaqe dhe arsye të ndryshme, sado që ka pasur profesionistë dhe institucione të gatshme për të mbledhur faktet në terren.

Më poshtë do të gjeni një histori reale të një vajze të mitur e cila ishte përdhunuar nga forcat serbe. Kjo histori është një nga 20 mijë historitë e dhunimeve të forcave serbe në Kosovë.

“Ajo kishte qenë 13 vjeçare dhe ishte me nënën e saj dhe disa bashkëfshatarë me traktor duke u larguar për në Mal të Zi. Në dalje të qytetit, ishte ndaluar nga një “polic” serb, në një pikë të policisë, në dalje të Pejës. Në atë pikë policore, një ish “komshi”, serb i familjes prindërore, ishte bashkë me bashkëshorten e vet, që të dy i njihnin prej vitesh dhe kishin “marrëdhënie normale”, ishte udhëheqës i pikës. Për

¹² <https://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/undword2a.html>, 2023.

“ironi”, serbi, komshi që e njihnin njëri - tjetrin dhe me gjithë fakti se nëna e saj ishte e të njëjtit komunitet, vajza 13 vjeçare me një vajzë tjetër, u ndanë nga familja dhe u ndalën me dhunë. Ajo u largua nga nëna me dhunë, edhe pse si ajo, edhe nëna e saj, kishin rezistuar. Ata ishin më të fuqishëm dhe i ndanë këto dy vajza nga familjet e tyre. Ajo i ishte dorëzuar një njësie tjetër, ku shumë vajza shqiptare i kishin grumbulluar në një shtëpi jashtë qytetit. Tri ditë të tëra u dhunuan në mënyrën më brutale, seksualisht, duke u ndërruar dhunuesit. Ato u dhunuan me orë të tëra, por edhe u rrahën, u ofenduan në mënyrën më vulgare dhe brutale. Pas disa ditësh vajzat ishin liruar. Nga dhuna bizare, ishin të molisura dhe të përgjakura. Aty i merr një shqiptare, u ndihmon të pastrohen dhe t'i ndërrojnë rrobat, pas disa ditësh arrin ta gjejë familjen e saj. Nëna dhe babai, i morën vesh përjetimet tragjike të vajzës. Disi, ata të dy ishin aranzhuar në këtë tragjedi. Ajo kishte tentuar disa herë të bënte vetëvrasje, në forma të ndryshme. Jeta ishte për të e papërballueshme. Në njërin anë dhuna brutale nga kriminelët dhe dhunuesit serbë dhe në anën tjetër diskriminimi brutal nga familja. Për fatin e të gjithëve, ajo nuk kishte pasur “sukses” në këto akte (tentim vetëvrasjeje).¹³

Ky fakt dhe shumë e shumë ngjarje të tjera, janë një thirrje për drejtësi. Drejtësi e vonuar, është drejtësi e mohuar dhe për aq kohë sa drejtësia nuk vendoset, traumat dhe vuajtjet do të shërbejnë për të mos harruar dhe sërish për të kërkuar drejtësi. Shoqëria kosovare duhet të ndërgjegjësohet dhe të bëhet më e ndjeshme ndaj këtyre viktimave, me qëllim që trauma të mos kalojë ndër breza dhe të vazhdojë të shkaktojë vuajtje të mëdha, pa e ditur pse. Viktimat e dhunës janë pjesë thelbësore jona dhe nuk ka lumturi individuale pa lumturinë e të gjithëve.

¹³ Skender Munishi, *Psikotrauma dhe Stresi Post-traumatik Manual lidhur me traumën psikike, rrjedhën dhe trajtimin e saj*, Prishtinë, 2022, f. 44.

Ramë Manaj

TIPOLOGJIA E MASAKRAVE TË LUFTËS 1998-1999 NË KOSOVË

Abstrakt

Luftërat shkaktojnë pasoja të rënda dhe gati gjithëherë të pariparueshme: humbje të jetëve njerëzore, vrasje të civilëve të të gjitha moshave, djegie kufomash, masakrime në grupe të mëdha e të vogla, përdhunime, si dhe dëme kolosale materiale, si shkatërrime pronash, djegie shtëpish e shkatërrime të institucioneve me vlera kulturore, historike etj.

Por, pasojat më të rënda janë masakrimet e trupave të njerëzve, djegiet e tyre, dhunimet seksuale para vrasjes, si dhe përpjekjet për fshehje të krimeve duke hedhur trupa në varreza masive, në hapësira sekrete, nëpër miniera etj.

Gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999 kur u humbën më shumë se 13 mijë jetë njerëzore, u shkatërruan më shumë se 120 mijë shtëpi, u dhunuan më shumë se 20 mijë femra shqiptare, u shkatërruan qindra e qindra objekte të kulturës materiale e shpirtërore, kulturore, historike, kombëtare e fetare dhe më shumë se 6000 trupa të vrarësh u fshehën nëpër varreza të ndryshme masive nëpër Serbi (ende sot kërkohen mbi 1600 trupa të të vrarëve të zhdukur ose ende të pagjetur).

Kumulativisht, gjatë viteve 1998-1999, në Kosovë, nga forcat ushtarake e policore dhe paramilitare serbe, që vepronin në akordancë të efektshme, janë bërë rreth 400 masakra të mëdha e të vogla- vrasje masive në grupe të mëdha (146 veta në Izbicë më 28 mars 1999, 377 veta janë vrarë në Mejë të Gjakovës më 27 prill 1999, Reçaku, Krusha e Madhe dhe e Vogël, Likoshani, Prekazi, Pastaseli, Kralani e shumë e shumë të tjera) dhe në grupe më të vogla. Janë vrarë e masakruar fëmijë (më shumë se 1300 janë të evidentuar) pleq e të rinj dhe gra e vajza, pa dallim.

Tipologjia e masakrave serbe në Kosovë mund të specifikohet sipas disa kritereve:

- Sipas numrit të të ekzekutuarve (pra në grupe të mëdha e të vogla dhe individuale);
- Me armë zjarri dhe me armë të ftohta;
- Sipas mënyrës së ekzekutimeve (me rafale dhe të shtëna individuale);
- Sipas vendit (në fusha, në rrënoja ndërtesash, në brigje lumenjsh etj.);
- Sipas kohës (në çdo orë brenda 24 orëve).

Elementet gjenocidale të masakrimeve e vrasjeve ishin evidente jo vetëm në tendencën e zhdukjes apo shfarosjes së një populli përmes ekzekutimeve, por edhe përmes përndjekjes së rreth një milion njerëzve jashtë Kosovës duke ua konfiskuar dokumentet e identitetit dhe ato të udhëtimit, me qëllim që të mos u lejohej kurrë më (sipas planeve të tyre) kthimi në shtëpitë e tyre.

Vrasjet e fëmijëve (personave nën moshën madhore, paraqet monstrozitetin e barbarisë dhe llahtarisë që forcat serbe e manifestuan kundër shqiptarëve të pambrojtur.

Pas përfundimit të luftës, familjarët kanë lajmëruar tek organizatat e ndryshme humanitare ndërkombëtare se mungonin më tepër se 6.000 persona, për fatin e të cilëve nuk dihej.

Më shumë se 4500 prej tyre deri tani janë gjetur nëpër varreza masive, prej tyre më shumë se 945 janë sjellë nga varrezat masive nëpër Serbi, nëpër lumenj e puse të ndryshme ku herë-herë janë hedhur bashkë me trupa kafshësh të ngordhura.

Fjalët çelës: Masakra, vrasje civilësh, grash, fëmijësh, civilë të paarmatosur e të pambrojtur, djegie trupash, dhunime seksuale, shkatërrime shtëpish, rrënimë të objekteve të kulturës.

Pikëpamja sipas së cilës nëse dihet botërisht se në Kosovë, gjatë viteve 1998-1999 ka ndodhur një luftë dhe se janë të njohura pasojat e saj, nuk do të jetë e nevojshme që të evidentohen, eksplorojnë dhe memorizohen nga aspekti shkencor juridik e historik krimet e rënda që u bënë ndaj një populli të pambrojtur, duket të jetë e paqëndrueshme. Prandaj është e domosdoshme të trajtohet në përkufizimin dhe memorizimin shkencor e institucional të dimensioneve të krimit dhe pasojave që shkaktoi agresioni serb, si dhe monumentalizimin e homazhit ndaj viktimave të luftës.

Është në ndërgjegjen njerëzore që ballafaqimi e dëshmimi i krimeve, i secilit krim, të jetë pjesë e obligimit dhe vetëdijes për historitë njerëzore. Rrëfimi për krimin, tipologjizimi i tij, sikur edhe përpjekja për lidhjen e të gjitha krimeve bashkë në kërthizën e origjinës, ndikon në ndërgjegjen e njerëzimit.

Prandaj, është dobishme që të bëhet tipologjizimi, struktura e krimeve serbe ndaj shqiptarëve. Kjo nuk është e lehtë nga aspekti shkencor, por është edhe më e dhimbshme nga aspekti njerëzor.

Fundi i shekullit XX, provoi edhe një herë, si shumë herë të tjera në histori, se koncentrimi i forcës dhe armatimit shkatërrues në duart e të papërgjegjshmëve dhe në duart e atyre që lakmia për dominim e për pushtim jo vetëm që mund të arrijë në shkallë të absurdit, por mund të shkaktojë pasoja të paparashikueshme, duke e pasqyruar anën e errët të koshiencës njerëzore.

Shkaktari i luftërave gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë, agresioni serb, pas Kroacisë e Bosnjës dhe Hercegovinës, gjatë vitit 1998-1999,

me gjithë arsenalin e tij ushtarako-policor e paramilitar, nën komandën e Slobodan Milosheviçit, iu sul Kosovës.

Preteksti për vrasjet, plagosjet, masakrimet, djegiet e shkatërrimet ishte UÇK-ja, por qëllimi i vërtetë ishte krijimi i “tokës së djegur” e pastaj deportimi i popullsisë jashtë Kosovës.

Projekti strategjik luftarak serb “Patkoi” e dëshmoi këtë: përveç vrasjeve grupore dhe atyre individuale, masakrimet të kufomave, djegies e zhdukjes së tyre, dhunimeve seksuale, përveç djegies e shkatërrimit të më shumë se 120 mijë shtëpive e shumë objekteve të tjera të institucioneve publike e fetare, ushtria, policia dhe paramilitarët serbë i deportuan jashtë kufijve të Kosovës - në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi rreth një milion shqiptarë, gra, fëmijë e të moshuar, me synimin e qartë që t’ua pamundësojë atyre kthimin në trojet e veta.

Në fjalorët juridikë e gjuhësorë, termi *masakër* ka domethënie të gjakderdhjes masive, vrasje në masë, prerje, copëtim, demolim e djegie kufomash...¹ (në gjuhën shqipe përdoret edhe termi kasaphanë). Por masakër ose masakrim është edhe kur vetëm një personi të vvarë i shkrep armën, e copëton, e djeg, ia demolon fizikisht trupin.

Ndërkaq, termi *gjenocid*, siç dihet, vjen prej fjalës greke *genos* që do të thotë: gjini, etni, komb dhe *cidere*,² që do të thotë: vrasje. Pra vrasje masive, përpjeke për zhdukje të një etnie ose pjesëtarëve të një përkatësie etnike-kombëtare. E tillë ishte përpjekja e regjimit të Milosheviçit.

Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNI), nga data 1 janar 1998 deri më 12 qershor 1999, kur në territorin e Kosovës janë futur trupat e NATO-s, nën akronimin KFOR, forcat ushtarake, paraushtarake dhe policore të Serbisë dhe të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) kanë vvarë 7900 civilë shqiptarë të paarmatosur (6579 meshkuj, 1321 femra).³

Por të dhënat e publikuara nga Fondi për të Drejtën Humanitare e tashmë të njohura botërisht, citoj: *...si pasojë e konfliktit 1998-1999 dhe pas përfundimit të luftës deri në fund të vitit 2000, 13535 persona janë vvarë apo janë zhdukur me dhunë. Nga numri i përgjithshëm i viktimave 10317 ishin civilë (prej tyre 8676 shqiptarë, 1196 serbë dhe 445 nga grupet e tjera etnike) dhe 3218 nga forcat e ndryshme të armatosura*

¹ Bratoljub Klajiq: Fjalori i fjalëve të huaja, Zagreb 1978, f. 852.

² Po aty

³ KMDLNI - Krimet e Luftës në Kosovë 1998-1999- Monografi, fq. 41, Prishtinë 2010.

(prej tyre 2131 nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, 1084 nga forcat e armatosura serbe dhe jugosllave dhe 3 nga forcat e NATO-s. Nga ana tjetër, më shumë se 1600 persona ende rezultojnë të zhdukur.⁴

Fëmijët ishin në shënjestër të forcave serbe me motivacion se ata ishin,, armiq të ardhshëm të Serbisë.,,

Gjatë konfliktit në Kosovë, sipas evidencës së Këshillit të Mbrojtjes së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, 953 fëmijë shqiptarë janë vrarë e masakruar nga forcat serbe 4, (ndonëse disa autorë-burime të tjera konfirmojnë se shifra e fëmijëve të vrarë është më tepër se 1300).

Rreth 400 masakra kolektive i ka kryer makineria vrastare serbe gjatë luftës në Kosovë, në të cilat civilët shqiptarë u vranë në grupe: 377 në masakrën e Mejës, 146 në më masakrën e Izbicës, 115 në masakrën e Pastaselit, 86 në masakrën e Kralanit, pastaj në masakrën e Reçakut, Krushës së Madhe e të Vogël, Prekazit, Likoshanit, Çirezit, Pokleikut, Çikatovës, Rezallës, Abrisë, Lubeniqit e Korenicës e shumë e shumë masakra të tjerat që regjimi serb kreu në Kosovë

Këto masakra janë kryer ndaj civilëve të pambrojtur shqiptarë, gjë që dihet por e kanë dëshmuar edhe të mbijetuarit e paktë të këtyre masakrave.

Përveç, vrasjeve, masakrimeve, djegieve e dhunimeve edhe rreth një milion shqiptarë u deportuan jashtë Kosovës, me synimin etnocidal për ta bërë spastrimin etnik të saj nga shqiptarët, të cilët përbënin më shumë se 95 për qind të popullsisë autoktone dhe rezidente të Kosovës. Por cila është tipologjia e masakrave në Kosovë?

Arsim Bajrami, në librin e tij,, *Gjenocidi i Serbisë në Kosovë*-aspekte juridike,, thekson se gjenocidi i Serbisë në Kosovë është shumëdimensional: gjenocidi në sferën e arsimit, gjenocidi ekonomik, gjenocidi në sferën kulturore, media dhe fushat e tjera, gjenocidi demografik, duke eksploruar detajisht dhe në mënyrë të argumentuar gjithë kompleksitetin e gjenocidit shtetëror të Serbisë në Kosovë.⁵

Megjithatë këtu do të paraqitet një tipologjizim i shkurtër, i të reduktuar në shtruarje, për vrasjet masive dhe masakrat, të cilat forcat serbe i bënë kundër shqiptarëve të pambrojtur civilë, gjatë viteve 1998-1999.

⁴ Fondi për të drjtën humanitare, libri Memorializimi, Prishtinë 2022, f.10.

⁵ Arsim Bajrami, *Gjenocidi i Serbisë në Kosovë-Aspekte juridike*, Prishtinë 2023, f. 57.

Gjenocidi është përkufizuar me Konventën e OKB-së për Gjenocidin e vitit 1948, e cila ka hipur në fuqi më 12 janar 1951.

Sipas kësaj Konvente, Gjenocid nënkupton secilin nga aktet e kryera me qëllim të shkatërrimit të tërësishëm apo të pjesëshëm të një grupi kombëtar, etnik, racor apo fetar, siç është:

(a) Vrasja e anëtarëve të grupit; (b) shkaktimi i lëndimeve serioze trupore apo mendore, anëtarëve të grupit; (c) të imponuarit e qëllimshëm të kushteve të atilla të grupit, të parashikuara që ta shkaktojnë shkatërrimin fizik apo mendor, të plotë ose të pjesëshëm të atij grupi; (d) imponimi i masave që kanë për qëllim parandalimin e lindjeve brenda grupit; (e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve prej një grupi në tjetrin.⁶

Kështu, masakrat serbe ndaj popullatës shqiptare dalin të jenë thjesht ilustrim i faktit se ato u bënë me qëllim dhe në funksion të gjenocidit të organizuar shtetëror, në përputhje të plotë me përkufizimin dhe kriteret e gjenocidit.

Gjatë mbajtjes së Konferencës së Rambujesë, Serbia kishte dislokuar në Kosovë rreth 150 mijë forca ushtarake, policore dhe grupe paramilitarësh, si ato të kriminelëve Sheshel e Arkan, me gjithë arsenalin e tyre vrasës: artileri të rëndë e të lehtë ushtarake e policore, të cilat kishin mbuluar tërë territorin e Kosovës. Kjo forcë, sidomos pas datës 24 mars 1999, kur filluan sulmet e NATO-s ndaj caqeve të caktuara në Serbi e Kosovë, fillojnë sulmet e tmerrshme të përndjekjes masive, vrasjeve, dhunimeve, djegieve e shkatërrimeve kundër popullatës civile shqiptare.

Veçori e këtyre vrasjeve është se ato u kryen ndaj individëve, por po kështu duke i grupuar njerëzit, të cilët më pas vriteshin ose masakroheshin nga ato forca.

Këto grupime qenë të ndryshme, grupime më të vogla ose më të mëdha (nga 10, 20, 30... e deri në 377 persona, sikur tregon rasti i Mejes së Gjakovës).

Pra, tipologjinë e vrasjeve dhe masakrimeve e ilustron vrasja në numra të mëdhenj, duke filluar prej numrave të vegjël, siç u citua më lart.

Por tipologjia e vrasjeve masive dhe masakrimit individual e masiv të trupave të të vrarëve ilustron edhe me mënyrën e vrasjeve:

⁶ Po aty, f. 63.

1. vrasje me armë të nxehta dhe me armë të ftohta;

- vrasje me armë zjarri, individualisht dhe në grupe,

- vrasjet në fusha, hapësira të ndryshme e rrënoja shtëpish, siç janë ekzekutimet kolektive në Mejë, Izbicë, Pastasel, Krushë të Madhe, Kralan e shumë të tjera;

- vrasjet nëpër hapësira të mbyllura, duke granatuar e bombarduar dhe duke hedhur bomba ose shkrepur rafale automatikësh mbi gra, fëmijë e të moshuar, siç janë rastet e Prekazit, ai i familjes Jashari, rasti i Suharekës, ai i familjes Berisha, rasti me të burgosurit e Dubravës e shumë raste të tjera.

2. vrasje me armë të ftohta: thika e mjete tjera të forta goditëse.

3. me mënyrën e masakrimit të trupave:

- pas ekzekutimeve masive nëpër dhoma e hapësira të ngushta, duke u hedhur bomba dore dhe rafale automatikësh, paramilitarët, policët e ushtarët serbë i copëtojnë e djegin trupat me katalizatorë të ndryshëm të lëngët e të gaztë, përfshirë edhe djegiet në furnalta. Ata i kanë hedhur trupat e gjymtuar e të sakatuar nëpër puse e shpella, lumenj e liqene, i kanë hedhur dhe i kanë mbuluar më pas me shtresa të trasha të dheut nëpër miniera) etj.;

Shumë trupa janë gjetur me duar të lidhura e me shenja maltretimesh para ekzekutimit;

- pati masakër kundër civilëve edhe në treg të artikujve ushqimorë, të konsumit ditor, siç kishte ndodhur vite më parë në tregun e Sarajevës. Kjo ka ndodhur më 13 mars 1999 kur forcat serbe hedhin granatë në tregun e artikujve ushqimorë në Mitrovicë, ku vriten, më saktë masakrohen 5 shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe gra e fëmijë dhe plagosen 23 të tjerë.

- Është e konfirmuar se nëpër shumë fshatra, në Drenicë, Dukagjin- në komunën e Istogut, në Llapushë e gjithandej Kosovës, menjëherë pas hyrjes së forcave të NATO-s, nga pusët janë nxjerrë me qindra trupa të dekompozuar të shqiptarëve të vrarë;

Ndërkaq, nga Serbia, nga varrezat kolektive: Batajnicë -747, në Bajna Bashta -84, Petrovo Sello -61, nga nëntoka e minierave në Rudnicë 54 e Kizhevak janë nxjerrë e janë sjellë në tokën e tyre në

Kosovë (deri në vitin 2020) gjithsej 946 trupa të shqiptarëve të vrarë, më saktësisht, mbetje të trupave të tyre.⁷

Ka raporte të organizatave humanitare ndërkombëtare me të dhëna të pakonfirmuara, në të cilat thuhet se rreth 300 trupa të shqiptarëve të vrarë janë hedhur në furnalta të shkretoreve të metaleve si në Maçkaticë e Bor të Serbisë dhe në Ferronikël e Trepçë në Kosovë. Rrjedhimisht, do të jetë e pamundur që ndonjëherë të gjendet ndonjë pjesë – mbetje prej trupave të tyre

Pas vrasjeve e djegieve, dërgimi i trupave në Serbi është një krim tjetër. Ende sot, 23 vjet më pas, më shumë se 1.600 familje të Kosovës me ankth e pa shpresë presin që trupat e më të dashurve të tyre të gjenden, t'u dorëzohen atyre, për të mos lënë varret e hapura kaq vite e pafundësisht.

5. Dhunimet seksuale të rreth 20.000 femrave, vajzave e grave shqiptare, por edhe të një numri meshkujsh, janë dhe mbesin forma më monstruoze e krimeve të luftës në Kosovë. Shumë prej të dhunuarave, pas dhunimit janë vrarë.

Shumë organizata ndërkombëtare joqeveritare dhe ekspertë të ndryshëm manipulojnë me shifrën se afër 20.000 femra shqiptare janë dhunuar nga pjesëtarët e forcave serbe në ditët e luftës. Mirëpo, sipas një burimi tjetër, kjo shifër sillet rreth 2018 femra të dhunuara gjatë luftës në Kosovë.⁸

Por, ka pasur raste kur nëse nuk arrinin ta ndanin një femër nga familjarët dhe nga kolonat e përndjekjes, e vrisnin atë, siç kishte ndodhur me Shpresa Musli Krasniqin nga Klina. Ishte shtatzënë kur e vrasin në një fshat të Gjakovës, në fshatin Lug Bunar, pasi nuk arrijnë ta zbresin nga rimorkioja e traktorit. Sot aty ndodhet një memorial që i është ngritur trimërisë, nderit, moralit dhe dinjitetit të saj.

Vrasjet pas dhunimeve paraqesin masakër të llojit të veçantë që barbaria serbe e kishte zbatuar gjatë luftës në Kosovë;

6. Spastrimi etnik:

Brenda periudhës dyvjeçare të luftës në Kosovë e sidomos ndërmjet 24 marsit 1999 kur sulmet e NATO-s fillojnë mbi caqet serbe dhe 12 qershorit kur përfundojnë ato, nga Kosova janë deportuar në Shqipëri, Maqedoni (tani të Veriut) e Mal të Zi rreth 1 (një) milion qytetarë shqiptarë të Kosovës.

⁷ Raport i KQPZH-së, Prishtinë 2020, f. 2.

⁸ Arsim Bajrami, Gjenocidi i Serbisë në Kosovë-Aspekte juridike... f. 57.

Atyre në kufi u merreshin lejet e njoftimit dhe pasaportat, për t'i hedhur ato në plehra e për të pamundësuar kthimin në vendlindjen e tyre.

Ky është rasti tipik i spastrimit etnik masiv të Kosovës.

Padyshim, po të mos kapitullonte para NATO-s ekspansioni serb, numri i shqiptarëve që ishin dëbuar nga Kosova, edhe sot do të silleshin si refugjatë nëpër vende të ndryshme të Evropës dhe botës.

Kolonat e përndjekjes e zbrazjes, kishin mbuluar rrugët e Kosovës. Prej Mitrovicës nëpër Dukagjin kolonat e njerëzve, të etur e të uritur, të rrahur e maltretuar, udhëtonin me ditë e javë për në Shqipëri e Mal të Zi, prej Kamenice e Gjilani përndiqeshin për në Maqedoni e Shqipëri po ashtu, sikundër edhe prej të gjitha komunave të tjera të Kosovës.

Treni zbrazjes nga Prishtina për në Shkup, për çdo ditë, ishte i stërm bushur.

7. Vazhden e krimeve të mëdha të luftës, e që është i pranishëm gjithë këtë kohë, e dëshmon pandëshkueshmëria e kriminelëve dhe e vrasësve mizorë serbë.

Faktet tregojnë se fare pak procese janë hapur nga organet serbe të drejtësisë e akoma më pak kanë përfunduar me të dënuar - edhe në të përfunduarat, janë shqiptuar dënime qesharake. Rast ilustrativ është ai i vrasjes së tre vëllezërve Bytyqi, qytetarë shqiptaro-amerikanë, vrasësit e të cilëve janë të njohur, por ata shëtisin sot e kësaj dite të lirë nëpër Serbi, me gjithë kërkesat e përsëritura të qeverisë amerikane për ndëshkimin e tyre.

Botërisht dihet tashmë se asgjë nuk ka ndodhur rastësisht dhe e paplanifikuar nga pushteti okupues dhe ai i luftës së ushtrisë e policisë serbe.

Po kështu, është e sigurt se për çdo masakër, vrasje ose dhunë të natyrës tjetër gjatë luftës dhe në rrethana të luftës janë mbajtur evidenca e janë bërë raportime sekrete. Ato edhe sot ruhen në arkiva shtetërore e ushtarake - policore si sekrete shtetërore në Serbi.

Prandaj, me të drejtë, Kosova kërkon me insistim që Serbia të japë informata për vendndodhjen e më shumë se 1.600 trupave të zhdukur gjatë luftës, për fatin e të cilëve nuk dihet gjë as 23 vjet pas përfundimit të saj e që, për më shumë se 1600 familje, të mos mbeten varret e hapura pafundësisht.

Pa hyrë në detaje të shumta, të cilat e pasqyrojnë barbarinë, monstruozeitetin dhe çmendurinë e urrejtjen patologjike jo vetëm ndaj shqiptarëve, por edhe ndaj forcave të NATO-s, kundër të cilave nuk u bënte punë mbrojtja, prandaj,, hakmirreshin,, ndaj popullatës civile, mund të nxirren disa përfundime, si emërues i përbashkët i maliciozitetit, i pashpirtësisë, i barbarisë e harbutërisë, i kundërnjerëzores dhe çmendurisë e absurdit, të cilat nuk mund të mendohen të vijnë nga specia njeri.

Të gjitha vrasjet e masakrat kolektive janë bërë nën komandën e ushtrisë dhe policisë serbe.

Me gjithë faktin se në Kosovë ka pasur përpjekje për grumbullim dhe evidencë të saktë e të plotë pasojave të luftës, shifra për të vvarë e masakruar, për dhunime e vrasje fëmijësh, për djegie kufomash e të zhdukur, fatkeqësisht ende nuk kemi një pasqyrim zyrtar, të plotë e të unifikuar të këtyre të dhënave.

Po kështu, besoj se është meritore që kategoria e të mbijetuarve nga makineria vrasare serbe gjatë luftës, pra kategoria e atyre që ngelën në jetë me plagë e pa të nga kordonët serbë të vdekjes, të ketë hise strukturimi në strukturat e kategorive të dala nga lufta.

Duke përfunduar, një fakt mbetet përfundimisht dhe pakontestueshëm i qartë: planet serbe ishin bërë që të vrisnin sa më shumë shqiptarë, madje me metodat më barbare, më çnjerëzore e më mizore, t'i masakronin ata dhe të fshihnin gjurmët me çdo kusht, gjë që paraqet krim të dyfishtë, si dhe paralelisht të deportonin sa më shumë prej tyre jashtë kufijve të Kosovës, në mënyrë që Kosova të pushtohej e të serbizohej përfundimisht, si edhe herë të tjera gjatë historisë.

Jusuf Osmani

MASAKRAT NDAJ GRAVE, PLEQVE, FËMIJËVE DHE TË BURGOSURVE NË KOSOVË MË 1998-1999

Abstrakt

Gjenocidit serb ndaj popullatës shqiptare në Kosovë në vitet 1998-1999 i kanë paraprirë dhe nxitur propaganda dhe gjuha fyese, urrejtja dhe diskutimet e shumta të politikanëve serbë në organet më të larta shtetërore e qeveritare në mitingjet e shumta antishqiptare në Kosovë dhe jashtë Kosovës, planet e Akademisë Serbe të Shkencave, shkrimet e gazetave ditore, mediet elektronike, si dhe botimet "shkencore" të dirigjuara një kohë të gjatë, etj. Rol të theksuar ka luajtur Kisha Ortodokse.

Në luftën e fundit të agresorit serb më 1988-1999 ndaj popullatës shqiptare në Kosovë kanë ndodhur krime gjenocidiale barbare aq të tmerrshme kundër civilëve shqiptarë, që ushtruan pa mëshirë pjesëtarët e forcave policore, ushtarake e paramilitare serbe, ku nuk kursyen as gratë, gratë shtatzëna, foshnjat, fëmijët, pleqtë, të burgosurit dhe të tjerë.

Masakrimet, vrasjet masive të grave, fëmijëve, pleqve, të burgosurve e të tjerë, dhunimet e vajzave dhe të grave të reja, djegiet dhe shkatërrimet masive të vendbanimeve, të ekonomisë dhe pronës, nuk u mjaftonin forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, por për t'i humbur gjurmët e krimeve hapnin varreza masive dhe individuale akoma të pidentifikuara, në Kosovë dhe jashtë Kosovës, në Serbi. Ka shumë raste kur kufomat janë varrosur, por pas disa ditësh janë zhvarrosur dhe dërguar në vende të panjohura.

Gjenocidi, krimet, masakrat dhe dhuna e ushtruar ndaj popullatës shqiptare, posaçërisht ndaj grave, fëmijëve, pleqve, në Kosovë në periudhën 1998-1999 janë më të rëndat dhe më tragjiket në Evropë. Lufta e fundit në Kosovë ka shënuar përmasat e një tragjedie, e cila la mijëra të vdekur dhe të zhdukur, qindra të plagosur, mijëra objekte të ndryshme të rrënuara, femra të dhunuara, popullatën e dëbuar dhe shumë pasoja të tjera.

Fjalë çelës: gjenocidi, krimet, vrasjet, fëmijët, pleqtë, gratë, të burgosurit, forcat serbe, Kosovë.

Krimet dhe vrasjet në Kosovë

Vitet 1998-1999 ishin vitet e vrasjeve, djegieve dhe të masakrimeve të qindra e të mijëra qytetarëve të pafajshëm e të pambrojtur, përfshirë edhe fëmijë, gra, e pleq. Janë këto vite të zhdukjes së dhjetëra, qindra e mijëra anëtarëve të familjeve shqiptare. Faktet dëshmuajnë se

pikërisht këtë e parashihte faza e fundit e skenarit të çmendur serbo-madh kundër shqiptarëve të Kosovës - skenarit për vrasjen dhe zhdukjen e një populli të tërë nga trojet e veta shekullore.¹

Në luftën e fundit të agresorit serb më 1988-1999 ndaj popullatës shqiptare në Kosovë kanë ndodhur krime gjenocidale aq të tmerrshme ndaj civilëve shqiptarë, që ushtruan pa mëshirë pjesëtarët e forcave policore, ushtarake e paramilitare serbe, ku nuk kursyen as gratë, gratë shtatzëna, foshnjat, fëmijët, pleqtë, të burgosurit dhe të tjerë. Përveç kësaj, krimet në Kosovë përfshinin dëbimin e popullatës, masakrat, pastrimin etnik, dhunimet, plaçkitjet, helmimin e puseve, fshehjen e kufomave, fshirjen e identitetit, keqpërdorimin e civilëve dhe puna e dhunshme, shkatërrimin e vendbanimeve dhe minimin e terrenit. Krimi në Kosovë ishte masë e paraparë dhe e planifikuar nga Serbia, përkatësisht nga qarqet e saj politike, shkencore, kulturore dhe ushtarake.²

Masakrimet, vrasjet masive të grave, fëmijëve, pleqve, të burgosurve e të tjerë, dhunimet e vajzave dhe të grave të reja, djegiet dhe shkatërrimet masive të vendbanimeve, të ekonomisë dhe pronës, nuk u mjaftonin forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, por për t'i humbur gjurmët e krimeve hapnin varreza masive dhe individuale akoma të paidentifikuara, në Kosovë dhe jashtë Kosovës, në Serbi. Ka shumë raste kur kufomat janë varrosur, por pas disa ditësh janë zhvarrosur dhe dërguar në vende të panjohura.

Vepriktaria kriminale e forcave policore, ushtarake e paramilitare serbe që ushtruan kundër popullsisë shqiptare në Kosovë ishte tërësisht identike, pothuajse në mbarë Kosovën. Vetëm viktimat shqiptare janë të ndryshme e të shumta. Kjo tregon për mënyrën e organizuar të frikësimeve, përndjekjeve, terrorizimeve, burgosjeve, ngritjes së kampeve të përqendrimit, plaçkitjeve, djegieve e shkatërrimeve, krimeve makabre e më në fund edhe zhdukjen e kufomave të të vrarëve, me qëllim të fshehjes së gjurmëve të krimeve. "*Nuk kam besuar që njeriu mund t'i bëjë diçka të tillë njeriut, derisa vizitova Kosovën*", deklaroi ish-senatori amerikan, Robert Dol, më 6 shtator 1998, para gazetarëve në Prishtinë, pasi ishte kthyer nga një vizitë që u bëri zonave të përfshira në luftime.³

¹ Vrasjet dhe masakrimet në Kosovë - Shprehje e politikës gjenocidale serbomadhe, Kushtrim Hyseni, KMDLNI, Buletini, nr. 13, tetor - dhjetor 1999, f. 110.

² Të dhënat janë marrë kryesisht nga libri: The Serb Government's Crimes in Kosova 1998-1999), Book 1, 2, State Agency of Kosova Archive, Prishtinë, 2016.

³ Qendra Informative e Kosovës, datë 8 shtator 1998; Fitnete Ramosaj, Krimet serbe në Kosovë. Pa apologji 2. Me fakte kundër shpifjeve, Prishtinë 2008, f. 189.

Gjenocidi, krimet, masakrat dhe dhuna e ushtruar ndaj popullatës shqiptare, posaçërisht ndaj grave, fëmijëve, pleqve, në Kosovë në periudhën 1998-1999 janë më të rëndat dhe më tragjiket në Evropë. Lufta e fundit në Kosovë ka shënuar përmasat e një tragjedie, e cila la mijëra të vdekur dhe të zhdukur, qindra të plagosur, mijëra objekte të ndryshme të rrënuara, gra të dhunuara, popullatën e dëbuar dhe shumë pasoja të tjera. Gjenocidi e krimi i tillë në Kosovë i zbatuar nga agresori pushtetar serb, kanë qenë veprime që kanë qenë në kundërshtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare.

Vrasjet e qëllimshme dhe të paligjshme të civilëve - ekzekutimet pa gjyq - ishin një pjesë e rëndësishme e fushatës "së spastrimeve". Në të gjithë Kosovën u vranë nga policia serbe, nga ushtarët dhe nga forcat paramilitare të implikuara në vrasjet e stilit "ekzekutim në vend", civilë të cilët dihej mirë se nuk ishin luftëtarë dhe ndër të cilët kishte shumë gra dhe fëmijë. Ato ishin masakra të vërteta. Sipas Human Rights Watch, në përgjithësi vrasjet kishin tri motive të qarta. E para ishte përsheptimi i procesit "të spastrimit" nëpërmjet kërcënimit dhe ngjalljes së frikës. E dyta, ishte eliminimi i individëve që dyshoheshin se luftonin në radhët e UÇK-së apo ndihmonin atë, dy gjëra që shpeshherë ishte vështirë të dalloheshin nga njëra-tjetra. Ndër individët e vënë në shënjestër kishte udhëheqës të shquar politikë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe biznesmenë të pasur. E treta ishte kryerja e vrasjeve për hakmarrje: disa masakra u kryen pasi forcat serbe dhe jugosllave pësuan humbje nga ana e UÇK-së. Vrasjet nuk ishin rezultat i rastësishëm i dhunës së forcave qeveritare, përkundrazi, ato ishin planifikuar me kujdes dhe vinin në jetë operacionet, që i shërbenin qëllimit strategjik të qeverisë.

Një "raport i brendshëm", i cilësuar "tepër sekret", i hartuar nga shërbimet sekrete të "Ushtrisë Jugosllave", në janar/shkurt të vitit 2000, jep një pamje të përmasave të krimeve të tmerrshme që kryen forcat ushtarake serbo-jugosllave gjatë pranverës së vitit 1999 në Kosovë.⁴

Siç del nga ky dokument, për shumë nga oficerët, propaganda që bën Beogradi është e pavërtetë dhe e pabesueshme. Komandanti i një njësie tankiste ka hedhur poshtë pretendimet e pavërteta serbe se fushata e Kosovës kishte për synim shtypjen e "separatistëve" shqiptarë, duke thënë: "*Gjatë gjithë kohës sa kam qenë në Kosovë nuk kam parë asnjë ushtar armik dhe njësia ime nuk është përfshirë asnjëherë në*

⁴ IWPR – Raporti i Krizës së Ballkanit: Miroslav Filipović, Oficerë serbë kujtojnë vrasjet (BCR Nr. 130, 4 prill 2000; Fitnete Ramosaj, Pa Apologji 2, v. e c. f. 138-139.

luftime apo nuk ka hapur zjarr ndaj objektivave ushtarake. Tanket moderne janë dërguar kundër fshatrave të pambrojtura shqiptare. Tanket, që kushtojnë 2.5 milionë dollarë amerikanë secili, janë përdorur për të masakruar fëmijë shqiptarë”, ka thënë ky oficer, për të përfunduar se për gjithë këtë “më vjen turp!”.⁵

Më 25 janar 2001, në një transmetim radiofonik të një dokumentari në Radion Publike Nacionale të Shteteve të Bashkuara, të titulluar “Fshehja e krimit”, tregohet se forcat serbe e jugosllave transportonin në mënyrë sistematike trupat e shqiptarëve të vrarë në kompleksin e minierave të Trepçës pranë Mitrovicës, ku shndërroheshin në hi. Sipas raportit që citonte luftëtarë serbë dhe “një zyrtar të informuar mirë të shërbimeve sekrete serbe”, në Trepçë ishin kremuar 1 200- 1 500 kufoma... Burra të dyshuar për lidhje me UÇK-në, vriteshin aty për aty. Një dyshim i tillë mund të bazohet ndonjëherë thjesht te fakti, që dikush kishte moshën e një luftëtari.⁶

Për të argumentuar përfshirjen e strukturave më të larta shtetërore në veprimtaritë kriminale dhe si të tilla me përmasa gjenocidale, në vijim po i referohemi një raporti të Organizatës ”Human Rights Watch”. Në raportin e tetorit 2001, kjo organizatë hulumtuese (faktmbledhëse) për krimet në Kosovë, shkruan: „Ushtria jugosllave kishte komandën e përgjithshme gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s. Sipas ligjit, ajo kishte nën varësinë e saj policinë dhe forcat paraushtarake, megjithëse zyrtarët e lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme serbe ushtruan dukshëm një influencë të rëndësishme gjatë fushatës. Ushtria kontrollonte rrugët kryesore dhe kufijtë duke koordinuar dhe lehtësuar kështu “spastrimin etnik” (në Kosovë). Policia dhe forcat paraushtarake u përfshinë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në dëbimin e civilëve dhe shkatërrimin e fshatrave, për të cilën kishin mbështetjen e artilerisë së ushtrisë (serbe-vërejtja ime). Gjatë këtyre operacioneve burrat veçoheshin nga gratë dhe fëmijët për t’u marrë në pyetje për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe ekzekutoheshin në vend.”⁷

Ideologu e nacionalisti serb, Dobrica Qosiq, më 12 qershor 1999, në kujtimet e tij në librin “Kosovo”, Beograd, 2004, në mes tjerash tregon për takimin dhe bisedën që ka zhvilluar me patriarkun Pavle. “I kam thënë: “Lartmadhëria e Juaj, më thuani ju lutem, se çka ka ndodhur në Kosovë dhe Metohi”. A kanë bërë serbët vepra të këqija. Dhe

⁵ M. Filipoviq, Oficirët serbë kujtojnë vrasjet..., p. i cit.

⁶ “Ne kerkim...”emisioni 16 TV Kosova.

⁷ Marrë nga faqja e internetit: Krimet në Kosovë.

ata kanë plaçkitur dhe vrarë në vendet ku janë zhvilluar luftërat me shqiptarët. Dhe i kanë rrënuar disa xhami, që kurrsesi nuk është dashur të ndodhë”. “Patriku ka heshtur dhe duke vështruar në kryqin e tij, me një zë që mezi dëgjohej ka thënë: Po edhe serbët kanë bërë vepra të këqia. Edhe ata kanë plaçkitur dhe kanë vrarë në vendet ku janë zhvilluar luftimet me shqiptarët dhe i kanë rrënuar disa xhami, që kurrsesi nuk është dashur të ndodhë..”.

Në një intervistë në “American Radioworks”, me të ashtuquajturin “Millosh”, pjesëtar i një njësie speciale të policisë sekrete, ky në mes tjerash deklaroi përkitazi me grupet paramilitare: “... Të gjitha këto grupe kishin zonat e tyre, ku kryenin operacione dhe ishin të lejuar të bënin çfarë të donin. Ata viheshin qëllimisht në vende të caktuara, e ndërkohë u thuhej të bënin atë që donin, me kusht që detyra të realizohej. Ishte detyra e tyre të vrisnin, të përdhunonin e të bënin atë që dëshironin....”⁸

Shumë shqiptarë të vrarë në Kosovë, trupat e pajetë të tyre janë zhvendosur jashtë Kosovës, me qëllim të zhdukjes së shenjave të krimit të kryer. Kjo është vërtetuar në hapjen e varrezave të shumta nëpër Serbi. Përveç kësaj, dyshohet se shumë kufoma të shqiptarëve janë djegur në furra të shkretoreve, siç flitet edhe në atë të Zveçanit.

Vrasjet e fëmijëve

Nataliteti më i lartë te shqiptarët në Kosovë në krahasim me viset tjera të ish Jugosllavisë ishte temë e shkrimeve negative në propagandën zyrtare serbe. Thuhej se ai është pjesë e politikës së paramenduar që të shtohet popullsia shqiptare. Kjo i kishte nxitur shumë paramilitarë serbë që të bënin vrasje edhe në fëmijë. Por, me të gjitha normat ndërkombëtare në botë, si në paqe edhe në luftë fëmijët janë të mbrojtur.

Mirëpo, nga pushteti serb fëmijët konsideroheshin armiq të ardhshëm të Serbisë, andaj edhe këta u vranë e u masakruan në forma të ndryshme. Ata masakroheshin dhe ekzekutoheshin nga forcat serbe po sikur të ishin të rritur. Ka shumë raste kur fëmijët janë vrarë në mënyra më mizore. Madje, janë masakruar edhe foshnjat e palindura, në bark të nënave, ose ata të porsalindurit. Në disa raste, qëllimi i vrasjeve të

⁸ Human Rights Watch, Under Orders, War Crimes in Kosovo, New York, Washington, London, Brussels, Albanian translation “Korbi”, Tirana, 2002, p. 89.

fëmijëve ishte edhe tmerrimi dhe traumatizimi i prindërve dhe të rriturve të tjerëve. Ata janë marrë dhe vrarë para prindërve ose prindërit janë vrarë para tyre. Kishte raste të shumta kur fëmijët merreshin pengë për përfitime materiale, ndërsa disa fëmijë femra ende të mitura janë dhunuar. Vrasjen e fëmijëve të shumtë e dëshmon numri i madh i fëmijëve të vrarë në regjistrin e personave të vrarë dhe të masakruar nëpër tërë Kosovën.⁹ Një dëshmitar serb në mes tjerash tregon: “Në tre muajt e ardhshëm kam parë tmerret – si janë vrarë fëmijët, civilët dhe meshkujt dhe femrat. Se si plaçkitesh me të madhe, gjatë natës është bartur malli i vjedhur nëpërmjet kanaleve të caktuara etj.”¹⁰

Vrasjet e fëmijëve, Forcat e armatosura serbe, edhe përkundër Konventës për të drejtat e fëmijëve (1998) dhe Deklaratës botërore për mbijetesën, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve (1990), në fund të shekullit XX në Kosovë, kundër popullit shqiptar, posaçërisht kundër fëmijëve kanë zbatuar kampanjë të koordinuar, afatgjatë, gjithëpërfshirëse dhe të fortë.

Gjatë kohës së eskalimit të luftës në vitin 1998, e posaçërisht në periudhën pas fundit të muajit mars 1999, pësimet e fëmijëve ishin të shpeshta dhe mjaft të mëdha. Ndër aspektet më makabre të konflikteve, janë vrasjet me paramendim të fëmijëve shqiptarë, të cilët i vinin në shënjestër ushtarët serbë.

Fëmijët e tjerë që nuk ishin vrarë, kanë përjetuar lëndime të rënda që ishin në kundërshtim me të drejtën humanitare, duke përfshirë edhe torturën dhe keqtrajtimet.¹¹ Fëmijët shqiptarë të Kosovës gjatë luftës së agresorit pushtetar serb në mënyrë sistematike dhe masovikisht e individualisht janë vrarë dhe plagosur. Duke u bazuar në numrin e madh të fëmijëve të vrarë, mund të konstatohet se ndaj fëmijëve shqiptarë të Kosovës janë bërë akte të planifikuara, të organizuara dhe sistematike me qëllim të asgjësimit të shqiptarëve, në aspektin nacional, etnik dhe fetar.

Fëmijët shqiptarë jo vetëm që nuk ishin të kursyer nga dhuna shoviniste, por në të kundërtën, ata posaçërisht ishin në shënjestër. Ishin në shënjestër të forcave serbe me motivacion se ata ishin ”armiqtë të ardhshëm të Serbisë”. Kështu që, “armiqtë e ardhshëm të Serbisë” llogariteshin edhe

⁹ Prof. dr. Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë 1998-1999*, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 58.

¹⁰ *Elektronske Novine*, 9. 11.2013, Svedočenje: Očevidac monstroznosti srpskih snaga na Kosovu (1) Pravili su lampe od albanskih lobanja. Razgovarao: Bojan Tončić. Svedok monstroznih zločina: Slobodan Stojanović.

¹¹ *Analiza OEBS Verifikacione misije Kosovo*. Stanje ljudskih prava oktobar 1998 – jun 1999 godine. Fond za humanitarno pravo, Edicija Dokumenta, Beograd, 2004, fq. 126.

foshnjat në djep dhe në gji të nënës. Një grua e përshkruan se si ka dëgjuar pjesëtarin e njësisë paramilitare i cili ka thënë se duhet të vriten të gjithë fëmijët, sepse këta, nëse rriten, do të hakmerren¹².

Një “raport i brendshëm”, i cilësuar “tepër sekret”, i hartuar nga shërbimet sekrete të “Ushtrisë jugosllave”, në janar/shkurt të vitit 2000, jep një pamje të përmasave të krimeve të tmerrshme që kryen forcat ushtarake serbo-jugosllave gjatë pranverës së vitit 1999 në Kosovë.¹³ Veçanërisht tronditëse ishin dëshmitë për vrasjen e fëmijëve. *“Dëshmitë e përbashkëta të oficerëve në terren, tregojnë se njësitë e Ushtrisë jugosllave kanë qenë përgjegjëse për vdekjen e të paktën 800 fëmijëve shqiptarë nën moshën 5 vjeç”*.¹⁴

Gazeta, DIE ZEIT e Hamburg-ut ka botuar një shkrim tronditës mbi shtazëritë e kriminelëve serbë në Kosovën e kësaj pranvere të përgjakur, ku në mes tjerash shkruan: *“... Gjatë ngrënies Mirko ka rrëfyer për shokun e tij Josipin, për luftën në Kosovë dhe mbi atë se si kishte qëndruar aty pranë kur Josipi kishte vrarë fëmijën. Josipi dhe Mirko nuk e dinin se prej nga vinte fëmija, nuk e dinin si quhej, nuk e dinin se sa vjet kishte. Por, kjo aq u bënte, sepse e vetmja që i interesonte Josipit, ai e shihte me sy: ishte shqiptar. Ishte një “shiptar”. Andaj Josipi në orët e para të pasditës së 6 prillit 1999 mori një çekan dhe me shtatë goditje copëtoi kafkën e fëmijës. Ishte rreth tetë vjeçar. E tërë kjo nuk kishte zgjatur më shumë se dhjetë sekonda. Pastaj, thotë Mirko, “përbindëshi i vogël më në fund vdiq”. Mirko kishte parë se si shokun e tij, Josipin, e kishte shkundur neveria. Diç nga truri i djaloshit kishte përlyer uniformën. Josipi kishte marrë një leckë dhe ishte përpjekur ta fshijë masën me ngjyrë të përhime në të verdhë. Por, truri nuk po fshihej. “Mut i mallkuar”, kishte dëgjuar Mirko shokun e tij Josipin duke u çjerrë. Ky ia kishte dhënë një shqelm trupit të fëmijës së vdekur. Pastaj kishte marrë kufomën, e kishte futur në një valixhe, e kishte “stolisur” me gjashtë granata dore përreth dhe e kishte lidhur atë me një spagë me kyçin e valixhes...”*¹⁵

¹² Po aty.

¹³ IWPR – Raporti i Krizës së Ballkanit: Miroslav Filipoviç, Oficerët serbë kujtojnë vrasjet (BCR Nr. 130, 4 prill 2000; Fitnete Ramosaj, Pa Apologji 2, v. e c. fq. 138-139.

¹⁴ IWOR – Raporti i Krizës së Ballkanit: Miroslav Filipoviç, Oficerët serbë kujtojnë vrasjet...: IWPR – Raporti i Krizës së Ballkanit: Antoni Borden, Historia e Filipoviçit: BCT Nr. 231, 30 mars 2001; F. Ramosaj, Pa Apologji 2, v. e c. fq. 139; Mikel Ndreca, 87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999), Prishtinë, 2001, fq. 336.

¹⁵ “Koha Ditore”, 23 dhjetor 1999, përgatitur nga Enver Robeli; Rustem R. Berisha, Hollokausti shqiptar I, Neë York – Prishtinë, 2010, fq. 104-105.

Një oficer i quajtur Drazhen, i cili ka marrë pjesë në luftë në Kosovë, kujton: *"Kam parë me sytë e mi se si një rezervist rreshtoi para një muri rreth 30 gra dhe fëmijë shqiptarë. Mendova se ai donte vetëm t'i frikësonte ata, por pastaj shkoi pas një mitralozi të rëndë kundërajror dhe tërhoqi këmbëzën. Plumbat 12 milimetërsh i këputnin në mes trupat e tyre. Më dukej si një skenë e ndonjë filmi aksion, por në fakt ajo ndodhi me të vërtetë". Drazheni përfundon: "Nuk e di se si do të jetoj me këto kujtime, se si mund t'i rris fëmijët e mi. Unë dëshiroj t'i shoh para gjykatës ata që kanë kryer këto krime."*¹⁶

Një epror i ushtrisë jugosllave, i quajtur Miroslav Filipoviç, i cili kishte folur për gazetën "Danas", në mes tjerash kishte deklaruar se ushtria jugosllave është përgjegjëse për vrasjen e së paku 800 fëmijëve shqiptarë. *"Tanket serbe janë përdorur për të masakruar fëmijët shqiptarë..."*¹⁷

Në bazë të ekspertizave mjekësore është konstatuar se shumica e viktimave ishin ekzekutuar nga afër, ndërsa një numër jo i vogël janë masakruar edhe me armë të ndryshme të ftohta. Në mesin e trupave të shqiptarëve të gjetur në varrezat masive në Batajnicë, një numër i madh i trupave ishte i grave dhe fëmijëve.

Një dëshmitar tjetër serb tregon edhe për vrasjen e fëmijëve në djep. "Në shtator të vitit 1998 kemi luftuar në fshatrat mbi Prizren, si në Lez, Lybiçevë, Hoçë e Qytetit, në të ashtuquajturën pastrim i terrenit. Nuk do ta përmendi emrin e policit, edhe sot është gjallë, është pensionist, në rrethana të qeta në djep e vrau fëmijën, i cili nuk ishte më i vjetër se katër muaj. Me thënien se *"Më mirë shqiptar i vdekur, sesa shqiptar i gjallë"*. Kam dashur që ta vrasë. E kuptova se nuk kam shkuar në Kosovë me grup të policëve, por me grupin të cilin nuk mund ta definoj, se ata nuk ishin as kriminelë. Isha me sadistët, të sëmurit, maltene më kanibalët, vetëm se nuk i kanë hëngër ata njerëz."¹⁸ Raste të tilla të vrasjeve të fëmijëve dhe të tjerëve ka pasur shumë në Kosovë.

Shumë fëmijë për shkak të kushteve të vështira gjatë qëndrimit ose lëvizjeve e dëbimit kanë vdekur nëpër male. Kanë vdekur edhe fëmijët e porsalindur.

¹⁶ M. Filipoviç, Oficirët serbë kujtojnë vrasjet, p. i cit.; F. Ramosaj, Pa Apologji 2, v. e c. fq. 140.

¹⁷ Mikel Ndreca, 87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999), Prishtinë, 2001, fq. 336.

¹⁸ Elektronske Novine, 9. 11.2013, Svedočenje: Očevidac monstroznosti srpskih snaga na Kosovu (1) Razgovaraao: Bojan Tončić. Svedok monstroznih zločina: Slobodan Stojanović.

Gjatë luftës në Kosovë (1998- 1999), nga hulumtimet e bëra në terren dhe regjistrimin e viktimave të luftës është konstatuar se më shumë se 11% e viktimave të luftës janë fëmijët. Sipas të dhënave të grumbulluara për numrin e fëmijëve të vrarë dhe të pagjetur, por të rënë edhe dëshmorë në Kosovë në periudhën janar 1998 – 12 qershor 1999 janë gjithsej 1.396 fëmijë (1011 meshkuj dhe 385 femra) të moshës deri 18 vjeç. Ndërsa, të nacionalitetit serb kanë pësuar 14 fëmijë. Gjithsej 1300 fëmijë të vrarë dhe të pagjetur. Ndërsa, deri në moshën 5 -vjeçare kanë pësuar 299 fëmijë, duke mos llogaritur ata që kanë vdekur menjëherë pas lindjes dhe nuk ishin të pagëzuar, si dhe ata në bark të nënës së vrarë. Duhet përmendur se më 12 dhjetor të vitit 1998 nga shërbimi sekret serb, në kafenenë e quajtur “Panda” në Pejë janë vrarë 6 persona serbë, prej tyre 5 fëmijë, me qëllim që të akuzohen pjesëtarët e UÇK-së se kinse ata po bëjnë krime edhe ndaj fëmijëve.

Shumë fëmijë për shkak të kushteve të vështira gjatë qëndrimit ose lëvizjeve e dëbimit kanë vdekur nëpër male. Kanë vdekur edhe fëmijët e porsalindur.¹⁹ Statistikat e organizatave humanitare ndërkom-bëtare, që kanë vepruar në Kosovë, në fund të vitit 1999, kanë publikuar të dhënat e tyre se si pasojë e luftës 27.000 fëmijë kanë mbetur jetimë, 12.000 prej të cilëve pa asnjërin prind. Gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), nga organizatat e ndryshme humanitare është konstatuar se 20% e viktimave të luftës janë fëmijët dhe se 5% e viktimave të fëmijëve në Kosovë është më e lartë se ajo e të gjitha vendeve të pushtuara nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore.²⁰

Numri i përmendur i fëmijëve të vrarë gjatë luftës në një vit e gjysmë, vendet dhe mënyrat e vrasjeve, qartë tregojnë që vrasjet nuk ishin të rastësishme, që fëmijët nuk ishin viktimë kolaterale, por qëllim i sulmuesve. Vrasja e fëmijëve të pafajshëm e të paafte për vetëm-brojtje, dëshmon për urrejtjen e sulmuesit. Kjo statistikë për dhunën ndaj fëmijëve është më tragjike në historinë e re të Evropës.

Fëmijët janë vrarë në regjione të ndryshme të Kosovës dhe se janë vrarë në mënyra të ndryshme nga armët e zjarrit apo armë të ftohta dhe se trupat e tyre janë gjetur nëpër vende të ndryshme (në shtëpi, në rrugë, nëpër pyje, nëpër strehimore të improvizuara, në automjete transporti).

¹⁹ Në regjistrin e viktimave të luftës të shumtën e rasteve këta fëmijë nuk ishin të pagëzuar dhe as të regjistruar si viktimë të luftës. Andaj, regjistrat që pasojnë për të vrarët nuk janë komplet dhe mungojnë të dhënat për ta.

²⁰ Nexhat Çoçaj, Shtigjeve të Lirisë, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës, Prizren, 2009, fq.98.

Vrasjet e femrave shqiptare

Femra shqiptare që ngaherë ishte në shënjestër të propagandës shoviniste serbe. E njohur ishte thënia e Vasa Çubriloviçit për gruan shqiptare në vitin 1937, e cila me lindshmërinë e saj e mundi projektin serb për shpërngulje të shqiptarëve dhe kolonizimin e Kosovës me elementin serb. Një propagandë e ashpër serbe kundër nënës shqiptare u zhvillua në vitet tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë të shek. XX. Pas vitit 1981 në shënjestër të propagandës nacionaliste serbe u gjet nataliteti i madh i shqiptarëve, që u manifestua përmes dhunës ndaj shqiptarëve që atëherë (policët godisnin femrat shqiptare, studentët në gjenitalet e me kërcënimin morbid: “më s’do të lindësh separatistë” (1981); pastaj serbët tentuan që “shkencëtarisht” ta vërtetonin këtë tezë morbide, se kinse, shqiptarët i shfrytëzojnë gratë për numër enorm lindjesh (gratë lavartiçe) për synimet e tyre separatiste pa vullnetin e tyre. Gruan shqiptare e paraqitnin si injorante që nuk di asgjë tjetër, pos të prodhojë fëmijë. Kjo i çoi serbët drejt verbërisë nacionaliste, për të arritur deri te shqyerja e barkut të nënave shqiptare (madje edhe shtatzëna dhe vrasja në fund e pjellës së tyre.²¹ Kjo urrejtje ndaj femrës shqiptare u reflektua edhe në vrasje të shumta në luftën e vitit 1998-1999. Vrasjet e femrave shqiptare ishin një atak vrastar, jo vetëm në jetën dhe në integritetin fizik të femrës shqiptare, por edhe në nderin dhe dinjitetin moral e shpirtëror të saj dhe jo vetëm të saj, por edhe të burrit e të fëmijëve të saj, të të afërmeve dhe të të njohurve të saj.

Gratë gjatë luftës ishin të rrezikuara në një formë tjetër nga meshkujt. Ato, përveç që në shumë raste janë vrarë, ato ishin dhunuar ose seksualisht keqtrajtuar. Në gjendje më të vështirë ishin gratë shtatzëna. Ato në shumë raste lindin në kushte të pazakonshme, në pyll, në stacion të trenit, duke pritur gjatë rrugës, në kalimet kufitare, etj. Kështu që shumë foshnje të porsalindura vdisnin. Në disa raste për shkak të urrejtjes së madhe, gratë shtatzëna goditeshin në bark, ose ushtarët i vritnin ose ua nxirrnin frytin.²² Gratë në luftë u bënë një grup potencial i madh i frikës, kërcënimit, urisë, sakrificës, vrasjeve, dhunimeve dhe spastrimit etnik.

Sipas shënimeve me të cilat posedojmë në periudhën janar 1998 deri më 12 qershor 1999 në Kosovë janë vrarë apo zhdukur 1.776 femra,

²¹ Halil Matoshi, Lufta, lojë apo sëmundje, “Koha ditore”, 9 korrik 2011.

²² Marrë nga Analiza e OEBS, Verifikacione misije Kosovo. Stanje ljudskih prava, oktobar 1998-jun 1999, Beograd, 2004, fq. 122.

të moshave të ndryshme, duke përfshirë edhe 52 femra të kombësisë serbe që u vranë ose janë zhdukur.²³ Disa prej atyre femrave shqiptare kanë rënë edhe dëshmor.

Vrasjet e të rinjve

Në shënjestër të forcave serbe ishin vënë edhe të rinjtë shqiptarë. Vrasjet e tyre bëheshin në forma të ndryshme. Vriteshin vetëm se ishin meshkuj dhe të rinj dhe me mundësi potenciale të inkuadrohen në UÇK. Më të rrezikuarit ishin të rinjtë, të cilët pësonin më së shumti, duke ikur dhe ziheshin meqë vinin nga zonat, të cilat ishin çerdhe të UÇK-së. Kishte raste kur ndonjë i ri apo edhe i moshuar është vrarë se e kishte mbiemrin e njëjtë me luftëtarët e njohur të UÇK-së. Të rinjtë merreshin dhe ndaheshin nga konvojet, merreshin në fshat me rastin e rrethimit. Ata ose vriteshin menjëherë, madje edhe para familjeve, ose torturoheshin ose merreshin dhe për fatin e tyre nuk dihej më kurrë.

Të rinjtë para se të vriteshin provokoheshin nga forcat serbe duke i detyruar të thoshin “Rroftë Serbia”, të ngrinin tre gishtërinjtë etj. Si motiv merrnin kinse në duart e tyre po u vjen era barut, sepse kanë luftuar në radhët e UÇK-së.

Vrasjet e familjeve të tëra

Ndër modalitetet e posaçme të gjenocidit të ushtruar është vrasja e anëtarëve të shumë familjeve dhe zhbërja e institucionit më të nderuar dhe më të mbrojtur të shqiptarëve. U bënë vrasje e masakrime të familjeve të tëra shqiptare. Të vrarë ishin me dhjetëra e dhjetëra banorë. Karakteristikë e këtyre dhe shumë rasteve të tjera si këto është fakti se vrasjet kanë qenë të qëllimta dhe janë kryer, pothuajse në të gjitha rastet, brenda shtëpisë. Shkak i sulmit ishte qenia e tyre shqiptare. Objekt i sulmit ishte familja shqiptare si bërthamë e entitetit shqiptar të Kosovës, kurse viktima të dhunës e të gjenocidit në të shumtën e rasteve ishin, fëmijët e të rinjtë, gratë dhe të moshuarit.²⁴

²³ Jusuf Osmani, *Serb Government's Crimes in Kosova 1998-1999*, Book 1, Book 2, Prishtinë, 2016, f. 170.

²⁴ Vrasjet dhe masakrimet në Kosovë - Shprehje e politikës gjenocidale serbomadhe, Kushtrim Hyseni, KMDLNJ, Buletini, nr. 13, tetor - dhjetor 1999, fq. 111.

Këtu duhen përmendur familjet Jashari në Prekaz të Poshtëm, Deliu e Ahmetaj në Abri, Bogujevci nga Podujeva, Muçolli në Poklek, Hoti në Krushë të Madhe, Berisha në Suharekë, Krasniqi në Carallukë, Gashi nga Tërnia, Krasniqi në Pastasel, Morina në Astrazub, Gërxhaliu nga Studimja e Poshtme dhe shumë të tjera.

Përkitazi me vrasjen e familjes së Selatin Gërxhaliut në Studime të Poshtme të komunës së Vushtrrisë, më datën 31 maj 1999 ku pothuajse të gjithë ishin fëmijë, një i afërm i tij, që kishte shkuar për ta thirrë policinë në Vushtrri dhe kishte ardhur të hetonte në vendngjarje kishte deklaruar: *“Policët dhe gjykatësi hetues erdhën e bënë fotografi. Na thanë që do të na japin kopje të fotove, gjë që nuk ndodhi. Kur hyra brenda, gjykatësi hetues, një grua nga Mali i Zi, ia plasi të qarës. Njëri nga policët e pyeti, pse po qante. Gruaja tha: “Po fëmijët, çfarë kanë bërë?”. Njëri nga policët, Dragan Petroviç ia ktheu: “Kjo është luftë, shoqe”. Unë i thashë atij: “Lufta është burrat me burra, kështu që po ua mbajti shko në pyll dhe lufto me UÇK-në. Këta janë fëmijë që i kanë vrarë në gjumë”. Petroviçi pa nga unë, por nuk më foli. Pasi bënë fotografitë, thanë se do t’i varrosnin të vrarët, sepse do të sillnin njerëz nga Mitrovica. Ata shkuan në Vushtrri me veturë, por më pas u kthyen dhe na thanë neve që t’i varrosim të vrarët”.*²⁵

Vrasjet e pleqve dhe të invalidëve

Edhe pleqtë e shumë dhe invalidët në Kosovë rënë viktima të luftës²⁶. Shumë prej tyre në pamundësi për të ikur ose duke e konsideruar vetën të moshuar, nuk u larguan nga shtëpia, me gjithë insistimin anëtarëve të familjes që së bashku të largohen. Ata që janë gjetur në shtëpi, armiku i ka vrarë ata në mënyrë më mizore duke i djegur, masakruar madje, edhe duke i hedhur në puse, siç është rasti në fshatin Dragaçinë të Suharekës, ku 11 pleq të fshatit i kanë hedhur në një pus. Shumë pleq në aspektin tradicional bartin plisat e bardhë, pikërisht ata ishin në shënjestër për shkak të plisat dhe pësonin duke u vrarë ose duke

²⁵ Marrë nga: Human Rights Watch, Nën Pushtetin e Urdhrave, Krimet e Luftës në Kosovë, New York, Washington, London, Brussels, 2001, fq. 442.

²⁶ Duhet theksuar se gjatë vizitës nëpër fshatra të Kosovës, sidomos ato të Drenicës rreth marrjes së të dhënave për të kaluarën historike të Kosovës, në fshat kërkjoja pleqtë, mirëpo, në disa raste nga fëmijët që i takoja në rrugë më thoshin se nuk kemi pleq në fshat, të gjithë i kanë vrarë gjatë luftës.

u keqtrajtuar në mënyrën më barbare. Ky sulm në ta konsiderohej si sulm në kulturën dhe në traditën shqiptare

Pleqtë dhe invalidët, duke mos pasur mundësi të lëviznin në mënyrë të pavarur, ata barteshin në forma të ndryshme nga të afërmit, si bartje në shpinë, në karroca të dorës dhe të tjera. Ka pasur raste kur pleqtë janë fshehur nëpër male me ndonjë të afërm dhe kanë qëndruar me muaj të tërë.

Shumë pleq gjatë qëndrimit nëpër male dhe lëvizjes prej një vendi në vendin tjetër, për shkak të kushteve të vështira jetësore, vdisnin. Vdekje të tilla ka pasur edhe në kampin e Bllacës.

Një dëshmitar serb në Gjykatën e Beogradit dëshmon për shumë vrasje. Përkitazi me vrasjen e një plaku thekson: *“Më kujtohet edhe një vrasje që Luçica e ka kryer në fshatin Pagarushë, jo larg Rahovecit. Pas marrjes së fshatit, një grup i policëve, në mesin e të cilëve isha edhe unë, shkaku i shiut u strehuam në një shitore buzë rrugës në qendër të fshatit. Papritur u paraqit një njeri me shkop në dorë dhe me plis në kokë. Ishte shqiptar në moshë mbi 80 -vjeçare, shkonte qetë, me kokë të ulur. Kur kaloi afër shitores, Luçica e ngriti pushkën dhe e mori në shenjë, ne të gjithë e shikonim me habi, duke mos besuar që ai do të shtijë në plakun e paarmatosur. Por, ai e vrau me gjakftohtësi, duke shtirë në të nga një afërsi e vogël...”*²⁷

Në luftë pësuan edhe shumë të moshuar dhe invalidë. Në bazë të të dhënave që kemi arritur t’i grumbullojmë në Kosovë janë vrarë apo zhdukur 1.843 persona mbi moshën 65 -vjeçare, që mund të konsiderohen pleq. Disa persona të moshuar kanë rënë si dëshmorë në altarin e lirisë.

Vrasjet në burgje

Në burgjet e Serbisë, por edhe në Kosovë para dhe gjatë luftës mbaheshin me mijëra shqiptarë të arrestuar në mënyra të ndryshme, nën akuzat "bashkim për veprimtari armiqësore" dhe "terrorizëm". Disa prej tyre janë vrarë në burgje që para luftime. Mirëpo, gjatë luftës u bë vrasja masive e të burgosurve shqiptarë në Burgun e Dubravës, më 22-24 maj 1999. Duhet theksuar se gjatë luftës më se 2.000 shqiptarë ishin marrë

²⁷ Publikuar: 30.11.2013 - 10:54 në internet. Beograd, 29 nëntor – Redaksisë së botimit elektronik enovina i është paraqitur polici Petar Gjorgjeviç, i cili ka akuzuar pjesëtarët e MUP-it serb për krime monstruoze në Kosovë dhe pas kësaj, siç pohon, ai ka qenë viktimë e Njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve, si dhe të Prokurorisë për krime lufte të Serbisë.

peng dhe burgosur në burgjet e ndryshme të Serbisë, disa prej të cilëve më vonë janë liruar.

Vrasjet e intelektualëve e veprimtarëve politikë e humanitarë

Individët apo grupet, të cilat në një farë mënyre kanë luajtur rol të rëndësishëm në jetën publike të shqiptarëve të Kosovës, në masë të madhe ishin keqtrajtuar, burgosur, bastisur, madje edhe vrarë. Të rrezikuar ishin grupe të ndryshme: politikanët dhe individët e tjerë të shquar, liderët fetarë, mjekët, gazetarët, profesorët, studentët, veprimtarët e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ata që punonin në organizatat e huaja joqeveritare që deri më atëherë vepronin në Kosovë, si dhe personat e pasur. Ata konsideroheshin "armiç" ose elementë subverzivë. Andaj, në Kosovë, objekt i dhunës dhe i terrorit serb u bënë edhe intelektualët e veprimtarët politikë e humanitarë.²⁸

Vrasjet e inskenuara dhe mburoja njerëzore

Mbrojtja e civilëve dhe joluftëtarëve në konfliktet e armatosura shtrihet edhe në ndalimin e shfrytëzimit të atyre personave me qëllim që të ndikojnë në rrjedhën e operacioneve të luftës. Ky parim sidomos është definuar në të drejtën humanitare ndërkombëtare, e cila rregullon konfliktin e armatosur ndërkombëtar, ku ndalon shfrytëzimin e popullatës civile ose të individëve që në ndonjë vend ose territor për „mbrojtje të operacioneve ushtarake". Palëve në konflikt gjithashtu u ndalohet që të largojnë individët ose grupet me qëllim që të fshehin qëllimet ushtarake nga sulmet.

²⁸ Të njëjtin rast gati e kam përjetuar edhe unë. Më datën 5 prill të vitit 1999 disa persona me një regjistër kanë ardhur dhe më kanë kërkuar në banesën në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Unë një ditë më parë kisha arritur të largohem dhe të strehohem në Shkup. Pasi nuk më kanë gjetur, tërë banesën e demoluan, morën disa gjëra të vlefshme dhe dokumente historike arkivore. Pastaj, kanë pyetur disa fqinjë që nuk kishin ikur se ku jam. Ata i kishin thënë se jam në Sllatinë të Madhe. Kanë shkuar në Sllatinë të Madhe ku kam lindur dhe e kam pasur shtëpinë. Popullata e Sllatinës ishte dislokuar në pyll, mbi fshat. Atëherë në shenjë hakmarrjeje kanë shkuar në shtëpinë ku kam pasur një bibliotekë dhe arkiv të pasur dhe e kanë djegur.

Ky ndalim i shfrytëzimit të „mburojës njerëzore” është e lidhur ngushtë me dy parimet e tjera të përbashkëta me konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe të brendshme. Njëri ndalon marrjen e pengjeve, tjetri ndalon shkaktimin e dëmit „atyre që nuk janë të ndërlidhur drejtpërdrejt në veprimet armiqësore”. Shfrytëzimi i këtyre “mburojave njerëzore” është e ndaluar me nenin 28 të Konventës së Gjenevës, në të thuhet: *“Pjesëmarrja e personit për mbrojtje nuk guxon të shfrytëzohet që pikat ose trevat e caktuara të mbrohen nga operacionet ushtarake”*.

Mirëpo, forcat ushtarake e policore serbe vepruan në të kundërtën. Civilët dhe të burgosurit shqiptarë në Kosovë janë shfrytëzuar që të mbrojnë forcat e armatosura nga sulmet e NATO-s.

Mburojat njerëzore nuk janë shfrytëzuar vetëm për mbrojtje kundër sulmeve të NATO-s. Ato shfrytëzoheshin për fitim të epërsisë në terren gjatë kohës së operacioneve ushtarake. Civilët dhe të burgosurit viheshin para ushtarëve serbë në sulm kundër njërive të UÇK-së dhe shërbenin si mburojë. Ata deklarorin se nëse një ushtar serb vritet, ata që ishin si mburojë do të vriteshin të gjithë. Në shumë raste njësitë ushtarake i detyronin civilët të shkonin para me qëllim që ato lokalitete mund të ishin të minuara. Kishte raste kur popullata nuk lejohej të largohej nga fshati, ku qëndronin njësitë ushtarake serbe me qëllim të mbrojtjes nga sulmet e anës kundërshtarë. Popullata që qëndronte aty ishte e detyruar që të kryente punë të ndryshme për njësitë ushtarake. Ka edhe raste të tjera, sidomos të burgosurit shqiptarë shfrytëzoheshin për kryerjen e punëve të rrezikshme në dobi të forcave të armatosura serbe.

Të dy strategjitë janë paramenduar me qëllim të krijimit të mbrojtjes njerëzore të forcave serbe ndaj sulmeve të NATO-s dhe të UÇK-së. Raste të tilla të mburojës njerëzore dhe të pësimit të civilëve apo të zënëve peng në Kosovë ka shumë, siç ishin rastet në Korishë të Prizrenit e në Lluzhan të Podujevës, në Bishtazhin të Gjakovës, etj.²⁹

Vdekjet nga pasojat e luftës

Gjatë asaj kohe në Kosovë pati edhe vdekje të shumta si pasojë e luftës. Shumë banorë ishin detyruar t'i lëshojnë shtëpitë dhe banesat e tyre dhe të strehohen nëpër male, të vendosur nëpër tenda ose në qiellin

²⁹ Prof. dr. Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999*, 1, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 59.

e hapur që ishin rrezik i përhershëm, jo vetëm nga granatimet serbe, por edhe nga të ftohtit, uria, etja, mungesa e barnave etj. Disa kalonin edhe kilometra të shumta prej një vendi në tjetrin për strehim. Si pasojë e të gjitha këtyre shumë veta kanë vdekur, sidomos fëmijë, pleq, të sëmurë, të hendikepuar dhe të tjerë.

Pësimet nga minat

Armët dhe armatosja, përdorimi i të cilave është i përkufizuar ose posaçërisht janë të sanksionuara me të drejtën humanitare janë: armët dhe armatosja biologjike, kimike, ato për djegie, laserike, minat etj. Këto të fundit janë vendosur në një pjesë të madhe të territorit të Kosovës. Minat ishin vrasësit e padukshëm.

Gjatë gjithë vitit 1998 e gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 1999, forcat serbe e jugosllave vendosën në Kosovë afro 50.000 mina antitank dhe antipersonel, sidomos gjatë kufirit me Maqedoninë e Shqipërinë.³⁰ Minat paraqesin mjetet më vdekjeprurëse të luftës në Kosovë. Sipas të dhënave të “Kosova Live”, të datës 20 nëntor 2000, në Kosovë janë të vrarë 103 persona dhe 394 të gjymtuar nga minat. Pak a shumë e njëjta gjë thuhet edhe në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në korrik 2000, ku nënvizohej se nga 12 qershor 1999 deri në korrik 2000,³¹ si pasojë e minave dhe predhave të paplasura, u vranë 101 vetë e u plagosën 395 të tjerë. Minat ishin vendosur edhe nëpër shkolla. Sipas një raporti të një Agjencie Amerikane të Zhvillimit Ndërkombëtar, më shumë se 900 shkolla kishin nevojë të pastroheshin nga minat.³²

Kështu, përveç formës së vrasjes, njësitë ushtarake minuan një pjesë të madhe të tokës së Kosovës, kryesisht në pjesët kufitare të Kosovës me Maqedoninë dhe me Shqipërinë, dhe si pasojë e kësaj shumë persona, kryesisht fëmijë gjatë dhe pas luftës e humbën jetën ose pjesë të trupit. Të dëbuarit gjatë tërheqjes nuk guxonin të largoheshin jashtë

³⁰ Fushata Ndërkombëtare për ndalimin e minave, Landimine Monitor Report 2000, gusht 2000; Human Rights Watch, Nën Pushtetin e Urdhrave, Krimet e Luftës në Kosovë, v. e c., fq. 160.

³¹ Raport i Sekretarit të Përgjithshëm rreth Misionit të UNMIK në Kosovë, 6 korrik 2000; Human Rights Watch, Nën Pushtetin e Urdhrave, Krimet e Luftës në Kosovë, v. e c., fq. 160-161; S/2000/538).102 “Status Report”, UNMIK, 14. jul 2000.

³² Kosovo Crisis Fact Sheet # 133, U.S. Agency for International Development, 10 dhjetor 1999; Human Rights Watch, Nën Pushtetin e Urdhrave, Krimet e Luftës në Kosovë, v. e c., fq. 162.

rrugës së trasuar. Nëse vepronin ndryshe, pësonin. Duhet përmendur rasti i minimi të tërë territorit të fshatit Milaj në Hasin e Prizrenit.

Të dëbuarit gjatë tërheqjes nuk guxonin të largoheshin jashtë rrugës së trasuar. Nëse vepronin ndryshe, pësonin. Përkritazi me këtë duhet përmendur rasti i familjes Berisha nga Bardhi i Madh, e cila më 15 prill 1999 në pjesën kufitare me Shqipërinë, vetëm se e lëshoi dy-tri metra trasenë e rrugës për të kaluar më shpejt në kufi, nga minimi i asaj pjese u vranë 5 anëtarë, kryesisht fëmijë.

Qendra MACC pranë KB (Mine Action Coordination Center), e cila pas luftës është formuar në Kosovë, ka raportuar se deri nga mesi i muajit korrik 2000 nga minat dhe mjetet e tjera të paeksplojuara janë pastruar 1,1 milionë metra katrorë të tokës.³³ Raporti i Sekretarit gjeneral gjithashtu thekson se ekipet të cilat i ka koordinuar MASS kanë demontuar 3.405 mina kundër këmbësisë dhe 3.768 mina kundër tankeve, 3.066 kasetë bomba. Përveç kësaj, KFOR-i në periudhën e njëjtë ka pastruar 16.000 shtëpi, 1.165 shkolla dhe më shumë se 2.000 kilometra rrugë.

Edhe pas mbarimit të luftës, nga minat e vendosura, pësonin sidomos fëmijët duke lozur apo duke ruajtur bagëtinë. Rreziku më i madh ishte në prag të pranverës dhe gjatë verës, pra, në kohën e përmirësimit të motit kur njerëzit janë më të angazhuar në punët e tjera, me çka shtohet edhe rreziku nga pësimi prej minave, bombave dhe mjeteve të tjera shpërthyesë të paeksplojuara. Karakteristikë tjetër është se një pjesë e konsiderueshme e viktimave ishin të miturit (shumica nën moshën 14 -vjeçare). Ata përbënin 50% të të vranëve nga minat dhe 58% të të plagosurve.³⁴

Ndotja e ujit si formë e vrasjes

Një prej formave të krimeve, përkatësisht formë e hapur e vrasjes së civilëve, gjatë vitit 1998 dhe 1999 në Kosovë ishte praktika e përhapur e ndotjes së puseve të ujit, e cila është e ndaluar nga ligjet e luftës. Protokollu II, Neni 14 i Konventës së Gjenevës thotë: *“Është e ndaluar të sulmohet, shkatërrohet, zhvendosësh ose të nxjerrësh jashtë përdorimit, për atë qëllim, objekte të domosdoshme për mbijetesën e*

³³ Human Rights Watch, PO NAREDJENJU, Ratni zlocini na Kosovu, Beograd, 2003. (Marrë nga interneti).

³⁴ Basi Berisha, Minat – vrasës të padukshëm. KLMDNJ, Buletini nr. 15, Prill-qershor 2000, fq. 179.

popullsisë civile, të tilla, si produktet ushqimore, zonat bujqësore për prodhimin e artikuve ushqimorë, drithërave, gjësë së gjallë, instalimeve të ujit të pijshëm, si dhe të strukturave ujëtëse.”³⁵

Në disa pjesë të Kosovës, forcat serbe e jugosllave i bënë qellimisht të papërdorshme burimet e ujit – puset, duke vendosur kemikale, kafshë të ngordhura, madje edhe kufoma njerëzish në ujë. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC), i cili drejtoi një operacion për higjienizimin e ujit në Kosovë, “besohet se më nga 20 mijë puse të Kosovës, me shumë se gjysma u ndotën me kufoma kafshësh apo njerëzish, me plehra, ose thjesht u shndërruan në ujë i ndotur për mospërdorim. Nga janari - në shtator 1999, ICRC pastroi më shumë se 1.700 puse.³⁶

Numri i përgjithshëm i të vrarëve

Për të konstatuar numrin e të vrarëve dhe personave të pagjetur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 së pari është dashur të caktohen disa kriterë. Së pari periudha kohore që personat janë vrarë apo janë zhdukur. Gjatë periudhës kohore janar 1998 deri më 12 qershor 1999 kur forcat e NATO-s hyjnë në Kosovë.³⁷


Për çdo viktimë është shënuar emri, emri i prindit dhe mbiemri, vendi i lindjes (emri i vendbanimit dhe komuna), data e lindjes ose mosha, vendi i lindjes, gjinia (meshkull ose femër), data kur është vrarë ose data kur është parë për herë të fundit (për të zhdukurit) dhe vendi ku ka pësuar.

³⁵ “Balkan Crisis: Cleaning Wells in Kosovo”, ICRC News 99/37, 8. shtator 1999; Human Rights Watch, PO NAREDJENJU, Ratni zlocini na Kosovu, Beograd, 2003. (Marrë nga interneti).

³⁶ “Kriza ballkanike: Pastrimi i burimeve në Kosovë”. ICRC News 99/37, 8 shtator 1999; Human Rights Watch, Nën Pushtetin e Urdhrave, Krimet e Luftës në Kosovë, v. e c., fq. 153.

³⁷ Të dhënat për të vrarët, të pagjeturit dhe dëshmorët i kam marrë nga Kuvendet komunale dhe disa organizata humanitare, por ato nuk ishin të plota dhe është dashur që t’i vizitoj vetë vendbanimet dhe të marrë të dhëna dhe t’i vërtetoj ato ekzistuese për viktimat e luftës. Kam vizituar në periudhën 2002 deri 2009 më se 800 vendbanime dhe kam arritur që në vitin 2010 të botoi librin “Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999, në dy vëllime. Më vonë të dhënat e paraqitura janë plotësuar me të dhëna të reja. Në grumbullimin e të dhënave kisha angazhuar dhe grupin punues që e kishim formuar si arkiv në vitin 2002.

Viktimat në Kosovë gjatë luftës, janar 1998 – 12 qershor 1999 (Numri i viktimave sipas komunave)



Nga rezultatet e hulumtimit për periudhën janar 1998 deri më 12 qershor janë regjistruar këto të dhëna për çdo viktimë me shënimet e theksuara më lart: Gjithsej të vrarë dhe të pagjetur - shqiptarë dhe ndonjë tjetër i nacionalitetit turk, boshnjak e romë: 11.507 persona (9.793 meshkuj dhe 1.714 femra). Prej tyre të vrarë 8.162 persona (6.667 meshkuj dhe 1.495 femra); të pagjetur gjithsej 1.137 persona (954 meshkuj, 183 femra); dëshmorë: gjithsej 2.208 (2.172 meshkuj

dhe 36 femra). Ndërsa, të vrarë dhe të pagjetur të nacionalitetit serb dhe malazezë, në periudhën janar-12 qershor 1999, të bazuar në të dhënat e Fondit për të Drejtën Humanitare dhe disa të dhëna të marra nga faqja e internetit, në Kosovë, përkatësisht banorë të Kosovës janë vrarë apo janë zhdukur 595 persona (543 meshkuj dhe 52 femra), prej tyre janë vrarë 192 persona (161 meshkuj dhe 31 femra), të pagjetur janë gjithsej 116 persona (96 meshkuj dhe 21 femra), ndërsa të angazhuar në forcat e armatosura janë 287 persona.³⁸

Gjithsej, sipas hulumtimeve kam arritur që t'i regjistroj këto viktima në luftën në Kosovë në vitet 1998 – 1999: gjithsej të vrarë e të pagjetur të të gjitha nacionaliteteve: 12.102 persona (10.366 meshkuj dhe 1.766 femra). Nga këta të vrarë: 8.354 persona (6.828 meshkuj dhe 1.526 femra); të pagjetur: 1.253 persona³⁹ (1.049 meshkuj dhe 204 femra); Të rënit në uniformë janë gjithsej 2.495 persona (2.459 meshkuj dhe 204 femra).⁴⁰

Përveç këtyre mënyrave të vrasjeve të popullatës shqiptare në luftën e agresorit serb në vitet 1998-1999, janë bërë dhunime ndaj femrave shqiptare, është bërë dëbimi masiv nga vendlindja e popullatës shqiptare, u shkatërruan shumë objekte banimi dhe ndihmëse, shkolla, xhami dhe shumë objekte të tjera ekonomike dhe infrastrukturore. Shumë persona ende janë të zhdukur dhe shumë forma të tjera të gjenocidit dhe krimit, por nuk janë objekt trajtimi në këtë temë, andaj nuk do të ndalemi në shqyrtimin e këtyre temave.

³⁸ Ndoshta numri i tyre është më i madh, por unë nuk kam të dhëna.

³⁹ Në deklaratat publike të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës thuhet se ende të pagjetur janë rreth 1.600 persona. Si duket këta kanë regjistruar edhe për ata të zhdukurit para dhe pas luftës.

⁴⁰ Jusuf Osmani, *Serb Government's Crimes in Kosova 1998-1999*, Book 1, Book 2, Prishtinë, 2016, f. 170.

Arbër Hadri

RELACIONE TË DEPARTAMENTIT TË SHTETIT TË SHBA-SË, LIDHUR ME SPASTRIMIN ETNIK TË POPULLIT SHQIPTAR DHE KRIMET SERBE KUNDËR NJERËZIMIT NË KOSOVË (1999)

Abstrakt

Ky punim paraqet të dhënat kryesore të dokumenteve zyrtare amerikane lidhur me spastrimin etnik dhe krimet serbe kundër njerëzimit në Kosovë, gjatë vitit 1999. Përfshirja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, përpjekjet diplomatike për parandalimin e luftës, si dhe më pas në formë të drejtpërdrejt në bombardimin ushtarak të Serbisë milosheviçiane, rezultoi me angazhimin zyrtar të Departamentit të Shtetit në paraqitjen faktografike të barbarizmave të luftës së ushtrisë dhe policisë serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Në këtë prizëm, si dhe të arsyetimit të domosdoshmërisë së përfshirjes së saj në luftë, Qeveria amerikane prezantoi në formë të argumentuar dhe të përpiktë mizoritë dhe krimet e luftës serbe në Kosovë, duke përfshirë edhe nivelin dhe shtrirjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të drejtës e katastrofës humanitare.

Në periudhën kohore mars-qershor 1999, Departamenti i Shtetit dokumentoi mizoritë serbe në një sërë publikimesh zyrtare, duke përfshirë raportin e titulluar “Çrrënjësja e historisë: Spastrimi Etnik në Kosovë”, si dhe të “Raporteve javore të spastrimit etnik në Kosovë”. Raporti përfundimtar “Spastrimi Etnik në Kosovë: Dëshmi”, i botuar në dhjetor të vitit 1999, paraqet të dhënat e përditësuara të krimeve serbe në Kosovë, të kryqëzuara edhe me gjetjet në terren të institucioneve ndërkombëtare, Gjykatës së Hagës, si dhe ato të instaluar në Kosovë, KFOR dhe UNMIK. Faktet e përmbledhura, rezultuan me këto të dhëna: 11.000 (njëmbëdhjetë mijë) të vrarë në 529 varreza të identifikuar masive dhe të skenave të krimit. Vrasjet ishin vetëm njëra faqe e gjenocidit të orkestruar serb në Kosovë. Dokumentet amerikane pohojnë se më shumë se 1.5 milionë shqiptarë të Kosovës, 90 % e popullatës së saj, ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë. Në këtë kuadër, gjatë luftës në Kosovë, forcat ushtarake dhe policore të Serbisë, zbatuan një fushatë sistematike për spastrimin etnik të Kosovës nga popullata shqiptare.

Këto veprime të paramenduara gjenocidiale të Serbisë, përfshinin: ekzekutime në masë, djegien e trupave, zhvarrosje të varrezave masive dhe shkatërrimin e trupave njerëzore, dëbimin me dhunë të civilëve shqiptarë, plaçkitjen e shtëpive dhe bizneseve, djegien në masë të shtëpive, përdorimin e mburojave njerëzore, veçimin dhe arrestimin e meshkujve, dhunime, shkelje të neutralitetit mjekësor, çrrënjësje të identitetit etj. Këto dokumente zyrtare, të bazuara në burimet qeveritare amerikane, dëshmitë e refugjatëve, dokumentimin e organizatave joqeveritare, shtypin dhe burimet e organizatave ndërkombëtare, përmbajnë të dhëna objektive historike dhe statistikore dhe janë të një rëndësie të veçantë për historiografinë e Kosovës.

Fjalët çelës: Spastrimi etnik, Lufta në Kosovë, Departamenti i Shtetit, mizoritë serbe.

Argumentimi dhe prezantimi i fakteve lidhur me gjenocidin e organizuar shtetëror të Serbisë ndaj popullit shqiptar në Kosovë gjatë luftës së vitit 1998-1999, është një detyrë e rëndësishme për të gjitha sferat e shkencave shoqërore të Kosovës dhe më gjerë, e veçanërisht të historisë dhe juridikut. Dokumentet dhe të dhënat e kohës që janë në dispozicion për këtë dimension të rëndësishëm për zberthimin e ecurisë dhe përfundimit të luftës në Kosovë, me përfshirjen e bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të saja të sigurisë për ndaljen e gjenocidit në qendër të Evropës, kryesisht janë në dispozicion si rezultat i angazhimit dhe përcaktimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dokumentimin dhe paraqitjen e këtyre barbarive serbe në prag të shekullit XXI. Ky veprim amerikan ishte në funksion të një përgjigjeje ndërkombëtare ushtarake ndaj Serbisë që orkestruan këtë gjenocid ndaj popullit shqiptar në Kosovë, si dhe për grumbullimin e të dhënave për gjykimin ndërkombëtar të kriminelëve serbë në krye me Milosheviçin.

Ky punim paraqet të dhënat kryesore të dokumenteve zyrtare amerikane gjatë vitit 1999, lidhur me spastrimin etnik dhe krimet serbe kundër njerëzimit në Kosovë, si dhe veprimet e politikës së jashtme amerikane kundruall saj.

Përfshirja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në zgjidhjen e çështjes së Kosovës, përpjekjet diplomatike për parandalimin e luftës, si dhe më pas në formë të drejtpërdrejtë në bombardimin ushtarak të Serbisë milosheviçiane, rezultuan me angazhimin zyrtar të Departamentit të Shtetit në paraqitjen faktografike të barbarizmave të luftës ndaj popullit shqiptar në Kosovë, nga ana e ushtrisë dhe policisë serbe. Në këtë prizëm, si dhe të arsytimit të domosdoshmërisë së përfshirjes së saj në luftë, Qeveria amerikane prezantoi në formë të argumentuar dhe të përpiktë, mizoritë dhe krimet e luftës serbe në Kosovë, duke përfshirë edhe nivelin dhe shtrirjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare, si dhe të katastrofës humanitare në terren. Në periudhën kohore mars-qershor 1999, Departamenti i Shtetit i dokumentoi mizoritë serbe dhe spastrimin etnik të shqiptarëve në Kosovë në një sërë publikimesh zyrtare, duke përfshirë raportin e titulluar “Çrrenjosja e historisë: Spastrimi etnik në Kosovë” (Erasing History: Ethnic Cleansing in Kosovo)¹ botuar në maj të vitit 1999, si

¹ U.S. Department of State “Erasing History: Ethnic Cleansing in Kosovo”, qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/regions/eur/rpt_9905_ethnic_ksvo_-1.html#:~:text=Serbian%20forces%20have%20made%20Pristina,ethnic%20Albians%20remain%20in%20Pristina.

dhe të “Raporteve javore të spastrimit etnik në Kosovë”². Raporti përfundimtar “Spastrimi etnik në Kosovë: Dëshmi” (Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting),³ i botuar në dhjetor të vitit 1999, në të cilat paraqiten të dhënat e përditësuara të krimeve serbe dhe gjenocidin në Kosovë, të kryqëzuara edhe me gjetjet në terren të institucioneve ndërkombëtare, Gjykatës së Hagës, si dhe ato të instaluar në Kosovë, KFOR-it dhe UNMIK-ut, është dokumenti zyrtar më kredibil, i hartuar nga një Qeveri ndërkombëtare, me të dhëna të sakta, gjithëpërfshirëse me qëllim të dokumentimit të shkeljes së të drejtave të njeriut, ligjit humanitar dhe gjenocidit serb në Kosovë.

Rrethanat që ndikuan në përpilimin e këtyre raporteve ishin të ndërlikura me gjendjen në Kosovë dhe relacionin që në këtë kuadër kishte politika e jashtme amerikane. Për këtë shkak, në këtë punim do të elaborojmë shkurt edhe qëndrimin e saj.

Eskalimi i situatës së sigurisë në Kosovë në pjesën e dytë të vitit 1998, kyçi politikën amerikane në formë direkte me synim të parandalimit të luftës në Kosovë, vendosjes së paqes dhe gjetjes së një zgjidhjeje politike për statusin e ardhshëm të Kosovës. Interesat e sigurisë kombëtare amerikane ishin prekur, meqë kontingjenti ushtarak i saj gjendej në afërsi të Kosovës, në Bosnjë dhe Hercegovinë. Po ashtu, kredibiliteti i institucioneve politike e ushtarake ndërkombëtare ishte vënë në pikëpyetje, shenjat e katastrofës humanitare ishin evidente në terren në Kosovë, si dhe kishte presion të jashtëzakonshëm medial ndaj qeverisë amerikane për veprim. Ashpërsimi i situatës rrënuese në terren si rezultat i ofensivave ushtarake serbe, shënon një kaptinë të veçantë në aspektin e vendosmërisë së politikës amerikane drejt ndalimit të mizorive të policisë dhe ushtrisë serbe në Kosovë, duke përfshirë edhe nxitjen e intervenimit ushtarak të NATO-s (Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut - North Atlantic Tractact Organization). Kjo qasje, ishte në linjë me krijimin e një platforme dhe mundësie përfundimtare politike, për ndërprerjen e luftimeve dhe arritjen e një marrëveshjeje paqësore.⁴

Situata në terren në Kosovë në këtë kohë ishte shpërthyes.

² U.S. Department of State, qasur më 30.09.2023, www.state.gov/www/regions/eur/rpt_990604_ksvo_ethnic.html.

³ U.S. Department of State, "Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting", qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovoii/pdf/kosovii.pdf.

⁴ Arbër Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA: Lufta në Kosovë - Dokumente shtetërore-publike të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA: Kosova Vëllimi I (19 qershor 1998-31 tetor 1998)* (Prishtinë: SHBAH, 2020), 35.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe Lëvizja Paqësore, ishin kategorikisht kundër çdo zgjidhjeje që parashihte autonominë përpos parvarësisë së plotë të Kosovës. Qëndrime diametralisht të kundërta kishte shteti i Serbisë, i cili e shihte popullin shqiptar në Kosovë, si një kërcënim për projektionet e saja nacionaliste dhe ekspansioniste në Ballkan. Ky synim u dëshmuua që nga fillimi i viteve 80, me instalimin e apartheidit shtetëror serb dhe shtypjen e lirive të njeriut në Kosovë; ndrydhjen e identitetit kulturor, arsimor e shkencor; suprimimin e autonomisë politike të Kosovës; spastrimin etnik dhe vrasjet makabre, si dhe aktet gjenocidiale që pushteti serb në formë të organizuar e të qëllimshme i realizoi në Kosovë. Nëpërmjet këtyre veprimeve, regjimi serb i Slobodan Milosheviçit kishte për qëllim zbatimin e misionit të tij për rikonfigurimin etnik të Kosovës, në favor të Serbisë.⁵

Sjellja në një linjë e këtyre qëndrimeve diametralisht të kundërta të Kosovës dhe Serbisë, ishte një sfidë e madhe edhe për politikën e jashtme amerikane, e cila ishte në një presion medial të brendshëm për veprim, me qëllim të ndaljes së katastrofës humanitare dhe masakrave të popullit shqiptar të Kosovës, si dhe parandalimit të rrezikut për destabilizim në rajon dhe Evropë. Një element i rëndësishëm që ndikoi në përkushtimin dhe determinimin e administratës amerikane për ta ndaluar luftën dhe t' i japë kah zgjidhjes së Kosovës, ishte eksperiencia jo e mirë me Bosnjën⁶ ku kishte më shumë se njëqindmijë⁷ persona të vrarë dhe fytyra e nacionalizmit milosheviçian ishte demaskuar tërësisht. Qëndrimi i prerë i Presidentit Klinton, ishte se “nuk do të lejonte një Bosnjë të dytë të ndodhte në zemër të Evropës në prag të shekullit XXI”.⁸

⁵ Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 72-75.

⁶ William J. Clinton, *Public Papers of the Presidents Of The United States* (Washington; US Government Printing Office, 1993), Administration of William J. Clinton, Book I, “Remarks at a Town Meeting in Detroit”, February 10, 1993, 79.

⁷ Victor Toom, “Ontologically dirty knots: The production of numbers after the Srebrenica genocide”, *Security Dialogue* Volume 51/Issue 4 (2020): 358-359; Seybot TB, Aronson JD and Fischhoff B, *Counting Civilian Casualties: An Introduction to Recording and estimating nonmilitary deaths in conflict* (Oxford: Oxford University Press, 2013), 3-6; 213-246.

⁸ Bill Clinton, *My Life* (UK: Arrow Books, 2005), 848-851; William J. Clinton, *Public Papers of the Presidents of the United States January 1– June 30, 1999* (Washington; US Government Printing Office, 1993), Administration of William J. Clinton, Book I, “Remarks on the NATO Airstrikes Against Serbian Targets and an Exchange with Reporters March 28, 1999”, f. 462; Më tej, do të përdoret termi i shkurtuar Bosnjë, për Bosnjë dhe Hercegovinën.

Në këtë kuadër, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si superfuqia e vetme botërore, vepruan duke shfrytëzuar potencialin e saj diplomatik, ushtarak dhe mekanizmat e saj në institucionet ndërkombëtare NATO, OSBE, OKB dhe Grupin e Kontaktit, që Aleatët e saj dhe Bashkësia Ndërkombëtare ta kenë një zë në atë situatë, si dhe të ushtrojnë tryzni qenësore ndaj regjimit serb të Milosheviçit për parandalimin e eskalimit të mëtutjeshëm të luftës dhe akteve gjenocidiale ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Me gjithë përpjekjet e pareshtura diplomatike, Serbia në krye me Milosheviçin nuk ndalej në ushtrimin e dhunës në terren në Kosovë, që rezultoi me fillimin e përgatitjeve të Administratës Amerikane për mundësinë e përgjigjes me intervenim ushtarak, nëse nuk pranoheshin kushtet e Bashkësisë Ndërkombëtare.

Çështja e intervenimit ushtarak të NATO-s në Kosovë ishte vu në radhitjen prioritare të politikës së jashtme amerikane. Tani më, kjo agjendë ishte në binarë të zgjidhjes politike dhe ushtarake, e në këtë aspekt u përfshinë në lëvizje edhe agjencitë ndërshtetërore duke vepruar me zhvillimin e udhëzimeve të duhura për Misionin e Shteteve të Bashkuara në NATO, me qëllim të inicimit të procesit formal të gjenerimit të operacioneve ushtarake ajrore.⁹

Përpjekjet e fundit të diplomacisë shtrënguese amerikane të shoqëruara me kërcënim kredibil të përdorimit të forcës, me synim arritjen e një zgjidhjeje diplomatike para përfshirjes ushtarake të NATO-s në Kosovë, ndaljes së luftimeve në terren, si dhe kthimit të të përndjekurve në shtëpitë e tyre, rezultuan me sukses vetëm në tetorin e vitit 1998.¹⁰ Me gjithë përpjekjet pasuese të diplomacisë shtrënguese amerikane Serbia milosheviçiane nuk pranoi propozimin e paqes në Rambuje dhe me këtë filloi edhe bombardimi 78 ditor i saj. Sulmet ajrore nxitën edhe nisjen e zbatimit të planit gjenocidial të Serbisë për shpopullimin e Kosovës nga shqiptarët. Më shumë se 1.5 milionë¹¹ shqiptarë të Kosovës (rreth 90% të popullatës), sipas raporteve amerikane u dëbuan me forcë nga vendi i tyre, në kuadër të zbatimit të fushatës sistematike të Serbisë për spastrimin etnik të shqiptarëve nga Kosova. ShBA-ja tani më kishin hyrë në luftë dhe ishte e domosdoshme që të faktohej edhe arsyeshmëria e këtij veprimi. Në këtë kuadër, Departamenti i Shtetit Amerikan ndërmori publikimin e një sërë raporteve

⁹ Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare*, 72-75.

¹⁰ Po aty.

¹¹ U.S. Department of State "Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting", qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovoii/pdf/kosovii.pdf, p. 3.

zyrtare me qëllim të demaskimit të akteve gjenocidiale të orkestruara të Milosheviçit dhe Serbisë ndaj popullatës shqiptare në Kosovë.

Informacionet në këto raporte zyrtare amerikane u bazuan në të dhënat e ICTY (The International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia- Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë) dhe KFOR-it ndërlidhur me eksumimin e trupave dhe të dhënat për varrezat masive, dëshmitë e refugjatëve, dokumentacionin e OJQ-ve, dëshmitë e shtypit dhe informacione të deklasifikuara nga burime të qeverive dhe organizatave ndërkombëtare. Mizoritë kundër shqiptarëve të Kosovës të dokumentuara në këtë raport kanë ndodhur kryesisht ndërmjet marsit dhe fundit të qershorit 1999. Përmbajtja e raportit përfundimtar “Spastrimi etnik në Kosovë: Dëshmi” (Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting),¹² konsiston në kapitujt më se vijon: Përmbledhja e përgjithme; Prezantimi; Vështrim i përgjithshëm; Dokumentimi i mizorive; Procesi i intervistimit të refugjatëve; Paslufta; Mizoritë dhe krimet e luftës sipas vendndodhjes; si dhe Shtojcë: Lista e faqeve të internetit me shënime përkatëse.¹³

Një ndër çështjet thelbësore të trajtuara në raport është numri i viktimave të shqiptarëve të Kosovës të vrarë nga ana e forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë. Shumë prej trupave u gjetën nga KFOR-i dhe ICTY-i kur hynë në Kosovë në qershor të vitit 1999. Provat e prezantuara janë fuqiplota, meqë pos të dhënave të tjera janë shoqëruar edhe me gjetjet profesionale dhe mjekësisë ligjore të ICTY dhe KFOR-it, duke konkluduar se forcat ushtarake-policore serbe kryen një fushatë sistematike për të djegur dhe shkatërruar trupat, për të varrosur trupat, si dhe më pas për rivarrosjen e tyre për të fshehur provat e krimeve makabre serbe. Departamenti i Shtetit, në këto raporte zyrtare paraqiti përfundimin se të paktën 6,000 shqiptarë të Kosovës ishin viktima të vrasjeve masive, nga një numër dyfish më i madh i viktimave të përgjithshme duke përfshirë edhe vrasjet individuale, dhe një numër të panjohur trupash të djegura ose shkatërruara nga forcat serbe gjatë gjithë luftës.¹⁴

¹² U.S. Department of State, "Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting", qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovoii/pdf/kosovii.pdf.

¹³ U.S. Department of State "Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting", qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovoii/pdf/kosovii.pdf, p. 1-17.

¹⁴ Po aty.

Departamenti i Shtetit Amerikan në këtë dokument, po ashtu, paraqet edhe konkluzionet e Zyrës së Kryeprokurores së ICTY-së Carla Del Ponte me rastin e prezantimit të saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së më 10 nëntor 1999, se në Kosovë kishte më shumë se 11,000 persona të vrarë në 529 varreza masive dhe lokacione të vrasjeve të raportuara në Kosovë. Prokurorja theksoi se zyra e saj kishte zhvarrosur 2,108 trupa nga 195 prej 529 varrezave masive të njohura. Nga këto të dhëna Departamenti i Shtetit sugjeron se janë rreth 6,000 trupa në varreza masive në Kosovë, nëse bazohet në faktin se 334 varreza masive të përkrahura deri më tani përmbajnë të njëjtin numër mesatar të viktimave.¹⁵

Këto fakte të përmbledhura të Departamentit të Shtetit të ShBA-së, rezultuan me këto të dhëna: 11.000 (njëmbëdhjetë mijë) të vrarë në 529 varreza të identifikuar masive dhe të skenave të krimit. Vrasjet ishin vetëm njëra faqe e gjenocidit të orkestruar serb në Kosovë. Dokumentet amerikane pohojnë se më shumë se 1.5 milionë shqiptarë të Kosovës, 90 % e popullatës së saj, ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë. Rreth 600.000 mijë prej tyre ishin zhvendosur brenda Kosovës në kushte çnjerëzore, gjersa pjesa tjetër ishte dëbuar me dhunë në shtetet fqinje, kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni, si dhe në Mal të Zi. Në këtë kuadër, gjatë luftës në Kosovë, forcat ushtarake dhe policore të Serbisë, zbatuan një fushatë sistematike për spastrimin etnik të Kosovës nga popullata shqiptare. Këto veprime të paramenduara gjenocidiale të Serbisë, përfshinin: ekzekutime në masë, djegien e trupave, zhvarrosje të varrezave masive dhe shkatërrimin e trupave njerëzore, dëbimin me dhunë të civilëve shqiptarë, plaçkitjen e shtëpive dhe bizneseve, djegien në masë të shtëpive, përdorimin e mburojave njerëzore, veçimin dhe arrestimin e meshkujve, dhunime, shkelje të neutralitetit mjekësor dhe çrënjosje të identitetit.¹⁶

Pjesa më e madhe e këtyre raporteve “Spastrimi etnik në Kosovë: Dëshmi”, “Çrënjosja e historisë: Spastrimi etnik në Kosovë” dhe “Raporteve javore të spastrimit etnik në Kosovë”, përshkruajnë vendet e vrasjeve dhe varrezave masive të raportuara në mbarë Kosovën që nga fundi i marsit 1999.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ U.S. Department of State, "Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting", qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovooi/pdf/kosovii.pdf, p. 1-16.

Pjesë e raportit “Spastrimi etnik në Kosovë: Dëshmi (Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting)”, është edhe pjesa e ndërlidhjes së akteve gjenocodiale serbe me lokacionet përkatëse në Kosovë, e titulluar “Mizoritë dhe krimet e luftës sipas lokacioneve (Atrocities and war crimes by location)”.¹⁷

Pjesa më e madhe e këtij raporti përshkruan vendet e vrasjeve dhe varrezave masive të raportuara në mbarë Kosovën që nga fundi i marsit 1999. Ekipet mjeko-ligjore dhe hetuesit e krimeve të luftës nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (ICTY) dhe një numër i qeverive që punuan në emër të ICTY, si dhe nga ana e Forcës së Kosovës (KFOR), kanë realizuar hetimin e vendeve të vrasjeve dhe varrezave masive. Lokacionet janë paraqitur si vende të “raportuara”, që konsiderohen raporte të besueshme të vrasjeve ose vendeve të varrezave masive, si dhe vende të “konfirmuara” që janë vende të raportuara ku janë kryer dhe përfunduar hetimet në terren të mbështetura nga ICTY apo KFOR-i.¹⁸

Raporti i lokacioneve në formë përmbledhëse paraqet të dhëna se në Kosovë janë më shumë se 500 varreza masive dhe lokacione vrasjesh të cilat janë regjistruar nga ICTY, KFOR-i dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Numri i përgjithshëm i personave të vrarë të raportuar në ICTY në më tepër se 500 varreza është më shumë se 11.000. Nga këto 500 lokacione, ICTY ka konfirmuar përfundimin e hetimeve në terren në rreth 200 vende, që nga fillimi i nëntorit 1999. Më shumë se 2.100 njerëz të vrarë janë konfirmuar se janë gjetur nga hetuesit në më tepër se 160 lokacione. Raporti sugjeron se duke marrë parasysh të dhënat e parashtruara, numri i përafërt i personave të vrarë në varrezat e identifikuar ishte më shumë se 6.000.¹⁹

Raporti i klasifikon viktimat në tri kategori: “1. Viktimat e varrosura në varrezat masive, vendndodhja e të cilave nuk dihet; 2. Numri i vendeve ku numri i saktë i trupave nuk mund të numërohen; si dhe 3. Viktimat, trupat e të cilëve janë djegur apo shkatërruar nga forcat ushtarake, pjesë e programit të shkatërrimit të provave nga forcat serbe në mbarë Kosovën dhe në Serbi”. Raporti paraqet në formë të detajuar në 72 faqe, lokacion për lokacion dhe për çdo komunë të Kosovës,

¹⁷ Raporti “Spastrimi etnik në Kosovë: Dëshmi (Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting)”, Kapitulli “Mizoritë dhe krimet e luftës sipas lokacioneve (Atrocities and war crimes by location)”, qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovoii/pdf/account.pdf, p. 17-92.

¹⁸ Po aty, p. 17.

¹⁹ Po aty, p. 17-18.

numrin e varrezave dhe viktimave, të shoqëruara në disa raste edhe me fotografi satelitore. Në përfundim, ky dokument i Departamentit të Shtetit konkludon se “numri i viktimave trupat e të cilëve janë djegur ose shkatërruar nuk mund të dihet me saktësi, mirëpo ka prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se rreth 10.000 shqiptarë të Kosovës janë vrarë nga forcat serbe”.²⁰

Relacionet dokumentare të Departamentit të Shtetit Amerikan, ndërlidhen edhe me një sërë dokumentesh të deklasifikuara të “Këshillit të Sigurisë Amerikane” (NSC)²¹ gjatë luftës në Kosovë, pjesë e së cilës ishte dhe vetë Departamenti, në të cilën në formë të hollësishme pasqyrohet kontributi i jashtëzakonshëm i Shteteve të Bashkuara për ndaljen e luftës dhe gjenocidit në Kosovë, katastrofës humanitare, planifikimin dhe realizimin e bombardimeve të NATO-s në krye me ShBA-në, si dhe rikthimin e trajektores së historisë me kthimin e refugjatëve në shtëpitë e tyre, lirisë, rekonstruimit të shtëpive dhe jetëve të tyre.

DOKUMENTIMI I MIZORIVE

Departamenti i Shtetit në pjesën pasuese të raportit, sipas tematikës paraqet dokumentimin e krimeve dhe mizorive të luftës, shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të drejtave të njeriut dhe akteve gjenocidiale të raportuara në gjithë Kosovën.

Zhvendosja e dhunshme e civilë shqiptarë

Departamenti i Shtetit i ka dhënë një hapësirë të veçantë pasqyrimin të spastrimit etnik të Kosovës nga ana e Serbisë, si një fushatë e zhvendosjes së detyruar të popullsisë shqiptare në një shkallë që nuk ishte parë në Evropë që nga vitet e Luftës së Dytë Botërore. Raporti thekson se ushtria dhe policia serbe dëboi shumicën dërrmuese të popullit shqiptar nga shtëpitë e tyre. Me këtë rast hidhen poshtë pretendimet e regjimit serb se kjo zhvendosje e popullsisë ishte rezultat i largimit nga frika e sulmeve ajrore të NATO-së. Theksohet me këtë rast se viktimat vazhdimisht raportuan se ishin “dëbuar nga shtëpitë e tyre nga forcat

²⁰ Po aty, p. 19-92.

²¹ Arbër Hadri, *Këshilli i Sigurisë Kombëtare i SHBA: Lufta në Kosovë - Dokumente shtetërore-publike të Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA: Kosova Vëllimi I (19 qershor 1998-31 tetor 1998)* (Prishtinë: SHBAH, 2020), 35.

serbe nën kërcënimin e armëve, ndryshe nga luftimet e vitit 1998, kur pjesa më e madhe e personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatët u larguan për t'i shpëtuar ofensivës serbe ose për të shmangur raprezaljet nga forcat serbe të sigurisë. Një pjesë e popullatës u futën në trena dhe mjete të tjera transportuese në formë të organizuar dhe u dëbuan nga Kosova. Përveç kësaj, forcat serbe dëbuan shumicën e shqiptarëve të Kosovës nga zonat urbane. Refugjatët deklaruan se ata që u detyruan të qëndronin prapa u përdorën si mburoja njerëzore.”²²

Me këtë rast, në raport theksohet po ashtu, se forcat serbe gjithashtu u maskuan si refugjatë për të parandaluar shënjestrimin nga avionët e NATO-s. “Refugjatët pohuan se më 6 maj 1999, forcat serbe të veshura me kapela të bardha dhe xhaketa me logot e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe lëvizën ndërmjet Gjakovës dhe Brekocit me kolona të civilëve të dëbuar. Për të fshehur ngarkesën e tyre ushtarake, forcat serbe i mbuluan vagonët e tyre me goma plastike të marra nga OJQ-të”. Departamenti i Shtetit vë në dukje se ndryshe nga viti 1998, kur forcat serbe të sigurisë sulmuan fshatra të veçanta, njësitë e Ushtrisë Jugosllave dhe civilët e armatosur serbë në vitin 1999 iu bashkuan policisë në dëbimin sistematik të shqiptarëve nën kërcënimin e armëve nga fshatrat dhe qytetet më të mëdha të Kosovës. “Autoritetet serbe detyruan shumë refugjatë të nënshkruajnë deklaratat e mohimit duke thënë se po largoheshin nga Kosova me vullnetin e tyre të lirë. Viktimat raportuan gjithashtu se forcat serbe konfiskuan sendet e tyre personale dhe dokumentacionin, duke përfshirë letrat e identitetit kombëtar, dhe u tha atyre që të hidhnin një vështrim të fundit përreth sepse nuk do të ktheheshin më në Kosovë. Shumë nga vendet e shënjestruara nuk kishin qenë skena të mëparshme luftimi apo e veprimtarisë së UÇK-së. Ky është një fakt se dëbimet serbe ishin një ushtrim i spastrimit etnik dhe jo pjesë e një operacioni legjitim të sigurisë ose kundër kryengritjes, por ishte në fakt një plan për të spastruar etnikisht Kosovën nga popullsia etnike shqiptare”.²³

Plaçkitja e shtëpive dhe bizneseve

Raporti thekson se sipas deklaratave të shumta nga viktimat dhe shtypi, forcat serbe ndërmerrnin aksione ushtarake shtëpi për shtëpi

²² U.S. Department of State “Ethnic Cleansing in Kosovo: An Accounting”, qasur më 30.09.2023, https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovooii/pdf/-kosovooii.pdf, p. 1-17.

²³ Po aty, p. 9.

duke plaçkitur banorët para se t'u digjnin shtëpitë. Përveç kësaj, viktimave shqiptare forcat serbe ua grabitën të gjitha sendet e tyre personale para se të kalonin kufijtë.

Djegia e përhapur e shtëpive

Departamenti i Shtetit thekson se më shumë se 1200 zona të banuara me shqiptarë, duke përfshirë më tepër se 500 fshatra, u dogjën pas fundit të marsit 1999, ndërsa shtëpitë dhe dyqanet serbe mbetën të paprekura gjatë luftës. Shkatërrimi ishte shumë më i gjerë dhe më i plotë se ajo që ndodhi në verën e vitit 1998. Shumë vendbanime u shkatërruan plotësisht në një përpjekje të dukshme për të siguruar që popullata shqiptare e Kosovës të mos mund të kthehej, si dhe të zbatohej spastrimi etnik. Po ashtu, raporti thekson se forcat serbe “dogjën të gjitha shtëpitë e dhëna më parë me qira të OSBE-së në Vushtrri, Shtime dhe Mitrovicë”.²⁴

Përdorimi i mburojave njerëzore

Departamenti i Shtetit lidhur me përdorimin e e popullatës shqiptare si mburojë njerëzore, vë në pah se forcat ushtarake dhe policore serbe i detyruan shqiptarët e Kosovës që të shoqërojnë autokolonat ushtarake serbe dhe objektet e mbrojtjes në të gjithë Kosovën. Civilët u përdorën për të mbrojtur asetet ushtarake, po ashtu njësitë serbe gjithashtu shoqëronin ose grumbullonin shqiptarët e Kosovës gjatë operacioneve ushtarake. Kjo dukuri në këtë raport pasqyrohet me disa raste, sikurse kur forcat serbe përdorën burra shqiptarë të Kosovës, nga mesi i prillit 1999, për të mbrojtur autokolonat ushtarake nga sulmet ajrore të NATO-s. “Forcat serbe i larguan të rinjtë shqiptarë kosovarë nga kolonat e refugjatëve dhe i detyruan të formojnë një zonë tampon rreth autokolonave serbe. Dëshmitarët pohuan se kanë qenë mburojë ushtarake në rrugët ndërmjet Pejës, Gjakovës dhe Mitrovicës”. Po ashtu, në raste të tjera sikurse në Korishë, ushtria dhe policia e Serbisë pozicionuan qëllimisht shqiptarët në vende që ata besonin se ishin objektiva të sulmeve ajrore të NATO-s, brenda zonave të shënjestuara të NATO-së për të gjeneruar viktima civile për të cilat mund të fajësohej NATO-ja.²⁵

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty.

Paraburgimet

Paraburgimet gjatë luftës në Kosovës karakterizohen me faktin se forcat policore dhe ushtarake serbe kanë ndarë nga popullsia sistematikisht shqiptarët e moshës ushtarake-duke filluar nga moshë 14 deri në 59 vjeç-ndërsa dëbuan nga shtëpitë e tyre shqiptarët, me qëllim që të spastrohet etnikisht Kosova. Të dhënat e paraqitura në relacionet e Departamentit të Shtetit, në fillim të prillit, marrin shembuj të këtyre krimeve sikurse rasti kur forcat serbe përdorën fabrikën e Ferronikelit në Drenas si qendër ndalimi për një numër të madh të shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu, fabrika e çimentos në Han të Elezit ishte përdorur si qendër paraburgimi për shqiptarët e Kosovës. Sipas Amnesty International, të paktën 2.000 shqiptarë etnikë, mbaheshin në objektet e paraburgimit serb – disa pa akuza formale kundër tyre. OJQ-të kishin dokumentuar se mes të arrestuarve janë gra dhe fëmijë. Nga 21 maji deri në fillim të qershorit, rreth 2.000 burra shqiptarë të Kosovës hynë në Shqipëri pasi u mbajtën nga forcat serbe për tre javë në një burg në Smrekovicë afër Skenderajt. Gjatë ndalimit të burrave, forcat serbe i detyruan të hapnin llogore dhe shumë prej tyre i dhunuan fizikisht. Pas marrjes në pyetje, të arrestuarit janë ngarkuar në autobusë dhe janë dërguar në Zhur, nga ku janë detyruar të shkojnë në këmbë për në Shqipëri.²⁶

Raporti, po ashtu vë në pah se, janë edhe një sërë çështjesh të tjera të të drejtave të njeriut që burojnë nga veprimet kriminale të autoriteteve serbe në Kosovë. Sipas Amnesty International, të paktën 2.000 shqiptarë etnikë, mbaheshin në objektet e paraburgimit serb – disa pa akuza formale kundër tyre. OJQ-të kanë dokumentuar se mes të arrësuarve janë gra dhe fëmijë.²⁷

Ekzekutimet në masë

Departamenti i Shtetit, lidhur me ekzekutimet në masë nga ana e ushtrisë dhe policisë serbe gjatë luftës në Kosovë, thekson se janë identifikuar rreth 500 lokacione në Kosovë ku janë realizuar ekzekutime në masë dhe viktimat janë varrosur në varreza masive. Me këtë rast në raportin e cekur, Vetëm në një shembull, ilustruhet rasti kur “forcat serbe të sigurisë mbyllën një familje të tërë në një shtëpi në zonën e Drenicës dhe i dogjën të gjallë”. Përveç ekzekutimeve në masë,

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty, p. 16.

forcat serbe kishin një strategji të zhdukjin edhe anëtarët e inteligjencës shqiptare të Kosovës duke përfshirë avokatë, mjekë dhe udhëheqës politikë. Të mbijetuarit raportuan se forcat serbe dogjën trupat e zhvarrosur nga varret masive në një përpjekje të dukshme për të shkatërruar provat mjeko-ligjore të krimeve të luftës.²⁸

Zhvarrosja e varrezave masive

Departamenti i Shtetit i kushton një vëmendje të veçantë zhvarrosjes së organizuar të varrezave masive në Kosovë, nga ana e ushtrisë dhe policisë së Serbisë. Ky veprim makabër, ishte prezent që nga fillimi i luftës, si pjesë e krimit të paramenduar për të minimizuar provat e mizorive ndaj popullatës civile shqiptare. Raporti thekson se në disa raste forcat serbe i refuzojnë trupat e shqiptarëve të ekzekutuar në varre individuale, ndërsa në raste të tjera kufomat u dogjën. Lëvizja e trupave nga varret masive në varre individuale kishte për qëllim pengimin e lokalizimit të vendndodhjes së vendeve të ekzekutimit në masë dhe që të pengojë aftësinë e hetuesve mjeko-ligjorë për të bërë dallimin midis varreve "të rregullta" dhe varreve që përmbajnë viktimat të masakrës.²⁹

Raporti i Departamentit të Shtetit, nënvizon se një nga shembujt më eklatantë është gjithashtu edhe një nga më të dokumentuarit. Në prill të vitit 1999, forcat serbe masakruan civilët shqiptarë të Kosovës në një fushë afër fshatit Izbicë. Pas masakrës, shqiptarët vendës të Kosovës i varrosën viktimat në varre individuale, një ngjarje e filmuar nga një dentist vendës. Departamenti i Shtetit, me këtë rast konfirmoi se vendndodhja e incizimit të videokasetës vërtetohej nga imazhet satelitore. Forcat serbe, gjatë tërheqjes së tyre nga Kosova në fillim të qershorit, shkatërruan varret në Izbicë së bashku me varret e tjera të viktimave të tyre, fakt të cilin Departamenti i Mbrojtjes së ShBA-së e konfirmoi përmes imazheve satelitore dhe fakteve të tjera. Si ilustrim i këtyre veprime të zhvarrosjes së varreve masive, Departamenti i Shtetit, prezanton edhe rastin kur forcat serbe në Lipjan, në fillim të muajit maj 1999, zhvarrosën trupat e shqiptarëve të cilët ishin ekzekutuar më 18 prill 1999. "Pasi i zhvendosën kufomat në një ndërtesë në fshat, forcat ushtarake dhe policore serbe me këtë rast, urdhëruan anëtarët e mbijetuar të familjes që të bëhet rivarrosja e tyre në varre individuale. Në mënyrë të ngjashme, forcat serbe më 15 maj 1999 zhvarrosën trupat

²⁸ Po aty, p. 11.

²⁹ Po aty, p. 11.

e të paktën 50 shqiptarëve në Drenas dhe i transportuan trupat në fshatin e afërt të Çikatovës, ku më pas u varrosën në varre individuale”. Raporti, merr si shembull edhe zhvarrosjen e trupave nga një varr masiv në Kaçanik, në mes të qershorit të vitit 1999, me ç’rast policia serbe i zhvendosi në një varrezë lokale, për t’i zhdukur gjurmët e krimit.³⁰

Përdhunimi

Bazuar në raportin e Departamentit të Shtetit, dhunimi i organizuar dhe sistematik i grave shqiptare të Kosovës nga ana e policisë dhe ushtrisë së Serbisë ishte shumë i përhapur gjatë luftës në Kosovë. Në raportimet fillestare të refugjatëve të cilat transmetohen nga ana e Departamentit të Shtetit, theksohen fillimisht dhunimi sistematik i grave nga ana e policisë dhe ushtrisë serbe në Gjakovë dhe Pejë. “Gratë shqiptare u ndanë nga familjet e tyre dhe u dërguan në një kamp ushtarak afër Gjakovës, ku u përdhunun në mënyrë të përsëritur nga ushtarët serbë. Në Pejë, shqiptarët e Kosovës u deklaruan se forcat serbe mblodhën gra të reja shqiptare nga Kosova dhe i çuan në hotel “Karagaç”, ku u përdhunun në mënyrë të përsëritur. Komandanti i bazës lokale thuhej se kishte përdorur një listë me emra ushtarësh për t’i lejuar të gjithë trupat e tij një mbrëmje në hotel. Një viktimë që u shpëtoi rrëmbyesve të saj raportoi se forcat serbe përdorën një hotel të dytë në Pejë, “Metohi”, për përdhunimin e grave shqiptare të Kosovës. Përveç këtyre rrëfimeve specifike, shumë shqiptarë të Kosovës kanë pohuar se gjatë bastisjeve serbe në fshatrat e tyre, vajzat e reja u përdhunun në grup në shtëpi dhe në rrugë anësore.” Raporti, po ashtu, thekson se shumë përdhunime nuk janë deklaruar edhe për shkak të stigmës që është prezente në shoqërinë tradicionale shqiptare të Kosovës. Ndërlidhur me këtë, objektet e shërbimeve mjekësore kanë raportuar për aborte në mesin e grave refugjate, të cilat kanë deklaruar se janë përdhunun nga forcat serbe.³¹

Shkeljet e neutralitetit mjekësor

Departamenti i Shtetit në relacionet e tij për krimet dhe mizoritë serbe në Kosovë, thekson se forcat serbe sulmuan sistematikisht mjekët, pacientët dhe objektet mjekësore të shqiptarëve të Kosovës. Shkeljet e neutralitetit

³⁰ Po aty, p. 11.

³¹ Po aty, p. 11-12.

mjekësor nga ushtria dhe policia serbe përfshinin vrasjet, torturat, ndalimet, burgosjet dhe zhdukjen me forcë të mjekëve shqiptarë të Kosovës. Në mars dhe prill të vitit 1999, ofruesit e kujdesit shëndetësor serbë, policia dhe ushtria dëbuan pacientët shqiptarë të Kosovës dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor nga objektet shëndetësore si pretekst mbrojtës për aktivitete ushtarake. OJQ-ja “Mjekët për të Drejtat e Njeriut” raportonte për shkatërrimin e të paktën 100 klinikave mjekësore, farmacive dhe spitaleve.³²

Çrrënjësja e identitetit

Në lidhje me çështjen e nëpërkëmbjes së identitetit etnik të shqiptarëve, Departamenti i Shtetit thekson në formë specifike që “forcat ushtarake dhe policore serbe kanë konfiskuar dokumentet e identitetit dhe pronës, duke përfshirë pasaportat, fletat posoduese të tokës, targat e automjeteve, kartat e identitetit dhe forma të tjera të dokumentacionit nga shqiptarët e Kosovës pasi ata ishin dëbuar me forcë nga vendbanimet e tyre, apo kur ata kaluan kufijtë në Shqipëri ose Maqedoni. Mjekët për të Drejtat e Njeriut raportojnë se gati 60 për qind e të anketuarve në ultimatumin e tyre vëzhguan forcat serbe duke marrë ose shkatërruar dokumentet personale të identifikimit. Lidhur me këtë, organizata “Physicians for Human Rights” (Mjekët për të Drejtat e Njeriut) raportoi gjithashtu se qëllimi për të shkatërruar identitetin shoqëror të shqiptarëve të Kosovës u reflektua edhe në numrin e objekteve të kultit, shkollave dhe objekteve mjekësore që u shkatërruan nga ushtria dhe policia e Serbisë.³³

PROCESI I INTERVISTIMIT TË REFUGJATËVE

Me qëllim të dokumentimit dhe regjistrimit të krimeve makabre serbe ndaj popullatës civile shqiptare të Kosovës, një sërë organizatash joqeveritare, qeveri dhe organizata ndërkombëtare ndërmorën hulumtime dhe intervista sistematike të refugjatëve që si pasojë e spastrimit etnik të orkestruar nga Serbia, ishin sistemuar në kampe të refugjatëve dhe familje mikpritëse në Maqedoni dhe Shqipëri. Në këtë kontekst, do të paraqiten ato dokumentime të cilat kanë qenë me rëndësi për Departamentin e Shtetit amerikan.

³² Po aty, p. 12.

³³ Po aty.

Mjekët për të Drejtat e Njeriut

Organizatata “Physicians for Human Rights” (PHR) - (Mjekët për të Drejtat e Njeriut) dhe “Programi mbi Migrimin e Detyrueshëm dhe Shëndetin” të Universitetit Columbia-Shkollës së Shëndetit Publik “Joseph L. Mailman”, hartuan një studim epidemiologjik të orientuar rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e forcave serbe, me qëllim të krijimit të modeleve matricë lidhur me këtë çështje, në mesin e popullatës së refugjatëve të Kosovës. Në vend të përdorimit të rrëfimit të viktimave apo dëshmitarëve të abuzimit, PHR-ja me këtë rast u përpoq të vlerësonte përhapjen e abuzimeve nëpërmjet metodave perkatëse të pranura ndërkombëtarisht të hulumtimit-anketimit. Përfaqësuesit e këtyre organizatave intervistuan 1. 209 refugjatë të Kosovës në 31 kampe refugjatësh dhe qendra kolektive në Shqipëri dhe Maqedoni, ndërmjet 19 prillit dhe 3 majit 1999. Hulumtimi kishte për qëllim të vlerësoi shkeljet e të drejtave të njeriut në mesin e 11.458 anëtarëve të familjeve, në kohën kur ata jetonin në Kosovë. Rezultatet e këtij vlerësimi u përfshinë në raportin e “Krimet e Luftës në Kosovë”, botuar në gusht të vitit 1999 nga ana e “Mjekëve për të Drejtat e Njeriut”. PHR-ja vë në dukje se gjetjet e studimit të tyre tregojnë se “forcat serbe u angazhuan në një fushatë sistematike dhe brutale për të dëbuar me forcë popullsinë shqiptare etnike të Kosovës. Si pjesë e këtyre dëbimeve masive, si dhe përgjatë vitit 1998, forcat serbe kanë kryer shkelje shumë të përhapura të të drejtave të njeriut kundër shqiptarëve të Kosovës, duke përfshirë: vrasje, rrahje, tortura, sulme seksuale, ndarje dhe zhdukje, të shtëna, plaçkitje dhe shkatërrim të pronave, si dhe shkelje të neutralitetit mjekësor”. Sipas këtij hulumtimi një në tre familje raportuan të paktën një nga këto abuzime, me shumicën e abuzimeve të ndodhura në mars dhe prill të vitit 1999. Në mesin e 598 rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut të raportuara në mesin e respondentëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, lokacioni ku kanë ndodhur këto abuzime përfshinte 23 nga 29 komunat e Kosovës. Në përgjithësi, frekuenca më e lartë e krimeve ishte vërejtur në komunat me numrin më të madh të popullsisë.³⁴

Ky hulumtim, po ashtu, trajtoi edhe shtrirjen dhe natyrën e spastrimit etnik të shqiptarëve nga Kosova nga ana e forcave ushtarake dhe policore serbe. Gjetjet e anketës së PHR-së pasqyrojnë qartë se pothuajse të gjithë respondentët (91%) u detyruan, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të

³⁴ Physicians for Human Rights, qasur më 30.09.2023, <https://phr.org/wp-content/uploads/1999/08/kosovo-war-crimes-1999.pdf>; Po aty, p. 13.

largoreshin nga shtëpitë e tyre thjesht me arsyetimin se ishin shqiptarë të Kosovës. Në këtë kuadër, 68% u dëbuan me forcë nga forcat serbe. Më shumë se një e treta e të anketuarve kishin përjetuar dhunën policore ose ushtarake serbe që vinin në shtëpitë e tyre (36%), duke demonstruar në këtë mënyrë shumë të përhapur në të cilën terrori ndërpreu jetën individuale dhe familjare të tyre. Të tjerët u dëbuan me forcë për shkak të bombardimeve serbe (25%). Ndryshe nga raportimet e medieve serbe, asnjë pjesëmarrës i hulumtimit nuk përmendi bombardimet e NATO-së si arsye për zhvendosjen nga shtëpitë e tyre. “Dëshmitë e rasteve individuale treguan se dëbimet nga forcat serbe ishin bërë në mënyrë metodike dhe të pamëshirshme. Ato përfshinin forcat serbe që vinin në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe urdhëronin të gjithë banorët të largoreshin brenda disa orësh nën kërcënimin e vdekjes. Dëbimet e tilla shoqëroheshin me shkatërrimin e shtëpive dhe pronës personale, dhe/ose dëmtim fizik të anëtarëve të familjes”.³⁵

Projekt dokumentimi i krimeve të luftës ABA/CEELI

Departamenti i Shteti prezanton, po ashtu, edhe projekte të tjera të dokumentimit të krimeve në Kosovë. Një ndër iniciativat që shpalosen në këtë relacion është edhe projekti i dokumentimit të realizuar nga ana e “American Bar Association’s Central (Shoqata e Avokatëve të Amerikës) and East European Law Initiative (Iniciativa Ligjore e Evropës Qendrore dhe Lindore) (ABA/CEELI). Ky projekt filloi në maj të vitit 1999. Qëllimi i projektit ishte dydimensional. Objektivi i parë përfshinte përpjekjet për të hetuar krimet e luftës dhe për të ndjekur penalisht autorët. Për këtë qëllim, ABA/CEELI kreu intervista me refugjatë në Maqedoni, Shqipëri dhe Fort Dix, Nju Xhersi që nga maji deri në korrik të vitit 1999. Objektivi i dytë i projektit ishte të ngrinte ndërgjegjësimin publik për krimet e luftës, ndjekjen penale të tyre dhe rolin e ICTY.³⁶

Informacioni i mbledhur gjatë intervistave me refugjatët u fut në një bazë të dhënash kompjuterike të miratuar nga ICTY. Ky projekt i udhëhequr nga ABA/CEELI publikoi një raport në gusht të vitit 1999 mbi përdorimin e kësaj baze të dhënash dhe natyrën e të dhënave të saj. Baza e të dhënave përfshinte 1.582 deklaratatë të dëshmitarëve me 4.328 raste të raportuara në formë diskrete. Krimet e raportuara përfshinin torturën, shkatërrimin e pronës, arrestimet dhe ndalimet, zhvendosjen e

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty, p. 13.

detyruar, ngacmimet, sulmet seksuale dhe vrasjet. Ky informacion ka ndihmuar hetuesit e Tribunalit të Hagës për gjetjen e dëshmitarëve, identifikimin e skenave të mundshme të krimit dhe kryerjen e planifikimit strategjik për hetimet e tyre.³⁷

Përpjekje të tjera të dokumentimit

Departamenti i Shtetit në pah edhe veprimtarinë e organizatës “Medecins sans Frontieres” (Mjekët pa kufij) e cila publikoi një raport më 30 prill të vitit 1995, lidhur me gjendjen e refugjatëve dhe kreu një studim epidemiologjik ndaj një popullsie prej 1 537 personash që kishin mbërritur në kampin e refugjatëve në Rozhajë të Malit të Zi. Hulumtimi mbuloi ngjarjet në më shumë se 50 fshatra në Kosovë ndërmjet 24 marsit dhe 15 prillit 1999. Ky raport nxori përfundimin se shkak i lëvizjeve masive të popullsisë në Kosovë ishte deportimi nën kërcënimin e vdekjes. Po ashtu, theksohet se “deportimi u shoqërua me plaçkitje dhe shkatërrim të pasurisë së viktimave; metodat e deportimit të detyrueshëm ishin pothuajse identike në mbarë Kosovën; letrat e identitetit konfiskoheshin dhe asgjësoheshin sistematikisht nga forcat serbe; si dhe ndarja e burrave dhe grave ishte një praktikë e zakonshme gjatë dëbimeve.” Më shumë se gjysma e këtyre të anketuarve, si dëshmitarë okularë përshkruan vrasjet.

Relacionet e Departamentit të Shtetit të ShBA-së, lidhur me spastrimin etnik të popullit shqiptar dhe krimet serbe kundër njerëzimit në Kosovë (1999), janë dokumente me rëndësi për Kosovën dhe janë të bazuara në të dhënat e hulumtimeve mjeko-ligjore të ICTY dhe KFOR-it, dëshmime të refugjatëve, dokumentimin e qeverive, organizatave joqeveritare, shtypin dhe burimet e organizatave ndërkombëtare dhe informata të tjera qeveritare.

Këto raporte zyrtare amerikane përmbajnë të dhëna statistikore për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare, katastrofës humanitare, mizoritë dhe krimet e luftës në Kosovë dhe karakterizohen si fakte kredibile e objektive dhe si të tilla janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për historiografinë e Kosovës, meqë hedhin dritë në shqyrtimin e gjenocidit shtetëror të Serbisë ndaj shqiptarëve të Kosovës.

³⁷ Po aty, p. 13.

Sadik Krasniqi
Besnik Rraci

MASAKRAT SERBE NË KOSOVË 1998-1999 - SIPAS DËSHMIVE MATERIALE MUZEORE

Abstrakt

Kumtesa me titull: “Masakrat Serbe në Kosovë 1998-1999 - sipas dëshmime materiale muzeore” trajton materien e krimeve serbe në Kosovë, përkatësisht do të fokusohet te masakrat e kryera nga forcat e okupatorit serb ndaj civilëve shqiptarë, duke mos i kursyer as kategoritë me të ndjeshme të popullit, siç ishin fëmijët, pleqtë dhe gratë. Punimi ynë do të përqendrohet kryesisht te rrëfimi i ngjarjeve tronditëse nëpërmes dëshmime materiale muzeore, siç janë: heshtat, thikat, sëpatat, shiringat, litarët, telat me gjemba, rroba të brendshme të femrave të përdhunuara, e deri te përdorimi i të gjitha predhave të kalibrave të ndryshëm të artilerisë serbe. Pra, janë këto disa nga burimet materiale autentike, të cilat janë përdorur nga forcat e ushtrisë dhe policisë serbe, për t’i masakruar në mënyrën më brutale popullsinë e pafajshme të Kosovës, me arsyen e vetme, pse ishin shqiptarë. Një pjesë e konsiderueshme e dëshmime materiale që i referohet luftës së fundit në Kosovë, përfshirë këtu edhe masakrat serbe ndaj popullsisë civile shqiptare, që kryesisht janë të mbledhura dhe të ruajtura nëpër muzetë e Kosovës, me theks të veçantë në Muzeun Kombëtar të Kosovës. Prandaj këtij punimi shkencor e profesional i jemi qasur nga këndvështrimi muzeor, me qëllim të pasqyrimin sa më të detajuar të këtij kapitulli, sa të dhimbshëm po aq edhe krenar.

Fjalët çelës: Masakrat, Kosova, Muzeu, dëshmitë, krimet, burime materiale, lufta, shqiptar, civile, forcat ushtarake serbe, etj.

Populli shqiptar në përgjithësi dhe ai i Kosovës në veçanti, gjatë historisë nuk i pushoi asnjëherë përpjekjet për çlirim kombëtar. Gjatë këtij rrugëtimi të gjatë dhe me plot sakrifica të mëdha, dhanë kontribut të çmuar shumë gjenerata dhe kategori të ndryshme të popullit tonë.¹ Në vitet 40 të shek. XIX udhëheqësit serbë filluan t’i mendojnë planet ekspansioniste për zgjerimin e Serbisë, të cilat e kishin zanafillën edhe më herët. Mbi këtë bazë ata filluan edhe të ndërtojnë platformën

¹ Ph.D. Besnik Rraci & Dr. Sadik Krasniqi, “*Veprimtaria Atdhetare e heroit Sali Çekaj*”, Botues, Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë, 2022, fq. 140-141

famëkeqe të „Naçertanias“, e cila u jetësua në vitin 1844, në krye me ideologun e këtij elaborati, Ilia Garashanin, rreth të cilit do të mbli-dheshin të gjithë krerët politikë”, por edhe ata fetarë që u vunë në shër-bim të kësaj ideologjie duke u mbështetur edhe nga qarqet konservatore serbe. Ky plan në shënjestër kryesore i kishte vënë shqiptarët që, në fakt, pësuan dhunë, padrejtësi historike, shpërngulje dhe kolonizim të tokave të tyre të shoqëruara me një gjenocid të paparë deri te tentativat për shfarosjen e tyre të plotë.²

Kthesa radikale që e favorizonte Serbinë ishte “Paqja e Shën Stefanit” dhe gjendja e brishtë e krijuar me dobësimin e Perandorisë Osmane, kur edhe filluan shpërnguljet e mëdha të shqiptareve nga trojet e tyre të përcjella më dhunë dhe krime monstruoze ndaj tyre,³ të cilat nuk u ndalën asnjëherë në vijimësi deri te lufta e fundit 1999. Përdorimi i metodave me drakonike si; dhuna shtetërore e pandërprerë dhe kolonizimi i tokave ua nxinë jetën shqiptareve dhe në fund i detyronte të shpërnguleshin, te asimiloheshin apo të vriteshin pa gjyqe nga falangat paramilitare serbe që vepruan lirshëm me leje të strukturave shtetërore. Pra, nxitja e ekseseve më banale ndëretnike bëhej me qëllim të caktuar për të pasur alibi për terrorin që do të ushtrohej ndaj gjithë popullatës së një rajoni të tërë. Duke mos mundur të ballafaqohej me rezistencën shqiptare, ushtria, policia dhe paramilitarët serbë gjithë egërsinë e tyre e shfrynin kundër popullatës së pafajshme civile shqip-tare, kundër grave e fëmijëve, pleqve e të rriturve. Në këtë kasaphane nuk mbeti metodë më monstruoze që të mos jetë përdoruar vetëm e vetëm që popullata autoktone shqiptare të shfarosej përgjithmonë.⁴

Vrasjet dhe masakrat masive të shkaktuara nga aparati shtetëror serb në Kosovë, janë të shumta, gjithandej Kosovës.⁵ Në lidhje me këtë tematikë, fokusi ynë kryesisht bie te rrëfimi i ngjarjeve tronditëse nëpërmes dëshmive materiale muzeore, siç janë: heshtat, thikat, sëpatat, shiringat, litarët, telat me gjemba, rroba të brendshme të femrave të përdhunara, e deri te përdorimi i të gjitha predhave të kalibrave të ndryshëm të artillerisë serbe. Pra, janë këto disa nga burimet materiale

² Nysret Pllana, “*Terrori i Serbisë* pushtuese mbi shqiptarët 1844-1999”, Prishtinë, 2001, fq. 11-16

³ Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Historisë, “*Historia e Popullit Shqiptar II*”, Botimet Toena, Tiranë, 2002, fq. 148

⁴ Mikel Ndreca, “*87 VJET, terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*”, Prishtinë, 2001, fq. 15-21

⁵ Mr. Sadik V. Krasniqi, “*Lufta për Çlirimin e Kosovës (1997-1999)*”, Prishtinë, 2009, fq. 676

autentike, të cilat janë përdorur nga forcat e ushtrisë dhe policisë serbe, për t'i masakruar në mënyrën më brutale popullsinë e pafajshme të Kosovës, me arsyen e vetme, vetëm pse ishin shqiptarë.⁶

Një pjesë e konsiderueshme e dëshmimeve materiale që i referohet luftës së fundit në Kosovë, përfshirë këtu edhe masakrat serbe ndaj popullsisë civile shqiptare, që kryesisht janë të mbledhura dhe të ruajtura nëpër muzetë e Kosovës, me theks të veçantë në Muzeun Kombëtar të Kosovës, janë dëshmitë më reale që mund të shihen dhe preken me dorë, të cilat kanë shërbyer nga okupatori fashist serb për kryerjen e krimeve dhe masakrave në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Dëshmitë materiale muzeore të cekura si më lart, na argumentojnë edhe një anë tjetër të errët të medaljes, ku përmes përdorimit të tyre, kriminelët serbë i kanë copëtuar gjymtyrët e trupave të civilëve shqiptarë, duke ua prerë veshët, hundën, duart, këmbët, sytë, organet gjinitale, kokën, e deri te nxjerrja e organeve me vitale të trupit të njeriut siç janë mushkëritë, veshkat, zemra, etj.⁷

Përdorimi i këtyre metodave morbide, nga aparati shtetëror serb, në mënyrë të organizuar, tentonte që t'ia fuste frikën në palcë, popullatës civile shqiptare, në mënyrë që ta nënshtronte dhe ta detyronte atë që të hiqte dorë nga kauza e tyre për liri dhe pavarësi. Gjithashtu, pushteti okupues gjenocidial serb pretendonte ta përdhoste edhe identitetin kulturor dhe kombëtar, duke i shkatërruar disa nga objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike.⁸

Prej këtyre dëshmimeve materiale posedojmë; dy shpata të shkurtra të gjetura në lagjen Arbana të Prizrenit; një thikë e gjetur në fshatin Vërmicë të Prizrenit; një thikë e gjetur në fshatin Celinë të Rahovecit; dy shpata të gjetura në fshatin Dresnik të Pejës; një sëpatë e gjetur në fshatin Marec të Prishtinës; dorëz e thikës me mbishkrime ruse e gjetur në fshatin Bellacerkë (Fortesë) të Rahovecit; shkop druri i gjetur në fabrikën e Ferronikelit në Drenas; një litar i përgjakur dhe një shiringë të gjetur në fshatin Duhël të Shtimes; sofër buke e traditës shqiptare e përdhosur dhe e dëmtuar me mbishkrime nacionaliste serbe, e gjetur në fshatin Bellacerkë (Fortesë) të Rahovecit, plisi i bardhë i përgjakur me

⁶ Raporte pune nga tereni, gjatë hulumtimeve kërkimore në mbledhjen e dëshmimeve materiale të luftës ndërmjet viteve 2000-2015, Sektori i Historisë, Muzeu i Kosovës, Prishtinë.

⁷ Katalogu i ekspozitës tematike me titull: "Drama Kosovare", e hapur zyrtarisht me 12 qershor 2000, në hapësirat e Muzeut të Kosovës në Prishtinë.

⁸ Mr. Tefik Morina "Mozaik Historik", Prishtinë, 2011, fq. 120, 121

mbishkrime nacionaliste serbe (shkrimi i katër “S-ve”), i gjetur në Fushë Kosovë; disa dhjetëra gëzhoja të predhave të kalibrave të ndryshëm të përdorura nga forcat artilerie ushtarake dhe policore serbe kundër popullsisë civile shqiptare të gjetura në të gjitha komunat e Kosovës ku kishte luftë; si dhe disa palë rroba të brendshme të femrave shqiptare të dhunuara seksualisht nga paramilitarët dhe militarët e forcave serbe.⁹

Dy shpata të shkurtra: të gjetura në banesën e kriminelit Gadaf Demaj nga lagja Arbanë e Prizreni, i shkolluar në Beograd të Serbisë, i cili ishte bashkëpunëtor shumëvjeçar i UDB-së. Ka marrë pjesë në shumë masakra të kryera nga paramilitarët dhe njësitë e rregullta militare policore serbe në rajonin e Prizrenit dhe në tërë Kosovën. Pra sipas buri-meve okulare thuhet se ky kriminel i njohur në këto anë me pseudonimin “Gadafi” me këto armë të ftohta ka masakruar shumë civilë shqiptarë. Krimineli në fjalë ka arritur t’i shpëtojë luftës dhe pas kapitullimit të Serbisë ka ikur në Serbi, ku jeton edhe sot e kësaj dite. Me qëllim të zbardhjes dhe argumentimit të krimeve të kryera gjatë luftës nga ky kriminel, informatat për Muzeun Kombëtar të Kosovës i ka dhënë Enver Rexha, ish-veprimtar politik i LKÇK-së, me datën 18.02.2001.¹⁰



Fig.1. Dy shpata të shkurtra të gjetura në lagjen Arbana të Prizrenit

⁹ Raport pune, “Lista me dëshmitë materiale të luftës1998/99”, Sektori i Historisë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë.

¹⁰ Deklaratë me gojë e Enver Rexha, ish-veprimtar i LKÇK-së, të dhënat i dha më datën 18.02.2000, Prizren.

Thikë: e gjetur në trupin e një femre civile shqiptare të paidentifikuar, në fillim të muajit nëntor të vitit 1999, në vendin e quajtur Vërmicë, fshat ky që gjendet ndërmjet kufirit shqiptaro-shqiptar, Kosovë-Shqipërisë. Sipas rrëfimeve autentike të dëshmitarit Xhemshit Krasniqi, i cili thotë se forcat serbe, kanë vrarë shumë civilë shqiptarë në shumë vende përgjatë vijës kufitare me Shqipërinë, përfshirë këtu edhe rastin në fjalë. Më tej ai shprehet se: *“kudo që kemi arritur t’i shohim vrasjet dhe masakrat e bëra ndaj civilëve shqiptarë kemi hasur në shumë dëshmi materiale kryesisht armë të ftohta. I vetëdijshëm për vlerën dhe rëndësinë argumentuese që ka thika, e kam marrë nga vendi i ngjarjes për të dëshmuar për rastin”*. Ndërkaq me datën 16 qershor 2001, këtë eksponat ia ka dhuruar si dëshmi Muzeut të Kosovës.¹¹



Fig.2. Thikë e gjetur në fshatin Vërmicë të Prizrenit

Thikë ushtarake: e gjetur në fshatin Celinë, përkatësisht në lagjen Hasanaj të Rahovecit me datën 25 mars 1999. Sipas rrëfimeve të dëshmitarit Sadik Hasani, vërtetohet se thika është përdorur nga paramilitarët dhe militarët e forcave serbe për të vrarë dhe masakruar civilët shqiptarë të këtij fshati. Pra, pikërisht në mars të vitit 1999 janë masakruar 81 fshatarë të të gjitha moshave. Dëshmitari veç të tjerash thekson se forcat serbe përveç që i vrisnin civilët shqiptarë më pas ata i masakronin duke ua prerë organet e ndryshme të trupit, si: hundët, gjuhën, syrin, kokën, duart, këmbët dhe në fund fare ua nxjerrin jashtë të gjitha organet e brendshme, kështu që në shumë raste ishte e pamundur ta identifikojë familjarin tënd. Për t’i vrarë njerëzit me lehtë zakonisht i përdornin armët e zjarrit, ndërsa më pas kufomat e tyre i prenë e i copëtonin në format më barbare të mundshme me armët e ftohta, vetëm e vetëm që t’i frikësonin shqiptarët dhe t’i bënë të vuajnë sa më shumë. Sipas dëshmitarit Sadik Hasani, në kohën kur janë vrarë fshatarët e fshatit Celinë në mesin e tyre

¹¹ Deklaratë me gojë e Xhemshit Krasniqi, ish eprorë i UÇK-së Zonën Operative të Pashtrikut në Prizren, të dhënat i dha më datën 16.06.2001, Prizren.

kanë qenë edhe pesë anëtarë të ngushtë të familjes së tij. Pas përfundimit të luftës me qëllimet me mira që t'i kontribuonte ndriçimit të krimeve serbe, dëshmitë materiale përfshirë këtu edhe thikën ia dorëzoi Muzeut të Kosovës, si institucioni më kompetent për ruajtjen dhe prezantimin e krimeve të luftës më 10 dhjetor 2000.¹²



Fig.3. Thikë e gjetur në fshatin Celinë të Rahovecit

Dy shpata: të gjetura në shtëpinë e një serbi në fshatin Dresnik të komunës së Klinës në tetor të vitit 1999. Sipas të dhënave të marra nga Halit Sahitaj, thuhet se shpatat janë përdorur nga forcat paramilitare dhe militare serbe për të bërë masakra ndaj civilëve shqiptarë në rajonin e Pejës. Sipas tij shpatat e përgjakura janë dëshmia me autentike konkrete në të cilat shihen qartë gjurmët e krimit, që forcat serbe i përdorën si metodat me monstruoze për të treguar edhe kësaj here se urrejtja e tyre ndaj shqiptarëve është patologjike dhe e organizuar mirë nga aparati shtetëror që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, e në vijimësi shpërfaqet deri në përfundim të shekullit XX. Po e themi këtë për faktin se të përdorësh në luftë armë të tilla për t'i prerë dhe copëtuar viktimat e pafajshme, duhet të jesh shumë i prishur në shpirt, në shkallë kanibali ose të jesh egërsirë e çmendur, aq më tepër në këtë shekull kur vetëdija e njeriut dhe botës së qytetëruar në përgjithësi kishte arritur në një nivel tjetër, derisa mendësia e okupatorit serb kishte mbetur në nivel mesjetar. Të dy shpatat janë sjellë në Muzeun e Kosovës me datën 6 dhjetor 1999, si dëshmi për ta argumentuar gjenocidin serb ndaj shqiptarëve dhe për t'i informuar e edukuar brezat e rinj se çfarë kishte ndodhur në Kosove gjatë luftës 1998-1999.¹³

¹² Deklaratë me gojë e Sadik Hasani, ish student i Fakultetit Ekonomik të UP-së, të dhënat i dha më datën 10.12.2000, Celinë-Rahovec.

¹³ Deklaratë me gojë e Halit Sahitaj, ish student i Fakultetit të Filologjisë të UP-së, të dhënat i dha më datën 06.12.1999, Çifllak-Rahovec.



Fig.4. Dy shpata të gjetura në fshatin Dresnik të Klinës

Sëpatë e gjetur në fshatin Marec të komunës së Prishtinës, me të cilën është masakruar shqiptari Faik Vitia nga forcat policore serbe në prill të vitit 1999. Sipas të dhënave të kushëririt të tij të afërm, Behxhet Vitia, i cili thotë se forcat serbe përveç që ishin të armatosur dhe të organizuar paraprakisht me armë të ftohta, gjithashtu edhe kur hynin nëpër shtëpitë e fshatrave shqiptare i vrisnin dhe i masakronin ata me veglat e tyre të punës, qofshin ato bujqësore apo të amvisërisë siç ishin sëpatat, kmesat, drapërinjtë, kosat, sharrat, etj. E në rastin konkret me sëpatat tona që fshatarët kryesisht i kanë përdorur për nevoja familjare, përkatësisht për prerjen e drunjve në pyll apo në shtëpi është masakruar Faik Vitia. Pas përfundimit të luftës këtë eksponat e ka sjellë në muze Behxhet Vitia, e cila ka shërbyer si dëshmi materiale për t'i prezantuar përmes ekspozitave tematike në muze krimet serbe para opinionit vendor dhe sidomos atij ndërkombëtar.¹⁴



Fig. 5. Sëpatë e gjetur në fshatin Marec të Prishtinës

¹⁴ Deklaratë me gojë e Behxhet Vitia, ish luftëtar i UÇK-së, të dhënat i dha me datën 02.05.2000, Marec-Prishtinë.

Dorëz e thikës me mbishkrime ruse e quajtur “DUMA”: e gjetur në shtëpinë e familjes së Avdurrahman Kelmendit në fshatin Fortesë të Rahovecit. Sipas rrëfimit të tij, me datën 24 prill 1999, forcat serbe dhe paramilitar rusë të ardhur vullnetarisht dhe si mercenar nga Rusia, janë stacionuar në shtëpinë e tij prej nga janë dhunuar seksualisht, vranë dhe masakruar shumë shqiptar në mesin e tyre edhe Nadie Spau nga Rahoveci, Shaipi me djalë nga fshati Brestoc i Rahovecit dhe shumë të tjerë. Për këto krime dëshmojnë edhe dëshmitë e shumta materiale përfshirë këtu edhe thikën me mbishkrime ruse, të përdorur nga paramilitarë rusë kundër civilëve shqiptarë, që shumë prej tyre kishin marrë pjesë në luftën e Kosovës 1998-1999, në kuadër të forcave serbe. Dorëza e thikës është dëshmi konkrete që flet qartë për pjesëmarrjen dhe kryerjen e krimeve në Kosovë. Është me rëndësi të potencohet fakti se, gjatë kësaj kohe në fshatin Bellacerk (Fortesë) të Rahovecit janë vranë dhe masakruar dhjetëra shqiptarë të këtij fshati nga forcat serbe dhe paramilitare ruse. Dorëza e thikës që mban emërtimin rus “Duma”, pas luftës me datën 13 janar 2001, i është dhuruar Muzeut të Kosovës, si dëshmi historike materiale për ta argumentuar pjesëmarrjen dhe masakrat e shkaktuara edhe nga paramilitarët rusë.¹⁵



Fig.6. Dorëz e thikës me mbishkrime ruse e gjetur në fshatin Bellacerkë (Fortesë) të Rahovecit

Shkop druri: i gjetur në fabrikën e Ferronikelit në Drenas, si rezultat i hulumtimeve kërkimore të bërë nga bashkëpunëtorët shkencorë dhe profesionalë të sektorit të historisë në Muzeun e Kosovës, gjatë muajve nëntor-dhjetor të vitit 1999, me ç‘rast, krahas shumë dëshmimeve

¹⁵ Deklaratë me gojë e Avdurrahman Kelmendit, vëllai i dëshmorit të UÇK-së Agim Kelmendi, të dhënat i dha m datë 02.05.2000, Bellacerkë (Fortesë), Rahovec.

materiale u gjet edhe ky shkop druri. Sipas të dhënave okulare të marra nga komuniteti shqiptar që jetonte pranë këtij lokaliteti, rrëfyon për ngjarjet që kishin ndodhur gjatë luftës në këtë qytet. Ata veç të tjerash, na treguan se për çfarë ishte përdoruar shkopi i drurit nga forcat serbe. Shkopi i drurit apo siç njihet në opinionin e gjerë si “shkop beizbolli” ishte përdorur nga forcat serbe për rrahje masive në grup dhe individuale të të gjithë shqiptarëve që në mënyra të dhunshme i kapnin nëpër qytet dhe i grumbullonin në fabrikën e Ferronikelit në Drenas, pikërisht aty ku ishte stacionimi kryesor i forcave serbe. Si pasojë e rrahjeve brutale, shumë prej civilëve shqiptarë vdisnin, ndërsa një pjesë e vogël prej tyre mbetën përgjithmonë invalidë. Aq lart shkante brutaliteti sa kriminelët serbë, përveç që i mbytnin, me pas kufomat e tyre i gjymtonin dhe i tjetërsonin duke ua ndërruar rrobat para se t’i varrosnin masivisht. Ekspoziti në fjalë, është pjesë integrale e koleksioneve të luftës, të cilat shërbejnë si dëshmi historike për t’i argumentuar krimet e forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë.¹⁶



Fig.7. Shkop druri i gjetur në fabrikën e Ferronikelit në Drenas

Litar i përgjakur: i gjetur në fshatin Duhël të Shtimes, me datën 10 korrik 1999. Sipas burimeve të marra nga Zona Operative e Pashtrikut, sektori për informim, nën udhëheqjen e eprorit Halil Çadraku, i cili konfirmon se të gjitha këto dëshmi materiale përfshirë këtu edhe litarin në fjalë, janë përdorur nga forcat paramilitare dhe militare serbe

¹⁶ Raporte pune nga terreni, gjatë hulumtimeve kërkimore në mbledhjen e dëshmimeve materiale të luftës ndërmjet viteve 2000-2015, Sektori i Historisë, Muzeu i Kosovës, Prishtinë.

për të bërë dhunë dhe vrasje kundër popullatës civile shqiptare, duke mos i kursyer as kategoritë me të ndjeshme që ishin fëmijët, gratë, pleqtë dhe të hendikepuarit. Sa i përket litarit, në të cilin shihen qartë gjurmët e krimit është përdorur posaçërisht për ngulfatjen e civilëve në shkallë vdekjeje. Pra, barbaritë serbe nuk lanë asnjë metodë apo mjete të ndryshme që nuk e përdorën për t'i dhunuar dhe vrarë shqiptarët në format më shtazarake. Përzgjedhja e vrasjeve nëpërmes litarëve, telave me gjemba dhe me gjësende të tjera ishin të menduara mirë nga kriminelët serbë. Këtë e bënin me pretendimet se shqiptarët gjatë procesit të vrasjeve duhej të vuanin sa më shumë, t'i frikësonin për ta braktisur atdheun e tyre dhe që Kosova të popullohej me popullsi serbe. Ekspoziti në fjalë iu dhurua Muzeut të Kosovës, si dëshmi historike me datën 09 dhjetor 1999.¹⁷



Fig.8. Litar i përgjakur i gjetur në fshatin Duhël të Shtimes

Shiringë: Sipas burimeve të marra nga Zona Operative e Pashtrikut, drejtoria për informim, nën udhëheqjen e eprorit të UÇK-së Halil Çadraku, shiringa është gjetur në fshatin Duhël të Shtimes me datën 10 korrik 1999. Sipas tij shiringat janë përdorur nga njësitë paramilitare dhe militare serbe për drogimin e tyre në mënyrë që veprimet e tyre të ishin sa me të shfrenuara dhe më të rënda në ekzekutimin e krimeve të kryera ndaj civilëve shqiptarë. Këtë formë e aplikonin kryesisht njësitë paramilitare serbe që shteti serb në mënyrë të organizuar i kishte mbledhur dhe mobilizuar kriminelët nga burgjet serbe, kriminelë me

¹⁷ Deklaratë me gojë e Halil Çadraku, ish- epror i UÇK-së, të dhënat i dha me datë 02.05.2000, Prizren.

përvojë nga luftërat e zhvilluara në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, si dhe kriminelë të ardhur nga bota e krimit në Serbi dhe jashtë saj. Me fjalë të tjera, të gjitha këto grupe kriminelësh duke përdorur drogë dhe lëndë të tjera narkotike, përpiqeshin ta mënjanonin ndjenjën e dhimbjes shpirtërore dhe nën ndikimin e saj të dhunonin, vrisnin dhe masakronin popullatën shqiptare të Kosovës.¹⁸




Fig.9. Shiringë, i gjetur në fshatin Duhël të Shtimes

Sofër buke e traditës shqiptare: e dëmtuar dhe e përdhosur me mbishkrime nacionaliste serbe dhe ruse, e gjetur në shtëpinë e familjes së Avdurrahman Kelmendit në fshatin Bellacerkë (Fortesë) të Rahovecit. Sipas rrëfimit të tij, më 24 prill 1999, forcat serbe dhe paramilitare ruse të ardhur vullnetarisht dhe si mercenarë nga Rusia, janë stacionuar në shtëpinë e tij prej nga kanë vrarë dhe masakruar dhjetëra civilë shqiptarë të këtij fshati. Dëshmitë e shumta dhe materiale të disponueshme vërtetojnë fakte të rënda kriminale, përfshirë këtu edhe sofrën e bukës me shenja cirilike serbe dhe ruse.

Siç dëshmon Avdurrahman Kelmendi, sofrja e bukës fillimisht ishte përdorur për qëllime normale të ngrënies. Pasi kishin konsumuar alkool, sofrja u keqpërdor për tallje, duke shfaqur mospërfillje për trashëgiminë etno-kulturore të shqiptarëve. Ata kanë shkruar simbole nacionaliste, grafika të figurave femërore të zhveshura dhe në fund, bënë veprime të turpshme, duke kryer edhe nevoja fiziologjike mbi të. Veprime të tilla ndaj kulturës dhe trashëgimisë historike shqiptare ka pasur nëpër të gjitha komunat e Kosovës, gjë që dëshmon edhe për krimet kulturore apo siç njihet në terminologjinë ndërkombëtare kulturocid.

¹⁸ Po aty.

Është me rëndësi të potencohet fakti se sofrat e bukës me tërë pamjen e saj karakteristike që pasqyrojnë barbarizmin serb dhe rus, në korrik të vitit 1999, pas hyrjes së NATO-s në Kosovë është përdorur si dëshmi kundër vendosjes së ruseve në Rahovec, krahas shume krimeve të tjera të bëra në këtë rajon. Ndërkaq më 13 janar 2001, sofrat e bukës i është dhuruar Muzeut të Kosovës, si dëshmi historike materiale për t'i dëshmuar krimet kulturore në Kosovë.¹⁹




Fig.10. Sofër buke e traditës shqiptare e përdhosur dhe e dëmtuar me mbishkrime nacionaliste serbe, e gjetur në fshatin Bellacerkë (Fortesë) të Rahovecit

Plisi i bardhë i përgjakur me mbishkrime nacionaliste serbe (shkrimi i katër “S-ve”), i Shefki Halil Dedincës nga fshati Lajthishtë (Leshkoshiq), i gjetur në banesën e tij në Bresje të Fushë Kosovës. Sipas rrëfimeve të Naim Buelnicas, Shefkiu ishte zhdukur gjatë luftës në Kosovë nga forcat paramilitare serbe me datë 7 mars 1999, i cili ende nuk është gjetur. Raste të tilla ku janë vrarë civilët shqiptarë me plisin e bardhë në kokë ishin të shumta, kjo për faktin se forcave serbe u pengonte çdo simbol kulturor e kombëtar që lidhej me shqiptarët, ndaj edhe në rastin e plisit të bardhë të Shefki Dedincës, janë shkruar katër S-të, për të treguar ambicien e tyre shoviniste për Serbi të madhe. Pas

¹⁹ Deklaratë me gojë e Avdurrahman Kelmendit, vëllai i dëshmorit të UÇK-së Agim Kelmendi, të dhënat i dha me datë 02.05.2000, Bellacerkë (Fortesë), Rahovec.

përfundimit të luftës, këtë relik të ka sjellë në muze Naim Buelnica, i cili ka shërbyer si dëshmi materiale për t'i prezantuar krimet serbe.²⁰



Fig.11. Plisi i bardhë i përgjakur me mbishkrime nacionaliste serbe (shkrimi i katër "S-ve"), i gjetur në Fushë Kosovë

Dhjetëra gëzhoja të predhave të kalibrave të ndryshëm të përdorura nga forcat ushtarake dhe policore serbe kundër popullsisë civile shqiptare në Kosovë, të gjetura si rezultat i hulumtimeve kërkimore të bërë nga bashkëpunëtorët shkencorë dhe profesionalë të sektorit të historisë në Muzeun e Kosovës gjatë viteve 2000-2015. Sipas të dhënave okulare të marra nga komuniteti shqiptar që jetonte pranë këtyre lokaliteteve, rrëfyon për ngjarjet që kishin ndodhur gjatë luftës nëpër vendbanimet e tyre. Ata, përveç të tjerash na treguan se për çfarë dhe nga kush ishin përdorur gëzhojat e ndryshme të artilerisë serbe. Sipas tyre, në secilën bazë ushtarake ku operonte ushtria serbe në Kosovë, ishte përdorur artileria rëndë në mënyrë që t'i bombardonin nga larg vendbanimet ku ishin mbledhur dhe strehuar popullata civile shqiptare; nëpër fusha, male, gryka, fshatra e deri nëpër qytete. Si pasojë e këtyre predhave u vranë dhe u gjymtuan mijëra civilë shqiptarë anekënd Kosovës. Numri i vrasjeve nga artileria serbe vinte kryesisht nga madhësia e predhave dhe volumi i tyre në gjuajtje. Gëzhojat e predhave të lartcekura të të gjitha kalibrave që nga ato me të voglat e deri te me të mëdhatë janë dëshmitë faktike që i pasqyrojnë krimet serbe në Kosovë në shkallë gjenocidi. Gëzhojat e predhave të ndryshme, tashmë të shndërruara në eksponate muzeore, në kuadër të Muzeut Kombëtar të

²⁰ Deklaratë me gojë e Naim Buelnica, familjar, të dhënat i dha me datë 10.03.2002, Fushë Kosovë.

Kosovës, janë pjesë integrale e koleksioneve të luftës 1998-1999, të cilat shërbejnë si fakte historike për t'i argumentuar krimet e forcave serbe ndaj civilëve shqiptarë.²¹



Fig.12. Dhjetëra gëzhoja të predhave të kalibrave të ndryshëm të përdorura nga forcat artilerive ushtarake dhe policore serbe kundër popullsisë civile shqiptare të gjetura në të gjitha komunat e Kosovës ku kishte luftë 1998-1999

Në kuadër të krimeve serbe kundër shqiptarëve të Kosovës, një segment mjaft i ndjeshëm që ndodhi në Kosovë gjatë luftës 1998-1999 ishte edhe dhunimi i femrës shqiptare. Sipas të drejtës ndërkombëtare dhe Statutit të Tribunalit të Hagës, dhunimet janë vepra penale që radhiten si krime kundër njerëzimit. Ndaj pushteti terrorist i Serbisë në krye me kriminelin Milosheviç nuk qe kursyer edhe rreth dhunimeve masive të femrës shqiptare në Kosovë. Këto forma të veprimeve të kriminelëve serbë kishin për qëllim diskreditimin politik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të shqiptarëve në përgjithësi e të femrës në veçanti.²² Në bazë të informacioneve nga terreni të marra prej dëshmitarëve dhe viktimave të ndryshme, rezulton të jenë më shumë se njëzetmijë (20.000), numri i femrave shqiptare të dhunuara gjatë luftës

²¹ Raporte pune nga terreni, gjatë hulumtimeve kërkimore në mbledhjen e dëshmimeve materiale të luftës ndërmjet viteve 2000-2015, Sektori i Historisë, Muzeu i Kosovës, Prishtinë.

²² Luljeta Selimi, "Rrëfime tronditëse (femra të dhunuara gjatë luftës në Kosovë)", Prishtinë, 2003, fq. 90, 91.

së fundit në Kosovë.²³Për këtë dimension të krimeve, posedojmë disa fotografi, dhe tri palë rroba të brendshme të femrave të dhunuara të gjetura në fshatin Duhël ndërmjet komunës së Shtimes dhe Suharekës.²⁴

Rroba të brendshme të femrave shqiptare të dhunuara seksualisht:

Sipas burimeve të marra nga Zona Operative e Pashtrikut, drejtoria për informim, rrobat e brendshme të femrave shqiptare të dhunuara seksualisht janë gjetur në fshatin Duhël të Shtimes që kufizohet me komunën e Suharekës me datë 10 korrik 1999. Sipas të dhënave, rrobat e brendshme të femrave janë dëshmi autentike që dëshmojnë se gjatë luftës në Kosovë, ushtria dhe policia serbe kanë dhunuar seksualisht femrat civile shqiptare. Me qëllim të zbardhjes dhe argumentimit të krimeve seksuale të kryera nga kriminelët serbë, si dëshmi materiale muzeore, për Muzeun e Kosovës i ka dhënë Halil Çadraku, ish-epror i lartë i UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut, me datë 9 shkurt 1999.²⁵



Fig.13. Rrobat e brendshme të femrave shqiptare të dhunuara seksualisht nga forcat ushtarake dhe policore serbe 1998-1999

²³ Gazeta “Koha Ditore”, më 01 qershor 1999, Prishtinë, fq. 4.

²⁴ Koleksioni muzeor i dëshmimeve për krime lufte në Muzeun Kombëtar të Kosovës, Prishtinë.

²⁵ Deklaratë me gojë e Halil Çadraku, ish eprorë i UÇK-së, të dhënat i dha më datën 02.05.2000, Prizren.

Përfundime

Materia e zhvilluar si me lart, na sjell te përfundimet se punimi është një përpjekje serioze për ta pasqyruar drejt luftën e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi. Në mënyrë që të realizohej kjo kauzë u kërkuar që të sakrifikohen shumë qytetarë të Kosovës ndër vite, duke i vënë në fokus krimet e bëra në shkallë gjenocidi të shkaktuara nga forcat okupatore kriminale serbe, siç ishin; shkatërrimet, djegiet, vrasjet, dëbimet, dhunimet e duke shkuar deri në ekstremitet ku u vranë dhe u masakruan edhe kategoritë me të ndjeshme të popullit tonë si, fëmijët, gratë, pleqtë dhe të hendikepuarit.

Gjithashtu, në vijim po e paraqesim një përmbledhje të përgjithshme të vrasjeve, masakrave, dhunimeve, dëbimeve, të zhdukurve dhe shkatërrimeve, të cilat janë të renditura si më poshtë:

-Numri i shqiptarëve civilë të vranë nga forcat serbe në Kosovë janë: **9. 525**

-Numri i dëshmorëve nën organizimin e luftës së UÇK-së janë: **2. 800**

-Numri i shqiptarëve të zhdukur gjatë luftës dhe të pagjetur deri më sot, është rreth **1. 600**

-Pra numri i përgjithshëm i shqiptarëve të vranë gjatë luftës në Kosovë, arrijnë shifrën rreth **14.000**

-Më shumë se **800.000** shqiptarë të Kosovës u dëbuan me dhunë nga atdheu i tyre.

-Numri i komunave, fshatrave, shtëpive të dëmtuara dhe të djegura nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, janë: **29** komuna, **100** fshatra, **99. 362** shtëpi.

-Numri i objekteve të arsimit, kulturës, shëndetësisë dhe shërbimeve publike të dëmtuara janë:

objektet e arsimit dhe edukimit **534**, Numri i objekteve të shëndetësisë **240**, numri i objekteve të

kulturës (trashëgimisë) **869**, numri i objekteve të shërbimeve publike **407**.

Ndaj falë rezistencës së popullit shqiptar të Kosovës ndër vite, luftës së UÇK-së dhe intervenimit të NATO-s të udhëhequra nga ShBA-ja, bënë të mundur që krimet dhe masakrat më shumë se 100 -vjeçare serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, të ndërpriten dhe Kosova të ecë në rrjedhën e vet historike.

Burimet dhe Literatura:

- [1] Arkivi i Muzeut Kombëtar të Kosovës, Prishtinë
- [2] Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Historisë, “*Historia e Popullit Shqiptar II*”, Botimet Toena, Tiranë, 2002
- [3] Ph.D. Besnik Rraci & Dr. Sadik Krasniqi, “*Veprimtaria Atdhetare e heroit Sali Çekaj*”, Botues, Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë, 2022
- [4] Nysret Pllana, “*Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët 1844-1999*”, Prishtinë, 2001
- [5] Mikel Ndreca, “*87 VJET, terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*”, Prishtinë, 2001
- [6] Mr. Sadik V. Krasniqi, “*Lufta për Çlirimin e Kosovës (1997-1999)*”, Prishtinë, 2009
- [7] Luljeta Selimi, “*Rrëfime tronditëse (femra të dhunuara gjatë luftës në Kosovë)*”, Prishtinë, 2003
- [8] Mr. Tefik Morina “*Mozaik Historik*”, Prishtinë, 2011
- [9] Katalogu i ekspozitës tematike me titull: “*Drama kosovare*”, e hapur zyrtarisht më 12 qershor, 2000, në hapësirat e Muzeut të Kosovës në Prishtinë.
- [10] Gazeta “*Koha Ditore*”, qershor, 1999, Prishtinë
- [11] Koleksioni muzeor i dëshmimeve për krime lufte në MKK
- [12] Raporte pune nga terreni, gjatë hulumtimeve kërkimore në mbledhjen e dëshmimeve materiale të luftës ndërmjet viteve 2000-2015, Sektori i Historisë, Muzeu i Kosovës, Prishtinë.
- [13] Raport pune, “*Lista me dëshmitë materiale të luftës 1998/99*”, Sektori i Historisë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë.
- [14] Deklaratë me gojë e Enver Rexha, Prizren.
- [15] Deklaratë me gojë e Xhemshit Krasniqi, Prizren
- [16] Deklaratë me gojë e Sadik Hasani, Celinë-Rahovec.
- [17] Deklaratë me gojë e Halit Sahitaj, Çifllak-Rahovec
- [18] Deklaratë me gojë e Behxhet Vitia, Marec-Prishtinë
- [19] Deklaratë me gojë e Avdurrahman Kelmendit, Bellacerkë (Fortesë), Rahovec
- [20] Deklaratë me gojë e Halil Çadrakut, Prizren
- [21] Deklaratë me gojë e Naim Buelnica, Fushë Kosovë

SHTOJCË

DËSHMI TË TË MBIJETUARVE NGA MASAKRAT E POLICISË, USHTRISË DHE NJËSIVE PARAMILITARE SERBE GJATË LUFTËS NË KOSOVË

NA E DOGJËN SHTËPINË DHE NA DËBUAN ME DHUNË!



Afrim Islami, i mbijetuar

Afrim Islami nga fshati Dumnicë i Komunës së Podujevës, i lindur më 13 maj 1965.

Gjatë muajit prill të vitit 1999, po qëndronim me bashkëshorten Mihrije Islami, me tre djemtë-Avdylin, Labinotin dhe Dritëmirin, si dhe me prindërit e sëmurë, babain Abaz Islami 75 vjeç, nënën Rabe Islami 75 vjeçe dhe motrën Shukrie Islami 50 vjeçe, e paralizuar, qëndronin në shtëpinë e tyre në Dumnicë.

Më 19 mars, pasi na e dogjën shtëpinë, na dëbuan me dhunë nga shtëpia dhe u nisëm në drejtim të Podujevës. Pos shtëpisë që na e dogjën, na plaçkitën edhe shumë gjëra të tjera me vlerë: kamionin e Tipit Mercedes 8/13, dhe tri vetura Golf, pronë e Autoshkollës Abis, veturën personale Opel Vektra, të cilën sot e përdor polici serb i quajtur Doshoviç në Kurshumli. Atje u vendosëm te një i afërm yni.

Në Podujevë kemi qëndruar 4 ditë e prej aty edhe 6 ditë të tjera në fshatin Ballofc, në Shajkovc e në Dyz, prej ku, të ndjekur nga policia, ushtria e paramilitarët serbë, u vendosëm në Koliq nën një tendë najloni. Me mua ishin dy prindërit e mi të sëmurë dhe tezja 90 -vjeçare, e sëmurë. Në Koliq nuk kishim ushqim as ilaçe dhe për pasojë druhesha se të sëmurët do të vdisnin. Duke parë gjendjen e tyre, u detyrova të nisem për Prishtinë, me shpresë se atje mund të gjej diku barëra për ta.

Më 15 prill, isha nisur së bashku me familjen time të ngushtë në drejtim të Prishtinës. Tek i ashtuquajturi Bunari i Hajratit, në hyrje të Prishtinës, papritmas më ndalojnë forcat serbe, më detyrojnë të zbres nga vetura dhe fillimisht m'i grabisin 1800 marka gjermane që i kisha me veti e pastaj më godasin mizorisht, më rrahin deri në alivanosje.

Nga të rrahurat e kisha humbur vetëdijen dhe diku rreth dy orë më vonë më erdhi vetëdija dhe pashë se dikush po më nxirrte nga një ambient krejtësisht i errësuar që nuk e dija as vetë ku isha e as çka po ndodhte. Ndërkohë e kuptova se po më nxirrnin nga një furrë e bukës, ku më kishin futur për të më pjekur, për së gjalli. Për fatin tim të mirë nuk kishte pasur energji elektrike, që ishte ndërprerë nga sulmet e NATO-s. Nga maltretimi i rëndë që më kishin bërë paramilitarët në prani të anëtarëve të familjes sime të ngushtë, për pasojë më kishin thyer disa brinjë të trupit dhe më kishin thyer edhe hundën. Në mesin e paramilitarëve që më maltretuan, njëri ishte që si duket më kishte njohur sepse më thërriste në emër. Dhe, pas rreth dy orësh të qëndrimit tim pa vetëdije brenda në furrë dhe pasi kishin parë se nuk kishte pasur energji elektrike, njëri prej tyre hap furrën dhe më nxjerr duke më hedhur në tokë. Ai më kërcënon që menjëherë të largohesha nga Prishtina.

Futem në veturë për t'u larguar nga Prishtina, por këmbët nuk mund t'i lëvizja. Mëzi kam arritur duke i tërhequr me duar t'i fus këmbët në veturë dhe të nisem. Në rrugën e atëhershme "Dubrovniku" i kisha lënë gjysmën e familjes në zyrën e punës të Autoskollës "Abis" që kisha në pronësi, shkova disa dhe kur më panë në çfarë gjendje më kishin prurë, si të çmendur ia krisin vajit të gjithë, gruaja dhe fëmijët. U them të heshtnin, kalojmë nëpër disa rrugica dhe nisem për të marrë prindërit, motrën dhe tezen që i kisha lënë të më prisnin.

U vendosëm në "Lagjen e Muhaxherëve" te një miku im, i cili nuk më njohu, sepse nga rrahjet dhe torturat më kishin shpërfytyruar të tërin. Aty kemi qëndruar deri në hyrjen e NATO-s në Prishtinë, nën panik, frikë e terror të vazhdueshëm dhe të traumatizuar. Dy muaj nuk kam mundur të shtrij trupin nga pasojat e maltretimit fizik, nga brinjët e thyera dhe hunda e thyer. Kam qëndruar vetëm ulur. Derisa kemi qenë në Kodër të Trimave, një mjeke e re me mbiemrin Mekuli, më vonë kam mësuar se duhet të ketë qenë bija e Doktorshës së njohur Sadete Mekuli, vazhdimisht është kujdesur për ne, na ka kuruar me injeksione e ilaçe të tjera jo vetëm mua, por edhe prindërit, motrën dhe tezen.

Intervistoi: Ramë Manaj

NA I MORËN PARATË DHE DOKUMENTET, PASTAJ NA
PUSHKATUAN. SHPËTOVA SEPSE PLUMBI E GODITI NË
KOKË NJË DJALË TË RI DHE AI RA MBI MUA



Bajram Ramadan Zulfu i mbijetuar i Masakrës në Krushë të Vogël.

I lindur më 27 maj 1954, në Krushë të Vogël.

Më 24 mars 1999, ditë kur forcat e NATO-s filluan bombardimet e pozicioneve të forcave serbe. Ishte një ditë gëzimi për ne, por edhe një dozë frike për ndonjë të keqe që do të na gjejë, pasi në fshat kishim 29 shtëpi serbe.

Më 25 mars 1999 jemi larguar nga shtëpitë, kemi shkuar në mal me familje dhe kemi qëndruar deri kah ora 5 pasdite. Pastaj jemi kthye nëpër shtëpia. Gratë kanë filluar të përgatitin ushqim për ditën e nesërme, sepse prapë duhet të ikim. Unë e lashë familjen në fshat dhe me nja 16-17 persona meshkujt të fshatit jemi kthye në mal dhe kemi qëndruar tërë natën. Në ora 4 të mëngjesit kemi dëgjuar zhurmën e tankeve, automjeteve të blinduara dhe të tjera. Një vëlla imi m'i kishte lënë fëmijët e tij dhe kishte shkuar në Gjermani. Mendoja që menjëherë nga mali të shkoj te familja ime dhe e vëllait që ishin në fshat, sepse edhe e kisha edhe obligim moral ndaj vëllait për amanetin që ma kishte lënë. Ashtu veprova. U ktheva në shtëpi. Aty ishin edhe disa pleq kushërinj dhe një fqinjë tjetër. Kur erdha i them Hysenit, djalit të axhës, Cenë, tërë rruga Prizren – Gjakovë është e mbushur me autoblanda, tanke e mjete të tjera, në çdo 10 metra.

Në atë moment, një turmë e madhe e njerëzve po vijnë nga Mahalla e Shehëve. Kanë hyrë këtu nëpër shtëpia. Shumë prej nesh shkuam në shtëpinë e Sejdi Batushës. Aty u vendosën gra, fëmijë, pleq e plaka, invalidë, madje edhe një grua lehonë që kishte lindur para dy

ditësh. Ajo s'mund të qëndronte, ishte e sëmurë dhe shpesh e humbet vetëdijen. Nga lart vinin dy vëllezërit Ramadan dhe Hysen Ramadani. Në atë moment Hysenin e qëlluan me snajper dhe e vranë. Gratë dhe fëmijët filluan të qajnë. Menjëherë erdhi policia serbe dhe iu tha grave e fëmijëve: ja shkoni në Shqipëri ose mbytuni në Dri! Neve meshkujve nga qiten prej oborrit në rrugë. Gratë dhe fëmijët shkoni duke qarë. Pasi shkuan gratë dhe fëmijët, policët na thanë: qitni çdo gjë që keni nëpër xhepa, para, dokumente etj. dhe na thanë nëse dikush nuk i qetë e ia gjejmë do ta pushkatojmë menjëherë. I nxorëm krejt çka patëm dhe i qitëm në një çantë të Adem Asllanit që i mbante dokumentet e pensioneve të Gjermanisë. Atij i thoshin me këtë çantë ke mbledhur para për UÇK-në. E shanin UÇK-në, e shanin NATO-n, e shanin Clintonin. S'kanë lënë gjë pa sha. Na i qitëm krejt çka patëm.

Pastaj na urdhëruan që të rreshtohemi nga tre, me duar të lidhura prapa dhe na kanë nisur. Nuk dinim se ku po na dërgojnë. Vëllai i Sejdi Batushës, Qazim Batusha e ka pasur një shtëpi me dy dhoma e një korridor, të ndërtuar me blloka të bardhë. Aty brenda kishte pasur edhe 3-4 duaj sanë dhe na futën aty brenda. Na shpërndanë në dhoma. Korridori ka qenë më i mbushur. Një invalid me karrocë e lanë te dera si pengesë që mos me ik lehtë. Ka ardhur një polic me një mitraloz të madh, me një sanduk të ngjitur në të, me më tepër se 120 fishekë. Filloi të shtinte. Invalidin e këputi në midis. Kështu filluan të vrasin në mënyrën më mizore. Një djalë i ri që ishte para meje, i shëndosh e i madh e i rëndë, e rroku në kokë dhe ai u rrëzua mbi mua, u rrëzuan edhe të tjerët. Unë u zura nën kufoma. Gjaku ishte i madh, sa që nuk mundja të merrja as frymë, sa që e shtyra pak një kufomë. Pas kësaj policët kanë ardhur dhe kanë shtënë me revole e automatik në ata që lëviznin dhe bërtitnin. Pas kësaj kufomat i kanë stërpikur me një lëngë djegës që ta merrte mendja edhe betonin e digjte. Policët pastaj shkuan.

Një person që kishte mbetur gjallë, ngriti kokën dhe tha kush ka mbetur gjallë të çohet, sepse policia shkoi. U ngrita, çka me pa bërtimë të mëdha, shumë të vranë, të plagosur e shumë prej tyre edhe duke u djegur. Edhe unë kisha filluar të digjem. I kisha veshur dy "vetrovka" dhe isha përgatitur të qëndroj në mal. Dola jashtë dhe i desha. Menjëherë filluam të ikim në disa drejtime, disa nëpër përrue e disa kanë hyrë nëpër shtëpia. Na kanë parë policia që kishin filluar të largohen nga vendi i masakrës dhe kanë bërtitur "Çekajte, çekajte" (pritni, pritni).

Unë me dy veta u nisëm në drejtim të Krushës së Madhe. Dy u fshehëm nën një urë e njëri hyri në mal. Nga gjuajtën me një lloj

minahedhësi, që ra afër nesh. U shtriva për tokë. Shoku im që ishte afër më tha: “Ik Bajram përpjetë se marove”. Unë jam ngjitur përpjetë, e ata kanë shkuar kah Krusha e Madhe. Unë mbeta dhe u strehova në mal, afër një përroske me qëllim që të rri aty deri kur të terrohet. Pas u terrua filloi të binte shi, unë depërtova më tutje në mal dhe kërkoja vend më të përshtatshëm për strehim. Mendoja të shkoja në fshatin Reti, ku ishte Shtabi i UÇK-së, por ishte e pamundur, sepse rrugët ishin të bllokuara si ajo Randobravë – Krushë e Madhe dhe kontrolloheshin nga policët dhe ushtarët serbë. U detyrova që të kthehem. Ia gdhiu mëngjesi. Ishte ora 4. Nuk dija se ku të fshihem. E gjeta një zgavër te Përroi i Madh, ka vreshtat dhe u futa aty. Qëndrova 3 net e 4 ditë pa hëngër e pa pi. Edhe pse ujin e kisha 5 metra larg nuk guxoja të dilja, sepse vëzhgohej nga të gjitha anët dhe çdo lëvizje vërehej. Ditën e tretë erdhi shoku im që ishim ndarë më parë Lutfi Ramadani, më pas se isha tërë i kuq me gjak. Më pyeti se a jam i plagosur. I thash jo! Më tha rri këtu se mali është me plotë policë dhe dikush të shpëton. Ai shkoi teposhtë përroit, e unë mbeta aty. Ditën tjetër ka ardhur prapë Luftiu, dhe më tha rri aty se edhe unë po vij. Ditën e katërt kam filluar të humb vetëdijen. Dhëmbët me kërshitnin. Kur erdhi Luftiu më kapi dhe më afroi dhe shtrëngoi për trupin e tij. Fillova ta ndjej vetën më mirë. Më tha” eja të dalim prej këtuhit të shkojmë lart se vjen edhe Ganiu dhe Safeti”. Ishte mali i tij.

Në atë kohë nga shtëpia ku ishte bërë masakra, kanë shtie 6 herë me snajper kah ne. Plumbat shkëputën degët e drunjve të afërt. Kam ikur dhe jam futur prapë në përrua. Aty kam pirë ujë pas një kohe të gjatë. I kam shkëputur disa lule që kishin dalë në atë kohë që quheshin “angliça” dhe i kam hëngër. Erdha pak në veti. Kur është terruar kam shkuar te Luftiu dhe Ramadani. Aty pamë një kufomë. Dikur erdhi Ganiu dhe Safeti. Vendosëm që të kalojmë rrugën e asfaltuar Prizren-Gjakovë, lumin Dri dhe të dalim në Has. Por kishte shumë policë dhe autoblanda dhe u detyruam të kthehemi. Një natë kemi bujtur në fabrikën e betonit *Unimont*. Kemi shkuar prapë në mal dhe kemi qëndruar edhe 7 ditë. Pastaj kemi kaluar Drinin dhe jemi vendosur në një shtëpi në fshatin Bregdri. Aty takova Franin që kishte qenë me gra dhe fëmijë, shkonte në Zym. U ndal dhe i tregova se jam Bajrami dhe po i tregoj se forcat serbe kanë vrarë e masakruar dhe nuk dimë gjë çka ka ndodhur me gra e fëmijë. Aty kishte qenë një vajzë nga fshati ynë dhe tha, shume familje nga fshati juaj kanë qëndruar këtu 4 ditë dhe kanë dalë në Shqipëri. U relaksova shumë kur mora vesh se ishin gjallë. Në mbrëmje pasi e pamë se gjendja u qetësua, ndezëm një zjarr, vokëm një kazan me ujë dhe u pastruam. Fjetëm atë natë dhe në mëngjes herët

dilnim në mal dhe u vendosëm në një kolibe. Ditën e nesërme binte shi i madh. Ne ikëm nga ajo shtëpi dhe shkua në mal. Pas 15 minutave ka ardhur policia dhe ka hyrë në atë shtëpi. Ka gjetur rrobat tona me gjak. Natën tjetër shkua në një shtëpi tjetër. Kështu kaluam jetën më se 5 javë. Më pastaj jemi nisur për në Shqipëri. Kemi kaluar malin Pashtrik dhe kemi arritur afër fshatit Vlanë. Nga Vlana na dërguan në Krumë, në polici për të dhënë dëshmi. Mua më pyetën të parin dhe të gjitha të dhënat i dhashë, të tjerët hynin por dilnin menjëherë, sepse atë çka e kërkonin ata unë ua kisha dhënë. Na dhanë një karton në formë të letërnjoftimit dhe shkua në mbrëmje në Kukës. Çka me pa, na u duk se këtu është tërë Kosova.

Duhet të theksoj se nga 109 persona të ndarë për pushkatim dhe që e kanë përjetuar masakrën, kam shpëtuar unë, Lufti Ramadani, Qamil Shehu, Agim Asllani, Mehmet Krasniqi dhe Petrit Rashkaj. Në atë shtëpi kanë mbetur të vrarë 103 persona. Disa të tjerë janë pushkatuar në fund të fshatit. Nga fshati ynë kanë pësuar 103 persona.

Janë më se 52 serbë nga fshati ynë që i kemi regjistruar e që kanë bërë krime. Nga ata vetëm një është dënuar me 22 vjet burg, pastaj i është zbritur në 11 burg.

Intervistoi: Jusuf Osmani

PARA PAVIJONIT B, E KAM PARË TË SHTRIRË NJË TË
PLAGOSUR DHE KAM SHKUAR PËR T'I DHËNË NDIHMËN E
PARË DHE NË MOMENTIN QË E KAM FUTUR DORËN PAS
KOKËS SË TIJ, MË KA MBETUR TRURI I TIJ NË DORË



Bislim Zogaj – i mbijetuar i Masakrës në Burgun e Dubravës

Bislim Zogaj ka lindur më 27.04.1965, në fshatin e Ri të komunës së Malishevës.

Masakrën e Dubravës e përshkruaj që nga fillimi, do të thotë që kur kemi qenë në Mitrovicën e Sremit, atëherë kur disa të burgosur që ishim me dënime më të larta na kishin larguar nga Kosova për në Serbi. Kur kanë filluar bombardimet, pas - të themi 3 javësh që kemi qenë në Mitrovicën e Sremit - na kanë grumbulluar, ku në mesin tonë ishte edhe profesori Ukshin Hoti e që deri në atë kohë kishte qenë në repartin, ose me të burgosurit ordinerë. Më 26 prill, na kanë kthyer nga burgu i Mitrovicës për në burgun e Nishit, ku na kanë pritur një kordon i gardianëve. Ne duhej të futeshim në mes të gardianëve, të cilët na torturorin me shkopinj gomash, shqelma dhe boksa. Në burg të Nishit, 43 persona të cilët na kishin kthyer nga burgu i Mitrovicës së Sremit, kemi qëndruar 3 ditë. Gjatë tërë atyre tri ditëve, ne jemi torturuar, herë paradite e herë pasdite.

Më 29 prill na kanë transferuar me tre autobusë nga burgu i Nishit për në Dubravë, pasi edhe në pavijonet e tjera kishte pasur të burgosur të tjerë shqiptarë.

Kur kemi shkuar, përtej Orllatit, autobusi ynë ka kaluar dhe një pizgauer ka qenë në mes të autobusit të dytë dhe të tretë. Autobusi ynë ka kaluar, NATO-ja ka granatuar atë “pizgauer”, ku për fat vetëm

Pizgauerin, dhe ata dy autobusë kanë ndaluar. Ata dy autobusë i kanë kthyer për në Lipjan, ndërsa neve na kanë dërguar në burgun e Dubravës. Të burgosurit e tjerë, të cilët ishin në autobusin e dytë dhe të tretë, kanë qëndruar një natë në burgun e Lipjanit, ndërsa të nesërmen i kanë sjellë edhe ata në burgun e Dubravës.

Deri më 16 maj nuk ka pasur diçka të veçantë, deri në momentin kur është liruar profesor Ukshin Hoti. Ditën e diel i kanë thënë Ukshinit që po e lirojnë sot dhe për ne ka qenë çudi që po e lirojnë pikërisht të dielën, madje kemi menduar mos ka ardhur Kryqi i Kuq.

Me datë 19 maj kur kanë filluar granatimet e NATO-s. Ka pasur hipoteza të shumta se mos kanë qenë avionët serbë, por ne që ishim brenda si të burgosur nuk dinim gjë, kemi supozuar që janë granatime të NATO-s. Është granatuar pavijoni C, ku kanë mbetur të vrarë 3 persona dhe 3 të tjerë të plagosur, e ku 2 prej të plagosurve kanë qenë pa vetëdije. Posa kanë ardhur të burgosurit ordinerë dhe na kanë hapur derën neve që ishim në pavijonin B, e kam parë grumbullin e të plagosurve dhe kam vrapuar për t'u dalë në ndihmë pasi me profesion kam qenë teknik medicinal. I kam parë dy persona të lënduar e pavetëdije me nga një qebe, të cilët i kanë vënë jashtë korridorit. Kam qenë njëri prej katër personave që i kemi marrë e i kemi dërguar deri te dalja e burgut ku kishte qenë makina e ndihmës së parë, të cilët i kanë dërguar në spital të Prishtinës e që fatbardhësisht kanë shpëtuar të dy. Megjithatë, gjatë këtij granatimi 3 persona kanë humbur jetën aty, brenda në burg.

Më 21 maj, sërish ka pasur granatime në mëngjes. Ka qenë një situatë shumë e vështirë sepse janë bombarduar disa pavijone, ku në pjesën e poshtme janë vrarë shumë persona, por edhe në pjesë të tjera të objektit kishte pasur të vrarë. Njëra prej situatave më të vështira të jetës sime është kur i kam parë dy djem të rinj – njërit iu kishte çarë shpina dhe i kishin dalë organet jashtë, tjetrit, i cili ishte djali i axhës së këtij të parit, iu kishte këputur këmba deri te gjuri. Këta dy djem ishin të moshës 20 dhe 21 vjeç. Ka qenë një situatë shumë e rëndë, sepse ata kërkuan ndihmë prej meje duke me thënë – “doktor, ndihmomë mos më le vetë”. Por ishte e pamundur t'i shpëtoje ata për shkak të plagëve shumë të rënda. Pastaj, një të burgosuri tjetër, Zejnullah Elshanit nga komuna e Drenasit, iu këput këmba nën gju dhe ishte e vështirë që të ia ndalje gjakderdhjen. Megjithatë, disi kam arritur që t'ia ndali gjakderdhjen. Gjatë dhënies së ndihmës më ka ndihmuar Nait Hasani, edhe pse ai vetë ishte i plagosur. Më pas e kemi bartur Zejnullah Elshanin në një pjesë tjetër të burgut. Kur kam filluar të ia heqë rrobat

Naitit, e kam parë plagën e tij e cila i kishte prekur edhe shtyllën kurrizore. Ia ndala gjakderdhjen me rroba të trupit të tij, pasi nuk kemi pasur diçka tjetër. Pas disa minutave, ai ka filluar të këndellet.

Me datë 21 maj, kemi fjetur te fusha e sportit, unë dhe disa të burgosur të tjerë, si dhe të plagosurit e që ishin 25 persona që fatmirësisht kishin arritur të mbijetonin. Deri në mëngjesin e datës 21, do të thotë atë natë kemi fjetur në ambient të hapur. Atë ditë nga Kulla e Vrojtimit ka dalë një gardian i cili na tha që duhej të shkonim në një tjetër burg. Të gjithë kemi shkuar për t'i marrë rrobat nëpër dhomat e burgjeve. Për një moment dikush nga të burgosurit na tha: “çohuni, po lëvizim” dhe pas 10-20 sekondash që kemi lëvizur, pra jemi larguar nga ai vend, ka rënë granata. Pas kësaj, jam ngritur në këmbë dhe kam vrapuar deri te një ambulancë stacionare e cila ka qenë brenda burgut.

Pasi kam shkuar në këtë ambulancë, ka ardhur Fadil Xhylani i Bajincës, i cili m'u patë drejtuar: “baci Bislim, jam plagosur në shpinë”. Ia dhashë ndihmën e parë. Fadili ishte vëllai i dëshmorit, Fatonit, i cili ishte vrarë në betejë bashkë me Mujë Krasniqin. Pas Fadilit, kishte arritur që të vinte edhe Arsim Zogiani nga Harilaçi. Edhe ky ishte i plagosur rëndë, një plumb pas kokës dhe një tjetër në krah. Më tha: “Bislim, jam plagosur në kokë”. Tamam kam shkuar për t'ia ndalur gjakderdhjen, në momentin që më tha “Bislim, po më vjen me vjellë”, e kam ditur që ishte e pamundur të shpëtonte. Edhe pse arrita që t'ia ndali gjakderdhjen, ai ndërroi jetë pas 10-15 minutave. Pastaj kanë ardhur edhe disa të tjerë të plagosur, dhe unë bashkë me të tjerët, ua kemi dhënë ndihmën e parë. Pas rreth 20 minutave, kemi vrapuar nga ambulanca stacionare për në Pavijonin C, sepse aty ishte vendi ku të plagosurit e mbetur ishin më afër. Kemi shkuar që t'i marrim të plagosurit edhe pse të shtëna kishte në vazhdimësi. Nuk kemi pasur as kohë e as mundësi që t'i shohim mirë, por kur dëgjonim kah thërrisnin për ndihmë, aty shkonim menjëherë i merrnim dhe i transportonim për te Pavijoni C. Në mëngjesin e ditës 22, afërsisht rreth orës 8:00 - 9:00, përsëri disa nga gardianët kanë hyrë dhe kanë kërkuar që të grumbullohemi, pasi tashmë nuk ka kushte dhe duhej të zhvendoseshim në një burg tjetër, ashtu sikurse më herët. Gjatë kësaj dite gardianët kishin vrarë e plagosur të burgosurit. Unë nuk i kam parë, por kohë pas kohe më vinin të plagosurit dhe më tregonin. Ne kishim dilema nëse duhej të shkonim apo jo, për shkak të përvojës së mëhershme që i kishin grumbulluar dhe vrarë te burgosurit. Nait Hasani na u drejtua dhe na tha se edhe po të qëndronim, do të na vrisnin, kështu që po shkojmë. Në ndërkohë, dikush nga ushtarët na pyeti se kush po dëshironte cigare

duke na shpërndarë ato në drejtim tonin. Dukej sikurse në filma – ajo dëshira e fundit. Pastaj, dikush tjetër na pyeti se kush kishte nevojë për ujë, e që edhe kjo ishte njëra prej dëshirave të fundit, dhe ne prisnim ekzekutimin në çdo moment. Pas gjysmë ore ose edhe më shumë, ka ardhur njëri prej tyre dhe ka pyetur nëse është dikush që di të japë ndihmën e parë, sepse ata, gjatë rrugës së tyre, kishin plagosur të burgosur. Përderisa unë isha në dilemë se mos po dëshironin të dinin se kush ishte doktori aty, në mënyrë që ta vrisnin dhe që kështu të mos kishte asnjë njeri që do të mund të jepte ndihmën e parë. Përkundër këtyre mendimeve, për një moment iu pata thënë: “po, unë jam personi që di me e dhënë ndihmën e parë”, dhe ata iu drejtuan të tjerëve ushtarë serbë “dilni ju të tjerët dhe sillni të plagosurit këtu për t’u dhënë ndihmën e parë”. Ne pastruam vendin nga xhamat e thyer dhe kemi marrë dyshekë ku do të trajtoheshin të plagosurit.

Gjatë asaj kohe, d.m.th gjatë granatimit, kishte pasur të burgosur të cilët ishin fshehur nëpër shakte, ndërsa ushtria serbe, pa shkas ose qëllimshëm, i kishin gjuajtur për t’i vrarë duke i hequr kapakët e shaktave dhe duke u lëshuar granata. Në një shakt kanë qenë 9 të burgosur, ku nga dy granata 3 ishin plagosur rëndë, 3 ishin plagosur lehtë dhe 3 kishin pasur vetëm gërvishtje. Në mesin e këtyre që kishte pasur plagë më të rënda, kishte qenë Xhemil Alimani, i cili i kishte bërë 14 vjet burg nëpër burgjet e Serbisë. Meqë Xhemili kishte shumë gjakderdhje, ata që i kishin shkuar për ta ndihmuar për ta nxjerrë nga shakti, nuk kanë ditur as ku ta kapin, pra në cilën pjesë të trupit, me frikën se mos po e lëndojnë edhe më shumë. Xhemili kishte pësuar gjakderdhje në këmbë dhe ije, por plaga ishte shumë e rëndë në këmbë. Fatmirësisht kam arritur që t’ia ndali gjakderdhjen dhe Xhemili kishte arritur të shpëtonte sikur të ndodhte ndonjë mrekulli.

“Me datë 23 maj, gjatë gjithë ditës, kanë sjellë vazhdimisht të plagosur dhe deri në mbrëmje kemi arritur t’ua japim ndihmën e parë të gjithë atyre që ia kishin arritur të shpëtonin. Në mbrëmje, kanë qenë 109 të plagosur, me lëndime të rënda dhe të palëvizshëm, përjashtim të 200-300 të tjerëve që kishin marrë plagë më të lehta. D.m.th gjatë gjithë ditës dhe natën jemi përkujdesur për të plagosurit, ndërsa të nesërmen në mëngjes kanë ardhur 4 autobusë më duket dhe 3 kamionë për të na transferuar në Lipjan. Në autobus kanë hyrë të plagosurit me plagë më të lehta, ndërsa në kamionë - këta që ishin më rëndë e që u duhej të qëndronin shtrirë. Deri në momentin kur e kemi ngarkuar të plagosurin e fundit, unë kam qenë në sallë të sporteve.

Gjatë kësaj periudhe, ka pasur edhe raste të tjera të tmerrit, siç e kujtoj një rast kur para pavijonit B, e kam parë të shtrirë një të plagosur dhe kam shkuar për t'i dhënë ndihmën e parë dhe në momentin që e kam futur dorën pas kokës së tij, më ka mbetur truri i tij në dorë dhe nuk shkuan minutat, i burgosuri ndërroi jetë. Pastaj ka pasur të plagosur me plagë në të gjitha pjesët e trupit dhe në çdo pozicion që e vendosje kishte dhimbje, por që fatmirësisht gjatë qëndrimit në burg e që na kishte rënë të qëndronim nëpër burgje edhe dy vjet pas çlirimit, kur dëgjonim për shumë persona që ishin gjallë më dukej mrekulli në krahasim me atë se çfarë kishte ndodhur aty.

Mrekulli kishte qenë edhe rasti specifik i Bedri Kukulajt nga Deçani, ku me datë 22 maj kur na kanë grumbulluar dhe ekzekutuar, që plagosur edhe Bedri Kukulaj. Mirëpo, kur kanë shkuar për t'i tërhequr të burgosurit, ne kemi supozuar që nuk ka më asnjë të gjallë dhe jemi organizuar për t'i shkruar emrat e tyre në letra që pastaj t'u vendosnim nëpër rrobat e tyre në mënyrë që të identifikohen që të gjenden më lehtë. Duke ua ngjitur këto letra me emra, është parë që dikush po lëvizte, do të thotë 27 orë pas ekzekutimit, dikush ishte ende i gjallë, por pa vetëdije. Ma kanë sjellë në sallën e sportit dhe kam parë që Bedriu kishte plagë në fytyrë dhe gjakderdhje nga goja. Gjaku në gojë i ishte trashur dhe kur i kam futur gishtat për t'ia pastruar atë, kam vërejtur se si i është liruar frymëmarrja pasi gjaku i trashë i kishte vështirësuar frymëmarrjen dhe në atë moment ka marrë frymë shumë thellë. Nga mbrëmja, Bedriu kishte filluar me u ngjallë, por kishte halucinacione vazhdimisht duke i bërë disa kërkesa të pavetëdijshme, “bjerma do lëngë, do djathë, do specat etj”, por që mrekullisht edhe ky arriti të mbi-jetojë.

Masakra e Dubravës ka zgjatur disa ditë, sepse nganjëherë flitet sikurse ka ndodhur vetëm atë ditë kur kanë hipur në kamionë.

Më kujtohet një rast se si dikush e kishte lënduar dorën dhe unë kisha arritur që t'ia ndalja gjakderdhjen, por që kur kishte shkuar në këtë spital, mjekët ia kishin këputur dorën. Ngjashëm kishin vepruar edhe me shumë të tjerë. Bedriun e kanë torturuar dhe e kanë lidhur për krevati po ashtu. Pas 16 ditëve, kur është nënshkruar Marrëveshja e Kumanovës më 10 qershor 1999, na kanë dërguar nëpër burgjet e Serbisë. Një grup prej 400 personash, ku isha edhe unë, na kanë transferuar për në Nish.

Unë rrëfimin e tregova në vetën e parë, ashtu siç unë i kam parë këto ngjarje. Përndryshe, ndihma e të burgosurve, posaçërisht e të plagosurve, ka qenë një organizim i shumë të tjerëve, e që kanë

kontribuar që pasojat të jenë minimale. Ka qenë edhe një grup i studentëve të Prizrenit, pastaj një personi me emrin Frashër Shabani – student i mjekësisë, Abaz Beqiri – teknik medicinal, e sidomos në natën e fundit në sallën e sporteve ku ka pasur shumë të plagosur dhe që duhej përkuqdesur edhe natën e ku kanë kontribuar shumë të tjerë si: Aqif Ilazi, Hasan Selimi, Isak Shabani, Shefqet Kabashi e shumë të tjerë.

Ne kemi identifikuar me emra dhe mbiemra 117 të vrarë, mirëpo gjasat janë që të ketë më shumë të vrarë, ndërsa të plagosur kanë qenë 187, e që edhe në këtë rast gjasat janë që numri i të plagosurve të ketë qenë më i madh se kaq. Mirëpo, të faktuar do të thotë janë 117 të vrarë dhe 187 të plagosur prej ditës së parë të masakrës së Dubravës. Afërsisht 600 të burgosur kanë mbijetuar.

Intervistoi: Ramë Manaj

NUK NA LANË TA VARROSIM NJOMZËN



Fahrije Morina e mbijetuar e Masakrës së Landovicës

Fahrije Ramush Morina, e lindur në vitin 1957 në fshatin Brestovc të Rahovecit.

Idriz Gashi, banor i fshatit Landovicë më datën 26 mars 1999 ka shkuar nëpër fshat dhe i ka informuar banorët se në fshatin tonë kanë hyrë forcat serbe, andaj duhet pasur kujdes dhe duhet të ikim. Shkuam te shtëpia e Ismetit. Jemi bërë bashkë me familjen e Ismetit, familjet e Çerretëve, familjet e Kurtishëve etj. Kjo ishte shtëpi në dy kate me shumë dhoma, në pjesën kodrinore të fshatit.

Më pastaj kanë ardhur forcat serbe me automjete dhe e kanë rrethuar. Të shtënat filluan nga të gjitha anët. Nuk dinim se nga po na vinin ato të shtëna, por situata ishte e tmerrshme. Në një moment, një granatë goditi vajzën e kunatit, Njomzën 15 vjeçe, e cila ishte në korridor. Në oborr e vranë edhe Afrimin, djalin e Eqremit. Nëna e Njomzës filloi të qante me të madhe. Ibishi i thotë mos qaj se kjo është luftë. Pas goditjes së Njomzës, ajo ra përmbys. Nëna e Ismetit, bërtiti “kuku për ne, se kufoma ra përmbys dhe paskemi me shkue shumë!” Në atë shtëpi ishin strehuar më se 60 persona. Në një pjesë ishin ndarë burrat e në të tjerat gratë dhe fëmijët. Kur u vra Njomëza, personat që ishin strehuar aty filluan të ikin duke dalë nëpër dritare dhe dyer dhe të vrapojnë drejt pyllit. Ne paraprakisht e kemi marrë Njomzën dhe e kemi vendosur në dhomën e Hajdinit. Ia kemi mbuluar fytyrën me një pelenë dhe edhe unë me të tjerë kemi filluar të ikim. Ibishi na tha: “shkoni zhagas së bashku se ndoshta shpëtojmë”. Unë kanë qenë me tre djemtë e vegjël. Me mua ishte Ibishi, gruaja e tij, Fatimja, që e kanë mbytur. Ajo e ka pasur vajzën e vogël në krah, Festinën, që i ka pasur dy vjet. Të gjithë banorët civilë të fshati filluan të vrapojnë në drejtim të pyllit. Ndërsa

vraponin, ata ranë pre e zjarrit të forcave serbe dhe 12 prej tyre u vranë, përfshirë nëntë fëmijë. Pra, e vranë Fatimën që i kishte ra granata në gjoks, Ismetin, Zarifën, Lulen e Çerretit, Diellzën, Bukurinë, Nazën e Çerretit, Gëzimin e Haxhiut etj. Disa janë vranë në shtëpinë e Ismetit e disa gjatë ikjes. Unë u plagosa rëndë. Janë plagosur edhe Sakibja, Fisniku etj. Unë e humba vetëdijen. Ka ardhur Agimi i Nuhiut me një tjetër dhe në një batanije më kanë bartur dhe më kanë dërguar në mal. Pastaj e sjellin Sakiben, të renë e kunatit, Fisnikun që kishte 7 vjet e gjysmë. Më vonë kanë ardhur edhe disa të tjerë. Siç kuptova atëherë dhe më vonë në Landovicë janë vranë: Njomëza (Ibish) Morina (1983), Dalife (Hazer) Gashi (1923), Ismet (Selman) Gashi (1952), Afrim (Eqrem) Gashi (1981), Fatime (Selman) Morina (1955), Festina (Islam) Morina (1997), Luljeta (Haxhi) Qarreti (1965), Bukurije (Xhemajl) Qarreti (1971), Diellza (Selajdin) Qarreti (1998), Nazmie (Haxhi) Qarreti (1984), Gëzim (Haxhi) Qarreti (1990), Kosovare (Nazim) Selimaj (1988), Kushtrim (Nazim) Selimaj (1991, Avdi (Ragip) Gashi (1939), Avdi (Haxhi) Morina (1935), Hadije (Mustafë) Gashi (1924), Shefki (Ali) Jahaj (1948) dhe Abaz (Sejdi) Krasniqi (1977). Këta të vranë ishin kryesisht nga Landovica, por kishte edhe banorë që kishin ardhur si nipa e strehuar këtu si nga fshati Grejçevc i Suharekës. Duhet theksuar se Bukuria e vranë ishte në muajin e nëntë të shtatzënisë.

Më kujtohet momenti kur më ka ardhur vetëdija në mal, sepse isha e lënduar në disa vende, e sidomos në kukë. Më kanë dhënë ujë dhe m'i kanë larë sytë. Nëna e Agimit të Nuhiut, Bahrija i ka shqyer pizhamet e veta dhe m'i ka lidhur plagët. Unë nuk dija se janë vranë anëtarët e tjerë të familjes, derisa ka ardhur Ibishi dhe më tregoi se përveç Njomzës, është vranë edhe Fatimja. Aty ishte edhe Lulja e Deliut.

Më pastaj arritën që të shkojmë në fshatin Petrovë afër Prizrenit. Aty mjekët filluan të na shërojnë. Nga aty kaluam në Prizren dhe u vendosëm në disa familje që na pritën mirë dhe u kujdesën për ne. Të gjithë të plagosurve filluan që të na shëronin. Jam mirënjohës për mjekët që u kujdesën dhe na shëruan, por edhe ato familje që na strehuan dhe na ndihmuan me ushqim, rrobe etj. Numri i tyre është i madh, andaj nuk po i përmendi me emra, se mund ta harrojë dikë.

Pas një muaji djali im Fidani kishte arritur që të shkonte në fshatin Landovicë. E sheh Njomzën të vdekur në kade, të pavarrosur. Ibishi më tha që të shkojë me Fidanin e Zeqirin që ta varrosin Njomzën, sepse në fshat nuk ka më policë. U nisa me djem dhe kushëririn Esatin me bashkëshorte dhe me disa udhëtarë të tjerë hipëm në autobus dhe

arrijmë në Landovicë. Te xhamia e fshatit na ka ndalur policia, na ka legjitimuar, na ka mbajtur prej orës 7 deri në ora 13:00. Mua më kanë goditur me shuplakë, djemtë Zeqirin dhe Fidanin i rrahën. Na provokonin, na pyetnin ku i keni burrat, a janë në UÇK etj. Na kanë hipur në një kamion dhe na kanë kthyer në Prizren, pa e varrosur Njomzën. Na dërgojnë SPB në Prizren, na marrin në pyetje dhe na dërgojnë në kufi dhe dalim në Shqipëri. Vendosemi në një kishë në fshatin Baqevë të Lezhës. Aty na ndihmon popullata vendëse me ushqim e veshmbathje. Aty kishte edhe shumë refugjatë nga Mitrovica, gati të gjithë gra, fëmijë e ndonjë i moshuar. Nëpërmjet djalit që e kisha në Zvicër, kuptova se bashkëshortin e kisha në Elbasan. Ai ndërkohë erdhi dhe u bashkua me ne. Qëndruam në këtë vendbanim deri më 16 qershor 1999 kur u kthyem në vendlindje.

Intervistoi: Jusuf Osmani

KUFOMAT E VARROSURA TË TË VRARËVE DHE TË MASAKRUARVE, FORCAT SERBE I ZHVARROSËN ME EKSKAVATOR DHE I DËRGUAN NË DREJTIM TË PANJOHUR



Feriz Gërbeshi i mbijetuar nga Masakra e Slllovisë

Fshati Slllovi kishte rreth 500 shtëpi shqiptare 65 shtëpi serbe dhe 3-4 shtëpi rome. Me fillimin e luftës në Drenicë kanë ardhur në fshatin tonë refugjatët nga vise të ndryshme. Te serbët shihej një mosdurim. Shtojë urrejtja ndaj nesh.

Më 14 prill 1999 filloi rrethimi i fshatit tonë me tanke dhe automjete të tjera nga ana e policisë dhe ushtrisë. Atë natë jemi tubuar kryesia e fshatit për konsultë se çka të bëjmë dhe si të veprojmë me popullatën. Ne strukturat e fshatit një kohë ishim të angazhuar në logjistikën e ZOP të Nerodimës. Me formimin e Shtabit të ZOP të Zhegovcit ne u lidhëm me ta dhe u ndihmonim me ushqim dhe gjëra të tjera. Atë natë vendosëm të shkojmë unë, Mehmedali Gashi dhe Gafurr Hyseni në Shtab të Zhegovcit për konsultë. Na rekomanduan që të kthehemi dhe të jemi në mesin e popullatës. Mendonim që të tërhiqemi nëpër male, por ishte e pamundur sepse tërë fshati dhe malet ishin të rrethuara, ndërsa anën jugore të fshatit e kishim të banuar me serbë. Edhe në rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup nuk kishim mundësi të shkonim pa kaluar afër tyre. Më 15 prill, në ora 2 të mëngjesit ne dy shokët u kthyem në fshat e një mbeti në Shtabin e Zhegovcit. Popullatën e kishte kapluar frika, sepse kishin filluar të shtënat me armë nga të gjitha anët. Popullata filloi të ikte, disa u drejtuan kah fshati Vërbicë e Zhegovcit, të tjerët nëpër malet e Manastirit, kah Plitikoviqi, një pjesë, serbët i detyruan të shkojnë kah fshati Gadime, në fshatin Vrellë, kah Tërshevinat. Gjatë ikjes së popullatës dhe nëpër shtëpi, atë ditë më 15 prill janë vrarë 24 banorë të Slllovisë dhe është djegur gati gjysma e fshatit. Nga të vrarit ishin gra, vajza, fëmijë, pleq e djem të rinj. E kanë

vrarë me snajper vajzën e re, Fatime Dubovën. Një djalë i ri e kishte parë dhe ishte kthyer dhe e ka bartur shpinë, por kur e vëren se ajo kishte vdekur, e lëshon dhe për të shpëtuar vetën, ik. Ditën e nesërme i tubojnë kufomat, përveç njëres që familja e kishte varrosur në oborr, i marrin dhe i çojnë në vendin Çuka dhe i varrosin në një varrezë masive. I kanë mbuluar, kanë rrafshuar terrenin që të humbin gjurmët. Aty ishte vendosur ushtria e rregullt serbe. Mirëpo, halla Zepë që i kishte fqinjë serbët Tomçin dhe Goranin, kishte ngulur këmbë të tregonin se ku i kanë dërguar fëmijët e saj dhe të tjerët, ose u ka thënë: “vramni edhe mue”! I tregojnë vendin hallës Zepë se ku i kishin dërguar kufomat e të vrarëve, në mesin e të cilave ishte burri i saj, dy djemtë e dy nipa. Një rast tjetër që kishte ndodhur që Shefki Salihun e kanë mbytur me dru, ndërsa vëllanë e tij e kanë rrahur shumë, por ka shpëtuar. Aty e kanë rrahur e torturuar edhe shumë të tjerë.

Unë tërë ditën kam qëndruar në fshat. Në mbrëmje duke e parë se këtu nuk ka më të ndenjtur, me familjen time dhe shumë familje të tjera u drejtua kah malet e Manastirit. Në livadhe i takuam disa bashkëvendës. E kuptuam se janë vrarë 24 banorë të fshatit dhe janë djegur më se gjysma e fshatit. Atë natë qëndruam në mal. Filluam të ndërtonim disa kolibe me najlon dhe degë të drunjve që të strehohemi, se e pamë se nuk ka mundësi kthimi në fshat. Disa familje kishin marrë miell dhe filluan edhe të gatujnë dhe përgatisin ushqimin, duke iu përshtatur kushteve në mal.

Kah ora 12 filluan krismat e armëve të forcave serbe nga ana e Plitkoviqit dhe e Zhegovcit, shtinin pa kontrollë dhe filluan të digjinin pyjet. Vrasjet e para janë bërë në livadhet te “Lugu i Thive”, ku janë vrarë katër anëtarët e familjes Baftiu nga Zhegovci, në mesin e tyre ishte edhe i mituri Kastriot Baftiu, 16 vjeç. Rreth orës 12:30 na u ofrua këmbësoria, sepse për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe mungesës së rrugëve nuk kanë ardhur me automjete. Ata ishin ushtri e rregullt e organizuar mirë. Në atë kohë iu thashë anëtarëve të familjes shkoni të turma e madhe e njerëzve që qëndronin në vendin “Lugu i Demës”, se unë po rri me pleqtë, sepse e kisha nënën rreth 70 vjeç, Halimen, babanë Hamdiun dhe mixhën Balik Gërbeshin,. Ashtu edhe u veprua. Mirëpo, kur u afrua ushtria baba më tha – shko te fëmijët se ata frikësohen. Jam nisur për të shkuar në livadh. Në atë moment forcat serbe vrasin dy fëmijë, njëri ishte duke i ruajtur bagëtinë e tjetri ishte buzë lumit. Ata ishin Avni Sopa e Ramadan Sopa, kushërinj. E pashë me sytë e mi vrasjen e tyre. Forcat serbe filluan të ofrohen me të madhe, një grup nga fundi i “Lugut të Demës”, një grup prej malit, një grup prej rranxës.

Dëgjoja se ata komandën e merrnin me radiolidhje. Në atë kohë mali ende nuk kishte mugulluar, nuk kishte dushk, sepse ishte një pranverë e vonë. Ata na shihnin neve mirë, sikurse në shuplakë të dorës. U rrethuan nga të gjitha anët. Erdhën ata me shirita në kokë me ngjyrë të zezë, të kuqe dhe të bardhë, varësisht se cilës njësi i takonin. Ushtria e rregullt rrinte më larg. Pasi na rrethuan, komanda e parë ishte – Kush i ka plisat e bardhë, hiqni e gjuani. Nja katër-pesë pleq i hoqën, e një nuk e hoqi, sepse ai kishte qenë minator i Kishnicës dhe nuk kishte dëgjuar mirë. Menjëherë paramilitarët kanë shtënë me armë në kokën e tij, e pashë kur ra ai në duar të plakës së tij. Pra, e vrasin vetëm pse kapelën nuk e hoqi. Menjëherë kanë filluar plaçkitjet. Na urdhëruan që të heqim çdo gjë që kemi nëpër xhepa, ashtu edhe vepruam. Morën çdo gjë që gjetën, para, orë dore, stoli. Pastaj filluan t’i kontrollonin të rinjtë se mos kanë rroba me simbole të UÇK-së. Filloi rrahja e keqtrajtimi më mizor ndaj 5-6 të rinjve në prezencë të gjithë neve. Dy të rinj, pasi u rrahën, dalin prapa turmës dhe fillojnë të ikin në mal. I hetojnë dhe shtien në ta me automatik. Por, “nafakalitë“, siç thuhet “ymri i zotit”, shpëtojnë, ikin, vetëm njërin e kishte pas rrokur plumbi në një gisht.

Paramilitarët u egërsuan edhe më tepër, e panë se nuk po mund të gjithë t’i fusin në rreth. Urdhëruan që të ndahen gratë dhe fëmijët dhe u thanë që të shkojnë poshtë. Na kanë ndalur të gjithë neve që ishim në moshën madhore. Na thanë kthehuni prej mali që të mos ju vrasim në ballë, por në shpinë. Ata ishin përgatitur paraprakisht. Kishin vendosur automatikë e mitralozë në një veturë dhe në një traktor që i kishin plaçkitur. Menjëherë shtien në popullatë dhe të gjithë ata fishekë që ishin në rrathë, i zbrazën. Plumbat i rrokën ata që ishin përpara, e ata ishin kryesisht të rinj. Unë me disa ishim pak më prapa dhe menjëherë kemi rënë përtokë. Aty ishin rreth 80 persona. Përveç atyre dy djemve të rinj që u vranë më parë, u vranë 11 persona, e 12 mbetën të plagosur. Siç konstatova unë, ata nuk e kishin pasur për qëllim t’i vrasin të gjithë, por disa t’i vrasin e të tjerët t’i frikësojnë që ta lëshojnë vendin.

Ndërkohë paramilitarët dhe ushtarët filluan të largohen. Një kushëri imi që ishte arsimtar, që ishte rreth 5 metra larg, e ngriti dorën e më tha “a je gjallë?”. Unë e ngrita një gisht, meqë frikësohesha të ngrihesha, duke i dhënë shenjë se po. Kushëriri ishte në një pozitë më të mirë dhe i shihte forcat serbe. Jam ngritur. E pashë Raif Shalën, mysafir nga fshati Sushicë duke dhënë shpirt dhe kërkonte ujë. Më poshtë e pashë edhe një person tjetër, Bajramin, mysafir nga Prishtina që e kishin rrokur plumbat. Po ashtu, pashë edhe trupin e Ramadan Dubovës të dërrmuar. Kemi nisur t’i tubojmë kufomat. Pastaj të tjerëve

u thashë: vazhdoni ju se unë po shkoj të shohë familjen time, e cila nuk ishte aty. Ata kishin mbetur në mal. Kur shkova më lart hasa në kufomat e tre djemve të mixhës Shaip Gashi, Faik Gashi dhe Bejtush Gashi. Atyre ua kishin marrë letërnjoftimet dhe ua kishin grisur. Shihej se ishin ekzekutuar. Shaipi e Faiku ishin vëllezër, ndërsa Bejtushi që ishte profesor, ishte i mixhës tjetër. Kur i pashë, u trishtova shumë, mendoja se i paskan vrarë të gjithë, edhe gratë dhe fëmijët. Kam vazhduar në vendin ku e kishim ndërtuar kasollen për strehim. Kur shkova atje, çka me pa, shkonte flakë e tym. E gjeta mixhën afër një çufre të kërrusur ku kishin shtënë me armë në kokë të tij dhe e kishin vrarë. Dikush më tregoi se e kishte parë babanë tim, mendoja se e ka parë të vrarë, por ai ishte fshehur jo larg, prapa një cingu dhe nuk e kishin parë paramilitarët. Shkova e gjeta. E pyeta ku është nëna? Më tha se ka qenë në atë koliben shtrirë në sfunxher. Unë e kisha parë koliben duke u djegur dhe nuk më ka shkuar ndërmend se aty është nëna ime. Shkova menjëherë dhe e gjeta duke u djegur. Ishte djegur më se 80%. E kishin ekzekutuar, e më pastaj me një aparat me pluhur që digjej shpejt e kishin djegur koliben. Vrapova për të marrë ujë për ta shuar, që të mos digjet e tëra kufoma e nënës sime. Po ashtu, me atë aparat kishin djegur shtëpi, vetura, traktorë etj.

Kemi ndenjtur edhe 8 ditë, në mal te Lugu i Demës. Atë natë disa nga ne ndenjëm duke i ruajtur kufomat. Koha ishte me shi dhe nga pak edhe binte borë edhe pse ishte muaji prill. Ditën e nesërme më 17 prill jemi organizuar për varrosjen e kufomave. E mora një laps dhe shënova emrat e viktimave të renditur në atë varrezë. I kam shënuar emrat e 17 personave të vrarë që u varrosën atë ditë. Kam ndenjtur edhe 8 ditë. Në ndërkohë kërkoi gruan me fëmijët se ku janë. Më pastaj kuptova se kishin shkuar në fshatin e afërt, Smallushë. Erdhi një veturë për ta marrë Ramadan Dubovën, që këmbën gati e kishte të këputur. E kemi dërguar në Smallushë për shërim. Ky më vonë është dërguar në Suedi dhe është shëruar dhe sot është gjallë. E futa babanë në atë veturë, ai shkoi dhe e gjeti familjen time.

Pasi i varrosëm kufomat, u shpërndamë, unë shkova dhe qëndrova në Gadime dhe ndenja deri në çlirimin e Kosovës. Pas 30 ditësh na vjen lajmi se forcat serbe kanë shkuar dhe i kanë nxjerrë kufomat. Unë me shokët Ismetin dhe Milazimin që ishim në Gadime shkojmë nëpër male fshehurazi, duke u ruajtur që të mos diktohem nga ushtria dhe paramilitarët serbë. Kur arritëm e pamë se i kishin nxjerrë kufomat me ekskavator dhe i kishin ngarkuar në kamion. Deri në vitin 2018 nuk

kemi ditur për ato kufoma kur janë gjetur në një varrezë masive në Batajnicë të Serbisë.

Në fund dua të theksoj se 45 njerëz u vranë nga forcat ushtarake serbe dhe nga fqinjët tanë të veshur me rroba policie e ushtrie. Përpara kemi pasur fqinjësi të mirë dhe kurrë nuk kisha besuar që fqinjët tanë serbë do të bënin masakra të tilla ndaj nesh.

Intervistoi: Jusuf Osmani

PLUMBAT E FORCAVE SERBE MË QËLLUAN NË DORË TË
MAJTË DHE NGA DORA IME E QËLLUAN NË FYT DJALIN
TIM FITIMIN SHTATËVJEÇAR I CILI VDIQ NË VEND



Fikrije Tusha – Gudaqi, (e mbijetuar të Masakrës së Stagovës)

Fikrije Tusha – Gudaqi e lindur më 19 maj 1968, në fshatin Sopanicë të komunës së Kaçanikut, e martuar në fshatin Stagovë të Kaçanikut.

Më datën 21 maj 1999, në Stagovë, në orët e hershme të mëngjesit janë vërejtur forcat paramilitare, ushtarake dhe policore serbe. Në orën 5 të mëngjesit të 21 majit 1999 kemi dalë prej shtëpisë dhe kemi shkuar në drejtim të malit, te vendi i quajtur “Kumlishtë” për t’u strehuar i gjithë fshati. Posa kemi dalë në mal, duke pushuar vërejtëm disa paramilitarë që po vinin në drejtim tonin. Në gjuajtjet e para më qëlluan mua (Fikrijen) në dorë të majtë, por i njëjti plumb depërtoi dhe e qëlloi në fytyrë djalin tim, Fitimin, shtatë vjeç, ku e la të vdekur në vend. Të shtënat e serbëve nuk pushuan. Në fshat kishin mbetur vetëm gra, pleq dhe fëmijë.

Nga të shtënat e armëve u plagos edhe Nurimanja, shtatëvjeçare, vajza e kunatit tim (Ekremit). Ata filluan të afrohen nga ne. Djali im Leutrimi pasi e pa trupin e vëllait që po rridhte gjak, filloi të largohet nga unë, por forcat serbe gjuanin në drejtim të tij. Fati nuk e kapi asnjë plumb, përpos këpucëve që i kishte mbathur.

Forcat serbe na zunë të gjithëve në një rrugë mali. Më lart ishin pleqtë dhe plakati e sëmura dhe të paralizuar. Ata në prezencë tonë i pushkatuan (ekzekutuan). Në mesin e tyre ka qenë edhe vjehrra ime Hanifja, e cila ka qenë e paralizuar.

Aty vranë 9 veta, prej tyre 5 burra dhe 4 gra. Neve na dërguan në një shtëpi të Enver Jahës në fshat, e cila gjatë kësaj kohe mbeti e padjegur. Në atë shtëpi kemi qenë tri familje, familja e Remzi Krrabës, e Rufki Krrabës dhe e Rrustem Gudaqit. Të gjitha gra dhe fëmijë, përveç kunatit tim që ka qenë me ne, i cili e barti djalin tim Fitimin.

Gjatë gjithë kohës na keqtrajtonin në mënyrë më shtazarake dhe kohë pas kohe vinin grupe të ndryshme si paramilitarë, ushtarë, policë dhe romë pa uniformë. Ata prej mëngjesit deri në ora 16:30 pas dreke, ku edhe fëmijët qëndruan pa bukë e pa ujë, por më së keqi pësuan fëmijët që qëndruan tërë kohën para thikave dhe duarve të përgjakura të kriminelëve serbë, të cilët vinin nga mali.


Ata plaçkitën, rrënuan, thyen dhe në fund e marrin kunatin tim Ekremin në prezencë të fëmijëve tanë, ndërsa djali im Fitimi i vranë dhe vajza e kunatit tim Nurimanja e plagosur rëndë, e cila veç sa nuk kishte vdekur.

Ekremin e marrin dhe e quan në stallë të lopëve dhe e ekzekutuan, pastaj ia shtinë flakën stallës. E bënë minimin e vendit ku ishin kufomat e të vdekurve dhe ngarkuan plaçkat e tyre dhe ia vunë zjarrin shtëpive duke lënë të vdekur dhe të plagosur gra, fëmijë e pleq. Prej tyre 14 të vdekur (të varë) dhe 10 të plagosur, si dhe 90 shtëpi të djegurua tërësisht dhe afër 80 kafshë të vrara.

Forcat serbe vranë: Ekrem Gudaqin, Hanife Gudaqin, Fitim Gudaqin, Hamdi Dashin, Ramadan Dashin, Sevdije Gurin, Elfije Jahën, Bahrije Elezin, Baki Belën, Ibush Rrushin, Fahri Manin, Ramush Jahën dhe Selvije Krivanjevën. Ndërsa, të plagosur ishin: Rrahim Sadiku, Qemajl Ahmeti, Shukri Dashi, Beradin Dashi, Zijadin Mani, Mevlude Sallahu, Lirije Krraba, Nurimane Gudaqi, Firkije Gudaqi dhe Shefkije Brruti.

Intervistoi: Jusuf Osmani

E DËGJOVA NJË EPROR USHTARAK KUR URDHËROI QË TË MOS NA VRASIN ME RAFALË, POR NJË NGA NJË



Hajriz Haxholli i mbijetuar i Masakrës së Makocit

Hajriz Haxholli i lindur më datë: 08.09.1948 në Marec të Prishtinës.

Në Marec erdhi një numër shumë i madh i refugjateve të cilët u strehuan nëpër shtëpitë tona. Pothuajse nuk kishte shtëpi që nuk i kishte të strehuar nga 100 persona. Më 18 prill 1999 pamë se ishim të rrethuar nga të tri anët dhe u detyruam të përgatiteshim për t'u larguar nga fshati. Të nesërmen më 19 prill filluan granatimet nga Novobërda, nga lagjja Kukaj dhe nga Prapashtica. Të gjitha shtëpitë ishin të stërmbushura, po ashtu edhe shkollat dhe rrugëdalja e vetme ishte që të largohemi për në lagjen Bullaj; aty u tubuam njerëz nga të gjitha lagjet e fshatit bashkë me refugjat të tjerë. Nisemi për te Përroi i Zi, aty kishte me qindra kamionë e traktorë, aty e kaluam natën, ishte ftohtë, binte shi qe besa më vonë edhe borë. Tërë natën ndezëm zjarre, kush kishte ndonjë grimë miell gatuante ndonjë bukë, ishim të pasigurt, në ankth dhe kështu na çel mëngjesi.

Në mëngjes tani forcat serbe ishin ofrua shumë afër nesh, ata duke zbritur nga lagja e Pacajve kë gjenin nëpër shtëpi dhe jashtë shtëpive i vrisnin. Nga trishtimi i madh vdiqën dy plaka, njëren e varrosem disi ashtu si mundëm, kurse tjetrën nuk kishte kohë për ta varrosur, prandaj kufomën e saj e morëm me vete në traktor.

Nisemi kodrës përjetë ku kishte me qindra kamionë dhe traktorë, kurse me mijëra vetë nga dy anët e rrugës ecnin në këmbë, kështu arritëm në fshatin Zllash, kurse forcat serbe vazhdimisht granatonin në drejtim të kolonës së civilëve.

Ecëm tërë ditën kështu dhe në mbrëmje arritëm te lagjja e Cervadikëve. Banorët e kësaj lagjeje i kishin braktisur shtëpitë e tyre,

disa u strehuan nëpër shtëpitë e tyre të braktisura kurse ne vazhduam rrugën për në Grashticë ku arritëm në orët e vona të natës. Forcat paramilitare serbe na kishin dalë në pritë dhe papritmas na gjuajnë me breshëri plumbash sikur na lajmëronin se duhet të ndalemi. Kolona ndalet në vend për të mos lëvizur më tej. Aty e kaluam gjithë natën. Të nesërmen në mëngjes, në ora 8, nisemi për në Prishtinë duke menduar se siç tregonin disa, ndoshta ka kaluar ora policore. Kur kemi mbërritur te Mulliri i Isufit më kujtohet kur një person vinte në drejtimin tonë duke bërëtitur “ja kanë nis e po vrasin njerëz sa po mujnë”, ishte e vështirë kur e dije se pas disa qindra metrash mund të vritesh, por s’kish rrugëdalje tjetër. Pikërisht te Mulliri i Isufit na ndalin edhe neve, aty para neve i kishin vlarë disa veta dhe nga mali dalin edhe shumë të uniformuar serbë me fytyra të ngjyrosura dhe na kërkojnë që për një minutë krejt qa kemi nëpër xhepa para, ari, stoli e gjëra të tjera t’i nxjerrim jashtë. Unë ua dhashë 1000 marka gjermane, mirëpo ata prapë u kërkonin familjarëve dhe refugjatëve të tjerë që ishin në rimorkion e traktorit dhe pasi na i marrin 7800 marka, na urdhëruan që të ecim dhe kështu ne menduam që i shpëtuam më të keqes. Pak metra më andej prapë na ndalin dhe kërkonin para, kur ne ju tregojmë që nuk kemi më, pasi ua dhamë atyre që ishin më lart dhe kështu një paramilitar më ofrohet afër e nxjerr thikën e lëpin me gjuhë dhe mundohet të më godasë në zemër, por unë në ato momente jam munduar të mbrohem me dorë, ku me thikë ma shpon krahun anë e përtej pastaj më godit edhe në këmbë. Ashtu i plagosur u detyrova të nisemi disi. Aty, para se të dalim në rrugën kryesore në drejtim të Prishtinës, i vrasin edhe disa civilë, si: Mentor Llapashtica, Naser Haxholli dhe disa të tjerë që nuk i mbaj mend emrat.

Kur arritëm në Makoc, përpara na ndali grupi tjetër i forcave serbe. Na urdhëruan të zbresim nga traktori mua dhe Tafilin, të cilin e dërguan në anën tjetër. Mua më dërguan te tabela e Llukarit në anën e majtë të rrugës, aty ku shumë burra e të rinj, i kishin rrahur dhe lënduar rëndë.

Traktori im mbeti disa kohë në rrugë. Vajzën time Vjollcën e nxorën nga traktori bashkë me Tahirin plak dhe donin t’i pushkatojnë. Kur e ndajnë vajzën për ta pushkatuar, Tahiri u tha të mos vrisnin sepse është shumë e re, ende pa i mbushur 15 vjet. Fati deshi dhe e liruan pa pasoja të mëdha. Ata që mbetën në traktor, vazhduan rrugën për në Prishtinë, kurse ne të tjerët mbetëm të rreshtuar në buzë të rrugës, pranë varrezave. Dëgjova një epror ushtarak kur urdhëroi që të mos na vrasin me rafale, por një nga një. Gjaku nuk më ndalej dhe kaluan disa orë pa

kurrfarë intervenimi, filloi të më lëshojë forca dhe mezi qëndroja në këmbë. Njerëzit kalonin rrugës duke qarë. Britnin nënat për djemtë, gratë për burra, fëmijët për nëna, nënat për fëmijë.

Rreth orës 15:30 një polic që qëndronte para nesh na tha që të kapemi pas traktorëve. Por, ne nuk guxonim të ecnim shpejt, sepse frikësoheshim se do të na vrasin pas shpine, unë hipa në traktorin e Fehmi Krasniqit, në të cilin kishte pasur shumë gra e fëmijë. Pasi isha i lënduar rëndë ma liruan një vend, por me që gjaku nuk më ndalej, për të mos i rrezikuar të tjerët zbrita nga traktori dhe fillova të eci në këmbë, nuk dija se si, por pas pak çastesh, para meje vërejta traktorin me anëtarët e familjes sime, kur më panë nga gëzimi filluan të qajnë dhe qava edhe unë. Pastaj ma lidhën dorën me shall e rrip dhe e mora traktorin për ta vozitur. Në hyrje të Prishtinës te Bunari i Hajratit, disa policë na ndalin përsëri dhe deshën të më vrasin, por pasi u shfrynë duke na sharë, më lëshuan. Pastaj me familjen time u vendosëm në shtëpinë e Muharremit, i cili ishte një kushëri imi që jetonte në Prishtinë. Pastaj plagët e mia m'i shëroi në ilegalitet mjeku Dr. Agron dhe Ajshe Uka, dhe këtu qëndruam deri në përfundim të luftës.

Intervistoi: Abaz Makolli

SADIK HEREQIT TË PUSHKATUAR, QË RËNKONTE NGA
DHIMBJET E FORTA IU AFRUAN DHE E GODITËN ME
PLUMB NË KOKË



Hysen Krasniqi, i mbijetuar i vetëm i Masakrës së Kralanit

Hysen Krasniqi, i lindur më 15 prill 1978 në fshatin Zajm të Klinës, banor i Klinës dhe i cili është i vetmi i mbijetuar me katër plagë plumbash në trup. Me 1999 Hyseni ishte 21 vjeçar.

Më 28 mars, në shtëpi kemi qenë unë vetëm me nënën. Kanë ardhur milicët serbë në mëhallën tonë. Na kanë nxjerrë prej shtëpive me dhunë, bile, në kojshi, edhe kanë gjuajtur me armë në ajër, sepse një grua, Fatime Elezi, nuk donte të dilte nga shtëpia. Unë kam qenë vetëm me nënën. Në dalje të Klinës, tek ura e lumit na kanë shtyrë në drejtim të Zajmit. Kemi qenë shumë. Kur kemi mbërri tek Ura e Haxhisë, disa milicë na kanë ndalur dhe kanë thënë kthehuni se nuk bën të shkoni kënde, shkoni për Shqipëri. Aty e kanë arrestuar Hamit Krasniqin dhe Emin Deskun, kurse ne jemi kthyer prapa. Në Gremnik dikush na ka dhënë një Gollon (motokultivator) kemi hipur në të dhe jemi nisur me një turmë të madhe njerëzish.

Në udhëkryqin e rrugës Pejë - Prishtinë, një serb na kishte thënë shkoni drejt për Shqipëri e mos u ndalni as mos u ktheni askund.

Tek Ura e Rakovinës kanë dalë katër persona, ushtarë të UÇK-së dhe na kanë thënë të mos vazhdojmë për Gjakovë kurrsesi, por të kthehemi në Kralan ose Qifllak. Dikush ka thënë se një serb na ka thënë të vazhdojmë drejt për Shqipëri. Ata kanë reaguar: “a po doni t’i dëgjoni serbët apo ne?” Kemi hyrë në Kralan, jemi strehuar nëpër shtëpi, në një odë kemi qenë 30-40 persona, por na kanë dhënë bukë e strehim, të gjitha të mirat. Aty kemi qëndruar 5 ditë.

Më 2 prill ka filluar ofensiva, (diku rreth orës 13-14 ndoshta se nuk kam pasur orë). Kanë filluar të gjuajnë prej së largu. Jemi tubuar te shkolla të gjithë, tani dikush i dushëve, nuk më kujtohet emri, ka thënë:

“Hajde të dorëzohemi, na jemi të Klinës dhe s’kanë çka me na ba”. Jemi nisur teposhtë fshatit për t’u dorëzuar te forcat serbe meqë nuk kishim zgjidhje tjetër. Duke u ofruar te një livadh na kanë ndarë meshkujt na kanë futur brenda livadhit dhe na kanë urdhëruar të ulemi. Gratë dhe fëmijët i kanë nisur drejt Shqipërisë.

Na kanë urdhëruar të vëmë duart pas koke e pastaj edhe të zhvishemi ne shokë e lart. Për disa orë na kanë mbajtur ashtu. Disa i kanë rrahur fort. Kanë kërkuar dhe kanë marrë para prej xhepave të rrobave tona. Më vonë kanë thënë vishuni dhe secili kemi veshur çka kemi gjetur, sepse ishin përzier rrobat. Atë natë ka qenë ftohtë dhe kemi qëndruar afër njeri-tjetrit për t’u ngrohur me trupat tanë. Të nesërmen më 3 maj, gjithë ditën na kanë mbajtur ashtu, dikur kah mbrëmja kemi nderur edhe zjarr për t’u ngrohur. Ndërkohë, vjen një grup ushtarësh serbë me Majorin Grujiq dhe thonë se po ju sjellim kamionë për t’ju përcjellë deri te kufiri me Shqipërinë. Më herët, nga disa gjuajtje janë plagosur në duar dhe këmbë dy persona të rinj. E sollën një kamion të ushtrisë serbe dhe në të futën 50-60 persona të moshuar dhe të plagosurit. Por kamionë të tjerë nuk erdhën dhe ne e kaluam natën e dytë në shtettrëhim të lodhur, të uritur, pa bukë e ujë.

Me gjithë molisjen fizike e shpirtërore, nen peshën e pasigurisë dhe kërcënimit, jashtë e në të ftohtë, na kapte gjumi herë pas here. Ne mëngjesin e ditës së diel, më 4 prill, diku në mes të orës 8 dhe 9 vjen një grup ushtarësh e policë, të cilët ne njërën anë i lirojnë numrin më të madh të qytetarëve që për dy ditë e net ishin zënë dhe trajtuar si rob luftime, kurse në anën tjetër kërkojnë që disa të rinj të shkonin pas tyre për të hapur disa kanale. Ky grup u zgjodh, thuaja një nga një dhe na nisën ne anën e majtë te daljes nga livadhi. Në hapësirën ku sot është ngritur lapidari i martirëve të Kralanit një pjesë ua zhveshin jaknet. Aty fillojnë ndarjen në grupe. Grupin e parë prej rreth 15 - 20 vetash na nisën në drejtim të hyrjes së fshatit dhe na fusin në oborrin e një shtëpie në të majtë të rrugës. Ne fund të oborrit ishte një posllam (object hapur për vendosjen e ushqimit të kafshëve, pleme), na rreshtojnë me shpinë nga muri. Ne këtë gjendje, të gjithë ne i lusim të mos na vrisnin, u kemi gjuajtur të gjitha paratë që i kishim. Ata, 7 veta me një fare lloj uniforme me xhempera të gjatë, nga një distance prej rrethe 15-20 metrash filluan të shtinin drejt nesh, duke na rrëzuar përtokë një nga një. Plumbi i parë që më mori në krahun e majtë ma ka humbur vetëdijen, kurse tre plumbat e tjerë të cilët më qëllojnë në stomak, gjoks e shpatull, më kthejnë vetëdijen. Plumbi i tretë më digjte si zjarri. Të gjithë kanë rënë përtokë.

Njëri prej të pushkatuarve, Sadik Hereqi, i plagosur, nga dhimbjet e forta është dëgjuar duke gjëmuar. Janë afuar dhe nga afër i kanë dhënë edhe një plumb në kokë, pastaj ai nuk është dëgjuar më.

Pasi u larguan vrasësit, menjëherë jam ngritur, me dorën e djathtë mbaja dorën e majtë. Jam përpjekur të shikoj nga krahu i djathtë drejt livadhit nëse kishte njerëz, por nuk kam parë askënd. Pastaj kam kaluar rrugën dhe kam ecur drejt një shtëpie në dalje të fshatit pothuajse në mal. Në atë shtëpi të braktisur, në një dyshek jam shtrirë për të vdekur. Kërkoja ujë por nuk gjeja, digjësja nga etja. Nuk di sa kam qëndruar aty pa vetëdije. Mbaj mend se si në ëndërr më është dukur se Hamit Gashi i cili mbeti i vdekur, më ftonte duke më thënë eja, kurse unë i thosha jo, nuk dua të vij.

Pasi më është kthyer vetëdija, kam parë dyshekun krejtësisht të gjakosur. Kam dalë dhe kam gjetur një pus uji, kam pirë shumë dhe menjëherë e kam kthyer vetëdijen, (e kam vjell). Aty kam humbur prapë vetëdijen, nuk di për sa kohë.

Pasi po binte terri, ndërkohë kanë ardhur dy ushtarë të UÇK-së për të marrë ujë dhe sa më kanë parë, janë larguar, për t'u kthyer të përforcuar me 4-5 shokët e tyre, të cilët më rrethojnë duke më pyetur kush isha. Në ndërkohë, më ishte kthyer vetëdija. Ata më marrin në shpinë dhe më dërgojnë në një shtëpi ku më japin ndihmë. Nuk kishin medikamente. Më japin çaj dhe ushqim, por nuk mund ta haja. Më kanë pyetur për ngjarjen, me sa di kanë mbajtur shënim. Pastaj më kanë nxjerrë prej aty në mal, në një vend pak më të sigurt dhe më kanë lënë aty. Të nesërmen u kthyen, kishin siguruar në Gllogjan edhe disa medikamente, fasha, jod etj. për të më pastruar e fashuar plagët. Pastaj më kanë marrë me veti dhe për gjithë kohën kam pasur përkujdesje. Dalëngadalë e kam marrë veten dhe deri në tërheqjen e forcave serbe kam qëndruar me UÇK-në.

Intervistoi: Ramë Manaj

NIPIN TIM E SHPËTOI ASHKALIU AGIM BISLIMI



Idriz Govori i mbijetuar i Masakres së Hallaqit të Vogël

Idriz Govori, i lindur më 25 qershor 1968 në Hallaq të Vogël, datë 18 maj 1999.

Ngjarja e 19 prillit të vitit 1999 ka ndodhur në fshatin Hallaq i Vogël të komunës së Lipjanit është mjaft e rëndë, jo vetëm për mua, familjen time, por edhe për tërë fshatin dhe më gjerë. Ka ndodhur një masakër ku janë vrarë me pushkatim 20 persona, prej tyre 11 të pushkatuar dhe 9 të vrarë nëpër shtëpia (4 të familjes Buzuku dhe 5 të familjes Gashi).

Forcat serbe kanë ardhur dhe kanë hyrë në fshatin tonë kah ora 7 e mëngjesit, te oborri i mullirit. Aty kanë filluar të shpërndahen dhe të gjuajnë me armë. Pastaj kanë filluar të hyjnë nëpër familje. Së pari kanë hyrë te familja Gashi dhe aty është bërë vrasja e parë e 5 anëtarëve. Nga familja Gashi kanë shkuar te familja Buzuka dhe kanë vrarë 4 anëtarë. Kanë filluar që t'i detyrojnë fshatarët që të grumbullohen në vendin Mera të katundit.

Unë dhe vëllai im kemi shkuar më lart fshatit ku ishin të dy familje të Jasharëve, e Qamilit dhe e Rasimit. Jemi takuar me ta dhe kemi filluar të konsultohemi se si të bëjmë planin për të ikur në Shqipëri, siç veprohej ato ditë. Të mos shpërndahemi, por të shkojmë së bashku sepse mund të ishim më të sigurt. Përderisa ne bisedonim kanë mbërritur disa paramilitarë dhe na kanë rrethuar në oborre, na kanë detyruar të dalim në rrugë dhe të shkojmë drejt mullirit. Pastaj filluan t'i ndanin meshkujt nga turma. Unë dhe vëllai e kishim nga një fëmijë në dorë. Pasi na urdhëruan që të dalim nga turma, i lëshuam fëmijët dhe

na kanë rreshtuar më poshtë. Unë kisha një kapelë në kokë dhe e hoqa dhe kur arrita të gjysma e rreshtit, një paramilitar më ka thënë “Ti u stroj”. Ashtu edhe veprova. Na kanë marrë dhe na kanë rreshtuar 40-50 veta. Ka ardhur një komandant siç e quanin ata, na ka pyetur se a keni rroba të UÇK-së, a keni armë etj. Natyrisht ne nuk kishim asgjë. Ai u tha paramilitarëve “Vodi tamo kod livade na strelanj”. Na nisën neve rreth 40 veta për të vendi i pushkatimit. Rrugës pamë shumë forca serbe të shpërndarë dhe të armatosur. Na kanë dërguar te livadhi. Kur shkuam atje pamë se 5-6 fshatarë i kishin mbështetur për muri. Edhe neve na detyruan të bëjmë të njëjtën gjë. Na thanë nga 5 veta të dalim përpara dhe të qesim çka kemi nëpër xhepa. Papritmas e vrasin një djalë të ri nga Zborci që kishte qenë mysafir. Një paramilitar tha se kush lëviz kështu e ka. Çka kemi pasur krejt i kemi qitur përpara. Tjetri thotë po e marrim një prej tyre dhe po e çojmë ta presim e të shihni se cilët jemi ne dhe çka jemi (në gjuhën e tyre). E kanë marrë Beqir Asllanin. E kanë dërgua dy veta në një ahër të afërt. Na kanë thënë: cilët jeni vllazër dilni përpara. Kemi dalë me vëllezërit, dy Zekiqët, dy të Asllanit e disa të tjerë që nuk ishin vëllezër, por të afërm. E kanë lëshuar një pjesë të madhe të personave që ishin aty. Thanë se kush i ka nën 17 vjet të dalë prej rreshtit. Kanë lëshuar edhe disa të moshuar. Ndërkohë filloi të flasë Muharremi, por paramilitari ndërhyri dhe i tha se ti je pronari i mullirit. “Ti bizismen”, po i thotë ky dhe kam para mjaft, kam veturë e çdo gjë tjetër. Nuk e kemi vërejtur kur një rom shtiu dhe në rresht e vrau në vend Muharremin. Paramilitarët shikojnë prapë në rresht ku kishin mbetur 13 veta dhe thoshin ta marrim edhe një dhe ta prejme. E kanë marrë Nazim Asllanin, vëllanë e Muharremit. Duke e çuar atje, Beqën e kthejnë dhe e kishin prerë në fytyrë dhe në duar”.

Neve na thanë po ju pyesim për herë të fundit a keni rroba të UÇK-së. U thamë, po të të kishim rroba të UÇK-së, nuk do të ishim këtu. Komandanti tha: “Nema nema, postupite po naredjenju”. Së pari e vranë Ekrem Faik Bajramin (1976), mysafir që ishte nga Zborci i Shtimes që ishte shumë i ri. Pranë murit rreshtuan nga e majta në të djathtë: Beqir Asllanin (33 vjeç), Nazim Asllanin (29), mua Idriz Govorin (40), Ragip Jasharin (38), Isa Govorin (40), vëllanë tim, Fehmi Aliun (26), Enver Malokun (37) mysafir nga Vushtrria, Sami Zekqin (23), Milaim Zekiqin (37), Avdi Zekiqin (35) dhe Nexhmi Fazliun (33).

Si ka krisur pushka e parë, kam rënë për tokë dhe më kanë rrokur në dy vende, vetëm pallton që e kisha veshur, ndërsa baruti më kishte shkuar nëpër trup. Kam ra në bark, nuk kam lëvizur. Njëri nga paramilitarët po thotë “u krye”, tjetri thotë ka të gjallë dhe fillon të shtie me

revole në viktimat që ishte 5-6 metra larg. Kur vjen radha tek unë, revolja shkrep, por pa plumb. Njëri që komandonte tha “dosta, idemo”. Unë rrija i shtrirë përtokë, vështirë merrja frymë, sepse nuk guxoja që të lëvizja se më hetojnë. Kam qëndruar ashtu rreth 50 minuta. E kam ngritur kokën ngadalë. Vëreja se nuk është më askush. Jam ngritur ngadalë, kam kapërcyer një gardh dhe kam hyrë në një stallë dhe jam fshehur. Pas dy orësh, popullatën që e kishin nisur për Shqipëri e kanë kthyer të fshati Grackë e Vjetër. Kam shkuar te popullata dhe u kam treguar për pushkatimin e 11 vendësve tanë. Kemi ardhur te kufomat dhe vendosëm që t’i varrosim në një varr masiv, duke përfshirë edhe ata të vrarë më parë, 4 të familjes Buzuku e 5 të familjes Gashi. E dërgova djalin e vëllait që t’i marrë disa dërrasa në shtëpi. Në atë moment kanë ardhur po ata paramilitarë me një veturë që e kishin marrë të një fqinjë. Kur erdhën, e thirrën një fqinjë ashkali se ata që ishin tubuar për të hapur varrezën, a ka ndonjë pjesëtarë të familjeve të tjera, përveç ashkalinjve. Ai i është përgjigjur se jo, prapë tri herë e pyetën, por ai që quhej Fetush Mehmeti, tha bindshëm jo, edhe pse e dinte se ka, e në mesin e tyre edhe unë. Fetushi kishte 27 vjet e unë 31 vjeç. Ndërsa, turmës së popullatës, një komandant bërtet “kome sam rekao da ide u Lipljan, majku vam jebem, berze, brze krenite” dhe ka shtënë në ajër. Të gjithë shqiptarët nisen për në Lipjan, përveç Ejup Troshupës dhe Besim Zekës që ishin duke e hapur varrin. Në ndërkohë, vjen nipi im që kishte shkuar t’i marrë dërrasat për varrezë. Një paramilitar thotë “Strelaj odmah”. Ashkaliu Agim Bislimi, thotë “To je nash”. Paramilitari i thotë “vidish da je beo”, ky i thotë a po e sheh “i ja sam beo”. Kështu e shpëton nipin dhe e shtien ta çelin varrin.

Pas dy javësh kanë ardhur dhe kanë urdhëruar që secila familje nga një anëtar të dalë te varrezat e veta. Me një ekskavator të “Higjienoteknikës” dhe i kanë nxjerrë kufomat dhe i kanë dërguar në Lipjan, kinse për obduksion. Më pastaj i sjellin dhe na detyrojnë t’i varrosim secila familje në varrezat e veta, sipas lagjeve, në prezencë të policëve. Unë e kisha të vrarë vëllanë Isa Govorin. Këtë ata e kanë bërë me qëllim që nesër të thonë “Shih këta janë vrarë në mes vete dhe i kanë varrosur në varrezat e tyre. Më pastaj kanë sjellë edhe disa ashkalinj që t’u ndihmojnë disave në hapjen e varreve.

Çdo ditë nëpër rrugën e fshatin kalonin me qindra tanke, autoblanda e mjete të tjera ushtarake. Ne strehoheshim në një shtëpi të djegur të Metush Jasharit. Aty qëndronim unë, Metush Jashari, Refki Jashari, Aliu, nipi. Në atë shtëpi strehoheshim. Na binin bukë tinëz dhe na lëshonin nëpër një pjesë të çelur të pllakës. Këtu i kam përjetuar

momentet e vështira dhe mendoja çdo gjë që mund të na ndodhë, jo mua, por familjes. Në atë kohë që qëndroja unë i fshehur në atë shtëpi, varroseshin kufomat e sjella nga Lipjani. Doja të shkoja të varrosja vëllanë. Vendosa, me gjithë rrezikun që të shkoj e ta varrosë vëllanë, ashtu edhe veprova. Kur e varrosa mu duk se m'u hiq një barrë e rëndë.

Në fund, po theksoj se atë që kam përjetuar unë, por edhe shumë të tjerë, njeriu mund të pësojë nga mendja, të mos jetë normal.

Intervistoi: Jusuf Osmani

ARRITA TA IDENTIFIKOJ TRUPIN E VËLLAIT TIM QË ISHTE I COPËTUAR DHE PA KOKË



Jeton Kuçi i mbijetuar i Masakrës së Kotlinës

Jeton Kuçi, 24 vjeçar, i lindur në fshatin Kotlinë. Në kohën e masakrës ishte 19 vjeç.

Për masakrën e Kotlinës, për shumë skena të trishtueshme të saj, Jetoni ishte dëshmitar okular. Më 24 mars 1999, para se NATO-ja të fillojë bombardimet, në fshat erdhi ushtria serbe së bashku me njësitë e policisë speciale. Ata ishin të uniformuar me fytyra të maskuara nga të cilat shiheshin vetëm sytë dhe hundët pjesërisht. Flitej se në fshatin tonë kanë qenë rreth 500 trupa të forcave serbe të gjitha gjinive ushtarake, me armatim të rëndë dhe të llojllojshëm dhe me autoblanda me mjete të tjera ushtarake.

Forcat serbe kishin ardhur në fshatin tonë herët në mëngjes. Me të arritur kanë filluar të shtien në popullatë. Rreth orës 11:00 nga një autoblandë kanë shtënë dhe e plagosur Zymer Lokun, i cili ndërkohë si pasojë e plagëve të rënda, vdiq. Në atë kohë unë gjendesha në pyll. Serbët më vrejën dhe filluan të shtienë me armë drejt meje. Unë isha me Nexhmedin Kuçin dhe Sherif Kuçin. Doja të shihja se çka po ndodh me familjarët tanë të rrethuar. Kur na hetuan, unë fillova të ikja, diku zhagas, diku i kërrusur. Gjatë ikjes takova vendësin tim, Shahinin që kishte vetëm 16 vjet. Kemi ikur bashkë dhe kemi dalë në kodrën e Shullanit. Kam parë një njësit ushtarak serb që vinte nga fshati i afërt Ivajë, duke shtënë me armë. Që të mos na hetonin, me Shahinin kemi rënë në një gropë dhe filluam të mbulohemi me dushk. Unë Shahinin e mbulovala, por vetë nuk arrita të mbulohem në tërësi. S'kishim kah të shkonim. Policia vinte nga poshtë e ushtria në anën e sipërme duke e pastruar terrenin. Ato dy njësitë u takuan. Ata bisedonin ndërmjet veti me radiolidhje. Unë dëgjoja, se nuk isha larg, e kuptoja gjuhën serbe, kur njëri i thotë se aty janë disa njerëz, e tjetri thotë se nuk ka, se po i

shoh gjurmët se kah kanë shkuar. Falë Zotit nuk na zbuluan se ishim aty.

Unë në dorë e kisha një bombë dore. Bindja ime ishte të mos bie në dorë të tyre, sepse e dija se çka të gjen dhe se unë më parë isha i përndjekur dhe i torturuar nga policia serbe. Me një dorë ia mbaja kokën Shahinit që të mos lëvizë se mos po na hetojnë. Unë shpesh ngritja kokën dhe shihja këmbët e ushtarëve serb se si po lëviznin sepse dushku ende nuk kishte dalë dhe shihej vetëm pjesa e poshtme e trupit. Për fat tonin ata janë tërhequr dhe kanë vendosur kordonin përmbi fshat në kodrën e Shullanit.

Në atë pozitë kemi ndenjur deri në ora 4 pasdreke. Aty dëgjonim shumë të shtëna armësh. Në atë kohë u munduam të afrohemi, përmbi kodër dhe të shohim se çka ka ndodhur. Kemi parë disa ushtarë që bënin roje afër vendit të masakrës. Paramilitarët dhe ushtarët e tjerë serbë kishin hyrë në popullatën e rrethuar dhe i rrihnin, keqtrajtonin dhe i vrisnin para hedhjes në bunar.

Ne shikonim se çka po ndodhte me njerëzit e paarmatosur. Por, disa ushtarë serbë na hetuan dhe shtien drejt nesh. Jemi tërhequr dhe jemi fshehur duke u shtrirë në një pusëtë me baltë e me borë. Në ora 7 në mbrëmje ushtarët serbë filluan t'i djegin shtëpitë e fshatit. Në atë moment kemi dëgjuar një detonim të fortë. Nuk dinim se çka po ndodhte. Tërë natën kemi kaluar në mal me Shahinin. Në mëngjes po ndiejmë një erë të keqe që kundërmonte. E shohim fshatin e djegur në tërësi. Shkuam të vendi ku më parë i kishin ekzekutuar, hedhur në puse bashkëfshatarët tanë, në mesin e tyre edhe vëllanë tim, Minahun 16 vjeçar. Gjeta disa gjurmë të vëllait tim, orën, dorëzën e tij, një shishe që e merrte me ujë e disa pjesë të rrobave që i njihja. Sot ato edhe i ruaj në shtëpinë time. Aty hasëm në shumë gjurmë të kimit, fillimisht të torturave, pastaj ekzekutimeve. Këtë e dëshmojnë gozhdat e gjetura me xhak. Pastaj ata pas keqtrajtimit dhe torturave të shumta i kanë ekzekutuar ata persona që ishin të rrethuar, këtë e dëshmojnë edhe gëzhojat e fishekëve të gjetur në vendin e ngjarjes. Pas kësaj i hedhin në dy puse që kishin qenë të hapura më herët për ujë. Pasi i hedhin në ujë i minojnë me qëllim që të humbin gjurmët. Nga detonimi i fortë pamë se në një lis që kishte rënë ndërmjet dy puseve kishte copëza të mishit të njerëzve, pjesë të rrobave që ishin shpërndarë gjatë miniminit. Askush nuk i ka parë momentet e hedhjes së kufomave në puse. Unë kisha parë vetëm grumbujt e njerëzve të rrethuar dhe forcat serbe që i keqtrajtonin dhe kisha ndier detonimin e fuqishëm. Më pastaj pothuajse i pari kam shkuar në vendin ku është bërë masakra.

Mendonim se vetëm ne kemi shpëtuar. Kemi dalë dhe kemi kontrolluar pjesën e Shullanit, ku më parë ishte pjesa dërrmuese e popullatës, mendonim se mos po e gjejmë dikë që ka nevojë për ndonjë ndihmë. Aty takojmë Azizin dhe Nebiun që kishin shpëtuar. Prej tyre jemi informuar për vrasjet e popullatës, por nuk e dinim se sa dhe kush janë vrarë.

Kemi shkuar në lagjen Dashec që të pushojmë, sepse nuk kishim fjetur një kohë të gjatë, ishim të lodhur e të rraskapitur. Duke shkuar në lagjen Dashec takuam katër bashkëfshatarë tanë Naserin, Osmanin, Nebiun dhe Sherifin. Kishin shpëtuar edhe tre fqinjë të tjerë që ishin fshehur në një hambar – Nexhati, Remziu dhe Bislimi. Kishim hasur në tri kufoma që ishin vrarë dhe nuk ishin hedhur në puse. Mendonim që ato t'i varrosnim që të mos i hanë egërsirat. Natën e kemi kaluar në një shtëpi. Në mëngjes shohim se kishte ardhur edhe një tog vëzhgues i Brigadës së UÇK-së. Ne nuk e dinim se cilët janë. Më pastaj donim që dikush prej nesh të shkojë në Kaçanik dhe të interesohet për familjarët tanë që ishin detyruar të shkonin në Kaçanik. Në i ri i quajtur Çeliku ishte fshehur në minare të xhamisë së fshatit dhe kishte parë disa ngjarje rrëqethëse. Ai dy ditë nuk kishte mundur të fliste, sepse ishte i tmerruar nga skenat makabre të masakrës. Kur e gjeta unë pallton e babait tim, mendoja se e kanë ekzekutuar, por ai në atë moment foli dhe më tregoi se babanë tim paramilitarët e kanë marrë në kamion dhe e kanë dërguar në Kaçanik, e disa edhe i kishin dërguar në stacionin policor në Ferizaj.

Momentet më të vështira për mua dhe të tjerët ishte kur është bërë zhvarrosja e kufomave me ndihmën e një organizate humanitare nga Norvegjia që udhëhiqej nga humanisti Josef Martinsen, që më vonë e shkroi edhe librin “Puset e vdekjes”. Aty pashë se kufomat ishin të copëtuara, vështirë identifikoheshin. Unë arrita të identifikoj trupin e vëllait tim që ishte i copëtuar dhe pa kokë. Ashtu edhe pa kokë është varrosur. Aty gjetëm edhe pjesë të rrobave, këpucëve dhe disa gjësende të tjera, të cilat i morën nëpunësit e UNMIK-t dhe më nuk dihet asgjë për ato dëshmi se ku janë. Një njërin pus në thellësi prej 8 metrash u gjetën 16 viktima, ndërsa në atë tjetrin janë gjetur 6 viktima. Gjithsej 22 kufoma të hedhura në puse dhe tri kufoma të gjetura jo larg vendit të masakrës.

Intervistoi: Jusuf Osmani

KUR HESHTININ ARMËT E PARAMILITARËVE, DËGJOHESHIN BRITMAT E NJERËZVE



Kajtaz Xhemë Paçarizi, i mbijetuar i masakrës së Burimit (Joviqit)

Kajtaz Xhemë Paçarizi, i lindur më 7 shtator 1947 në fshatin Dragobil.

Burimi (Joviqi) shtrihet në pjesën jugperëndimore të Malishevës. Në vendin Vrella e Mëhillit, të këtij vendbanimi më 31 mars 1999, janë pushkatuar e masakruar 36 persona: 13 nga Dragobili, 20 nga Astrazubi, 1 nga Studençani, 1 nga Samadraxha dhe 1 nga Semetishti i Therandës.

Data e 31 marsit të vitit 1999 ishin momente shumë të vështira të jetës sime dhe të gjithë njerëzve që ndodheshin aty. Dëgjoja britmat e fëmijve dhe grave që nuk ndaleshin. Unë me djalim tim, Arsimin, jo larg vendit të masakrës, vendosëm në mes tre shkëmbinjve të mëdhenj, që ishin rreth një metër e gjysmë e gjerë dhe rreth një metër e thellë. Larg vendit të masakrës ishim rreth 70 metra.

Pjesa më e madhe e familjes sime ishin të “Vrella e Mëhillit”. Atje po zhvillohej një dramë e vërtetë. Nuk e dinin saktësisht se çfarë po ndodhte. Kur heshtnin armët e paramilitarëve, dëgjoeshin britmat e njerëzve që dëgjoeshin te “Vrella”. Po përpiqesha që të vëzhgoja gjendjen nga ajo pozitë. Nganjëherë ngihesha në këmbë dhe shikoja popullatën që ishin bërë të gjithë tok në lëndinë, ndërsa ushtria vrastare serbe, me autoblanda dhe me pizgaverë gjuanin mbi kokat e tyre.

Në ora 14, tri autoblanda u ndalën në tri pozicione, kurse popullata mbeti në mesin e tyre. Ata filluan të terrorizojnë njerëzit. Dëgjoeshin britmat e tyre, duke fyer dhe sharë. Në mesin e tyre dëgjohej zëri i një personi i quajtur Marko. Ai ishte shumë agresiv dhe i fyente popullatën duke iu thënë “Ajde shiptari, shta çekate, majku vam...”, që në shqip do të thotë “Hajde shqiptarë, çka prisni, hë nënë...”.

Ata filluan t’u kërkonin njerëzve para, por edhe gjësende prej ari. Në ato momente filluan t’i ndajnë burrat nga gratë dhe fëmijët.

Gratë dhe fëmijët i largonin kah livadhi, kurse burrat afër një muri aty mbi livadh. Derisa i ndanin me dhunë burrat prej grave dhe fëmijëve, përpos që i plaçkitnin popullatën, ata bënëin provokime ndër më të rëndat, si: “do t’ua heqim kokat me këto thika”, pastaj “Ju po e kërkoni Shqipërinë e Madhe, tash do ta keni”, “Këtu është Serbi”, “Ku e keni NATO-n”, “Tani do t’u shpëtojë NATO-ja”, “Ku e keni Adem Jasharin?!”, “Ku e keni UÇK-në?!”, e shumë provokime të tjera të këtij lloji. Burrat mbetën aty, ndërsa gratë, fëmijët dhe disa pleq me forcë i detyruan të ecin rrugës për në fshatin Gurbardh.

Në atë pjesë të lëndinës, ku unë po shikoja prej shkëmbinjve ku qëndroja me djalin, shikoja se si një paramilitar me rroba të zeza i ka rënë më kondak të automatikut në kokë një burri i cili mbante plisin e bardhë dhe e rrëzoi përtokë. Kur i larguan fëmijët, gratë dhe pleqtë, rreth dyqind metra larg “Vrellës”, ata me forcë i morën të gjithë burrat e tubuar te muri i gurëve afër livadhit dhe i larguan në drejtim të burimit të ujit “Vrellës së Mëhillit”. Pas pak minutave u dëgjuan dy rafalë të automatikut, po ashtu u dëgjua edhe një britmë e madhe dhe gjëmime të njerëzve që i pushkatonin. Pastaj u dëgjua edhe një rafal tjetër i automatikut dhe u ndalën britmat dhe gjënimet e njerëzve të vrarë nga forcat serbe.

Pas kryerjes së këtij krimi, ata filluan të vidhnin traktorë dhe makina, orendi dhe gjësende të tjera me vlerë nga shtëpitë e shqiptarëve. Pasi i plaçkitën, ua vinin flakën shtëpive. Unë dhe djali që ndodheshim, rrinim të fshehur pa guxuar të lëviznim fare.

Pasi kryen vrasjet, vjedhjet dhe djegiet, forcat barbare serbe me gjithë arsenalin e tyre luftarak filluan tërheqjen prej vendit të krimit dhe u stacionuan në “Lagjen e Zymerajve”. Prapa, kishin lënë njerëz të pafajshëm të vrarë e të masakruar: pleq, gra, fëmijë etj., që nuk kishin mundësi të iknin këtyre pyjeve të dendura plot me drunj dhe me shkëmbinj të thepisur.

Rreth orës 19:00 unë dola nga vendi i fshehur për të shkuar në vendin ku kishte qëndruar popullata për të gjetur ushqim dhe batanije për djalin dhe për vete sepse kishim të ftohtë. U nisa teposhtë lëndinës me një kujdes të shtuar. Gjeta pak bukë në një shporet dhe disa biskota, mora një batanije dhe u ktheva të djali në mes të shkëmbinjve.

Kah mesnata, ishte kohë me shi. Mendoja të flija. Por, në një moment dëgjova se dikush po lëviz, e zgjova djalin dhe i tregova që të ketë kujdes, sepse u frikësova se janë pjesëtarë të forcave serbe. Por, dëgjova një zë që më thirri në emër “o Kajtaz!”, kuptova se ishte vëllai im Xhaferi që kishte ardhur se e dinte se ku jam strehuar. Xhaferi ishte

së bashku me katër shokë të tjerë që unë i njihja. U tregova për masakrën e bërë nga forcat serbe. Unë me Isuf Morinën u nisëm te vendi ku ishte bërë masakra. Të tjerët edhe vëllai Xhaferi mbetën te shkëmbinjte ku ishte djali im Arsimi.

Vendosëm me Isufin që me dritën e shkrepësës, të cilën e drejtonim kah fytyrat e kufomave, do të arrinim të identifikonim personat e pushkatuar. E identifikova edhe vëllanë e vrarë, Behramin. Filluam në ato kushte t'i identifikojmë viktimat. Me lehtësi i identifikonim viktimat që i njihnim dhe ishin nga fshati Dragobil dhe Astrazub, por nuk mundëm të identifikonim viktimat që ishin nga fshatrat e komunës së Therandës, të cilët kishin qenë mysafirë të disa familje në Dragobil. I numëruam ishin gjithsej 42 kufoma, prej të cilave i identifikuam 32 kufoma. Të vrarët ishin prej moshës 15 deri 80 vjeçare.

Pas pak minutave kemi dëgjuar të shtëna armësh, në drejtim të “Vrellës së Mëhillit”. Ishin rikthyer forcat serbe në vendin e krimit. Dy autoblanda me ushtarë zbarkuan në lëndinën para Vrellës, në vendin ku qëndronin kufomat e shtrira përtokë.

Ishte kohë me riga shiu, pas orës 4, sa kishte filluar të zbardhte drita. Unë vëzhgoja nga lëndina e “Vrellës së Mëhillit” për të parë çka do të bënin me kufomat. Ata sollën me vete një traktor me rimorkio. Forcat serbe ngarkuan kufomat në rimorkion e traktorit, dhe u nisën në drejtim të lagjes së Zymerajve. Ata filluan t'i zbresin kufomat, t'u linin armë afër dhe t'i incizonin me kamera.

Këtë e bënin me qëllim që të mashtronin opinionin ndërkombëtar, gjoja se këta njerëz nuk janë ekzekutuar në një vend dhe pa gjyq, por këta janë vrarë duke luftuar në vijën e frontit. I dëgjoja duke folur në gjuhën serbe “Ajde sada počni snimaj”, që në shqip thoshin “Hajde tani, incizo”, “Ostavi oružje još bliže kod ruke i sada snimaj” (Lëre armën më afër dorës e tani incizo). Me këtë u binda edhe njëherë se ata po bënin incizimin, duke u munduar që të fshihnin krimin ndaj popullatës së pambrojtur.

Në fund po theksoj se unë me djalin tim, Arsimin, prej datës 31 mars e deri më 17 prill 1999 kam qëndruar në mesin e shkëmbinjve dhe kam parë shumë ngjarje makabre që kanë bërë forcat paramilitare serbe ndaj popullatës civile shqiptare të pambrojtur.

Intervistoi: Jusuf Osmani

KOKA E VËLLAIT TIM TË VRARË ISHTE E MBËSHTETUR MBI MUA



Leutrim Caraku i mbijetuar i Masakrës së Poklekut të Vjetër

Leutrim Caraku nga Fshati Dobroshevc, komuna e Drenasit i lindur më 19.08.1989.

Më 17 prill 1999, Leutrimi në këtë masakër ka humbur nënën me dy vëllezrit dhe gruan e axhës.

Siç rrëfen ai një ditë para se të ndodhte masakra më 16 prill 1999, babai i tij Ejupi i kishte sjellë te dajat, meqë fshati i tyre ishte i rrethuar me forca serbe dhe ishin përherë në rrezik. Në mbrëmje u vendosëm te dajat, në familjen Muçolli të Poklekut të Vjetër, kurse të nesërmen me shumë nga familjarët e kësaj familjeje dhe të strehuar të tjerë nga familja Elshani e Korroticës së Ulët, herët në mëngjes jemi nisur për në Glllogoc me shpresë që do të jemi më larg rrezikut nga forcat serbe. Ka qenë kohë e ftohtë dhe vazhdimisht binte shi. Kur kemi mbërritur te Xhamia e Glllogocit, na kanë ndalë në rrugë dy xhipa me policë serbë, të cilët na kanë urdhëruar për t'u kthyer sërish në fshat dhe madje vazhdimisht gjaunin me armë anash neve. Pasi jemi kthyer përsëri në fshatin Poklek i Vjetër, kanë ardhur dy persona të armatosur të cilët kanë folur më Sinan Muçollin dhe Ymer Elshanin dhe i kanë urdhëruar të dalin krejt jashtë shtëpisë. Pastaj ne na kanë urdhëruar prapë të hyjmë brenda në shtëpi e Sinanin dhe Imerin i kanë marrë me vete dhe i kanë dërguar më poshtë shtëpisë dikund 200 apo 300 metra dhe nuk i kemi parë më, vetëm kur kemi dëgjuar disa krisma dhe e ditëm që i kanë vrarë. Rreth orës 4-5 pasdite nga jashtë kanë filluar të gjuajnë dhe ne e kemi pasur rrezik të dalim jashtë. Ndërkohë ka ardhur një polic i armatosur dhe na ka urdhëruar ta mbyllim derën edhe menjëherë e ka hedhur një bombë me gaz. Në ato momente Elhemja (Muçolli) e ka thyer dritaren edhe ka dalë jashtë. Shumë shpejt, pa u vonuar shumë, ka hyrë brenda dhe njëherë dhe ka gjuajtur tjetër bombë dhe aty e kam

ndier që kur ka krisur bomba e kam parë që m'u kanë gjuajtur shumë trupa përmbi mua. Më kish pas humbur vetëdija. Mbas një kohe më erdhi vetëdija. Koka e vëllait tim të vrarë ishte e mbështetur në mua. Plumbi e kishte marrë në kokë. Unë nuk guxoja të lëvizja, sepse policët ishin brenda, i shqelmonin kufomat për të kuptuar a ka mbetur ndonjë i gjallë. Kanë gjuajtur përsëri derisa ua ka marrë mendja që i kanë mbytur krejt dhe pastaj janë larguar. Lumnija është ngritur e para dhe ka thanë "kush është gjallë çonu!" Me Arbenitën 4 vjeçe, jam çuar unë. Ka qenë djali i Elmi Muqollit i plagosur dhe jemi munduar ta nxjerrim nën kufoma, po nuk kemi mundur. Përveç Elhemes që ka dalë më herët, kemi dalë edhe pesë veta. E di që ka qenë gjallë edhe djali i Xhavitit (Muqollit) 2 vjeç dhe gruaja e Xhavitit ka qenë e plagosur në këmbë. Të plagosurit lypnin ujë, më kujtohet që njëri prej tyre deri te dera ka shkuar zhagas duke u munduar të dalë. Më kujtohet aty ku ka rënë bomba kam parë fëmijët me tru të shkapërderdhur. Lumja mundohej t'i kapte e t'i këqyr a kanë shpëtuar. Kur e kam kapur unë vëllanë tim gjysmën e qafës e ka pasur të hequr dhe jam tmerruar. Kur kemi dalë nga dhoma e masakrës, jemi ngjitur në katin e dytë e pastaj në të tretin të shtëpisë për të shikuar se mos janë ende serbët diku afër. Atëherë kam filluar ta kërkoj nënën që ta di se ku janë. Nga kati i tretë i kemi parë policët që po vinin prapë dhe ne kemi dalë, jemi fshehur mbrapa shtëpisë, unë, Lumja dhe Arbenita dhe pastaj kemi ikur dhe kur kemi shkuar në një shtëpi, u kemi treguar se ende ka të gjallë që kanë mbetur në shtëpi ku ka ndodhur masakra. Pastaj siç kemi marrë veshë më vonë, policët janë kthyer prapë dhe ua kanë vënë zjarrin kufomave për të zhdukur çdo gjurmë. Nga familja ime vetëm babai më ka shpëtuar, ngase ai nuk ka qenë aty se ka qenë ushtar, ndërsa nëna Bahtija me dy vëllezërit Hasanin e Besartin dhe gruaja e axhës, Mihrija kanë mbetur të vrarë. Unë në atë kohë kam qenë 9 vjeçar, përfundon rrëfimin Leutrim Carraku. Dëshmitarët që kanë shpëtuar nga masakra janë gjashtë: Lumnije Muqolli, Elhame Muqolli, Arbenita Muqolli, Ramadan Kluna, Hysen Kluna dhe unë Leutrim Caraku.

Intervistoi: Izet Avdyli

MË KANË PRERË NË FYT, NË BALLË E NË KËMBË



Naim Karaçica, i mbijetuar

Më 13 prill 1999, rreth orës 11:00, përderisa isha bashkë me disa të tjerë rrugës për t'u dërguar bukë familjarëve që kishin mbetur të ngujuar në Drenas, forcat serbe na dalin përpara dhe shtien në drejtim tonin. Nga këto të shtëna, tre familjarë të mi mbesin të vrarë në vend, Kadri Karaçica, Xhevdet Karaçica dhe Avdi Karaçica. Ndërsa unë u plagosa në këmbë. Forcat serbe më kanë tërhequr zhagas, më kanë marrë me vete dhe më kanë torturuar. Më kanë dërguar në Likoshan, ku jam torturuar mizorisht nga një kriminel rom me emrin Elez Alia, për të cilin kam dëshmuar edhe tek Eulex-i, UNMIK-u dhe çdokund tjetër.

Gjatë torturave, më patën thënë se do të ma bëjnë sikurse familjes Ahmeti në Likoshan. Romi ka ditur shqip, ka qenë nga Fushë Kosova. Më kanë kërcënuar edhe me familje, për të cilën nuk kisha asnjë dijeni. Në fund më kanë dërguar në një shtëpi në Qirez, dhe aty kam përjetuar torturat më të tmerrshme, nuk kanë lënë gjë pa më bërë. Më kanë akuzuar për terrorizëm, kërkonin që ta pranoja se isha terrorist, por nuk kam pranuar asnjëherë. Elez Alija dhe një tjetër që dukej se ishte rus pasi gjuhën e fliste më ndryshe dhe kishte shkronja të tjera në uniformë, më kanë rrahur aq shumë sa e kam humbur vetëdijen.

Më kanë prerë në fyt, në ballë e në këmbë. Pas kësaj u lodha aq shumë sa e pranova para Elez Alisë dhe personit tjetër që ishte me të, se unë isha terrorist – pa qenë. Më pas erdhën edhe të tjerë, gradat e të cilëve nuk i dija e nuk i kuptoja çfarë pozitash mbanin dhe më flisnin në gjuhën serbe. U thashë që nuk kuptoj serbisht, m'u drejtuan se si nuk kupton dhe u detyruan të ma kthenin në shqip. Më thanë se ti Naim Karaçica je terrorist. Më thanë se janë edhe tre terroristë. U thashë se nuk është e vërtetë. Ne ishim të ngarkuar me bukë për më shumë se 50 familjarë dhe asnjë nuk është terrorist. Ata insistonin për terrorizëm si dhe më pyesnin pse e kisha pranuar njëherë që isha terrorist. U thashë

se isha i detyruar: “shihni dorën s’po e lëvizi, këmbën të plagosur e plagën të palidhur”. Në ato momente u jam drejtuar, ‘a keni Zot, ju a keni fëmijë’, por dikush shpejt ka ardhur dhe më ka mëshuar shqelm dhe pastaj janë larguar. Aty e kam parë një litar dhe një drapër të varur në derë dhe kam shkuar zhag sepse mendoja ta vras veten e të shpëtoj nga këto tortura, mirëpo ky oficeri që më pyeste më pa dhe m’i largoi ato pa më thënë ndonjë fjalë.

Kur shkoi ai, e kam dëgjuar një britmë dhe menjëherë tek unë erdhën Elez Alija së bashku me atë personin tjetër. Më kanë sharë me nënë, më kanë thënë se “ti po din me dredh e me zhdredh, neve na the diçka tjetër, kurse atyre tjetër gjë”. U thashë se ju më keni shtyrë me zor të them ashtu, jo me dashjen time. Atëherë sërish kanë filluar torturat në mu saqë më kanë bërë të humbas prapë vetëdijen. Pas një kohe, e kam parë veten në vend tjetër në Qirez. Më kanë vënë në një karrocë e me kanë qitur para tankeve dhe kur më ka ardhur vetëdija kam dëgjuar tek thoshin për mua që të më shkelin me tanke. Për një moment kam menduar dhe jam pajtuar që me tanke të më mbysin shpejt dhe do të ishte më mirë sepse nuk do të hiqja më nga torturat. Jam bërë si i vdekur, e doja të më shkelnin.

Madje, në ato momente UÇK-ja kishte sulmuar në Qirez një patrollë serbe, dhe këta kishin marrë aksion për të shkuar vrap atje, ndërsa mua më kanë lënë aty me ushtarë të tjerë. Ç’është e vërteta, një ushtar të ri serb ma kanë lënë te kryet dhe ai nuk dinte mirë shqip, ndërsa unë s’kam ditur mirë serbisht. Më ka ofruar ujë për të pirë. Kur e piva ujin u forcova. Nuk janë vonuar shumë, kur janë kthyer, sërish me tortura e me thikë luanin si dëshironin në trupin tim. Këmbe më nuk më ka funksionuar për shkak të plumbit. Elez Alia dhe të tjerët që ishin me të, çdo herë më kanë kapur për këmbë të plagosur e më kanë ngrehur zhag, e më kanë gjuajtur në kamion.

Pas një kohe, më kanë hipur në një kamion dhe më kanë nisur rrugës për në Skënderaj. Mbërritëm në fshatin Polac, aty vazhduan torturat duke mos lënë asnjë metodë pa përdorur në trupin tim. Elez Alija në një moment tha: “e kam rendin me ta heqë kryet”. I thashë hiqe dhe ia zgjata kryet. Ma vendosi thikën te qafa, por pastaj u largua. Më vonë e pashë veten në Skenderaj te një kryqëzim, aty i kam parë dy shqiptarë – njëri rreth 55 vjeçar me plis në kokë dhe një djalë i ri. Plaku erdhi tek unë e më pyeti se kush jam unë, unë e pyeta a po më njeh, edhe i thashë s’po ju vjen marre...më kanë gjuajtur në asfalt me ç’rast e kam humbur vetëdijen. Dikush më pa nga ndërtesat aty pari se jam gjallë, mjekët kishin qenë aty në Skenderaj. Bedri Shala (mjek) me disa të tjerë më

ndihmojnë dhe më dërgojnë në spital, unë s'u besoja, mendoja se janë serbë e s'u tregoja kush jam fillimisht, edhe pse këta flisnin shqip. Nuk kalon gjysmë ore, dikush i lajmëron serbët se jam gjallë dhe e kanë marrë shqiptarët. Serbët në ato momente marrin aksion për të më marrë mua nga spitali. Bedri Shala u thotë atyre, "ky njeri nuk ka shpëtim më", ndërsa ata ia kthejnë: "mos pastë shpëtim na e lë neve" dhe e dërgojmë për Mitrovicë, në spitalin që gjendej në veri. Bedriu u thotë: "në rregull, vij unë dhe Zeneli (shoferi) me makinën tonë". Bedriun e rrahin në ato momente dhe mua më vinte keq që për shkak timin i ndodhi ajo. Megjithatë, Bedriu ishte shumë i vendosur. Ne shkuam në Mitrovicë. Atje kishte ushtarë të rinj, të cilët mendonin se mos ishte ndonjë serb i plagosur. Kur e kuptuan se kush jam, provokonin non stop me armë.

Pas 2-3 orësh, vjen një mjek dhe kërkon që të më dërgojnë në sallë të operimit. Mjekët ishin të armatosur, dhe vetëm Zenelin (shoferin) e lejojnë të hyjë brenda ku isha unë. Më thanë: "tash ta rregullojmë këmbën" dhe kanë filluar me brumashinë, ashtu pa e mpirë, pa asgjë. Mua më lëshoi fuqia, dhe sipas Zenelit, mjekët kishin pasë thënë "ky nuk ka asgjë, merreni gjuajeni". Më marrin dhe më dërgojnë për në Skenderaj. Aty më dërgojnë në spital të Skenderajt. Natën s'kishte rrymë, më japin infuzion dhe me shumë vështirësi më gjejnë venat. Të nesërmen kthjellem pak. Riza Malaj, një mjek, në ndërkohë vjen dhe kërkon që t'mi shohë plagët. Atij kurrë nuk do t'ia harroj, më ka ndihmuar rreth plagëve për t'u mos u infektuar më shumë.

Mirëpo, për një moment, në atë mëngjes vijnë serbët dhe i kërce-nojnë mjekët duke u thënë: "po qe se ik ky, ju të gjithë do të vriteni". Bedri Shala më tregon për këtë dhe më thotë se nëse ndodh diçka me ty, ne të gjithë do të ekzekutohemi, dhe për këtë i vinte shumë keq. Ua dhashë fjalën se kurrë në jetë nuk do t'i rrezikojta ata, mua le të më vrasin.

Një ditë prej ditësh, serbët siç ishin duke pirë kafe, vriten mes veti. U shkrepën ngapak me disa kerre. Kur erdhi Besimi i Klinës (mjek), më thotë: "Karaçicë, më doket do me shpëtu", i thashë: "o doktor, le të shpëtojnë të tjerët, se unë jam veç një, nuk çoj shumë peshë". Më tha: "shuj mos e thuaj këtë gjë, sepse ne po mundohemi shumë për ty". Këta, d.m.th doktorët aty, kishin marrë vesh nga populli që i kisha 5 anëtarë të familjes të humbur dhe e dinin gjithë historinë time, e mundoheshin me çdo kusht që të më shpëtonin mua.

Momentin që forcat serbe u larguan dhe hyri NATO-ja me tanke, ne u frikësuan sërish mos po ktheheshin serbët, mirëpo Bedri Shala më tha që tash NATO-ja ka hyrë dhe s'ka arsye për frikë. Atë natë fjeta aty

i qetë pas shumë netëve pa gjumë. Të nesërmen e pashë një dhëndër timin Brahim Gjokaj, i cili më tregon vetëm për ata tre familjarët që kishin mbetur të vrarë, mirëpo jo edhe për të tjerët të zhdukur, si babai, axha dhe vëllai. Vëllai kishte qenë në burg dhe pastaj e kishin dërguar për shërim në Angli. Me traktor nisem për në shtëpi.

Më vonë e kuptova se nga familja jonë kishin mbetur të vrarë 5 anëtarë, Shefqet Karaqica (babai), Sadik Karaqica (axha), Kadri Karaqica (djali i axhës), Avdi Karaqica (djali i axhës) Xhevdet Karaqica (djali i axhës).

Dy shokë të mi të nesërmen bien në mina, Afrim Gjoka ushtar i UÇK-së, Mirvetja – mbesa, dhe tre të tjerë mbesin të plagosur.

Intervistoi: Ramë Manaj

EKZEKUTIMI KA NDODHUR RRETH ORËS 7:00 TË MËNGJESIT

Naim Makolli i mbijetuar i Masakrës së Çikatovës së Vjetër në vendin e quajtur Shavarina

Naim Hajdin Makolli u lind më 17.09.1974 në Çikatovë të Vjetër, komuna Gllogoc.

Në rrëfimin e tij të datës 13.06.2022 ai tregon për masakrën që ka ndodhur më 17 prill 1999 në Çikatovë të Vjetër të Gllogocit (Drenas), afër minierës së Fabrikës së Feronikelit në vendin e quajtur Shavarina ku u ekzekutuan dhjetëra shqiptarë, civilë të nxjerrë me dhunë nga shtëpitë e tyre. Sipas Naim Makollit, ai së bashku me familjen e tij dhe disa familje të lagjes Makolli nga 21 marsi i viti 1999 janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre dhe të vendosën në lagjen Morina, përkatësisht shtëpitë e Zenel Morinës dhe Zymer Morinës në Çikatovë të Vjetër, për shkak të vendosjes së forcave serbe në shtëpitë e tyre dhe në objektin e shkollës fillore në Çikatovë. Pas vendosjes në këto shtëpi, ai thotë se disa herë ushtarë të Serbisë kanë bërë vizita rutinore për çka gjithmonë kanë qëndruar në ankth të shqetësuar se mund t'u ndodhë më e keqja. Dhe kjo e keqe erdhi siç thotë Naimi më 17 prill 1999, kur në orët e hershme të mëngjesit diku nga ora 6:00 forca paramilitare të armatosur, me pamje frikësuese me shirita të kuq duke shtënë vazhdimisht në ajër kanë hyrë në oborre të Çikatovës. Ata hynë edhe në familjen e Zenel e Zymer Morinës ku ishim të strehuar. Gjithçka u zhvillua me një shpejtësi të madhe si duket ishte përgatitur më herët ky plan nga ushtarët serbë që na kishin vizituar më herët. Paramilitarët silleshin si të ishin të droguar. Ka qenë ditë e zyrtë dhe vazhdimisht binte shi. Shtëpitë i digjnin me "pishtole" të cilat kishin një masë ndezëse që sapo përplasej në muret e shtëpive dilte flaka menjëherë. Kur e dogjën shtëpinë ku ishim ne, kam hyrë mes flakëve në podrum dhe kam marrë nga djepi, që të mos digjet, djalin e vëllait që kishte një vit e gjysmë. Pesë meshkuj sa ishim, na ndanë prej grave e fëmijëve dhe nën tytat e armëve na detyruan të dalim në rrugë. Aty ishin më se 60 veta të tjerë dhe na bënë kolonë duke na urdhëruar të ecim duke na kërcënuar të mos shikojmë anash. Ata qëndronin anash të armatosur që në rast të ndonjë përpjekjeje për shmangie nga kolona të na vrisnin. Derisa na dërguan te vendi i ekzekutimit vazhdimisht kanë gjuajtur me armë dhe këndonin këngë serbe duke na kërcënuar të këndonim edhe ne. Kur mbërrimë te vendi i ekzekutimit menjëherë na renditen për

pushkatim. Ekzekutimi ka ndodhë rreth orës 7:00 të mëngjesit. Gjithçka ka ndodhur me shpejtësi. E kam dëgjuar komandën „strelaj, baci bombe” dhe kanë shtënë me rafalë mbi ne. Jam rrëzuar për tokë dhe përmbi mu kanë qenë të vrarët, por një kohë nuk kam guxuar as të lëviz e as të shikoj nëse ka shpëtuar dikush. Kam vërejtur se jam plagosur në këmbën e majtë. Pas ekzekutimit forcat serbe u larguan menjëherë. Kanë qenë shumë të vrarë, por unë kam njohur Zenel Sylë Morinen nga Çikatova e Vjetër, ndërsa të plagosur ishin mësuesi Tahir Makolli në këmbë dhe Hajrullah Zymer Morina në dorë, etj. Ndërkohë kam ikur në malin e Çikatovës, pastaj kam vazhduar malit të Kamenicës, nëpër Gllobar dhe pas dy orësh kam mbërritur në Çikatovë të Re ku takova familjen time të cilët u gëzuan shumë kur më panë, ngase më dinin për të vdekur. Ndonëse isha i plagosur, ndieja dhimbje, po këmbën e kisha ende të nxehtë e lëvizja pa pushuar fare. Kur kam pushuar pak kanë filluar dhimbjet, ngase gjaku ishte terur. Më kanë dërguar në ambulancën e Nënë Terezës që ishte në Çikatovë të Re dhe kam marrë ndihmën e parë nga motra Nafije Morina që ishte po ashtu nga fshati im. Aty m’i kanë pastruar plagët pastaj pjesën tjetër të shërimit e kam vazhduar në Terdevc te mjeku Gani Halilaj. Aty më kanë ndihmuar edhe teknikët Çerkin Berisha, Hazir Elshani dhe Sherife Demaku. Gjatë luftës kemi qëndruar në Berishë dhe Petrovë të Shtimes, ku ka qenë një spital në të cilin jemi shëruar ne të plagosurit.

Intervistoi: Abaz Makolli

BACIT BANUSH IA KISHIN HEQUR KOKËN ME SËPATË



Ramë Nusret Shabani i mbijetuar i Masakrës së Reçakut

Në mëngjes rreth orës 6:30 të 15 janarit 1999 fshati ka filluar të granatohet nga artileria e ushtrisë serbe prej vendit Podi i Gështenjave, prej Pishave dhe Qestës. Në atë kohë më ka thirrur nëna dhe më ka treguar se forcat policore serbe kanë filluar të gjuajnë me të madhe. E pyeta a po gjuajnë me armë të lehta apo të rënda, më tha të rënda. I thashë hyr brenda se po të rrok ndonjë granatë. Nëna shkoi dhe unë mendoja se si të veprojmë dhe çka të bëjmë. Ka hyrë, por prapë ka ardhur rreth orës 7:00 dhe më ka thënë: “Ramë puna nuk është mirë”. Jam çuar dhe kam dalë në oborr. Jam takuar me bacin Sadik Osmani. Baca Sadik e ka pasur një telefon dore. I kemi thirrur e njoftuar verifikuesit e OSEB-se që kanë qenë në Ferizaj. Ata kanë ardhur menjëherë dhe kanë arritur deri në Shtime. Na kanë telefonuar dhe kanë thënë se nuk mund të hyjnë në fshat se tërë fshati është i rrethuar nga forcat serbe. Granatimet vazhdonin me të madhe nga të gjitha anët. Kemi shkuar me familje dhe jemi strehuar në podrumin e shtëpisë së Sadik Osmanit, sepse mali ishte më afër. Aty u strehuam rreth 60 persona, si fëmijë, gra, burra, pleq etj. Në burrat ishim strehuar në stallën e bagëtive, ndërsa gratë dhe fëmijët në podrum. Ka ardhur Ramë Bajrami. Unë, Rama dhe Burimi i bacës Adem që në atë kohë ka qenë 15 vjet, si dhe kisha marrë vajzën të dal e të ik. Prej granatimeve të mëdha nuk kam mundur të kaloj gardhin. Jam kthyer me vajzën dhe kam shkuar te gratë ku kam hyrë edhe vetë aty. Ndërkohë pas granatimeve kanë ardhur disa milicë dhe ushtarë serbë dhe kanë hyrë në oborr, së pari kanë shkuar te stalla dhe i kanë qitur të gjithë në oborr. Kanë filluar të na plaçkitin, kanë marrë krejt çka kemi pasur dhe disave edhe na kanë rrahur. Më pastaj kanë shkuar në podrum te gratë.

Fillimisht hyjnë në ahur rreth orës 13:00 dhe i marrin ata që ishin strehuar dhe i nxjerrin në oborr. Burrat që i nxorën përjashta, i detyruan

që të shtrihen përtokë dhe kush e ngrite kokën e goditnin me dru në kokë. Ua morën dokumentet që kishin.

Më pastaj kanë ardhur në podrum ku isha unë prej meshkujve me bacin Sadik dhe Mufailin. Na rrahën gjatë marrjes nga bodrumi dhe në oborr. Më kanë marrë mua, bacën Sadik, Mufailin dhe na kanë shtrirë për toke dhe na kanë rrahur derisa janë lodhur. Më kanë rrahur aq shumë sa që më dëmtuan kokën, kurrizin, e gati çdo pjesë të trupit. Në ato momente më shumë brengosësja për fëmijët e familjen që e kisha aty, por vajzat kushërira, gra të reja etj. që ishin aty si dhe të gjithë të tjerët. Aty ishte edhe bashkëshortja e Adem Ramadanit, e cila ishte shtatzënë dhe pastaj edhe e kanë vrarë. Gjatë asaj kohe kur na keqtrajtojshin, na rrihinin, kam dëgjuar radiolidhjen e komandirit, i cili ka qenë afër meje dhe e kanë pyetur: “A është krye aksioni?”. “Po” i tha. Pyeti sa janë, ai i numëroi se janë 30. Na kanë urdhëruar që të largohemi dhe të shkojmë përpjetë kodrës. Unë fillimisht isha i pari, por mbeta i fundit. Duke shkuar kodrës përpjetë, pashë se nuk po na vinin mbas forcat serbe. Që të jemi më të sigurt, të mos na vrasin grumbull, iu thashë të shpërndahemi. Kur shkojmë aty e shohim se kishim qenë të rrethuar. Jemi ulur unë, baci Adem dhe baci Lutë. Menjëherë ka dalë një polic serb dhe na ka sharë në gjuhën e vet dhe ka thënë se “unë juve po ju pres këtu”. Ka filluar të shtinte me armë. E kanë vrarë Sadikun, Lutën e disa të tjerë që unë vetë i kam parë. Unë kam ikur, kurse ata i ka qëlluar bashkë me tjerë. Më kanë gjuajtur edhe mua. Plumbat më kanë gërvishur nëpër rroba, por kisha pasur fat dhe nuk më kanë qëlluar në trup. Kam ikur dhe jam fshehur në një gropë dhe kam qëndruar disa orë, kurse ata dy i kanë gjuajtur së bashku me të tjerët: Ahmet Ahmetin, Eshref Jakupin, Hakip Rexhepin e të tjerët. Kishte filluar një masakër e tmerrshme. Unë isha larg nga vendi i masakrës së vrasjeve masive rreth 20 metra. Askush që ka qenë aty në vendin e masakrës nuk ka shpëtuar. Të tjerët nuk kanë pasur shanse të ofrohen, sepse të gjitha anët ishin të rrethuara me forcat serbe.

Askush nga të mbijetuarit nuk ka qenë më afër se unë. I kam ndier, unë nuk di as vetë se si shpëtova. Nga frika s’dija çka të bëj. Ishte tmerr i madh. Më shkoi mendja se kanë vdekur pa një pikë uji, s’ka pasur kush t’u jap ndihmë. Pas një kohe, janë tubuar vrasësit dhe janë nisur për në vendin Vrellë, duke kënduar e sharë. Kanë shkuar teposhtë. E kanë djegur Shtabin ku kanë ndenjur pjesëtarët e UÇK-së. Më poshtë e kanë vrarë një gura Zahiden. E ka parë nëna ime. Dy persona e kanë kapur për duar dhe këmbë dhe e kanë hedhur në pizgaver. Unë kam ndenjur aty të vendi i masakrës deri në mbrëmje.

Kur kam shkuar, ç'të shihje, ishte një kasaphane e vërtetë. I kontrollova të gjithë. Ishte tmerr i madh, njerëzit të përgjakur, pa kokë, pjesët e trupit të copëtuara. Aty afër i pashë edhe mjetet që kanë përdorur më parë për rrahje, si stupca e mjete të tjera. Bacit Banush ia kishin hequr kokën me sëpatë, që edhe sot nuk është gjetur koka e tij. Kur e kam parë Ragip Bajramin të vrarë, me dhëmbë të thyer dhe kapuqin e tij në gojë, ia kam hequr nga goja dhe ia kam mbyllur sytë. Sytë ua kam mbyllur edhe të tjerëve. Aty ishin të masakruar edhe të tjerët si baci Nazmi, polari që ia kishin hequr kokën dhe të gjithë të tjerët që jo vetëm që ishin vrarë me armë të llojllojshme, por edhe ishin masakruar. Kur i kam parë të vrarët të masakruar, pa krye, me gjymtyrë dhe pjesë të tjera të masakruara. Mirëpo, Perëndia më ka forcuar dhe i thashë "O Zot ruami mendët!". Kjo masakër që ishte më e madhja ndodhi në vendin "Kodra e Bebushit".

Tërë natën qëndrova në mal, pastaj kam shkuar në shtëpi, në fshat. Në mëngjes u takova me disa bashkëvendës dhe më pyetën se çka ka ndodhur. Iu thashë "mosvet se çka u bë, masakër e vërtetë!". Kemi shkuar poshtë, rreth orës 10:00 kanë ardhur verifikuesit e OSBE-së. Kur fëmijët dhe gratë i kanë parë automjetet e tyre që dukeshin si pishgauer të forcave serbe, kanë filluar të bërtasin dhe të qajnë, duke menduar se janë forcat serbe. Ka ardhur kryesuesi i OSBE-së William Wolker me stafin e tij. Tërë fshati u tubuan. Wolker-i shkonte me rend dhe i shihte kufomat e masakruara. Kur arrin te kufoma e bacës Banush me krye të hequr me sëpatë. Wolker-i bënë me gisht dhe thotë: "Ky është krim kundër njerëzimit". Ai sheh, por edhe të tjetër se janë vrarë edhe fëmijët, pleqtë, plaka, persona që kanë qenë të sëmurë, janë vrarë vetëm se ishin shqiptarë.

Përveç të Kodra e Bebushit, ku janë vrarë e masakruar 29 veta, në Reçak ka pasur edhe masakra të tjera, si te Vrella, të mahalla e Begovite, e Eminovite. Në çdo pjesë të Reçakut ka pasur të vrarë nga 2-4 veta. Gjithsej në Reçak janë vrarë e masakruar 44 persona të moshave dhe gjinive të ndryshme.

Kufomat gjatë natës së 16 janarit janë bartur dhe vendosur në xhami të fshatit. Më pastaj policia ka ardhur e i ka marrë kufomat. Më se një muaj kufomat janë bartur me thasë të najlonit nga një vend në tjetrin, deri më 11 shkurt kur varrosen.

Intervistoi: Jusuf Osmani

NDANI NJA GJASHTË VETË NGA TA DHE PUSHKATONI MENJËHERË



Remzi Makolli

Remzi Makolli i lindur me dt.19.07.1957 në Marec të Prishtinës me nr. Personal 1014524041, shtetësia – Kosovar, personi i cili i ka mbijetuar masakrës së datës 21.04.1999, vendi i ngjarjes: fshati Makoc KK Prishtinë.

Dy javët e para pas fillimit të luftës i kaluam duke ndenjtur nëpër shtëpi të ndryshme në Prishtinë, mirëpo pas dy javësh forcat paramilitare serbe na larguan me forcë. Unë me familjen time shkuam në Marec, në vendin tim të lindjes. Aty qëndruam 2 javë ditë bashkë edhe me refugjat të tjerë. Pas dy javësh forcat serbe na rrethuan nga të katër anët duke na granatuar. Për t’u shmangur, u nisem në drejtim të fshatit Krilevë. U vendosëm në vendin e quajtur “Prroni i Zi” ku qëndruam tërë natën. Ishte shumë ftoftë, binte shi dhe borë. Në mëngjes pa pritur dëgjuam krisma, rafale të ushtrisë serbe. U nisem përroit përpjetë dhe nga të dy anët e rrugës me mijëra njerëz të lodhur dhe rraskapitur ia arritëm të dalim në Zllash. Në mbrëmje vonë, arritëm në Grashticë. Aty e kaluam natën në kushte shumë të vështira, të uritur dhe në kohë të ftohtë. Në mëngjes në ora 8:00 u nisëm në drejtim të Prishtinës. Kur arritëm afër rrugës kryesore Keqekollë Prishtinë, afër lumit i pamë tri kufoma që i kishin vrarë forcat serbe. Aty na dalin disa ushtarë, pjesëtarë të forcave serbe, shumica me maska dhe të ngjyrosur në fytyrë. Fillimisht më kapën mua dhe më kërkuan të holla. M’i morën të gjitha paratë që i pata dhe na urdhëruan të vazhdojmë rrugën në drejtim të Prishtinës. Kur arritëm në Makoc, papritmas erdhën dy xhipa me paramilitarë serbë dhe nga ballkoni i shtëpisë së Sabitit një person me maicë të bardhë ka bërtitur në gjuhën serbe “odvajaj jedno sest od njih i strelajte odmah” (ndani nja gjashtë vetë nga ta dhe pushkatoni

menjëherë). Dhe menjëherë m'u vërsulën mua dhe më kërkuan prapë para, por unë iu thashë në qetësi se të gjitha parat ua kamë dhënë shokëve tuaj që na ndaluan më herët. Në një traktor përpara nesh e zbritën një djalë të ri dhe e zbrazen në drejtim të tij një rafal plumbash dhe ai bie për toke. Në Llukar, aty prapë na ndalin forcat paramilitare serbe, mua prapë më morën të parin dhe më vendosën skaj rruge për të më pushkatuar, pas meje i marrin edhe 18 persona të tjerë dhe na rreshtuan për pushkatim, kurse kolonën e urdhëruan që të vazhdojnë rrugën. Familja ime u detyrua të ecë rrugës, e unë vetëm me dorë nga prapa jam munduar të përshëndetem me ta. Druhesha se do të më vrisnin në sy të familjes. Na mbajtën disa orë dhe tërë kohën pritnim se kur po na vrasin, por më pas na liruan dhe na hipën në një kamion, na dërguan në stacionin e improvizuar të policisë në lagjen Ulpiana, aty na kanë rrahur, maltretuar për disa orë rresht. Në mbrëmjen e 21 prillit, me një kamion na dërguan në periferi të Prishtinës dhe pasi na zbresin nga kamioni, filluan të gjuajnë me rafale plumbash në drejtim tonin, kurse ne mundoheshim të fshihemi pas disa kaçubave për t'i shpëtuar vdekjes. Duke ikur, e kam takuar një person të plagosur rëndë të cilit jam munduar t'i jap ndihmën e parë. E kam marrë duke e bartur në shpinë dhe e kam dërguar në Vranjevc te shkolla "Zenel Hajdini" te një mjek të cilin personi i plagosur e njihte, pasi e dorëzova të plagosurin tek mjeku, unë vazhdova rrugën për Kolovicë, sepse e dija se familja ime mund të ketë shkuar te shtëpia e Abaz Makollit, ashtu siç kam mundur të kalojë nëpërmes oborreve të shtëpive mezi arrita në Kolovicë, ku më në fund arrita te shtëpia e Abaz Makollit, ku edhe siç e prisja u bashkova edhe një herë me anëtarët e familjes sime. Në shtëpinë e Abazit kemi qëndruar përafërsisht dy javë dhe më pas jemi larguar në një shtëpi tjetër në Vranjevc, ku edhe atje kanë ardhur policia dhe na kanë maltretuar vazhdimisht, por nuk na kanë larguar nga shtëpia dhe aty kemi qëndruar deri në përfundim të luftës.

Intervistoi: Abaz Makolli.

SHTATË SHQIPTARË PËR NJË SERB E NË FUND TË VRITEN TË GJITHË, ISHTE URDHRI I OFICERIT SERB.



Rifat Bilalli, i mbijetuar

Më 29 të muajit prill të vitit 1999, aviacioni i NATO-s bombardoi vendqëndrimet e forcave serbe që ishin strehuar në objektet e Ferronikelit në Drenas. Të nesërmen, forcat serbe filluan ofensivën kundër banorëve shqiptarë të fshatrave të Drenasit, që nga orët e hershme të mëngjesit. Nën tym e flakë filluan të shtëna nga të gjitha drejtimet që rrerthonin fshatrat Shtuticë, Vërbovc, Gllanasellë, Baks, Qirez, Dashevc, Tërstenik e Polluzhë. Popullata e pambrojtur nuk dinte kah të shpëtonte. Në Shtuticë njerëzit vendosën që gratë, pleqtë dhe fëmijët të vendosen në objektin e shkollës së fshatit, ndërsa meshkujt e tjerë të strehoheshin në pyllin e afërm të fshatit.

Një grup prej 50 burrash e të rinjësh, në mesin e të cilëve ishin edhe vëllezërit e mi, u strehuan në vendin e quajtur “Kroi i arave të fushës”, në një luginë, kurse unë së bashku me nipat e mi Bekim Bilall Bilallin 18 vjeçar, Milaim Hetem Bilallin 19 vjeçar, Fehmi Zukë Fetahun (djali i motrës nga Qirezi) dhe me kushërinjtë Nezir Sylë Bilalli, Hysni Nezir Bilalli, Avni Nezir Bilalli, Sefedin Rexhep Bilalli dhe disa miq e kushërinj të tjerë, kaluam në pjesën e pyllit të quajtur “Gurët e bardhë”.

Në fillim ishin 10-15 veta, por na u bashkuan edhe disa të tjerë, kështu që u bëmë 27 veta gjithsej. Të shtënat e forcave serbe dëgjoheshin vazhdimisht dhe vinin nga të gjitha anët. Ashtu kemi qëndruar deri në orën 17:00, kur nipi im Bekimi i pari vërejti se forcat serbe po na ofroheshin. Ju thashë të shtrihen të gjithë për tokë. Nuk kishim mundësi dhe gjasa të tjera, sepse ishim të rrethuar nga të gjitha anët. Na hetuan, u afruan dhe bërtitën:” ja terroristët!” dhe filluan të shtinin breshëri plumbash mbi ne. Ndër të parët u qëllua djali i vëllait

tim Bekimi, i cili ishte shumë afër meje ndërsa unë plagosem në pesë vende në trup: në krahun e djathtë, në anën e djathtë të gjoksit, në shpinë, në anën e anën e majtë të qafës dhe në dy gishtërinjtë e dorës së djathtë. Ashtu i shtrirë, bashkëfshatari im Ibrahim Ademi (51 vjeçar), mësues në shkollën “Azem Bejta” të Shtuticës, bërtet me gjithë fuqinë e zërit: mos gjuani, ne jemi civilë. Megjithatë, të shtënat vazhduan edhe pak kohë e pastaj u ndalën kur forcat serbe u ofruan dhe na urdhëruan të ngriheshim. Prej 27 vetash sa ishim, u ngritëm vetëm 7, prej të cilëve 4 ishim të plagosur. Përveç meje, të plagosur ishin edhe nipi im Milaim Bilalli, Artan Ademi e Ilir Dvorani ndërsa Bedri Qerim Ademi i plagosur tha se nuk mund të ngrihej, atëherë paramilitarët i shkrepën edhe disa plumba duke e lënë të vdekur në vend. Neve, me duar të lidhura pas koke, na mbajtën disa çaste derisa mbaruan me të plagosur të tjerë, duke u shkrepën plumba edhe kufomave. Myrvet Ramës (40 vjeçar) dhe Hysni Nezir Bilallit (27 vjeçar) u a derdhën trutë nga kokat, aq rëndë u ishin dëmtuar kokat e tyre nga plumbat dum-dum. Në këtë vend u vranë këta 18 persona:

1. Bekim Bilall Bilalli, 18 vjeçar nga Shtutica
2. Nezir Sylë Bilalli, 56 vjeçar,,
3. Hysni Nezir Bilalli, 27 vjeçar,,
4. Avni Nezir Bilalli, 17 vjeçar,,
5. Sefedin Rexhep Bilalli, 17 vjeçar,,
6. Fehmi Zukë Fetahu, 20 vjeçar nga Qirezi
7. Bedri Qerim Ademi, 44 vjeçar nga Shtutica
8. Myrvet Milazim Rama, 44 vjeçar nga Qirezi
9. Fetah Zymer Ademi, 20 vjeçar nga Shtutica
10. Selim Zymer Ademi, 53 vjeçar,,
11. Maliq Fetah Ademi, 25 vjeçar,,
12. Esat Selim Ademi, 13 vjeçar,,
13. Besnik Halit Jusufi, 16 vjeçar,,
14. Sami Bahtir Jusufi, 17 vjeçar,,
15. Nazmi Dvorani, 25 vjeçar nga Tërsteniku
16. Abedin Ferizi, nga Qirezi
17. Bekim Ferizi nga Qirezi dhe
18. Naim Ferizi nga Qirezi.

Neve që mbijetuaam na rrahën me kondak pushkësh, dhe na thernin me thika si Xhevat Ademin, nga trupi i të cilit i rridhte gjaku rrëke pas therjes. Pasi na mbajnë rreth 20 minuta duke na torturuar, na nisin drejt pyllit. Më kujtohet se aty kam parë trupin e pajetë të Lamë Muqollit, 57 vjeçar nga fshati Baks, pranë të cilit qëndronin disa ushtarakë, njërin prej të cilëve e thërrisnin kapiten. Pasi kaluam pyllin, në vendin e quajtur “te Bajraku”, në oborrin e shtëpisë së Azem Ibrahim Baksit, na detyruan të shtrihemi për tokë me duar të lidhura pas koke për të na rrahur përsëri.

Pas gjysmë ore na nxorën nga ajo shtëpi duke vazhduar të na rrihnin me shkopinj druri. Në rrugë pamë një kolonë civilësh të zënë rob, të cilët i keqtrajtonin dhe ne na bashkëngjiten në kolonë.

Duke vazhduar rrugën në kolonë, pas 200 metrash kemi hasur në një grup tjetër paramilitarësh serbë, të cilët vinin prej varrezave të ashtuquajtura “varrezat e xhelit”, të cilët kishin zënë rob 7 civilë shqiptarë. Ata bartnin kufomën e një paramilitari serb të vvarë. Ata urdhëruan kolonën që të ndalej, ndërsa ata që bartnin kufomë i urdhëruan që atë (kufomën) ta futnin në një tank që ndodhej afër pastaj i rreshtuan para tankut dhe i pushkatuan të gjithë. Pas pushkatimit të tyre, kapiteni serb tha: shtatë shqiptarë për një serb e në fund të vriten të gjithë. Në fshatin Baks, në Lagjen e Imerajve, na urdhëruan të ndalemi. Aty digjnin çdo gjë. Vazhduam rrugën, por numri i të zënëve rob zvogëlohej sepse i ndanin nga një dhe i ekzekutonin.

Përveç maltretimeve çnjerëzore, rrahje e therje me thika, na detyronin të këndojmë këngë nacionaliste serbe dhe të ecnim nëpër ujë e baltë. Dy djem të rinj nga Gllogovci me mbiemrin Qorra, për shkak se përpiqeshin t’i shmangeshin baltës, i zhveshën lakuriq, i detyruan të shtriheshin në baltë dhe i rrahën brutalisht.

Pak para se të errësohej kemi arritur në Xhaminë e Qirezit, ku do të na priste një tjetër grup paramilitarësh, i cili kryesohej nga njëfarë Çarli. Por aty kishte edhe një numër pjesëtarësh të ushtrisë jugosllave. Aty në oborrin e xhamisë na vendosën duke na rrahur pandërprerë. Duke na therur me thika, prerje të veshëve e të gishtërinjve, na vizatonin me thikë kryqin serb në trup, në ballë e në fytyrë. Ndërkohë vjen një tank në të cilin ishte një civil, i tëri në gjak, për të cilin dëshmitarët thanë se e kishin lidhur për tank dhe e kishin tërhequr zvarrë. Edhe pse ishte i mbuluar në gjak, e njoha, ishte Ismet Prokshi, të cilin e kisha pasur nxënëses më herët. Atë e zbritën, e hodhën mbi një grumbull mbeturinash dhe e ekzekutuan para syve tanë. Në këtë kohë Çarli hapi derën e xhamisë dhe thirri “dogji ovamo”. Nga xhamia doli Sokol Krasniqi i

Gllanasellës, të cilin e kishin zënë rob në fshatin Vërbovc, ishte në gjendje shumë të rëndë nga rrahjet që i kishin bërë. Çarli e urdhëroi të na numëronte 3-4 herë e pastaj e urdhëroi të përkthente fjalët tija nëse ndonjëri tenton të ikë, do t'ju vrasim të gjithëve dhe se xhamia do të jetë e minuar. Çarli urdhëroi të futeshim në xhami ku kishte shumë shqiptarë civilë, të zënë rob në fshatin Vërbovc dhe i kishin sjellë aty para nesh. Shumë prej tyre i njihja. Në katin e parë të xhamisë ishin 176 persona kurse në të dytin 38.

Pas hyrjes në xhami, pashë se me kolonën që kishte ardhur prej Baksi ishin edhe tre vëllezërit e mi: Muharremi, Hetemi, Bilalli dhe djali i vetëm i vëllait, Izeti. Ky bashkim në këto rrethana e rëndoi edhe më shumë gjendjen time. Kisha derdhur shumë gjak, isha i mbuluar në gjak, kurse ata u munduan të më lidhnin plagët e dorës me faculeta, por edhe ata ishin të keqtrajtuar dhe të përgjakur. Shumë të plagosurve nuk ishte e mundur t'u jepej as ndihma më elementare.

Dhembjen që e mbaja për vrasjen e djalit të vëllait e ndava me ta, u tregova çfarë kishte ndodhur me ne. E ngushëlluam vëllain Bilallin për vrasjen e të birit Bekimit. Në xhami kishte edhe pleq dhe fëmijë. Të nesërmen urdhëruan të dilnim nga xhamia dy nga dy, duke na rrahur me gilindera të xhamisë dhe duke na therur me thika vazhdimisht.

Na ngarkuan në disa kamionë dhe na nisën në drejtim të panjohur. Kemi parë rrugës duke hedhur kufoma në greminë dhe duke i ndezur me materiale ndezëse. Na kërcënonin se do t'ju hedhim në furrat e Ferronikelit. Arritëm në Glllogoc, aty tregu i gjelbër dhe oborri i Shtëpisë së Shëndetit ishin plot ushtarë e policë serbë, kurse rrugë para objekteve zeytare plot gra e fëmijë që qëndronin ulur. Na futën në sallën e kulturës, na shtrinë në dysheme dhe pas pak kohësh prapë na nxorën jashtë. Ndërkohë pamë edhe një grup civilësh të zënë rob te gllarevët e Vërbovcit. Të gjithëve na urdhëruan të mbështeteshim për muri ku na rrahën me kablllo rryme. Shumë alivanoseshin, pastaj na hidhnin ujë. Një polic nga Kijeva, i cili më parë punonte në Kuvendin komunal, i quajtur Dragan Damjanović, sapo më pa më tha në gjuhën shqipe: ti je i mirë, kthehu kënde. Por unë u bëra se nuk po e dëgjoja, ai u ofrua më kapi për sakoje ku më kishte kapur plumbi dhe më tha çfarë kisha në gishta. I thashë se isha plagosur e pastaj më tha ti je UÇK dhe më rrahu derisa humba vetëdijen dhe rashë përtokë. Më kanë hedhur ujë dhe sapo jam ndjerë e kanë urdhëruar Sali Gllarevën nga Vërbovci që të më ndihmojë të ngrihem në këmbë (ky njeri më ka ndihmuar shumë ato ditë shumë të rënda të jetës sime).

Mbaj mend se nga Shtëpia e mallrave vjen një polic me shishe alkooli në dorë dhe thotë kam ardhur të vras një shqiptar, duke iu drejtuar Kadri Baliut, por Dragani i thotë të merrte një tjetër se ishte më i mirë (ishte fjala për të birin e Haxhi Topillës, Rrahmanin i cili kishte qenë farkëtar në Ferronikel, të cilin e ekzekuton aty për aty. Selim Kastratin nga Vërbovci e rrahën rëndë, sepse e kishin kuptuar se ishte mësues.

Të dielën më 2 maj erdhën dhe i morën disa të zënë rob dhe i dërguan në Stacion të trenit ku i kishin rrahur tmerrësisht. Atje kishin dëgjuar edhe britma femrash. Të hënë më 3 maj në orën 9:00 të mëngjesit na dërguan në Stacion të milicisë ku serbi i quajtur Pirçe e të cilin unë e njihja që më parë sepse më kishte arrestuar në vitin 1994, fillon të marrë shënime për ne, kush ishim e nga vinim. Mua më mori në pyetje një inspektor tjetër mjekërgjatë.

Pasdite i sollën një grup prej lagjes Dobra të Vërbovcit, në mesin e të cilëve edhe nipin tim Avdi Gashi. I kishin zhveshur, gjendja e tyre ishte tmerruese. Më vonë në mbrëmje sjellin edhe një grup prej 15-16 vetash, të cilët i kishin zënë robër në Polluzhë, këta ishin Veliq e Kastrat. Disa ishin të plagosur, si Hajdin Kastrati dhe Islam Veliqi, që të dy mësues. Në këtë sallë na mbajtën deri të mërkurën, diku rreth orës 14 : 30. Duke na rrahur na detyronin të këndojmë, „Kosova është Serbi”. Ishte dita e gjashtë që nuk kishim ngrënë asgjë. Një oficer pyeti nëse kishim ngrënë bukë. Sali Gllareva i tha se ishte dita e gjashtë pa ngrënë, për këtë fjalë ai është rrahur disa herë në mënyrën më barbare. Na sollën disa rrisa buke të mykur. Na ndajnë, një grup në Poterk, një në Vukoc dhe një në Krajkovë. Na detyronin të bëjmë punë të ndryshme, madje edhe të rrihnim njëri-tjetrin. Kështu kaluan shumë ditë nga dita kur isha plagosur. Një ditë duke hapur bunkerë brenda shtëpisë, një shok imi gjen në shishe alkool, me të cilin fshehurazi çdo mbrëmje shokët (Shaban Veliqi, Behram Maloku, Ilir Dvorani e Milaim Veliq) më pastruan plagët që ishin infektuar (qelbosur) dhe lëshonin erë të rëndë. Kështu, falë alkoolit dhe kujdesit të shokëve, shpëtova, sepse do të vdisja nga plagët. Më 13 qershor na zgjuan në orën 4 të mëngjesit. Gjithë arsenalin ushtarak e kishin renditur në kolonë kurse neve, në rresht për katër, na urdhëruan të ecnim në ballë të kolonës dhe ta shkelim mirë çdo pjesë të terrenit, në mos kishte mina e që duhej ta bënim duke kënduar këngë serbe. Në orën 5 arritëm te Xhamia e Krajkovës ku u takuam me grupin tjetër, por tani nuk ishin më 25 veta, sepse disa i kishin ekzekutuar. Na bashkuan dhe na urdhëruan të shkonim rrugës gjer te mali ku na thanë: shkoni, jeni të lirë. Nuk mund të besonim, përjetimi i vërtetë ishte i

papërsshkrueshëm. Më 18 qershor shkova në Spitalin e Prishtinës ku dr Talat Gjinolli më nxori dy plumba nga trupi e pas dy javësh dr Faton Morina më nxori edhe një plumb nga dora.

Pas një muaj e gjysmë, Tribunali i Hagës fillon zbulimin e varrezave dhe identifikimin e kufomave. Aty gjeta rrobat e tre vëllezërve të mi: Muharremit, Hetemit, Bilallit si dhe Milaimit - djalit të vëllait – Hetemit. Mjekët më thonë se ishin identifikuar trupat e vëllait Bilallit dhe djalit të vëllaut- Milaimit. Por të dhënat për vëllain tjetër Hetemin nuk përputhen me kufomën e gjetur.

Djali i Muharremit, Izeti edhe sot e kësaj dite konsiderohet i zhdukur.

Gjatë vitit 1999, nga familja e ngushtë më janë vrarë 10 meshkuj kurse për fatin e njërit ende nuk dihet gjë.

Intërvistoi: Ramë Manaj

NË MASAKRËN NË FSHATIN RIBAR I VOGËL MA VRANË
BASHKËSHORTIN REXHEPIN DHE DY DJEMTË
ISMETIN DHE KUSHTRIMIN



Shemsije Vishesella, 19.02.1960, e mbijetuar e masakrës së Ribarit të Vogël

Në ditën e kobshme i kam pasur 38 vjet. Ishte ditë e diel, më 18 prill 1999, ora 6:00 e mëngjesit. Ishim të gjithë shtrirë në shtrat. I kemi dëgjuar ushtrimat e automjeteve. Në atë moment kunati Selimi ka ardhur dhe i thotë burrit tim Rexhepit, se a po i dëgjon ushtrimat dhe eja të ikim. Menjëherë burri im doli te dera e shtëpisë, i pa paramilitarët serbë që po vinin nga shtëpia e fqinjit dhe tha: s’kemi kah t’ia mbajmë, do të shkojmë kah të na thonë. Unë isha me dy djemtë në dhomë, Rexhepi mbeti në korridor. Aty afër, në dhomën tjetër ishte vjehri Asllani. Paramilitarët kanë hyrë brenda dhe na kanë thënë – dilni jashtë. Jemi ngritur dhe kemi dalë në korridor. Djalin e madh Kreshnikun e kanë kapur për fyti dhe e kanë shtirë mbas dere, edhe mua më kanë kapur për fyti dhe na kanë thënë qitni paret. Pastaj na kanë qitur jashtë shtëpisë. Në oborr pashë shumë ushtarë të armatosur e të maskuar, me mitraloza e armë të tjera në gjendje gatishmërie. Nuk e di sa kanë qenë. Kur kemi dalë prej shtëpisë, një paramilitar e urdhëron djalin tim të dytë, Ismetin, që të bie në fund të shkallëve. Mua me burrin Rexhepin na mbështetën për muri të shtëpisë dhe prapë na thanë qitni paret. Unë i kam pasur 500 marka dhe ua kam dhënë. S’ka kaluar as pesë minuta e na kanë thënë bini në tokë. U shtrimë në tokë, Rexhepi e Kreshniku ishin afër, fytyrë për fytyrë, e unë dhe vajza Besa, 11 vjeçare ishim afër të rënë fytyrë për fytyrë, ndërsa djali im Ismeti ishte i shtrirë në fund të shkallëve. Pastaj na thanë që unë e Besa të ngrihem në këmbë. Na urdhëruan që të largohemi, ashtu edhe vepruam. Me ne ishte edhe vjehri Asllani. Kur arritën tek oda, u mbështetëm për muri. Aty Besa më tha, nënë e kanë vrarë Ismetin, sepse ajo i kishte parë paramilitarët të cilët i thoshin njëri-

tjetrit “mëshoj ti e mshoj ti”. Pas kësaj, nga oda kemi vazhduar teposhtë oborrit, gati kemi dalë në rrugë të fshati. Aty ishte traktori që e kishim përgatitur për të ikur. Jam ulur te rrota e traktorit dhe mundohesha të shikoj se a janë djemtë e mi aty. Në atë moment një paramilitar që ishte pas bunarit, shtiu me armë dhe më qëllloi në fytyrë. Në atë moment kam ra prej traktori. E kapa gojën dhe fulqinë tjetër të fytyrës dhe e ofrova. Kisha rënë përmbys, por u ktheva në shpinë sepse mendova që të mos vdes në këtë pozitë. Besa më është ofruar menjëherë dhe më tha – nënë a je gjallë. I thashë, po çika jeme. Ato i tha vjehrrit si duket e mbytën edhe nënën. Pas kësaj, Besa më ka kapur për krahu dhe me shumë vështirësi kemi arritur që të dalim në një rrugicë që çonte për në fshatin e afërt Torinë.

Oborri ynë vlonte nga nga forcat ushtarake e paramilitare serbe. Nuk dija se çka po bëhet. Aty e kanë mbytur kunatin Qazimin, kunatin Selimin me grue e me vajzë. Në shtëpinë tjetër të kunatit ishin vendosur refugjatët e familjes Vuniqi nga fshati Vërshefc. Edhe këta i kanë vrarë po atë ditë. Nuk dinin asgjë se çka po ndodh nëpër shtëpi të tjera. Paramilitarët kanë hyrë në katër shtëpitë e familjes sonë. Kur kemi dalë në rrugicën për Torinë, Besa gjithnjë më mbante për krahu, e pashë të vrarë në rrugë Mirsadin e Vuniqëve të mbytur, pastaj po ashtu të mbytur e pashë edhe Miradinë e Selimit. Besa në atë moment më tha “nënë e paskan mbytur Kushtrimin, i thashë. Jo nënës, e paskan mbytur Miradinë. Miradia kishte në kokë një kapelë. Kështu i njihja njerëzit e vrarë, por nuk mund të flisja më.

Unë e Besa ishim larguar, por vjehri kishte mbetur edhe më pas në oborr. Ai i kishte parë djemtë e mi dhe bashkëshortin tim të vrarë. Kur erdhi e na zuni neve në rrugë, na tregoi për këtë dhe tha se vetëm Ismeti ishte ende gjallë. I thashë “o babë pse nuk e more?! Më tha se “s’ka më prej tij asgjë dhe se vetëm e vëreja se ishte pak gjallë”. U ulëm qe te tre te një therrë. Ia qita vjehrrit kokën në krah. Ai ishte shumë i mirë dhe ka përjetuar gjatë jetës së tij, por edhe në këtë rast, momente të vështira.

Unë ecja zbatuar, sepse ishte baltë e madhe. Na thanë disa ushtarë që të shkojmë në fshat dhe të bashkohemi me banorët e tjerë të fshatit. Unë mezi ecja, por me ndihmën e vajzës arrita që të qëndroja në këmbë. Duke u kthyer në fshat, kaluam afër shtëpisë sime. Doja që të hyja në oborr dhe t’i shoh se a i kam djemtë gjallë. Më kapi vajza e më tha: “Aman nënë, mos me lë vetëm dhe këta, paramilitarët po të përcjellin”. Më pastaj hymë në një shtëpi të Nazimit të Budakovëve. Aty kishin qenë disa ushtarë serbë, por ata ishin ndryshe nga ata paramilitarët që i

vrarë familjen time dhe të tjerët. Ata e kapën vajzën dyvjeçare të Rrahimit dhe e ngritnin lart. Mendoja se tani do ta presin atë me thika, por jo! M'u afruan mua dhe më thanë që të më pastrojnë varrën. Aty ata ushtarë në shtëpi të Nazimit i thanë vjehrrit se ku i keni djemtë. Ai iu përgjigje se ju i keni vrarë. Ata thanë se ne jo, por i kanë vrarë shokët e tyre, aludonte të serbët e tjerë të fshatrave të afërta që na njihnin dhe shpesh kishin kaluar këndeja para masakrës. Pra, thanë se ata janë të këtuhit dhe nuk kanë ardhur nga vendet e tjera. Ata mirë iu kanë njohur.

Pas kësaj ushtarët serbë na kanë urdhëruar që të hipnim në traktor dhe të shkojmë kah të duam, në Lipjan, në mal apo gjetiu. Unë hipa në traktor e plagosur rëndë. U nisëm për në mal ku ishin edhe të tjerët nga Ribari i Vogël. Traktorin e ngiste Kushtrimi, djali i Selimit që kishte vetëm 11 vjet. Në fund të katundit, në një përrua na mbeti traktori dhe nuk mund të dilte. Ishim të detyruar që të zbresim nga traktori. Unë mezi arrita me ndihmën e vajzës dhe të tjerëve të zbres nga traktori. Mora pak ujë me dorë nga përroska dhe e lava fytyrën që me kthjelli pak, por nuk piva ujë. Duke shkuar rrugës e pashë të vrarë Mihanën e bacit Hajdar, kushëri, Vishesellë. Në rrugë kishte mbetur e vrarë edhe Dafina 6 vjeçe. Gjatë rrugës iu luta vjehrrit që të më lënë dhe ta vazhdojnë rrugën ata, se unë më nuk mundëm. Vjehrrin më tha: Kurrsesi. Dikush kishte siguruar një traktor në Ribar të Madh, më hipën në traktor dhe u nisëm për në fshatin Zllakuqan. Kur arritëm në Zllokuqan, më dhanë ndihmën e parë, duke ma pastruar plagën. Më mua ishte edhe Zejnepi nga Ribari i Vogël, i familjes Hasani, edhe kësaj ia kishin mbytur burrin. Aty ishte edhe Liria e Vuniqëve që ishte e plagosur në këmbë. Më pastaj mua më vunë në një batanije dhe më kanë nisur për në fshatin Krojmir. Unë nuk dija se ku po më dërgojnë. Më vendosën në një traktor që e ngiste Rrahimi, djali i kunatit, të cilit ia kishin vrarë babanë dhe ai tërë ato ngjarje makabre i kishte përjetuar. Më pastaj Rrahimi erdhi tek unë në rimorkio dhe traktorin e drejtonte dikush tjetër. Kur arritëm në Krojmir natën, nuk kishte drita. Ne nuk kishim asgjë. Erdhën mjekët. Rrahimi u tregoi për vujtjet e mia. Mjekët e panë se unë isha në gjendje të rëndë dhe mendonin se as "sabahi nuk do të më qelë". Isha vendosur në një tendë ku qëndrova në deri në ora 11:00. Atëherë vjen dr. Naseri nga fshati Qylagë. Me të ishin edhe mjekët Hasani, Jakup Ismaili, Reshati dhe disa motra medicinale. Naseri më operoi, më qepi plagën që e kisha në faqe. Në mbrëmje dëgjova lajmet në televizor për masakrën që është bërë në Ribar të Vogël. Unë e dija tërë atë që ka ndodhur. Nuk mund të dëgjoja lajmet dhe mbyllja veshët.

Në atë vend në shërim qëndrova një muaj. Mjekët janë kujdesur shumë për mua. Më jepnin infuzion dy herë në ditë. Kisha humbur shumë gjak. Pa kujdesin e mjekëve sot nuk do të isha gjallë. Humba tërë familjen, por prapë mendoja se dua të jetojë për hatër të vajzës. Pas një kohe vjen vajza ime Besa me Rrahimin që të më vizitojnë. Më se 8 orë kishin udhëtuar këmbë prej Zllakuqani. Kur e pashë vajzën pak u qetësova. Ata shkuan. Por, pas një muaji vjen Rrahimi të më marrë dhe më tha që të ikim në Shkup apo gjetiu se në Ribar të Vogël nuk mund të jetojmë më. Por, nuk arritëm që të largohemi, sepse ishte rrezik i madh dhe mbetëm në Ribar të Vogël.

Pas pesë javësh, vijnë forcat serbe dhe i nxjerrin kufomat nga varrezat. Ne nuk guxam të qëndrojmë në shtëpi dhe ikëm në fshatin e afërt Rufc. Pas një kohe vijnë prapë dhe i nxjerrin kufomat dhe i dërgojnë në xhami të fshatit, kinse për identifikim. Më pastaj i varrosën. Herën e tretë janë nxjerrë pas lufte nga përfaqësuesit e Gjyqit të Hagës.

Intervistoi: Jusuf Osmani

KUFOMAT I MBULUAM SA TË MOS MUND TË ZBULOHESHIN SEPSE MUND T’I HANIN QENTË!



Tahir Krasniqi – i mbijetuari i masakrës së Pastaselit

Më 30 mars (një ditë para ofensivës), fshati është mbushur me refugjatë. Ne kemi dalë, i kemi marrë e i kemi strehuar nëpër shtëpia, dhe në shkollë. Shkolla ka qenë e mbushur me diku afërsisht 400 njerëz brenda. Më 31 mars, kemi dalë nëpër fshat për t’ju sjellë fshatarëve ushqim e robra, për t’u kujdesur për ta. Unë i kam pasur nja 106-7 mysafirë të zhvendosur. Diku kah ora 12:00 (mesditë), dëgjuam që ia kanë mësyre për te ne forca të mëdha ushtarake serbe, të cilat kishin mbërritur deri në Polluzhë. Atje i kishin tubuar disa njerëz dhe i kanë rrahur, por nuk i kanë pushkatuar.

Në Pastasel erdhen 12 tanke dhe më shumë se 20 autoblinda. Tanket ecnin përpara, autobлиндat pas tyre. Në hyrje të fshatit, kanë zbritur këmbësoria. Ne e kemi lëshuar fshatin krejt, disa kanë shkuar, janë nisur për Ratkoc, disa në drejtime të tjera. Aty kemi qenë afërsisht 400-450 të tubuar, gra e fëmijë, edhe tash kur kemi shkuar aty, ata diku kanë mbërritur kah ora 4:00 pasdite. Gra e fëmijë që kanë qenë aty, kanë ngritur lart këmisha, a çka kanë pasë të bardha, për të dhënë shenjë që po dorëzohemi, por këtë se kanë marrë parasysh. Nja 5-6 tanke kanë shkuar përmbi fshat edhe e granatonin Senovcin, e këta me autoblinda i granatonin disa shtëpi që ishin në shpat.

Trupave serbe u kemi dhënë para, unë me nja 5-6 vetë, se pat dalë fjala që po t’u japim para, të lëshojnë edhe une mendoja që pasi t’i marrin paratë, nuk do të na vrasin. Ata na shanë e fyen në gjuhën e tyre dhe na urdhëruan të ngremë “duart përpjetë”. Ne u thamë – “i kemi bo do pare me ju dhënë, vec mos me ardhë te femijët e pafajshëm e të vegjël e po kajnë...”. Ata na kanë thënë – “a po kthehuni mbas, uluni aty ku ishit, edhe ndahuni prej grave veç, se ju merr plumbi menjëherë, s’ka para këtu”. Na kanë detyruar të ulemi në gjunjë dhe kokën në tokë. Na rrahën me kondak pushke dhe gjithçka tjetër që kishin në dorë. I morën disa dhe u dëgjuan të thoshin “po e marrim njo, po e masakrojmë për së gjalli”. Ua dhamë 7000 marka, por nuk ua mbushnin syrin.

Fillimisht e morën një burrë të Zatriqit. Pastaj e kanë marrë Isuf Nushin bashkë me djalë. Isuf Nushi është i varrosur në Zatriq.

Pastaj kur na kanë ndarë, 30 i kanë zgjedhur, ma të rinjtë, edhe i kanë çuar në atë përroin ku kemi qenë të fshehur në ofensivën e parë, diku 60-70 metra distancë, edhe i kanë gjuajtur në atë përrua edhe asnjë gjallë s'ka shpëtuar, se ka qenë vendi lëndinë. Nga grupi i dytë kanë shpëtua nja 2-3 vetë. Në grupin e tretë kam qenë edhe unë. Afërsisht nga 30 persona na ndanin nëpër grupe. Neve na kanë bërë rresht, unë kam shkuar teposhtë me një djalë të axhës, afër njëri-tjetrit, edhe me një tjetër të fshatit, edhe ia kemi bërë 'hallall' shoqi-shoqit, sepse aty ka qenë momenti i fundit.

Në krah të majtë e kam pasur një djalë të axhës, Selim Krasniqin, në krah të djathtë e kam pasur një të fshatit me emrin Vehbi Krasniqi, se këtu Krasniqi ka më shumë si fis. Kur na kanë gjuajtur me rafale herën e parë, mbetën të vrarë djali i axhës Selim Krasniqi dhe bashkëfshatari Vehbi Krasniqi. Kurse në rafalet e dyta jam plagosur edhe unë, por për fat kam shpëtuar.

Një grup i ushtarëve serbë prej 17 vetave, ishin skuadra e pushkatimit. Ata shtinin pandërprerë në civilë të paarmatosur shqiptarë. Të tjerët endeshin poshtë e lart. Në mesin e tyre ka pasur edhe civilë serbë të rekrutuar. Skuadra e pushkatimit vrau shumë shqiptarë, por për numrin e të vrarëve nuk kishim informata. Ne u detyruam të shmangeshim sa e si mundeshim. Ndërkohë jemi mbledhur në një mal që thirret Bibiçak, është përmbi Polluzhë. Aty kemi qëndruar krejt natën deri në mëngjes. Diku kah ora 3:00 pasdite, i kemi dëgjuar ato tanket, edhe në bazë të ushtimës (zhurmës) nuk kanë qenë më larg se nja 100 metra, po ne kemi qenë në përrua thellë poshtë, e ato ishin lart rrugës, për në Saraç, për në Guri të Kuq. Më pas erdhi Nuhi Krasniqi, të cilit iu pat vrarë babai e axhën e kishte gjallë, e kishte marrë vesh që ne jemi te një krua – i njohur si: te kroni i Debiqakut.

Pas tërheqjes së forcave serbe kemi gjetur dhjetëra kufoma njerëzish të masakruar, të djegur, të shpërfytyruar që kishin mbetur nëpër pjesë të ndryshme të fshatit. Numri i tyre kalonte shifrën prej 100 vetash. Ne u munduam t'i varrosim dhe t'i mbulojmë aq sa të mos mund zbulojnë dhe t'i hanë qentë. Por të gjitha kufomave ua kemi qitur sipër nga një najlon, dikujt ndonjë batanije, aq sa kemi mundur, me mundësitë e tona. Rreth 4 ditë ka zgjatur varrimi, por me ndërprerje, sepse vinin serbët me autoblanda dhe ne ishim të detyruar të fshiheshim.

Intervistoi: Ramë Manaj

EDHE FËMIJËT E GRATË PANË TMERRIN ME SY



Muhamet Bajoku nga Dyzi, i mbijetuar i masakrës së Dyzit

Muhameti i cili i kishte vetëm 14 vjet rrëfen për këtë ngjarje të tmerrshme të 18 prillit të vitit 1999.

Ishim duke ngrënë mëngjes dhe pasi e kryem mëngjesin erdhën forcat serbe, të cilat ishin të prirë edhe nga një rom. Kanë nisur të shtinin me armë. Babai ka dalë dhe ka shkuar te shtëpia e kushëririt për të parë çka po ndodhte. U kthye këtu dhe nga pozicionet e tyre lart e kanë vrarë me snajper. Në oborrin tonë kanë ardhur shumë forca serbe dhe pastaj kanë hyrë nëpër dhomat e shtëpisë sonë. Kanë qenë edhe tri praga e tanke afër. E kanë marrë Ragip Mulollin nga Shajkovci i Podujevës, dhëndrin tonë, i cili ishte mysafir te ne. Atë e kanë rrahur dhe i kanë thënë shko e thirri burrat e tjerë. Ragipin e kanë pushkatuar para shkallëve. Tani e kanë marrë mixhën 83 vjeçar, Rifat Bajokun. Edhe atë e kanë pushkatuar aty. E kanë pushkatuar edhe një kushëri tjetër. Më kanë marrë edhe mua dhe më kanë qitur për të më pushkatuar.

Dëshmitarja tjetër, **Bedrije Bajoku** dëshmon: “Këtu është dhoma ku jemi vendosur ne si të strehuar prej Podujevës. Edhe nga këtu, forcat policore serbe kanë ardhur, diku nja 40 vetë kanë qenë. Na kanë nxjerrë prej kësaj dhome, edhe na kanë thënë të dalim jashtë. Mirëpo, ne jemi frikësuar të dalim jashtë dhe jemi ulur të gjithë. Kemi qenë gjithsej 21 veta. Na kanë rreshtuar të gjithëve. Ragip Mulollit, i kanë thanë që t’i nxjerrë jashtë, që të dalin të gjithë. Mirëpo, atij i ka ardhur keq që t’u thotë ashtu, edhe ata prapë kanë ardhur këtu, e kanë nxjerrë me forcë jashtë, edhe këtu, para derës, e kanë pushkatuar, mu te ky qoshi këtu. Pas Ragipit, kanë ardhur e i kanë thanë mixhës, dilni jashtë, dorëzohuni. Mixha ka thënë menjëherë, i ka ngritur duart lart. Ka dalë, edhe ai në oborr aty, edhe atë e kanë pushkatuar. Ne s’e kemi parë, veç kur i kemi pa të rrëzuar, sepse dera ka qenë e hapur. Pas atij, e morën edhe mixhën tim, Rifat Bajoku. I thanë të dorëzohet, t’i çojë duart lart. Ai menjëherë, doli përjashta, edhe atë e vranë, këtu në oborr. Pas mixhës, mbeti vetëm

babai Vesel Bajoku, i cili ishte i ulur në mes të fëmijëve të motrës, një djalë e tri vajza. Atë e morën të fundit nga fëmijët dhe i thanë “çohu plak, dil përjashta!”. Doli, si dhe këtu afër, nuk e pritën as të dalë ende prej derës, edhe atë e vranë me një plumb. Pra, 3 burrat u vranë këtu. Edhe Ferati u vra para derës së shtëpisë së vet. Pra, 4 civilë. Këtë ekspeditë e ka udhëhequr një rom. Mirëpo, ne vetëm e njohëm në bazë të gjuhës, se e dinte shumë mirë shqipen. Por, emrin nuk arritëm t’ia mësojmë.

Edhe **Fatime Bajoku** pa dhe përjetoi me shumë ankth këtë ngjarje të tmerrshme të prillit të vitit 1999. Ajo rrëfen: “Na kanë zënë brenda tanë, do njerëz të ligj. Nuk kishim mundësi as me ikë, sepse ishim të lodhun, të mërztun, t’untuem. Më së pari, burrin ma kanë vra qaty, para dyerve, para derës së shpisë vet, edhe ata kojshi e vllazni që kemi pasë. Ma së tepërmi më mundon djalin e vogël - Muhametin që ma kanë marrë para duarve dhe ma kanë rrehë dhe kanë deshtë edhe këtë me e pushkatue. Kanë ardhë policët, të cilët kanë sha dhe kanë thanë ‘hajde qitni markat, pare’...”

Në fshatin Dyz të Podujevës dhe në Koliq të Prishtinës më 18 dhe 19 prill 1999 në shtëpitë e tyre dhe në male u ekzekutuan 70 civilë shqiptarë, të gjitha moshave, të rinj dhe pleq. Pas luftës, më 1 gusht të vitit 1999, në Kompleksin përkujtimor në Dyz të Podujevës janë rrvarroshur vetëm të vrvarrët nga ky fshat dhe fshatrat për rrvreth: Sejdi N. Veliu, Hazir S. Islami, Sadik B. Berisha, Sabit U. Islami, Mustafë I. Llapashtica, Ajshe A. Berisha, Daut A. Asllani, Faton V. Shabani, Ekrem S. Bajrami, Hasan Sh. Bajrami, Fadil Rr. Xhemajli, Zylfije Rr. Xhemajli, Burim A Podvorica, Sabedin H. Hasani, Rrustem S. Rrustemi, Bajram I. Topanica, Avdyl B. Veliu, Idriz R. Rama, Shemsi H. Mehana, Rifat A. Bajoku, Vesel A. Bajoku, Ferat. A. Bajoku, Ragip R. Mulolli, Fatime I. Berisha-Retkoceri, Mensur S. Mustafa, Zoja S. Mustafa, Isa A. Mustafa, Musa H. Berisha, Sofije A. Berisha, Naile A. Berisha, Bahri M. Mehmeti, Hasan r. Hyseni, Shefki R. Llugaliu, Kajtaz A. Sekiraqa, Fehmi A. Sekiraqa, Bajram A. Stublla. Ndërsa të vrvarrët e tjerë janë rrvarroshur në vendlindjet e tyre. Ata janë: Besim M. Hasani, Azem N. Ibishi, Nazif Rr. Ibishi, Hasan Sh. Bajrami, Fadil H. Ademi, Agron R. Tahiri, Zejnun M. Haziri, Hava R. Haziri, Ismet Xh. Zejnullahu, Esat K. Ahmeti, Rrahman B. Mustafa, Xhafer M. Mustafa, Islam I. Xhaka, Afrim F. Murati, Enver N. Maloku, Fehmi O. Musolli, Xhevat S. Jupolli, Bekim Q. Berisha, Enver S. Sefa, Shefki R. Llugaliu, Hyzri E. Selmani, Hazbije J. Selmani, Besim Z. Islami, Nysret F. Jaha, Faik A. Jaha, Adil A. Jaha, Sylejman J. Cakiqi, dhe Bahri Mehmeti.

Intervistoi: Nuhi Bytyqi

I MBIJETUARI QË PA VDEKJEN ME SY



Selman Morina, i mbijetuari i masakrës në Gulluboc të Malishevës

Milicia serbe na kanë marrë me duar të lidhura prapa, dhe na kanë rrahur e torturuar secilin prej nesh. Njeri prej tyre ka gjuajtur dhe na ka vrarë aty të gjithëve. Njërin që lëvizte e ka goditur me shqelmë, duke thënë: “ky qenka gjallë” dhe ia ka zbrazur edhe një rafal tjetër”. Edhe mua më ka goditur me shqelmë, mirëpo nuk kam lëvizur që të mos jap shenja se jam gjallë. Prandaj edhe kam shpëtuar, por i plagosur rëndë.

Ndërkohë janë tërhequr nga vendi i masakrës. Kanë dalë para dyerve të Ademit. Atëherë, e kanë kallur edhe një kerr dhe janë tërhequr krejtësisht. Kur kanë dalë në udhëkryq, aty ia kanë dhënë edhe një rafal. Kështu unë e kuptova që policët kanë shkuar dhe për nja 15 minuta a një gjysmë ore kam qenë në ankth. Asnjë prej banorëve të pushkatuar nuk kanë bërë asnjë faj. Unë tetë fëmijë i kam. Edhe vëllanë tim 25 vjeç ma kanë vrarë.

I mbijetuar i masakrës në Gulluboc është dhe **Musli Hoxha**, i cili pohon: “Më shumë se 300 vetë, me familje na kanë futur brenda në shtëpinë time, atje kemi ardhur prej milicisë serbe, na kanë futur atje, kanë ardhur 3 policë e kanë lypur, kanë folur, e kanë kërkuar raki. Iu thashë s’kemi raki, vetëm kafe kemi. Ua kam qitë tri kafe, e nuk i kanë pirë. Kemi ikur në mal me gra, me fëmijë krejt. Tani kanë ardhur milicia e na kanë rrethuar të gjithëve: burra e gra. Gratë i kanë lënë, ne burrave na kanë ndarë veçmas. Këta njerëz, i kanë thirrur veç me gisht, zgjohu ti, zgjohu ti, i ka ndarë, në vendin e quajtur Rreth i Hajdinit, edhe i kanë sjellë lidhur prej katundit deri këtu. Kur i kanë sjellë lidhur, të gjithë i kanë marrë i kanë rrahur me stupca, sfulq, me sëpata, me shati, me gjithçka, i kanë bërë llom duke i rrahur. Tani i kanë marrë disa automatikë të vegjël, i kemi dëgjuar ne prej shtëpisë këtu, kanë krisur disa automatikët. I kanë vrarë 13 vetë. Të vrarët ishin të Gollbocit, Pllaçicës, të Gllarevës, të Balincës, një ka qenë i Gjurgjicës, edhe një djalë të vëllait tim – Ramadan Hoxhën e kishin pasë vrarë në mal atje dhe e kishin pasë djegur.

Intervistoi: Nuhi Bytyqi

NGA PLUMBAT JAM PLAGOSUR NË DORË, SHPINË DHE NË FAQE



Ismet Rukolli, i mbijetuari i masakrës në Rezallë të Skënderajt

Më 5 prill të vitit 1999 rreth orës 10 kanë ardhur forcat serbe dhe na kanë nxjerrë nga shtëpia, duke na rrahur e duka na sharë. Na kanë prurë në oborrin e shtëpisë së Hashim Dergutit. Këtu na kanë mbajtur nga ora 11:00 e deri në orën 5:00 pasdite. Ka ardhur edhe një grup tjetër i ushtarëve nga drejtimi i Likocit. Ata kanë thënë se “po gjuajnë terroristët” dhe atëherë kanë filluar ndarjen e fëmijëve dhe të grave. Gratë dhe fëmijët i kanë nisur në drejtim të Likocit. Neve, burrat dhe të rinjtë na kanë qitur nën rrugë të Likocit. Rreth 30 policë kanë qenë në rrugë dhe kanë filluar t’i mbushin armët. Një ushtar serb me mitraloz ka hipur në shtëpinë e Hashim Dergutit. Ai ka filluar të gjuajë i pari, pastaj edhe gjithë të tjerët. Unë kam rënë për toke, jam plagosur në dorë dhe shpinë, gjithashtu kur kam rënë më kishte qëlluar plumbi në faqe. Mixha i babës Januzi më ka rënë përmbi. Gjuajtjet kanë zgjatur rreth gjysmë ore. Pastaj ka ardhur një ushtar, i cili i ka hyrë për së afërmi rreshtit dhe ka shtënë mbi të gjithë. Kur ka ardhur rendi tek unë, iu ka harxhuar municioni dhe kur e ka ndërruar karikatorin më ka kapërcyer. Unë kam qëndruar rreth 2 orë nën kufoma. Nuk e dija se a janë tërhequr, larguar forcat serbe nga shtëpia e Hashim Dergutit. Pas 2 orësh kanë filluar të lëvizin dhe të flasin Misin Deliu dhe Pajazit Kelmendi. Atëherë, e kam kuptuar se serbët janë larguar. Jam lëshuar zhagas 15 metra më poshtë. Kam ndenjtur aty deri në mesnatë. Aty ka ardhur Pajazit Kelmendi, Misin Deliu dhe Sadri Gashi, të cilët janë lëshuar më poshtë. Kah mesnata Pajazitit i kam thënë “a po vjen e largohemi nga këtu?”. Pajaziti ka qenë i plagosur rëndë dhe ka thënë “Jo, nuk muj. Po shkoj për Tushilë.” Kur kam dalë nën gardh, nën vendin e ekzekutimit të civilëve, e kam parë edhe bacin Dibran Rukollin, të cilin e kam njohur nga zëri. Më vonë e kam kuptuar që në Rezallë ishin vrarë e masakruar shumë shqiptarë civilë të pafajshëm.

Të vrarët nga forcat serbe në Rezallë të Skënderajt:

1. Adem O. Deliu 19939
2. Hetem O. Deliu 1944
3. Vesel O. Deliu 1947
4. Dermir H. Deliu 1939
5. Aziz I. Deliu 1943
6. Nezir Sh. Deliu 1932
7. Demir Sh. Rukolli 1952
8. Ilaz B. Rukolli 1940
9. Isuf I. Rukolli 1957
10. Januz H. Rukolli 1918
11. Jahë K. Rukolli 1981
12. Avdullah T. Rukolli 1965
13. Burhan H. Rukolli 1930
14. Besim S. Rukolli 1983
15. Dibran H. Rukolli 1932
16. Rexhep O. Rukolli 1924
17. Zymer S. Rukolli 1937
18. Bajram Z. Ahmeti 1935
19. Burim Xh. Zabeli 1985
20. Xhemajl H. Zabeli 1949
21. Shefqet K. Zabeli 1912
22. Sadri J. Zabeli 1939
23. Mehmet K. Zablei 1916
24. Latif I. Zableli 1944
25. Isuf R. Aruqi 1955
26. Jahë R. Aruqi 1953
27. Hisen B. Aruqi 1927
28. Shaban S. Aliu 1939
29. Sadik Z. Mulaj 1931
30. Ukë B. Hoti 1939
31. Përparim u. Hoti 1983

32. Azem B. Hoti 1939
33. Nazif A. Hoti 1951
34. Alush Hoti 1999
35. Rexhep F. Hoti 1931
36. Blerim B. Dibrani 1979
37. Nebih H. Kodra 1935
38. Rrahim U. Kadriu 1932
39. Zymer Z. Koca 1957
40. Pajazit M. Kelmendi 1929
41. Hamëz Z. Deliu 1959
42. Ismet H. Deliu 1942
43. Deli Rr. Deliu 1939
44. Bedri I. Deliu 1959
45. Mustafë S. Deliu 1963
46. Fazli H. Deliu 1968
47. Basri S. Deliu 1981
48. Lulver Z. Deliu 1987
49. Bleart S. Deliu 1992
50. Bahtije S. Rukolli 1912
51. Hamit Z. Rukolli 1936
52. Leutrim H. Ahmeti 1991
53. Malush H. Ahmeti 1951
54. Ramadan I. Ahmeti 1955
55. Elfije R. Ahmeti 1989
56. Xufë R. Ahmeti 1990
57. Vjollca F. Ahmeti 1993
58. Ali M. Ahmeti 1978
59. Muharrem S. Ahmeti 1933
60. Fadil H. Ahmeti 1976
61. Muhamet E. Ahmeti 1976
62. Avdullah Sh. Ahmeti 1958
63. Arben A. Ahmeti 1978
64. Safet Xh. Ahmeti 1983

65. Abedin N. Ahmeti 1981
66. Agron B. Ahmeti 1977
67. Besim B. Ahmeti 1981
68. Tafil I. Ahmeti 1981
69. Hamide S. Ahmeti 1917
70. Ramadan A. Gashi 1931
71. Refiqe M. Gashi 1925
72. Ferat M. Gashi 1938
73. Sadri M. Gashi 1941
74. Idriz Sh. Gashi 1944
75. Hana A. Zabeli 1915
76. Kada M. Zabeli 1966
77. Xhafer I. Zabeli 1942
78. Hajdar F. Zabeli 1918
79. Jashar H. Zabeli 1922
80. Isa M. Zabeli 1933
81. Sokol R. Zabeli 1935
82. Hajdin M. Zabeli 1920
83. Faton U. Aruqi 1980
84. Banush A. Aruqi 1937
85. Halim Sh. Aliu 1943
86. Ilaz A. Aruqi 1957
87. Abedin F. Vojvoda 1952
88. Xhemë M. Veseli 1971
89. Milazim M. Gashi 1961
90. Shehide Sh. Aruqi 1938
91. Nebih Z. Deliu 1925
92. Ibush B. Deliu 1945
93. Xhelil Z. Deliu 1927
94. Ahmet Sh. Deliu 1939

Intervistoi: Nuhi Bytyqi

I VRANË, I MASAKRUAN DHE I DOGJËN TRUPAT E TYRE



Halit Gashi, i mbijetuar i masakrës së Qyshkut

Më kujtohet, edhe kurrë s'do ta harroj atë ditë. 5 ushtarë serbë na maltretonin duke na sjellë sa andej sa këndej. Njëri ka qenë me mitraloz, të tjerët me automatikë. Ai me mitraloz është afruar afër derës, edhe na ka urdhëruar prej këtu të hyjmë përnjëherë në dhomë. Kemi hyrë prej këtu dhe menjëherë kemi vazhduar nën tytën e mitralozëve e automatikëve, kemi hyrë brenda në dhomë. Kur kemi hyrë në dhomë, na kanë urdhëruar të ulemi në kauç, këtu kanë qenë kauçët, ka qenë si kuzhinë kjo. Unë përnjëherë, prej që kam hyrë këtu, kam marrë këtë drejtim, edhe kam ardhur drejt, këtu ka qenë kauçi. Në anën e djathtë e kam pasur një mysafir, Isuf Shalën nga Grabovci i i Pejës. Në anën e majtë e kam pasur Arjan Çausht Lushin, 20 vjeçar, nga Qyshku, djalë hasreti, kurse të tjerët kanë qenë të ulur në kauç.

Gjatë asaj kohe, i kam parë kur u ndez flaka e mitralozit që është parë, drejt në mua këtu qe, edhe u shkrep rafali i parë këtu, të shtëna pandërprerë. Janë kthyer edhe një herë kështu. Ky në anën e djathtë e di veç kur ka rënë, edhe këtë këmbë ma ka zënë, pak këtë pjesë të këmbës, në anën e djathtë. Ky në anën e majtë, e kam pasur dorën mbi të, ulur, ky vetëm pak trupi i ka luajtur, nuk i është ndier asnjë krismë, asnjë britmë. Ne të gjithë, prej kauçit kemi rënë në tokë, prej asaj pjese edhe prej kësaj pjese, këtu një përtej Arianit ka qenë i ramë në kauç, kështu, ka dalë prej asaj pjese në anën tjetër. Atje e ka ndezur një batanije edhe ka filluar të shtie prej asaj ane, tash ky në tokë, për herë të katërt. Unë jam plagosur, në atë moment, më ka marrë plumbi në anën e majtë, tash vetëm shihet që plaga ka nisur të shërohet. Shihe këtu hyrja është dhe dalja, rafalin tjetër më ka marrë këtu, edhe e ka qitur në këmbën e djathtë, këtu më kanë marrë, një mbas njërit, këmbën e djathtë ma kanë thyer, në shtatë a tetë vende është e thyer, për fat, Zoti deshi të shpëtoj unë nga më e keqja.

Forcat serbe i kanë ekzekutuar këtu djalin e axhes, Hakiun dhe vëllanë Selimin. Neve na kanë çuar te Fabrika e baterive, aty kishte qenë grupi i madh i forcave serbe që kontrollonte çdo gjë. Na kanë ndalë rrafsh dy orë a

më shumë, derisa janë marrë vesh me kolegët e tyre të cilët kishin vrarë, masakruar dhe djegur shqiptarët në këtë fshat. Atëherë, na kanë kthyer, kur kemi ardhur ne këtu, përnjëherë kemi tentuar, duke i kërkuar se ku janë njerëzit tanë. Atë natë s'kemi mundur se ka qenë ende duke dalë flaka dhe zjarri shkruvonte gjithçka. Aty ishin djegur trupat e njerëzve tanë. Të nesërmen kemi marrë e i kemi varrosur, ata eshtra që kemi mund t'i marrim, i kemi varrosur atje, s'kemi guxuar të dukemi më, jemi frikësuar mos po na shohin dhe do të vijnë e të na vrasin edhe neve.

Pra më 13 dhe 14 maj të vitit 1999 në fshatin Qyshk të Pejës ka ndodhur një ndër masakrat më makabre të forcave ushtarake e policore serbe ndaj popullatës civile shqiptare. Janë ekzekutuar dhe pastaj janë djegur në mënyrën më barbare 42 meshkuj.

Më së shumti kanë pësuar pjesëtarë të familjes Lushi, Gashi, Kelmendi, të familjes së gjeneral Agim Çekut, ku ishte vrarë nga forcat serbe babai i gjeneral Çekut, Hasan Çeku, si dhe pjesëtarë të familjeve të tjera.

Më 14 maj, në Qyshk janë vrarë e masakruar këta shqiptarë të paarmatosur:

1. Ramë Dervish Gashi (65), 2. Xhafer Ramë Gashi (40), 3. Rrahim Dervish Gashi (55), 4. Rasim Hysen Ramaj (45), 5. Metë Shala (55), 6. Selim Maxhun Gashi (50), 7. Haki N. Gashi (45), 8. Jashar Azem Gashi (58), 9. Muharrem Azem Gashi (50), 10. Avni Drevish Gashi (50), 11. Skënder Dervish Gashi (35), 12. Musë Shaban Gashi (63), 13. Ibish Kadri Gashi (55), 14. Rrahim Shaban Gashi (55), 15. Ahmet Rustem Gashi (35), 16. Emin Bekë Gashi (60), 17. Emrush Krasniqi, mysafir nga Vranoci, 18. Ismet Bajraktari, mysafir nga Raushiqi, 19. Hasan Metë Avdyli – mysafir nga Batusha, 20. Gani Avdyli, mysafir nga Batusha, 21. Hasan Ahmet Çeku (69), 22. Bedri Ahmet Çeku (65), 23. Isuf Shala, mysafir nga Grabovci, 24. Çausht Rustem Lushi, 25. Ardian Çausht (30), 26. Ardian Çausht Lushi (20), 27. Osman Haxhi Lushi (48), 28. Sefedin Haxhi Lushi (44), 29. Avdullah Lush Lushi (45), 30. Ukë Lush Lushi (43), 31. Ramiz Lush Lushi (40), 32. Xhafer Lush Lushi (35), 33. Skënder Lush Lushi (30), 34. Nifa Din Kelmendi (55), 35. Skënder Din Kelmendi (50), 36. Besim Din Kelmendi (38), 37. Ardian Skënder Dina (20), 38. Rrahim Sylë Kelmendi (40), 39. Xhemë Isuf Kelmendi (40), 40. Mentor Shaban Kelmendi (22), 41. Avdi Shaban Berisha (58) dhe 42. Zeqir Aliaj – mysafir nga Zillopeku.

Intervistoi: Nuhi Bytyqi

GJENOCIDI DHE MASAKRAT E SERBISË NË KOSOVË
(1998-1999)

Konferencë shkencore
(28 prill 2023)

2023

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Bahri Koskoviku

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 26.5 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51)“1998/1999”(062)
323.282(496.51)“1998/1999”(062)

Gjenocidi dhe masakrat e Serbisë në Kosovë : (1998-1999) : konferencë shkencore = Genocide and massacres of Serbia in Kosova : (1998-1999) : Scientific Conference / Këshilli organizues Isa Mustafa ... [etj.]. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2023. - 421 f. ; 24 cm. - (ASHAK : Seksioni i Shkencave Shoqërore)

1. Mustafa, Isa 2. Bajraktari, Jusuf 3. Bajrami, Arsim
4. Manaj, Ramë 5. Demaj, Frashër

ISBN 978-9951-26-077-0